KOMBET E BASHKUARA

	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991	Lënda Nr.	IT-04-82-T
		Data:	10 korrik 2008
		Origjinali:	anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: **Gjykatësit Kevin Parker, Kryegjykatës**
Gjykatëses Christine Van Den Wyngaert
Gjykatësit Krister Thelin

Sekretari: **Z Hans Holthuis**

Aktgjykimi i datës: **10 korrik 2008**

PROKURORJA

kundër

LUBE BOSHKOSKIT
JOHAN TARÇULOVSKIT

PUBLIK

AKTGJYKIM

Zyrës së Prokurorit:

Z. Dan Saxon
Znj. Antoinette Issa
Znj. Joanne Motoike
Z. Gerard Dobbyn
Znj. Meritxell Regue
Znj. Nisha Valabhji
Z. Matthias Neuner

Avokatëve të të Akuzuarve:

Znj. Edina Reshidoviq dhe Z. Guénaël Mettraux për Lube Boshkoskin

Z. Antonio Apostolski dhe Znj. Jasmina Zhivkoviq për Johan Tarçulovskin

PASQYRA E LËNDËS

I. HYRJE 5

II. FAKTORË TË VLERËSIMIT TË PROVAVE 10

III. KONTEKSTI 16

IV. NGJARJET NË LUBOTEN DHE RRETHINAT E TIJ 19

A. NGJARJET E 12 GUSHTIT 2001 DHE DITËVE TË MËVONSHME 19
B. NJËSITË E USHTRISË MAQEDONASE TË PËRFSHIRA NË NGJARJET NË LUBOTEN 52
C. NGJARJET E 10 GUSHTIT 2001 53
D. NGJARJET E 11 GUSHTIT 2001 61
E. A ISHIN NGJARJET NË LUBOTEN TË PËRLIGJURA PREJ DOMOSDOSHMËRISË USHTARAKE? 68
1. Prania dhe baza logjistike e UÇK-së në Luboten 70
2. Ushtria maqedonase e dislokuar pranë Lubotenit 75
3. Pozicione të mundshme të UÇK-së në Luboten si objektiva më 12 gusht 77
4. Konkluzion 94

V. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË NENIT 3 TË STATUTIT 97

A. KONFLIKTI I ARMATOSUR 97
1. Ligji 97
(a) Ashpërsia 99
(b) Organizimi i grupit të armatosur 111
2. Përfundime 118
(a) Ashpërsia e konfliktit 118
(b) Organizimi i grupit të armatosur 144
3. Konkluzion 165
B. LIDHJA MIDIS VEPRIMEVE QË PRETENDOHET SE JANË KRYER NGA TË AKUZUARIT DHE KONFLIKTIT TË ARMATOSUR 165
C. KUSHTET *TADIQ* 168
D. A MERRNIN PJESË AKTIVE NË LUFTIME VIKTIMAT 169

VI. AKUZAT 171

A. VRASJE (PIKA 1) 171
1. Ligji 171
2. Përfundime 171
(a) Rami Jusufi 171
(b) Sulejman Bajrami 176
(c) Muharem Ramadani 180
(d) Atulla Qaili 184
(e) Xhelal Bajrami, Bajram Jashari dhe Kadri Jashari 187
3. Konkluzion 193
B. SHKATËRRIM PA SHKAK (PIKA 2) 193
1. Ligji 193
2. Përfundime 197
3. Konkluzion 205
C. TRAJTIM MIZOR (PIKA 3) 205
1. Ligji 206
2. Përfundime 206
3. Konkluzion 211

VII. PËRGJEGJËSIA 212

A. LIGJI 212
1. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(1) 212
(a) Kryerja e krimit përmes pjesëmarrjes në një ndëmarrje të përbashkët kriminale 212
(b) Planifikimi 215
(c) Nxitja 215
(d) Urdhërimi 216
(e) Ndihma dhe inkurajimi 216
2. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(3) të Statutit 218
(a) Marrëdhënia epror-vartës 219
(b) Elementi mendor: Eprori dinte apo kishte arsye të dinte 221
(c) Masat e nevojshme dhe të arsyeshme 222
B. PËRFUNDIME NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË E LUBE BOSHKOSKIT 224
1. Roli i Lube Boshkoskit në ngjarjet e 12 gushtit 224
2. Njoftimi për gjykatësin hetues 228
3. Përpjekjet hetimore prej Ministrisë së Brendshme 230
(a) Komisioni i krijuar më 13 gusht 2001 230
(b) Informacione të tjera të marra nga Lube Boshkoski në gusht/shtator 2001 236
(c) Çështje të tjera 239
(d) "Hetime" të tjera 242
(i) Grupi i punës për krimet e luftës 242
(ii) Puna e Zj. Sofija Galeva-Petrovska 244
(iii) Komisioni Zoran Jovanovski 246
4. Përgjegjësia e Lube Boshkoskit 247
(a) Struktura organizative e Ministrisë së Brendshme 247
(i) Njësitë organizative rajonale dhe vendore të Ministrisë së Brendshme 250
(ii) Njësitë e posaçme policore 253
(iii) Pozita e policëve rezervistë në Ministrinë e Brendshme 254
(iv) "Kometa" 256
(b) Kompetencat *de jure* dhe *de facto* të Lube Boshkoskit 257
(c) Dijenia dhe veprimet e Lube Boshkoskit 265
(d) Përfundime 272
C. PËRFUNDIME MBI PËRGJEGJËSINË E JOHAN TARÇULOVSKIT 273
1. Roli i Johan Tarçulovskit 273
2. Përgjegjësia e Johan Tarçulovskit 284
(a) Urdhërimi, planifikimi, nxitja dhe ndihma dhe inkurajimi 285
(b) Ndërmarrja e përbashkët kriminale 291

VIII. PËRCAKTIMI I DËNIMIT 296

A. PESHA E KRIMIT 297
B. RRETHANAT INDIVIDUALE TË TË AKUZUARIT: RRETHANA RËNDUESE DHE LEHTËSUESE 299
C. PRAKTIKA E PËRGJITHSHME NË GJYKATAT E IRJM-SË DHE NË KËTË TRIBUNAL 301
D. LLOGARITJA E KOHËS SË PARABURGIMIT 302

IX. VENDIM 303

X. SHTOJCA I: FJALORI 305

XI. SHTOJCA II: HISTORIA PROCEDURALE 316

A. FAZA PARAGJYQËSORE 316
1. Konfirmimi i aktakuzës fillestare, arrestimi dhe paraqitja e parë 316
2. Mospranim i jurisdiksionit të Tribunalit 316
3. Historia e Aktakuzës 319
4. Kërkesa për lirim të përkohshëm 323
5. Fillimi i procesit 325
B. PROCESI GJYQËSOR 325

1. Vështrim i përgjithshëm.....325
2. Çështje lidhur me dëshmitarët 326
3. Vendimi në lidhje me pranueshmërinë e provave.....326

I. HYRJE

1. Aktakuza akuzon të Akuzuarit, Lube Boshkoski dhe Johan Tarçulovski, për krime të kryera kundër shqiptarëve etnikë në fshatin Luboten, në pjesën veriore të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë ("IRJM"), nga 12 deri më 15 gusht 2001.[1] Pretendohet se këto veprime u kryen gjatë një konflikti të armatosur, i cili, siç pretendohet, filloi në janar 2001 dhe vazhdoi të paktën deri në fund të shtatorit 2001, midis forcave të sigurisë së IRJM-së, d.m.th., ushtrisë dhe policisë, nga njëra anë,[2] dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare shqiptare ("UÇK") nga ana tjetër. Duhet theksuar se kjo është çështja e vetme para këtij Tribunali lidhur me pretendimet e ngritura për gjendjen në IRJM, në vitin 2001.

2. Aktakuza pretendon se më 12 gusht, fshati Luboten u bë objekt i një sulmi të përbashkët nga policia e drejtuar prej Johan Tarçulovskit, si dhe nga ushtria e IRJM-së. Pretendohet se gjatë sulmit policia vrau gjashtë banorë të Lubotenit. Më tej pretendohet se 13 banorë shqiptarë etnikë u rrahën rëndë në shtëpinë e Adem Ametovskit më 12 gusht, se 10 individë nga ky grup prej 13 vetësh, u shoqëruan për në postbllokun e policisë në shtëpinë e Bracës dhe se ata u rrahën si gjatë rrugës për në këtë postbllok, po ashtu dhe kur mbërritën atje. Pretendohet se këta burra u keqtrajtuan përsëri fizikisht dhe psikologjikisht në stacionin policor të Mirkovcit. Pretendohet se një prej tyre vdiq për shkak të trajtimit mizor të pësuar. Gjithashtu pretendohet se më 12 gusht, të paktën 90 banorë civilë meshkuj të Lubotenit u arrestuan në postbllokun e Buzallakut ndërkohë që po largoheshin nga fshati së bashku me familjet e tyre dhe se nga ky postbllok ata u transportuan dhe u mbajtën në stacione të ndryshme policore dhe, në disa raste, në Gjykatën II të Shkupit si dhe në Spitalin e Qytetit të Shkupit. Pretendohet se burrat e mbajtur në këto vende të ndryshme, u rrahën përsëri. Më tej në Aktakuzë deklarohet se të paktën 14 shtëpi në fshat u dogjën nga policia e komanduar nga Johan Tarçulovski. Mbi

[1] Dhoma Gjyqësore pranon se nëpërmjet rezolutës A/RES/47/225 të 8 prillit 1993, Asambleja e Përgjithshme vendosi të pranojë si anëtar të Kombeve të Bashkuara shtetin, përkohësisht i quajtur për të gjitha qëllimet brenda Kombeve të Bashkuara si "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë," deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me emrin e tij.

[2] Në disa raste kur janë përmendur Forcat Maqedonase të Sigurisë në dëshmitë dhe në këtë Aktgjykim, nuk bëhet dallim midis policisë dhe ushtrisë, që të dyja pjesë të Forcave Maqedonase të Sigurisë. Në varësi të kontekstit, përmendja e Forcave Maqedonase të Sigurisë mund të përfshijë si policinë ashtu dhe ushtrinë, apo vetëm një prej tyre.

bazën e këtyre pretendimeve, Aktakuza akuzon të Akuzuarit për tri pika të shkeljeve të ligjeve apo zakoneve të luftës, konkretisht, vrasje, trajtim mizor, dhe shkatërrim pa shkak, në bazë të Nenit 3 të Statutit.

3. Lube Boshkoski, Ministër i Brendshëm ("MB") i IRJM-së nga maj 2001 deri në nëntor 2002, akuzohet për përgjegjësi individuale penale në bazë të Nenit 7(3) të Statutit. Pretendohet se, si epror, ai ka përgjegjësi penale për krimet e policisë së rregullt dhe rezerviste, duke përfshirë njësitë e posaçme të policisë; pra, si për kryerjen e krimeve nga këto forca policore, po ashtu dhe për veprimet apo mosveprimet e atyre policëve që ndihmuan dhe nxitën rojet e burgjeve, personelin e spitaleve, dhe civilët për kryerjen e krimeve të përfshira në Aktakuzë. Pretendohet se ai ushtronte kontroll *de jure* dhe *de facto* ndaj policëve që morën pjesë në krimet e akuzuara dhe se kishte dijeni për krimet e kryera nga vartësit e tij në Luboten, ndër të tjera, nëpërmjet vëzhgimeve të tij të drejtpërdrejta të pronave të dëmtuara dhe të arrestuarve të keqtrajtuar pranë vendit të sulmit në pasditen e 12 gushtit, nëpërmjet takimeve me pjesëmarrësit në sulmin e 12 gushtit, nëpërmjet raporteve të brendshme të policisë, njoftimeve në media, raporteve të organizatave ndërkombëtare të bëra publike pak ditë dhe javë pas krimeve, si dhe nëpërmjet takimeve me përfaqësues dhe gazetarë të huaj. Pretendohet se ai kishte dijeni për përgatitjen dhe pjesëmarrjen e policisë së drejtuar nga Johan Tarçulovski në sulmin e Lubotenit më 12 gusht. Gjithashtu, pretendohet se nga 12 gushti 2001 deri në maj 2002 (datë në të cilën Prokurorja e TPNJ-së informoi autoritetet maqedonase se kishte vendosur të ushtronte të drejtën e përparësië së juridiksionit të Tribunalit, ndër të tjera, në lidhje me çështjen e Lubotenit), si epror, Lube Boshkoski kishte detyrim që të hetonte krimet dhe të merrte masa ndëshkuese ndaj keqbërësve, mirëpo ai nuk e bëri një gjë të tillë. Rrjedhimisht duhet përmendur se Lube Boshkoski nuk akuzohet për kryerjen e krimeve të akuzuara dhe as për mosparandalimin e këtyre krimeve, por për mosmarrjen e masave për ndëshkimin e autorëve të krimeve të pretenduara.

4. Johan Tarçulovski, në atë kohë polic me detyrën e Inspektorit Shoqërues në Trupën e Sigurimit të Presidentit, në Ministrinë e Brendshme, akuzohet për përgjegjësi individuale penale në bazë të Nenit 7(1) të Statutit, për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale ("NPK"), nga 10 deri më 12 gusht 2001, qëllimi i së cilës

pretendohet se ishte kryerja e një sulmi të paligjshëm kundër civilëve dhe objekteve civile në fshatin Luboten, sulm i cili nuk justifikohej prej domosdoshmërisë ushtarake, gjë që përbën krim në bazë të Nenit 3 të Statutit. Pretendohet se ai bashkëpunoi me anëtarë të njohur dhe të panjohur të NPK-së në forcat e rregullta dhe rezerviste të policisë së IRJM-së, të cilët ishin nën komandën e tij në MB. Pretendohet se Johan Tarçulovski mori pjesë në NPK, duke qenë në dijeni për objektivat e saj të paligjshme, ndër të tjera, nëpërmjet përzgjedhjes së individëve për formimin e njësisë së policisë së rregullt dhe rezerviste, që morën pjesë në sulm, duke kërkuar dhe siguruar për këtë sulm mbështetje logjistike, materiale, dhe me armë zjarri nga komandantët më të lartë të policisë dhe ushtrisë të bazuar në zonën e Lubotenit, nëpërmjet përcaktimit të kohës, metodës, mënyrës, qëllimeve dhe objektivave të sulmit, si dhe mbi bazën e pozitës së tij si epror nëpërmjet urdhërimit të policëve e rregullt dhe rezervistë në njësinë e tij, që të sulmonin Lubotenin. Pretendohet se krimet e akuzuara në Aktakuzë përputhen me qëllimin e NPK-së, apo janë pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të qëllimit të NPK-së. Gjithashtu, Johan Tarçulovski akuzohet për përgjegjësi individuale penale në bazë të Nenit 7(1) për urdhërimin, planifikimin, nxitjen, dhe ndihmën dhe inkurajimin e krimeve të akuzuara. Aktakuza nuk e akuzon Lube Boshkoskin për pjesëmarrje në NPK-në e pretenduar së bashku me Johan Tarçulovskin. Po ashtu, Aktakuza nuk pretendon pjesëmarrjen e ushtrisë së IRJM-së në synimin kriminal të NPK-së së pretenduar. Lidhur me ngjarjet më 12 gusht, Aktakuza është e përqëndruar në veprimet e policisë.

5. Lube Boshkoski dhe Johan Tarçulovski u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me pikat për të cilat akuzohen.

6. Në maj 2002, Prokurorja e Tribunalit informoi autoritetet maqedonase për vendimin e saj për të ushtruar privilegjin e përparësisë juridiksionale të Tribunalit, ndër të tjera, në lidhje me akuzar lidhur me veprimet e forcave maqedonase kundër civilëve shqiptarë etnikë në IRJM, në vitin 2001, ndër të cilat akuzat për krime në Luboten.[3] Në bazë të Rregullave 9(iii) dhe 10 të Rregullores, më 5 shtator 2002, Prokurorja paraqiti një

[3] Prova materiale P391, *Në Re: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, "Prosecutor's Request for Deferral and Motion for Order to the Former Yugoslav Republic of Macedonia", 5 September 2002, paras 3, 6-7. ("Kërkesa e Prokurorit për Transferim Kompetence dhe Mocion për Urdhër adresuar Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë," 5 shtator 2002, para. 3, 6-7).

kërkesë për transferim juridiksioni.[4] Me vendim të datës 4 tetor 2002, një Dhomë Gjyqësore[5] i kërkoi formalisht Qeverisë së IRJM-së të urdhëronte gjykatat shtetërore që, ndër të tjera, t'i përcillnin Tribunalit hetimin për Lubotenin,[6] dhe t'i dërgonin Zyrës së Prokurorisë së Tribunalit në Hagë rezultatin e hetimit, një kopje të dokumentave gjyqësore, si dhe vendimet e gjykatave shtetërore, në rast se këto të fundit kishin shpallur ndonjë vendim.[7]

7. Theksohet se prej fillimit të vitit 2001 në IRJM ka patur prani ndërkombëtare, ndër të tjera, të OSBE-së, KFOR-it dhe NATO-s. Më 13 gusht u nënshkrua Marrëveshje Kuadër e Ohrit nga Qeveria e IRJM-së dhe përfaqësuesit e shqiptarëve etnikë në përpjekje për t'i dhënë fund dhunës që kishte përfshirë IRJM-në në 2001. Në gusht dhe shtator 2001 u krye operacioni "Essential Harvest" i udhëhequr nga NATO për çarmatosjen e individëve të përshkruar si rebelë shqiptarë etnikë.

8. Megjithëse ngjarjet e pretenduara diskutohen hollësisht në pjesët përkatëse të këtij Aktgjykimi, Dhoma Gjyqësore shpreh këtu përfundimin e vet, se më 12 gusht 2001 fshati Luboten u sulmua gjatë një operacioni policor të mbështetur nga ushtria maqedonase. Gjatë këtij operacioni u qëlluan dhe u vranë gjashtë banorë meshkuj të Lubotenit, shqiptarë etnikë. Një banor tjetër shqiptar etnik vdiq të nesërmen si rezultat i keqtrajtimit të egër më 12 gusht. Gjatë asaj dite, shumë banorë të fshatit u ndaluan në një postbllok policor në afërsi të fshatit, ku policia ndau burrat nga gratë dhe fëmijët dhe i keqtrajtoi ata. Pasi përfundimit të operacionit në Luboten në orët e para të pasdites, një numër i madh burrash shqiptarë etnikë, banorë të fshatit, u transferuan në stacione policore jo larg Lubotenit, ku u keqtrajtuan nga policia dhe të tjerët. Gjatë sulmit policia u vuri zjarrin shtëpive në Luboten, duke përdorur benzinë apo lëndë të tjera djegëse. Të shtatë banorët e vrarë u varrosën në Luboten, mirëpo në vitin 2002 kufomat e tyre u zhvarrosën dhe u

[4] Prova materiale P391, para. 1, 21.
[5] Gjykatësi Liu Daqun (kryegjykatës), Gjykatësi El Mahdi dhe Gjykatësi Orie.
[6] Qeverisë së IRMJ-së iu kërkua gjithashtu formalisht të urdhëronte të gjitha gjykatat e saj për transferim kompetencash në lidhje me të gjitha hetimet dhe procedimet penale lidhur me "çështjen e udhëheqjes së UÇK-së," çështjen e "Punëtorit të Rrugës së Mavrovës," çështjen e "Rezervuarit të Ujit të Lipkovës," dhe çështjen "Neproshteno," Prova materiale 1D218, f. 19, para. 1.
[7] Prova materiale 1D218, Lënda Nr. IT-02-55-MISC.6, *Në Re: Republika e Maqedonisë*, "Kërkesa e Prokurorit për Transferim Kompetence dhe Mocion për Urdhër adresuar Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë," 4 tetor 2002, f. 19, para. 1-2 të Vendimit.

kryen autopsi për përcaktuar, ku ishte e mundur, lëndimet e pësuara dhe shkakun e vdekjes.

II. FAKTORË TË VLERËSIMIT TË PROVAVE

9. Neni 21(3) i Statutit garanton supozimin e pafajësisë si e drejtë e çdo të Akuzuari. Ky supozim e ngarkon Prokurorinë me detyrimin për të vërtetuar fajësinë e të Akuzuarit, detyrim që i mbetet Prokurorisë gjatë gjithë procesit gjyqësor. Lidhur me secilën prej të tri pikave të akuzës kundër secilit prej dy të Akuzuarve, standardi që duhet të plotësohet për shpalljen e fajësisë së tyre, është vërtetimi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.[8] Rrjedhimisht, lidhur me secilën pikë të akuzës kundër secilit të Akuzuar, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar, mbi bazën e të gjitha provave, nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për vërtetimin e çdo elementi të atij krimi dhe të formave të përgjegjësisë të shprehura në Aktakuzë. Duke vepruar kështu, lidhur me disa çështje Dhoma Gjyqësore ka qenë e detyruar të nxjerrë një ose me tepër se një konkluzion nga faktet e përcaktuara prej provave. Në rastet kur ishte e arsyeshme që nga faktet të nxirrej më tepër se një konkluzion, Dhoma Gjyqësore është treguar e kujdesshme në vlerësimin nëse konkluzioni i dytë i aryeshëm nxjerrë prej fakteve nuk përputhej me fajësinë e të Akuzuarit. Në një rast të tillë, detyrimi dhe standardi i provës kërkon që për atë pikë të shpallet pafajësia.[9]

10. Dhoma Gjyqësore dëshiron të theksojë se pranimi i një prove gjatë procesit gjyqësor nuk ka asnjë ndikim në përcaktimin e mëvonshëm të rëndësisë së kësaj prove nga Dhoma Gjyqësore.

11. Në këtë proces, Dhoma Gjyqësore mori dëshmi nga një numër dëshmitarësh, në atë kohë banorë të fshatit Luboten ku pretendohet se kanë ndodhur ngjarjet e përmendura në Aktakuzë. Dhoma Gjyqësore dalloi një prirje të qartë të këtyre dëshmitarëve për të folur me një zë të vetëm, veçanërisht për çështje të tilla si prania ose jo e ushtarëve të UÇK-së në fshat, rrethanat në të cilat ndodhën vdekjet, si dhe identiteti i forcave maqedonase që hynë në fshat më 12 gusht 2001. Kjo i krijoi Dhomës Gjyqësore përshtypjen e qartë se para ardhjes së tyre në Tribunal, këta dëshmitarë ishin përgatitur për të dhënë dëshmi të parapërcaktuara lidhur me disa çështje. Dhoma Gjyqësore ka

[8] Rregulla 87(A) e Rregullores parashikon në pjesë përkatëse përcakton: "[…] Verdikti i fajësisë mund të jepet vetëm kur shumica e Dhomës Gjyqësore binden se është vërtetuar fajësia jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm."

[9] *Čelebići* Appeals Judgement/ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458.

gjithashtu parasysh rëndësinë e vlerave të grupit, nderit, dhe besnikërisë familjare në traditën kulturore të dëshmitarëve me prejardhje shqiptare.[10] Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranonte dëshmitë e tyre si plotësisht bindëse në disa aspekte. Në çështje të tjera pati shumë mospërputhje midis disa dëshmitarëve, megjithëse në këtë rast dukej se mospërputhjet nuk ishin për shkak të pandershmërisë së dëshmitarëve, por për shkak të dallimeve në aftësinë e tyre vëzhguese apo kujtesën mbi ngjarjet. Në këto aspekte Dhoma Gjyqësore i ka trajtuar dëshmitë me rezervë.

12. Gjithashtu shumë anëtarë të policisë dhe ushtrisë maqedonase të përfshirë apo të pranishëm në ngjarjet e pretenduara në Aktakuzë apo në ngjarje lidhur me to, të cilët dhanë dëshmi para Tribunalit, i krijuan Dhomës Gjyqësore përshtypjen e qartë se nëpërmjet dëshmive të tyre ata u orvatën të distancoheshin nga çfarëdo veprimi keqbërës të forcave maqedonase, apo të shfajësoheshin ose të shfajësonin veprimet e policisë apo të ushtrisë. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk mund t'i pranonte disa nga këto dëshmi si të vërteta apo të besueshme.

13. Gjatë dëshmive të disa dëshmitarëve, veçanërisht të disa punonjësve të mëparshëm apo të tanishëm të Ministrisë së Brendshme apo disa institucioneve të tjera publike maqedonase, u duk qartë se për disa çështje dëshmia e tyre gojore para Dhomës Gjyqësore ishte materialisht e ndryshme nga ajo çka dëshmitari kishte thënë në deklaratën që i kishte dhënë më parë Prokurorisë. Natyra e këtyre dallimeve si dhe shpjegimet e dëshmitarëve e bindën Dhomën Gjyqësore se, në shumicën e rasteve, shpjegimet e dhëna për këto dallime nuk ishin të sinqerta dhe se dëshmia gojore e dhënë para Dhomës Gjyqësore nuk ishte e vërtetë. Në shumë raste të kësaj natyre, Dhoma Gjyqësore krijoi mendimin se kur vinin për të dhënë dëshminë para Tribunalit, dëshmitarët ishin të shqetësuar për ndikimin sipas gjykimit të tyre që dëshmia mund të kishte në karrierën e tyre nëqoftëse do t'i përmbaheshin deklaratave të tyre të mëparshme.

14. Dhoma Gjyqësore konstatoi gjithashtu se dëshmitë e disa dëshmitarëve të Mbrojtjes, punonjës të mëhershëm apo të tanishëm të Ministrisë së Brendshme, veçanërisht të ish-vartësve të Lube Boshkoskit, dukej se ishin ndikuar nga një ndjenjë

[10] *Shih* Provën Materiale 2D109.

besnikërie ndaj eprorit të tyre të mëparshëm, apo nga mendimi se dëshmia e tyre do të ndikonte në punësimin apo karrierën e tyre në ministri.

15. Për disa çështje, dëshmitë karakterizohen nga dallime të konsiderueshme. Kjo vështirësi prek veçanërisht referencat kohore për ngjarjet materiale më 12 gusht 2001. Nuk është e habitshme të ketë ndryshime në lidhje me referencën kohore të ngjarjeve duke qenë se ky faktor kishte pak rëndësi për njerëzit e përfshirë në to. Rrjedhimisht ka shumë të ngjarë që dëshmitarët, të kenë gabuar joqëllimisht apo të kenë qenë të pasigurtë për kohën kur kanë ndodhur ngjarjet. Mirëpo, në lidhje me disa dëshmitarë, veçanërisht dëshmitarë të ushtrisë dhe të policisë, natyra e dëshmive të tyre konkrete, mënyra e dhënies së dëshmisë si dhe, në disa raste, dallimet midis dëshmive të tyre dhe raporteve ose deklaratave të mëparshme, krijojnë përshtypjen e qartë se koha kur ndodhën ngjarjet, duke përfshirë renditjen e disa ngjarjeve, u manipulua apo u ngatërrua qëllimisht. Gjithsesi, duke marrë parasysh dëshmitë e tjera, Dhoma Gjyqësore, pasi peshoi dëshmitë të tjera dhe hodhi poshtë dëshmitë kundërthënëse dhe mospërputhëse, ishte në gjendje të arrinte në konkluzione për kohën dhe renditjen e ngjarjeve materiale në fjalë.

16. Në veçanti, duke patur parasysh çështjet e lartpërmendura, Dhoma Gjyqësore është bindur se duhet të hedhë poshtë apo të shqyrtojë me kujdes dëshmitë e disa anëtarëve të ushtrisë dhe policisë për njerëzit dhe ngjarjet që ata supozuan se kishin parë në Luboten më 12 gusht, kohën kur ndodhën disa ngjarje, si dhe për operacionet e njësive ushtarake supozimisht si reagim ndaj zhvillimeve në Luboten. Lidhur me këto çështje si dhe ngjarjet më 10 dhe 11 gusht, dëshmitë e dëshmitarëve të ushtrisë karakterizohen nga shumë dallime midis tyre, si dhe bien ndesh me raportet dhe deklaratat e mëparshme. Dhomës Gjyqësore iu krijua përshtypja e qartë se shumë nga këto dëshmi ishin sajuar për të përligjur, nga pikëpamja ligjore, operacionet e ushtrisë ose për të rritur reputacionin e ushtrisë për efikasitet dhe rendiment.

17. Gjithashtu, siç do të trajtohet më hollësisht në këtë vendim, nga përmbajtja e dëshmive të tyre, në disa raste nga mënyra e dhënies së dëshmisë, nga raportet dhe deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve, si dhe nga efekti i dëshmive kundërthënëse, që përbënte element bindës për Dhomën Gjyqësore, ishte e qartë se disa dëshmitarë të

ushtrisë dhe policisë po ndryshonin dëshminë e tyre për të mos hedhur dritë mbi natyrën e vërtetë të ngjarjeve ku kishin marrë pjesë si dhe për shmangien e të vërtetës mbi rolin e tyre në disa incidente. Me pak fjalë, këta dëshmitarë u orvatën të mbronin veten nga mundësia e përballjes me akuza të rënda në këtë Tribunal apo gjetiu.

18. Mbrojtja ka ngritur disa shqetësime lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit të Prokurorisë Franz-Josef Hutsch. Z. Hutsch, gazetar në profesion të lirë, por që njëkohësisht mblidhte të dhëna ushtarake për një qeveri tjetër,[11] dëshmoi para Tribunalit si dëshmitar i Prokurorisë. Ai tha se vizitoi Lubotenin në datat e përmendura në Aktakuzë dhe se pa ngjarjet e rëndësishme që pretendohet se kanë ndodhur në fshat dhe gjetiu.[12] Megjithëse po të ishte pranuar, kjo dëshmi do të kishte qenë tepër e rëndësishme, për arsyet e shpjeguara më poshtë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë se Franz-Josef Hutsch ka qënë në IRJM, apo se ka qenë me të vërtetë i pranishëm në Luboten, më 12 gusht apo në ditët e mëvonshme. Z. Hutsch dëshmoi se ai ngiste një xhip të bardhë mbi të cilin dalloheshin shkronjat TV.[13] Ky nuk është automjet i zakonshëm dhe do të kishte rënë në sy. Mirëpo nuk ka dëshmi që një automjet i tillë të jetë parë në postbllokun e policisë ku ai thotë se ndaloi ose nga pozicionet e ushtrisë mbi Luboten nga ku ushtria vëzhgonte veprimet brenda fshatit dhe rreth tij. Megjithëse ai dëshmoi se gjatë ngjarjeve të 12 gushtit 2001 kaloi përmes fshatit nga lindja në perëndim me makinën e tij që e ndiqte pas,[14] asnjë nga banorët e Lubotenit dhe vëzhguesit e ngjarjeve të asaj dite të cilët dëshmuan, nuk thanë se e kishin parë atë, që mund të kishte konfirmuar praninë e Franz-Josef Hutsch atje. Nuk është paraqitur asnjë dokument udhëtimi, bujtjeje apo faturë në mbështetje të dëshmisë së tij, se ai udhëtoi në IRJM dhe qëndroi atje disa ditë para dhe pas 12 gushtit 2001. Megjithëse Z Hutsch dëshmoi gjithashtu se gjatë qëndrimit të tij në IRJM dhe, veçanërisht, më 12 gusht 2001, u ndihmua nga disa persona—veçanërisht dy

[11] Franz-Josef Hutsch, T 2808-2810.

[12] Në veçanti, ai dëshmoi se kishte vëzhguar ngjarjet në Luboten më 12 gusht që herët në mëngjes deri në orët e vona të ditës nga një lartësi midis Lubotenit dhe fshatit fqinj të Lubancës, T 2693-2700; Prova materiale P307. Ai shënoi në bllokun e shënimeve të gjitha ngjarjet dhe i grupoi këto shënime, T 2693-2694. Në sallën e gjyqit, gjatë dhënies së dëshmisë së tij ai shënoi në hartë disa vende dhe veprime që pa më 12 gusht, T 2695-2696; 2699-2700; Prova materiale P307. Më pas ai ishte i pranishëm në një postbllok policie dhe pa kur shqiptarët etnikë po keqtrajtoheshin, T 2748-2753. Ai hyri gjithashtu në fshat pasdite dhe bisedoi me një grup policësh, ndër të cilët Johan Tarçulovskin dhe një person, për të cilin ai mësoi më vonë se ishte komandant i njësive të posaçme policore Luanët, T 2756; 2760; 2769-2778; 6484. Në mbrëmje, në restorantin e hotelit ku kishte bujtur në Shkup, ai pa të Akuzuarin Lube Boshkoski dhe një person, për të cilin mësoi pas disa vitesh se ishte Buçuku, pronar i një agjencie private sigurimi, për të cilin pretendohet se mori pjesë në ngjarjet në Luboten, T 2785-2786.

[13] Franz-Josef Hutsch, T 2692-2693.

[14] Franz-Josef Hutsch, T 2760.

përkthyes[15]—asnjë nga këta persona nuk u thirr për të dëshmuar dhe Z. Hutsch refuzoi në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i identifikonte këta individë me arsyetimin se një gjë e tillë do t'i ekspozonte ata ndaj rrezikut.[16] Pavarësisht vërtetësisë ose pavërtetësisë së këtij pohimi, fakt është se nuk u thirr asnjë dëshmitar tjetër për të konfirmuar, në çfarëdolloj mënyre, praninë e Z. Hutsch në IRJM, ose në Luboten, më 12 gusht 2001. Çka është më domethënëse, nuk ekziston asnjë dokument që vërteton praninë e Franz-Josef Hutsch-it në IRJM, më 12 gusht. Sipas dokumentacionit të IRJM-së, ai hyri në vend më 19 gusht dhe u largua më 31 gusht 2001.[17] Pra nuk ka asnjë dokument që tregon se ai hyri në IRJM në një datë që do të mundësonte praninë e tij në këtë vend më 12 gusht 2001. Ka gjithashtu prova që tregojnë se ai nuk u regjistrua në atë hotel në Shkup ku ai thotë se ka qëndruar për 10 ditë duke filluar nga 12 gushti.[18] Kur u pyet nga pala kundërshtare, Z. Hutsch sugjeroi se regjistrimi i bujtjes së tij ishte fshirë. Ai përmendi një rast të ngjashëm kur regjistrat e një hoteli tjetër ishin ndryshuar për të fshirë çdo gjurmë të qëndrimit në atë hotel të një personi me emrin El-Masri.[19] Ky supozim mbetet i paprovuar dhe i pakonfirmuar. Gjithsesi u bënë përpjekje në mbështetje të rrëfimit të Z. Hutsch duke u nisur nga fakti se regjistri i hotelit të tij për klientët e huaj për periudhën nga 23 maj 2001 deri më 8 mars 2002, dukej më pak i përdorur dhe në gjendje më të mirë se sa regjistri për klientët e huaj për periudhën nga 8 mars 2002 deri më 1 mars 2004.[20] Ashtu siç u sugjerua, kishte dallim të dukshëm midis këtyre dy regjistrave, mirëpo pronari i hotelit shpjegoi se regjistri në periudhën e parë ishte në gjendje më të mire, sepse ishte përdorur më pak për shkak të ndryshimit të mënyrës së regjistrimit të klientëve në të.[21] Ky shpjegim ishte i besueshëm dhe i pakundërshtueshëm. Në vetë regjistrat nuk dalloheshin gjurmë të manipulimit të tyre. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore dëshiron të theksojë se përpara se Z. Hutsch të dëshmonte në këtë proces gjyqësor, përfaqësuesi i tij ligjor kërkoi

---

15 Franz-Josef Hutsch, T 2692-2693; 6188.
16 Franz-Josef Hutsch, T 2734.
17 Igor Dimovski, T 10925-10926; Prova materiale 2D111.
18 Branislav Dimitrov, T 10311-10316; Prova materiale 1D244.
19 Franz-Josef Hutsch, T 6344. Gjatë fazës së ripyetjes, Z. Hutsch dëshmoi se El-Masri ishte qytetar gjerman libanez, i cili dikur në vitet 2002-2003 u çua në Afghanistan për t"u hetuar nga shërbimet amerikane të zbulimit. Sipas Z. Hutsch, El-Masri qëndroi dy - tri javë në hotelin Skopski Merak në Shkup. Një komitet hetimor i BE-së (me gjasë, pas ngjarjeve) shkoi në hotel dhe, sipas Hutschit, "atyre iu treguan personel krejtësisht të ndërruar, por jo vetëm kaq, edhe libri, regjistri që iu paraqit atyre nuk përmbante më emrin El Masri,' dukej qartë se edhe ata ishin ndryshuar," T 6488. Këto çështje nuk u konfirmuan ose shqyrtuan plotësisht gjatë dëshmive të paraqitura para Dhomës Gjyqësore në këtë proces gjyëqesor.
20 Prova materiale P542.
21 Branislav Dimitrov, T 10335-10337; 10355.

ndihmën e Zyrës së Prokurores lidhur me një çështje ligjore në Gjermani.[22] Këto rrethana ngritën pyetjen nëse në dhënien e dëshmisë së tij në këtë proces gjyqësor. Z. Hutsch ishte shtyrë nga interesi i tij personal, dhe jo nga dëshira për të thënë të vërtetën. Kjo çështje është një arsye shtesë që e bën Dhomën Gjyqësore të mos jetë e bindur për vërtetësinë e dëshmisë së Z. Hutsch. Mbi bazën e shqyrtimit të çështjeve të mësipërme, Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë dëshminë e Franz-Josef Hutsch-it se ai ishte në Luboten, apo IRJM, më 12 gusht 2001. Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në asnjë element të dëshmisë së tij.

19. Pavërësisht nga çështjet e ndryshme që ndikojnë në vlerësimin e dëshmive në këtë proces gjyqësor, pasi shqyrtoi dhe peshoi me kujdes të gjitha provat, Dhoma Gjyqësore arriti të nxjerrë përfundime mbi bazën e fakteve në një masë të tillë që e lejon të përcaktojë fajësinë apo pafajësinë e dy të Akuzuarve lidhur me akuzat e Aktakuzës. Në disa raste Dhoma Gjyqësore ka refuzuar dëshmi, megjithëse ishin përputhëse. Në raste të tjera, Dhoma Gjyqësore ka pranuar dëshmi, pavarësisht kundërshtive ose mospërputhjeve në to. Në çdo rast, Dhoma Gjyqësore ka vepruar mbi bazën e të gjitha dëshmive përkatëse dhe vetëm pasi ka ekzaminuar hollësisht dëshmitarin dhe dëshminë e tij. Arsyet e Dhomës Gjyqësore jepen në hollësi për çdo rast.

[22] Ky proces ka të bëjë me një padi civile për kompensim të iniciuar nga Z. Hutsch lidhur me një artikull gazete që vinte në pikëpyetje ndershmërinë e punës së tij si gazetar. Ky artikull trajtonte dëshminë e dhënë nga Z. Hutsch si dëshmitar i mbrojtjes në një çështje tjetër përpara këtij Tribunali, T 6132; Prova materiale 1D241. Në një artikull të botuar si pjesë e marrëveshjes së arritur në këtë çështje thuhet se Prokurori i atëhershëm i këtij Tribunali i shkroi një letër avokatit të Z. Hutsch, me kërkesë së avokatit të Z. Hutsch, ku Z. Hutsch cilësohej si një "dëshmitar i ekuilibruar dhe i ndershëm' i cili edhe në të ardhmen duhej të dëshmonte si dëshmitar i prokurorisë (*sic*) kundër kriminelëve të luftës së konfliktit në Jugosllavi." (Franz-Josef Hutsch, T 6134; 6226; Prova materiale 1D245) Artikulli u botua më 11 qershor 2007. Franz-Josef Hutsch filloi dëshminë e tij para Dhomës Gjyqësore më 21 qershor 2007.

III. KONTEKSTI

20. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonise (IRJM) gjendet në pjesën qëndrore të Gadishullit Ballkanik. Në kohën e ngjarjeve të përmendura në këtë Aktgjykim, ajo kufizohej në veri me Republikën Federale të Jugosllavisë, në lindje me Bullgarinë, në jug me Greqinë, dhe në perëndim me Shqipërinë. Kryeqyteti është Shkupi.[23]

21. Deri në vitin 1991, IRJM-ja ishte republikë përbërëse e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë.[24] Më 8 shtator 1991 u organizua një referendum i cili përfundoi me votë në favor të pavarësisë, dhe, si pasojë, më 17 nëntor 1991, Parlamenti *("Sobranje")* miratoi Kushtetutën e IRJM-së.[25] Republika u pranua si anëtare e Kombeve të Bashkuara më 8 prill 1993,[26] si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.[27]

22. Rënia e Federatës Jugosllave në 1991 dhe ngjarjet e mëvonshme në Ballkan, krijuan vështirësi ekonomike dhe politike për IRJM-në.[28] Gjatë kësaj periudhe, IRJM-ja u cënua nga embargoja e OKB-së ndaj Jugosllavisë. Gjithashtu, ajo vetë iu nënshtrua një bllokade nga Greqia,[29] ndërsa në vitin 1999, priti më tepër se 300,000 shqiptarë nga Kosova si rezultat i krizës së atjeshme.[30] Në vitin 2001, sipas njoftimeve, niveli i papunësisë ishte të paktën 30% dhe të ardhurat mesatare ishin vetëm 300 marka gjermane në muaj.[31] Gjithsesi para vitit 2001, IRJM--ja nuk përjetoi drejtpërsëdrejti luftimet që u shtrinë në pjesë të tjera të Ballkanit.

23. Para vitit 2001, zgjedhjet për *Sobranje-n* u zhvilluan në tetor dhe nëntor 1998.[32] Numri i gjithsejtë i deputetëve në *Sobranje* ishte 120, ndër të cilët 85 përfaqësues të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe 35 të zgjedhur nga listat e partive.[33]

---

[23] Prova materiale P45, f. 13.
[24] Provat materiale P43, f. 4; P44 f. 4; *shih* gjithashtu Prova materiale P402, f. 9; Prova materiale P45, f. 21.
[25] Provat materiale P45, f. 21; P43, f. 5.
[26] Provat materiale P45, f. 21; P43, f. 4; P44, f. 4.
[27] Prova materiale P44, f. 4.
[28] Provat materiale 2D101, para. 43 - 45; P45, f. 58.
[29] Prova materiale 2D101, para. 48.
[30] Provat materiale P43, f. 5; P45, f. 56.
[31] Prova materiale P45, f. 57 (Fjalim i mbajtur nga Presidenti Trajkovski në samitin e BE-së, 3 mars 2001).
[32] Prova materiale P45, f. 25.
[33] Prova materiale P45, f. 25.

24. Zgjedhjet e vitit 1998 sollën në parlament partitë e mëposhtme (sipas numrit të vendeve në *Sobranje*) – Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Maqedonas ("VMRO-DPMNE"), Aleanca Social-Demokrate e Maqedonisë ("SDSM") (ish-komunistët), Partia e Prosperitetit Demokratik ("PPD") (shqiptarë etnikë), Partia e Prosperitet Demokratik për Shqiptarët ("PPDSH") (shqiptarë etnikë), Alternativa Demokratike ("DA") (partnere centriste e koalicionit me VMRO-DPMNE), Partia Liberale ("LP"), Partia Liberal-Demokrate ("LDP"), Demokracia e Re ("ND"), Partia Socialiste dhe Bashkimi i Romëve të IRJM-së.[34] Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Opsioni i Vërtetë Reformues Maqedonas ("VMRO-VMRO") u shkëput nga VMRO-DPMNE në 2000 dhe ishte parti më vete gjatë periudhës së mbuluar nga Aktakuza.[35]

25. Në fillim të janarit 2001, Presidenti i IRJM-së ishte Boris Trajkovski.[36] Kryetari i qeverisë maqedonase ishte Lupço Georgievski.[37] Të dy ishin anëtarë të VMRO-DPMNE-së.[38] Në maj 2001 u formua qeveri e re.[39] Në qeverinë e re i Akuzuari, Lube Boshkoski, gjithashtu anëtar i VMRO-DPMNE-së,[40] u ngrit në pozitë nga posti i sekretarit të shtetit në Ministrinë e Brendshme, në postin e Ministrit të Brendshëm.[41] Në bazë të Kushtetutës së Maqedonisë,[42] Lube Boshkoski u bë në atë kohë anëtar i Këshillit të Sigurimit, organ i ngarkuar me shqyrtimin e çështjeve lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e IRJM-së.

26. Në vitin 2000, popullsia e IRJM-së llogaritej mbi dy milion.[43] Popullsia përbëhej nga një larmi grupesh kombëtare dhe etnike. Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 1994, grupi më i madh që e quante veten maqedonas përbënte 66.6% të popullsisë.[44] Grupi i dytë më i madh, që përfaqësonte 22.7% të popullsisë, përbëhej nga shqiptarët.[45] Grupe të tjera etnike përbëheshin nga turqit, romët, serbët dhe vllehët.[46] Nga pikëpamja fetare,

[34] Provat materiale P321, f. 15 -18; P45, f. 26.
[35] Provat materiale P321, f. 17; P45, f. 26.
[36] Prova materiale P321, f. 7.
[37] Prova materiale P321, e mbajti këtë post që nga 30 nëntori 1998, f. 7.
[38] Prova materiale P321, f. 7.
[39] Prova materiale P466, para. 239.
[40] Provat materiale P43, f. 4; P321 f. 10.
[41] Provat materiale P43, f. 4; P321, f. 10; P402, f. 22.
[42] Prova materiale P91, Neni 86(2).
[43] Prova materiale P45, f. 12.
[44] Provat materiale P43, f. 5; P44, f. 4; P45, f. 12.
[45] Provat materiale P43, f. 5; P44, f. 4; P45, f. 12.
[46] Provat materiale P45, f. 12; P43, f. 5; P44, f. 4; P45, f. 47.

67% e popullsisë e quante veten të krishterë ortodoks maqedonas, ndërsa 30% e konsideronte veten myslimane.[47] Pjesa tjetër, 3%, u shënua se i përkiste besimeve "të tjera."[48]

27. Në vitin 2001, përveç përfaqësimit nëpërmjet PPD-së dhe PPDSH-së në *Sobranje*,[49] shqiptarë kishin poste në qeveri.[50] Mirëpo mosmarrëveshjet etnike ishin burim i një tensioni të madh politik. Një ndër pakënaqësitë më të mëdha të pjesëtarëve të bashkësisë shqiptare ishte se sipas tyre përfaqësimi i shqiptarëve në ushtri dhe polici ishte në nivel të ulët.[51] Pjesëtarët e pakicave etnike përbënin jo më shumë se 8,7% të policëve të Ministrisë së Brendshme.[52]

28. Data e saktë e krijimit të UÇK-së nuk njihet. Megjithatë, që më 22 janar 2001, një organizatë e vetëquajtur UÇK mori përgjegjësi për një sulm kundër një stacioni policor.[53] Në maj 2001, udhëheqësit e UÇK-së dhe të partive politike shqiptare lëshuan një deklaratë ku pasqyroheshin qëndrimet kryesore të përbashkëta të figurave udhëheqëse të UÇK-së, "Marrëveshja e Prizrenit," lidhur me nevojën "për reformimin e Republikës së Maqedonisë në mënyrë që të bëhet një shtet demokratik i të gjithë qytetarëve dhe të gjitha kombësive."[54] Sipas disa dëshmitarëve në këtë çështje gjyqësore, UÇK-ja u krijua si pasojë e pakënaqësisë së popullsisë shqiptare gjatë më se një dekade me statusin e tyre si pakicë në IRJM.[55] Sipas dëshmitarëve, zanafilla e pakënaqësisë ishte kushtetuta e vitit 1991, e cila i përjashtonte shqiptarët nga institucionet shtetërore, ndër të tjera nga ushtria dhe policia.[56] Kjo i shqetësoi shqiptarët, të cilët i trembeshin krijimit të një shteti "njëkombësh."[57] Ndikimi përhapës i luftës në Kosovë, që kishte mbaruar në 1999, dhe dyndja e mëse 300,000 refugjatëve nga Kosova në Maqedoni, pa dyshim, e shtuan pakënaqësinë dhe përshpejtuan procesin e krijimit të UÇK-së.

---

47 Prova materiale P45, f. 12.
48 Prova materiale P45, f. 12.
49 Prova materiale P321, f. 18; Viktor Bezruchenko, T 6510; Nazim Bushi, T 5767-5768; M092, T 5746.
50 Provat materiale P321, f. 7-14; 2D101, para. 37; Gëzim Ostreni, T 7624; Nazim Bushi,T 5764-5765.
51 Provat materiale P45, f. 47; 2D101, para. 38; Nazim Bushi, T 5767.
52 Prova materiale P45, f. 47.
53 Prova materiale 1D256, f. 3, Raporti i ICG-së për Balkanin 109, datë 5 prill 2001 (ERN 1D00-6438).
54 Prova materiale P560, "Deklaratë e Udhëheqësve Shqiptarë në Maqedoni Lidhur me Procesin e Reformave dhe të Paqes në Republikën e Maqedonisë," Prizren, datë 22 maj 2001; *shih* gjithashtu Gëzim Ostreni, T 7871-7873; *shih* gjithashtu Provën materiale P520, Komunikatë numër 6 (pa datë) e cila cakton objektivat e qëllimeve të UÇK-së.
55 Nazim Bushi, T 5579; Gëzim Ostreni, Prova materiale P497, para. 16.
56 Gëzim Ostreni, Prova materiale P497, para. 16.
57 Gëzim Ostreni, Prova materiale P497, para. 16.

IV. NGJARJET NË LUBOTEN DHE RRETHINAT E TIJ

A. Ngjarjet e 12 gushtit 2001 dhe ditëve të mëvonshme

29. Pretendohet se ngjarjet që përbëjnë bazën e kësaj Aktakuze, kanë ndodhur në fshatin Luboten, rrethinat e tij, dhe më pas në Shkup, të dielën, 12 gusht 2001, dhe gjatë dy ditëve të mëvonshme.

30. Fshati Luboten ndodhet disa kilometra në veri të qytetit të Shkupit, në shpatet e Malit të Zi të Shkupit.[58] Fshati gjendet në një lartësi prej afro 600 metrash[59] dhe prej tij mund të shihet fare mirë qyteti i Shkupit.[60] Një rrugë e vjetër mbi Luboten lidh zonën e Kumanovës me kufirin me Kosovën që gjendet aty pranë.[61] Shumë e konsideronin pozicionin e fshatit si një pikë të rëndësishme strategjike për UÇK-në.[62] Në vitin 2001 Luboteni kishte një popullsi prej afërsisht 3,000 banorësh.[63] Shumica e banorëve të Lubotenit ishin shqiptarë etnikë, por në të jetonte gjithashtu një grup maqedonasish etnikë të vendosur kryesisht në pjesën veriperëndimore të fshatit, pranë fshatit fqinj Lubancë, i cili banohej kryesisht nga maqedonas etnikë.[64] Shumica e banorëve të Lubotenit merrej me bujqësi.[65] Fshati kishte një kishë ortodokse dhe një xhami.

31. Për shkak të veprimeve në atë zonë të UÇK-së, e cila kishte zënë pika kyçe midis vijës kufitare me Kosovën në veri dhe kryeqytit, Shkupit, në jug, ushtria maqedonase ishte vendosur në pozicione në shpatet malore të rajonit mbi Luboten dhe Lubancë. Këto pozicione përfshinin pikat që njiheshin si Smok, Bomba dhe Mecka,[66] dy të parat ishin në vendin e quajtur Malistena apo Bregu i Rashitit,[67] një shpat malor në veri të Lubotenit, nga ku mund të shihej Luboteni si dhe zona përreth. Një nga njësitë ushtarake kishte vendosur një postkomandë të përkohshme në fshatin fqinj të Lubancës.[68] Pavarësisht nga

[58] Elmaz Jusufi, T 491.
[59] Prova materiale P298.
[60] M037, T 858-859. *Shih* gjithashtu Ismail Ramadani, T 1007.
[61] Ismail Ramadani, T 1007. *Shih* gjithashtu M083, T 1420-1421.
[62] *Shih* M051, T 4198-4199; Prova materiale 2D35, f. 2.
[63] Peter Bouckaert, T 3028.
[64] 084, T 1518; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 7.
[65] Elmaz Jusufi, T 560.
[66] Marijo Jurišić/Marijo Jurishiq, T 3319; Prova materiale P366.
[67] Pozicionet e ushtrisë maqedonase Smok dhe Bomba (*shih më poshtë*, para. 141, 142) ndodheshin në zonën e njohur si Malistena. (Prova materiale P216; M088, T 1255)
[68] *Shih më poshtë* , para. 99.

prania e njësive ushtarake në afërsit të Lubotenit, mbi bazën e të gjitha dëshmive përkatëse që ka parë dhe dëgjuar, Dhoma Gjyqësore shënon përfundimin e vet konkret se ushtria nuk hyri në fshat më 12 gusht 2001.[69] Mirëpo atë ditë ka patur të shtëna të kufizuara nga pozicionet e ushtrisë kundër objektivave në Luboten dhe në rrethinë, fakt që do të diskutohet më poshtë në këtë Aktgjykim.[70]

32. Për shkak të veprimtarisë së UÇK-së, policia kishte ngritur disa postblloqe në rrugët në zonën e Lubotenit.[71] Numri i policëve të dislokuar normalisht në çdo postbllok ishte 5 deri në 15.[72] Ka dëshmi që tregojnë se më 12 gusht numri i zakonshëm i policëve u rrit në më shumë se një postbllok, fakt që përputhet me një vendim të marrë në një takim planifikues të zhvilluar në Lubancë më 10 gusht 2001.[73]

33. Një postbllok policor ishte vendosur në Rrugën e Lubotenit (ose *Lubotenski Pat*), pak kilometra nga Luboteni në drejtim të Shkupit.[74] Ky postbllok ishte ngritur midis vendit të quajtur Buzallak (i cili ishte më pranë Lubotenit) dhe vendit të quajtur Kodra e Zajmit (ose në maqedonisht *Zamski Rid*[75]), i cili ishte më pranë Shkupit.[76] Disa dëshmitarë e përmendën postbllokun me emrin Buzallak, dhe disa të tjerë me emrin Kodra e Zajmit.[77] Dhoma Gjyqësore është e bindur se referencat postblloku Buzallak dhe postblloku Kodra e Zajmit, janë refererenca për të njëjtin vend. Në këtë Aktgjykim Dhoma Gjyqësore do t'i referohet këtij postblloku me emrin Buzallak. Në ditët e mëparshme atje ishin vendosur nëntë policë, por më 12 gusht, në bazë të një urdhri, në postbllokun e Buzallakut u vendosën 11 policë.[78]

---

69 *Shih* gjithashtu Marijo Jurishiq/ Marijo Jurišić, T 3319; Mitre Despodov, T 2597; Nikollçe Grozdanovski/ Nikolče Grozdanovski, T 10455; M2D008, T 10574; M051, T 4137.

70 *Shih më poshtë*, para. 39; 42.

71 Prova materiale 1D182.

72 Petre Stojanovski, T 9142-9143.

73 *Shih më poshtë,* para. 111; poshtëshënim 496.

74 Në bazë të një urdhri nga stacioni policor i Çairit dhe lidhur me 10 gushtin 2001, detyrat e nëntë policëve të dislokuar në postbllokun e Buzallakut përfshinin verifikimin e letërnjoftimeve, kontrollin e automjeteve dhe udhëtarëve të tyre, si dhe bagazhit të tyre. (Prova materiale P544)

75 Farush Memedi, T 2043.

76 Farush Memedi, T 2044; Prova materiale P267.

77 Farush Memedi, T 2035, 2044. Një dëshmitar dëshmoi gjithashtu se postblloku midis Kodrës së Zajmit dhe Buzallakut quhej Çezma e Rizvanit. (Ejup Hamiti, T 4441-4442) Dhoma Gjyqësore pranon se postblloku, të cilin ky dëshmitar e quan Çezma e Rizvanit është i njëjti postbllok i vendosur në rrugën kryesore nga Luboteni në Shkup, të cilit dëshmitarët e përmendën Buzallak dhe Kodra e Zajmit. *Shih* gjithashtu *Prokuroria kundër Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, Lënda Nr: IT-04-82/T, "Vendimi mbi Mocionin për Ndryshimin e Aktakuzës," 14 nëntor 2007.

78 Provat materiale P492; P544.

34. Postblloku i Murit Kinez (në maqedonisht *Kineski Zid*), ose shtëpia e Bracës, ndodhej midis Lubotenit dhe Lubancës, në hyrje të Lubotenit.[79] Postblloku ishte në rrugën që çonte nga Lubanca në Luboten, pas kryqëzimit të kësaj rruge me një rrugë që çonte në një ndërtesë, e cila normalisht ishte shtëpi pushimi për fëmijë.[80] Emri Muri Kinez i referohej një muri të madh që rrethonte shtëpinë pranë vendit ku ishte ngritur postblloku. Shtëpia ishte e një personi të quajtur Andreja Braca, kroat.[81] Në bazë të një urdhri lëshuar nga stacioni policor i Mirkovcit natën e 11 gushtit 2001, në postbllokun e Murit Kinez u dislokuan gjashtë policë.[82] Nuk ka asnjë provë për një urdhër të ngjashëm në lidhje me datën 12 gusht 2001. Gjithsesi, në atë postbllok ishin rreth 15 policë rezervistë të ndërrimit të zakonshëm.[83]

35. Postblloku Stranishtë (ose Straishtë, or Straishta) ishte vendosur në një kodër mbi fshatin Luboten, në fushat midis Lubancës dhe Lubotenit, afërsisht 200 metra prej kryqëzimit të rrugës që çonte nga Lubanca në fshatin Luboten dhe rrugës për në shtëpinë e pushimit të fëmijëve.[84] Ishte pranë postbllokut në shtëpinë e Bracës. Ky postbllok ishte afërsisht një kilometër larg në vijë ajrore prej xhamisë në qendër të Lubotenit.[85] dhe ndodhej në një pozicion nga ku mund të shikohej mirë zona.[86] Në bazë të një urdhri të lëshuar më 11 gusht 2001, në postbllokun Stranishtë, më 12 gusht 2001 u dislokuan 11 policë.[87]

36. Gjithashtu mëngjesin e 12 gushtit 2001 në zonën e Lubancit dhe Lubotenit ishte edhe një ekip me pesë policë të tjerë, më të shumtët rezervistë, nga stacioni policor i Mirkovcit,[88] të hipur në një autoblindë "Hermelinë" të policisë.[89] Policët ishin të veshur me uniforma kamuflimi[90], e zakonshme për policinë e angazhuar në detyra të tilla në atë

[79] M052, T 8267-8268; M053 T 1987; Provat materiale 2D26; P298.
[80] Mitre Despodov, T 2672; M083, T 1377-1380; Prova materiale P225.
[81] M052, T 8280; M053, T 1913; M017, T 634-635; Prova materiale P20; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 32-33.
[82] M052, T 8308-8309; Prova materiale P547.
[83] M052, T 8280; 8497.
[84] M052, T 8267-8268; 8305-8307; M083, T 1377-1380; Provat materiale P225; P298.
[85] M037, T 765.
[86] M037, T 827.
[87] M052, T 8305-8307; Prova materiale P546.
[88] M037, T 757-758; 762; Prova materiale P34.
[89] M037, T 758.
[90] M037, T 759.

kohë. Megjithëse disa dëshmi sugjerojnë se kjo ndodhi më vonë, [91] Dhoma konkludoi se patrulla nga Mirkovci mbërriti në postbllokun Stranishtë brenda orës 08:00. Në atë kohë, në postbllokun Stranishtë, një person që përdorte emrin e koduar "Rudnik," dhe që mendohej se ishte i Akuzuari Johan Tarçulovski,[92] në atë kohë oficer i sigurisë në trupën e sigurimit për mbrojtjen e bashkëshkortes së Presidentit të atëhershëm të IRJM-së, Boris Trajkovski,[93] kontaktoi me radio postbllokun Stranishtë dhe njoftoi se "kolegët" do të hynin së shpejti në fshatin Luboten për kryerjen e një operacioni për shkatërrimin e "terroristëve." Qëllimi i kësaj thirrjeje ishte të paralajmërohej policia në postbllok, në mënyrë që të mos i ngatërronte këta "kolegë" të angazhuar në operacion, me "terroristët", dhe si pasojë të vepronte kundër tyre.[94] Patrulla që erdhi me Hermelinë nga Mirkovci, qëndroi për një farë kohe në postbllokun Stranishtë nga ku mund të shikohej mirë Luboteni, por më vonë hyri në fshat dhe, siç do të diskutohet më vonë, i ndihmoi "kolegët" konkretisht.

37. Prej dëshmive të cilat diskutohen më hollësisht më poshtë, Dhoma Gjyqësore konkludon se më 12 gusht 2001, deri në orën 08:00, si pozicionet e ushtrisë po ashtu dhe postblloqet e policisë në afërsi të Lubotenit, ishin të gjitha të pajisura me personelin përkatës, në disa raste me personel më të shumtë se zakonisht, dhe se ishin njoftuar për fillimin së shpejti të operacionit në Luboten. Ky përfundim u arrit pavarësisht orvatjeve të shumta nga pjesëtarët e policisë dhe ushtrisë në dëshmitë e tyre, se ata nuk kishin dijeni për çka do të ndodhte dhe se nuk ishin pjesëmarrës në këto veprime apo në përgatitjet e tyre.

38. Gjithashtu në atë moment kohor, një njësi e madhe njerëzish të armatosur kishte zënë pozicion pranë hyrjes për në Luboten nga drejtimi i Lubancës. Kjo njësi përbëhej nga anëtarë me uniforma të policisë rezerviste, por në të mund të kenë qenë edhe disa persona të armatosur, me uniformë, dhe të pajisur, që silleshin si policë rezervistë, megjithëse nuk ishin caktuar si të tillë dhe as kishin të drejtë të pajiseshin me armë në bazë të procedurës ekzistuese. Ka gjithashtu dëshmi që tregojnë se në këtë njësi mund të

[91] M037, T 765.
[92] M037, T 779.
[93] *Shih më poshtë,* para. 537.
[94] M037, T 767-768.

kenë qenë gjithashtu anëtarë të një njësie të rregullt të policisë së posaçme, por siç do të diskutohet më poshtë, Dhoma Gjyqësore nuk u bind për vërtetësinë e këtij elementi. Kjo njësi policore ishte e përgatitur dhe e gatshme të hynte në këmbë në Luboten nëpërmjet rrugës që vinte nga Lubanca. Dëshmitë për numrin e personave në këtë njësi janë të ndryshme, mirëpo Dhoma Gjyqësore konkludon se në të ishin të paktën 60-70 persona.[95] Sipas disa dëshmive, ky numër mund të ketë qenë mbi 100. Siç do të diskutohet më poshtë, komandant i kësaj njësie ishte i Akuzuari Johan Tarçulovski, i cili ishte atje së bashku me anëtarët e njësisë.[96] Ai mbante kontakt me njësi të tjera policore dhe ushtarake në atë zonë.[97]

39. Rreth orës 08:00 të 12 gushtit 2001, banorët e Lubotenit dhe të tjerë dëgjuan të shtëna dhe granatime në fshat.[98] Më tej këto veprime u përqëndruan në pjesën perëndimore të fshatit, pranë kishës ortodokse.[99] Një dëshmitar besonte se shtëpia e një shqiptari etnik, Jakup Myftari (Miftari), e cila gjendej në pjesën jugperëndimore të fshatit, poshtë kishës ortodokse, u godit nga një predhë.[100] Një predhë, dhe më pas edhe një predhë tjetër goditën hambarin e Dalip Muratit, shqiptar etnik, e cila gjendej në pjesën jugperëndimore të fshatit, në perëndim të kishës ortodokse.[101] Një dëshmitar sugjeroi se këto predha mund të kenë ardhur nga Malistena[102] ku ishin pozicionet e ushtrisë,[103] por

[95] *Shih më poshtë*, para. 120.
[96] *Shih më poshtë*, para. 560.
[97] Në këtë aspekt Dhoma Gjyqësore thekson, siç është konstatuar gjetkë, radiot iu dhanë Tarçulovskit më 10 gusht 2001 (*shih më poshtë*, para. 113; 550.
[98] Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 22; M039, Prova materiale P200.2, para. 13; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 28; M088, Prova materiale P206, para. 15; M092, Prova materiale P215, para. 12, M092, T 1293-1294; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 7; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 7; Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 16; Sedat Murati, T 4064; Ejup Hamiti, Prova materiale P417, para. 5. Disa dëshmitarë dëshmuan se kishin dëgjuar të shtëna të armëve të lehta (apo të shtëna me armë automatike) përpara se të fillonin granatimet (Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 28; M039, Prova materiale P200.2, para. 13; Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 16; M092 Prova materiale P215, para. 12), ndërsa të tjerët dëshmuan se granatimet filluan menjëherë (M088, Prova materiale P206, para. 15).
[99] M017 vuri re tym që dilte nga vendi pranë Kishës Ortodokse, T 695-696.
[100] Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 17, 5, 6; Sedat Murati, T 4063; 4064-4068; Prova materiale P406.
[101] Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 16, 17; Sedat Murati, T 4064-4068; Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 13. *Shih* gjithashtu Ejup Hamiti, Prova materiale P417, f. 2. Hambari i shtëpisë së Dalip Muratit u godit përsëri shpejt nga një predhë, e cila shkaktoi zjarr që e dogji atë. (Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 14; Fatmir Kamberi, T 4607; M017, T 694-696).
[102] Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 13.
[103] Pozicionet e ushtrisë maqedonase Smok dhe Bomba (*shih më psohtë*, para. 141; 142) ndodheshin në zonën që njihej Malistena. (Prova materiale P216; M088, T 1255)

ky sugjerim dukej se ishte hamendje, dhe jo i bazuar në ndonjë vëzhgim. Një predhë tjetër goditi një shtëpi në kufirin verilindor të Lubotenit.[104]

40. Këto ngjarje u vëzhguan prej fshatit Radishan, nga Henry Bolton, përfaqësues i OSBE-së. Në 08:05 ai dëgjoi një shpërthim të fortë dhe pa tym që dilte afër një ndërtese të bardhë pranë kishës ortodokse. Kjo u pasua nga dy shpërthime të tjera, njëri pas tjetrit. Ai mendonte se shpërthimet ishin shkaktuar prej mortajave 120-milimetërshe.[105] Afërsisht pas 15-20 minutash, ai pa qitje me mortaja 81 ose 82-milimetërshe nga pozicionet e ushtrisë maqedonase në shpatin malor në juglindje të manastirit të Shën Nikollës, dhe predhat ranë "në terren të vdekur" në Luboten.[106] Ai mendonte se atë mëngjes në Luboten, pati 40 deri në 60 shpërthime prej mortajave.[107]

41. Patrulla policore në Hermelinë u largua nga postblloku i Stranishtës për të hyrë në fshat.[108] Përpara këtij veprimi, patrulla takoi Johan Tarçulovskin, i cili ishte veshur me uniformë kamuflimi dhe kishte me vete një telefon celular dhe një radio.[109] Në atë kohë ai nuk ishte i armatosur.[110] Johan Tarçulovski ishte së bashku me një grup njerëzish të veshur me uniforma kamuflimi pa simbole dalluese.[111] Ata ishin të armatosur me automatikë dhe mbase dy apo tre prej tyre kishin pistoleta.[112] Dhoma Gjyqësore konkludoi se ky grup ishte njësia policore e kryesuar nga Johan Tarçulovski, që në atë kohë po priste të hynte në fshat. Johan Tarçulovski u tha pjesëtarëve të Hermelinës të

---

[104] Isni Ali, T 2019-2020. Në deklaratën e tij të Rregullës 92*bis* dëshmitari tha se shtëpia e tij u godit nga një bombë (Isni Ali, Prova materiale P263, para. 7). Mirëpo në gjykatë ai dëshmoi se shtëpia e tij u godit nga një predhë, T 2019-2020. Duke marrë parasysh masën e shkatërrimit të shkaktuar shtëpisë së tij (Prova materiale P412.39) Dhoma Gjyqësore pranon dëshminë e Isni Aliut, se shtëpia u godit nga një predhë. Duhet patur gjithashtu parasysh se më 10 gusht 2001 një predhë ra shumë afër kësaj shtëpie. (Isni Ali, Prova materiale P263, para. 3) Gjithashtu, megjithëse në deklaratën e tij të Rregullës 92*bis* dëshmitari tha se më 12 gusht 2001 shtëpia e tij u godit rreth orës 10:00 (Isni Ali, Prova materiale P263, para. 7) Dhoma Gjyqësore pranon se kujtesa e dëshmitarit për kohën nuk është e saktë dhe se në fakt kjo ndodhi më herët, rreth orës 08:00 apo menjëherë pas kësaj ore.

[105] Henry Bolton, T 1676; Henry Bolton, Provat materiale P236.1, para. 6;1D21; 1D22.

[106] Henry Bolton, Prova materiale P236.1, para. 7.

[107] Henry Bolton, T 1676; Henry Bolton, Prova materiale P236.1, para. 9.

[108] Ka dëshmi se patrulla me autoblindën Hermelinë në postbllokun e Stranishtes u udhëzua nga shefi i OVR-së së Çairit për të hyrë dhe patrulluar në fshat, ndoshta për të gjetur "terroristë" (M037, T 774; M052, T 8289; 8570) dhe se kjo mund të ketë ndodhur pas orës 1100 (M053, T 1911; 1986; M052, T 8277). Lidhur me sa më sipër, Dhoma Gjyqësore mendon se kjo dëshmi është sajuar për të mbrojtur disa dëshmitarë nga përgjegjësia për ngjarjet në Luboten. Nga dëshmi të tjera veçanërisht lidhur me veprimet e autoblindës Hermelinë në fshat, Dhoma Gjyqësore pranon, se Hermelina hyri në fshat shumë më herët dhe se ajo mbështeti aktivisht njësinë policore në fshat.

[109] M037, T 778.

[110] M037, T 868.

[111] M037, T 776; 817. Dëshmitë për madhësinë e grupit ndryshojnë. M037 mundi të sugjerojë vetëm 20, 30 apo ndoshta 40 veta. Dëshmitarë të tjerë panë më shumë. Dhoma Gjyqësore konkludon se grupi ishte i përbërë afërsisht nga 60 deri në 70 veta.

[112] M037, T 778.

prisnin një farë kohe pasi mund të kishte granatim me mortaja. Dëshmitari mendoi se Tarçulovski e kishte marrë këtë informacion nga ushtria.[113] Pastaj, Johan Tarçulovski dhe grupi i njerëzve të veshur me uniforma kamuflimi u larguan. Dhoma Gjyqësore pranon se kjo bisedë u zhvillua në mëngjesin e datës 12 gusht 2001. Pavarësisht nga disa dëshmi sipas të cilave kjo ndodhi në orët e vona të paradites, duke marrë parasysh dëshmitë e tjera për çka ndodhi në fshat atë ditë si dhe pamundësinë e Dhomës Gjyqësore për të pranuar si të vërteta ato aspekte që disa dëshmitarë i trajtuan nga këndvështrimi i interesit të tyre personal,[114] Dhoma Gjyqësore konkludon se kjo bisedë u zhvillua me herët, rreth orës 08:00.

42. Ka disa dëshmi jobindëse për hapje zjarri kundër Lubotenit më herët me armë të lehta,[115] por pjesa dërrmuese e dëshmive e bind Dhomën Gjyqësore se rreth orës 08:00, pas goditjeve të para me mortaja dhe të shtënave me armë të tjera nga disa njësi të ushtrisë, policia e kryesuar nga Johan Tarçulovski hyri në Luboten. Ndërkohë u dëgjuan të shtëna të dendura që vinin nga një vend në afërsi të kishës ortodokse[116]. Dhoma Gjyqësore konkludoi se këto të shtëna erdhën prej policisë. Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se, siç do të diskutohet më poshtë, autoblinda e tipit Hermelinë hyri në fshat menjëherë pas njësisë së Tarçulovskit dhe se ndihmoi policinë.[117]

43. Më 12 gusht 2001, rreth orës 08:00, por me sa duket pak pas ngjarjeve të përshkruara më sipër, Elmaz Jusufi, shqiptar etnik, banor i Lubotenit, bashkëshortja e tij Zenepe Jusufi dhe kushuriri i tij Muzafer Jusufi, dëgjuan një shpërthim të fortë shumë pranë shtëpisë së Elmaz Jusufit, e cila ndodhej paksa në verilindje të kishës ortodokse.[118] I biri i Elmaz dhe Zenepe Jusufit, Rami Jusufi, i cili ishte gjithashtu në shtëpi, vrapoi për te dera e përparme dhe u përpoq t'a mbyllte.[119] Në atë moment nga jashtë, nga pjesa e përparme e shtëpisë, filluan të shtëna të shumta. Rami Jusufi u godit në stomak. Në trup

[113] M037, T 779.
[114] *Shih supra*, para. 15.
[115] Të shtëna sporadike që vinin nga shpati i malit mbi fshat mund të dëgjoheshin që më herët se ora 08:00. (M039, Prova materiale P200.2, para. 13) *Shih* gjithashtu M083, T 1428.
[116] Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 12.
[117] Dhoma Gjyqësore nuk e pranon dëshminë e M037 se patrulla priti më shumë se një orë në postbllokun e Stranishtes dhe hyri në fshat vetëm kur pas një farë kohe policët panë se nuk kishte të shtëna nga pozicionet e ushtrisë. (M037, T 780)
[118] Elmaz Jusufi, T 528-529; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 22; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.2, para. 17-18; Zenep Jusufi, T 443; Muzafer Jusufi, Prova materiale P389, para. 5. Duket se shpërthimi u bë për të hapur portën e lartë metalike nga rruga për në oborrin e përparmë të shtëpisë të rrethuar me mure.
[119] Elmaz Jusufi, T 572; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 24; Zenepe Jusufi, T 407.

kishte dy plagë plumbi. Të shtënat erdhën nga cepi i shtëpisë, nga një largësi prej rreth 10 -15 metra prej derës.[120] Plumbat goditën edhe shtëpinë. Makina larëse në banjë u godit nga 12 plumba.[121] Sulmuesit goditën me shkelma derën e përparme, por nuk hynë brenda.[122] Përpara se të largoheshin nga shtëpia e Elmaz Jusufit, sulmuesit hodhën benzinë mbi makinën e Elmaz Jusufit, e cila ishte parkuar në oborrin para shtëpisë, si dhe mbi disa materiale ndërtimi në oborr dhe u vunë zjarrin.[123]

44. Këto ngjarje në shtëpinë e Elmaz Jusufit ndodhën për rreth 10 minuta.[124] Pasi u larguan sulmuesit, Elmaz Jusufi dhe Muzafer Jusufi e larguan Rami Jusufin nga dera ku ishte qëlluar, dhe e futën në një dhomë brenda shtëpisë. Rami Jusufi vdiq atje nga plagët e plumbave në më pak se një orë.[125] Rami Jusufi u varros të nesërmen në oborrin e vajzës së Elmaz Jusufit.[126] Ai u varros me po atë rroba që kishte veshur kur vdiq.[127]

45. Pasi u larguan nga shtëpia e Elmaz Jusufit, sulmuesit vazhduan përgjatë së njëjtës rrugë, duke iu vënë zjarr me benzinë shtëpive.[128] Shtëpisë së Qenan Jusufit, vëllai i Elmaz Jusufit, shtëpisë dhe stallës së Xhabir Jusufit së bashku me kafshët, si dhe shtëpive të Sabit Jusufit, Nazmir Jusufit dhe Agim Jusufit iu vu zjarri dhe u dogjën.[129] Dhoma konkludoi se policia u vuri zjarrin edhe shtëpive të Xhevdet Jusufovskit[130] dhe Alim Durakit.[131] Sulmuesit hodhën gjithashtu nga një bombë dore në dy shtëpi të

120 Elmaz Jusufi, T 572; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 24.
121 Elmaz Jusufi, T 598; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 25; Zenepe Jusufi, T 410.
122 Elmaz Jusufi, T 594; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 25; Zenepe Jusufi, T 472.
123 Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 26; Muzafer Jusufi, Prova materiale P389, para. 5.
124 Muzafer Jusufi, Prova materiale P389, para. 5.
125 Zenepe Jusufi, T 448; Elmaz Jusufi, T 588; Muzafer Jusufi, Prova materiale P389, para. 6.
126 Elmaz Jusufi, T 533; Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 42; Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 19.
127 Elmaz Jusufi, T 541. Pas një muaji ai u rivarros. (Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 42)
128 Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 26, 27.
129 Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 27, 8. *Shih gjithashtu* Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 20; Mamut Ismaili, T 1344-1345; Mamut Ismaili, P219.1, para. 4; Prova materiale P222. Dëshmitarët panë shtëpitë e Qenan Rashitit, Iusuf Rashitit dhe Sabit Rashitit në të njëjtën zone, duke u djegur. (Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 8) Ka dëshmi se familja Jusufi thirrej Rashiti (Zenepe Jusufi, T 488). Dhoma Gjyqësore pranon se ku përmenden Rashitët në fakt përmenden Jusufët.
130 Më 13 gusht 2001, Fatmir Kamberi pa se shtëpia e Xhevdet Jusufovskit ishte djegur; Prova materiale P426, para. 20. Shtëpia e Xhevdet Jusufovskit gjendet midis shtëpive të Nazmir Jusufit dhe Agim Jusufit, (Prova materiale P427) të cilat u dogjën nga policia më 12 gusht 2001. Dëshmitë për praninë e policisë pranë shtëpisë së Xhevdet Jusufovskit dhe djegjen e shtëpive fqinje si dhe dëshmitë për dëmtimin shkaktuar kësaj shtëpie, e bindin Dhomën Gjyqësore se policia i vuri zjarrin edhe kësaj shtëpie.
131 Më 13 gusht 2001, Fatmir Kamberi pa se shtëpia e Alim Durakit ishte djegur; Prova materiale P426, para. 20. Një ditë më parë, Kamberi kishte parë tym që dilte nga lagjja ku ishte kjo shtëpi; Fatmir Kamberi, T 4555-4556; Prova materiale P427. Dëshmitarët panë policë në afërsi të shtëpisë së Durakit mëngjesin e 12 gushtit 2001; Nikollçe Grozdanovski, T 10420; 10494; Prova materiale 2D88.

paidentifikuara duke shkaktuar dëme në to.[132] Ndërkohë që ndodhnin këto ngjarje, banorët e Lubotenit panë të ngrihej tym nga pjesa perëndimore apo veriperëndimore e fshatit ku ishin shtëpitë e familjeve Jusufi.[133]

46. Elmaz Jusufi i përshkroi burrat që sulmuan shtëpinë e tij si një grup prej 20 policësh të veshur me uniforma dhe jelekë antiplumb, të armatosur me automatikë AK-47.[134] Disa prej tyre kishin maska në fytyrë, por ai mendoi se disa prej tyre arriti t'i njihte nga zëri.[135] Më herët atë mëngjes, para se të sulmohej shtëpia e tij, ai mendoi se rreth orës 07:30 dëgjoi zhurmën e kamionëve dhe sipas tij, të autoblindave jashtë portës së shtëpisë së tij. Ai dëgjoi gjithashtu zëra që flisnin maqedonisht. Ai mendoi se arriti të njihte tre nga këta zëra.[136] Dhoma Gjyqësore pranon se Elmaz Jusufi dëgjoi zhurmën e automjeteve dhe zëra që flisnin maqedonisht. Megjithëse pranon mendimin e tij se arriti të identifikonte personat prej zërit të tyre, Dhoma Gjyqësore është e vetëdijshme se një identifikim i tillë është krejt i pasigurtë, me përjashtim të rasteve kur zërat e personave që flasin janë të qarta dhe të njohura për dëgjuesin. Dëshmitë nuk sugjerojnë se kemi të bëjmë me një rast të tillë lidhur me këta katër persona dhe, për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk mund t'i pranojë këto identifikime si të sakta, dhe as nuk mund të pranojë përcaktimin e hamendësuar të Elmaz Jusufit. Muzafer Jusufi tha se sulmuesit "ishin të veshur me llojje të ndryshme uniformash."[137] M088, i cili po i shikonte këto ngjarje nga largësia, pa policë të veshur me uniforma të errëta në këtë zonë rreth kohës kur u sulmua shtëpia e Elmaz Jusufit.[138]

47. Elmaz Jusufi dëshmoi gjithashtu se pasi policia ishte larguar nga shtëpia e tij, një Hermelinë ndaloi para shtëpisë dhe tre policë zbritën prej saj, u ngjitën në çatinë e shtëpisë, dhe prej andej u hodhën në ballkon, nga ku hapën zjarr në drejtim të luginës.[139]

---

132 Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 30.
133 M088, T 1190-1191; Prova materiale P208; Prova materiale P210; Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 8.
134 Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 23.
135 Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.2, para. 20; Elmaz Jusufi, T 539-540. Elmaz Jusufi përmendi në veçanti Dime Acevskin dhe Dushan Krushkarovin (Dušan Kruškarov), të cilët ishin maqedonas etnikë që i njihte si banorë të fshatit Luboten. (Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 23)
136 Elmaz Jusufi i identifikoi këta si Dime Acevski, ungji i tij Sime, dhe Stojan Petrovski, maqedonas etnikë që i njihte si banorë të fshatit Luboten. (Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 17, 19)
137 Muzafer Jusufi, Prova materiale P389, para. 5.
138 M088, T 1192.
139 Elmaz Jusufi, Prova materiale P8.1, para. 29.

Dhoma Gjyqësore pranon se autoblinda ishte një Hermelinë e patrullës së stacionit policor të Mirkovcit, e cila kishte hyrë në fshat pak pas njësisë policore.

48. Dy burra të veshur me uniforma kamuflimi dhe me maska u panë tek thertorja, e cila ishte pranë kishës ortodokse, në pjesën perëndimore të fshatit. Ata po përgatisnin një granatedhës Zolja për të hapur zjarr.[140] Zolja është granathedhës dore i këmbësorisë. Shtëpia e Dalip Muratit ishte afro 100 metra nga thertorja.[141] Më pas, po atë ditë, një dëshmitar pa një granatë Zolja të pashpërthyer të mbetur në murin e shtëpisë së Dalip Muratit.[142] Pasi ishin parë të dy burrat, nga shtëpia e Dalip Muratit u dëgjua një shpërthim i fortë. Pak pas këtij shpërthimi dëshmitarët panë Dalip Muratin të plagosur rëndë në pjesën e stomakut.[143] Ai vdiq pak minuta më vonë.[144] Mirëpo, përpara këtyre ngjarjeve, siç përshkruhet me hollësi në Aktgjykim, dy predha mortajash të ushtrisë ranë në hambarin e shtëpisë së Dalip Muratit, duke shkaktuar zjarr në të. Nga dëshmitë nuk mund të përcaktohet nëse shpërthimi në shtëpinë e Dalip Muratit u shkaktua nga një predhë tjetër e ushtrisë apo nga një granatë Zolja. Edhe dëshmitë për kohën kur ndodhën këto ngjarje janë tejet të pasaktësuara, duke mos mundësuar nxjerrjen e përfundimit.

49. Pak kohë pas të shtënave në drejtim të shtëpisë së Elmaz Jusufit, burra të veshur me uniforma kamuflimi, me maska, dhe të armatosur me armë automatike, u panë në lagjen Elezaj të Lubotenit, në rrugën për në Rashtak.[145] Ata ecnin pas një autoblinde Hermelinë, e cila ndaloi shumë pranë shtëpisë së Harun Rexhepit.[146] Ata i vunë zjarrin shtëpisë së Harun Rexhepit duke hedhur mbi të shishe me benzinë.[147] Shtëpia e Harun Rexhepit u dogj atë mëngjes.[148] Pranë shtëpisë së Harun Rexhepit ishin disa shtëpi të tjera të familjes Redžepi [149] ose (Rexhepi) si dhe disa shtëpi të familjes Lutfiu.[150] Shtëpisë së Avdulla Rexhepit dhe shtëpisë së Qamuran Rexhepit (ku jetonte gjithashtu Ismet

140 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 24-25.
141 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 24.
142 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 25.
143 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 26-28.
144 Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 16. Vdekja e Dalip Muratit nuk përfshihet në Aktakuzë.
145 Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 2; *shih* Provën materiale P410 dhe Provën materiale P411, IMG Numrat e identifikimit 195, 196, 211, 212.
146 Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 10.
147 Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 10-11; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 8.
148 Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 11; Qemuran Rexhepi, T 3555.
149 Dhoma Gjyqësore pranon se Redžepi, Rexhepi , dhe Redžepovski është faktikisht i njëjti emër.
150 Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 2; *shih* Provën materiale P410 dhe Provën materiale P411, IMG Numrat e identifikimit 195, 196, 211, 212.

Rexhepi apo Rexhepovski, babai i Qamuranit[151]) si dhe plevicës së Shabi Lutfiut iu vu gjithashtu zjarr dhe ato filluan të digjeshin.[152] Pak para se shtëpitë të fillonin të digjeshin, u dëgjua një zhurmë e ngjashme me gazin e lëshuar prej cilindrave të gazit.[153] Shtëpive të Mitat Lutfiut dhe Qamuran Lutfiut, që ishin në anën tjetër të rrugës nga shtëpitë e Rexhepajve, [154] iu vu gjithashtu zjarri atë mëngjes,[155] dhe të njëjtin fat pati edhe shtëpia e Nazim Murtezanit.[156] Në bazë të këtyre dëshmive dhe dëshmive të tjera që diskutohen më poshtë, Dhoma Gjyqësore konkludon se këtyre shtëpive iu vu zjarri nga njësia policore e përmendur më sipër gjatë kalimit përmes fshatit.

50. Më 10 gusht 2001, mbi Luboten kishin rënë predha mortaje.[157] Për këtë arsye shumë banorë të Lubotenit ishin strehuar në bodrumet e shtëpive.[158] Mëngjesin e 12 gushtit afërsisht 10 persona, të gjithë meshkuj, ishin strehuar në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit, e cila gjendej në pjesën e sipërme të Lubotenit, në rrugën drejt fshatit Rashtak.[159] Ata ndodheshin atje që nga nata e 10 gushtit 2001.[160] Femrat e familjeve të tyre, së bashku me tre meshkuj, ishin në bodrumin e shtëpisë ngjitur të Zija Ametit, e cila gjendej në të njëjtin oborr.[161]

51. Policë me uniforma dhe të armatosur iu afruan bodrumit të shtëpisë së Adem Ametovskit dhe qëlluan disa herë në dritaren e bodrumit.[162] Burrat në bodrum u dorëzuan menjëherë; një plak tundi një cohë të bardhë në dritaren e bodrumit për të treguar se po

---

151 Aziz Rexhepi, T 4652. *Shih* gjithashtu, Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, f. 1.

152 Qamuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 8, 9; Qamuran Rexhepi, T 3525-3526; Prova materiale P375; Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 11.

153 Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 11.

154 Prova materiale P433.

155 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 9.

156 Peter Bouckaert dëshmoi se gjatë vizitës së tij në Luboten, më 23 gusht 2001, ai pa se vendbanimi familjar i Nazim Murtezanit, duke përfshirë shtëpinë, ishte djegur; Peter Bouckaert, T 2984; Prova materiale P347. Shtëpia e Nazim Murtezanit gjendet afër shtëpisë së Harun Rexhepit, së cilës, siç u diskutuar më sipër, iu vu zjarri nga policia më 12 gusht 2001. Shtëpia e Nazim Murtezanit gjendet ndanë rrugës që të çon në Rashtak (*shih* gjithashtu Provën materiale P411). Dhoma Gjyqësore konkludon se më 12 gusht 2001 shtëpisë së Nazim Murtezanit, po ashtu si dhe shtëpisë fqinje të Harun Rexhepit, iu vu zjarri nga policët që po lëviznin drejt shtëpive të Adem Ametovskit dhe familjes Jashari.

157 *Shih më poshtë*, para. 103.

158 Qamuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 9; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 8; Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 12.

159 M012, T 885; M017, T 612-615; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 10, 12; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 2.

160 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 11.

161 M017, T 615-616; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 11; M012, T 920-921.

162 Kujtesa e dëshmitarëve për kohën ndryshon nga ora 08:00-09:00 (M017, T 620), në orën 10:00 (Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 14), në pas orës 12:00 (Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 28). Dëshmitë e marra në tërësi tregojnë se këto ngjarje ndodhën midis orës 09:00- 10:30.

dorëzoheshin.[163] Pastaj policia i urdhëroi burrat të dilnin nga bodrumi. Burrat u detyruan të dilnin nga bodrumi përmes dritares.[164] Asnjë prej tyre nuk ishte armatosur. Asnjë prej tyre nuk kishte uniformë apo emblemë të UÇK-së. Më tej policia bastisi të gjitha shtëpitë në oborrin e Adem Ametovskit.[165] Nuk u gjet asnjë armë, municion, lëndë shpërthyese, uniforma, apo pajisje të tjera ushtarake.

52. Policia i nxorri burrat nga bodrumi në oborrin e shtëpisë së Adem Ametovskit ku u mori paratë, sendet e çmuara, si dhe letërnjoftimet.[166] Burrat u urdhëruan të shtriheshin në oborrin e shtëpisë dhe të ngrinin bluzat me mëngë të shkurtra mbi kokë. Pastaj policia i rrahu keqas.[167]

53. Ndërkohë, disa policë hynë në bodrumin e shtëpisë ngjitur të Zija Ametit, ku ishin strehuar gratë. Edhe grave iu morën paratë dhe stolitë.[168] Të tre burrat që ishin me gratë u nxorrën jashtë dhe u detyruan të bashkoheshin me grupin e burrave të bodrumit të Adem Ametovskit.[169]

54. Pastaj burrat u çuan tek porta kryesore e shtëpisë, në hyrje të oborrit, dhe u urdhëruan të shtriheshin përsëri përmbys në tokë dhe të mbulonin kokat me bluzat që kishin veshur.[170] Ata u morën në pyetje dhe u quajtën terroristë.[171] Pastaj policët i goditën burrat me armë, grushta, dhe shkelma.[172] Dëshmi të shumta tregojnë se shumë nga burrat pësuan plagë të rënda. Disa policë kërcënuan burrat me thika, por shumë prej tyre nuk u lejuan nga policë të tjerë të vazhdonin me veprime të mëtejshme.[173] Megjithatë, një polic gdhendi një kryq me thikë mbi shpinën e një prej burrave, Ismail Ramadani.[174] Dëshmitë

163 M017, T 620; M012, T 939-940, 979: Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 2.
164 M017, T 620-621; M012, T 887, 940, 971; Vehbi Bajrami, T 1837, 1861. *Shih* gjithashtu Ismail Ramadani, T 1021, 1039.
165 Ismail Ramadani, Prova materiale P189, para. 10.
166 M012, T 888; M017, T 621; 616-617; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 16; Ismail Ramadani, Prova materiale P189, para. 11; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 36; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1844.
167 M012, T 888; M017, T 625; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 16; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 31-32; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1870.
168 M017, T 705; M012, T 892.
169 M017, T 621-623; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3.
170 M012, T 888; M017, T 625; Prova materiale P17; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 17; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3.
171 M017, T 621.
172 M012, T 889-890; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 17.
173 M017, T 621-623; M012, T 889; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 18.
174 M012, T 894; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 19, 20; Prova materiale P194.

tregojnë gjithashtu se burrat u detyruan të këndonin një këngë maqedonase si dhe të përsërisnin "Rroftë Arkani."[175]

55. Pastaj burrat dëgjuan një të shtënë. Një nga burrat e grupit, Aziz Bajrami, i cili në atë moment dukej se po i fliste të birit, u plagos me një plumb të shkrehur nga një pushkë automatike e policisë.[176] I biri, Sulejman Bajrami[177] u godit apo u shkelmua keq në kokë.[178] Menjëherë pas kësaj burrat dëgjuan disa të shtëna.[179] Dhoma Gjyqësore konkludon se Sulejman Bajrami, i cili ishte orvatur të largohej apo t'ia jepte vrapit, dergjej i vdekur në anën e djathtë të rrugës që kalon pranë shtëpisë së Adem Ametovskit.[180] Ai ishte qëlluar disa herë dhe vdiq nga plumbat e policisë.

56. Pastaj policët i urdhëruan burrat të ecnin këmbëzbathur[181] për në postbllokun policor në shtëpinë e Bracës, që ishte ngritur midis Lubotenit dhe fshatit fqinj të Lubancës.[182] Shume prej tyre u keqtrajtuan dhunshëm gjatë rrugës si dhe pasi mbërritën tek shtëpia e Bracës.[183] Ata u shoqëruan nga katër deri në gjashtë persona të veshur me uniforma kamuflimi të policisë, anëtarë të njësisë policore.[184] Një nga policët shoqërues ishte Aleksandar Janevski, punonjës i agjencisë së sigurimit "Kometa."[185]

57. Dy pleq që ishin në këtë grup, Muharem Ramadani[186] dhe Aziz Bajrami,[187] u urdhëruan të qëndronin në shtëpinë e Adem Ametovskit.[188] Siç do të diskutohet më

---

175 M017, T 621-623; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 35. Arkani ishte një udhëheqës famëkeq paraushtarak serb, i cili kishte luftuar në Kroaci dhe Bosnjë.

176 M012, T 893, 949; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 22.

177 Sulejman Bajrami ishte një nga tre personat që u nxorën nga bodrumi ku ishin gratë. (M017, T 615-616; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 26; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 12; Ismail Ramadani, T 1022)

178 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 33; Ismail Ramadani, T 1022.

179 Osman Ramadani, Prova materiale P198, para. 22; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 24; Prova materiale P189, para. 189.

180 M017, T 624, 626-628; M012, T 892, 974; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 33; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 25; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3.

181 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 26; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 36. *Shih* gjithashtu M017, T 616-617.

182 M017, T 634; Prova materiale P20.

183 M012, T 897; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 36; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3.

184 M053, T 1912-1914; M052, T 8282.

185 M053, T 1910; M052, T 8283.

186 Muharem Bajrami ishte midis burrave në bodrumin e Adem Ametovskit. (M017, T 613-615; M012, T 885; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 12; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 26, 31)

187 Aziz Bajrami u nxor nga bodrumi i shtëpisë së Zija Ametit ku ishin strehuar gratë. (M017, T 615, 621-623)

188 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 27.

poshtë në këtë Aktgjykim, dëshmitarët mësuan më vonë se Muharem Ramadani ishte vrarë atë mëngjes nga policia tek porta e shtëpisë.[189]

58. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi të shumta lidhur me këta persona të armatosur në shtëpinë e Adem Ametovskit më 12 gusht 2001. Ata ishin anëtarë të njësisë së armatosur policore, që kishte hyrë në fshat rreth orës 08:00. Dëshmitë tregojnë se këta persona të cilët shkuan në shtëpinë e Adem Ametovskit, ishin të veshur me dy lloj uniformash: uniforma të zeza ose me ngjyrë të errët dhe uniforma kamuflimi.[190] Një dëshmitar i identifikoi këto forca si anëtarë të njësive së posaçme policore "Tigrat" dhe "Luanët," sepse, sipas mendimit të tij, ata ishin të veshur me uniformën e njësive të "Luanëve" dhe "Tigrave." Mirëpo ai e identifikoi këtë si uniformë kamuflimi me simbolin në mëngë, siç është paraqitur në Provën materiale P15.[191] Këta ishin dëshmitarë, të cilët thanë se kishin parë simbolin me fjalën "Luanët" në maqedonisht të shkruar mbi mëngë,[192] ndërsa të tjerë thanë se nuk kishin qënë në gjendje të dallonin simbolin.[193] Disa dëshmitarë dëshmuan se personat kishin maska në fytyrë.[194] Mirëpo disa të tjerë kishin arritur të njihnin midis policëve disa banorë vendës, të cilët i identifikuan në dëshmitë e tyre.[195] Dhoma Gjyqësore pranon se disa nga policët kishin maska në fytyrë.

59. Dëshmitë lidhur me numrin e këtyre policëve ndryshonin shumë; një dëshmitar tha se numri ishte rreth 50,[196] dhe një tjetër mendonte se kishte parë 200 ose 300 persona në oborrin e shtëpisë së Adem Ametovskit.[197] Të gjithë ishin të armatosur me

189 M012, T 894-895, 974; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 27, 57; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 57. *Shih më poshtë*, para. 321.

190 M012, T 888; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 14; Ismail Ramadani, T 1018; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 30; Vehbi Bajrami, Exhibit P247.1, f. 2.

191 M017, T 618-620.

192 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 14; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 30; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 2.

193 M012, T 969.

194 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 30.

195 M017 njohu, në veçanti, një burrë nga Rashtaku, i cili nuk ishte polic i rregullt. (M017, T 621-623) Ismail Ramadani njohu Nikolla Kostovskin, Sreqko Milevskin, Mirçe Stojanovskin dhe Zoran Stojanovskin. (Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 15) Ai pa një person që mendoi se ishte Angjele /mbiemri nuk dihet/, një polic i rregullt i stacionit policor të Mirkovcit. (Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 15) Ai pa gjithashtu Zoranin /mbiemri nuk dihet/, nga Rashtaku, i cili po numëronte paratë që u ishin marrë burrave përpara shtëpisë së Adem Ametovskit. (Ismail Ramadani, Prova materiale P189, para. 11) Ai mendoi se ishte një ushtar rezervist, por nuk ka asgjë tjetër në dëshmi për të konfirmuar këtë identifikim ose që atëherë Zoran /mbiemri nuk dihet/ ishte ushtar rezervist.

196 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 14.

197 Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 2; Vehbi Bajrami, T 1868-1869.

automatikë.[198] Një dëshmitar pa në oborrin e shtëpisë së Adem Ametovskit një automjet të blinduar të gjelbër, mbi të cilin ishte vendosur një armë e rëndë kundërajrore.[199] Dhoma Gjyqësore pranon se një patrullë nga stacioni policor i Mirkovcit në një autoblindë Hermelinë ishte në mbështetje të policisë në fshat dhe se në atë kohë kishte mbërritur në shtëpinë e Ametovskit,[200] megjithëse ka shumë mosmarrëveshje nëse mbi Hermelinë ishte vendosur ndonjë armë, dhe nëqoftëse po, çfarë lloj arme.

60. Dhoma Gjyqësore konkludoi se personat e armatosur, që hynë në oborrin e Adem Ametovskit më 12 gusht 2001 dhe keqtrajtuan burrat atje, i përkisnin njësisë policore që kishte hyrë në Luboten rreth orës 08:00. Kjo ishte e njëjta njësi policore që kishte sulmuar shtëpinë e Elmaz Jusufit, kishte qëlluar Rami Jusufin dhe u kishte vënë zjarrin shtëpive të Jusufëve dhe më vonë të Rexhepajve dhe shtëpive të tjera. Anëtarë të kësaj njësie kishin qenë pranë shtëpisë së Muratit, siç u përshkrua më sipër. Në arritjen e këtij përfundimi Dhoma Gjyqësore merr parasysh veçanërisht faktin se dëshmitarët në këto vende bënë përshkrime të këtyre forcave që përgjithësisht përputheshin, se këto vende nuk ishin shumë larg nga njëri-tjetri, dhe se veprimet e këtyre forcave ravijëzojnë tablonë e kalimit nëpër fshat si dhe ngjashmëri në vendet ku u kryen.

61. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore pranon se kjo njësi e armatosur policore përbëhej nga anëtarë me uniforma të forcave rezerviste të policisë, ndër të cilët, siç do të diskutohet më vonë, disa persona që ishin punonjës të agjencisë private të sigurimit

198 M012, T 969; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 15; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 30.

199 Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 2.

200 M037 dëshmoi se pasi kishte arritur në pjesën lindore të fshatit, Hermelina ndaloi pranë një prej katër shtëpive që ishin në rresht pranë rrugës për në Rashtak (M037, T 782-784; Provat materiale P38; P39), ku pasi zbriti nga Hermelina ai u kthye tek një shtëpi tjetër, çka do të thotë, sipas gjykimit të Dhomës Gjyqësore, tek shtëpia e Adem Ametovskit, megjithëse largësia është shumë më e madhe se 50-60 metra, siç u tha nga M037. M037 pa Johan Tarçulovskin dhe një grup prej 10 personash në hyrje të kësaj shtëpie. M037 i tha Johan Tarçulovskit se këta njerëz ishin gjetur brenda shtëpisë. (M037, T 786) Njerëzve të shtëpisë iu gjetën patenta makinash dhe letërnjoftime personale. M037 tha se ai u përpoq të përcaktonte identitetin e këtyre njerëzve mbi bazën e dokumentave që iu gjetën atyre si dhe duke i pyetur ata. Njerëzit e kapur u pyetën konkretisht nëse ishin nga Kosova. (M037, T 786) Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të përcaktojë të vërtetën e disa aspekteve të kësaj dëshmie. M037 kishte interes të qartë për t'u distancuar nga veprimet e policisë në shtëpinë e Adem Ametovskit si dhe në sugjerimin se ai vetë ishte sjellë në përputhje me ligjet. Është e rëndësishme të theksohet se në dëshminë e M037 nuk përmendet ndonjë keqtrajtim, megjithëse prej dëshmive del qartë se në atë kohë u kryen akte të rënda keqtrajtimi. Gjithashtu, sipas dëshmisë së M037, Hermelina veproi e pavarur nga njësia policore e Johan Tarçulovskit. Nuk është e besueshme që në rrethanat e atij mëngjesi ai do t'a parkonte Hermelinën dhe do të kthehej vetëm përgjatë rrugës. Për më tepër, një ushtar tha se që nga pika e tij e vëzhgimit në një kodër mbi fshat, ai pa një njësi policore të përbërë nga policë që ecnin pas një Hermeline. (M2D-008, T 10553-10554; 10583) Dhoma Gjyqësore pranon se njësia policore, duke përfshirë Johan Tarçulovskin, mbërriti në shtëpinë e Adem Ametovskit duke ecur prapa autoblindës Hermelinë.

"Kometa."[201] Disa dëshmi identifikuese nga banorë të Lubotenit tregojnë se midis policëve rezervistë ishin disa banorë vendës. Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të përcaktojë nëse në njësinë policore ishin edhe anëtarë të njësive të posaçme "Luanët" ose "Tigrat." Disa dëshmitarë arritën në konkluzionin se këta policë ishin anëtarë të njësive të posaçme "Luanët" ose "Tigrat" duke u nisur pjesërisht nga fakti se ata ishin të veshur me uniforma të këtyre njësive të posaçme. Mirëpo ekzistojnë dëshmi që tregojnë se në atë kohë këto uniforma i përdornin, herë pas here, policia e rregullt, policia rezeviste, si dhe njësitë e posaçme.[202] Disa dëshmitarë thanë se, sipas mendimit të tyre, kishin parë në sup emblemën me fjalën "Luanët" në maqedonisht. Të gjitha uniformat e policisë të këtij lloji kanë emblema në sup dhe nuk është e lehtë të bëhet dallimi midis tyre. Për më tepër, siç theksohet me poshtë, njësia "Luanët" u krijua formalisht më 6 gusht 2001, por ka shumë dëshmi që tregojnë se kjo njësi u bë e gatshme për veprim shumë më vonë.[203] Megjithatë, sipas disa dëshmive të tjera, krijimi formal i kësaj njësie thjesht sanksionoi një njësi që *de facto* ishte vepruese. Duke patur parasysh këto dëshmi të ndryshme nga njëra-tjetra, Dhoma Gjyqësore nuk mund të përcaktojë nëse anëtarë të "Luanëve" apo "Tigrave" ishin pjesëtarë të njësisë. Megjithëse nuk mendon se kemi të bëjmë me një rast të tillë, Dhoma Gjyqësore nuk përjashton as mundësinë që në njësinë policore të jenë përfshirë persona me uniformë, të armatosur dhe të pajisur, të cilët vepronin si policë rezervistë, megjithëse nuk ishin caktuar formalisht si të tillë dhe as nuk kishin të drejtë të pajiseshin me armë në bazë të procedurave ekzistuese.

62. Pas ngjarjeve në shtëpinë e Adem Ametovskit, siç u përshkrua më sipër, 10 banorë meshkuj shqiptarë etnikë u shoqëruan nga një grup prej katër deri në gjashtë policë për në shtëpinë e Bracës.[204] Policët e tjerë u bashkuan me Hermelinën dhe vazhduan për në shtëpinë e Qani Jasharit.

---

[201] *Shih supra*, para. 73.

[202] Prova materiale P15 tregon uniforma të gjelbra//kafe/të verdha/kamuflimi me emblemën e policisë. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi se në atë kohë uniformat e treguar në Provën materiale P15 përdoreshin nga policia me uniformë, forcat rezerviste, policët speciale, dhe njësia e posaçme e policisë. (M037, T 762; M083, T 1457) Dhoma Gjyqësore është bindur se në kohën e mbuluar nga Aktakuza, uniformat e kamuflimit të treguara në Provën materiale P15 përdoreshin nga forcat e policisë së rregullt dhe ato rezerviste. Megjithëse këto uniforma mund të jenë përdorur edhe nga njësitë e posaçme të policisë, ky fakt i vetëm nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar se anëtarë të një njësie të posaçme policore, ishin në Luboten më 12 gusht 2001.

[203] *Shih më poshtë*, para. 491.

[204] *Shih më sipër, para.* 56.

63. Ka dëshmi që tregojnë se mëngjesin e 12 gushtit 2001, disa burra shqiptarë etnikë nga Luboteni, ndër të cilët Xhelal Bajrami, Qani Jashari, Bajram Jashari, dhe Kadri Jashari, ishin në shtëpinë e Xhelal Bajramit, e cila gjendej në pjesën lindore të Lubotenit, afërsisht 200 metra larg nga shtëpia e Adem Ametovskit, në rrugën që çonte në Rashtak.[205] Shtëpia ishte në anën veriore të rrugës.[206] Sipas dëshmive të tyre ata e kaluan të gjithë paraditen, që nga ora 09:30, së bashku në atë shtëpi.[207] Gjithashtu u dëshmua se ata u larguan nga shtëpia kur dëgjuan ulërima dhe të shtëna që vinin nga shtëpia e Adem Ametovskit.[208] Dëshmitë tregojnë se më pas Bajram Jashari, Kadri Jashari dhe Xhelal Bajrami vrapuan duke iu ngjitur kodrës në drejtim të shtëpisë së Qani Jasharit, e cila gjendej në lindje të shtëpisë së Xhelal Bajramit.[209] Në atë moment u dëgjua zhurma e një Hermeline që po afrohej.[210]

64. Ka gjithashtu dëshmi që tregojnë se ndërkohë, një grup tjetër banorësh të Lubotenit ishin grumbulluar në shtëpinë e Afet Zendelit, e cila gjendej në jug të rrugës që çonte në Rashtak.[211] Dy prej tyre, M088 dhe M092, dëshmuan se dikur pas orës 10:00 atyre u telefonoi dikush dhe u tha se policia po keqtrajtonte njerëzit në postblloqe dhe se njerëzit e tjerë po largoheshin nga fshati.[212] Ata dëshmuan se pas kësaj bisede telefonike vendosën të largoheshin nga shtëpia. Në fillim vrapuan për në shtëpinë e Zendel Zendelit, ku ndaluan për një kohë të shkurtër. Që andej ata vrapuan përpjetë kodrës në drejtim të shtëpisë së Qani Jasharit, e cila ishte rreth 200 - 300 metra larg.[213] Në shtëpinë e Qani Jasharit ata gjetën Kadri Jasharin, Bajram Jasharin dhe Xhelal Bajramin.[214]

65. Ka gjithashtu dëshmi nga ushtria që sugjerojnë se të shtënat nga shtëpia e Qani Jasharit dhe/ose shtëpitë fqinje të familjes Jashari filluan më herët se sa në momentin e përcaktuar në dëshmitë e mësipërme, kur pesë personat e lartpërmendur mbërritën në

---

205 M039, Prova materiale P200.2, para. 4, 6, 16.
206 M039, Prova materiale P200.2, para. 6.
207 M039, Prova materiale P200.2, para. 13, 14; M039, T 1141, 1157.
208 M039, Prova materiale P200.2, para. 15.
209 M039, Prova materiale P200.2, para. 15, 16, 17, 6.
210 M039, Prova materiale P200.2, para. 19.
211 M088, Prova materiale P206, para. 18; M092, Prova materiale P215, para. 10. Lidhur me vendndodhjen e shtëpive të familjes Zeneli *shih* Provën materiale 2D20.
212 M088, T 1217; M088, Prova materiale P206, para. 20.
213 M088, Prova materiale P206, para. 21; M092, Prova materiale P215, para. 13.
214 M088, Prova materiale P206, para. 22; M092, Prova materiale P215, para. 14; M092, T 1295.

shtëpinë e Qani Jasharit.[215] Për arsye të shprehura gjetiu, Dhoma Gjyqësore ka rezerva të mëdha për ndershmërinë e këtyre dëshmive. Këto çështje do të trajtohen përsëri më poshtë në këtë Aktgjykim.[216]

66. Pesë burrat e lartpërmendur ishin në shtëpinë e Qani Jasharit, kur nga rruga u afrua Hermelina. Pas një minute ajo u pasua nga një grup policësh që po ecnin në këmbë.[217] Ata ishin të veshur me uniformat e zakonshme të policisë rezerviste.[218] Dhoma Gjyqësore konkludon se kjo ishte e njëjta njësi policore përgjegjëse për ngjarjet e mëhershme në fshat, të përshkruara më sipër. Të pesë burrat në shtëpinë e Qani Jasharit dëgjuan të thirrura jashtë shtëpisë; në atë kohë nuk pati të shtëna.[219] Dy mbijetuesit nga të pesë burrat, M088 and M092, dëshmuan se në atë kohë ata vendosën të largoheshin nga shtëpia.[220] Ata dolën nëpërmjet dritares në pjesën e prapme dhe u larguan nga rruga në drejtim të hambarit që përdorej për të tharë duhanin. Ata vendosen që prej andej të largoheshin me vrap përmes fushës së hapur drejt pyllit. [221] Largësia që do të vraponin ishte rreth 500 metra.[222]

67. Po në atë kohë u hap zjarr nga një mitraloz në Hermelinë, e cila kishte ndaluar në mes të rrugës, përpara rrugicës me zhavorr që çonte në drejtim të shtëpisë së Qani Jasharit.[223] Edhe policët që ishin në këmbë filluan të shtinin. Policët ecën në drejtim të shtëpisë së Qani Jasharit si dhe hynë në shtëpitë e reja në anën jugore të rrugës që i përkisnin familjes Jashari.[224] Ata hapën zjarr në drejtim të shtëpisë së Qani Jasharit. Pas një farë kohe u dëgjua një polic që tha me zë të fortë se muret e shtëpisë nuk mund të shkatërroheshin pasi ishin prej guri.[225] Hermelina iu afrua shtëpisë së Qani Jasharit e ndjekur nga policët. Ata hynë në oborrin e Qani Jasharit.[226] Pastaj nga shtëpia e Qani Jasharit dolën flakë, një mullar i madh bari mori zjarr, kishte të shtëna të vazhdueshme.[227]

---

215 *Shih më poshtë*, para. 154.
216 *Shih më poshtë*, para. 155.
217 M039, Prova materiale P200.2, para. 20, 22.
218 M039, Prova materiale P200.2, para. 23.
219 M088, Prova materiale P206, para. 23, 24.
220 M088, Prova materiale P206, para. 25; M088, T 1219; M092, T 1297.
221 M088, Prova materiale P206, para. 25; M092, Prova materiale P215, para. 18.
222 M092, Prova materiale P215, para. 18. *Shih* gjithashtu M088, Prova materiale P206, para. 25.
223 M039, Prova materiale P200.2, para. 22.
224 M039, Prova materiale P200.2, para. 24, 25, 26, 5.
225 M039, Prova materiale P200.2, para. 25.
226 M039, Prova materiale P200.2, para. 26.
227 M039, Prova materiale P200.2, para. 27.

Ekzistojnë dëshmi që tregojnë se u dëgjuan piskamat e Kadri Jasharit dhe Bajram Jasharit që kërkonin ndihmë. Zërat e tyre vinin nga brenda shtëpisë.[228]

68. Ndërkohë që policët po shtinin në drejtim të shtëpisë së Qani Jasharit, dëshmitë tregojnë se të pesë burrat ishin duke vrapuar përmes fushës në drejtim të pyllit. Ndaj tyre u hap zjarr nga Malistena ku ndodheshin pozicionet Smok dhe Bomba të ushtrisë si dhe nga policia që ishte në shtëpitë e Jasharëve.[229] Pak pas kësaj, u hap gjithashtu zjarr nga personat në Hermelinë.[230] Duket se u qëllua gjithashtu edhe me predha Zolja nga vendi ku ishte Hermelina, pasi dy ditë më vonë në rrugën që të çonte në shtëpinë e Qani Jasharit u gjetën gëzhoja Zolja.[231] Burrat hasën në zjarr të dendur. I pari arriti të ikte pa pësuar lëndime. I dyti, Kadri Jashari, u plagos dhe nuk mundi të vazhdonte më tej.[232] Kufoma e tij u gjet më pas në fushë.[233] Burri i tretë u plagos në këmbë por arriti të hynte në pyll.[234] Në fushë u gjetën më vonë edhe kufomat e dy personave të fundit, Xhelal Bajramit dhe Bajram Jasharit. Kufoma e Bajram Jasharit u gjet pranë plevicës që përdorej për të tharë duhanin, ndërsa ajo e Xhelal Bajramit u gjet më thellë në fushë.[235] Pastaj nga Hermelina u hodhën tri apo katër shishe me benzinë në drejtim të shtëpisë së Qani Jasharit.[236] Policët i vunë zjarrin shtëpisë së Qani Jasharit.[237] Edhe dy shtëpive të Jasharëve në anën jugore të rrugës iu vu gjithashtu zjarri.[238] Ngjarjet që nga mbërritja e Hermelinës dhe policëve deri në largimin e tyre mund të kenë vazhduar për një kohë të shkurtër, afërsisht 20 minuta.[239]

69. Ka dëshmi se para largimit të njësisë policore nga kjo zonë, dy apo tre policë gjetën një automatik të lehtë Tompson dhe dy automatikë Kallashnikov të prodhimit

---

228 M039, Prova materiale P200.2, para. 27.

229 M092, Prova materiale P215, para. 19; M092, T 1297. *Shih* gjithashtu M088, Prova materiale P206, para. 25. Shtëpitë janë në lagjen Elezaj.

230 M092, Prova materiale P215, para. 20.

231 Henry Bolton, T 1627-1629; Prova materiale P238, f. 2.

232 M092, Prova materiale P215, para. 20; M039, Prova materiale P200.2, para. 27.

233 M039, Prova materiale P200.2, para. 41; M039, T 1167; Prova materiale P203, f. 3.

234 M092, Prova materiale P215, para. 21. *Shih* gjithashtu M088, Prova materiale P206, para. 27, 29.

235 M039, Prova materiale P200.2, para. 37, 39, 40; M039, T 1167; Prova materiale P203, f. 2; 4. Ata u varrosën pak ditë më vonë ende të veshur me të njëjtat rroba, pa u kontrolluar. (M039, T 1148)

236 M039, Prova materiale P200.1, f. 5; M039, Prova materiale P200.2, para. 29. Dhoma Gjyqësore shënon përfundimin e vet konkret, në këtë aspekt, se një pjesë ose i tërë materiali zjarrvënës i përdorur nga policia për t'i vënë zjarrin shtëpive dhe pronave u soll në fshat me autoblindën Hermelinë.

237 M039, Prova materiale P200.1, f. 5; M039, Prova materiale P200.2, para. 29; M092, T 1299. Dhoma Gjyqësore mban parasysh dëshminë e M039 se nga shtëpia po dilte zjarr pasi njerëzit që ishin brenda, u larguan (M039, T 1166). Duke patur parasysh dëshminë e mëparshme të M039 (M039, Prova materiale P200.2, para. 27) si dhe dëshmitë e kundërta, Dhoma Gjyqësore pranon se shtëpisë iu vu zjarri pasi të pesë burrat ishin larguar prej saj.

238 M039, Prova materiale P200.2, para. 31.

239 M039, Prova materiale P200.2, para. 34.

kinez pranë këtyre kufomave,[240] si dhe municion duke përfshirë 50 plumba për Tompsonin.[241] Policët ia treguan armët dhe municionin Johan Tarçulovskit në vendin e ngjarjes, dhe, mbi këtë bazë, ai arriti në përfundimin se personat e vrarë ishin terroristë.[242] U sugjerua që të bëhej një "inspektim" por Johan Tarçulovski tha se nuk ishte e nevojshme pasi ata ishin në "gjendje lufte."[243] Ekzistojnë dëshmi se Johan Tarçulovski ia dorëzoi të tri armët patrullës në Hermelinë, pasi grupi i tij kishte ardhur në këmbë dhe nuk mund të transportonte armët.[244] SVR-ja e Shkupit u informua nëpërmjet stacionit policor të Mirkovcit për vdekjen e tre personave për të cilët mendohej se ishin terroristë.[245] Shoferi i Hermelinës vazhdoi rrugën në drejtim të Murit Kinez së bashku me tri armët që u tha se ishin gjendur pranë kufomave.[246] Ai mori gjithashtu me vete një polic rezervist, Vlado Janevski, i ashtuquajtur Kunta, i cili ishte plagosur,[247] siç duket, kur kishte qëlluar veten aksidentalisht.[248] Atë ditë nuk u plagos asnjë anëtar tjetër i njësisë policore.[249] Anëtarët e tjerë të patrullës me Hermelinë nga stacioni policor i Mirkovcit shkuan te Muri Kinez në këmbë.[250]

70. Ndërkohë që po ndodhnin këto ngjarje, banorët e mbajtur në shtëpinë e Adem Ametovskit po ecnin në drejtim të shtëpisë së Bracës të shoqëruar nga policë të armatosur. Sipas dëshmive të tyre, ata arritën atje rreth orës 12:30 ose 13:00.[251] Osman Ramadani dhe Ismail Ramadani dëshmuan se atje ata panë një Hermelinë, e cila kishte ndaluar në fshat.[252] Dëshmitarë të tjerë dëshmuan se kishin parë dy Hermelina kur kishin kaluar nga shtëpia e Adem Ametovskit për në shtëpinë e Bracës,[253] duke ardhur nga i

240 M037, T 793; 835; të njëjtat si ato të treguara në Provat materiale P23, P41, 2D6, 2D7.
241 M037, T 793; 835. M039 dëshmoi se Hermelina dhe njësia policore u larguan nga zona pasi i ishte vënë zjarri shtëpisë së Qani Jasharit dhe dy shtëpive të tjera. (M039, Prova materiale P200.2, para. 30, 34) Dhoma Gjyqësore thekson se ai mund të mos ketë qënë në një pozicion të tillë që të ketë parë nëse policia i mori të tri armët nga fusha përpara se ata të ishin larguar.
242 M037, T 792.
243 M037, T 793.
244 M037, T 793.
245 M037, T 794; 803.
246 M037, T 793-794.
247 M037, T 864-865.
248 M052, T 8294-8295. Duket se dëshmitari ka ngatërruar Knutën me vëllain e tij Aleksandrin. Mirëpo dëshmia e M037 e bën të qartë se personi i plagosur ishte Kunta.
249 *Shih* M037, T 864, 865, 870; M052, T 8293-8295. Prova materiale P442.
250 M037, T 865.
251 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 30; Ismail Ramadani, T 1042; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 43.
252 M017, T 634.
253 Osman Ramadani, T 1101. *Shih* gjithashtu Vehbi Bajrami, T 1869.

njëjti drejtim. Disa të tjerë nuk kishin parë asnjë automjet.[254] Dhoma Gjyqësore konkludon se burrat nga shtëpia e Adem Ametovskit arritën në shtëpinë e Bracës rreth të njëjtës kohë kur Hermelina u kthye nga shtëpia e Qani Jasharit.[255] Dhoma Gjyqësore pranon dëshminë e M037, se më 12 gusht 2001, asnjë Hermelinë tjetër nuk kishte hyrë në Luboten.[256]

71. Në shtëpinë e Bracës burrat nga shtëpia e Adem Ametovskit, panë civilë maqedonas nga Luboteni si dhe policë.[257] Ka dëshmi se një grup prej rreth 20 apo 30 fshatarësh nga Lubanca, të revoltuar nga incidenti i shpërthimit të minës në Stanet e Lubotenit (në maqedonisht *Lubotenski Bačila*),[258] u përpoqën t'u afroheshin njerëzve të kapur në Luboten,[259] siç duket për t'u hakmarrë. Siç përshkruhet hollësisht më poshtë, më 10 gusht, nga shpërthimi i një mine poshtë një kamioni ushtarak, për të cilën ishte akuzuar UÇK-ja, ishin vrarë tetë ushtarë dhe ishin plagosur disa të tjerë. Dy nga viktimat ishin nga Lubanca.

72. Pas mbërritjes në shtëpinë e Bracës, banorët e mbajtur në shtëpinë e Adem Ametovskit, u mbajtën në anë të rrugës, jashtë oborrit të shtëpisë. Atje ata panë të Akuzuarin Lube Boshkoski.[260] Sipas dëshmisë së M017, Lube Boshkoski iu drejtua policëve duke i përgëzuar për kapjen e "terroristëve."[261] Burrat e mbajtur në shtëpinë e Adem Ametovskit nuk mund të shikonin qartë pasi mbi kokë kishin ende bluzat e tyre. Mirëpo, megjithëse nuk ishin në gjendje të këqyrnin me hollësi Lube Boshkoskin, ata gjithsesi mund ta shikonin pjesërisht.[262] Lube Boshkoski ishte në oborrin e shtëpisë së Bracës, vetëm pak metra larg nga grupi i burrave të arrestuar.[263] Në të vërtetë, siç do të

254 Ismail Ramadani, T 1042.
255 M052, T 8290-8291.
256 M037, T 826.
257 M017, T 630, 739-740; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 31.
258 *Shih më poshtë*, para. 102.
259 M037, T 799-800.
260 M017, T 632-635; Prova materiale P21; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 31; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 37; Osman Ramadani, Prova materiale P198, para. 25.
261 M017, T 632-635; Prova materiale P21.
262 M017, T 633-634; 711; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 40.
263 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 32; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 37; Shih gjithashtu Osman Ramadani, T 1080.

diskutohet më vonë, Lube Boshkoski mbërriti në shtëpinë e Bracës dikur pas orës 12:00 dhe qëndroi atje deri pak para orës 13:45.[264]

73. Në atë kohë brenda gardhit të oborrit të shtëpisë së Bracës ishin 20 deri 100 individë. Midis tyre kishte policë rezervistë me uniforma kamuflimi, ushtarë rezervistë, dhe civilë.[265] Pas përfundimit të operacionit në fshatin Luboten, policët që morën pjesë në të, apo të paktën disa prej tyre, u kthyen në postbllokun tek shtëpia e Bracës. Buçuku, pronari i agjencisë private të sigurimit Kometa,[266] ishte ndër njerëzit që u pane tek ktheheshin nga Luboteni.[267] Aleksandar Janevski dhe Vlado Janevski, i quajtur Kunta, të dy punonjës të Kometës,[268] u panë gjithashtu ndër njerëzit që u kthyen pas operacionit në Luboten.[269] Siç u tha më sipër, Vlado Janevski u transportua nga Hermelina, pasi ai ishte vetëplagosur. Disa nga policët që u panë duke u kthyer nga Luboteni pas operacionit policor, ishin të pajisur me armë AK-47 në OVR-në e Çairit mbrëmjen e 11 gushtit. [270] Kjo do të diskutohet hollësisht më poshtë në këtë Aktgjykim.[271]

74. Menjëherë pas mbërritjes në shtëpinë e Bracës, burrat që ishin mbajtur në shtëpinë e Adem Ametovskit, u urdhëruan të shtriheshin përmbys përtokë jashtë gardhit.[272] Policët i rrahën egërsisht, duke i goditur dhe duke u hedhur mbi ta.[273] Rrahja ishte kaq e egër sa disa nga burrat humbën vetëdijen.[274] Kur një nga burrat më pas erdhi në vete, ai vuri re se i kishin hequr pantallonat dhe të mbathurat. Fytyrën dhe trupin e kishte të mbuluar me gjak.[275] Burrat ishin në gjendje të keqe. Disa prej tyre nuk mund të lëviznin apo të qëndronin në këmbë.[276]

---

264 *Shih më poshtë*, para. 425.
265 Blagoja Jakovoski, T 3936-3939; 3994.
266 M052, T 8258. *Shih* gjithashtu *më poshtë*, para. 497.
267 M052, T 8290-8291; 8355. Një dëshmitar tjetër pretendoi se nuk kishte dijeni për praninë e Buçukut tek Muri Kinez atë ditë, megjithëse para se të fillonte procesi gjyqësor ai i kishte deklaruar hetuesit të Prokurorisë se e kishte parë atë atje. (Blagoja Jakovoski, T 3939-3941)
268 M052, T 8262.
269 M052, T 8293-8294.
270 M052, T 8274.
271 *Shih më poshtë*, para. 117-118.
272 M017, T 630; M012, T 976; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 37.
273 M017, T 630; M012, T 897; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 34; Prova materiale P197, para. 45; Vehbi Bajrami, T 1872.
274 M017, T 634-6345; M012, T 898; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 45; Osman Ramadani, Prova materiale P198, para. 28.
275 M012, T 898-899.
276 Ismail Ramadani, T 997.

75. Në shtëpinë e Bracës burrat e arrestuar i hipën në një kamion të ruajtur nga dy policë. Megjithëse ka dëshmi se besohej se të dy policët ishin rezervistë[277], dëshmitë nuk japin asnjë bazë për të arritur në përfundimin se ata ishin anëtarë të njësisë policore që kishte hyrë në fshat. Kamioni kishte ardhur nga stacioni policor i Mirkovcit. Pastaj burrat i transportuan në stacionin policor të Mirkovcit.[278] Së bashku me burrat e arrestuar, në kamion u vendosën edhe të tri armët e konfiskuara në Luboten.[279] Në Murin Kinez u sollën edhe letërnjoftimet e konfiskuara nga burrat e arrestuar,[280] po nuk ka dëshmi që tregojnë se çfarë u bë me to.

76. Raportet e përgatitura nga stacioni policor i Mirkovcit dhe OVR-ja e Çairit tregojnë se më 12 gusht 2001, në Luboten u kapën dhjetë individë dhe u sollën në postbllok, dhe se u gjetën gjithashtu tre automatikë, dy të prodhimit kinez dhe një Tompson, si dhe municion.[281] Megjithëse ka dallime në përshkrimin e saktë të armëve dhe municionit, Dhoma Gjyqësore konkludon se është e qartë se këto armë, sipas dëshmive policore në këtë çështje gjyqësore, ishin gjetur pranë kufomave të tre burrave në fushën pranë shtëpisë së Qani Jasharit. Siç u tha, të tri armët dhe municioni ishin të vetmet materiale luftarake që u gjetën në Luboten atë ditë.

77. Në stacionin policor të Mirkovcit, banorët e Lubotenit të kapur në shtëpinë e Adem Ametovskit, i futën në një bodrum apo garazh.[282] Ata u keqtrajtuan përsëri egërsisht nga policia.[283] Ata i rrahën me kondakë pushkësh, shkopinj bejsbolli dhe shkopinj policorë.[284] Pastaj të arrestuarit i futën në një dhomë të stacionit policor. Atje i morën në pyetje dhe disa prej tyre u kërcënuan dhe u detyruan të nënshkruan mbi

277 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 35-36. *Shih* gjithashtu M052, T 8329; M083, T 1398-1401; Prova materiale P227.

278 M012, T 899; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 36; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 45; Osman Ramadani, T 1101. *Shih* gjithashtu M052, T 8329; M083, T 1398-1401; Prova materiale P227.

279 M083, T 1431-1432; 1446; Prova materiale P23.

280 Eli Çakar, Prova materiale P441, para. 18; Prova materiale P442.

281 Provat materiale P23; P108; M083, T 1381-1394; Provat materiale P257; P54, f. 105-106 (42-43 të versionit anglisht); Blagoja Toshkovski, T 4295.

282 M012, T 899-900; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 37; Prova materiale P191, Ismail Ramadani, T 998; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 46; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3.

283 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 37. Një dëshmitar dëshmoi se policia hodhi ujë mbi ta duke përdorur një tub plastik, M017, T 636. Lidhur me këtë, *shih* gjithashtu Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 46; Osman Ramadani, Prova materiale P198, para. 31; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 3.

284 M017, T 638; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 37. *Shih* gjithashtu Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 46-47.

dokumente të pashkruara.[285] Ata që nuk pranonin të nënshkruanin i kthenin në bodrum ku i rrihnin përsëri.[286] Në një moment policia njoftoi të arrestuarit se do t'i nënshtroheshin provës së parafinës me dorashkë, por nuk i sqaroi mbi qëllimin e kësaj prove.[287] Më pas disa prej tyre kryen provën e parafinës me dorashkë në stacionin policor të Mirkovcit.[288]

78. Banorët e Lubotenit u rrahën brutalisht në stacionin policor të Mirkovcit.[289] Ekzistojnë dëshmi konkrete lidhur me Adem Ametovskin, Hamdi Ametovskin dhe Atulla Qailin. Adem Ametovski pësoi plagë të rënda, iu thyen dhëmbët, dhe humbi vetëdijen.[290] Hamdi Ametovski u rrah veçanërisht keq.[291] Edhe Atulla Qaili u rrah egërsisht.[292] Ai ishte i alivanosur në pjesën më të madhe të kohës në stacionin policor të Mirkovcit, dhe megjithatë vazhdonin t'a rrihnin.[293] Duke cituar fjalët e një dëshmitari, nuk kishte asnjë pjesë të trupit të Qailit që të mos ishte e mbuluar me gjak; ai nuk ishte në gjendje të fliste.[294] Të arrestuarit kërkuan mjek, por fillimisht kjo kërkesë nuk u plotësua.[295] Pas një farë kohe në bodrum hynë policët dhe personeli mjekësor të cilët morën me vete Atulla Qailin.[296] Dëshmitë sugjerojnë se të arrestuarve të tjerë në stacionin policor të Mirkovcit iu dha një farë ndihme mjekësore.[297]

79. Në mbrëmjen e 13 gushtit 2001, katër apo pesë banorë të Lubotenit që mbaheshin në stacionin policor të Mirkovcit, u dërguan në Spitalin e Qytetit së Shkupit.[298] Atje ata u keqtrajtuan përsëri.[299] Sipas një dëshmitari, personat që i kryen këto akte ishin policë dhe

---

285 M012, T 900-901; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 40, 41; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 48; Osman Ramadani, Prova materiale P198, para. 32; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 4; Vehbi Bajrami, T 1871, 1874.

286 M012, T 901. Të tjerët i kthyen në bodrum, i rrahën dhe kërcënuan përsëri dhe u kërkuan të nënshkruanin në fletë të pashkruara. (Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 42, 45; Ismail Ramadani, Prova materiale P189, para. 21)

287 M012, T 902.

288 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 52.

289 M017, T 636-637.

290 M012, T 901.

291 M012, T 901.

292 M012, T 905.

293 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 43.

294 M012, T 905.

295 M012, T 905.

296 M012, T 906; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 44; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 48, 51.

297 *Shih* M012, T 954-955. Ismail Ramadani, T 1026; Osman Ramadani, T 1082; Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 4; Vehbi Bajrami, T 1873.

298 M017, T 638-640; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 47-48; Ismail Ramadani, T 1026; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 51.

299 M017, T 638-640; Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 49; Ismail Ramadani, T 1045-1046. Dhoma Gjyqësore nuk pranon dëshminë e M017 se disa doktorë goditën dhe shkelmuan të arrestuarit (M017, T 638-64)

një mjek,[300] kurse një dëshmitar tjetër i identifikoi këta persona si rezervistë.[301] Baza e këtyre identifikimeve është e paqartë. Dhoma Gjyqësore dëshiron të theksojë këtu se, siç është përmendur në një vend tjetër, rojet e sigurisë në spital nuk ishin personel i Ministrisë së Brendshme.[302] Gjatë kohës së qëndrimit në spital, të arrestuarve iu dha ndihmë mjekësore.[303] Të nesërmen të arrestuarit në spital u vizituan nga një gjykatës hetues dhe disa avokatë të mbrojtjes.[304] Njërit prej të arrestuarve i treguan një dokument me nënshkrimin e tij ku pohohej se ai kishte qenë anëtar i UÇK-së dhe se i ishte gjetur një prej armëve automatike të kapura më 12 gusht në Luboten.[305] Dëshmitari hamendësoi se deklarata ishte shkruajtur në copën e letrës që ishte detyruar t'a nënshkruante në stacionin policor të Mirkovcit. Ai ia mohoi brendinë e letrës gjykatësit hetues dhe i shpjegoi rrethanat në të cilat ishte detyruar t'a nënshkruante fletën e bardhë pa tekst.[306] Gjithsesi nga Spitali i Qytetit të Shkupit këta burra i çuan në burgun e Shutkës ku u mbajtën në burg për katër muaj.[307] Ata u liruan në dhjetor 2001, pas një vendimi të Presidentit, i cili do të diskutohet më pas.[308]

80. Më 12 gusht shumë banorë të Lubotenit u përpoqën gjithashtu të iknin nga fshati për në Shkup. Përpjekjet e tyre për të ikur prej fshatit vazhduan deri vonë pasdite më 12 gusht 2001[309] si dhe ditët e mëvonshme. Pasdite herët, më 12 gusht, një grup banorësh u ndaluan në rrugën kryesore që çonte nga Luboteni në Shkup, afro 300 metra përpara postbllokut policor në Buzallak.[310] Ata u ndaluan dhe u kontrolluan nga policë të veshur me uniforma kamuflimi.[311] Policët verifikuan letërnjoftimet e tyre dhe i urdhëruan burrat të hiqnin këmishat përpara së të vazhdonin drejt postbllokut.[312] Në postbllok policia ndau

---

pasi kjo nuk vërtetohet dhe bie ndesh me dëshmitë e tjera. (*Shih* për shembull, Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 49)

300 M017, T 638-639.

301 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 49.

302 *Shih më poshtë*, para. 517.

303 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 49; Ismail Ramadani, T 1026-1027.

304 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 51; M017, T 734-735.

305 Prova materiale P54.008, f. 3.

306 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 51, 52.

307 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 54-56; M017, T 643-644. Në burgun e Shutkës M017 u qëllua një herë nga një punonjës i burgut apo polic i burgut. (M017, T 643-644)

308 M017, T 643-644. *Shih* gjithashtu *më poshtë*, para. 95.

309 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 6; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 10; Prova materiale P376; Isni Ali, Prova materiale P263, para. 7; Isni Ali, T 2018-2020.

310 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 7; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 13.

311 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 7; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 13.

312 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 15; Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 7; Sherafedin Ajrullai, T 4028.

burrat nga gratë dhe fëmijët.[313] Burrat u urdhëruan të shtriheshin përtokë. Ata u rrahën nga policia.[314] Policët i goditën me kondakët e pushkëve dhe me shkelma.[315] Prej andej disa nga burrat u transportuan me një automjet policie për në stacionin policor të Butelit në Shkup.[316] Burrat e tjerë u çuan në stacionin policor të Proleqit në Shkup,[317] ku gjetën rreth 30 banorë të tjerë të Lubotenit, të cilët mbaheshin atje që më parë.[318] Gratë dhe fëmijët u lejuan të ktheheshin në Luboten.[319]

81. Veprime të kësaj natyre u përsëritën disa herë gjatë pasdites së 12 gushtit 2001. Dëshmitarët përshkruan ngjarje të tilla që ndodhën pak pas orës 13:00[320] dhe më pas, pas orës 17:00 të po asaj dite.[321] Dëshmitë tregojnë se grupe të ndryshme prej 7, 10, 20 apo 50 burrash, u urdhëruan të shtriheshin përtokë, se ata u rrahën, dhe se më pas u transportuan në një stacion policor në Shkup.[322]

82. Dëshmitë tregojnë se ndërkohë që banorët e Lubotenit po largoheshin nga fshati, qindra civilë maqedonas etnikë[323] me lopata, sëpata, dhe armë gjahu, po grumbulloheshin pranë postbllokut të Buzallakut, duke ardhur nga drejtimi i Radishanit, për të sulmuar popullsinë shqiptare që vinte nga Luboteni.[324] Një dëshmitar dëshmoi se policët që shoqëronin banorët e Lubotenit, shtinë në ajër për të trembur turmën e civilëve maqedonas që po afroheshin dhe për të parandaluar një sulm të tyre kundër banorëve të Lubotenit.[325] U tha gjithashtu se sipas një urdhri, ndoshta të lëshuar nga Ministria e Brendshme, këta banorë duhej të zhvendoseshin 100 metra larg nga postblloku i

313 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 7; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 13. *Shih* gjithashtu Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 17, 18, 19; Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 7-8; Isni Ali, Prova materiale P263, para. 8.

314 Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 8.

315 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 7; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 13. *Shih* gjithashtu Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 17, 18, 19.

316 Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 10; Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 8; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 13; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 21, 22.

317 Rreth orës 18:00, në postbllokun policor tek Kodra e Zaimit, policë të veshur me uniforma ndaluan njerëzit që po përpiqeshin të largoheshin dhe ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Atje ishin që më parë disa banorë meshkuj të Lubotenit të shtrirë përmbys. Pas disa minutash ky grup banorësh meshkuj të Lubotenit u çuan në stacionin policor të Proleqes. (Isni Ali, Prova materiale P263, para. 8; Isni Ali, T 2007) *Shih* gjithashtu Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 15.

318 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 10.

319 Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 8.

320 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 6-7; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 10-14.

321 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 7-8; Isni Ali, T 2007.

322 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 7; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 13. *Shih* gjithashtu Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 22-24.

323 M052, T 8405-8406; Petre Stojanovski, T 9161.

324 M084, T 1498; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 14.

325 M084, T 1498.

Buzallakut dhe se duhej të qëndronin atje[326] deri sa të vinin autobusët për t'i transportuar.[327] Dëshmitari nuk saktësoi se ku do t'i çonin autobusët këta njerëz nga Luboteni. Një dëshmitar tjetër dëshmoi se urdhri kërkonte që banorët e Lubotenit të transportoheshin me autobus për në Shkup.[328] Mirëpo, siç u konkludua më sipër, shumë banorë meshkuj shqiptarë etnikë të Lubotenit, në fakt, u çuan në stacione policore ku u mbajtën për disa ditë. Në postbllok ata u keqtrajtuan nga policia. Ndërkohë që banorët e Lubotenit po i afroheshin postbllokut, disa civilë maqedonas etnikë në moshë të re filluan të rrihnin dy banorë të rinj shqiptarë etnikë të Lubotenit. Kjo ndodhi pasi një polic[329] u bëri shenjë.[330] Të dy të rinjtë ia dhanë vrapit në drejtim të Radishanit. Dy policë iu thirrën të ndalonin dhe hapën zjarr kundër tyre. Një nga të rinjtë shqiptarë u godit nga një plumb në ballë dhe ra në tokë pa ndjenja.[331]

83. Meshkujt shqiptarë etnikë të Lubotenit u transportuan nga postblloku i Buzallakut në stacionin policor të Butelit (i cili njihet gjithashtu me emrin Çair) ku u futën në një bodrum të stacionit policor,[332] apo në një kthinë të vogël në katin e parë.[333] Pas mbërritjes së tyre në Butel, disa prej tyre u rrahën nga policë të veshur me uniforma kamuflimi dhe me maska në fytyrë.[334] Në pasditen dhe në mbrëmjen e 12 gushtit, disa nga burrat e ndaluar të Lubotenit u hipën në automjete të policisë dhe u transportuan nga stacioni policor i Butelit për në stacionin policor të Karposhit në Shkup.[335] Të tjerët u transportuan nga stacioni policor i Butelit për në stacionin policor të Proleqes.[336] Gjatë rrugës nga stacioni policor i Butelit, disa nga këta burra u rrahën nga policët e veshur me uniforma kamuflimi.[337]

---

326 M084, T 1500.
327 M084, T 1500.
328 M052, T 8405-8406.
329 Ejup Hamiti, T 4428- 4429.
330 Ejup Hamiti, Prova materiale f. 417, f. 3; Ejup Hamiti, T 4436-4437.
331 Ejup Hamiti, Prova materiale f. 417, f. 3; Ejup Hamiti, T 4436-4437; Prova materiale P419.
332 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 8; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 25; Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 12.
333 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 14, Farush Memedi, T 2036-2037.
334 Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 11.
335 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 8; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 27; Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 15.
336 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 15.
337 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 8; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 14, Farush Memedi, T 2041. *Shih* gjithashtu Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 11.

84. Ata, që u çuan në stacionin policor të Karposhit, i futën në një kthinë në bodrum ku u keqtrajtuan përsëri për rreth një orë.[338] Pastaj u çuan një nga një në një dhomë ku disa prej tyre iu nënshtruan provës së parafinës me dorashkë.[339] Burrat u morën në pyetje.[340] Disa u akuzuan se kishin luftuar në UÇK.[341] Disa u detyruan të nënshkruanin dokumente.[342] Kjo ndodhi në praninë e dy burrave të veshur me rroba civile dhe një policeje. Të pranishëm ishin edhe policë të veshur me uniforma kamuflimi dhe maska në fytyrë.[343] Me gjithë keqtrajtimin e pësuar në stacionin policor të Karposhit si dhe më parë, burrave nuk iu dha asnjë ndihmë mjekësore.[344]

85. Disa nga burrat u transportuan nga stacioni policor i Karposhit për në stacionin policor të Bit Pazarit në Shkup. Gjatë rrugës për në stacionin policor të Bit Pazarit si dhe në të hyrë të stacionit policor, ata u rrahën përsëri, por rrahjet u ndërprenë pas ndërhyrjes së një oficeri të lartë të policisë.[345] Burrat u morën në pyetje nga oficeri i lartë i policisë dhe u lanë të lirë.[346] Burrat e tjerë nga Luboteni që kishin mbetur në stacionin policor të Karposhit, u çuan në gjykatën e Shkupit më 14 gusht 2001.[347]

86. Banorët shqiptarë etnikë të Lubotenit që u çuan në stacionin policor të Proleqes, u rrahën keqas nga policët e atjeshëm.[348] Ata nuk u morën në pyetje për ngjarjet në Luboten.[349] Disa u detyruan të nëshkruanin mbi fletë të pashkruara[350] dhe shumë prej tyre u detyruan t'i nënshtroheshin provës së parafinës me dorashkë.[351] Ata që rezultuan pozitivisht, u mbajtën në stacionin policor.[352] Mbrëmjen e 13 gushtit, shumë prej burrave u çuan në një spital shtetëror në Shkup ku kaluan natën. Ata ishin nën ruajtjen e një polici

338 Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 17; Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 8.
339 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 8; Mamut Ismaili, Prova materiale P219.2, para. 6; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 29; Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 17;
340 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 30; Qemuran Rexhepi, T 3549.
341 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 30.
342 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 30.
343 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 30; Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 17.
344 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 12.
345 Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 20.
346 Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 20.
347 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 9; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 31, Qemuran Rexhepi, T 3510.
348 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 9, Isni Ali, T 2008-2010, 3463-3464; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 16.
349 Isni Ali, T 2010-2011; Farush Memedi, T 2038-2040, 2047-2048.
350 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 18.
351 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 9, Isni Ali, T 2008-2010, 3464; Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 18.
352 Isni Ali, T 3468.

të armatosur dhe të veshur me uniformë kamuflimi.[353] Në mëngjes dy nga burrat u keqtrajtuan nga një burrë i veshur civil në prani të një personi tjetër, i cili, sipas mendimit të një dëshmitari, ishte oficer i lartë i policisë i veshur me uniformë kamuflimi,[354] megjithëse baza e hamendësimit të tij nuk është e qartë. Rreth mesnatës së 14 gushtit këta banorë të Lubotenit u çuan nga spitali në gjykatën e Shkupit.[355] Ndërkohë rrahjet në stacionin policor të Proleqes kishin vazhduar.[356] Më 14 gusht 2001, disa nga burrat u transferuan nga stacioni policor i Proleqes në stacionin policor të Bit Pazarit.[357] Ata u keqtrajtuan në oborrin e këtij stacioni policor.[358] Vonë në mbrëmjen e 14 gushtit 2001, ndoshta në orën 02:00 të 15 gushtit 2001, ata u çuan në gjykatën e Shkupit.[359]

87. Shumë banorë shqiptarë etnikë të Lubotenit, të cilët më 12, 13 dhe 14 gusht, ishin mbajtur në stacione të ndryshme policore të Shkupit, më 14 gusht 2001 u çuan në gjykatën e Shkupit. Disa prej tyre dëshmuan për çka kishin përjetuar në Gjykatën e Shkupit. Rrëfimet e tyre do të shqyrtohen shkurtimisht më poshtë.

88. Më 14 gusht 2001, M012 u transportua nga stacioni policor i Mirkovcit për në gjykatën e Shkupit së bashku me banorë të tjerë të Lubotenit. Në momentin e mbërritjes ata u rrahën me shkopinj gome dhe u shkelmuan nga policë, disa prej të cilëve ishin të veshur me uniforma dhe disa me rroba civile. Ai dhe pesë burra të tjerë u çuan në gjykatë. Të pranishëm ishin një gjykatës, një prokuror, dhe një avokat. Në atë kohë M012 ishte në gjendje shumë të keqe, kishte plagë në fytyrë, dhe mezi qëndronte në këmbë. Ishte pa pantallona. Ai dëgjoi gjykatësin, prokurorin dhe avokatin e mbrojtjes kur diskutuan për gjendjen e tij fizike dhe thanë se ai duhej dërguar në spital. M012 dhe burrat e tjerë u pyetën si u ishin shkaktuar plagët. Ata u njoftuan se do të burgoseshin për 30 ditë në burgin e Shutkës.[360] Mirëpo M012 u mbajt katër muaj atje.[361] M012 e dinte se akuzohej për kryerjen e akteve terroriste.[362]

353 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 20.
354 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 21.
355 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 22.
356 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 10.
357 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 11, 12; Isni Ali, T 2011-2012.
358 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 12, Isni Ali, T 2011-2012.
359 Isni Ali, Prova materiale P263, para. 13, Isni Ali, T 2012-2014.
360 M012, T 912.
361 M012, T 919.
362 M012, T 916.

89. Vehbi Bajrami u çua gjithashtu nga stacioni policor i Mirkovcit në gjykatën e Shkupit. Atje një gjykatës i tregoi një dokument me nënshkrimin e tij. Pasi Vehbi Bajrami i tha gjykatësit se ai nuk dinte çfarë kishte nënshkruar, gjykatësi i shpjegoi Vehbi Bajramit se kishte nënshkruar një deklaratë ku pohohej se i kishin gjetur një automatik dhe një bombë dore. Vehbi Bajrami e mohoi një gjë të tillë dhe i tha gjykatësit se ishte detyruar nga policia të nënshkruante këtë dokument. Ai dëshmoi se kishte bërë një deklaratë në gjykatë dhe se kjo deklaratë e përfshirë në dosjen e tij gjyqësore ishte ndryshuar. Gjatë daljes nga ndërtesa e gjykatës ai dhe të arrestuar të tjerë nga Luboteni u rrahën nga persona të veshur me rroba civile.[363] Pastaj atë e çuan në burgun e Shutkës ku e mbajtën katër muaj.[364]

90. Mamut Ismaili u çua nga stacioni policor i Karposhit në gjykatën e Shkupit mbrëmjen e 14 gushtit 2001. Ai pa 10 deri në 15 banorë të tjerë të Lubotenit në ndërtesën e gjykatës. Mamut Ismaili dhe të tjerët u rrahën keqas me kondakët e pushkëve dhe sende të tjera nga policët me uniforma kamuflimi, midis së cilëve edhe disa femra. Pastaj Mamut Ismailin e çuan në një dhomë, e cila, sipas mendimit të tij, ishte zyrë, ku ai pa dy burra dhe një grua të veshur me rroba civile. Një prej tyre, i cili, sipas mendimit të Mamut Ismailit, ishte gjykatës, e pyeti për emrin dhe mbiemrin. Mamut Ismaili u pyet për ngjarjet në Luboten si dhe nëse ishte anëtar i UÇK-së. Ai tha se policia e kishte rrahur. Pastaj Mamut Ismailit i kërkuan të nënshkruante një dokument, i cili, sipas mendimit të tij, ishte procesverbal i asaj çka kishte thënë ai. Pastaj i thanë se do të mbahej në paraburgim për 30 ditë. Ai nuk e dinte nëse ishte i pranishëm apo jo avokati mbrojtës. Ai nuk kishte avokat kur u mor në pyetje.[365] Mamut Ismail u çua në burgun e Shutkës ku u mbajt për katër muaj.[366]

91. Isni Aliu u çua nga stacioni policor i Bit Pazarit në gjykatën e Shkupit natën e 14 gushtit 2001 shumë vonë, ndoshta pas mesnate. Në korridorin e gjykatës ai u keqtrajtua nga policë dhe rezervistë. Një grua, e cila sipas mendimit të Isni Aliut ishte gjykatëse, ndonëse ai nuk dha arsye përse mendoi kështu, e shkeli mbi këmbë me takat e saj të larta.

---

363 Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 4; Vehbi Bajrami, T 1822.
364 Vehbi Bajrami, Prova materiale P247.1, f. 4.
365 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 9, 10; Mamut Ismaili, Prova materiale P219.2, para. 7; Mamut Ismaili, T 1353-1354.
366 Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 11.

Pas një farë kohe, atë e futën në një dhomë, e cila sipas mendimit të tij ishte zyrë. Në të ishin tre persona. Njëri prej tyre e prezantoi veten si gjykatës, ndërsa i dyti tha se ishte avokati mbrojtës i Isni Aliut. Gjykatësi lexoi një dokument ku thuhej se Isni Aliu ishte terrorist. Ai e mohoi këtë. Ai tha se më pas i kërkuan të nënshkruante një dokument dhe pas kësaj e çuan në bodrumin e gjykatës e më vonë e transferuan në burgun e Shutkës.[367]

92. Aziz Rexhepi u çua gjithashtu nga stacioni policor i Bit Pazarit në gjykatën e Shkupit. Kjo ndodhi herët në mbrëmjen e 14 gushtit 2001. Kur mbërriti, ai pa atje banorë të tjerë të Lubotenit. Aziz Rexhepin e paraqitën para një personi, i cili, sipas mendimit të tij, ishte gjykatës hetues. Aziz Rexhepi kërkoi të ishte i pranishëm avokati i tij mbrojtës. Gjykatësi iu përgjegj se avokati nuk ishte i disponueshëm pasi ishte diku gjetkë dhe se ata nuk kishin kohë për t'a pritur. Pastaj gjykatësi e ndihmoi Aziz Rexhepin të kontaktonte një avokat tjetër. Pas një shqyrtimi të shpejtë të aktakuzës, avokati foli me gjykatësin hetues dhe informoi Aziz Rexhepin se nuk mund të bënte asgjë. Aziz Rexhepi akuzohej se kishte përdorur armë. I thane se kishte dalë pozitiv në provën e parafinës me dorashkë. Aziz Rexhepi u pyet nga gjykatësi. Ai informoi gjykatësin se e kishin rrahur në stacionet policore të Proleqes dhe Bit Pazarit si dhe në ambientet e gjykatës. Pas një ndërhyrjeje nga avokati, gjykatësi u tha policëve të mos e preknin më Aziz Rexhepin.[368] Pastaj atë e çuan në burgun e Shutkës ku u mbajt në paraburgim deri në dhjetor 2001.[369]

93. Farush Memedin e çuan nga spitali në Shkup në gjykatën në Shkup rreth mesnatës së 14 gushtit 2001. Atje ai pa rreth 20 burra nga Luboteni.[370] Ata ishin nën ruajtjen e një polici të veshur me uniformë kamuflimi. Një polic tjetër rrihte këdo që guxonte të lëvizte.[371] Ata i çuan një nga një në një dhomë, të cilën dëshmitari e përshkroi si zyrë. Atje Farush Memedit i thanë se prova e tij e parafinës me dorashkë kishte rezultuar pozitive dhe në këtë mënyrë vërtetohej se ai kishte mbajtur armë.[372] Farush Memedi nuk tha asgjë lidhur me këtë. Ai përfaqësohej nga një avokat shqiptar, të cilin Farush Memedi nuk e njihte personalisht.[373] Farush Memedit i dhanë një dokument të gjykatës, në të cilin

[367] Isni Ali, Prova materiale P263, para. 14-15; Isni Ali, T 2012-2014; 3476; 3479; 3496-3497.
[368] Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 33-38; Aziz Rexhepi, T 4677-4679; 4680-4682.
[369] Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 39, 41.
[370] Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 22.
[371] Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 22.
[372] Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 23.
[373] Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 23; Farush Memedi, T 2469.

ai akuzohej për terrorizëm.[374] Pastaj atë e çuan në burgun e Shutkës ku u mbajt në paraburgim për katër muaj.[375]

94. Më 14 gusht, në mbrëmje, Qamuran Rexhepin e çuan nga stacioni policor i Karposhit në gjykatën e Shkupit. Atje nuk e keqtrajtuan. Në fakt, policët e pyetën nëse donte të pinte apo të hante diçka. Mirëpo ai pa policë me maska që keqtrajtuan njerëzit që sollën në gjykatë.[376] Atë e çuan në një dhomë, të cilën e përshkroi si zyrë dhe ku ishin të pranishëm një gjykatës dhe një prokuror. Aty ishte gjithashtu edhe një avokat i caktuar nga gjykata, me gjithë këmbënguljen e Rexhepit për caktimin e një avokati që do ta përfaqësonte. Qamuran Rexhepi nënshkroi një deklaratë që ia vunë përpara. Ai nuk u lejua të thoshte asgjë gjatë seancës. E gjithë seanca vazhdoi rreth 15 minuta.[377] Pastaj Qamuran Rexhepin e çuan në burgun e Shutkës ku u mbajt i paraburgosur për 125 ditë.[378]

95. Rrëfimet e lartpërmendura nuk mbështeten nga dëshmi të tjera. Është e paqartë nëse referencat "policia" në dëshmitë kanë të bëjnë me pjesëtarë të Ministrisë së Brendshme apo policinë gjyqësore, e cila është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë.[379] Dëshmitë vënë gjithashtu në pikëpyetje nëse deklaratat e këtyre banorëve të Lubotenit u morën nëpërmjet përdorimit të forcës. Këto çështje të diskutueshme nuk u shtjelluan plotësisht para Dhomës Gjyqësore. Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në një përfundim lidhur me to. Mbi bazën e dokumentave gjyqësore, Dhoma Gjyqësore thekson se më 14 gusht 2001, këta banorë të Lubotenit fillimisht u paraburgosën mbi bazën e dyshimit se kishin kryer veprën penale të terrorizmit. Më pas akuzat kundër tyre u ndryshuan në "shërbim në forcat armike." Si përfundim, procedurat penale kundër tyre u ndërprenë në dhjetor 2001 si rezultat i faljes nga Presidenti në bazë të një ligji amnistie.[380] Mbi bazën e dëshmive në disponim, Dhoma Gjyqësore nënvizon se nuk u vërtetua se këta banorë të Lubotenit kishin qenë anëtarë të UÇK-së.

374 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 26; Farush Memedi, T 2082-2084; 2447.
375 Farush Memedi, Prova materiale P266, para. 23, 24.
376 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 32.
377 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 33; Qemuran Rexhepi, T 3535-3539; Prova materiale 1D102.
378 Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 33-36.
379 *Shih më poshtë*, para. 389.
380 Prova materiale P46.05; P47, f. 2, 5, 7; P48.1.

96. Gjatë ditëve pas 12 gushtit 2001, shumë banorë shqiptarë etnikë të Lubotenit u larguan nga fshati. Sipas dëshmisë së Sedat Muratit, shumë prej tyre u kthyen vetëm pas dy javëve.[381] Gjatë kësaj periudhe fshati ishte thuajse i zbrazët[382] dhe ka patur disa të shtëna të izoluara.[383] Më 13 apo 14 gusht iu vu zjarri të paktën dy shtëpive që u përkisnin maqedonasve etnikë (shtëpia që i përkiste një personi të quajtur Mirce dhe shtëpia e Kostovskit).[384] Gjatë kësaj periudhe iu vu zjarri të paktën një shtëpie të një shqiptari etnik.[385]

97. Më 14 gusht 2001 një përfaqësues i OSBE-së, Henry Bolton, hyri në Luboten. Ai pa kufomat e një mashkulli rreth 20 vjeç dhe një burri më të moshuar që dergjeshin në rrugë. Në trupat e tyre kishte disa plagë të shkaktuara prej armëve të zjarrit.[386] Dhoma konkludoi se këto ishin kufomat e Sulejman Bajramit dhe Muharem Ramadanit.[387] Zotit Bolton i treguan bodrumin e një shtëpie ku disa banorë i thanë se këta njerëz ishin strehuar më 12 gusht. Dhoma Gjyqësore konkludon se kjo ishte shtëpia e Adem Ametovskit. Më tej në rrugë përfaqësuesi i OSBE-së pa katër shtëpi, të cilat kishin pësuar dëmtime të konsiderueshme. Ai pati përshtypjen se këto shtëpi kishin qënë objektivi i sulmit. Dhoma konkludon se këto shtëpi ishin të familjes Jashari. Në fushën në veri të këtyre shtëpive dergjeshin tri kufoma të tjera, secila me plagë të shumta të shkaktuara nga armë zjarri.[388] Dhoma Gjyqësore konkludoi se këto ishin kufomat e Xhelal Bajramit, Bajram Jasharit dhe Kadri Jasharit.[389]

98. Gjatë vizitës në Luboten më 14 gusht 2001, Z. Bolton vuri re dy burra të veshur me rroba të zeza. Ai hamendësoi se ata ishin anëtarë të UÇK-së. Z. Bolton kontaktoi policinë në Shkup dhe kërkoi të dërgohej një gjykatës hetues në Luboten. Atë e informuan se nuk kishte siguri për gjykatësin që të shkonte në Luboten. Pastaj Z. Bolton i këshilloi banorët e Lubotenit të vepronin me kufomat si ta gjykonin të përshtatshme.[390]

381 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 34.
382 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 35.
383 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 35.
384 Sedat Murati, Prova materiale P405, para. 35; Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 21.
385 Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 22.
386 Henry Bolton, Prova materiale P236.1, para. 11, 14.
387 *Shih më sipër*, para. 55; 57.
388 Henry Bolton, Prova materiale P236.1, para. 18.
389 *Shih më sipër*, para. 68.
390 Henry Bolton, Prova materiale P236.1, para. 22.

B. Njësitë e ushtrisë maqedonase të përfshira në ngjarjet në Luboten

99. Siç u theksua më sipër, ka dëshmi se më 12 gusht 2001, njësitë e ushtrisë maqedonase të vendosura pranë Lubotenit, hapën zjarr në drejtim të fshatit. Njësitë i përkisnin Batalionit të Tretë të Brigadës së Parë Gardiste. Brigada e Parë Gardiste ishte dislokuar në veri të Shkupit.[391] Së bashku me tri brigada të tjera ajo ishte nën komandën e gjeneral Sokol Mitrovskit.[392] Komandanti i Brigadës së Parë Gardiste ishte Bllazho Kopaçev/ Blažo Kopačev/.[393] Në gusht 2001, majori Mitre Despodov ishte komandant i Batalionit të Tretë.[394] Zëvëndësi i tij ishte Sasha Isovski.[395] Komanda e Batalionit të Tretë ishte vendosur në fjetoren e shkollës fillore të Lubancës.[396] Atje ishin vendosur edhe shtabi logjistik dhe operativ i batalionit.[397] Batalioni i Tretë Gardist përbëhej nga tri kompani këmbësorie dhe një bateri mortajash.[398] Kompania e Parë e Këmbësorisë, nën komandën e toger Zoran Saltamarskit, ishte dislokuar në Brodec.[399] Togeri Marijo Jurishiq/Marijo Jurišić/ ishte komandant i Kompanisë së Dytë të Këmbësorisë.[400] Zëvendësi i tij ishte toger Darko Brashnarski/Darko Brašnarski/.[401] Postkomanda e Kompanisë së Dytë të Këmbësorisë ishte në shtëpinë e pushimit të fëmijëve mbi Lubancë, pranë manastirit të Shën Nikollës.[402] Shtëpia e pushimit përdorej gjithashtu si strehimore për ushtarët e Batalionit të Tretë.[403] Kompania e toger Jurishiqit përbëhej nga 100-120 ushtarë.[404] Kompania e Tretë e Këmbësorisë, nën komandën e Ferdo Pavlovit, ishte dislokuar në Rashtak.[405] Bateria e mortajave e Batalionit të Tretë Gardist ishte nën

391 M051, T 4196; Provat materiale 1D99; 1D81, f. 3.
392 M051, T 4196; Nikollçe Grozdanovski, T 10413.
393 M051, T 4196; Nikollçe Grozdanovski, T 10447.
394 Marijo Jurishiq, T 3295-3296; M051, T 4118; 4196; Mitre Despodov, T 2603; 2665; Nikollçe Grozdanovski, T 10399; 10450; Prova materiale P303.
395 Marijo Jurishiq, T 3368; Mitre Despodov, T 2665.
396 Mitre Despodov, T 2545; Marijo Jurishiq, T 3368; Nikollçe Grozdanovski, T 10400; 10458.
397 Marijo Jurishiq, T 3296; Prova materiale P233.
398 Marijo Jurishiq, T 3292; 3368; Mitre Despodov, T 2665.
399 Marijo Jurishiq, T 3368; Mitre Despodov, T 2665.
400 Marijo Jurishiq, T 3290; 3367-3368; Mitre Despodov, T 2666.
401 Marijo Jurishiq, T 3368.
402 Mitre Despodov, T 2545; gabimisht e përmendi manastirin si "Kisha Shën Ilija."
403 Marijo Jurishiq, T 3298; Prova materiale P367; Nikollçe Grozdanovski, T 10458; 10483.
404 Marijo Jurishiq, T 3353
405 Marijo Jurishiq, T 3368; Mitre Despodov, T 2545-2546; 2666.

komandën e kapiten Nikollçe Grozgjanovskit/Nikolče Grozdanovski/.[406] Edhe kjo bateri ishte strehuar në shtëpinë e pushimit të fëmijëve.[407]

100. Batalioni i Tretë Gardist përbëhej thuajse vetëm nga rezervistë. Eprorët ishin nga personeli i rregullt i ushtrisë.[408] Një numër i madh rezervistësh të Batalionit të Tretë Gardist vinin nga fshatrat përreth, veçanërisht nga Lubanca.[409] Për shkak të pranisë së numrit të madh të rezervistëve nën komandën e tij, majorit Despodov i duhej të merrej me probleme të ndryshme, ndër të cilat mungesa e disiplinës dhe abuzimi me alkool. Ushtarët nuk ishin të stërvitur në masë të mjaftueshme dhe disa prej nuk dinin madje as të mbanin armën siç duhet.[410]

C. Ngjarjet e 10 gushtit 2001

101. Aktakuza përqëndrohet vetëm mbi ngjarjet që ndodhën në Luboten dhe në rrethinat e tij më 12 gusht dhe ditët e mëvonshme. Mirëpo, ngjarjet që ndodhën më 10 dhe 11 gusht 2001 kanë lidhje materiale me pretendimet e ngritura në Aktakuzë dhe do të trajtohen më poshtë.

102. Më 10 gusht 2001, një automjet i ushtrisë maqedonase hasi në një minë tokësore pranë Staneve të Lubotenit, rreth 10 kilometra nga Luboteni,[411] duke shkaktuar vdekjen e tetë ushtarëve të Kompanisë së Dytë të Këmbësorisë dhe duke plagosur gjashtë të tjerë.[412] Dy prej ushtarëve të vrarë ishin rezervistë nga fshati Lubancë.[413] Menjëherë pas incidentit, majori Despodov urdhëroi që t'u jepej ndihmë ushtarëve të plagosur në incident.[414] Togeri Jurishiq shkoi në vendin ku kishte ndodhur incidenti.[415] Ushtarët që shkuan atje u sulmuan me zjarr armësh nga persona që mendohej se ishin terroristë.[416] Forcat e Batalionit të Tretë Gardist hapën zjarr me mortaja 120 milimetërshe si dhe me

406 Marijo Jurishiq, T 3368; Mitre Despodov, T 2666; Nikollçe Grozdanovski, T 10399; 10403; 10457.
407 Mitre Despodov, T 2666; Nikollçe Grozdanovski, T 10399; 10458.
408 Mitre Despodov, T 2614; Nikollçe Grozdanovski, T 10454.
409 Nikollçe Grozdanovski, T 10454; Mitre Despodov, T 2661.
410 Mitre Despodov, T 2632.
411 M012, T 936.
412 Provat materiale P45, f. 135; f. 466, Pjesa 5, f. 43; Marijo Jurishiq, T 3355; Henry Bolton, T 1644-1647; Prova materiale 1D13; Mitre Despodov, T 2638-2639.
413 Marijo Jurishiq, T 3355.
414 Mitre Despodov, T 2639; Prova materiale P301.
415 Mitre Despodov, T 2639; 2637.
416 Mitre Despodov, T 2639; Marijo Jurishiq, T 3355-3356.

dy topa 76 milimetërsh.[417] Ushtria përdori gjithashtu një helikopter për vëzhgim ajror.[418] Në vendin e incidentit u gjet një sasi municioni dhe armësh.[419]

103. Majori Despodov sugjeroi se gjatë gjithë këtij operacioni më 10 gusht 2001, ai u kishte dhënë urdhra konkrete ushtarëve të tij që të hapnin zjarr kundër "terroristëve" dhe jo në drejtim të fshatit Luboten.[420] Mirëpo, në kundërshtim me sugjerimin e tij, provat ndër të cilar një raport i përgatitur në atë kohë nga majori Despodov dhe i paraqitur komandës së tij,[421] tregojnë se trupat e tij hapën zjarr në drejtim të Lubotenit më 10 gusht 2001 dhe Dhoma Gjyqësore e pranon këtë. Në raportin e majorit Despodov ishte shënuar se disa anëtarë të grupit, i cili mendohet se ishte përgjegjës për incidentin me minën tokësore, u zhvendos pas incidentit në drejtim të Lubotenit. Sipas raportit, gjatë rrugës për në Luboten anëtarët e grupit u strehuan në një stan delesh. Ushtria maqedonase shtiu me top në drejtim të tyre.[422] Më pas, ushtria hapi zjarr drejt fshatit me mortaja dhe një top.[423] Si rezultat i këtij operacioni të ushtrisë maqedonase më 10 gusht 2001, u vranë katër persona të konsideruar si "terroristë." Raporti saktëson se ata u vranë në vende të ndryshme jashtë fshatit: në hyrje të fshatit, mbi një burim me ujë të pijshëm sipër fshatit si dhe mbi një rrugë që të çonte në fshat.[424]

104. Granatimet dhe të shtënat më 10 gusht 2001 u vunë re nga banorë të Lubotenit. Ato vinin nga malet sipër fshatit.[425] Të shtënat vazhduan gjatë natës deri në mëngjesin e 11 gushtit.[426] Pasditen e 10 gushtit 2001, një djalë pesëvjeçar që po luante në fshat, në

417 Prova materiale P301.
418 Nikollçe Grozdanovski, T 10413; 10477; Mitre Despodov, T 2639.
419 M051, T 4180; Prova materiale 1D86.
420 Mitre Despodov, T 2639.
421 Mitre Despodov, T 2553.
422 Prova materiale P301; *shih* gjithashtu M2D-008, T 10535; Prova materiale 2D95.
423 M2D-008, T 10541; 10592.
424 Prova materiale P301.
425 Ismail Ramadani, Prova materiale P188, para. 6, 7; Ismail Ramadani, Prova materiale P189, para. 4; Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 4; M039, Prova materiale P200.1, f. 2-3; Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1, para. 3; Isni Ali, Prova materiale P263, para. 3; Sherafedin Ajrullai, Prova materiale P403, para. 5; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 3; Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 3; Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 6-9;
426 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 21.

rrugën që çonte në Rashtak, u godit nga një predhë mortaje. Ai vdiq menjëherë.[427] Ka dëshmi që tregojnë se më 10 gusht, në Luboten u vra edhe Memet Memeti.[428]

105. Incidenti i minës tokësore në Stanet e Lubotenit shkaktoi shume shqetësim në popullsinë me kombësi maqedonase në zonë, veçanërisht në fshatin Lubancë.[429] Fshati dhe zona e Lubotenit vëzhgohej nga ushtria në bashkëpunim me anëtarët e Ministrisë së Brendshme (*d.m.th.* policia).[430] Majori Despodov dëshmoi se njësiti, i cili bashkëpunoi me ushtrinë në vëzhgim, kishte ardhur nga stacioni policor i Mirkovcit.[431]

106. Pasditen e 10 gushtit 2001,[432] i Akuzuari Johan Tarçulovski shkoi në stacionin policor të Çairit.[433] Në oborrin e stacionit policor u grumbulluan gjithashtu shumë persona të veshur me uniforma të policisë rezerviste.[434] Atje ishin edhe Zoran Kërstevski dhe Goçe Ralevski. Mendohej se Zoran Kërstevski ishte këshilltar i Ministrit të Brendshëm, Lube Boshkoski,[435] por ka dëshmi që tregojnë se ai e mori këtë post në fund të shtatorit 2001.[436] Goçe Ralevski ishte anëtar i agjencisë private të sigurimit "Kometa."[437] Johan Tarçulovski dhe Zoran Kërstevski pyetën nëse shefi i OVR-së së Çairit, Lube Kërstevski (asnjë lidhje farefisnore me Zoran Kërstevskin), ishte kontaktuar nga zyrtarë të lartë të Ministrisë së Brendshme.[438] OVR-ja (*Oddelenie za Vnatrešni Raboti*) Çair, apo Drejtoria e Punëve të Brendshme, ishte strukturë e Ministrisë së Brendshme, përgjegjëse për një nga komunat e qytetit të Shkupit.[439] SVR (*Sektor za Vnatrešni Raboti*) Shkup, Sektori për Punët e Brendshme, ishte përgjegjës për të gjithë qytetin e Shkupit.[440]

---

427 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 5, 6, 14-18; Isni Ali, Prova materiale P263, para. 4; *shih* gjithashtu Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 4; Aziz Rexhepi, Prova materiale P432, para. 5.
428 Howard Tucker, P443, f. 14, Kufoma 1D/10; *shih* gjithashtu Provën materiale 1D8.
429 Mitre Despodov, T 2647; Marijo Jurishiq, T 3356-3357.
430 Mitre Despodov, T 2554; Prova materiale P301.
431 Mitre Despodov, T 2554; 2661.
432 Në një notë zyrtare hartuar nga M052 për një komision hetimor, ai thotë se ngjarja kishte ndodhur më 11 gusht 2001. Mirëpo, në sallën e gjyqit dëshmitari deklaroi se ishte gabim dhe se ngjarja nuk mund të kishte ndodhur më 11 gusht. M052, T 8344-8345.
433 M052, T 8256; 8259.
434 M052, T 8259-8262.
435 M052, T 8259; Prova materiale P574.
436 Vesna Dorevska, T 9605; 9610; 9642; 9652; Provat materiale 1D285; 1D307.
437 M052, T 8261; Prova materiale P534.
438 M052, T 8259.
439 *Shih më poshtë,* para. 482.
440 *Shih më poshtë*, para. 479.

107. Shefi i OVR-së në Çair vuri në dispozicion automjete në mënyrë që policët rezervistë të grumbulluar në oborrin e stacionit policor të Çairit të mund të shkonin në fshatin Lubancë dhe më pas në shtëpinë e pushimit të fëmijëve jashtë Lubancës, ku do të strehoheshin.[441] Për më tepër, policët rezervistë të Johan Tarçulovskit u pajisën me jelekë antiplumb si dhe me gjashtë radio.[442] Ndër personat e veshur me uniforma të policisë rezerviste që erdhën në OVR-në e Çairit atë ditë, ishin disa individë të lidhur me agjencinë "Kometa," ndër të cilët edhe Zoran Jovanovski, me nofkën Buçuk.[443] Më 25 dhe 26 korrik 2001, policia iu dha armë punonjësve të agjencisë, duke përfshirë armë automatike, si dhe uniforma kamuflimi me emblemën e policisë në mëngë.[444]

108. Dëshmitë përcaktojnë se mbrëmjen e 10 gushtit 2001,[445] diku pas orës 17:00, u zhvillua një takim në postkomandën e Batalionit të Tretë Gardist në ndërtesën e shkollës në Lubancë.[446] Në takim morën pjesë përfaqësuesit kryesorë vendorë të ushtrisë dhe policisë (Ministrisë së Brendshme). Ndër të pranishmit në takim ishin gjithashtu Johan Tarçulovski, majori Despodov, shefi i OVR-së së Çairit, Lube Kërstevski, Sllavko Ivanovski, komandant i stacionit policor të Mirkovcit, dhe Borce Pesevski, shefi i sektorit të analizës së OVR-së së Çairit.[447] Shefi i OVR-së së Çairit kishte diskutuar me Petre

441 M052, T 8259-8262.

442 M084, T 1470; Prova materiale P231. Dëshmitari tha se xhaketat dhe radiot u shpërndanë një ditë më vonë, më 11 gusht 2001; M084, T 1468. Mirëpo shënimi në ditar për këtë ngjarje është vendosur para fillimit të shënimeve për 11 gushtin 2001, gjë që sugjeron se ngjarja ndodhi më 10 gusht; Prova materiale P231. Për më tepër, një person prania e të cilit, siç duket, u vu re në atë rast (M084, T 1466) mohoi se kishte takuar Johan Tarçulovskin më 11 gusht 2001; M052, T 8327.

443 Një dëshmitar pa Zoran Jovanovskin, të ashtuquajtur Buçuk, në oborrin e stacionit policor të Çairit. Në atë kohë dëshmitari e njihte atë me emrin Buçuk, por jo me emrin e tij të vërtetë. Një koleg i tha dëshmitarit se Buçuku ishte kriminel. Dëshmitari i tha gjithashtu se Buçuku ishte pronar i agjencisë së sigurimit "Kometa"; M052, T 8258. Gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, dëshmitari pranoi se mund të ishte keqinformuar për identitetin e personit që ai besonte se ishte Buçuku dhe se, për këtë arsye, ai nuk mund të garantonte saktësinë e këtij identifikimi; M052, T 8563-8564. Mirëpo, duke marrë parasysh dëshmitë e tjera për përfshirjen e Buçukut në ngjarjet në Luboten, gjë që do të diskutohet, ka pak të ngjarë që dëshmtari të ketë parë një Buçuk tjetër, apo që personi që ai pa, të jetë identifikuar gabimisht si Buçuku. Pavarësisht nga emri i personit që pa dëshmitari, Dhoma Gjyqësore është bindur se dëshmitari pa pronarin e agjencisë së sigurimit "Kometa." Siç do të diskutohet, Zoran Jovanovski, i ashtuquajtur Buçuk, ishte pronari i "Kometës"; *shih më poshtë, para.* 497. Midis personave që erdhën në OVR-në e Çairit atë ditë, ishte vëllai më i madh i vëllezërve Janevski, i ashtuquajtur Kunta, i cili punonte gjithashtu për "Kometën"; T 3632; M052, T 8261-8262; M053, T 1910. Siç u tha më sipër, po atë ditë në Çair erdhi edhe një punonjës tjetër i "Kometës," Goçe Ralevski.

444 Më 25 korrik 2001, atyre iu dhanë armë dhe pajisje në PSOLO, *dmth.* në stacionin policor për sigurinë e jashtme fizike të ndërtesave; Miodrag Stojanovski, T 6778-6779; 6791-6792; 6814; Prova materiale P436. Midis, të tjerëve, Zoran Jovanovski, Vlado Janev, Aleksandar Janevski and Trajce Kuzmanovski, u pajisën atë ditë me armë dhe uniforma kamuflimi; Miodrag Stojanovski, T 6794-6795; Prova materiale P436.

445 Një dëshmitar tha se ky takim u zhvillua më 11 gusht 2001; M084, T 1477. Mirëpo dëshmitë përputhëse të dëshmitarëve të tjerë si dhe dokumentat, që Dhoma Gjyqësore i pranon, tregojnë se takimi u zhvillua më 10 gusht 2001; M052, T 8264; Mitre Despodov, T 2555; Petre Stojanovski, T 9151-9152; Provat materiale P302, f. 14; P303.

446 M052, T 8264; M084, T 1477; Mitre Despodov, T 2555; Prova materiale P303.

447 Mitre Despodov, T 2555; 2649; M052, T 8264-8265; M084, T 1478; Prova materiale P302, f. 14.

Stojanovskin e SVR-së së Shkupit nëse duhej të merrte pjesë në takim, dhe Stojanovski kishte urdhëruar apo miratuar pjesëmarrjen e Kërstevskit.[448]

109. Mbi bazën e informacioneve të marra nga oficerët në postkomandën e Batalionit të Tretë Gardist, një dëshmitar mbajti shënime se çfarë kishte ndodhur në këtë takim.[449] Dy ditë pas takimit, mbi bazën e këtyre shënimeve u përpilua një raport. Raporti iu paraqit Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë maqedonase.[450] Si shënimet ashtu dhe raporti janë pranuar si prova. Dallimet midis tyre janë të vogla. Në to thuhet se një grup prej 60-70 vetësh të veshur me uniforma policie kishte ardhur në Lubancë mbrëmjen e 10 gushtit 2001. Në shënime thuhet se ky grup i veshur me uniforma policie, fillimisht shkoi në shtëpinë e Johan Tarçulovskit në Lubancë.[451] Raporti nuk e përmend shtëpinë e Johan Tarçulovskit, por thekson se grupi udhëhiqej nga Johan Tarçulovski.[452] Sipas të dy dokumentave, aty mbërriti edhe një kamion i Ministrisë së Brendshme (policisë) i ngarkuar me "bomba," armë dhe municione, të cilat iu shpërndanë grupit. Në to pohohet gjithashtu se anëtarët e grupit i thanë majorit Despodov se ishin urdhëruar të qëndronin atë natë në shtëpinë e pushimit në Lubancë dhe të "pastronin Lubotenin nga terroristët," dhe se majori e miratoi vendosjen e tyre në këtë ndërtesë.[453] Shënimet dhe raporti thonë se majori Despodov u informua nga oficerët e Ministrisë së Brendshme se Presidenti kishte dijeni për qëndrimin e tyre në Lubancë dhe se askush tjetër nuk duhej t'a dinte këtë.[454] Një rrëfim i ngjashëm i ngjarjeve atë mbrëmje jepet edhe në një raport të përgatitur nga Koloneli Kopaçev,[455] i cili shkruan gjithashtu se, në bazë të një urdhri të marrë nga Presidenti, operacioni në Luboten do të fillonte në orën 04:30 të ditës së nesërme.[456]

110. Mirëpo gjatë dëshmisë së tij, majori Despodov e kundërshtoi versionin e ngjarjeve të përshkruara në shënimet dhe në raport.[457] Ai tha se nuk kishte parë dhe, as nuk kishte

448 M052, T 8262-8264; 8459; Petre Stojanovski, T 9152; 9337.
449 M051, T 4119-4121.
450 M051, T 4126-4127; 4193.
451 Prova materiale P302.
452 Prova materiale P303.
453 Provat materiale P302; P303.
454 Provat materiale P302; P303.
455 Prova materiale P304.
456 Prova materiale P304.
457 Mitre Despodov, T 2573.

dëgjuar kurrë për ardhjen e një grupi prej 60-70 vetësh, mohoi që dikush t'i ketë kërkuar strehim për ndonjë polic,[458] dhe tha se nuk kishte parë ndonjë kamion të Ministrisë së Brendshme në Lubancë.[459] Meqë majori Despodov ishte komandant i të gjitha njësive ushtarake të dislokuara në zonën e Lubancit, është tërësisht e pamundshme që ai të mos ketë patur dijeni për mbërritjen e një grupi kaq të madh personash në zonën e përgjegjësisë së tij, pra, në postkomandën e tij, dhe po kështu për armatimet dhe operacionin e propozuar. Pasi shqyrtoi me kujdes dëshminë e tij për këto aspekte, mënyrën e dhënies së dëshmisë prej tij dhe dëshmi të tjera, natyrën dhe përmbajtjen e shënimeve dhe raporteve të kohës, çështjet e diskutuara në paragrafët e mëposhtëm dhe interesin shumë të qartë dhe të fortë të majorit Despodov për t'u distancuar nga veprimet e të Akuzuarit Johan Tarçulovski dhe të këtij grupi personash me uniforma policie lidhur me ngjarjet në Luboten më 12 gusht 2001, Dhoma Gjyqësore është plotësisht e bindur se shënimet dhe raportet ushtarake të asaj kohe janë më të pranueshme se sa dëshmia e majorit Despodov lidhur me këto çështje. Rrjedhimisht ky është edhe konkluzioni i Dhomës. Aspekte të përshkrimit të bërë në shënimet dhe raportet ushtarake konfirmohen gjithashtu nga dëshmitë e dhëna nga kapiteni Grozdanovski dhe M084, të cilët panë rezervistë të policisë në oborrin e shkollës në Lubancë më 10 gusht dhe, më vonë atë mbrëmje, në shtëpinë e pushimit të fëmijëve.[460]

111. Gjithsesi, në dëshminë e tij majori Despodov pranoi se atë natë në Lubancë ishte zhvilluar një mbledhje, në të cilën pjesëmarrësit diskutuan për praninë e "terroristëve" në Luboten dhe mënyrën e kapjes së tyre.[461] Dëshmi të tjera tregojnë se Lube Kërstevskit iu kërkua të përforconte postblloqet në zonën e Lubotenit.[462] Majori Despodov dëshmoi gjithashtu se një person nga Ministria e Brendshme (policia), emri e të cilit, siç pretendoi nuk i kujtohej, deklaroi në mbledhje se policia do të ndërmerrte një operacion për të hyrë në fshat.[463] Majori Despodov dëshmoi se një person nga ministria pyeti nëse Despodovi

458 Mitre Despodov, T 2578.
459 Mitre Despodov, T 2654.
460 Nikollçe Grozdanovski, T 10479-10480; M084, T 1478-1479. M084 dëshnoi se ai shkoi në shtëpinë e pushimit të fëmijëve atë ditë kur u zhvillua takimi në shkollën në Lubancë. Siç u theksua më sipër, M084 e ngatërroi 10 gushtin 2001 me 11 gushtin; *shih më sipër,* poshtëshënimi 445. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore pranon se rrëfimi i tij i ngjarjeve për natën e 11 gushtit, në fakt, i referohet datës 10 gusht.
461 Mitre Despodov, T 2562; M052, T 8266; 8553-8554.
462 M052, T 8266.
463 Mitre Despodov, T 2562.

kishte marrë urdhra nga eprorët e tij lidhur me operacionin.[464] Sipas dëshmisë së majorit Despodov, ai u përgjigj se nuk kishte marrë ndonjë urdhër të tillë dhe se ai mund të merrte pjesë në operacion vetëm nëqoftëse do t'i jepej urdhër.[465] Një rrëfim tjetër i mbledhjes tregon se Johan Tarçulovski kërkoi mbështetje me mortaja nga majori Despodov,[466] i cili iu përgjigj se ai nuk mund të hapte zjarr pa marrë urdhër me shkrim. Johan Tarçulovski ia ktheu: "Dakord, do t'a marrësh një urdhër të tillë."[467]

112. Në raportin e mbledhjes paraqitur Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, shënohet se në mbledhje u shpjegua se Ministria e Brendshme do të jepte armë dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e operacionit në Luboten. Nga raporti del se armët do t'i jepeshin grupit prej 60-70 personash me uniforma policie, të cilët kishin mbërritur atë mbrëmje në shkollë së bashku me Johan Tarçulovskin.[468] Përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme i thanë gjithashtu majorit Despodov se do të merrte urdhra me telefon nga Presidenti i IRJM-së.[469] Kjo gjithashtu u mohua nga majori Despodov, i cili në dëshminë e tij tha se "një gjë e tillë nuk u diskutua."[470] Në raport thuhet edhe se grupi prej 60-70 personash ishte pajisur me armë që përpara mbledhjes.[471] Ndonëse raporti mund të mos jetë shumë i qartë lidhur me armët, duke marrë parasysh dëshmitë e tjera të dhëna për këtë çështje, Dhoma Gjyqësore konkludon se grupi prej 60-70 vetësh, i udhëhequr nga Johan Tarçulovski, do të pajisjej me armët dhe pajisjet e nevojshme nga policia dhe se kjo ishte bërë që përpara mbledhjes.

113. Mbi bazën e këtyre provave dhe provave të tjera të përmendura për aspekte të tjera të këtij Aktgjykimi, Dhoma Gjyqësore konkludon se i Akuzuari Johan Tarçulovski, me dijeninë e të paktën disa oficerëve të lartë të policisë (Ministrisë së Brendshme), do të udhëhiqte një grup prej 60-70 personash,[472] të cilët ishin grumbulluar pasditen e 10 gushtit 2001 dhe ishin pajisur me uniforma policie. Ky grup përfshinte gjithashtu, të

464 Mitre Despodov, T 2556.
465 Mitre Despodov, T 2574.
466 M052, T 8267.
467 M052, T 8267.
468 "… armë dhe pajisje për personat e lartpërmendur …." Më sipër në këtë raport, grupi prej 60-70 personash të veshur me uniforma të Ministrisë së Brendshme. Prova materiale P303.
469 Prova materiale P303.
470 Mitre Despodov, T 2578.
471 Prova materiale P303.
472 Ka dëshmi se ditën e nesërme mund të kenë ardhur persona të tjerë; *shih më poshtë, para.* 117.

paktën pjesërisht, persona që ishin të punësuar në agjencinë e sigurimit “Kometa.” Ky grup ishte ngarkuar të ndërmerrte një operacion sekret, qëllimi i të cilit, sipas përshkrimit ishte spastrimi i fshatit Luboten nga terroristët. Grupi u armatos me armë, duke përfshirë lëndë shpërthyese, nga policia, e cila gjithashtu vuri në dispozicion jelekë antiplumb, radio, si dhe transport, për armët dhe njerëzit, nga OVR-ja e Çairit për në Lubancë si dhe për në shtëpinë e pushimit të fëmijëve jashtë Lubancës që përdorej nga ushtria, vonë në mbrëmjen e 10 gushtit 2001. Policia do të përforconte gjithashtu pozicionet e veta në postblloqet në afërsi të Lubotenit. Të paktën një pjesë e grupit prej 60-70 vetësh u strehua nga ushtria në shtëpinë e pushimit të fëmijëve jashtë Lubancës. Ushtrisë iu kërkua gjithashtu të siguronte mbështetje me zjarr gjatë operacionit nga pozicionet e saj në kodrat në afërsi të Lubotenit. Mbrëmjen e 10 gushtit 2001, në një shkollë në Lubancë e cila në atë kohë përdorej nga ushtria, u zhvillua një mbledhje e përbashkët planifikuese. Midis të pranishmëve ishin Johan Tarçulovski, Lube Kërstevski, shefi i OVR-së së Çairit, si dhe majori Despodov i ushtrisë. Fillimisht u planifikua që operacioni të kryhej mëngjesin e 11 gushtit 2001, por, siç do të diskutohet më vonë, ai u shty për më 12 gusht 2001.

114. Siç do të diskutohet hollësisht më poshtë, ekzistojnë dëshmi se në atë kohë Johan Tarçulovski dhe të tjerët thanë se operacioni u ndërmor me dijeninë dhe mbështetjen, apo me urdhrin e Presidentit të atëhershëm të IRJM-së, Boris Trajkovski. Ndërkohë ai ka vdekur. Kjo përputhet me çka ndodhi, si dhe me pjesëmarrjen e Johan Tarçulovskit, i cili në atë kohë shërbente në ekipin e sigurimit të Presidentit, dhe duke marrë parasysh pozitën e tij hierarkike dhe detyrat e tij të zakonshme në Ministrinë e Brendshme, normalisht nuk duhej të ishte zgjedhur për udhëheqjen e një operacioni të kësaj natyre. Nga ana tjetër, nuk ka konfirmim të drejtëpërdrejtë, të besueshëm, dhe të pavarur për rolin e Presidentit. Dëshmitë për këtë rol janë nga dëshmitarë që nuk janë të besueshëm në çështje të tjera dhe gjithashtu shumë përfaqësuesve të policisë dhe ushtrisë mund t'u vijë për mbarë të thonë se operacioni u urdhërua nga Presidenti, nisur prej faktit se Presidenti ka vdekur. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore tërhiqet prej nxjerrjes së përfundimit se operacioni në Luboten u urdhërua nga Presidenti. Gjithsesi, ajo pranon se këto prova tregojnë se mund të ketë ndodhur pikërisht kështu. Edhe sikur operacioni policor në Luboten, më 12 gusht 2001, të jetë urdhëruar nga Presidenti, kjo nuk

përjashton domosdoshmërisht faktin që i Akuzuari Lube Boshkoski të ketë luajtur një rol të drejtpërdrejtë në drejtimin e operacionit, apo të ketë patur dijeni për të që përpara 12 gushtit. Mirëpo ekziston mundësia që planifikimi dhe organizimi i operacionit të jenë bërë pa përfshirjen apo pa dijeninë e Lube Boshkoskit. Ai mund të jetë anashkaluar

115. Ekzistojnë dëshmi bindëse për Dhomën Gjyqësore se persona në poste të larta në forcat policore (Ministrinë e Brendshme) kishin dijeni për operacionin e propozuar dhe u angazhuan aktivisht në mbështetjen e tij. Mirëpo këto dëshmi nuk janë të mjaftueshme për nxjerrjen e përfundimeve nëse kjo dijeni dhe përfshirje ishin shtrirë në nivelet më të larta të hierarkisë policore apo në kreun ministror të forcave policore, Ministrin e Brendshëm, i cili në atë kohë ishte i Akuzuari Lube Boshkoski. Ka dëshmi të cilat mund të sugjerojnë një gjë të tillë, por ato nuk janë të qarta apo bindëse për të arritur në përfundimin se Lube Boshkoski kishte dijeni.

D. Ngjarjet e 11 gushtit 2001

116. Më 11 gusht 2001, në fshatin Luboten u dëgjuan të shtëna sporadike me armë të vogla.[473] Disa dëshmi sugjerojnë se atë ditë në fshat pati dy shpërthime mortajash.[474] Më 11 gusht 2001, rreth orës 09:00, policia vuri re të shtëna me armë këmbësorie nga ushtria maqedonase drejt fshatit Luboten. Të shtënat vinin nga drejtimi i shtëpisë së pushimit të fëmijëve pranë Lubancës.[475]

117. Më 11 gusht 2001, në stacionin policor të Çairit u shpërndanë armë edhe për dy grupe të tjera burrash. Në orët e mëngjesit të asaj dite u pajis me armë një grup prej 20 deri 30 vullnetarësh nga Lubanca.[476] Anëtarët e këtij grupi kishin qenë në stacionin policor një ditë më parë,[477] por jo të gjithë morën armë atë ditë.[478] Një grup tjetër ishte

473 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 26; M039, Prova materiale P200.1, f. 4; M088, Prova materiale P206, para. 13; Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1 para. 5; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 6; Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 10.

474 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 26; *shih* gjithashtu M092, Prova materiale P215, para. 10.

475 Provat materiale P42; P159; M037, T 770-771.

476 M053, T 1889; 1892-1894; 1975; Provat materiale P231; P251.

477 M053, T 1890-1891; M084, T 1461; M052, T 8564-8565.

478 Ndërsa M053 dëshmoi se këtyre personave nuk iu shpërndanë armë atë ditë, (M053, T 1890-1891) dëshmi të tjera tregojnë, dhe Dhoma Gjyqësore pranon, se disa prej tyre u pajisën me armë; M052, T 8560. U bënë verifikime për të përcaktuar nëse vullnetarët që kërkonin armë kishin precedentë penalë dhe ata që nuk kishin precedent të tillë dhe kishin pamjen e duhura fizike, u pajisën me armë; M084, T 1461-1462; 1465; Prova materiale P231; M052, T 8273; 8480-8481; 8484.

pajisur me armë mbrëmjen e 11 gushtit. Ky ishte një grup i përbërë nga nëntë,[479] apo ndoshta 12 deri 13 vetë,[480] të armatosur dhe të veshur me uniforma kamuflimi. Edhe ata u pajisën me automatikë AK-47, "Kallashnikovë."[481] Sipas dëshmive, disa nga anëtarët e të dy grupeve që u pajisën me armë më 11 gusht 2001, kishin qenë të dënuar për vepra penale.[482] Ekzistojnë dëshmi se anëtarëve të grupit të dytë, të cilët erdhën në mbrëmje, armët iu shpërndanë në bazë të një urdhri gojor që Lube Kërstevski e mori nga Goran Mitevski, drejtor i zyrës së sigurisë publike, apo nga Petre Stojanovski.[483] Mirëpo dëshmitë në lidhje me këtë aspekt në disponim të Dhomës Gjyqësore ishin kundërthënëse.[484] Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të arrijë në ndonjë përfundim pasi dëshmitë lidhur me këtë çështje duket se janë të ndikuara nga dëshira e dëshmitarëve për t'u distancuar nga ngjarja si dhe për të shmangur përgjegjësinë për shpërndarjen e armëve në kundërshtim me procedurat ekzistuese.

118. Më 12 gusht 2001, pas operacionit policor, anëtarë të grupit të parë të pajisur me armë gjatë mëngjesit të 11 gushtit, u panë te shtëpia e Bracës.[485] Siç u tha më sipër, më 12 gusht 2001, persona të identifikuar si anëtarë të grupit të dytë dhe të pajisur me armë mbrëmjen e 11 gushtit, u panë më 12 gusht duke u kthyer nga fshati Luboten pas operacionit policor.[486]

119. Një grup tjetër njerëzish arriti në stacionin policor të Çairit më 11 gusht. Pas orës 19:00, në stacionin policor erdhën Zoran Jovanovski, me nofkën Buçuk, si dhe 20 - 30 persona nga agjencia e sigurimit "Kometa". Ata ishin të veshur me uniforma kamuflimi dhe kishin armë automatike.[487] Uniformat e tyre kishin emblemën e policisë.[488] Dëshmitë nuk zbuluan qëllimin e vizitës së tyre në stacionin policor të Çairit.

---

479 Prova materiale P232.
480 M084, T 1472; 1475.
481 M084, T 1472-1475; Prova materiale P232; M053, T 1892; 1983; 1900-1905; Prova materiale P251; M052, T 8481; 8484.
482 M084, T 1475-1476; Prova materiale P592. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar gjithashtu dëshmi se provat e precedentëve penalë të disa prej këtyre personave, mund të jenë fshirë; Prova materiale 1D329.
483 M052, T 8272-8274; 8251; 8323; 8479-8482; M053, T 1895; Prova materiale P536. Dëshmitë sugjerojnë se Petre Stojanovski i tha shefit të OVR-së së Çairit që të zbatonte urdhrin, siç pretendohet, për t'u shpërndarë armë njerëzve që kishin ardhur, megjithëse, siç dukej, dihej se disa prej këtyre njerëzve kishin precedent penal. M052, T 8272-8274.
484 Petre Stojanovski, T 9297.
485 M053, T 1911-1912; 1986.
486 M052, T 8274.
487 M053, T 1903-1904; Prova materiale P251.

120. Në këtë moment është e volitshme të theksohet se pikërisht mbi bazën e dëshmive të ndryshme për grupet e njerëzve të përbëra ndoshta nga 60-70, 20-30 dhe 9-13, që u grumbulluan në stacionin policor të Çairit në kohë dhe rrethana të ndryshme më 10 dhe 11 gusht, si dhe këtij grupi të tretë të përbërë nga 20-30 persona më 11 gusht, të cilët mund të kishin qenë edhe në grupet e mërparshme, si dhe në kushtet e mungesës së dëshmive më konkrete, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se njësia policore që hyri në Luboten mëngjesin e 12 gushtit 2001, përbëhej së paku nga 60-70 individë dhe ndoshta mund të ketë patur mbi 100 vetë.

121. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar gjithashtu dëshminë me gjasë shumë të rëndësishme prej M052, se në orët e mëngjesit të 11 gushtit 2001, shefi i OVR-së së Çairit, Lube Kërstevski, u thirr të paraqitej në zyrën e gjeneral Sokol Mitrovskit, komandant i Komandës së Mbrojtjes së Shkupit, në kazermat ushtarake të vendbanimit Aerodrom.[489] Sipas kësaj dëshmie, gjeneral Mitrovski ishte i pikëlluar nga humbja e ushtarëve në incidentin e minës tokësore në Stanet e Lubotenit.[490] Ai tha se ushtria do të ndërmerrte veprime luftarake kundër UÇK-së.[491] Majori Despodov do të ishte përgjegjës për veprimet luftarake në zonën e Lubancës.[492] Gjeneral Mitrovski tha se personi që do të udhëhiqte veprimet luftarake të forcave maqedonase të sigurimit do të ishte Johan Tarçulovski. "Ai ishte bosi i tyre."[493] Gjeneral Mitrovski tha se Lube Kërstevski do të merrte detyra nga Lupço Bliznakovski /Ljupčo Bliznakovski/, zëvendësshefi i SVR-së së Shkupit,[494] i cili ishte i pranishëm në takim.[495] Bliznakovski i kërkoi Lube Kërstevskit të përforconte postblloqet në zonën e Lubotenit.[496]

122. Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të pranojë vërtetësinë e kësaj dëshmie dhe as të nxjerrë përfundime bazuar mbi të. Dëshmitari i krijoi Dhomës Gjyqësore

---

488 M053, T 1993.
489 M052, T 8270-8271.
490 M052, T 8312-8313.
491 M052, T 8271.
492 M052, T 8312-8313.
493 M052, T 8271.
494 *Shih më poshtë,* para. 483.
495 M052, T 8271.
496 M052, T 8271. Në atë kohë u dhanë një numër urdhrash lidhur me dislokimin e policëve në postblloqet në zonën e Lubotenit. Në fundjavën e 10-12 gushtit 2001 u vu re një rritje e numrit të policëve të stacionuar në postbllokun e Buzallakut. Më 10 dhe 11 gusht, u dislokuan 9 policë; Provat materiale P544; P491. Më 12 gusht, numri i policëve u rrit në 11; Prova materiale P492. Numri në postbllokun në Murin Kinez ishte shumë më i lartë se më 12 gusht. (15 policë, M052, T 8280) Mirëpo në postblloqe të tjera duket se nuk ka patur rritje të numrit; Provat materiale P546; P538; P545; P547; 1D283; 1D284.

përshtypjen e fortë dhe të qartë se ai kërkonte të zmadhonte përgjegjësinë e ushtrisë për operacionin në Luboten. Kjo dëshmi mbart edhe një konflikt të brendshëm pasi, siç u tha, majori Despodov do të ishte përgjegjës për veprimet luftarake, kurse Johan Tarçulovski do të udhëhiqte veprimet luftarake. Për më tepër, aspekte të kësaj dëshmie bien ndesh me një raport të përgatitur nga koloneli Kopaçev, ku bëhet e ditur se më 12 gusht 2001, gjenerali Sokol Mitrovski i krijoi përshtypjen kolonelit Kopaçev se nuk kishte dijeni për operacionin që po zhvillohej në Luboten.[497]

123. Më 11 gusht 2001, u zhvillua varrimi i ushtarëve të vrarë një ditë më parë në incidentin me minë në Stanet e Lubotenit. Në varrim ishin të pranishëm disa mijëra vetë jo vetëm nga Lubanca, por edhe nga një rrethinë më e gjerë e Shkupit. Njerëzit që morën pjesë në varrim ishin shumë të revoltuar.[498]

124. Ekziston një raport ushtarak, sipas të cilit pasditen e 11 gushtit 2001, një grup i udhëhequr nga Johan Tarçulovski kreu një mision zbulimi në fshatin Luboten.[499] Sipas një rrëfimi tjetër të ngjarjeve atë ditë, rreth orës 17:00-17:30, ushtria maqedonase hapi zjarr,[500] gjë që bie ndesh me një raport të ushtrisë sipas të cilit ishte grupi i udhëhequr nga Johan Tarçulovski që hapi zjarr me granathedhësa dore "Zolja", nga ora 17:30 deri 18:00.[501] Gjithashtu në raportet ushtarake thuhet se në këtë rast Johan Tarçulovski kërkoi prej majorit Despodov mbështetje me zjarr mortajash për veprimet luftarake të grupit të Tarçulovskit.[502] Mirëpo përsëri majori Despodov mohoi shprehimisht marrjen e një kërkese të tillë nga Johan Tarçulovski atë ditë.[503] Lidhur me këto raporte kontradiktore Dhoma Gjyqësore thekson se banorët e Lubotenit nuk përjetuan të shtëna të dendura pasditen e asaj dite.[504] Dhoma Gjyqësore pranon se në orët e pasdites së 11 gushtit 2001, Johan Tarçulovski me policë nga grupi kryen një mision zbulimi në fshatin Luboten, por se në këtë rast nuk pati mbështetje me zjarr armësh nga ushtria.

---

497 Prova materiale P304, f. 2.
498 Mitre Despodov, T 2648.
499 Prova materiale P303.
500 Prova materiale P302.
501 Prova materiale P304, f. 1.
502 Provat materiale P303; P304.
503 Mitre Despodov, T 2588.
504 Osman Ramadani, Prova materiale P197, para. 26; M039, Prova materiale P200.1, f. 4; M088, Prova materiale P206, para. 13; Mamut Ismaili, Prova materiale P219.1 para. 5; Qemuran Rexhepi, Prova materiale P372, para. 6; Fatmir Kamberi, Prova materiale P426, para. 10.

125. Më 11 gusht 2001, rreth orës 17:00 apo 18:00, Johan Tarçulovski u kthye në postkomandën e Batalionit të Tretë Gardist në Lubancë.[505] Sipas dëshmisë së majorit Despodov, ai informoi Johan Tarçulovskin se nuk kishte marrë ndonjë urdhër lidhur me operacionin e planifikuar dhe se ai ishte i vendosur të mos ndërmerrte ndonjë veprim pa një urdhër të tillë, me përjashtim të rastit të mbrojtjes nga një sulm i drejtpërdrejtë.[506] Majori Despodov dëshmoi se Johan Tarçulovski u zemërua dhe i tha Despodovit se operacioni do të kryhej, me apo pa ndihmën e trupave të Despodovit.[507]

126. Majori Despodov tha më tej se në një moment Johan Tarçulovski foli në telefon dhe pastaj ia kaloi telefonin Despodovit, duke thënë se Presidenti donte të fliste me të.[508] Majori Despodov tha se kjo ndodhi më 10 gusht 2001.[509] Mirëpo të gjitha dëshmitë e tjera lidhur me këtë ngjarje tregojnë se kjo ndodhi më 11 gusht 2001, dhe ky është edhe përfundimi i Dhomës Gjyqësore.[510] Zllatko Keskovski dëshmoi se më 11 gusht 2001, rreth orës 17:00 apo 18:00, atij i telefonoi Johan Tarçulovski. Në atë kohë Presidenti Trajkovski ishte në shtëpinë e Zllatko Keskovskit. Johan Tarçulovski i tha Keskovskit se po bëheshin përgatitje për një operacion dhe se një major i ushtrisë refuzonte të bashkëpunonte me pjesëtarët e tjerë të forcave të sigurisë.[511] Johan Tarçulovski kërkoi të fliste me Presidentin. Gjatë bisedës Presidenti i kërkoi Tarçulovskit t'a vendoste në kontakt me majorin. Më pas Presidenti foli me majorin Despodov.[512] Raportet ushtarake japin përshkrime të ngjashme të ngjarjes.[513]

127. Majori Despodov dëshmoi se Presidenti e pyeti nëse ai ishte nën komandën e gjeneralit Sokol Mitrovski dhe, pasi mori përgjigje pozitive për këtë, i tha Despodovit se do të fliste me gjeneralin dhe se më pas do t'i telefononte sërish majorit Despodov.[514] Presidenti tha gjithashtu se përfaqësuesit e policisë, të cilët ishin dërguar më parë në postkomandën e majorit, "e dinin çfarë duhej të bënin."[515] Majori Despodov tha se kishte

505 Mitre Despodov, T 2559-2560.
506 Mitre Despodov, T 2566-2568.
507 Mitre Despodov, T 2566-2568.
508 Mitre Despodov, T 2650-2651.
509 Mitre Despodov, T 2580-2581; 2650.
510 Provat materiale P302; P303; P304; Zllatko Keskovski, T 10014.
511 Zllatko Keskovski, T 10004-10005.
512 Zllatko Keskovski, T 10005-10007; 10139.
513 Provat materiale P303; P304.
514 Mitre Despodov, T 2581.
515 Mitre Despodov, T 2579.

marrë nga Presidenti "disa udhëzime" për "ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në bazë të kompetencave [të tij]."[516] Majori Despodov dëshmoi se kjo ishte e vetmja bisedë që pati me Presidentin në atë kohë.[517] Raportet ushtarake japin një version të ngjashëm të ngjarjes. Ato thonë se biseda e Presidentit me majorin Despodov u zhvillua dikur midis orës 18:00 dhe 19:00.[518]

128. Mirëpo dëshmia e Zllatko Keskovskit, në atë kohë shef i sektorit të sigurisë për Presidentin dhe epror i Johan Tarçulovskit,[519] shkon shumë më tej. Zllatko Keskovski dëshmoi se gjatë bisedës telefonike, Presidenti e urdhëroi majorin Despodov të mbështeste veprimet që forcat e sigurimit kishin planifikuar të ndërmerrnin në bazë të urdhrave të tij.[520] Gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, Zllatko Keskovski përmendi një "urdhër për të sulmuar Lubotenin."[521] Dëshmia e Zllatko Keskovskit ndryshon nga dëshmitë e tjera edhe në një aspekt tjetër, dhe pikërisht lidhur me arsyen që dha Presidenti për të kontaktuar gjeneral Sokol Mitrovskin. Zllatko Keskovski dëshmoi se Presidenti i tha majorit se do t'i telefononte gjeneral Mitrovskit për t'a informuar për urdhrin e lëshuar nga Presidenti.[522] Sipas dëshmisë së majorit Despodov, pasi të kishte folur me gjeneralin, Presidenti do t'a informonte majorin Despodov për rezultatin e bisedës si dhe për përgjegjësitë e sakta që do të kishte ai gjatë operacionit. Dhoma Gjyqësore thekson gjithashtu dëshmitë që tregojnë se të nesërmen, majori Despodov e pyeti kolonelin Kopaçev nëse gjeneral Mitrovski kishte lëshuar ndonjë urdhër.[523]

129. Në një raport paraqitur gjeneral Sokol Mitrovskit jepet një version tjetër për masat e marra për operacionin në Luboten. Raporti bën të ditur se majori Despodov kishte dijeni për operacionin që më 10 gusht 2001 dhe në fakt e planifikoi atë së bashku me Johan Tarçulovskin. Sipas raportit, majori Despodov nuk njoftoi askënd për operacionin e planifikuar dhe, si shpërblim, ai mori garanci nga Johan Tarçulovski se me ndihmën e Presidentit ai do të çlirohej prej përgjegjësisë.[524] Dëshmia nuk e tregon burimin e këtij

[516] Mitre Despodov, T 2580.
[517] Mitre Despodov, T 2582.
[518] Provat materiale P303; P304.
[519] *Shih më poshtë, para.* 537.
[520] Zllatko Keskovski, T 10006-10007, 10139.
[521] Zllatko Keskovski, T 10170.
[522] Zllatko Keskovski, T 10006-10007, 10139.
[523] Provat materiale P303; 304.
[524] Prova materiale P304, f. 3.

informacioni. Raporti duket se është i bazuar në informacione të dhëna nga vartësit e kolonel Kopaçevit. Një raport tjetër i përgatitur në atë kohë nga Brigada e Parë Gardiste, nuk përmend ndonjë garanci të dhënë për lirimin nga çdo përgjegjësi. Raporti i paraqitur nga koloneli Kopaçev mund të jetë ndikuar nga dëshira e tij për të fshehur masën e implikimit të ushtrisë në nivele të ndryshme. Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të pranojë se majorit Despodov iu ofruan garanci për lirimin nga çdo përgjegjësi.

130. Dhoma Gjyqësore thekson se nuk duket të jetë në interes të majorit Despodov që të fshehë ndonjë urdhër të lëshuar nga Presidenti. Nëqoftëse do të kishte patur një urdhër të tillë, Despodovi do të dëshmonte për të, pasi një urdhër i tillë mund të minimizonte përgjegjësinë e tij për ngjarjet në Luboten. Përsëri Dhoma Gjyqësore ballafaqohet me dëshmi materialisht kontradiktore të zyrtarëve të IRJM-së. Për arsyet e dhëna më sipër, Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të pranojë si të vërteta disa aspekte të dëshmisë së majorit Despodov, që duket se është ndikuar nga shqetësimi për të mbrojtur pozitën e vet. Në rastin e Zllatko Keskovskit, duke u nisur nga përmbajtja e dëshmisë së tij dhe sjellja e dëshmitarit, Dhoma Gjyqësore druan se kjo dëshmi u ndikua nga dëshira për të ndihmuar të Akuzuarin Tarçulovski nëpërmjet sugjerimit se ai veproi në bazë të një urdhri të drejtpërdrejtë nga Presidenti, i cili në atë kohë ishte Kryekomandanti i Forcave të Sigurisë. Ndërkohë Presidenti ka vdekur. Nuk ka dëshmi të besueshme dhe të pavarura që do ta ndihmonin Dhomën Gjyqësore. Pas një shqyrtimi të plotë të dëshmive, Dhoma Gjyqësore pranon se në mbrëmjen e 11 gushtit 2001, Johan Tarçulovski e vuri majorin Despodov në kontakt telefonik me Presidentin e IRJM-së. Dhoma Gjyqësore nuk pranon nga dëshmia e Zllatko Keskovskit se Presidenti i dha majorit Despodov një urdhër të drejtëpërdrejtë dhe absolut. Dhoma Gjyqësore pranon se majori Despodov ishte interesuar të nesërmen në mëngjes nëse kishte ardhur ndonjë urdhër konkret nga gjeneral Sokol Mitrovski, gjë që konfirmon se majori Despodov nuk mori ndonjë urdhër të drejtëpërdrejtë dhe absolut nga Presidenti mbrëmjen e mëparshme dhe se, siç duket, Despodovi kuptoi se ai duhej të mbështeste operacionin policor të udhëhequr nga Johan Tarçulovski, por vetëm brenda kompetencave të tij normale, me përjashtim të rastit të një urdhri konkret nga gjeneral Sokol Mitrovski, gjë që në fakt nuk ndodhi. Mirëpo ky udhëzim ose nxitje prej Presidentit, ishte i mjaftueshëm për majorin Despodov që të siguronte mbështetje me artileri në fillim të operacionit, megjithëse siç konkludon Dhoma

Gjyqësore në diskutimin e hollësishëm më poshtë, majori Despodov pretendoi se forcat e ushtrisë iu përgjigjën zjarrit duke goditur objektiva të diktuara të armikut në fshat dhe ai angazhoi njësitë e tij për vëzhgimin e veprimeve në fshat dhe rreth tij, për të parandaluar hyrjen e pjesëtarëve të UÇK-së në fshat apo ikjen e tyre nga fshati gjatë operacionit policor.

131. Gjithashtu është për t'u theksuar se raportet ushtarake informojnë edhe për një vizitë tjetër të përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme dhe Johan Tarçulovskit në postkomandën e Brigadës së tretë Gardiste. Është dokumentuar se më 11 gusht 2001, pas orës 22:00, ata vizituan majorin Despodov për marrjen e masave përfundimtare për operacionin. Johan Tarçulovski informoi se operacioni do të fillonte në orën 04:30 të ditës së nesërme. Sipas raporteve, majori Despodov përsëriti se atij duhej t'i vinin urdhrat përkatëse për të mbështetur operacionin dhe Johan Tarçulovski iu përgjigj se do t'i vinin urdhra nga Presidenti apo "personat rreth tij."[525]

E. A ishin ngjarjet në Luboten të përligjura prej domosdoshmërisë ushtarake?

132. Mbrojtja parashtron se individë nga Luboteni morën pjesë në vendosjen e minës tokësore që vrau tetë ushtarë maqedonas më 10 gusht, se në Luboten pati prani të UÇK-së në fundjavën e 10-12 gushtit,[526] dhe se Luboteni ishte përdorur nga UÇK-ja si bazë logjistike që nga shkurti i vitit 2001.[527] Argumentohet se forcat e sigurisë kishin arsye legjitime për të hyrë në fshat,[528] dhe se qëllimi i operacionit ishte gjetja e anëtarëve të UÇK-së në fshat për të parandaluar sulme të tjera.[529] Më tej parashtrohet se më 12 gusht UÇK kishte brenda Lubotenit disa pozicione nga të cilat u hap zjarr kundër ushtrisë dhe, në disa raste, policisë më 12 gusht 2001.[530] Mbrojtja mendon se Luboteni ishte një objektiv legjitim ushtarak,[531] se operacioni u përqëndrua në ato zona dhe shtëpi ku

525 Provat materiale P302, P303, P304.
526 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 271.
527 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 271, 283; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit para. 165.
528 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 174.
529 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 280, 283.
530 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 323; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 200-204.
531 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 191.

mendohej se ndodheshin anëtarë të UÇK-së,[532] dhe se qitja me armë kundër këtyre vendndodhjejeve u përligj prej domosdoshmërisë ushtarake.[533]

133. Prokuroria argumenton se Luboteni nuk ishte bastion i UÇK-së dhe se nuk përdorej si bazë logjistike e UÇK-së.[534] Argumentohet se megjithëse UÇK-ja mund të ketë gëzuar mbështetje në fshat, fshati nuk ishte "mbushur me luftëtarë të UÇK-së" më 12 gusht.[535] Në këtë kontekst, Dhoma Gjyqësore thekson gjithashtu pretendimin apo pranimin në Aktakuzë se më 12 gusht, në Luboten ishin të pranishëm rreth 10-15 "luftëtarë shqiptarë" të armatosur me armë automatike dhe të paktën një mitraloz.[536] Së fundi, Prokuroria parashtron se shkatërrimi që ndodhi në Luboten nuk përligjej prej domosdoshmërisë ushtarake.[537]

134. Dhoma Gjyqësore thekson se në mbështetje të pretendimeve të veta për anëtarësinë e personave konkretë në UÇK, për UÇK-në, dhe për mbështetjen logjistike, Mbrojtja shfrytëzoi gjerësisht dhe në disa raste ekskluzivisht, intervistat dhe raportet operative të degës së sigurimit dhe kundërzbulimit (UBK). Burimet e këtyre dokumentave janë anonime dhe përmbajtja e tyre është e paverifikuar. Disa intervista dhe raporte u hartuan disa muaj pas ngjarjeve në Luboten.[538] Në mungesë të konfirmimit të pavarur, Dhoma Gjyqësore nuk mund t'i shfrytëzojë këto dokumente në lidhje me vërtetësinë e përmbajtjes së tyre. Po kështu, duke marrë parasysh dëshmitë e kundërta, Dhoma Gjyqësore nuk mund t'u akordojë rëndësi të konsiderueshme dëshmive të banorëve të Lubotenit, të cilat janë të dyshimta pasi janë thuajse të njëjta në pretendimet e tyre se asnjë banor i Lubotenit nuk kishte marrë pjesë në incidentin me minën tokësore,[539] se asnjë nga fshatarët nuk ka qenë anëtar i UÇK-së,[540] se nuk ka patur prani të UÇK-së në

[532] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 284-285.
[533] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 323.
[534] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 158-159.
[535] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 159.
[536] Aktakuza, para. 68.
[537] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 80, 155, 157.
[538] Ndër të tjera, dhe veçanërisht, Provat Materiale 1D87; 1D165; 1D166; 1D167; 1D168; 1D223.1; 1D273.
[539] M012, T 936; Qemuran Rexhepi, T 3519-3520; Ismail Ramadani, T 1011; Vehbi Bajrami, T 1835; 1864.
[540] M012, T 942; 961-962; Aziz Rexhepi, T 4660-4665; Elmaz Jusufi, T 548-550; Fatmir Kamberi, T 4570-4574; 4577; 4620; Fatmir Kamberi, Prova Materiale P426, para. 5; Vehbi Bajrami, T 1847-1848; 1864; Sedat Murati, T 4080-4083; 4109; M017, T 706-708; Ismail Ramadani, T 1009-1010; Osman Ramadani, T 1092-1095; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 20.

Luboten në fundjavën e 10-12 gushtit,[541] dhe se nuk ka ekzistuar asnjë formë e mbështetjes logjistike për UÇK-në në Luboten.[542] Në këto rrethana, e vetëdijshme se një burim i besueshëm nuk është *ipso facto* burim i saktë, Dhoma Gjyqësore është ndihmuar në shumë nga këto çështje nga dëshmitë e dhëna nga burime më asnjanëse. Mirëpo në lidhje me këto burime, Dhoma Gjyqësore duhet të theksojë se e ka analizuar me kujdes dëshminë e dhënë nga Peter Bouckaert, hulumtues me përvojë i Human Rights Watch ("HRW"). Ai kreu vëzhgime në fshat 11 ditë pas ngjarjeve. Gjithashtu raporti i HRW-së për ngjarjet në Luboten,[543] i cili u përpilua kryesisht prej tij dhe që përbën thelbin e dëshmisë së tij, mbështetet kryesisht në rrëfimet e paverifikuara të banorëve shqiptarë etnikë të Lubotenit, të cilat nuk janë verifikuar përkundrejt rrëfimeve të tjera që ndryshonin, të dëgjuara nga Dhoma Gjyqësore.[544]

135. Është për t'u vënë gjithashtu në dukje se në dëshmitë lidhur me praninë e UÇK-së në Luboten dhe çështjen nëse Luboteni ishte bazë logjistike, shpesh përmenden fjalë si "terroristë," grupe të armatosura, ose persona të veshur me rroba të zeza, por të pashoqëruara prej shkurtesës "UÇK."[545] Në shumë raste, kjo është thjesht çështje terminologjie dhe synimi nuk është të bëhet ndonjë dallim midis tyre. Mirëpo ky dallim në terminologji ka të bëjë me një aspekt që trajtohet më poshtë në Aktgjykim, se a ka patur grupe të armatosura të shqiptarëve etnikë që luftonin kundër policisë dhe ushtrisë në rrethanat e atëhershme në IRJM, në vitin 2001.[546]

1. Prania dhe baza logjistike e UÇK-së në Luboten

136. Nga disa raporte të pranuara si prova del se duke filluar nga muajt e parë të vitit 2001 dhe më pas, autoritetet maqedonase filluan të merrnin informacione që deri diku

---

541 Nazim Bushi, T 5669-5670; 5678-5683; M088, Prova Materiale P206, para. 12, 29; M092, Prova Materiale P215, para. 28-30, 40; Isni Ali, T 3457-3458; Aziz Rexhepi, T 4665-4667; Qemuran Rexhepi, T 3512; 3544; Elmaz Jusufi, T 550; Farush Memedi, T 2052; Vehbi Bajrami, T 1864-1865; Sedat Murati, T 4076.

542 Aziz Rexhepi, T 4658; Qemuran Rexhepi, T 3518; Ismail Ramadani, T 1009; Elmaz Jusufi, T 493-494; Fatmir Kamberi, T 4576-4577; Ismail Ramadani, T 1008-1009; 1029-1030; 1049; *shih* gjithashtu Nazim Bushi, T 5607; 5647; 5883.

543 Prova Materiale P352.

544 Prova Materiale P352. Dhoma Gjyqësore vë në dukje gjithashtu se disa aspekte të vëzhgimeve të tij mund të jenë ndikuar nga lajmet në media. (Peter Bouckaert, T 3074-3075)

545 Igno Stojkov, T 8922-8923; Blagoja Markovski, T 10648. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se konkluzioni i dëshmitarit për një strukturë të një grupi të armatosur shqiptar në Luboten nuk i referohet domosdoshmërisht UÇK-së; Prova Materiale 2D101, para. 333-334 and 343.

546 *Shih* më poshtë, para. 211.

krijuan mendimin se, veçanërisht duke filluar afërsisht nga qershori 2001, zona rreth Lubotenit po përdorej nga UÇK-ja për qëllime logjistike.[547] Dëshmitarët dëshmuan se që nga fillimi i vitit 2001,[548] kreshta e vargmalit Mali i Zi i Shkupit, që kalonte mbi Luboten, përdorej si shteg për infiltrimin e UÇK-së dhe për transportin e armëve nga Kosova në IRJM. Këto raporte nuk thonë se në muajin gusht apo, konkretisht gjatë periudhës para ngjarjeve të 10-12 gushtit pati shtim të transportit të armëve.[549] Gjithashtu ka dëshmi që sugjerojnë se duke filluar afërsisht nga marsi i vitit 2001, disa banorë të Lubotenit filluan t'i jepnin ndihmë logjistike UÇK-së.[550] Mirëpo këto dëshmi nuk bëjnë të ditur nëse pati shtim të kësaj ndihme pikërisht në periudhën para ngjarjeve të 10-12 gushtit.

137. Pavarësisht prej rrezikut të mundshëm që vinte nga kjo lëvizje armësh në zonën e Bashinecit mbi Luboten, dëshmia e kapiten Grozdanovskit, i cili ishte stacionuar në pozicionin e ushtrisë në Smok që prej qershorit 2001 dhe më pas, sugjeron se situata e përgjithshme e sigurisë në zonën Lubancë-Luboten deri në ngjarjet në Luboten ishte "e mirë."[551] Nuk kishte veprimtari luftarake.[552] Një mendim të ngjashëm shprehën edhe disa banorë të Lubotenit.[553] Megjithëse prej pozicionit të forcave të tij ushtarake, Luboteni shihej mirë[554] kapiten Grozdanovski nuk vuri re përgatitje për luftime në fshat gjatë periudhës deri në ngjarjet e 10-12 gushtit[555]. Ndonëse një dëshmitar tha se ushtarët panë lëvizje të njerëzve, kuajve dhe automjeteve në shpatet mbi Luboten, pranë Staneve të

---

547 Zoran Jovanovski, T 4941-4950; Provat Materiale 1D157; 1D160; 1D163, f. 3; *shih* gjithashtu T 5107-5108; Prova Materiale P438, datë 14 gusht 2001; 1D160, f. 2, "Fshati Luboten është caktuar si bazë kryesore logjistike e këtij grupi," *d.m.th,* UÇK-së. *Shih* gjithashtu Mitre Despodov, T 2620-2621; M037, T 819-823; M051, T 4162; 4201-4202; Prova Materiale 2D36; Marijo Jurishiq, T 3348-3349; M053, T 1986; 1992; Në aktekspertizën e Bllagoja Markovskit lexohet se Luboteni u bë bazë logjistike për zonën e Shkupit për grupet ekstremiste të armatosur (para 329, "të vetëquajtur UÇK") në rajonin Kumanovë-Likovë, duke filluar nga qershori 2001, T 10864-10865; Prova Materiale 2D101, para. 342-343; *shih* gjithashtu 1D162 f. 6-7; *shih* gjithashtu Provat Materiale 1D157; 1D163. Në këto Prova Materiale pohohet se ka patur lëvizje të njerëzve, si dhe baza në Bashinec, mbi Luboten, për shembull, por nuk pohohet se vetë Luboteni ishte bazë.

548 Zoran Jovanovski, T 4944; 4950; Mitre Despodov, T 2620-2621; M037, T 820; *shih* gjithashtu M051, T 4144-4147.

549 Provat Materiale 1D157; 1D160; 1D163, f. 3; P438.

550 M051, T 4154-4157; 4158-4159; 4161-4162; 4166-4168; Provat Materiale 1D141; 1D142; 1D143; 1D144; 1D169; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D157.

551 Nikollçe Grozdanovski, T 10405; 10468; 10514.

552 Nikollçe Grozdanovski, T 10411.

553 Elmaz Jusufi, T 506; 546; M088, Prova Materiale P206, para. 5; M092, Prova Materiale P215, para. 3; Farush Memedi, Prova Materiale P266, para. 3.

554 Nikollçe Grozdanovski, T 10410; 10461-10462; 10471.

555 Nikollçe Grozdanovski, T 10411.

Lubotenit në drejtim të Mateçit,[556] ai shtoi se nuk u ndërmor asnjë veprim; këto veprime "nuk përbënin kërcënim ndaj nesh."[557]

138. Lidhur me praninë e UÇK-së në Luboten, provat sugjerojnë se disa banorë të Lubotenit ishin anëtarë të UÇK-së,[558] dhe se para dhe gjatë ngjarjeve në 10-12 gusht në Luboten ka patur disa anëtarë të UÇK-së.[559] Gjithashtu sipas provave, disa banorë të Lubotenit u përfshinë në vendosjen e minës tokësore në Stanet e Lubotenit më 10 gusht, shpërthimi i së cilës shkaktoi vdekjen e tetë ushtarëve të IRJM-së.[560] Mirëpo këto prova bazohen në dokumente të UBK-së, të përgatitura nga persona të panjohur, të cilët kanë hedhur mbi letër pretendime të bëra nga persona të paidentifikuar. Për më tepër, këto dokumenta u përpiluan disa muaj pas ngjarjeve në Luboten dhe as policia, as ushtria nuk kanë patur dijeni për to në gusht 2001. Më herët, Dhoma Gjyqësore ka theksuar se nuk mund të bazohet në këto dokumente. Ekzistojnë gjithashtu prova se personat që morën pjesë në vendosjen e minës, u tërhoqën më pas në drejtim të Lubotenit apo në brendësi të Lubotenit.[561] Sipas raporteve të kohës, më 10 gusht, patrulla policore e Mirkovcit e vendosur pranë Lubotenit pa tre persona të armatosur, të veshur me rroba të zeza në zonën midis shkollës dhe varrezës, në anën e majtë të rrugës pranë shtëpive të familjes "Zendelovski."[562] Togeri Jurishiq konfirmoi se më 10 gusht kishte marrë një raport sipas

---

556 Nikollçe Grozdanovski T 10405-10406; T 10469.

557 Nikollçe Grozdanovski, T 10472.

558 M088, Prova Materiale P206, para. 12; M092, Prova Materiale P215, para. 28-30; M039, P200.2, para. 32; Zoran Jovanovski, T 4951; Prova Materiale 1D164; Nazim Bushi, T 5607-5608.

559 Zoran Jovanovski, T 4951-4952; Prova Materiale 1D165; M052, T 8461; 8534-8535; M051, T 4150; 4218-4219; Prova Materiale 1D162, f. 6; Prova Materiale 1D24, raport i posaçëm i OSBE-së për ngjarjet në Luboten i datës 14 gusht, përmend praninë e "EAAG" në Luboten gjatë luftimeve. Henry Bolton, përfaqësues i OSBE-së, përdori termin grupe të armatosura të shqiptarëve etnikë ("EAAG/GASHE/") për t'iu referuar UÇK-së, sepse termi UÇK në shqip është e njëjta shkurtesë si UÇK /Ushtria Çlirimtare e Kosovës/, T 1607; Marijo Jurishiq mori informacione nga ushtarët e tij për lëvizje të personave të armatosur të veshur me uniforma të zeza, dhe dëshmoi se kishte dijeni që uniformat e zeza përdoreshin nga UÇK-ja, T 3347-3348; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D34; 1D166; *shih* gjithashtu Blagoja Markovski, Prova Materiale 2D101, para. 342, bazuar në Rregullën 65*ter* 2D433, dokument i MB-së me informacion të marrë nga një operativ i paidentifikuar më 29 nëntor 2001 që thotë se më 26 qershor 2001, një numër ekstremistësh të armatosur, të cilët kishin marrë pjesë në sulmin në Haraçinë, ishin kthyer në këmbë në Luboten përmes Rashtakut. Dhoma Gjyqësore konkludon se burimi i pretendimit të Blagoja Markovskit në raport nuk është i besueshëm dhe, në mungesë të një konfirmimi të pavarur, nuk do të bazohet në këtë dëshmi për arsyet e përmendura më sipër në këtë Aktgjykim.

560 Zoran Jovanovski, T 4948; 4953-4954; Prova Materiale 1D161; *shih* gjithashtu M052, T 8535; *shih* gjithashtu Provën Materiale P438.

561 Mitre Despodov, T 2642-2644; Marijo Jurishiq, T 3357-3358; M053, T 1974; 1985-1986; Petre Stojanovski, T 9307; M2D-008, T 10535-10540, Provat Materiale 2D94; 2D95. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se raportet ushtarake të kohës pohojnë se ushtria kishte vrarë katër "terroristë" për të cilët pretendohej se kishin marrë pjesë në sulm dhe nuk flitet për individë që u tërhoqën më pas në fshat, Provat Materiale 1D238; P301, "një grup më i vogël" i përbërë nga 3-4 terroristë u tërhoq në drejtimin e fshatit Luboten.

562 Blagoja Toskovski, T 4347-4348; Petre Stojanovski, T 9150-9151; *shih* Provat Materiale 1D20, f. 12; P114; P151; 1D84; 2D44; 1D145; 2D42 f. 4; Prova Materiale 1D361 f. 1; gjithashtu Prova Materiale 1D137, f. 4, një

të cilit tre persona të armatosur kishin hyrë në fshat, në zonën e shtëpisë Zendeli, nga drejtimi i vendit ku kishte ndodhur shpërthimi.[563] Siç është përcaktuar gjetiu në këtë Aktgjykim, në një raport ushtarak të asaj kohe lexohet se ushtria kishte vrarë katër terroristë teksa po iknin në drejtim të Lubotenit.[564] Në një raport të kolonelit Blazo Kopaçev i Brigadës së Parë Gardiste, i datës 10 gusht 2001, shkruhet se menjëherë pas shpërthimit të minës tokësore në Stanet e Lubotenit, u hap zjarr nga xhamia në Luboten dhe nga drejtime të tjera kundër ushtarëve të plagosur të IRJM-së dhe ushtarëve të IRJM-së që kishin shkuar në ndihmë të tyre[565]

139. Në një dokument tjetër ushtarak të asaj kohe, në një shënim të datës 10 gusht, lexohet se forcat e sigurisë së IRJM-së mendonin se një grup prej 100 personash kishte kaluar në kodrat nga Mateçi, ndër të tjera, në drejtim të Lubotenit dhe Lubancës për të sulmuar postblloqet e forcave të sigurisë.[566] Mirëpo dëshmia e M051 e bën të qartë se ushtria e granatoi këtë grup personash dhe nuk e la të hynte në këto fshatra.[567] I ballafaquar me deklaratën dhënë Prokurorisë nga komandanti i UÇK-së, Xhezair Shaqiri, me pseudonimin Hoxha, M051 pohoi se përforcime të UÇK-së ishin nisur për të hyrë në fshatin Luboten dhe për t'u bashkuar me forcat që tashmë ishin në këtë fshat; ai shtoi se po të mos ishin granatuar nga ushtria maqedonase, këto përforcime do të kishin hyrë në Luboten.[568] Dëshmitarët dëshmuan gjithashtu për mendimin në lidhje me rrezikun e zhvendosjes së veprimeve të UÇK-së në drejtim të qytetit të Shkupit.[569] M051 konfirmoi ekzistencën e një numri dokumentash para datës 12 gusht, sipas të cilave UÇK-ja planifikonte të sulmonte Shkupin.[570] Gjithashtu në një shënim në ditarin ushtarak të Brigadës së Parë Gardiste më 11 gusht, thuhet gjithashtu se, sipas informacione të marra në orën 15:20, Gëzim Ostreni kishte urdhëruar Xhavit Hasanin[571] të sulmonte Rashtakun

---

raport i Ministrisë së Mbrojtjes, datë 21 shtator 2001, ku lexohet se më 10 gusht, rreth orës 15 :30, patrulla e policisë e vendosur në Luboten vuri re tre persona të armatosur dhe me uniformë që lëvizën prej shkollës në drejtim të varrezës së fshatit.

563 Marijo Jurishiq, T 3357-3358.

564 Prova Materiale 1D238.

565 Prova Materiale 2D103.

566 M051, T 4212-4213; Prova Materiale 2D42, f. 7-8.

567 M051, T 4212-4215; *shih* gjithashtu M092, T 1323-1325.

568 M051, T 4214-4215.

569 Blagoja Markovski, T 10693; M051, T 4144-4147.

570 M051, T 4204-4206; 4208-4209; Provat Materiale 2D38; 2D39 f. 3; 2D40, f. 7; 2D41.

571 Nazim Bushi dëshmoi se Xhavit Hasani ishte përgjegjës për moralin dhe informacionin e UÇK-së, T 5941; Mitre Despodov dëshmoi se ekzistonte rrezik serioz që njësitë e tij dhe pozicionet e tyre të sulmoheshin nga një njësi terroriste e udhëhequr nga Xhavit Hasani (siç duket, pak para. 10-12 gushtit), T 2591; *shih* gjithashtu Provën

dhe Lubancën.[572] Mirëpo në asnjë prej këtyre dokumenteve nuk sugjerohet se sulme të tilla do të kryheshin prej Lubotenit.

140. Duke marrë parasysh tërësinë e provave të shqyrtuara shkurtimisht në paragrafët e mësipërm si dhe pranimin prej Prokurorisë në Aktakuzë se, më 12 gusht, në Luboten ka patur 10-15 "luftëtarë të armatosur shqiptarë,"[573] Dhoma Gjyqësore shënon këtu përfundimin e saj se në atë kohë disa anëtarë të UÇK-së ishin nga fshati Luboten, dhe se disa anëtarë të UÇK-së ishin në Luboten para dhe gjatë ngjarjeve më 10-12 gusht. Megjithëse Dhoma Gjyqësore pranon se policia dhe ushtria maqedonase kishin informacione për mbështetje logjistike të UÇK-së nga disa banorë të Lubotenit gjatë muajve përpara ngjarjeve të trajtuara dhe gjithashtu se Luboteni luajti rol logjistik për UÇK-në, kryesisht për shkak të pozicionit të tij përgjatë rrugës së transportit në Malin e Zi të Shkupit, Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë se Luboteni ishte bazë logjistike për UÇK-në. Nuk ekziston asnjë provë, për shembull, për ekzistencën e ndonjë depoje apo pike furnizimi të UÇK-së në fshat. Për më tepër dëshmitë nuk vërtetojnë pretendimin se në korrik apo në gusht pati shtim të mbështetjes logjistike apo pranisë së UÇK-në në fshat. Mirëpo Dhoma Gjyqësore pranon se policia dhe ushtria dispononin informacione se disa terroristë që kishin marrë pjesë në sulmin me minë tokësore më 10 gusht, ishin larguar në drejtim të Lubotenit, se disa prej tyre ishin vrarë, dhe se disa të tjerë dyshoheshin se ishin fshehur në fshat. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore pranon se mbi bazën e informacione që dispononte, policia kishte arsye legjitime për të hyrë në fshatin Luboten më 12 gusht, për shkak të dyshimeve për praninë e terroristëve apo të UÇK-së në fshat.

Materiale 1D161, Intervista me operativin e MB-së, 15 gusht 2001, sugjeroi se Xhavit Hasani organizoi sulmin me minë tokësore; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D223.1, intervistë me operativin e UBK-së e datës 22 gusht, e cila pretendon se "Xhavit Hasani" ishte organizatori i vendosjes së minës. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se kjo intervistë u zhvillua me një operativ pas arrestimit të tij dhe, për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore i kushton pak rëndësi – "operativi" është vëllai i dëshmitareve Ismail dhe Osman Ramadani (*shih* Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 6; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 2).

572 Prova Materiale 1D85.

573 Aktakuza, para. 68.

2. Ushtria maqedonase e dislokuar pranë Lubotenit

141. Në gusht 2001, ushtria maqedonase pushtoi disa pozicione rreth Lubotenit. Pozicioni më i afërt me fshatin ishte "Smoku," i vendosur në malin mbi Luboten,[574] Largësia nga Smoku deri te kisha ortodokse dhe nga Smoku deri te xhamia në Luboten, është një deri në dy kilometra.[575] Pozicioni i Smokut ishte një pikë dominuese nga ku mund të shihej mirë pjesa më e madhe e fshatit, veçanërisht zona rreth xhamisë.[576] Pozicioni ruhej nga pesë ushtarë të Kompanisë së Dytë të Këmbësorisë së Brigadës së Parë Gardiste, duke përfshirë një snajperist me pushkë snajper 7.9 milimetërshe. Njësia e dislokuar në Smok kishte gjithashtu katër automatikë dhe një mitraloz.[577]

142. Pozicioni tjetër, paksa më larg Lubotenit, quhej "Bomba."[578] Në Bombë ishin vendosur mortaja 82 milimetërshe dhe topa.[579] Me gjasë, ato i përkisnin Kompanisë së Dytë të Këmbësorisë, e cila kishte një togë me mortaja 82 milimetërshe dhe një togë me topa 76 milimetërsh.[580]

143. Një bateri tjetër mortajash ishte dislokuar saktësisht sipër shtëpisë së pushimit të fëmijëve në Lubancë, pranë manastirit të Shën Nikollës.[581] Mortajat e baterisë ishin vendosur në një vend të quajtur "Zvero," në një luginë në pjesën veriperëndimore të shpatit që zbriste në drejtim të Lubotenit. Nga ky pozicion fshati nuk dukej.[582] Bateria kishte mortaja 120 milimetërshe. Luboteni gjendej pa diskutim brenda rrezes së largësisë qitëse të këtyre mortajave[583] Ato ishin vendosur në tri drejtime: dy mortaja ishin drejtuar nga Guri i Zi/Crn Kameni, pranë fshatit Brodec, dy nga Guri i Bardhë/Bel Kameni, dhe dy nga Luboteni.[584] Për secilën mortajë ishin caktuar koordinatat e objektivave të tyre.

---

574 Mitre Despodov, T 2660; Marijo Jurishiq, T 3292; 3295-3296; 3319; Provat Materiale P298; P366; Nikollçe Grozdanovski, T 10409-10410; 10464-10465; Provat Materiale 2D86; P596; M2D-008, T 10533.
575 Nikollçe Grozdanovski, T 10462; Prova Materiale P595.
576 Mitre Despodov, T 2660; Nikollçe Grozdanovski, T 10410; 10462; 10471.
577 M2D-008, T 10534; 10563; Nikollçe Grozdanovski, T 10467.
578 Mitre Despodov, T 2666-2667; Marijo Jurishiq, T 3292; 3295-3296; 3319; Provat Materiale P298; P366; Nikollçe Grozdanovski, T 10409-10410; 10464-10465; Provat Materiale 2D86; P596.
579 Nikollçe Grozdanovski, T 10419-10420.
580 Nikollçe Grozdanovski, T 10401; 10436; 10458-10459; dëshmitari përmendi "skuadrën e parë të kombësorisë, komandant i së cilës ishte Jurishiq Mario," gjë që Dhoma Gjyqësore pranon se ishte referencë për kompaninë e dytë të këmbësorisë që komandohej nga togeri Jurishiq; Marijo Jurishiq, T 3325.
581 Nikollçe Grozdanovski, T 10399.
582 Nikollçe Grozdanovski, T 10404; 10460; Provat Materiale P595; P596; Marijo Jurishiq, T 3292.
583 Nikollçe Grozdanovski, T 10401; 10458; 10465; Marijo Jurishiq, T 3325.
584 Nikollçe Grozdanovski, T 10403.

Koordinatat e caktuara në drejtim të fshatit Luboten, kishin si objektiv kishën, xhaminë, varrezën, dhe punishten.[585] Në një vend të quajtur Zdravec, më sipër shpatit ku ndodheshin pozicionet Smok dhe Bomba, kjo bateri mortajash kishte një pikë vëzhgimi me dy ushtarë.[586]

144. Sipas dëshmive të personelit ushtarak të njësive të ushtrisë, të dislokuara në zonën e Lubotenit, si dhe sipas raporteve ushtarake të kohës, kundër këtyre pozicioneve u hap zjarr nga drejtimi i fshatit më 12 gusht 2001, rreth orës 08:00. Siç dëshmoi kapiten Grozdanovski dhe siç thuhet në raportin që ai përgatiti në atë kohë, bateria e tij e mortajave hapi zjarr rreth orës 09:00[587] dhe vazhdoi deri në orën 10:00, duke shkrepur gjithsej 16 predha prej mortajave të tyre 120 milimetërshe.[588] Në një raport ushtarak thuhet se një njësi tjetër që vepronte në atë zonë, Kompania e Dytë e Këmbësorisë, hapi zjarr të dendur pak pas orës 09:20.[589] Toger Jurishiqi, komandant i kësaj kompanie, dëshmoi se u hap zjarr me mortaja 82 milimetërshe dhe me dy topa 76 milimetërsh.[590] Sipas raporteve të kohës, nga pozicionet e ushtrisë nuk pati të shtëna në drejtim të fshatit Luboten pas orës 10:00, me përjashtim të të shtënave në drejtim të varrezës të cilat vazhduan për një farë kohe pas orës 11:00.[591] Megjithëse Dhoma Gjyqësore i ka marrë shënim këto raporte si dhe dëshmitë e dëshmitarëve Grozdanovski, Jurishiq dhe ushtarakëve të tjerë, për arsye që trajtohen më gjerësisht më poshtë si dhe gjetkë në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore shpreh mendimin e saj se raportet ushtarake të asaj kohe dhe dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, në shumë aspekte, nuk janë të sakta apo të besueshme dhe, në fakt, janë të sajuara për të përligjur përdorimin e armëve të zjarrit nga ana e ushtrisë si dhe për të dhënë informacion të gabuar për objektivat e ushtrisë dhe për kohën e hapjes së zjarrit prej saj. Dhoma Gjyqësore përfundon se hapja zjarr me mortaja 120 milimetërshe dhe 82 milimetërshe prej ushtrisë shënoi fillimin e operacionit në Luboten më 12 gusht. Qitjet filluan rreth orës 08:00.

585 Nikollçe Grozdanovski, T 10403-10404.
586 Nikollçe Grozdanovski, T 10401; Prova Materiale P595.
587 Prova Materiale 1D26; Nikollçe Grozdanovski, T 10416.
588 Prova Materiale 1D25.
589 Prova Materiale 1D26.
590 Marijo Jurishiq, T 3325.
591 Provat Materiale P306; 1D25; 1D26. Në një raport tjetër ushtarak shkruhet se koloneli Kopaçev, i cili ishte i pranishëm në pozicionet e Batalionit të Tretë Gardist në zonën e Lubotenit nga ora 11:30 deri në orën 13:00 (Mitre Despodov, T 2584; Provat Materiale P303; P304), urdhëroi trupat e tij të ndërprisnin të shtënat; Prova Materiale P304. Mirëpo majori Despodov dëshmoi se në kohën kur mbërriti koloneli, veprimet luftarake të njësive të tij ishin ndërprerë; Mitre Despodov, T 2584.

3. Pozicione të mundshme të UÇK-së në Luboten si objektiva më 12 gusht

145. Mbrojtja argumenton se një nga vendet nga i cili erdhën të shtënat më 12 gusht ishte një pozicion i UÇK-së pranë kishës ortodokse, ku kishte disa shtëpi.[592] Siç përcaktohet prej provave, në atë zonë paksa në verilindje të kishës, gjendej një radhë shtëpish ku jetonin anëtarë të familjes Jusufi.[593] Dy dëshmitarë, kapiten Grozdanovski dhe një dëshmitar tjetër i ushtrisë, M2D-008, shënuan radhën e shtëpive të familjes Jusufi si një vend nga i cili u hap zjarr më 12 gusht.[594] Raporti ushtarak i asaj kohe i përgatitur nga kapiten Grozdanovski nuk është aq konkret sa dëshmia e tij, megjithëse edhe në atë raport flitet për të shtëna që erdhën nga "sektori rreth kishës."[595] Megjithëse në dëshminë e tij togeri Jurishiq u përpoq të konfirmonte se ky raport përputhet me informacionin që ai kishte më 12 gusht,[596] në raportin e tij të asaj kohe nuk përmendet ndonjë zonë pranë kishës.[597] Raporti përmend "GDT" (Grupe Diversante Terroriste) në "pjesën e përparme" të fshatit, por një përshkrim i tillë është shumë i papërcaktuar dhe i përgjithshëm për të sugjeruar se i referohet zonës pranë kishës. Në dëshminë e tij, kapiten Grozdanovski sugjeroi se kishte parë një grup prej katër apo pesë terroristësh, të cilët po qëllonin nga shtëpitë "përpara kishës, në anë të majtë." Ai shtoi se aty ishte një oborr i rrethuar nga një mur, dhe se ata po qëllonin nga ballkoni dhe dritaret.[598] I pari që sugjeroi se nga këto shtëpi ishte hapur zjarr, ishte kapiteni Grozdanovski kur u intervistua nga Zyra e Prokurorisë si i dyshuar. Fakti se ushtria kishte hapur zjarr me mortaja dhe armë të tjera që në çastet e para të operacionit në fshat, më 12 gusht 2001, u përligj pikërisht me të shtënat që kishin ardhur nga këto shtëpi. Sipas një raporti të përgatitur nga kapiten Grozdanovski në kohën kur ndodhën ngjarjet, bateria e tij e mortajave goditi me tetë

592 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 200.
593 *Shih* më lart, para. 43.
594 Nikollçe Grozdanovski, T 10416-10418; Prova Materiale 2D87; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D281.3, "C-1" ku shënohet vendndodhja e 3-4 terroristëve nga ku erdhën të shtënat; M2D-008, T 10543; 10544-10546; Prova Materiale 2D96; *shih* Provën Materiale P427, të shënuar nga Fatmir Kamberi, për vendndodhjen e shtëpive të familjeve Jusufi/Rashiti.
595 Prova Materiale 2D31 (e njëjtë si Prova Materiale 1D25, ku përmendet "zona e kishës").
596 Marijo Jurishiq, T 3378-3379.
597 Prova Materiale P306; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D26, referencë ndaj "terroristëve" në "fillim" të fshatit.
598 Nikollçe Grozdanovski, T 10417.

predha mortajash shtëpitë në zonën e kishës, duke përfshirë grupin e shtëpive që, sipas dëshmive, ishin të familjes Jusufi.[599]

146. Mirëpo Dhoma Gjyqësore vë në dukje se asnjë nga dëshmitarët që ishin të pranishëm në ato momente në shtëpinë e Elmaz Jusufit, e cila është në grupin e shtëpive që, siç pretendohet, u granatuan nga ushtria, nuk ka dëshmuar për ndonjë granatim. Të vetmet shpërthime që dëgjoi Elmaz Jusufi u shkaktuan prej policisë në përpjekje për thyerjen e portave të shtëpive në atë zonë me lëndë shpërthyese.[600] Bashkëshortja e tij, Zenepe Jusufi dhe kushëriri i tij, Muzafer Jusufi, të dy të pranishëm në po atë shtëpi gjatë gjithë 12 gushtit 2001, nuk panë atë ditë granatime në drejtim të shtëpisë. Është e rëndësishme të theksohet se shtëpitë e anëtarëve të familjes Jusufi janë shumë pranë njëra-tjetrës dhe rrjedhimisht nuk mund të pranohet që shpërthimi i një predhe mortaje në një nga shtëpitë të mos jetë dëgjuar nga personat në një shtëpi tjetër. Për më tepër Peter Bouckaert vëzhgoi shtëpitë në rrugën që kalon nëpër këtë lagje[601] dhe vuri re se të gjitha oxhaqet në shtëpitë e dëmtuara ishin ende në këmbë, gjë që sipas tij, tregon se shtëpitë nuk ishin dëmtuar nga ndonjë granatim, por nga djegja e tyre.[602] Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se shkaku i dëmtimit ishte djegja, dhe jo granatimi me mortaja. Pra duket se asnjë nga predhat e mortajave të gjuajtura nga ushtria, nuk arriti të godiste shtëpitë e Jusufëve. Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë se shtëpitë e Jusufëve nuk do të ishin shënjestruar konkretisht në rast se në to do të ishte konstatuar me të vërtetë veprimtari agresive ushtarake më 12 gusht. Për këtë arsye dhe pas vlerësimit të të gjitha provave për këtë çështje, si rezultat Dhoma Gjyqësore pranon se nga shtëpitë e familjes Jusufi, duke përfshirë shtëpinë e Rami Jusufit, nuk është hapur zjarr më 12 gusht.[603]

147. Nga ana tjetër, dëshmitë përcaktojnë se shtëpia e Dalip Muratit, në perëndim të kishës, ndoshta u granatua më 10 gusht,[604] dhe se më 12 gusht u granatua plevica e

---

599 Prova Materiale 1D25; Nikollçe Grozdanovski, T 10416-10419; Prova Materiale 2D87. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se në një fotografi të shënuar gjatë intervistës së tij si i dyshuar me Zyrën e Prokurorisë në 2004, Nikollçe Grozdanovski tregoi një vendndodhje më konkrete nga vinin të shtënat në raport me radhën e shtëpive Jusufi, dhe konfirmoi shënimet e tij në këtë fotografi se ata kishin granatuar me katër deri në gjashtë mortaja në këtë drejtim, T 10499-10500; Prova Materiale 1D281.3.

600 Elmaz Jusufi, Prova Materiale P8.1, para. 22.

601 Peter Bouckaert, Prova Materiale P322, para. 57-59; Peter Bouckaert, T 2964-2973; Prova Materiale P335.

602 Peter Bouckaert, T 2968.

603 *Shih* më lart, para. 45.

604 M012 shënoi me "7" shtëpinë e "Haxhi Dalipit" si një nga vendet ku pa se po binin predha më 10 gusht T 965; 967-968; Prova Materiale 2D13. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se personi, i cili përmendet me emrin "Haxhi

shtëpisë së tij dhe ndoshta edhe vetë shtëpia, si dhe shtëpia e Jakup Miftarit (Myftarit), shqiptar etnik që jetonte në atë zonë.[605] Mëngjesin e 12 gushtit, nga pozicioni në postbllokun policor të Straishtes, në jugperëndim të kishës u vunë re[606] tre persona të veshur me rroba të zeza, një prej të cilëve i armatosur me automatik, që vraponin midis shtëpive dhe oborreve.[607] Mirëpo ky konstatim nuk do të thotë se ata janë parë në shtëpinë e Dalip Muratit. Siç u theksua më sipër, në një fotografi bashkangjitur intervistës së tij nga Zyra e Prokurorisë si i dyshuar në vitin 2004, kapiten Grozdanovski shënoi një vend në perëndim të kishës dhe tha se në mëngjesin e 12 gushtit, drejt pozicionit të njësisë së tij ushtarake ishte hapur zjarr me pushkë pikërisht nga ky vend.[608] Por verifikimi me anë të hartave tregoi se vendi i shënuar është më larg në perëndim të shtëpisë së Dalip Muratit.[609] Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë se ka patur të shtëna nga shtëpia e Dalip Muratit më 12 gusht. Po ashtu, pavarësisht se në bazë të dëshmive, disa anëtarë të familjes Murati mund të kenë qenë anëtarë të UÇK-së,[610] nuk ka prova që tregojnë se Dalip Murati ishte anëtar i UÇK-së ose se shtëpia e tij u përdor si pozicion i UÇK-së më 12 gusht.

148. Ekzistojnë dëshmi që mund të tregojnë se predhat e para të mortajave që ranë në Luboten më 12 gusht, u gjuajtën nga UÇK-ja. Henry Bolton, person me përvojë ushtarake, gjendej në zyrën vendore të OSBE-së në Radishan, kur në një largësi prej 2 kilometrash nga Luboteni[611] ai dëgjoi një shpërthim të fuqishëm në orën 08 :05, që sipas tij ishte predhë mortaje 120 milimetërshe; ai pa tymin që u ngrit afër një ndërtese të

Dalipi" është i njëjti person me emrin "Dalip Murati" (Peter Bouckaert, Prova Materiale P322, para. 51; Fatmir Kamberi, T 4607; 4608); Dëshmi të tjera që sugjerojnë se shtëpia e tij u granatua më 10 gusht jepen nga M092, i cili më 10 gusht mësoi se Dalip Murati ishte plagosur nga granatimet, por ai nuk thotë konkretisht se shtëpia e Dalit Muratit ishte granatuar, Prova Materiale P215, para. 7; *shih* gjithashtu Farush Memedi, i cili tha se kishte parë goditjet (e predhave) në një zonë poshtë kishës më 10 gusht, dhe se më pas mësoi se Dalip Murati ishte vrarë nga granatimet, por nuk thotë konkretisht se shtëpia e tij u granatua atë ditë apo që Dalip Murari ishte vrarë pikërisht atë ditë, Prova Materiale P266, para. 3. Gjithsesi Dhoma Gjyqësore ka dëshmi nga një anëtar i familjes, e cila vërtetohet nga të tjerët, se Dalip Murati në fakt u vra më 12 gusht.

605 Sedat Murati, T 4059-4063; Sedat Murati, Prova Materiale P405, paras 15-19, 24-26; Prova Materiale P407; Fatmir Kamberi, Prova Materiale P426, para. 13, 14. Gjatë dëshmisë së tij dëshmitari u duk se sugjeroi që hambari i "Haxhi Dalipit" u dogj më 10 gusht si pasojë e granatimeve, T 4606-4607. Në deklaratën e tij të Rregullës 92*bis* ai thotë se hambari dhe ndoshta shtëpia e Dalip Muratit u granatuan më 12 gusht. Dhoma Gjyqësore pranon se shtëpia e tij u granatua më 12 gusht dhe se mund të jetë granatuar edhe më 10 gusht.

606 M037 dëshmoi se kishte parë lëvizje njerëzish në anë të djathtë të kishës, vërejtur nga postblloku i Straishtes, i cili është në jugperëndim, T 828.

607 M037, T 828.

608 Prova Materiale 1D281.3, shënuar "C-4."

609 Provat Materiale P407; 2D13 shënuar "7"; 2D48 shënuar "1."

610 M088, Prova Materiale P206, para. 12; M088, T 1213-1214; M092, Prova Materiale P215, para. 28.

611 M084, T 1495.

bardhë pranë kishës ortodokse në Luboten, por nuk ishte në gjendje ta përcaktonte saktësisht vendin e shpërthimit në një fotografi.[612] Henry Bolton theksoi se UÇK-ja mund të kishte objektivat e veta dhe se një prej tyre ishte pika apo postblloku policor pranë kishës.[613] Henry Bolton ishte informuar se forcat maqedonase në zonë nuk ishin të pajisura me mortaja 120 milimetërshe. Për këtë arsye, ai mendoi se çka po dëgjonte ishte sulm i UÇK-së kundër kësaj poste policore.[614] Një raport i posaçëm i OSBE-së për ngjarjet në Luboten, i datës 16 gusht 2001, pasqyron vëzhgimet e Z. Bolton, sipas të cilave predha e parë e mortajës që mendohej se ishte e kalibrit 120 milimetërsh, ra pranë kishës ortodokse, në atë zonë që është përshkruar si pjesa maqedonase e fshatit.[615] Edhe në një dokument tjetër të përpiluar nga ambasada gjermane më 16 gusht 2001, thuhet se "nuk ka dyshim" se tri predhat e para të shkrepura prej mortajave më 12 gusht, kishin për objektiv forcat e sigurisë.[616] Mirëpo duket se ky dokument mbështetet në informacione të marra gjatë një konference shtypi të OSBE-së.

149. Mirëpo në kundërshtim me informacionin e marrë nga Henry Bolton, ushtria maqedonase e dislokuar në atë zonë *në fakt* ishte e pajisur me mortaja 120 milimetërshe, të cilat u përdorën për të hapur zjarr atë ditë. Për këto mortaja ishin caktuar koordinatat e objektivave të tyre. Një prej tyre ishte kisha.[617] Natyrisht Henry Bolton i dëgjoi dhe vëzhgoi ngjarjet nga një largësi prej afro dy kilometrash. Ai nuk ishte i sigurtë se nga cili pozicion kishte parë të dilte tym. Dhoma Gjyqësore konkludon se ai gaboi kur tha se këto predha mortajash ishin gjuajtur nga UÇK-ja, si dhe në përfundimin e tij se këto predha ranë në pjesën maqedonase të fshatit. Dhoma Gjyqësore konkludon se predhat e para të mortajave shpërthyen në një zonë të banuar nga shqiptarët në perëndim të kishës ortodokse, por gjithsesi jo larg saj. Këto predha u gjuajtën nga mortajat e ushtrisë maqedonase në orën 08:00, ose pak pas kësaj ore, në datën 12 gusht. Ato nuk u gjuajtën

612 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 6; Henry Bolton, dëshmitari e pati të vështirë të shënonte saktësisht vendin prej të cilit pa të ngrihej tym pranë kishës, dhe shënoi një zonë të përafërt, T 1672-1673; Provat Materiale 1D21, 1D22.

613 Henry Bolton, T 1674; Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 6; Elmaz Jusufi, Prova Materiale P8.1, para. 12; Elmaz Jusufi, Prova Materiale P8.2, para. 6; *shih* gjithashtu Fatmir Kamberi, Prova Materiale P426, para. 10-11.

614 Henry Bolton, Prova Materiale 236.1, para. 6.

615 Prova Materiale 1D24, f. 3.

616 Prova Materiale 1D224.

617 Nikollçe Grozdanovski, T 10404; 10526-10527.

për t'iu përgjigjur zjarrit të UÇK-së, qoftë nga brenda fshatit, apo nga ndonjë pikë tjetër, pavarësisht nga dëshmitë e dëshmitarëve të ushtrisë për të kundërtën.[618]

150. Në dëshmitë e tyre kapiten Grozdanovski dhe vartësi i tij M2D-008, sugjeruan gjithashtu se kishin parë predhat e këtyre mortajave të binin mbi shtëpitë në pjesën maqedonase të Lubotenit, në një zonë që sipas tyre ishte në perëndim të kishës. Nuk ka dëshmi për dëmtim të ndonjë shtëpie maqedonase atë mëngjes. Dy shtëpitë e vetme që u granatuan ishin të dy shqiptarëve etnikë, Jakup Miftarit (Myftarit) dhe Dalip Muratit (plevica e tij dhe ndoshta edhe shtëpia e tij). Ato janë, të paktën në një kuptim të përgjithshëm, në afërsi të kishës dhe pranë zonës së banuar nga maqedonasit. Të dy këto shtëpi ndodhen afër vendit, të cilin gjatë intervistës së tij si i dyshuar në vitin 2004,[619] kapiten Grozdanovski e identifikoi si vendi nga erdhën të shtënat me pushkë në drejtim të ushtrisë.[620]

151. Në vijim, në asnjë prej raporteve ushtarake të asaj kohe për ngjarjet më 12 gusht, nuk flitet për ndonjë granatim të shtëpive maqedonase nga ana e UÇK-së. Në raporte thuhet vetëm se ushtria iu përgjigj të shtënave që erdhën nga fshati kundër *pozicioneve të ushtrisë* rreth orës 08:00.[621] Është për t'u theksuar se, as në dëshminë e tij si i dyshuar në vitin 2004 dhe, as në raportin e tij të kohës për ngjarjet në Luboten më 12 gusht, kapiten Grozdanovski nuk i përmend këto tri predha mortaje të pretenduara të UÇK-së që kishin goditur shtëpi maqedonase.[622] Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se kapiten Grozdanovski dhe M2D-008 sajuan kur dëshmuan para kësaj Dhome Gjyqësore se më 12 gusht 2001, rreth orës 08:00, në këtë pjesë të fshatit ranë predha mortaje të UÇK-së. Përfundimi i Dhomës Gjyqësore është se të vetmet predha mortaje që ranë në atë pjesë të

618 *Shih,* për shembull, Nikollçe Grozdanovski, T 10416-10417; 10499; Prova Materiale 1D281.3, një fotografi e shënuar nga Nikollçe Grozdanovski gjatë intervistës së tij me Zyrën e Prokurorisë në vitin 2004, ku tregohet se nga vinin të shtënat me pushkë me shënimin "C-4"; Prova Materiale 1D25; 1D26: P306.

619 Sedat Murati, T 4059-4063; Provat Materiale P406; P407, shtëpia e Jakup Miftarit (Myftarit) e shënuar me "1," edhe shtëpia e Dalip Muratit, e shënuar; Sedat Murati, Prova Materiale P405, para. 16-19, 24-26; *shih* gjithashtu M012, T 967-968, Prova Materiale 2D13, shënimi "7" është shtëpia e Dalip Muratit.

620 Nikollçe Grozdanovski, Prova Materiale 1D281.3, shënuar "C-4 Pushki," e përkthyer "zjarr me pushkë."

621 *Shih* për shembull, Provat Materiale 1D25 (e njëjta si 2D31); 1D26; P306.

622 Nikollçe Grozdanovski, T 10500-10501; Prova Materiale 2D31; shpjegimi i tij për këtë mospërmendje ishte se në hartat e përdorura në intervistën e tij të parë si i dyshuar, ai kishte shënuar vetëm predhat e lëshuara nga mortajat e tij dhe nuk i kishte përmendur në raportin e tij të asaj kohe, sepse majori Despodov donte që ai të përmendte në atë raport vetëm vendndodhjen e objektivave kundër të cilave kishte hapur zjarr ushtria. Dhoma Gjyqësore nuk e pranoi logjikën e këtij shpjegimi apo sinqeritetin e dëshminë së tij. Nëqoftëse në fillim të operacionit atë mëngjes në fshat do të kishin rënë me të vërtetë predha të UÇK-së, një gjë e tillë do të kishte qenë një çështje shumë e rëndësishme, e cila do të ishte përmendur në çdo raport të ushtrisë. Mirëpo një fakt i tillë nuk përmendet në asnjë raport.

fshatit rreth asaj kohe, ishin predhat e gjuajtura nga ushtria rreth orës 08:00. Këto predha goditën shtëpinë e Jakup Miftarit, plevicën e Dalip Muratit dhe ndoshta shtëpinë e tij.[623] Gjithashtu, për të njëjtat arsye si dhe në mungesë të dëshmive bindëse për të kundërtën, Dhoma Gjyqësore nuk pranon dëshmitë e kapiten Grozdanovskit apo M2D-008 sipas të cilave ushtria qëlloi me këto predha mortaja për t'iu përgjigjur zjarrit të hapur nga kjo zonë e fshatit kundër pozicioneve të ushtrisë. Merge with

152. Sipas Mbrojtjes, mendohej se UÇK-ja kishte edhe disa pozicione të tjera të vendosura në një zonë me popullsi të dendur, së cilës një dëshmitar iu referua si "Dolno Maalo," apo fshati i vjetër,[624] si dhe në afërsi të xhamisë. [625] Kjo zonë vazhdon me zonën e Fshatit të Vjetër, e cila gjendet pak më në perëndim. Është një zonë me popullsi të dendur, në të cilën gjenden, ndër të tjera, edhe shtëpitë e Abdulla Lutfiut, Nazim Murtezanit, Harun Rexhepit dhe Ismet Rexhepovskit (Rexhepi). Siç është shpjeguar më hollësisht gjetkë, këto shtëpi u shkatërruan apo dëmtuan nga policia e udhëhequr nga Johan Tarçulovski më 12 gusht.[626] Dhoma Gjyqësore nuk ka dëshmi të besueshme që konfirmojnë pretendimin e mbrojtjes për anëtarësinë e këtyre individëve në UÇK.[627]

153. Ka dëshmi se policia hasi në rezistencë nga një mitraloz i vendosur në një shtëpi pranë një ure.[628] Në një fotografi, M037 e shënoi urën afërsisht në qendër të fshatit dhe dëshmoi se Johan Tarçulovski i kishte thënë gjatë mëngjesit të 12 gushtit se në atë pikë ishin disa njerëz të veshur me uniforma të zeza.[629] Këto dëshmi nuk sugjeruan se kundër

---

623 Sedat Murati, Prova Materiale P405, para. 17; Fatmir Kamberi, Prova Materiale P426, para. 13, 14; *shih* gjithashtu Nikollçe Grozdanovski, T 10501-10505; 10526-10527. Duket se është qëlluar me predha në një zonë në afërsi në kishës, ku jetonin shqiptarë.

624 M2D-008, T 10547-10548; 10575.

625 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 201-202.

626 *Shih* më lart, para. 49.

627 Dhoma Gjyqësore vë në dukje se megjithëse ka prova që Besim Murtezani, ka të ngjarë i afërm, ishte anëtar i UÇK-së (M088, Prova Materiale P206, para. 12; M092, Prova Materiale P215, para. 28), dëshmitë nuk përcaktojnë se Nazim Murtezani ishte anëtar i UÇK-së; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D146, prova e parafinës me dorashkë rezultoi pozitive për disa anëtarë të familjes Murtezani.

628 M051 konfirmon dëshminë në fletoren e tij të shënimeve, e cila përmban informacion të marrë nga një takim me oficerë të ushtrisë si dhe nga disa biseda që dëshmitari kishte patur me oficerë të ushtrisë më 12 gusht, se në këtë urë, policia hasi rezistencë në shtëpinë që i përkiste "Qenanit." Fletorja e shënimeve dhe raporti i kohës i dëshmitarit thonë se ushtrisë iu kërkua të ndihmonte duke gjuajtur një predhë mortaje kundër shtëpisë dhe urës. Gjithashtu shkruhet se ushtria gjuajti një predhë mortaje dhe një predhë topi kundër shtëpisë së Qenanit dhe urës, T4119-4120; 4124-4126; 4171; Prova Materiale P302, f. 14-15 (N001-4712-N001-4713); *shih* gjithashtu Provat Materiale P303 f. 2; 1D30.

629 M037, T 781; 831; Prova Materiale P38, tregon urën me një kryq. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se ura e shënuar nga M037 ka shumë të ngjarë të jetë ura e përmendur nga M051 lidhur me vendin ku policia hasi rezistencë herët në mëngjes, *d.m.th.,* ura dhe shtëpia e "Qenanit," për të cilin Dhoma Gjyqësore beson se është kryetari i fshatit Kenan Salieveski (*shih,* për shembull, Provën Materiale 1D30). Mirëpo në hartën IMG nuk është shënuar shtëpia

policisë ishte hapur zjarr nga ajo zonë. M2D-008 dhe kapiten Grozdanovski shënuan në fotografi pozicionin e përafërt në atë zonë nga i cili, sipas tyre, u hap zjarr kundër ushtrisë më 12 gusht.[630] Kapiten Grozdanovski përshkroi një shtëpi të vjetër[631] nga e cila, sipas tij u hap zjarr me pushkë snajper si kundër ushtrisë, po ashtu dhe kundër policisë.[632] Mirëpo shtëpia e shënuar nga M2D-008, ishte një shtëpi tjetër, në lindje të shtëpisë së shënuar nga kapiten Grozdanovski.[633] Gjthashtu ai dëshmoi se nga pozicioni që shënoi, u hap zjarr si me mitraloz po ashtu dhe me pushkë snajper drejt pozicioneve të ushtrisë.[634] Për Dhomën Gjyqësore u bë e qartë se dëshmitë e sapopërmendura të këtyre dy dëshmitarëve për ngjarjet përkatëse atë mëngjes, nuk janë të sinqerta. Megjithëse Dhoma Gjyqësore pranon se M037 bisedoi me të Akuzuarin Johan Tarçulovski për zonat në fshat që ngjallnin interes apo shqetësim për njësinë policore që kaloi përmes fshatit, dhe se ata mund të kenë biseduar edhe për njerëz me uniforma apo rroba të zeza të parë pranë urës, ajo thekson se gjatë kësaj bisede nuk u diskutua nëse nga ky pozicion ishte hapur apo nuk ishte hapur zjarr kundër policisë. Pavarësisht se nuk mund të pranojë si të vërtetë gjithçka që thonë këta dëshmitarë në dëshmitë e tyre, Dhoma Gjyqësore është e vetëdijshme se ekziston një numër dëshmish për të shtëna me snajper nga kjo zonë e përgjithshme ndaj një pozicioni të ushtrisë si dhe për raporte që flasin për të shtënat e një mitralozi, dhe pranon se shumëkush mund të ketë besuar se nga ai pozicion po qëllohej me pushkë snajper dhe mitraloz kundër ushtrisë apo policisë.

---

e Kenan Salievskit. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore nuk mund të jetë e sigurtë se në fshat ka patur një urë apo disa ura.

630 Dhoma Gjyqësore vëren se M2D-008 dhe kapiteni Grozdanovski shënuan dy shtëpi të shkëputura pranë njëra tjetrës në vendin e përmëndur nga M2D-008 si Dolno Maalo, në rrugën që të çonte nga ura në drejtim të xhamisë, pak më sipër kryqëzimit të urës; M2D-008, T 10543; 10547; Prova Materiale 2D97, shënimi "1"; Nikollçe Grozdanovski, T 10422-10423; Prova Materiale 2D89; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D25 (e njëjta si 2D31); *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D281.2, shënimi "C-2" si vendndodhjen e snajpërve, shënuar nga kapiteni Grozdanovski gjatë intervistës së tij nga Zyra e Prokurorisë si i dyshuar në vitin 2004; *shih* gjithashtu M037, T 781; 830-831; Prova Materiale P38, që tregon urën me një kryq.

631 Nikollçe Grozdanovski, T 10421-10423; Prova Materiale 2D89, shtëpia e shënuar "1."

632 Nikollçe Grozdanovski, T 10421-10423; Prova Materiale 2D89, e shënuar "1"; Prova Materiale 1D281, një fotografi e shënuar nga Nikollçe Grozdanovski gjatë intervistës së tij nga Zyra e Prokurorisë si i dyshuar në vitin 2004, shënuar "C-2" që tregon të shtëna snajperi, ndaj të cilave, sipas dëshmitarit, ushtria reagoi duke qëlluar me 6-8 predha mortaje; *shih* gjithashtu Provën Materiale 2D31 (e njëjta si 1D25).

633 M2D-008, T 10543; 10546-10547; Prova Materiale 2D97, e shënuar "1."

634 M2D-008 dëshmoi se ai përcaktoi pozicionin e saktë nga i cili po qëllonte snajperi duke vendosur një helmetë mbi një shkëmb; helmeta u godit në atë pozicion dhe duke u bazuar në anën ku u godit helmeta, ata konkluduan se të shtënat e snajperit vinin "drejtpërsëdrejti nga zona Dolno Maalo," T 10546; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D26, një raport nga Darko Brashnarski në të cilin thuhet se pozicioni i ushtrisë në "B-1" u qëllua nga një snajper dhe se gjatë kësaj u godit dhe u dëmtua një helmetë e vendosur mbi thasë rëre. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se ka dëshmi nga M2D-008 sipas të cilës pasditen e të premtes ,10 gusht, kishte patur të shtëna me snajper edhe nga zona e Dolno Maalo-s, T 10540-10542; 10589-10591.

154. Ka gjithashtu prova se, gjatë mëngjesit të 12 gushtit ka patur të shtëna nga zona ku gjendet xhamia.[635] Xhamia dhe zona rreth saj ishin bërë objektiva të granatimeve të ushtrisë që më 10 gusht.[636] Raporti i kapitenit Grozdanovski thotë se më 12 gusht bateria e tij me mortaja goditi me pesë predha mortaje një shtëpi të vjetër rreth 100 metra nën xhaminë.[637] U dëshmua gjithashtu se Kompania e Dytë e Këmbësorisë hapi zjarr me topa kundër një shtëpie të vjetër nën xhami.[638] Mirëpo Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar edhe dëshmi nga banorët e zonës, Aziz Rexhepi dhe Qamuran Rexhepi (i cili në atë kohë banonte në shtëpinë e Ismet Rexhepit (Rexhepovskit)). Askush prej tyre nuk dëshmoi për granatime kundër shtëpive të tyre apo në afërsi.[639] Duke patur parasysh se sa afër ishin shtëpitë e Nazim Murtezanit, Abdulla Lutfiut dhe Harun Rexhepit,[640] është e vështirë të pranohet se Aziz dhe Qamuran Rexhepi nuk do kishin dëgjuar plasjen e predhave të mortajave apo topave. Nga ana tjetër, gjatë vizitë së tij në Luboten më 23 gusht 2001, Peter Bouckaert vuri re shenja të shkaktuara nga armë zjarri në muret e jashtme të oborrit të Nazim Murtezanit, ndonëse, natyrisht pa qenë në gjendje të thoshte se kur mund të kishte ndodhur një gjë e tillë. [641] Mirëpo ai nuk konstatoi ndonjë dëmtim tjetër të shkaktuar nga armë zjarri. Sikurse u dëshmua, më 10 gusht një predhë mortaje e ushtrisë shpërtheu në një rrugicë me zhavorr midis shtëpive të Nazim Murtezanit dhe Nevzat Murtezanit. Kjo mund të shpjegojë shenjat e konstatuara në muret e jashtme. Mbi bazën e

635 M2D-008, T 10546-10549; Prova Materiale 2D97 shënuar "2"; Marijo Jurishiq shënoi zonën e përgjithshme pranë xhamisë nga e cila pati të shtëna me snajper apo mitraloz, por ai dëshmoi se nuk ishte në gjendje të shënonte shtëpinë e saktë, T 3373-3376; Prova Materiale 2D29; *shih* gjithashtu Provën Materiale P306, raport i kohës nga Marijo Jurishiq i cili e përshkruan atë si "një shtëpi e vjetër më poshtë xhamisë." Në raportin e tij të asaj kohe Nikollçe Grozdanovski përmend një "shtëpi të vjetër 100 metra më poshtë xhamisë nga e cila ndoshta pati të shtëna me snajper, Prova Materiale 1D25; mirëpo në dëshminë e tij, ai nuk thotë se të shtënat erdhën nga një vend shumë pranë xhamisë. Përkundrazi, ai shënon një vend i cili është më afër qendrës së fshatit, në rrugën që të çonte tek ura, T 10422-10423; Prova Materiale 2D89, e shënuar "1." Ky është një vend, për të cilin Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se ndodhet në zonën e përshkruar si Dolno Maalo. Disa dëshmitarë kanë dëshmuar për të shtëna nga xhamia, por nuk e kanë shënuar këtë në fotografi; M037, T 828; 832; Mitre Despodov, T 2597; 2676; M051, T 4223; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D26.

636 M012, T 966-967; Prova Materiale 2D11; M017, T 722; Prova Materiale 2D4; Fatmir Kamberi, Prova Materiale P426, para. 7; Elmaz Jusufi, T 557-558; 564; Prova Materiale 2D1; *shih* gjithashtu Mamut Ismaili, Prova Materiale P219.1, para. 2, 3; Mamut Ismaili, Prova Materiale 219.2, para. 2; M037 dëshmoi se pati të shtëna me snajper nga drejtimi i xhamisë, të cilat goditën një shtëpi (në ose pranë) postbllokut të Straistës, ku ishte dëshmitari në atë kohë, T 832.

637 Provat Materiale 1D25 (e njëjta si Prova Materiale 2D31); 2D89.

638 Prova Materiale P306; Marijo Jurishiq, T 3375; Prova Materiale 2D29.

639 Qemuran Rexhepi, Prova Materiale P372; Qemuran Rexhepi, T 3555; Aziz Rexhepi , Prova Materiale P432.

640 Provat Materiale P433; P411.

641 Peter Bouckaert, T 2984; Prova Materiale P347. Shtëpia e Nazim Murtezanit është afër zonës, për të cilën pretendohet se ishte objektiv i topave, *shih* Provat Materiale P410; P411; 2D29, të shënuar "3." Po kështu, i vetmi dëm i njoftuar nga Peter Bouckaert lidhur me shtëpinë e Xhefki Huseinit, e vendosur në anën tjetër të rrugës nga shtëpitë e Ismet Rexhepovskit dhe Abdulla Lutfiut (Prova Materiale P334), u shkaktua nga një predhë Zolja; Peter Bouckaert, T 2980-2982; P345; Peter Boeckaert, Prova Materiale P322, para. 64 dhe 65.

këtyre dëshmive, Dhoma Gjyqësore bindet dhe konkludon se këto shtëpi, si dhe shtëpitë pranë tyre, nuk u goditën nga predhat e mortajave apo topave më 12 gusht 2001. Po të ishte hapur zjarr nga ndonjë prej këtyre shtëpive, ushtria do t'i ishte përgjigjur zjarrit të armëve të ardhur prej kësaj shtëpie. Gjithsesi, zona nga e cila, sipas dëshmitarëve ushtarakë u hap zjarr dhe të cilën ata e shënuan – ndonëse në mënyra të ndryshme dhe joqartësisht - në fotografi, është e madhe dhe përfshin edhe shumë shtëpi të tjera, disa prej të cilave gjenden larg shtëpive të Aziz dhe Qamuran Rexhepit. Megjithëse Dhoma Gjyqësore ka theksuar se nuk mund të pranojë si të vërtetë çdo gjë të deklaruar prej disa dëshmitarëve të ushtrisë në dëshmitë e tyre për ngjarjet më 12 gusht, Dhoma Gjyqësore është e vetëdijshme se mbi bazë e dëshmive të paraqitura nuk mund të thuhet me siguri se në zonën e shënuar nuk ra asnjë predhë e ushtrisë. Ajo pranon se personeli ushtarak mund të ketë menduar se mund të jetë hapur zjarr nga një shtëpi brenda zonave të shënuara në fotografi.

155. Dhomës Gjyqësore i janë paraqitur shumë prova për të shtëna nga një grup shtëpish, dhe kundër këtyre shtëpive në pjesën verilindore të Lubotenit, në zonën e rrugës për në Rashtak. Mbrojtja pretendon se në atë rrugë ishte një pozicion i UÇK-së që përbëhej nga katër shtëpi të njëjta dhe një shtëpi e veçuar në veri të rrugës.[642] Këto shtëpi i përkisnin anëtarëve të familjes Jashari, ndër të cilët, Qani Jasharit. Dhoma Gjyqësore thekson këtu se ishin disa dëshmitarë, që në fotografi e shënuan shtëpinë e Qani Jasharit në anën veriore të rrugës, dhe shtëpitë e anëtarëve të familjes Jashari pikërisht në jug të rrugës që çonte në Rashtak.[643] Kapiten Grozdanovski dëshmoi se u raportua, se nga këto

---

642 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 204.

643 Nikollçe Grozdanovski, T 10421; 10424-10428; 10521-10523; Provat Materiale 2D90; 2D92. Megjithëse në intervistën e tij me Zyrën e Prokurorisë si i dyshuar në 2004, dëshmitari kishte shënuar një shtëpi tjetër si vend nga i cili ishte hapur zjarr me mitraloz, dëshmia e tij në sallën e gjyqit e bind Dhomën Gjyqësore se ai kishte gabuar në shënimet që kishte bërë në fotografitë për shtëpitë nga të cilat besonte se ishte hapur zjarr. M2D-008, T 10540-10541; 10546; 10549-10552; T 10555-10556; 10589-10590; Provat Materiale 2D98; 2D99; *shih* gjithashtu Marijo Jurishiq, T 3372-3376; Prova Materiale 2D29; *shih* gjithashtu Provën Materiale P306. Dhoma Gjyqësore vë re se megjithëse disa dëshmitarë dëshmuan për shtënat e ardhura nga ky vend, ata nuk shënuan konkretisht shtëpitë e anëtarëve të familjes Jashari, ose shënuan një zonë shumë më të gjerë ku përfshinë shtëpitë e Jasharëve. Mbi bazën e detajeve të tjera të dëshmive të këtyre dëshmitarëve lidhur, ndër të tjera, me llojin e zjarrit të armëve nga ky vend, përshkrimin e shtëpive në një radhë, si dhe faktin se më vonë ata kishin parë disa individë duke u larguar nga ky vend në drejtim të pyllit, Dhoma Gjyqësore konkludon se këto dëshmi kanë të bëjnë me shtëpitë e anëtarëve të familjes Jashari. Dhoma Gjyqësore vëren gjithashtu se disa dëshmitarë nuk ishin gjendje të saktësonin ose gabuan lidhur me vendin konkret nga i cili ishte hapur zjarr në atë zonë. Kjo duket se shpjegohet me cilësinë e dobët të fotografisë që iu paraqit atyre dhe pamjen e saj (Nikollçe Grozdanovski, T 10442; 10507-10508; M2D-008, T 10550-10551; Prova Materiale 2D98), apo me faktin se fotografia ishte bërë më vonë se viti 2001 dhe si rezultat në të tregohen disa ndërtesa të tjera, apo për shkak se ata panë nga një largësi

shtëpi u hap zjarr me mitraloz në drejtim të pozicioneve të ushtrisë.[644] Kapiten Grozdanovski sugjeroi se nga ky vend pati gjithashtu të shtëna në drejtim të forcave të sigurisë në afërsi të kishës.[645] Sipas dëshmisë së tij të shtënat filluan herët në mëngjes nga të paktën një prej shtëpive në anën jugore të rrugës.[646] Një dëshmitar tjetër përshkroi të shtënat që vinin nga brenda shtëpive, nga plevica pranë shtëpive, dhe nga anash shtëpive.[647] Kapiten Grozdanovski dëshmoi gjithashtu se më pas mitralozi u zhvendos në anën tjetër të rrugës, në shtëpinë e cila, sipas dëshmitarëve të tjerë, i përkiste Qani Jasharit.[648] Ashtu siç thuhet edhe në raportin e tij të asaj kohe, Kapiten Grozdanovski dëshmoi se bateria e tij e mortajave shkrehu tri predha mortaje kundër shtëpisë së Qani Jasharit.[649] Veç mortajave, ushtria hapi zjarr edhe me një snajper dhe me mitraloza kundër këtij objektivi.[650] Edhe ushtarët e baterisë së mortajave hapën zjarr me një mitraloz dhe një pushkë snajper kundër dy shtëpive të para ndër katër shtëpitë që ishin në anën jugore të rrugës dhe që i përkisnin familjes Jashari.[651] Sipas dëshmive, Kompania e Dytë e Këmbësorisë shtiu me topa në drejtim të shtëpisë se dytë ndër katër shtëpitë.[652] Pavarësisht sugjerimit për goditjen e këtyre objektivave, nuk ka dëshmi se këto shtëpi u goditën prej predhave të mortajave dhe topave më 12 gusht 2001. Asnjë nga dëshmitarët që ishin të pranishëm pranë shtëpive, nuk dëshmoi se atë ditë u qëllua me mortaja apo topa kundër shtëpive.

156. Gjithashtu vëzhguesi i OSBE-së, Henry Bolton, përshkroi çfarë pa tek katër shtëpitë "në fund të rrugës" (Dhoma Gjyqësore pranon se këto janë shtëpitë e familjes Jashari) më 14 gusht; dëshmitari tha se, sipas mendimit të tij, dy nga këto shtëpi dukej se

---

e konsiderueshme (për shembull, M052, T 8546-8551). dhe Dhoma Gjyqësore është bindur se ata i referoheshin shtëpive të familjes Jashari.

644 Nikollçe Grozdanovski, T 10421; 10424.

645 Nikollçe Grozdanovski, T 10427; Prova Materiale 2D90.

646 Nikollçe Grozdanovski, T 10426-10427; Prova Materiale 2D90; M2D-008, T 10550.

647 M053, T 1995-1996.

648 Nikollçe Grozdanovski, T 10425-10426; 10428; 10523-10524; Provat Materiale 2D90, shtëpia e shënuar "2"; Prova Materiale 2D31.

649 Raporti i kapitenit Grozdanovski i referohet shtëpisë së dytë ndër katër shtëpitë e reja. Prova Materiale 1D25. Mirëpo kapiteni Grozdanovski dëshmoi se shtëpia që ishte objektiv, në fakt gjendej në anën tjetër të rrugës nga katër shtëpitë, në rrugën e Rashtakut; Nikollçe Grozdanovski, T 10425; Prova Materiale 2D90. Siç është përcaktuar gjetkë, shtëpia në anën tjetër të rrugës i përkiste Qani Jasharit, ndërsa katër shtëpitë në një rradhë u përkisnin anëtarëve të tjerë të familjes Jashari.

650 Nikollçe Grozdanovski, T 10428-10429.

651 Nikollçe Grozdanovski, T 10429; Prova Materiale 2D90.

652 Prova Materiale P306; Marijo Jurishiq, T 3375; Prova Materiale 2D29.

kishin qenë objektiv i sulmit,[653] dhe se veçanërisht një nga këto shtëpi dukej se ishte goditur shumë herë me plumba nga ana perëndimore.[654] Henry Bolton përshkroi shenjat që kishin lënë këto goditje në këtë shtëpi,[655] por ai nuk konstatoi prova të ndonjë shpërthimi predhe mortaje apo topi në këto katër shtëpi, apo në afërsi të tyre. Ajo çka Henry Bolton pa, tregon se dëmtimi ishte shkaktuar nga plumbat, jo nga shpërthimi i predhave të mortajave apo topave. Gjetiu në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore trajton dëmtimin shkaktuar shtëpisë së Qani Jasharit, e cila gjendet në anën tjetër të rrugës, përballë katër shtëpive të familjes Jashari të përmendura më sipër. Në këtë diskutim theksohet se shtëpia pësoi dëme të shumta të shkaktuara nga zjarri dhe plumbat, mirëpo nuk ka tregues se dëmet e shtëpisë u shkaktuan nga predha mortaje apo topi.

157. Përfaqësuesi i OSBE-së, Henry Bolton, inspektoi ambientet e brendshme të një prej katër shëpive të bardha të vendosura në rresht, të cilat i përkisnin familjes Jashari dhe të cilat dukej se ishin goditur shumë herë me armë zjarri, dhe ai nuk konstatoi ndonjë shenjë të mbrojtjes së organizuar nga brenda shtëpisë.[656] Peter Bouckaert, i cili vizitoi këtë vend shumë më vonë, më 23 gusht, nuk pa asnjë provë që tregonte se nga shtëpia e Qani Jasharit ishte hapur zjarr.[657] Mirëpo, meqë shtëpia u braktis ndërsa po digjej më 12 gusht, dhe meqë sipas vlerësimit, 60 përqind e saj ishte dëmtuar, Dhoma Gjyqësore nuk mund t'i pranojë konstatimet e Z. Bouckaert si bazë solide për të përcaktuar nëse nga shtëpia ishte hapur zjarr.

158. Dhoma Gjyqësore vë në dukje gjithashtu se ekzistojnë prova që tregojnë se nuk pati të shtëna ndërkohë që autoblinda Hermelin dhe policia iu afruan shtëpive të familjes Jashari përgjatë rrugës, por se policia hapi zjarr kur pa persona që po vraponin nga shtëpia e Qani Jasharit përmes fushës.[658] Edhe ushtarët shtinë kundër personave që u larguan nga shtëpia e Qani Jasharit dhe vrapuan përmes fushës për t'u fshehur midis pemëve. Është e vështirë të pajtohen dëshmitë, sipas të cilave nuk pati të shtëna ndërkohë

653 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 18.
654 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 13.
655 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 13; *shih* gjithashtu Peter Bouckaert, i cili dëshmoi se kur vizitoi Lubotenin, më 23 gusht 2001, oxhaku i shtëpisë kryesore të familjes Jashari ishte i padëmtuar, T 2987; *shih* gjithashtu Provën Materiale P348.
656 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 13.
657 Peter Bouckaert, Prova Materiale P322, para. 74.
658 *Shih* më lart, para. 68.

që policia po afrohej, me dëshmitë e dëshmitarëve të ushtrisë sipas të cilëve, ndaj shtëpive të familjes Jashari, duke përfshirë atë të Qani Jasharit, u hap zjarr me mortaja, topa, mitraloza, dhe pushkë.[659] Nga shtëpia e Qani Jasharit, policia hapi zjarr kundër shtëpive të tjera të Jasharëve.[660]

159. Siç është diskutuar gjetiu në këtë Aktgjykim, dëshmitarët e policisë thanë se më 12 gusht policia kishte gjetur dy pushkë Kallashnikov, një automatik Tompson, si dhe municion të papërdorur për këto armë pranë kufomave të Xhelal Bajramit, Kadri Jasharit dhe Bajrami Jasharit, në fushën pas shtëpisë së Qani Jasharit.[661] Gjithashtu duhet theksuar se kur kufomat e të tre burrave u zhvarrosën në prill 2002, pasi ishin varrosur një apo dy ditë pas 12 gushtit dhe më pas ishin rivarrosur përsëri, në xhepin e pantallonave me të cilat ishte varrosur Xhelal Bajrami u gjet municion i tipit që përdoret për Kallashnikov.[662] Tërësia e provave sugjeron se këta fishekë ishin në xhepin e pantallonave të Xhelal Bajramit kur ai u vra në fushën pranë shtëpisë së Qani Jasharit. Këto janë provat më bindëse se viktimat ishin të armatosur. Asnjë prej tyre nuk ishte veshur me uniforma të UÇK-së, megjithëse veshja e jashtme e njërit prej tyre ishte e zezë.

160. Pavarësisht nga provat për gjetjen e këtyre tri armëve dhe municionit pranë kufomave të tre burrave të vrarë, duhet theksuar se në një notë zyrtare të UBK-së, ku renditen emrat e dhjetë personave nga Luboteni që iu dorëzuan stacionit policor të Mirkovcit, figurojnë të regjistruara po këto tri armë dhe po ky municion, së bashku me numrat e serisë dhe kalibrin e tyre.[663] Një dokument i titulluar "Akuza Penale kundër Nevaip Bajramit" i datës 13 gusht 2001, përmend gjithashtu emrat e po këtyre dhjetë individëve nga Luboteni, si dhe bën një përshkrim të rrethanave në funksion të pretendimit se këta individë kishin përdorur "armë zjarri" gjatë veprimeve luftarake kundër forcave të IRJM-së, se "armët e zjarrit dhe municioni për këtë operacion" ishin dhënë nga "të njëjtët persona", dhe se individët e përmendur në listë kishin braktisur operacionet në orën 12:00, duke lënë pas "armët dhe pajisjet" për të "shmangur

659 *Shih,* për shembull, Provën Materiale 1D25 (e njëjta si 2D31); *Shih* më lart, para. 155.
660 *Shih* më poshtë, para. 379.
661 *Shih* më lart, para. 69.
662 *Shih* më poshtë, para. 336.
663 Prova Materiale P108.

përgjegjësinë" për veprimet e tyre terroriste.[664] Raportet e mëvonshme për konfiskimin e pikërisht këtyre armëve dhe municioneve, pasqyrojnë faktin se këto armë dhe municione iu atribuan zyrtarisht personave që ishin fshehur në bodrumin e Adem Ametovskit, ndër të cilët, Nevaip Bajrami,[665] M017, [666] Vehbi Bajrami,[667] dhe Atulla Qaili.[668] Dhoma Gjyqësore vë në dukje dëshminë e Blagoja Toskovskit lidhur me raportet për konfiskimin e këtyre armëve, të nënshkruara në praninë e tij, sipas tij; dëshmitari sugjeroi se megjithëse këta individë mohuan që armët dhe municionet u përkisnin atyre, pasi dëshmitari u paraqiti "argumentat," d.m.th. u tha se provat e parafinës me dorashkë kishin dalë pozitive, asnjë prej tyre nuk refuzoi të nënshkruante vërtetimin për konfiskimin e armëve.[669] Dhoma Gjyqësore vë gjithashtu në dukje dëshminë e Eli Çakarit, e cila tha se Boshkoski i kishte thënë personalisht në shtëpinë e Bracës se armët që kishte filmuar ajo u ishin kapur "terroristëve të arrestuar."[670] Sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, ekziston një farë paqartësie lidhur me dëshmitë se këto tri armë dhe municioni u gjetën në fushë pranë kufomave të tre personave të lartpërmendur. Edhe sikur të ketë ndodhur kështu, po këto tri armë dhe municioni u përdorën si prova kundër personave të tjerë të arrestuar në momente të tjera dhe në vende të ndryshme në fshat.

161. Megjithëse e vetëdijshme për dallimet dhe mospërputhjet e shumta në dëshmitë (disa prej tyre do të diskutohen më poshtë), mosbesueshmërinë e demonstruar të disa prej dëshmitarëve, moskëqyrjen e hollësishme të zonës atë ditë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundimin se mëngjesin e 12 gushtit pati të shtëna kundër policisë apo ushtrisë, nga një apo më shumë shtëpi të familjes Jashari. Gjithsesi, duke marrë parasysh të gjitha dëshmitë përkatëse, duhet lënë hapur mundësia e të shtënave me armë zjarri kundër policisë në fshat, apo kundër pozicioneve të ushtrisë në Smok dhe Bomba, ose kundër të dyjave. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se ka rezerva të forta për dëshmitë sipas të cilave nga ky pozicion u hap zjarr, madje edhe me mitraloz, dhe nuk është e bindur se një gjë e tillë ka ndodhur. Provat e ushtrisë tregojnë se këto shtëpi mbaheshin nën

664 Prova Materiale P31, f. 2, 4.
665 Blagoja Toskovski, T 4309; Prova Materiale P46, ERN 0463-8819.
666 Blagoja Toskovski, T 4311; Prova Materiale P30; *shih* gjithashtu Provën Materiale P46, ERN 0463-8827; M017, T 652; 666-670; 730.
667 Prova Materiale P46.20; *shih* gjithashtu Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 4.
668 M083, T 1391-1392; Prova Materiale P46, ERN 0463-8879; *shih* gjithashtu Provën Materiale P23.
669 Blagoja Toskovski, T 4312-4313.
670 Eli Çakar (Eli Čakar), Prova Materiale P441, para. 25.

mbikqyrje të rreptë. Megjithatë, atë mëngjes policia nuk gjeti në to asnjë mitraloz që mund të përdorej për të qëlluar kundër pozicioneve të ushtrisë në Smok dhe Bomba më tepër se 800 metra larg. Gjithashtu kur vizitoi shtëpitë e Jasharëve më 14 gusht, Henry Bolton nuk gjeti asnjë provë gëzhojash plumbi të përdorura nga një armë e tillë.[671]

162. Lidhur me dëshmitë që pretendojnë se pati të shtëna nga pjesa verilindore e fshatit, Dhoma Gjyqësore vë në dukje se disa dëshmitarë, kur iu kërkua të shënonin në fotografi zonat nga ku kishte patur të shtëna, shënuan me rreth zona të gjera ku përfshinë shtëpitë e identifikuara të anëtarëve të familjes Jashari, si dhe shtëpi të tjera, duke përfshirë atë të Adem Ametovskit,[672] që gjendej në krye të rrugës që çonte në Rashtak. Siç është diskutua më hollësisht gjetkë, më 12 gusht disa persona u strehuan në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit.[673] Mbrojtja nuk pretendon se kjo shtëpi ishte pozicion i UÇK-së. Nuk ka prova për të shtëna nga shtëpia e Adem Ametovskit më 12 gusht. Kjo shtëpi dhe ndërtesat e tjera në të njëjtin oborr, u bastisën nga policia atë mëngjes, por në to nuk u gjetën armë, municion, pajisje të tjera ushtarake apo uniforma ushtarake. Henry Bolton dëshmoi se më 14 gusht ai gjeti një çifte "për gjueti shpendësh" nën një stol, në bodrumin e shtëpisë së Ametovskit, por atij nuk iu duk se arma ishte përdorur. Ajo nuk ishte armë ushtarake. Dhoma Gjyqësore konkludon kjo armë nuk u përdor më 12 gusht.

163. Sipas Mbrojtjes, një pozicion tjetër i UÇK-së ishte në varrezë apo aty pranë, prej të cilit pretendohet se UÇK-ja hapi zjarr kundër forcave maqedonase.[674] Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se kundër ushtrisë është hapur zjarr me pushkë snajper dhe, ndoshta, me mortajë nga varreza[675] në periferi të fshatit, apo më saktësisht, nga një pyll i

---

671 Dhoma Gjyqësore pranon mundësinë teorike se të gjitha provat për mitralozin që kishte hapur zjarr mund të jenë zhdukur deri më 14 gusht dhe merr parasysh faktin se nuk u bë asnjë kontroll i hollësishëm. Dhoma Gjyqësore thekson se automatikuTompson i Luftës së Dytë Botërore apo model më i hershëm për luftime këmbësorie nga afër, që pretendohet se u gjet në fushën pranë shtëpisë së Qani Jasharit, nuk mund të jetë përdorur për të hapur zjarr me sukses kundër Smok-ut apo Bomba-s, të cilat ishin më larg rrezes së qitjes së kësaj arme nga shtëpitë e familjes Jashari. Dhoma Gjyqësore merr parasysh faktin se në Aktakuzë Prokuroria pranon praninë, të së paku, një mitralozi në fshat.

672 M052, T 8546-8551; Prova Materiale 2D83; M053, T 1986-1988; Prova Materiale 2D26; M084, T 1494-1495; 1504-1506; 1516; Provat Materiale 2D22, 2D23; *shih* gjithashtu M039, që shpjegon vendndodhjen e shtëpisë së Adem Ametovskit në raport me shtëpinë e Qani Jasharit, T 1121-1122 dhe Prova Materiale P201.

673 *Shih* më lart, para. 50.

674 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 203.

675 M2D-008, T 10548-10549; Prova Materiale 2D97; Marijo Jurishiq dëshmoi se ushtria gjuajti disa predha në drejtim të pyllit të vogël pranë varrezës; mirëpo, deri më sot ai nuk është i sigurtë nëse mortaja ishte vendosur atje apo jo, T 3326; *shih* gjithashtu Provën Materiales P306; 1D26; P160.

vogël pranë varrezës. Është dëshmuar se pas orës 11:00,[676] objektivi kryesor i Kompanisë së Dytë të Këmbësorisë ishte një mortajë 82 milimetërshe, e cila, sipas mendimit të ushtarëve, po qëllonte kundër pozicioneve të kompanisë nga pylli i vogël pranë varrezës.[677] Dhoma Gjyqësore pranon se ushtria hapi zjarr me mortaja në drejtim të pyllit, ndoshta si përgjigje ndaj të shtënave që dyshoheshin se vinin nga ai vend. Mirëpo nuk është e qartë nëse ka patur të shtëna me mortaja. Lidhur me këtë aspekt, Dhoma Gjyqësore i referohet dëshmisë së Marijo Jurishiqit sipas të cilit megjithëse "tingulli dhe kohëzgjatja" e fluturimit të predhës "përputhen afërsisht" me konkluzionin se predhat vinin nga drejtimi i varrezës, deri më sot ky dëshmitar ende nuk është i sigurtë që në atë vend ndodhej me të vërtetë një mortajë.[678] Asnjë armë e tillë nuk u gjet apo identifikua. Më vonë gjatë paradites, pozicionet e ushtrisë mund të jenë goditur nga pika të tjera në male ku ishin vendosur forca të UÇK-së, të armatosura me mortaja. Sipas dëshmive të tjera, në mëngjesin e 12 gushtit, pozicionet e ushtrisë në kodrat mbi Luboten u goditën nga pika *jashtë* Lubotenit, dhe pikërisht nga Jecmenista, Kulmi, Mateçi, Stanet e Rashtanit, Guri i Bardhë,[679] dhe, sipas përfundimit të Dhomës Gjyqësore, ka shumë të ngjarë, edhe nga një kodër mbi Luboten të quajtur Pop Cesme.[680] Atë ditë ushtria hapi zjarr të dendur me mortaja dhe topa kundër UÇK-së në kodra. Muzafer Agushi, anëtar i UÇK-së, u vra më 12 gusht në një pozicion të UÇK-së mbi Luboten, pranë Bashinecit.[681] Bashineci është në drejtim të Pop Cesmes.[682]

164. Në fshat nuk kishte fortifikime më 12 gusht.[683] Ky fakt nuk është domosdoshmërisht përcaktues për mospraninë e luftëtarëve të UÇK-së, për arsye se fortifikimet konvencionale prej thasëve me rërë mund të dallohen lehtësisht nga një largësi prej një kilometër dhe rrjedhimisht, mund të mos jenë ngritur fortifikime të

676 Prova Materiale 1D26.
677 Marijo Jurishiq, T 3325-3326; M2D-008, T 10548.
678 Marijo Jurishiq, T 3326.
679 Nikollçe Grozdanovski, T 10459-10463; 10429; 10436; 10524; Prova Materiale P595; *shih* gjithashtu Provën Materiale 2D45; Marijo Jurishiq, T 3324; Prova Materiale P305, f. 4; Prova Materiale P306; Mitre Despodov, T 2584; 2675-2676; 2547-2548; Prova Materiale P298.
680 M092 konfirmon pasi kishte dëshmuar, në para. 22 të deklaratës së tij *92bis*, se besonte se "ndoshta" UÇK-ja po qëllonte me mortaja llogoreje nga Pop Cesma kundër Hermelinës pranë shtëpisë së Qani Jasharit, T 1316; Prova Materiale P215, para. 22, 31, 33. Mirëpo pak më vonë në dëshminë e tij, dëshmitari sugjeron se në Pop Cesme nuk kishte patur pozicion të UÇK-së, T 1325.
681 M092, T 1318; 1329; Prova Materiale P215, para. 34; Ismail Ramadani, T 1013; 1015; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D7, f. 6, ku në listë përfshihet emri i Muzafer Agushit si dëshmor që u vra në Luboten.
682 M092, T 1324.
683 Nikollçe Grozdanovski, T 10411; 10452; 10469; Peter Bouckaert, Prova Materiale P322, para. 41; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D30.

tilla.[684] Për më tepër, shtëpitë dhe muret ashtu siç ishin ndërtuar, mund të përdoreshin si fortifikime.[685] Shumë dëshmitarë thanë se muret e larta të shtëpive të shqiptarëve shërbenin si fortifikime natyrale.[686] Gjithsesi, Henry Bolton dëshmoi se në fshat nuk kishte parë ndonjë fortifikim tipik si ato që kishte parë në vende të tjera në IRJM.[687]

165. Henry Bolton dëshmoi se më 14 gusht, në fshat, përgjatë rrugës që çonte në shtëpitë e Jasharëve, rrugë e cila vazhdonte në drejtim të Rashtakut,[688] ai pa qindra gëzhoja municioni 7.62,[689] si dhe tre gypa mortaje RBR 64 milimetërsh M-80.[690] Gëzhojat 7.62 milimetërshe përdoren për Kallashnikov, me të cilat ishin të armatosur policia, ushtria, dhe UÇK-ja. Z. Bolton pa se këto gëzhoja ishin të shpërndara në një zonë të gjerë, kryesisht në pika në të cilat qitësi ishte pozicionuar për t'u mbrojtur nga plumbat që mund të vinin nga drejtimi i lindjes. Prej këtij fakti dëshmitari kuptoi se qitjet me armë zjarri ishin sipas një trajektoreje përgjatë rrugës nga perëndimi, d.m.th., sipas së njëjtës trajektore, sipas provave të tjera, të lëvizjes së policisë dhe autoblindës Hermelinë. Në anën lindore nuk kishte gëzhoja, të cilat dëshmitari do t'i kishte parë atje po të kishte patur shkëmbim zjarri.[691] Ai konstatoi gjithashtu se shenjat e e plumbave në objekte të forta në anë të rrugës, ishin në anën perëndimore të këtyre objekteve, fakt që i tregoi dëshmitarit se plumbat kishin ardhur nga ana perëndimore.[692] Kjo dëshmi, megjithëse e rëndësishme, nuk është e pakundërshtueshme. Z. Bolton nuk shkoi në fshat deri më 14 gusht. Nuk pati asnjë këqyrje të hollësishme nga ndonjë dëshmitar më 12 gusht. Konstatimet e Z. Bolton ishin rezultat i vëzhgimeve të përgjithshme, jo rezultat i ndonjë hetimi të plotë dhe të hollësishëm.

---

684 M051, T 4250.

685 M051 iu referua fortifikimeve që pa nga pozicionet e ushtrisë mbi fshat. Mirëpo duket se në fakt ai u referohej shtëpive dhe mureve nga të cilat, siç u pretendua, ishte qëlluar, T 4171-4172.

686 Nikollçe Grozdanovski, T 10452; M051, T 4169-4170; 4172; Mitre Despodov, T 2636; 2686-2687; Marijo Jurishiq, T 3351-3352.

687 Henry Bolton, T 1629.

688 Henry Bolton, T 1627; Prova Materiale P238, OSCE Spot Report /Raporti i OSBE-së nga Terreni/, 15 gusht 2001, f. 2.

689 Henry Bolton, T 1629-1630.

690 Henry Bolton shpjegoi se një RBR është një armë kundërtanke ruse që përdoret duke u mbajtur në shpatull dhe e cila nuk mund të rimbushet, T 1627; *shih* gjithashtu Provën Materiale P238, f. 2; *shih* gjithashtu Provën Materiale P304, e cila përmend shpërndarjen e mortajave një grupi personash që ishin grumbulluar në shtëpinë e Johan Tarçulovskit më 10 gusht.

691 Henry Bolton, T 1629-1630.

692 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 13.

166. Më 12 dhe 13 gusht policia bëri provën e parafinës me dorashkë të një grupi banorësh të Lubotenit, duke përfshirë disa dëshmitarë dhe viktima në këtë çështje gjyqësore, për të përcaktuar nëse kishin përdorur armë zjarri.[693] Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga dy dëshmitarë ekspertë lidhur me mangësitë e provës së parafinës me dorashkë. Dr Zlatko Jaqovski dëshmoi se një test i tillë mund të provojë vetëm praninë e nitratit dhe nitritit në dorë. Mirëpo këto substanca, përveç se gjenden në barut, ndër të tjera mund të gjenden edhe në plehra kimike si dhe tek njerëzit që pinë cigare. U dëshmua se për të përcaktuar nëse një person ka qëlluar me armë zjarri, është e nevojshme të kryhet qitje provë me të njëjtën armë dhe të analizohet mënyra e depozitimit të mbetjeve të barutit.[694] Për shkak të problematikës lidhur me saktësinë e provës së parafinës me dorashkë dhe, duke u nisur vetëm nga rezultatet e kësaj prove, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundim të prerë nëse ndonjë nga banorët e Lubotenit, që iu nënshtruan testit policor të parafinës me dorashkë pas operacionit në Luboten, ka qëlluar me armë më 12 gusht. Më tej, lidhur me këtë aspekt, Dhoma Gjyqësore vë në dukje se, sipas dëshmive policore, nuk u arrit të siguroheshin rezultate të provës së parafinës me dorashkë nga 10 persona të kapur që ishin fshehur në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit, pasi, siç u tha, kishte patur një "ndotje të madhe" të "fletëve" të përdorura për provën.[695] Me fjalë të tjera, këta persona u testuan, por, siç u tha, nuk u siguruan rezultate të besueshme, pasi fletët e testeve ishin të ndotura, rastësi tejet habitëse po të kihet parasysh fakti se policia këmbëngulte që këta persona ishin terroristë si dhe fakti që të tri armët dhe municioni i kapur u ishin atribuar, siç duket, me qëllim gabimisht personave të fshehur në bodrumin e Adem Ametovskit.

167. Është për t'u nënvizuar se asnjë anëtar i policisë apo ushtrisë nuk u vra apo u plagos. I vetmi dëm që pësoi policia ishte vetëplagosja aksidentale e një polici rezervist. Fakt habitës, që përbën arsye shtesë për të qenë të kujdesshëm në pranimin e dëshmive për hapje zjarri nga brenda fshatit kundër policisë dhe pozicioneve të ushtrisë, veçanërisht me mitraloz. Gjithashtu të vetmet armë të UÇK-së, që siç pretendohet u

693 *Shih* më lart, para. 77; *shih* Provën Materiale 1D146, në të cilin janë nënvizuar emrat e banorëve të Lubotenit për të cilët prtendohet se rezultuan pozitiv në provë.

694 Zllatko Jaqovski, T 2293-2294; Simon Eichner, T 4456; 4490.

695 *Shih* Provën Materiale P46.17. Kur u ballafaqua me fletët e kontaminuara të këtyre individëve, Blagoja Toskovski dëshmoi se kishte patur edhe një hetim shtesë dhe se prova e parafinës me dorashkë kishte rezultuar pozitive; i pyetur ku ishin këto rezultate, dëshmitari u përgjigj se ato i ishin dërguar Prokurorisë Publike, T 4418-4419.

gjetën nga policia në fshat më 12 gusht 2001, ishin dy pushkë Kallashnikov dhe një automatik i vjetër Tompson, si dhe municion për këto armë.

4. Konkluzion

168. Më sipër në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore ka theksuar se për arsyet e dhëna nuk mund të pranojë si të vërteta aspekte të rëndësishme të dëshmisë së majorit Despodov i cili, u përpoq të mohonte veçanërisht se njësitë e tij kishin hapur zjarr kundër Lubotenit më 10 gusht dhe të distanconte vetveten dhe njësitë e tij prej veprimeve të policisë në Luboten më 12 gusht. Majori Despodov ishte komandant i dëshmitarëve të ushtrisë, të cilët dhanë dëshmi për operacionin e ushtrisë dhe veprimet e vëzhguara në Luboten, veçanërisht më 12 gusht. Elementi kryesor i këtyre dëshmive ishte se ushtria hapi zjarr nga pozicionet e saj vetëm kundër objektivave konkrete të identifikuara në Luboten, në përgjigje të zjarrit të vëzhguar që erdhi nga këto objektiva, dhe se ushtria kishte vepruar vetëm në përputhje me urdhrat e përhershëm në fuqi (d.m.th. të hapte zjarr vetëm në përgjigje të zjarrit) dhe në mënyrë krejt të pavarur nga policia.

169. Mirëpo në kundërshtim me këto dëshmi, Dhoma Gjyqësore pranon dhe konkludon se majori Despodov, dhe, nëpërmjet tij, edhe njësitë e tij, kishin dijeni për operacionin policor në Luboten më 12 gusht, se duke filluar nga 10 gushti i dhanë mbështetje njësisë policore që do të kryente operacionin dhe se mbështetën në mënyrë të drejtpërdrejtë operacionin policor më 12 gusht me zjarr artilerie prej mortajave kundër fshatit në fazën fillestare. Në këtë kuadër, pasi shqyrtoi me kujdes dëshmitarët e ushtrisë dhe vlerësoi dëshmitë e tyre dhe dëshmitë e tjera të kundërta, Dhoma Gjyqësore vendosi të mos pranojë aspekte të konsiderueshme të dëshmive të dhëna nga oficerë dhe persona nën komandën e majorit Despodov, veçanërisht kapitenit Grozdanovski, togerit Jurishiq dhe M2D-008.

170. Dhoma Gjyqësore konstaton se dëshmitë e dhëna nga anëtarët e ushtrisë të dislokuar në zonën e Lubotenit dhe raportet e përgatitur prej tyre në kohën e ngjarjeve, nuk përputhen në shumë pika me dëshmitë e tjera, veçanërisht me ato të dhëna nga banorët e fshatit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë. Siç u theksua më sipër, në disa nga zonat të cilat sipas ushtrisë ishin objektiva, nuk është konstatuar zjarr mortajash apo topash dhe

as dëme prej të shtënash të tilla. Sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, raportet ushtarake u sajuan për të treguar se në disa raste ishte qëlluar nga fshati kundër pozicioneve të ushtrisë, dhe se ushtria i është përgjigjur një zjarri të tillë. Në fakt, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se zjarri që hapi ushtria me mortaja kundër një pjese shqiptare të fshatit nuk ishte si përgjigje ndaj të shtënave të ardhura nga fshati, dhe se pas kësaj, ndërkohë që policia hyri në fshat, zjarri i mortajave dhe topave të ushtrisë u përqëndrua kryesisht në objektiva jashtë fshatit, duke përfshirë një vend pranë varrezës.

171. Për arsyet e diskutuara më parë, Dhoma Gjyqësore nuk pranon se ka patur të shtëna nga ndonjë vend pranë kishës ortodokse në fshat, apo se të shtënat me mortaja prej ushtrisë kundër këtij vendi ishin si përgjigje ndaj të shtënave të UÇK-së apo të shtënave që mendohej se vinin nga UÇK-ja. Dhoma Gjyqësore pranon se personeli i ushtrisë mund të ketë menduar se të shtënat erdhën nga një shtëpi afër urës së fshatit si dhe nga një shtëpi afër xhamisë në zonën që bashkohet me një zonë tjetër të quajtur Dolno Maalo, megjithëse Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të konkludojë se ka patur me të vërtetë të shtëna nga këto vende mëngjesin e 12 gushtit. Sipas përfundimit të Dhomës Gjyqësore, mbetet e hapur mundësia që, kundër policisë apo pozicioneve të ushtrisë Smok dhe Bomba, apo kundër të dyjave, të jetë hapur zjarr nga vendi ku ishin shtëpitë e familjes Jashari në të dalë të fshatit, në rrugën për në Rashtak, megjithëse Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë se ndër këto të shtëna pati edhe zjarr mitralozi. Dhoma Gjyqësore pranon se ushtria e përqëndroi granatimin me mortaja kundër një pylli të vogël pranë një varreze në periferi të fshatit, dhe se kjo mund të ketë ndodhur si përgjigje ndaj të shtënave që u dyshua se vinin nga ai vend.

172. Përndryshe, dëshmitë nuk konfirmojnë mendimin se policia hasi në vatra të tjera qëndrese në Luboten më 12 gusht 2001. Në fshat ishte një numër i kufizuar i anëtarëve të UÇK-së, megjithëse, sipas dëshmive, policia nuk hyri në të gjitha pjesët e fshatit dhe nuk mund të arrihet ndonjë përfundim mbi vendndodhjen e tyre. Numri i anëtarëve të UÇK-së në fshat ishte shumë më i vogël se ai i njësisë policore të armatosur mirë. Ndoshta anëtarët e UÇK-së vendosën të bënin qëndresë të armatosur të pakët, pasi gjendja e tyre dukej e pashpresë. Anëtarët e UÇK-së mund të kenë qenë midis atyre banorëve të fshatit që u përpoqën të largoheshin nga fshati gjatë ditës. Përveç ngjarjeve në zonën e shtëpive

të familjes Jashari, nuk ka dëshmi që tregojnë se veprimet e policisë që kanë lidhje me akuzat në këtë Aktakuzë, ishin vetëmbrojtje apo përgjigje ndaj kundërshtarëve të armatosur, dhe nuk ekziston bazë as për ndonjë dyshim të arsyeshëm se kjo mund të ketë qenë e vërtetë.

V. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË NENIT 3 TË STATUTIT

173. Secili nga të Akuzuarit akuzohet për tri pika të shkeljeve të ligjeve apo zakoneve të luftës, në bazë të Nenit 3 të Statutit, dhe konkretisht për vrasje, shkatërrim pa shkakr të qyteteve dhe fshatrave të papërligjur prej domosdoshmërisë ushtarake, si dhe për trajtim mizor.[696] Zbatueshmëria e Nenit 3 të Statutit kërkon plotësimin e disa kushteve paraprake. Përveç kushtit që këto krime duhet të mbulohen nga kjo dispozitë, duhet të vërtetohet se ka patur një konflikt të armatosur, ndërkombëtar apo të brendshëm, në kohën e mbuluar nga Aktakuza dhe se veprimet e të Akuzuarve kanë lidhje të ngushtë me këtë konflikt të armatosur.[697]

174. Siç është diskutuar gjetkë në këtë Aktgjykim,[698] mocionet e dy të Akuzuarve që kundërshtojnë jurisdiksionin e Tribunalit, të bazuara në argumentin se nuk ka patur konflikt të armatosur në IRJM në vitin 2001, u hodhën poshtë me vendim të Dhomës Paragjyqësore,[699] vendim i cili u la në fuqi më pas edhe nga Dhoma e Apelit.[700] Siç pohohet në këto vendime, çështja nëse ka patur apo nuk ka patur konflikt të armatosur në këtë periudhë, vërtetohet si fakt prej Dhomës Gjyqësore pasi kjo dëgjon dhe analizon provat e paraqitura në procesin gjyqësor.[701]

A. <u>Konflikti i armatosur</u>

1. <u>Ligji</u>

175. Kushti përcaktues për ekzistencën e një konflikti të armatosur u përcaktua prej Dhomës së Apelit në Vendimin *Tadiq* për Juridiksionin "Konflikt i armatosur ekziston sa herë që përdoret forca e armatosur midis shteteve ose dhunë e armatosur e zgjatur midis

---

696 Aktakuza, para. 23, 25 dhe 42.

697 *Tadić* Jurisdiction Decision/Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*, para. 70.

698 *Shih* më poshtë, *para.* 611.

699 *Prokurori kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Decision on Johan Tarčulovski's Motion Challenging Jurisdiction", 1 June 2005/"Vendim për Mocionin e Tarçulovskit që Kundërshton Juridiksionin," 1 qershor 2005.

700 *Prokurori kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Çështja IT-04-82-AR 72.1, "Decision on Interlocutory Appeal on Jurisdiction", 22 July 2005/"Vendim për Apelin e Ndërkohshëm në lidhje me Juridiksionin," 22 korrik 2005.

701 *Prokurori kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Çështja. IT-04-82-PT, "Decision on Johan Tarčulovski's Motion Challenging Jurisdiction", 1 June 2005, para. 11; *Prokurori kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Çështja IT-04-82-AR 72.1, "Decision on Interlocutory Appeal on Jurisdiction", 22 July 2005, para. 13.

autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara, ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti."[702] Ky kusht është zbatuar pandryshueshmërisht në jurisprudencën e mëvonshme.[703] Duke patur parasysh rrethanat e asaj çështjeje gjyqësore, në vërtetimin e ekzistencës së një konflikti të armatosur të brendshëm, Dhoma *në Tadiq* e interpretoi këtë kusht sipas dy kritereve: (i) ashpërsia e konfliktit dhe (ii) organizimi i palëve në konflikt[704] për të dalluar konfliktin e armatosur nga "banditizmi, kryengritjet e paorganizuara dhe jetëshkurtra, ose veprimtaritë terroriste që nuk trajtohen prej së drejtës humanitare ndërkombëtare.[705] Kjo qasje është zbatuar në aktgjykimet e mëvonshme, megjithëse nuk duhet harruar kushti i dhunës së armatosur së zgjatur në një konflikt të brendshëm, kur bëhet vlerësimi i ashpërsisë së konfliktit.[706] Këta kritere janë të ndërlidhur.[707] Ata kanë të bëjnë me çështje faktuale, të cilat duhet të vërtetohen mbi bazën e provave ekzistuese dhe rast pas rasti.[708]

176. Dhoma Gjyqësore në çështjen *Tadiq* vuri në dukje se faktorët që lidhen me këtë përcaktim janë trajtuar në Shpjeguesin e Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës.[709] Këto "kritere të përshtatshme" u identifikuan nga hartuesit e Nenit të

---

[702] Vendimi për Juridiksionin *Tadiq,* para. 70.

[703] *Tadić* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 561-562; *Čelebići* Trial Judgement/ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 183-185; *Krnojelac* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërnojelac*, para. 51; *Kunarac* Appeals Judgement/Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 56; *Kordić* Appeals Judgement/Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 336; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 83-84; *Naletilić* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Naletiliq*, para. 225; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 37-38.

[704] *Shih* Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 562; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 184; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 84; *Mrkšić* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 407.

[705] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 562.

[706] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 184; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq, para.* 341; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 84; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 38.

[707] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 562.

[708] *Rutaganda* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Rutaganda*, para. 93; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 90; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 407.

[709] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 562. Shpjeguesi i KNKK-së Konventës së Gjenevës I, f. 49-50. Këto "kritere të përshtatshme" (të cilat nuk janë aspak të detyrueshme) janë:

1. që pala rebele të ketë një forcë të organizuar ushtarake, një autoritet përgjegjës për aktet e saj, të veprojë brenda një territori të caktuar si dhe të ketë mjetet për të zbatuar dhe garantuar zbatimin e Konventës.
2. Qeveria ligjore është e detyruar të përdorë forcat e rregullta ushtarake kundër kryengritësve, të cilët janë të organizuar si forcë ushtarake dhe kontrollojnë një pjesë të territorit të vendit.
3.
   a. Qeveria *de jure* ka njohur kryengritësit si palë ndërluftuese; ose
   b. se pretendon vetë se ka të drejtat e një pale ndërluftuese; ose
   c. se i ka njohur kryengritësit si palë ndërluftues vetëm për qëllimet e konventës; ose
   d. se konflikti është përfshirë në rendin e ditës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo Asamblesë së Përgjithshme si kërcënim ndaj paqes, shkeljes së paqes, apo si akt agresioni.
4.
   a. Kryengritësit kanë një organizim që priret të ketë karakteristikat e një Shteti
   b. Autoriteti civil i kryengritësve ushtron pushtet *de facto* ndaj popullsisë brenda territorit të caktuar.

Përbashkët 3 gjatë negociatave të Konventave të Gjenevës, me qëllim që të bëhej dallimi midis një konflikti të armatosur dhe formave më pak të ashpra të dhunës, megjithëse nuk u përfshinë në tekstin përfundimtar.[710] Megjithëse kriteret ofrojnë disa tregues të dobishëm për konfliktin e armatosur. ata janë vetëm ilustrues.[711] Hartuesit e Shpjeguesit ishin të mendimit se Neni i Përbashkët 3, duhet të zbatohet sa më gjerësisht dhe se ky nen mund të zbatohej edhe në rastet kur "në një vend shpërthen një konflikt i armatosur, i cili nuk plotëson asnjë nga kushtet e lartpërmendura."[712] Dhoma Gjyqësore në *Limaj*, pasi shqyrtoi historinë e hartimit të Nenit të Përbashkët 3, arriti në konkluzionin se "hartuesit e Konventave të Gjenevës nuk synonin shprehimisht kërkesa të tilla për zbatimin e Nenit të Përbashkët 3."[713] Në përputhje me këtë qasje, Dhomat Gjyqësore kanë vlerësuar ekzistencën e konfliktit të armatosur duke iu referuar treguesve objektivë si ashpërsia e luftimeve dhe organizimi i grupit apo grupeve të armatosura pjesëmarrëse, në varësi të fakteve për secilin rast. Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë sesi është vlerësuar konkretisht secili prej këtyre kritereve.

(a) Ashpërsia

177. Për të vlerësuar "ashpërsinë" e konfliktit, Dhoma Gjyqësore ka marrë në konsideratë tregues të ndryshëm. Këtu përfshihen ashpërsia e sulmeve dhe fakti nëse ka patur shtim të numrit të përleshjeve të armatosura,[714] përhapja e përleshjeve anembanë territorit dhe gjatë një periudhe të caktuar kohore,[715] rritja e mundshme e numrit të forcave qeveritare dhe mobilizimi dhe shpërndarja e armëve midis dy palëve të përfshira

c. Forcat e armatosura veprojnë nën drejtimin e autoritetit të organizuar civil dhe janë të gatshme të respektojnë ligjet e zakonshme të luftës.
d. Autoriteti civil i kryengritësve pranon të respektojë dispozitat e Konventës.

710 Shpjeguesi i KNKK-së Konventës së Gjenevës I, f. 49-50. Dhoma Gjyqësore e TPNR-së në *Akayesu* iu referua këtyre kritereve kur shqyrtoi nëse ka patur konflikt të brendshëm civil në Ruanda në vitin 1994. *Akayesu* Trial Judgement, para 619/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Akayesu*, para. 619.

711 Në *Milošević* Rule 98*bis* Decision/Vendimi *Millosheviq* i Rregullës 98*bis*, Dhoma Gjyqësore theksoi në paragrafin 19 se "Shpjeguesi i KNKK-së nuk është gjë tjetër përveç se çfarë synon të jetë, d.m.th., shpjegues, dhe ka vetëm vlerë bindëse."

712 Shpjegues i KNKK-së Konventës së Gjenevës I, f. 50.

713 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 86.

714 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 565; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 189; Vendimi *Millosheviq* i Rregullës 98*bis*, para. 28; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 340; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 91 dhe 99.

715 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 566; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 186; Vendimi *Millosheviq* i Rregullës 98*bis*, para. 29; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 340-341; *Halilović* Trial Judgement, paras 163-166/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haliloviq*, para. 163-166, 169; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 168, 169. *Shih* gjithashtu para. 136-163; *Hadžihasanović* Trial Judgement, paras 20, 22Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq*, para. 20, 22; *Martić* Trial Judgement, para 344/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, para. 344.

në konflikt,[716] si dhe nëse konflikti ka tërhequr vëmëndjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe nëse janë miratuar rezoluta për këtë konflikt.[717] Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu parasysh në këtë kontekst numrin e civilëve të detyruar të largohen nga zonat e luftimit;[718] llojin e armëve të përdorura,[719] veçanërisht përdorimin e armëve të rënda,[720] dhe pajisjeve të tjera ushtarake, si tanke dhe automjete të tjera të rënda;[721] bllokimin dhe rrethimin e qyteteve dhe granatime të rënda të këtyre qyteteve;[722] masën e shkatërrimeve[723] dhe numrin e të vrarëve dhe të lënduarve nga granatimet apo luftimet;[724] sasinë e trupave dhe njësive të dislokuara;[725] ekzistencën dhe lëvizjen e vijave të frontit midis palëve;[726] pushtimin e territorit,[727] dhe qyteteve dhe fshatrave;[728] dislokimin e forcave qeveritare në zonën e krizës;[729] mbylljen e rrugëve;[730] urdhrat dhe marrëveshjet për armëpushim,[731] dhe përpjekjet e përfaqësueve të organizatave ndërkombëtare për të ndërmjetësuar dhe imponuar zbatimin e marrëveshjeve të armëpushimit.[732]

---

716 Vendimi *Milloshevi*q i Rregullës 98*bis*„ para. 30-31. *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 188.

717 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 567; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 190; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, para. 345; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 49.

718 Sepse ata janë evakuuar (Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 340), dëbuar (Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 565), kërcënuar (Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 139), apo shpërngulur (Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 167, *shih* gjithashtu para. 142); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 49 and 97.

719 Vendimi *Milloshevi*q i Rregullës 98*bis*, para. 31; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 166; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 49.

720 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 565 ("granatim me artileri"), Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 166; *shih* gjithashtu para. 136, 138, 156, 158, 163.

721 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 143 ("granatime të rënda pasuar prej avancimit të tankeve dhe këmbësorisë"); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*q, para. 166 ("sulm me tanke, mortaja, dhe këmbësori"); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 136, 166.

722 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 143 (bllokada e Kozaracit); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*q, para. 165-167 (bllokada e Mostarit), 168 (rrethimi i Sarajevës); *shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 153; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 96.

723 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 565; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 337-338; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj* para. 142; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 49.

724 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 565; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq,* para. 339; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*q, para. 164; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 142; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 49.

725 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*q, para. 168; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 49.

726 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*q, para. 161, 169, 172.

727 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*q, para. 163; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 146, 158.

728 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*q, para. 162, 164; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 143, 163.

729 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 142, 150, 164, 169.

730 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 144.

731 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanovi*q, para. 23; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, para. 345.

732 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanovi*q, para. 23.

178. Në kontekstin sistemor, një tregues i konfliktit të brendshëm të armatosur është mënyra e përdorimit të forcës kundër grupeve të armatosura prej organeve shtetërore si policia dhe ushtria.[733] Në raste të tilla, për të konkluduar nëse ekziston konflikt i armatosur mund të jetë e dobishme analiza e përdorimit të forcës nga autoritetet qeveritare dhe, veçanërisht, si janë zbatuar disa të drejta të njeriut, si e drejta për jetën dhe e drejta për të mos u arrestuar arbitrarisht.[734] Siç dihet, në rastet që nuk mund të cilësohen si konflikt i armatosur, shteti ka të drejtë të përdorë forcën, përfshirë edhe atë vdekjeprurëse, për ruajtjen e rendit dhe të ligjit. Mirëpo të drejtat e njeriut, aty ku zbatohen, kufizojnë përdorimin e forcës vetëm atëhere kur është absolutisht e domosdoshme si dhe rreptësisht në proporcion me arritjen e disa objektivave të caktuara.[735] Në disa çështje gjyqësore Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konkluduar se përdorimi i forcës vdekjeprurëse kundër një personi, i cili mund të arrestohet, nuk është "absolutisht i domosdoshëm."[736] Mirëpo në rastin e një konflikti të armatosur, çështja se çfarë përbën privim arbitrar të jetës duhet të interpretohet në përputhje me standardet e të drejtës humanitare ndërkombëtare.[737] Në këtë rast zbatohet një kusht tjetër i proporcionalitetit.[738]

---

733 Kriteri i dytë i "kritereve të përshtatshme" të Shpjeguesit të KNKK-së është se qeveria legjitime është "e detyruar të përdorë forcat e rregullta ushtarake kundër kryengritësve, të cilët janë të organizuar si forcë ushtrake dhe të kontrollojë një pjesë të territorit të vendit." Shpjegues i KNKK-së Konventës së Gjenevës I, f. 50.

734 *Shih* p.sh. Arne Willy Dahl dhe Magnus Sandbu, "The Threshold of Armed Conflict /Pragu i Konfliktit të Armatosur/," *Société Internationale de Droit Militaire et de Droit de la Guerre*, 45, 3-4 (2006) f. 369. Marco Sassòli identifikon "përfshirjen e drejtpërdrejtë të forcave të armatosura qeveritare (në dallim me organet e rendit publik)" si një nga faktorët përkatës për identifikimin e konfliktit të armatosur. Marco Sassòli, "Terrorism and War /Terrorizmi dhe Lufta/," *Journal of International Criminal Justice* 4 (2006) në f. 965.

735 Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR), objektiva të tilla janë (a) vetëmbrojtje (duke përfshirë mbrojtjen e të tjerëve), (b) për të kryernjë arrestim të ligjshëm apo për të parandaluar arratisjen e një pesoni që është paraburgosur në mënyrë të ligjshme, ose (c) vendim i marrë në mënyrë të ligjshme për të shtypur një rebelimi apo kryengitjeje. Neni 2, ECHR (1950). *Shih,* p.sh. *McCann and Others v. United Kingdom*, ECtHR, App. No. 18984/91 (27 September 1995), paras 148-149: "Teksti i Nenit 2 marrë në tërësi, tregon se paragrafi 2, në thelb, nuk përcakton rastet kur lejohet të vritet një individ, por përshktuan rastet kur lejohet "përdorimi i forcës' e cila mund të rezultojë pa dashje në privimin prej jetës. Mirëpo përdorimi i forcës duhet të bëhet vetëm kur është "absolutisht i nevojshëm' për arritjen e një prej qëllimeve të përcaktuara në nënparagrafët (a), (b) ose (c) […] Në veçanti, forca e përdorur duhet të jetë rreptësisht në përpjestim me qëllimet e përcaktuara në nënparagrafët 2 (a), (b) dhe (c) të Nenit 2 (art. 2-2-a-b-c)."

736 P.sh., *McCann and Others v. United Kingdom*, ECtHR, App. No. 18984/91 (27 September 1995), paras 148-150; *Ergi v. Turkey*, ECtHR, App. No. 23818/94, (28 July 1998), para 79; dhe *McKerr v. United Kingdom,* ECtHR, App. No. 28883/95 (4 May 2001), para 110.

737 *Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons*, Advisory Opinion of 8 July 1996, ICJ Reports 1996, para 25; *Legal Consequences of a Wall in the Occupied Palestinian Territory*, Advisory Opinion of 9 July 2004, para 106. But *see* Louise Doswald-Beck, "The right to life in armed conflict: does international humanitarian law provide all the answers?", *International Review of the Red Cross* 88, 864 (December 2006), pp 881-904 (ku argumentohet se të drejtat e njeriut mund të plotësojnë rregullat e të drejtës humanitare ndërkombëtare lidhur me përdorimin e forcës në konflikte të armatosura jondërkombëtare).

738 Theksohet se edhe në rastet e konflikteve të armatosura, disa gjykata e kanë vlerësuar përdorimin e forcës në lidhje me parimin e proporcionalitetit, në bazë të standardeve të të drejtave të njeriut. Për shembull, Gjykata e

179. Mbrojtja e Boshkoskit ka argumentuar se situata në IRJM nuk arriti nivelin e kërkuar të ashpërsisë dhe e krahasoi këtë situatë në vitin 2001 pjesërisht me "trazirat" në Irlandën e Veriut, e cila, siç u argumentua, nuk u njoh asnjëherë si konflikt i armatosur në praktikën e shteteve, si dhe me përleshjet midis ushtrisë turke dhe Partisë Punëtore të Kurdistanit (PKK), "konflikt shumë më i gjerë dhe më i ashpër" i cili, sipas konkluzionit të një gjykate holandeze, nuk përbënte konflikt të armatosur.[739] Mirëpo në rastin e situatës së ushtrisë turke dhe PKK-së, nuk është i vërtetë pretendimi i mbrojtjes së Boshkoskit se Gjykata e Lartë e Holandës konkludoi se kjo situatë nuk mund të kategorizohej si konflikti i armatosur i brendshëm. Kjo gjykatë duke marrë në konsideratë kushtin e penalitetit të dyfishtë në bazë të ligjit të ekstradimit, konkludoi se ishte e panevojshme që të shprehej për këtë çështje.[740]

180. Nga ana tjetër, disa gjykata shtetërore kanë cilësuar disa situata të tjera si konflikte jondërkombëtare për të cilat zbatohet Neni 3 i Përbashkët i Konventave të Gjenevës. Në lidhje me këtë aspekt, Dhoma Gjyqësore mban parasysh faktorët që i bënë këto gjykata të arrijnë në konkluzione të tilla. Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse, në një vendim të saj të vitit 1995, u shpreh se Protokolli Shtesë II, është i zbatueshëm për

---

Lartë e Izraelit është shprehur se një civil i cili merr pjesë drejtpërdrejtë në luftime nuk duhet të vritet në rast se është e mundur të përdoren mjete më pak të dëmshme, si arrestimi, marrja në pyetje, dhe gjykimi, "rrjedhimisht, nëqoftëse një terrorist që merr pjesë drejtpërsëdrejti në luftime, mund të arrestohet, të pyetet dhe të nxirret në gjyq, këto janë mjetet që duhen përdorur." *The Public Committee against Torture in Israel et al. v. The Government of Israel et al.*, Israel, Supreme Court, Judgment of 14 December 2006, HCJ 769/02, at para 40. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk u shpreh për ekzstencën apo cilësimin e një konflikti të armatosur në Çeçeni, mirëpo lidhur me situatën theksoi se, "prania e një grupi shumë të madh luftëtarësh të armatosur në Katyr-Yurt, dhe rezistenca e tyre ndaj organeve të rendit publik […] mund të kenë justifikuar përdorimin e forcës vdekjeprurëse të autoriteteve shtetërore, duke çuar në këtë mënyrë në një situatë që mbulohet nga paragrafi 2 i Nenit 2." *Isayeva v. Russia*, ECtHR, App. No. 57950/00 (24 February 2005) para 180. *Shih edhe Isayeva, Yusupova and Bazayeva v. Russia*, ECtHR, App. Nos. 57947–49/00 (24 February 2005) para 178; *Güleç v. Turkey*, ECtHR, App. No. 21593/93 (27 July 1998) paras 71-73.

739 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 262.

740 *Në re K.*, LJN: AF6988, Gjykata e Lartë (*Hoge Raad*) 02853/02 U NS 2004, 99, në 3.3.5. Paragrafi 35 i këtij aktgjykimi, i cili citohet në Dosjen Përfundimtare të Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 262 (ku thuhet se rrethanat nuk përbëjnë konflikt të armatosur të brendshëm), është opinion i Avokatit të Përgjithshëm, jo i Gjykatës së Lartë, dhe nuk është detyrues për Gjykatën. Megjithëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë disa vendime për shkeljet e të drejtave të njeriut në Turqi lidhur me PKK-në, si dhe lidhur me Irlandën e Veriut dhe Çeçeninë, kjo gjykatë, në përputhje me kompetencën e vet institucionale, është kufizuar në trajtimin e detyrimeve ligjore të vendeve anëtare në kuadrin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe nuk ka bërë cilësimin e drejtpërdrejtë ligjor të situatave përsa i përket zbatueshmërisë së mundshme të së drejtës humanitare ndërkombëtare. *Shih*, p.sh., *McCann and Others v. United Kingdom*, ECtHR, App. No. 18984/91 (27 September 1995); *Güleç v. Turkey*, ECtHR, App. No. 21593/93 (27 July 1998); *Ergi v. Turkey*, ECtHR, App. No. 23818/94 (28 July 1998); *Isayeva, Yusupova and Bazayeva v. Russia*, ECtHR, App. Nos. 57947–49/00 (24 February 2005); *Isayeva v. Russia*, ECtHR, App. No. 57950/00 (24 February 2005).

konfliktin e armatosur në Republikën Çeçene.[741] Gjykata theksoi se përdorimi i forcave të armatosura në bazë të kushtetutës, nuk kërkonte shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme apo gjendjes së luftës, dhe se kur Duma miratoi në vitin 1994 një rezolutë për përdorimin e forcave të armatosura, ajo deklaroi se çarmatimi i njësive të rregullta të paligjshme të armatosura në republikë, të cilat ishin të armatosura me tanke, pajisje raketash, sisteme artilerike, dhe aeroplanë luftarakë, "teorikisht është i pamundur pa përdorimin e forcave të ushtrisë."[742]

181. Në Peru, Gjykata Shtetërore Penale u shpreh se veprimet e grupit të armatosur të Partisë Komuniste Peruviane, Shtegu Ndriçues, si dhe kundëroperacionet e forcave qeveritare, të cilat shkaktuan më tepër se 69,000 të vrarë dhe dëmtime të mëdha të infrastrukturës publike dhe private, përbënin konflikt të armatosur dhe se ishte i zbatueshëm Neni i Përbashkët 3.[743] Gjykata e Lartë Kiliane pranoi zbatimin e Nenit të Përbashkët 3 për situatën në Kili në vitin 1973, duke marrë parasysh një dekret qeveritar të 12 shtatorit 1973, i cili e cilësonte gjendjen në vend si "gjendje lufte," gjë që justifikonte zbatimin e disa dispozitave penale.[744]

182. Në vitin 2006, Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara konkludoi se Shtetet e Bashkuara ishin në gjendje konflikti të armatosur me një grup joshtetëror që njihej si Al-Qaeda (Al Kaida), me argumentin se Neni i Përbashkët 3 zbatohet edhe në rastin kur përdoret forcë e armatosur midis një shteti dhe një pale që nuk ka nënshkruar Konventat e Gjenevës së vitit 1949, por është palë në një konflikt të armatosur.[745] Në Izrael, Gjykata e

---

741 *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse për kushtetueshmërinë e Dekretit Presidencial Nr. 2137 të 30 nëntorit 1994 për masat për rivendosjen e Kushtetutës dhe rendit publik në territorin e Republikës Çeçene, të Dekretit Presidencial Nr. 2166 të 9 dhjetorit 1994 për shtypjen e veprimeve të njësive të armatosura të paligjshme në territorin e Republikës Çeçene dhe në zonën e konfliktit Osetino-Ingushetian, të Rezolutës Nr. 1360 të 9 dhjetorit 1994 për garantimin e sigurisë dhe tërësisë territoriale të Federatës Ruse, parimin e ligjshmërisë, të drejtat dhe liritë e qytetarëve, dhe çarmatimin e njësive të armatosura të paligjshme në territorin e Republikës Çeçene dhe rajonet fqinje të Kaukazisë Veriore, dhe Dekretit Presidencial Nr. 1833 të 2 nëntorit 1993 mbi bazën e dispozitave bazë të doktrinës ushtarake të Federatës Ruse.* Sobranie Zakonodatelstva Rossiyskoy Federatsii, 1995, Nr. 33, Neni 3424.

742 Po aty., para. 6.

743 *Çështja e Guzmán Reinoso dhe të tjerëve*, Peru, Expediente acumulado Nr. 560-03, Vendimi i 13 tetorit 2006 (Gjykata Penale Kombëtare), para. 467-470.

744 Gjykata e Lartë e Kilit, 9 shtator 1998; *Revista Fallos del Mes*, Nr. 478, f. 1760-1769 (vendimi Nr. 3). Gjithashtu në kontekstin e Amerikës Jugore, *shih Juan Carlos Abella (Çështja Tablada)*, Inter-American Commission on Human Rights, Report No. 55/97, Case No. 11.137, 18 November 1997, (Argentina) paras 155-156.

745 *Hamdan, Salim Ahmed v. Rumsfeld, Donald H., Secretary of Defense, et al*., United States, Supreme Court of the United States, Judgment of 29 June 2006, 126 S.Ct.2749 (2006), pp 66-68. Gjykata e Lartë konstatoi se fraza që përshkruan rrezen e zbatimit të Nenit të Përbashkët 3 "mbart kuptimin faktual dhe është përdorur këtu për të bërë dallim me një konflikt midis shteteve," gjë që, Gjykata deklaron, vërtetohet nga Neni i Përbashkët 2 i Konventave

Lartë u shpreh se "[që] nga fundi i shtatorit 2000, ka patur luftime të ashpra në Judea, Samaria dhe Rripin e Gazës. Këto nuk janë operacione policore. Është luftë e armatosur."[746] Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, kjo gjykatë mori parasysh faktin se që nga fundi i shtatorit 2000 deri në vitin 2002 ishin vrarë më tepër se 600 qytetarë izraelitë dhe ishin plagosur më tepër se 4500 prej tyre, dhe se ishin vrarë dhe plagosur edhe "shumë" palestinezë.[747] Për t'iu bërë ballë sulmeve "terroriste", forcat izraelite të mbrojtjes, ndër të tjera,[748] kishin kryer operacione të posaçme ushtarake duke filluar nga qershori i vitit 2002 "për shkatërrimin e infrastrukturës së terrorizmit palestinez si dhe për parandalimin e sulmeve të mëtejshme terroriste."[749]

183. Këto raste tregojnë se për përcaktimin e konfliktit të armatosur, gjykatat shtetërore i kanë kushtuar vëmendje të veçantë ashpërsisë, duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e dhunës, që ka kushtëzuar përfshirjen e forcave të armatosura. Elementë të tjerë të rëndësishëm për këto gjykata në lidhje me përcaktimin e konfliktit të armatosur janë numri i lartë i viktimave dhe masa e shkatërrimit material.

184. Mbrojtjet e Boshkoskit dhe Tarçulovskit kanë argumentuar se meqë e drejta ndërkombëtare bën dallim midis konfliktit të armatosur dhe akteve të "banditizmit, kryengritjeve të paorganizuara dhe jetëshkurtra, apo veprimtarive terroriste, të cilat nuk trajtohen prej të drejtës humanitare ndërkombëtare,"[750] aktet terroriste mund të mos

---

të Gjenevës, "i cili kufizon zbatimin e vet në konfliktet e armatosura midis palëve nënshkruese dhe përcakton që palët nënshkruese të respektojnë të gjitha dispozitat e Konventave, edhe sikur një palë tjetër e konfliktit të mos jetë palë nënshkruese, për aq kohë sa kjo palë jonënshkruese "pranon dhe zbaton' këto dispozita." Kurse Neni i Përbashkët 3 "u siguron vetëm një farë mbrojtjeje minimale, në vend të mbrojtjes së plotë të Konventave, individëve të papërfshirë me një palë nënshkruese apo jonënshkruese, të cilët janë të përfshirë në një konflikt në territorin' e një vendi nënshkrues." rrjedhimisht, megjithëse Al Kaida nuk është palë nënshkruese e Konventave të Gjenevës, Neni i Përbashkët 3 zbatohet edhe në një konflikt në të cilin ajo është palë. Megjithëse Gjykata pranon se shpjeguesit zyrtarë të Nenit të Përbashkët 3 tregojnë se "një synim i rëndësishëm i dispozitës ishte t'u ofronte mbrojtje minimale rebelëve të përfshirë në një lloj konflikti jondërkombëtar,' d.m.th., një luftë civile," Gjykata thekson se shpjeguesit bëjnë të qartë "se fushëveprimi i Nenit duhet të jetë sa më i gjerë që të jetë e mundur." Lidhur me këtë, Gjykata tërhoqi vëmendjen ndaj faktit se në versionin përfundimtar të Nenit nuk është përdorur gjuhë kufizuese, e cila do të bënte që Neni 3 i Përbashkët të ishte i zbatueshëm "veçanërisht për rastet e luftës civile, konflikteve koloniale, apo luftrave fetare." "fushëveprimi më i gjerë u shoqërua me një paketë më një spektër më të ngushtë të drejtash se sa në versionet e propozuara më parë." *po aty.*, f. 66-68.

746 *Ajuri kundër Komandantit të IDF-së*, HCJ 7015/02; HCJ 7019/02, Izrael, Gjykata e Lartë e Izraelit që zhvillon seancë si Gjykatë e Lartë e Drejtësisë, Vendimi 3 shtatorit 2002, para. 1.

747 *Po aty.*

748 Çështja kishte të bënte me masat shtesë që ishin marrë nga Komiteti Ministror për Sigurinë Kombëtare më 31 korrik 2002, për shkak të pranimit se "operacionet e posaçme ushtarake nuk ishin përgjigjja e duhur në lidhje me domosdoshmërinë e ngutshme të ndalimit të sulmeve të rënda terroriste." *po aty*., në para. 4.

749 *Po aty.*, para. 3.

750 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 562; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 84.

merren në konsideratë në përcaktimin e konfliktit të armatosur.[751] Ky argument nënkupton përjashtimin e të gjitha akteve terroriste prej përcaktimit të ashpërsisë së dhunës në IRJM në vitin 2001.[752] Pa paragjykuar çështjen e cilësimit të akteve të UÇK-së si akte të natyrës terroriste, Dhoma Gjyqësore mendon se ky interpretim bazohet në një lexim të gabuar të jurisprudencës së Tribunalit, e cila shqyrtohet më poshtë.

185. Dhoma Gjyqësore në *Tadiq* u mbështet në Shpjeguesin e KNKK-së të Konventave të Gjenevës së vitit 1949, për të qartësuar se ashpërsia dhe organizimi i palëve mund të përdoren së paku vetëm për të bërë dallimin midis konfliktit të armatosur dhe formave më pak të ashpra të dhunës, siç janë "aktet terroriste."[753] Në pjesën e Shpjeguesin që është përdorur si referencë, thuhet se qëllimi i hartuesve të Konventave nuk ishte që shprehja "konflikt i armatosur" të vlente "për çdo ngjarje të veçuar ku madje përdoret edhe forca, dhe paqeruajtësit detyrohen të përdorin armët."[754] Përkundrazi, Neni i Përbashkët 3 do të zbatohej për "konflikte, të cilat në shumë aspekte ngjasojnë me një luftë ndërkombëtare, por që zhvillohen brenda kufijve të një vendi të vetëm," d.m.th. ku "forcat e armatosura " të secilës palë angazhohen në "luftime."[755] Çështja kyçe që thekson Dhoma Gjyqësore në *Tadiq* është se aktet e izoluara të dhunës, si për shembull disa akte terroriste të kryera në kohë paqeje, nuk mbulohen nga Neni i Përbashkët 3. Ky konkluzion pasqyrohet në përcaktimin e shprehur nga Dhoma e Apelit në *Tadiq*, se një konflikt i armatosur i natyrës jondërkombëtare ekziston vetëm kur ka "dhunë të *zgjatur* midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara apo midis grupeve të tilla brenda një shteti."[756] Në zbatimin e këtij kushti, e rëndësishme është nëse aktet janë kryer të izoluara apo si pjesë e një fushate të gjatë që shoqërohet me përfshirjen e të dy palëve në luftime. Është e parëndësishme nëse aktet e kryera të dhunës mund të cilësohen si akte të natyrës terroriste. Ky interpretim përputhet me mendimin e shprehur nga Dhoma e Apelit

751 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 265; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 48.
752 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 48: "Prokuroria duhej të kishte identifikuar të gjitha sulmet e natyrës terroriste dhe që nuk mund të jenë pjesë e shqyrtimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me ekzistencën e një konflikti të armatosur."
753 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 562.
754 Shpjegues i KNKK-së Konventës së Gjenevës II, f. 33.
755 Shpjegues i KNKK-së Konventës së Gjenevës II, f. 33.
756 Vendimi i Juridiksionit *Tadiq* , para. 70 (theksim i shtuar); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 84; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 37.

në *Kordiq*, se "kriteri i luftimeve *të zgjatura* është i rëndësishëm në përjashtimin e rasteve të trazirave civile apo akteve t*ë veçuara* terroriste."[757]

186. Elementi i dhunës "së zgjatur" të armatosur në përkufizimin e konfliktit të brendshëm të armatosur nuk është trajtuar shprehimisht në jurisprudencën e Tribunalit.[758] Ai shton elementin kohor në përkufizimin e konfliktit të armatosur.[759] Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e vetëdijshme për Nenin 8(2)(d) të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare lidhur me shkeljet e rënda të Nenit të Përbashkët 3, i cili "zbatohet për konfliktet që nuk janë të karakterit ndërkombëtar dhe rrjedhimisht nuk zbatohet për trazira dhe acarime të brendshme, si rebelime, veprime *të izoluara dhe sporadike të dhunës* ose veprime të tjera të së njëjtës natyrë."[760]

187. Pikëpamja se aktet terroriste mund të konsiderohen si dhunë e zgjatur përputhet gjithashtu me logjikën e të drejtës humanitare ndërkombëtare që ndalon "aktet

---

757 Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 341 (theksim i dytë i shtuar).

758 Megjithëse asnjë Dhomë Gjyqësore nuk e ka shpjeguar shprehimisht se çfarë kuptohet me fjalën "e zgjatur," ka shumë raste kur Dhomat Gjyqësore kanë shqyrtuar incidente dhune jashtë kornizës kohore të një aktakuze për të përcaktuar nëse dhuna e armatosur është "e zgjatur", veçanërisht kur periudha e aktakuzës është më e shkurtër se një vit. *Shih* p.sh., Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 566-567 (ku u konkludua se ashpërsia e luftimeve midis palëve të ndryshme në Jugosllavi nga viti 1991 arriti nivelin e një konflikti të armatosur gjatë periudhës së aktakuzës nga maji në dhjetor 1992); *Furundžija* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Furunxhija*, para. 51-57; 59 (ku shqyrtohen prova lidhur me konfliktin e armatosur nga janari në korrik 1993 në lidhje me periudhën e aktakuzës më 15 maj 1993 ose rreth kësaj date); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 186 (ku konkludohet se në tërë Bosnjë-Hercegovinën pati dhunë të vazhdueshme të armatosur duke filluar të paktën nga 6 marsi 1992 deri në nëntor 1995 në lidhje me periudhën e aktakuzës nga maji në dhjetor 1992); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kunarac*, para. 567; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 2, 58 (ku konkludohet ekzistenca e një konflikti të armatosur nga prilli 1992 deri të paktën shkurt në 1993 në lidhje me periudhën e aktakuzës nga 13 korrik deri tetor 1992); Vendimi *Milloshevi*q i Rregullës 98*bis*, para. 28 (ku konkludohet se ka ekzistuar një konflikt i armatosur në periudhën e aktakuzës nga 1 janar deri më 24 mars 1999, duke vënë në dukje një "ofensivë të gjerë" të forcave serbe në 1998, si dhe konkludohet se UÇK-ja kreu shumë operacione kundër policisë gjatë viteve 1996 dhe 1997); *Strugar* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 217, 26-78 (ku konkludohet se ekzistonte një konflikt i armatosur në periudhën e aktgjykimit nga 6 deri më 31 dhjetor 1991, dhe përfshihet shqyrtimi i provave të rëndësishme para konfliktit në të njëjtin vend gjatë muajve para fillimit të asaj periudhe).

759 Në *Haradinaj*, Dhoma Gjyqësore përcakatoi se kriteri i dhunës së zgjatur të armatosur ishte interpretuar në praktikë edhe nga Dhoma Gjyqësore e çështjes *Tadiq*, duke iu referuar më shumë ashpërsisë së dhunës së armatosur se sa kohëzgjatjes së saj. Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 49.

760 Neni 8(2)(d) Statuti i Romës i GJPN-së (theksim i shtuar). *Shih* Vendimi *Milloshevi*q i Rregullës 98*bis*, para. 20; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 87. Gjuha e kësaj dispozite përjashtuese rrjedh nga Neni 1 (2) i Protokollit II Shtesë, ku përcaktohet se Protokolli nuk zbatohet në "rastet e turbullirave dhe tensioneve të brendshme, si trazira, veprime të izoluara dhe sporadike të dhunës, dhe veprimeve të tjera të ngjashme, të ndryshme nga konflikti i armatosur." Një komentator vë në dukje se ky kufizim në zbatueshmërinë e Protokollit u vendos "prej shqetësimit se mos favorizoheshin krimet e zakonshme dhe aktet banditeske si dhe për shmangjen e një praktike të posaçme të mbrojtjes ligjore për veprime që nuk kanë të bëjnë aspak me konfliktin e armatosur të organizuar." Dieter Fleck, "International Humanitarian Law After September 11: Challenges and the Need to Respond," *Yearbook of International Humanitarian Law* (6) /(2003) p. 58.

terroriste"[761] dhe "aktet e dhunës apo kërcënimet për dhunë për të përhapur terror në popullsinë civile"[762] si në konfliktet ndërkombëtare po ashtu dhe në ato jondërkombëtare, dhe paralajmëron për përgjegjësi të mundshme individuale penale për këto akte.[763] Nuk do të kishte kuptim që e drejta humanitare ndërkombëtare të ndalonte akte të tilla nëqoftëse ato nuk do të përfshiheshin në sferën e konfliktit të armatosur.

188. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore vë në dukje se disa gjykata shtetërore nuk i kanë përjashtuar aktet e natyrës terroriste kur kanë shqyrtuar provat për rastin e një konflikti të armatosur. Gjykata Shtetërore Penale e Perusë konkludoi se rrethanat e aktetve të kryera nga Shtegu Ndriçues, si vrasje të civilëve, akte sabotazhi kundër ambasadave dhe objekteve publike dhe private, si dhe prita të armatosura kundër forcave shtetërore dhe reagimi ndaj tyre, plotësonin kushtin e vendosur nga Neni i Përbashkët 3.[764] Gjykata e Lartë e Nigerisë në vitin 1972, hodhi poshtë argumentat mbi urdhrat nga lart në lidhje me vrasjen e qëllimshme të një personi të paarmatosur nga anëtarë pa uniformë të forcave rebele të njohura si Ushtria e Biafra-s gjatë luftës civile, mirëpo kjo gjykatë nuk e anashkaloi këtë akt si pjesë e konfliktit të armatosur.[765] Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara nuk ngurroi të konkludonte se Neni i Përbashkët 3 vlente për konfliktin e armatosur midis Shteteve të Bashkuara dhe Al Kaidës, identifikuar prej kësaj gjykate, pavarësisht nga aktet "terroriste" të kryera nga Al Kaida, apo nga mendimi i qeverisë amerikane se Al Kaida ishte organizatë terroriste.[766]

---

761 Article 33(1) of Geneva Convention IV; Article 4(2)(d) of Additional Protocol II/ Neni 33(1) i Konventës së Gjenevës IV; Neni 4(2)(d) i Protokollit II Shtesë.

762 Article 51(2) of Additional Protocol I; Article 13(2) of Additional Protocol II; Article 22 of the Hague Rules on Warfare (1923);/Neni 51(2) i Protokollit I Shtesë; Neni 13(2) i Protokollit II Shtesë; Neni 22 i Rregullores së Hagës për Luftimet (1923); Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 90, afirmon statusin zakonor të Nenit 51(2) të Protokollit Shtesë I dhe 13(2) të Protokollit Shtesë II.

763 Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 86 dhe 98; *D. Milošević* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *D. Millosheviq*, para. 873-882. *Shih* gjithashtu "Decision on Motions for Judgment of Acquittal Pursuant to Rule 98", Case No. SCSL-04-14, paras 109-112; *Prosecutor v. Brima et al*., Case No. SCSL-04-16-PT, Further Amended Consolidated Indictment, 18 February 2005, përkatësisht Pikat 1 dhe 2; *Prosecutor v. Brima et al*., Case No. SCSL-04-16-T, "Decision on Motions for Judgment of Acquittal Pursuant to Rule 98", 31 March 2006, para 54.

764 *Çështja Abimael Guzmán Reinoso dhe të tjerë*, Peru, Expediente acumulado Nr. 560-03, Vendimi i 13 tetorit 2006 (Gjykata Kombëtare Penale), para. 470-476.

765 *Pius Nwaoga v. The State*, Nigeria, Supreme Court, 3 March 1972, All Nigeria Law Reports, Part 1, Vol. 1, p. 149; ILR vol. 52, 1979, p 494, at p 497 ("Sipas mendimit tonë, vrasja e qëllimtë dhe me paramendim e një personi të paarmatosur që jeton paqësisht në Territorin Federal, si në këtë rast, është krim kundër njerëzimit, dhe *edhe sikur të jetë kryer gjatë një luftë civile*, është shkelje e ligjeve të vendit dhe duhet të ndëshkohet) (Theksim i shtuar).

766 *Hamdan, Salim Ahmed v. Rumsfeld, Donald H., Secretary of Defense, et al*., United States, Supreme Court of the United States, Judgment of 29 June 2006, 126 S.Ct. 2749 (2006), pp 66-68

189. Edhe Gjykata e Lartë e Izraelit, në disa vendime të saj e ka cilësuar situatën midis Izraelit dhe "organizatave terroriste" si konflikt të armatosur.[767] Në një vendim të saj të vitit 2006, Gjykata e Lartë e Izraelit u shpreh se që nga *intifada* e parë midis Izraelit dhe "organizatave të ndryshme terroriste palestineze" ekziston një "situatë e vazhdueshme e konfliktit të armatosur"[768] për shkak të "sulmeve terroriste vrastare të shpeshta dhe të vazhdueshme" dhe reagimit të armatosur ndaj tyre.[769] Gjykata vuri në dukje se "në realitetin e sotëm, një organizatë terroriste ka të ngjarë të zotërojë kapacitete të konsiderueshme ushtarake. Në disa raste ato mund të kenë kapacitete më të mëdha ushtarake se sa vetë shtetet. Përballimi i këtyre rreziqeve nuk mund të kufizohet brenda shtetit dhe kornizës së të drejtës penale shtetërore."[770] Për më tepër, Komisioni Hetimor i Kombeve të Bashkuara për Libanin konkludoi se "luftimet që u zhvilluan nga 12 korrik deri më 14 gusht [2006] përbëjnë konflikt të armatosur ndërkombëtar," mirëpo theksoi "karakterin *sui generis* të tij, i cili konsiston në faktin se luftime të njëmendta u zhvilluan vetëm midis Izraelit dhe luftëtarëve të Hezbollahut."[771] Në raportin e tij, Komisioni theksoi se fakti që Izraeli e konsideronte Hezbollahun organizatë terroriste dhe luftëtarët e tij si terroristë, nuk pati asnjë ndikim në përkufizimin e këtij konflikti prej Komisionit.[772]

190. Këto raste tregojnë se gjykatat shtetërore dhe organet e Kombeve të Bashkuara, gjatë shqyrtimit të veprimeve që përbëjnë konflikt të armatosur, nuk kanë përjashtuar veprimet terroriste. Në jurisprudencën e Tribunalit nuk ka asnjë rast që Tribunali të ketë adoptuar një qasje të ndryshme ndaj kësaj çështjeje nëqoftëse veprimet terroriste përbëjnë "dhunë të zgjatur." Duke marrë parasysh argumentet e mësipërme, Dhoma Gjyqësore mendon se ndonëse veprimet e izoluara terroriste nuk mund të plotësojnë kushtin e

---

767 *Ajuri v IDF Commander*, HCJ 7015/02; HCJ 7019/02, Israel, Supreme Court, Judgement of 3 September 2002, para 1; *The Public Committee against Torture in Israel et al. v. The Government of Israel et al.*, Israel, Supreme Court, Judgment of 14 December 2006, HCJ 769/02, para 16, also citing: *El Saka v. The State of Israel* (unpublished), HCJ 9255/00; *Kn'aan v. The Commander of IDF Forces in the Judea and Samaria Area* (unpublished), HCJ 2461/01; *Barake v. The Minister of Defence*, 56(2) PD, HCJ 9293/01; *Almandi v. The Minister of Defence*, 56(3) PD 30, HCJ 3451/02; *Ibrahim v. The Commander of IDF Forces in the West Bank* (unpublished), HCJ 8172/02; *Mara'abe v. The Prime Minister of Israel*, HJC 7957/04.

768 *The Public Committee against Torture in Israel et al. v. The Government of Israel et al.*, Israel, Supreme Court, Judgment of 14 December 2006, HCJ 769/02, para 16.

769 Po aty., citohet shtojca e përmbledhjes në emër të Avokatit të Shtetit të Izraelit më 26 janar 2004.

770 Po aty., para. 21.

771 Report of the Commission of Inquiry on Lebanon, pursuant to Human Rights Council Resolution S-2/1, UN Doc. A/HRC/3/2, 23 November 2006, paras 8-9 and 57.

772 *Po aty*., para. 62.

konfliktit të armatosur, dhuna e zgjatur e këtyre lloj veprimeve veçanërisht kur kërkohet përfshirja e forcave të armatosura në luftime, duhet të merret parasysh në vlerësimin e nivelit të ashpërsisë për të konkluduar nëse kemi të bëjmë me konflikt të armatosur.

191. Në vijim të pretendimeve të tyre, Mbrojtjet e Boshkoskit dhe Tarçulovskit argumentojnë se deklaratat e shteteve apo organizatave ndërkombëtare që dënojnë sulmet terroriste të kryera nga UÇK-ja në IRJM në vitin 2001 shërbejnë si prova të mosekzistencës së konfliktit të armatosur në IRJM.[773] Dhoma Gjyqësore nuk është e këtij mendimi. Siç theksohet në vendimin e saj më të hershëm, të datës 27 shkurt 2008,[774] deklarata të tilla, megjithëse me gjasë pasqyrojnë praktikën e shteteve si dhe *opinio juris* për çështje të të drejtës zakonore, kanë vlerë minimale për përfundimet faktuale të Dhomës Gjyqësore.

192. Mbrojtja e Boshkoskit argumenton se deklarata të tilla nuk do të ishin bërë nëqoftëse në IRJM do të kishte patur konflikt të armatosur, sepse po të kishte patur konflikt të armatosur, veprime të tilla si sulmet e UÇK-së kundër forcave të sigurisë do të ishin konsideruar si operacione legjitime ushtarake.[775] Dhoma Gjyqësore nuk mund të jetë dakord me këtë pikëpamje. Në praktikën e tij, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka dënuar "akte terroriste" të grupeve rebele edhe në rrethana që ndoshta përbënin konflikt të brendshëm të armatosur.[776] Është praktikë e zakonshme e shteteve dhe organizatave t'i cilësojnë aktet e grupeve joshtetërore si "terroriste", pavarësisht se

---

773 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 264 and 268; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 112-116.

774 *Prokurori kundër Boshkoskit dhe Tarçulovksit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Decision on Boškoski Defence Motion for Admission of Exhibits from the Bar Table – 'armed conflict' and related requirements under Article 3 of the Statute", 27 February 2008, para 6./"Vendim në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes së Boshkoskit për Pranimin e Provave Materiale në Sallën Gjyqësore –" konflikti i armatosur' dhe kushtet përkatëse të Nenit 3 të Statutit," 27 shkurt 2008, para. 6.

775 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit para. 264.

776 *P.Sh.*, Security Council Res. 1465 (2003), 13 February 2003 (që dënoi sulmin me bombë në Bogotë, Kolumbi, atribuar FARK-ut, ku u vranë disa njerëz dhe u plagosën shumë të tjerë, dhe theksoi se akte të tilla, si të gjitha aktet e terrorizmit, përbëjnë kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare). *Shih* Mirko Sossai, Mirko Sossai, "The Internal Conflict in Colombia and the Fight Against Terrorism: UN Security Council Resolution 1465 (2003) and Further Developments," *Journal of International Criminal Justice* 3, 1 (2005):, p. 253. Gjykatat kolumbiane nuk e kanë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatueshmërinë e Nenit të Përbashkët 3 apo Protokollit Shtesë II për situatën në Kolombi, megjitëse Gjykata Kushtetuese ka lënë në fuqi kushtetueshmërinë e ratifikimit të Protokollit Shtesë II nga qeveria. *Shih* Corte Constitucional, Sentencia C-225/95, 18 May 1995, në Gaceta Constitutional, 1995. Shembuj të tjerë të rezolutave të Këshillit të Sigurimit që dënojnë akte teroriste që pretendohet se janë kryer prej grupeve joshtetërore në rrethana që mund të cilësohen konflikt i armatosur përfshijnë: S/RES/1735 (2006) për Afganistanin; S/RES/1618 (2005) për Irakun; S/RES/1544 (2004) për Izraelin; S/RES/1435 (2002) për Izraelin; S/RES/1199 (1998) për Kosovën; S/RES/941 (1994) për Bosnnjën. Shih edhe A/RES/50/159 (1996) për Burundin.

këto mund të jenë kryer në kontekstin e një konflikti të armatosur.[777] Për më tepër, rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe shteteve apo zyrtarëve të tyre bëhen mbi baza politike, jo ligjore, dhe nuk mund të interpretohen në mënyrë të drejtpërdrejtë si provë apo si interpretim ligjor i rrethanave faktuale, pavarësisht faktit se rezoluta të tilla mund të kenë pasoja ligjore. Dhoma Gjyqësore vë në dukje gjithashtu se, në kundërshtim me argumentin e Mbrojtjes së Boshkoskit se "bashkësia e shteteve, […] asnjëherë nuk gjykoi se situata në IRJM përbënte konflikt të armatosur,"[778] gjuha e përdorur në Rezolutën 1345 të 21 marsit 2001 mund të sugjerojë se Këshilli i Sigurimit e konsideronte situatën në IRJM si konflikt të armatosur.[779] Për shembull, Këshilli i Sigurimit pranoi se dhuna përbënte kërcënim për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, përdori shprehjen "veprim i armatosur kundër autoriteteve" dhe u bëri thirrje "të gjitha palëve të vepronin me vetëpërmbajtje dhe tërësisht në përputhje me të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut."[780]

193. Duke patur parasysh këta faktorë, në shqyrtimin e ngjarjeve në IRJM në vitin 2001, Dhoma Gjyqësore do të zbatojë kushtin e përcaktuar nga Dhoma e Apelit në Vendimin per Juridiksionin *Tadiq*. Ajo do t'i përdorë treguesit e identifikuar më sipër së bashku me karakterin sistemor të përdorimit të forcës nga autoritetet shtetërore si udhërrëfyes të dobishëm praktikë në vlerësimin e kriterit të ashpërsisë, në rrethanat konkrete faktuale të kësaj çështjeje.

---

777 Për shembull, një numër grupesh të armatosura joshtetërore, në dukje të përfshira në konflikte të armatosura të brendshme, janë përfshirë në listat e organizatave terroriste të hartuara nga shtetet. *Shih* p.sh. Council Common Position 2005/847/CFSP of 29 November 2005 updating Common Position 2001/931/CFSP and repealing Common Position 2005/725/CFSP;/Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2005/847/CFSP i 29 nëntorit 2005 që aktualizon Qëndrimin e Përbashkët 2001/931/CFSP në lidhje me zbatimin e masave konkrete për të luftuar terrorizmin dhe shfuqizon Qëndrimin e Përbashkët 2005/725/CFSP; U.S. Department of State, "Terrorist Exclusion List"; U.S. Department of State, "Foreign Terrorist Organizations"; United Kingdom Home Office, "Proscribed Terrorist Groups" under the Terrorism Act 2000; Canada, "Current Listed Entities" pursuant to subsections 83.05(9) and 83.05(10) of the Criminal Code; Australia, "Listing of Terrorist Organisations" under the Security Legislation Amendment (Terrorism) Act 2002./Departamenti Amerikan i Shtetit, "Lista e Ndalimit të Terroristëve"; Departamenti Amerikan i Shtetit, "Organizatat e Huaja Terroriste"; Ministria e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar, "Grupet e Ndaluara Terroriste" në bazë të Aktit të Terrorizmit 2000; Kanada, "Lista e Subjekteve Aktuale" në bazë të nënkapitujve 83.05(9) dhe 83.05(10) të Kodit Penal; Australia, "Lista e Organizatave Terroriste" në bazë të Aktit të Amendimit të Legjislacionit të Sigurisë Akti (i Terrorizmit) 2002./

778 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 268.

779 Për interpretimin e rezolutave të Këshillit të Sigurimit, *shih Legal Consequences for States of the Continued Presence of South Africa in Namibia South-West Africa Notwithstanding Security Council Resolution 276 (1970)*, Advisory Opinion of 21 June 1971, ICJ Reports 1971 15, at 53, ku Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë identifikoi si faktorë "gjuhën" e rezolutës, "diskutimet që çuan në të," "dispozitat e cituara të Kartës" si dhe "të gjitha rrethanat që mund të ndihmojnë në përcaktimin e pasojave [të saj] ligjore."

780 Prova Materiale 1D230, f. 11-12, përkatësisht para. 1, 4 dhe 7.

(b) Organizimi i grupit të armatosur

194. Jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar se një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të ndodhë vetëm kur ka dhunë të zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura *të organizuara* ose midis grupeve të tilla brenda një shteti.[781] Në tekstet ligjore apo në jurisprudencë nuk është përcaktuar saktësisht niveli i kërkuar i organizimit të një grupi të tillë në përputhje me Nenin e Përbashkët 3. Gjithsesi në jurisprudencën e Tribunalit janë profilizuar disa elementë të nivelit miminal të organizimit.

195. Në *Tadiq*, Dhoma e Apelit bëri dallim midis situatës ku individët vepronin në emër të shtetit pa udhëzime konkrete, nga situata ku individët ishin pjesë përbërëse e "*një grupi të organizuar dhe strukturuar nga pikëpamja hierarkike*, siç është një njësi ushtarake apo, në rastin e luftës apo trazirave civile, banda të armatosura të kryengritësve apo rebelëve."[782] Dhoma Gjyqësore vë në dukje se "një grup i organizuar zakonisht ka një strukturë, një sistem zinxhir të komandimit, një rregullore si dhe simbole të dukshme të pushtetit" dhe se anëtarët e tij nuk veprojnë me kokën e tyre por sipas "standardeve që mbizotërojnë në grup" dhe "i nënshtrohen pushtetit të kreut të grupit."[783] Rrjedhimisht, që një grup i armatosur të konsiderohet i organizuar, duhet që të ketë një farë strukture hierarkike dhe udhëheqja e tij duhet të ketë kapacitetin e duhur për të ushtruar pushtet ndaj anëtarëve të grupit.

196. Çështja e nivelit të organizimit të një grupi të armatosur u trajtua nga Dhoma Gjyqësore në *Limaj* gjatë përcaktimit nëse Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte grup i armatosur i organizuar.[784] Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë kushtet më kufizuese lidhur me organizimin, të paraqitura nga Mbrojtja, mbi bazën e "kritereve të përshtatshme" të Shpjeguesit të KNKK-së si dhe argumentet sipas të cilave një grup i armatosur duhet të ketë metodë të lejimit të shkeljeve të Nenit të Përbashkët 3 ose duhet të ketë plotësuar

781 Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*, para. 70.
782 Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 120 (theksim i shtuar).
783 Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 120.
784 Çështja nëse UÇK-ja ishte grup i organizuar, u shqyrtua gjithashtu në Vendimin *Millosheviq* të Regullës 98*bis*, në para. 23, në të cilin Dhoma Gjyqësore u shpreh "se në fakt ekziston një tërësi e mjaftueshme provash që tregojnë se UÇK-ja ishte një forcë e organizuar ushtarake, me një strukturë të përbashkët zyrtare komanduese, shtab qendror, zona të përcaktuara operative, si dhe aftësinë për të siguruar, transportuar, dhe shpërndarë armë".

kushtet e Protokollit Shtesë II. Në ndryshim me sa më sipër, Dhoma u shpreh se "për vërtetimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur mjafton *një farë organizimi* i palëve."[785] Së paku, udhëheqja e grupit duhet të ketë aftësinë për të ushtruar një farë kontrolli ndaj anëtarëve të grupit në mënyrë që të mund të zbatohen detyrimet themelore të Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës.[786] Edhe jurisprudenca e shteteve të ndryshme përputhet me kushtin minimal të kontrollit. Për shembull, një gjykatë ushtarake belge refuzoi ta cilësonte situatën që mbizotëronte në Somali në vitin 1993 si konflikt të armatosur për të cilin zbatohet Neni i Përbashkët 3, me arsyetimin se grupet e përfshira ishin grupe të armatosura të çrregullta, anarkiste, pa strukturë komanduese.[787]

197. Megjithëse jurisprudenca e Tribunalit kërkon që një grup i armatosur duhet të ketë "një farë organizimi," palët ndërluftuese nuk duhet të jenë domosdoshmërisht po aq të organizuara sa dhe forcat e armatosura të një shteti.[788] Po kështu, nuk është e nevojshme që niveli i organizimit të një grupi të armatosur pjesëmarrës në konflikt, për të cilin zbatohet Neni i Përbashkët 3, të jetë i njëjtë me nivelin e organizimit të palëve pjesëmarrëse në konflikte të armatosura që mbulohen nga Protokolli Shtesë II, ku palët duhet të kenë një komandë përgjegjëse si dhe të ushtrojnë një kontroll të tillë ndaj një pjese të territorit që t'u mundësojë kryerjen e operacioneve të vazhdueshme dhe të koordinuara ushtarake dhe zbatimin e Protokollit.[789] Protokolli Shtesë II kërkon një standard më të lartë se Neni i Përbashkët 3 për vërtetimin e një konflikti të armatosur. Si

---

785 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 89 (theksim i shtuar). Në mbështetje të pikëpamjes së saj, Dhoma Gjyqësore vuri në dukje një studim të që KNKK-ja ia paraqiti si dokument reference Komisionit Përgatitor për përcaktimin e elementëve të krimit për GJPN, ku theksohej se "përcaktimi nëse konflikti I armatosur nuk është ndërkombëtar nuk varet prej gjykimeve subjective të palëve në konflikt: ai duhet të bëhet mbi bazën e kritereve objektive; shprehja "konflikt i armatosur" presupozon ekzistencën e luftimeve midis forcave të armatosura *të organizuara në një shkallë më të madhe ose më të vogël*; duhet të ketë ekzistojë qëndresa ndaj forcave të armatosura si dhe *një farë ashpërsie* e luftimeve." ICRC Working Paper, 29 June 1999. theksim i shtuar.

786 ICRC Commentary to Geneva Convention II/Shpjegues i KNKK-së për Konventën e Gjenevës II, f. 34 (ku theksohet se nëqoftëse një grup joshtetëror nuk aplikon Nenin 3 të Përbashkët, "ai do t'u provojë atyre që i konsiderojnë veprimet e tij si thjesht akte anarkie apo banditizmi se kanë të drejtë"). *Shih* gjithashtu ICRC, "International Humanitarian Law and the Challenges of Contemporary Armed Conflicts", Report prepared by the International Committee of the Red Cross, 28th International Conference of the Red Cross and Red Crescent, Geneva, 2 to 6 December 2003, at p 19/KNKK, "E Drejta Humanitare Ndërkombëtare dhe Sfidat e Konflikteve Aktuale të Armatosura", Raport i përgatitur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Konferenca e 28-të Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, Gjenevë, 2 deri 6 dhjetor 2003, në f19 (ku përmenden "forca të armatosura apo grupe të armatosura me një nivel të caktuar organizimi, strukturë komanduese dhe rrjedhimisht me, aftësinë për të zbatuar të drejtën humanitare ndërkombëtare.")

787 *Ministre public et Centre pour l'égalité des chances et la lutte contre le racisme v. C... et B...*, Belgjikë, Gjykata Ushtarake, Aktgjykim i 17 dhjetorit 1997, *Journaux des Tribunaux*, 4 prill 1998, f. 286-289.

788 *Orić* Trial Judgement, para 254/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Oriq*, para. 254.

789 Neni 1(1) Protokolli Shtesë II. Kjo dispozitë bën të qartë se Protokolli "zhvillon dhe plotëson Nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së 12 gushtit 1949, pa ndryshuar kushtet ekzistuese të zbatimit."

rrjedhojë, niveli i kërkuar i organizimit për t'u përfshirë në "dhunë të zgjatur", është më i ulët se niveli i organizimit që kërkohet për kryerjen e "operacioneve të vazhdueshme dhe të koordinuara ushtarake." Në këtë aspekt duhet të theksohet se gjatë hartimit të Nenit 8(2) (f) të Statutit të Romës së Gjykatës Penale Ndërkombëtare në lidhje me shkelje "të tjera" të rënda të ligjeve dhe zakoneve të luftës të zbatueshme për konfliktet e armatosura jondërkombëtare, delegatët hodhën poshtë propozimin që në këtë kapitull të përcaktohej kufiri i zbatueshmërinë së Protokollit Shtesë II,[790] dhe si altternativë delegatët pranuan një propozim për përfshirjen e kushtit të "konfliktit të zgjatur të armatosur," marrë prej vendimit të Dhomës së Apelit për çështjen *Tadiq*.[791] Kjo tregon se ky kusht konsiderohej i ndryshëm dhe me kufi të poshtëm më të ulët se sa kushti i Protokollit Shtesë II. Ky ndryshim në nivelin e kërkuar të organizimit është logjik po të kihen parasysh rregullat më të hollësishme të të drejtës humanitare ndërkombëtare për konfliktet e mbuluara nga Protokolli Shtesë II, gjë që do të thotë se "duhet të ekzistojë një farë kontrolli i qëndrueshëm ndaj një pjese sado të vogël të territorit, në mënyrë që ata të kenë aftësinë për të zbatuar efektivisht rregullat e Protokollit."[792] Në dallim me këtë, Neni i Përbashkët 3 ofron garanci humanitare themelore,[793] dhe për zbatimin e këtyre garancive mjafton niveli minimal i organizimit të një pale në konflikt të armatosur.

---

790 *Shih* Anthony Cullen, "The Definition of Non-International Armed Conflict in the Rome Statute of the International Criminal Court: An Analysis of the Threshold of Application Contained in Article 8(2)(f)", *Journal of Conflict & Security Law*, 12, 3 (2008) pp 419-445/"Përkufizimi i Konfliktit të Armatosur Jondërkombëtar në Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare: Një Analizë e Kufirit Minimal të Zbatimit Shprehur në Nenin 8(2)(f),(ku shpjegohet se delegatët ishin veçanërisht kritikë për faktin se përkufizimi do të përjashtonte konfliktet ku nuk përfshihen forcat qeveritare, si dhe konfliktet në të cilat palët nuk kontrollonin territorin dhe si pasojë kjo do të sillte një kufizim të tepruar të juridiksionit të GjPN-së).

791 A/CONF.183/C.1/L.62 (13 maj 1998). Ky version zëvëndësoi fjalën "dhunë" me "konflikt."

792 Shpjeguesi i KNKK-së Protokollit Shtesë II, f. 1353. Rrjedhimisht për shembull, kujdesi për të plagosurit dhe të sëmurët, apo mbajtja e robërve dhe trajtimi njerëzor i tyre, siç përcaktohet në Nenet 4 "(Garanci Themelore)" dhe 5 "(Personat të cilëve u është kufizuar liria)." Në *Akayesu*, Dhoma Gjyqësore e TPNR-së u shpreh se "komanda përgjegjëse [. . .] nënkupton një shkallë të caktuar organizimi brenda grupit të armatosur apo forcave rebele të armatosura. Kjo shkallë organizimi duhet t'i mundësojë grupit të armatosur apo forcave rebele që të planifikojnë dhe zbatojnë operacione të koordinuara ushtarake, si dhe të vendosin disiplinën në emër të një autoriteti *de facto*." Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Akayesu*, para. 626; *shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Musema*, *para.* 257.

793 *Military and Paramilitary Activities in and against Nicaragua (Nicaragua v. United States*), ICJ Reports 14 (1986), at para 218/*AVeprimtari Ushtarake dhe Paraushtarake në Nikaragua dhe kundër saj (Nikaragua kundër Shteteve të Bashkuara*), Raporte të GjND-së 14 (1986), në para. 218 (ku thuhet se Neni i Përbashkët 3 pasqyron standarde minimale të zbatueshme në të gjitha konfliktet e armatosura). *Shih* gjithashtu Shpjeguesin e KNKK-së të Konventës I të Gjenevës, f. 50 (ku theksohet se dispozita "thjesht kërkon zbatimin e disa rregullave, të cilat tashmë pranohen në të gjitha vendet e qytetëruara si themelore dhe të mishëruara në legjislacionet e brendshme të shteteve në fjalë shumë më parë se të nënshkruhej Konventa").

198. Orientim i mëtejshëm lidhur me nivelin e organizimit të kërkuar të palëve në konflikte të armatosurar sipas Nenit të Përbashkët 3, mund të gjendet në *Haradinaj*, ku Dhoma Gjyqësore, pasi shqyrtoi praktikën e Dhomave Gjyqësore në interpretimin e kriterit të organizimit, konkludoi se "një konflikt i armatosur mund të ekzistojë vetëm midis palëve të cilat janë të organizuara në nivel të mjaftueshëm për t'u ballafaquar me njëra-tjetrën me mjete ushtarake."[794] Për të konkluduar nëse një grup i armatosur është i organizuar në nivel të mjaftueshëm, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi faktorët tregues të marrë parasysh nga Dhomat Gjyqësore, "asnjë prej të cilëve në veçanti nuk është thelbësor për vërtetimin e përmbushjes së kriterit të "organizimit"."[795]

199. Në vlerësimin e organizimit të një grupi të armatosur, Dhomat Gjyqësore kanë marrë parasysh një sërë faktorësh, të cilët ndahen në pesë grupe të përgjithshme. Në grupin e parë përfshihen ata faktorë që tregojnë praninë e një strukture komanduese, si krijimi i një shtabi të përgjithshëm apo komande të lartë,[796] që emëron dhe u jep udhëzime komandantëve,[797] shpërndan rregullore të brendshme,[798] organizon furnizimin me armë,[799] autorizon operacione ushtarake,[800] u cakton individëve detyra organizative,[801] dhe lëshon deklarata dhe komunikata politike,[802] si dhe informohet nga njësitë operative për të gjitha zhvillimet në zonat e përgjegjësisë së këtyre njësive.[803] Në këtë grup përfshihen gjithashtu edhe faktorë të tjerë si ekzistenca e një rregulloreje të brendshme, e cila përcakton organizimin dhe strukturën e grupit të armatosur;[804] caktimi i një zëdhënësi zyrtar;[805] komunikimi nëpërmjet komunikatave që informojnë për veprimet dhe operacionet ushtarake të ndërmarra nga grupi i armatosur;[806] ekzistenca e selisë;[807] rregullore të brendshme që përcaktojnë gradat e ushtarakëve të grupit si dhe detyrat e

[794] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 60.
[795] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 60.
[796] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 94; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 60, 65-68.
[797] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 96, 98, 99.
[798] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 98.
[799] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 100; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 60.
[800] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 46.
[801] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 46.
[802] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 46, 101.
[803] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 97.
[804] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 98.
[805] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 99, 102.
[806] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj* para. 103.
[807] Vendimi *Millosheviq* i Rregullës 98*bis* para. 23-24; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 104; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 65.

komandantëve dhe zëvëndëskomandatëve të një njësie, kompanie, toge, apo skuadre, duke krijuar një zinxhir të hierarkisë ushtarake midis niveleve të ndryshme të komandantëve;[808] si dhe shpërndarja e rregulloreve të brendshme ushtarëve dhe njësive operative.[809]

200. Së dyti, janë marrë parasysh faktorë që tregojnë se grupi është i aftë të kryejë operacione në mënyrë të organizuar, si aftësia e grupit për përkufizimin e një strategjie të njësuar ushtarake si dhe për kryerjen e operacioneve ushtarake në shkallë të gjerë,[810] aftësia për kontrollin e territorit,[811] ndarja territoriale në bazë të zonave të përgjegjësisë[812] në të cilat komandantët përkatës janë përgjegjës për formimin e brigadave dhe njësive të tjera dhe për emërimin e komandantëve të njësive të tilla;[813] aftësia e njësive operative për koordinimin e veprimeve të tyre,[814] dhe transmetimi efektiv i urdhrave dhe vendimeve gojore dhe me shkrim.[815]

201. Në grupin e tretë përfshihen faktorë që tregojnë nivelin e logjistikës, si aftësia për rekrutimin e anëtarëve të rinj;[816] organizimi i stërvitjes ushtarake;[817] furnizimi i organizuar me armë ushtarake;[818] furnizimi me uniforma dhe përdorimi i tyre;[819] si dhe ekzistenca e pajisjeve komunikuese për lidhjen e selisë/shtabit qendor me njësitë apo midis njësive të ndryshme.[820]

202. Në grupin e katërt janë marrë parasysh faktorët përkatës për të përcaktuar nëse një grup i armatosur zotëron një nivel të caktuar disipline si dhe aftësinë për zbatimin e detyrimeve bazë të Nenit të Përbashkët 3 si përcaktimi i rregullave dhe mekanizmave

808 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 111.
809 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 110.
810 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 129; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 410, 417; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 87.
811 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 158; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 70-75.
812 Vendimi *Millosheviq* i Rregullës 98*bis*, para. 23-24; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 95.
813 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 106, 109.
814 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 108; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, para. 135, 344.
815 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 105.
816 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 118; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 83-85.
817 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 118; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 119; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 86.
818 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, para. 118; Vendimi *Millosheviq* i Rregullës 98*bis*, para. 23-24; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 121-122; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 76-82.
819 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 123.
820 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 124.

disiplinorë;[821] stërvitja e duhur;[822] dhe ekzistenca e rregulloreve të brendshme dhe nëse ato u janë shpërndarë anëtarëve në mënyrë të efektshme.[823]

203. Grupi i pestë përfshin ata faktorë që tregojnë se grupi i armatosur ka qenë në gjendje të flasë me një zë të vetëm,[824] si aftësia për të vepruar në emër të anëtarëve të tij në negociatat politike me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe vendeve të huaja;[825] dhe aftësia për të negociuar dhe arritur marrëveshje, si marrëveshje armëpushimi apo paqeje.[826]

204. Mbrojtja Tarçulovski parashtroi se natyra "terroriste" e veprimeve të UÇK-së dhe shkeljet e pretenduara të së drejtës humanitare ndërkombëtare tregojnë se UÇK-ja nuk mund të konsiderohet si palë e një konflikti të armatosur, sepse ato tregojnë se "UÇK-ja nuk ka patur aftësinë e kontrollimit të forcave të veta në terren."[827] Dhoma Gjyqësore pranon se një numër i lartë i shkeljeve të të drejtës humanitare ndërkombëtare nga anëtarët e një grupi të armatosur, në disa raste, mund të jetë tregues i nivelit të ulët të disiplinës dhe mungesës së komandës hierarkike në këtë grup.[828] Duhet vënë në dukje se një gjykatë shtetërore u shpreh se shkeljet e vazhdueshme të rregullave të të drejtës humanitare ndërkombëtare si sulmet terroriste, tregojnë mungesën e komandës përgjegjëse në këtë grup, sipas Nenit 1 të Protokollit Shtesë II, megjithëse pavarësisht prej këtij konkluzioni, kjo gjykatë konkludoi se edhe në të këtë rast ishte i zbatueshëm Neni i Përbashkët 3.[829] Mirëpo Dhoma Gjyqësore gjithashtu pranon se kryerja e disa veprimeve terroriste kërkon një nivel të lartë planifikimi si dhe një strukturë të bashkërenduar komanduese. Me fjalë të tjera, përcaktimi konkret i kësaj çështjeje duhet të bëhet rast pas rasti.

---

821 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 113-117; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 69.
822 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 119.
823 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 110.
824 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 88.
825 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj* para. 125-129.
826 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovi*ć, para. 164; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanovi*ć, para. 20, 23; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 88.
827 Dosja e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 73; para. 70-110.
828 Studimet tregojnë se shumica e shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare kryhen në rrethana kur mungojnë udhëzime të qarta për standardet e kësaj kategorie ligjore dhe kur ka mungesë të disiplinës ushtarake tek ushtarët. *Shih* Daniel Muñoz-Rojas dhe Jean-Jacques Frésard, *The Roots of Behaviour in War: Understanding and Preventing IHL Violations* (Geneva: ICRC, October 2004), *Shkaqet e Sjelljes në Luftë: Kuptimi dhe Parandalimi i Shkeljeve të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare* (Gjenevë: KNKK, tetor 2004).
829 *Case of Abimael Guzmán Reinoso and others /Çështja Abimael Guzmán Reinoso dhe të tjerë* ; Expediente acumulado Nr 560-03, Peru, Vendim i Gjykatës Shtetërore Penale (*Sala Pena Nacional*) i 13 tetorit 2006; ILDC 670 (PE 2006), para. 470.

205. Në rastet kur anëtarët e grupeve të armatosura përfshihen në veprime që ndalohen prej të drejtës humanitare ndërkombëtare, si "veprime terroriste,"[830] "veprime apo kërcënime që kryesisht synojnë përhapjen e frikës tek popullsia civile,"[831] pengmarrja,[832] përdorimi i mburojave njerëzore,[833] simulimi i statusit të të mbrojturit,[834] sulme ndaj monumenteve apo ndërtesave historike ose fetare[835] apo përdorimi i objekteve të tilla për mbështetjen e veprimeve ushtarake,[836] ose shkelje të rënda të Nenit të Përbashkët 3, këta anëtarë ballafaqohen me ndjekje penale dhe ndëshkim. Mirëpo për aq kohë sa grupi i armatosur zotëron *aftësinë* organizative për përmbushjen e detyrimeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare, ekzistenca e shkeljeve të lartpërmendura nuk sugjeron domodoshmërisht se grupi nuk zotëron nivelin e kërkuar të organizimit të një pale në një konflikt të armatosur. Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludojë se grupit të armatosur i mungon organizimi duke u nisur vetëm nga shkeljet e shpeshta të së drejtës humanitare ndërkombëtare prej anëtarëve të tij. Në vlerësimin e këtij faktori Dhoma Gjyqësore duhet të shqyrtojë se si u planifikuan dhe u kryen sulmet – për shembull nëse këto sulme ishin kryesisht rezultat i një strategjie ushtarake të urdhëruar nga udhëheqësit e grupit, apo nëse këto sulme ishin veprime të kryera nga anëtarët e grupit në ujdi me njëri-tjetrin.

206. Mbi bazën e analizës së mësipërme, në shqyrtimin e ngjarjeve faktuale që ndodhën në IRJM në vitin 2001, Dhoma Gjyqësore do të zbatojë kushtin e përcaktuar nga Dhoma e Apelit në Vendimin e Juridiksionit *Tadiq*, duke i përdorur faktorët tregues të identifikuar më sipër si udhërrëfyes praktik për përcaktimin e përmbushjes së kriterit të organizimit të palëve.

---

830 Neni 33(1) i Konventës IV të Gjenevës; Neni 4(2)(d) i Protokollit Shtesë II.

831 Neni 51(2) i i Protokollit Shtesë I; Neni 13(2) i Protokollit Shtesë II.

832 Common Article 3(1)(b) to the Geneva Conventions; Article 34 Geneva Convention IV; Article 4(2)(c) Additional Protocol II. Shih edhe Jean-Marie Henckaerts dhe Louise Doswald-Beck, Customary International Humanitarian Law, Vol. I (Cambridge: CUP, 2005), Rule 96, pp 334-336.

833 Article 51(7) of Additional Protocol I/Neni 51(7) i Protokollit Shtesë II. Shih edhe Jean-Marie Henckaerts dhe Louise Doswald-Beck, Customary International Humanitarian Law, Vol. I (Cambridge: CUP, 2005), Rule 97, p 337; Rome Statute, Article 8(2)(b)(xxiii).

834 Article 37 Additional Protocol I Neni 37 Protokolli Shtesë I. Kjo rregullë është zakonore. *Shih* Jean-Marie Henckaerts dhe Louise Doswald-Beck, *Customary International Humanitarian Law*, Vol. I (Cambridge: CUP, 2005), Rule 65, f. 224. Një rregullë e ngjashme gjendet në Nenin 23(b) të Rregullores së Hagës bashkangjitur si shtojcë Konventës IV të Hagës të vitit 1907, e cila ndalon "Vrasjen apo plagosjen e pabesë të individëve që i përkasin vendit apo ushtrisë armike."

835 Article 53(a) Additional Protocol I/Neni 53(a) Protokolli Shtesë I. *Shih* gjithashtu Article 19(1) Convention for the Protection of Cultural Property in the Event of Armed Conflict of 14 May 1954/Neni 19(1) Konventa e 14 majit të 1954 për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Rastin e Konfliktit të Armatosur.

836 Neni 53(b) Protokolli Shtesë I.

2. Përfundime

207. Aktakuza pretendon ekzistencën e një konflikti të armatosur midis forcave të sigurisë së IRJM-së dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), i cili filloi në janar 2001 dhe vazhdoi deri në fund të shtatorit 2001.[837] Dhoma Gjyqësore do të diskutojë më poshtë nëse Prokuroria arriti të provonte se aktet e dhunës që ndodhën në IRJM gjatë periudhës përkatëse arritën nivelin e ashpërsisë së kërkuar prej jurisprudencës së Tribunalit dhe se UÇK-ja kishte veçoritë e një grupi të organizuar të armatosur, sipas kuptimit të kushtit *Tadiq*, për vërtetimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur.

(a) Ashpërsia e konfliktit

208. Megjithëse ekzistenca e një konflikti të armatosur në periudhën e pretenduar apo në një pjesë të saj kundërshtohet dhe përbën pretendimin më rrënjësor në këtë proces gjyqësor, konstatohet se dëshmitë për ngjarjet e paraqitura në lidhje me ashpërsinë e konfliktit janë larg të qenit tërësore, shpesh të paplota, dhe në shumicën e rasteve, janë apo shfrytëzojnë median dhe raporte të tjera të dorës së dytë. Zakonisht ato karakterizohen nga mungesa e hollësive të nevojshme për shqyrtimin e këtij pretendimi, si numri i personave të përfshirë në secilën ngjarje, kohëzgjatja e ngjarjes, llojet e armëve të përdorura, identiteti i personave të përfshirë apo njësisë (në rast të tillë) së cilës i përkisnin; fakte të cilat janë të rëndësishme për përcaktimin nëse me të vërtetë veprimet e kryera ishin dhunë e kryer nga një grup i organizuar, pra UÇK-ja, apo thjesht shprehje të çorganizuara të dhunës që nuk kishin lidhje me UÇK-në.

209. Megjithëse Dhoma Gjyqësore mori si prova raporte të gjata të paraqitura nga dy dëshmitarë ekspertë për temën e konfliktit të armatosura dhe pikërisht nga Z. Viktor Bezruchenko për Prokurorinë[838] dhe Dr Blagoja Markovski për Mbrojtjen e Tarçulovskit,[839] si dhe ka dëgjuar dëshmitë e tyre gojore, besueshmëria e analizave të të dy dëshmitarëve ekspertë u vu në pikëpyetje. Në rastin e dëshmitarit ekspert të

---

837 Aktakuza, para. 52.
838 Prova Materiale P466.
839 Prova Materiale 2D101.

Prokurorisë, përfshirja e tij në punën e Prokurorisë gjatë fazave hetimore[840] mund të ketë ndikuar në vlerësimin objektiv të fakteve lidhur me përfundimin mbi ekzistencën e konfliktit të armatosur. Gjithashtu raporti i Z Bezruchenko mbështetej shumë në lajmet prej medias, të cilat ishin përgjithësisht të paqarta dhe të pakonfirmuara nga burime të tjera, apo në raporte të MB-së, të cilat nuk u pranuan si prova të pavarura. Ngjashmërisht, dëshmitari ekspert i Mbrojtjes së Tarçulovskit ka qenë shefi i shërbimit të marrëdhënieve publike si dhe zëdhënës i ushtrisë së IRJM-së gjatë vitit 2001[841], kështu që ka dyshime për objektivitetin e tij në vlerësimin e situatës. Më tej Dhoma Gjyqësore thekson se duket se raporti dhe dëshmia e Dr Markovskit bazohen në përkufizime jo të sakta ligjore, e për pasojë rëndësia e një pjese të konsiderueshme të raportit të tij ishte e pakët për çështjen e trajtuar nga Dhoma Gjyqësore.

210. Burime të tjera të pranuara si prova lidhur me çështjen e konfliktit të armatosur përfshijnë raporte të organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare që vepronin në IRJM në atë kohë, si Grupi Ndërkombëtar i Krizave, NATO dhe OSBE, si dhe raporte të brendshme të MB-së. Këto raporte u konsideruan përgjithësisht të besueshme. U vu në dukje se një pjesë e madhe e informacionit që përmban "Libri i Bardhë" i MB-së[842] për ngjarjet e vitit 2001, nuk është verifikuar në mënyrë të pavarur, por është thjesht një përsëritje e fakteve të pretenduara në një raport tjetër të MB-së të titulluar "Informacion për veprimtarinë e UÇK-së në territorin e Maqedonisë."[843]

211. Një problem tjetër lidhur me provat për incidentet e dhunshme në vitin 2001, është se burimet shpesh i cilësojnë si akte të kryera nga "terroristë," "grupe të armatosura shqiptare" apo "grupe terroriste diversioniste," të cilat mund të jenë ose mund të mos jenë referime ndaj veprimeve të UÇK-së. Dhoma Gjyqësore e ka patur të pamundur të verifikojë nëse të gjitha aktet e kryera në këto raste duhet t'i atribuohen pikërisht UÇK-së. Dhoma Gjyqësore merr parasysh faktin se në disa incidente apo luftime, mund të kenë marrë pjesë edhe grupe apo individë të tjerë të cilët, për arsye të ndryshme, kryen akte

840 Viktor Bezruchenko, T 6879-6898 (dëshmoi se kishte marrë pjesë në intervistimin e dëshmitarëve dhe se u kishte bërë atyre edhe pyetje të drejtpërdrejta), T 6910-6913 (dëshmoi se kishte marrë pjesë në takime me Prokurorinë lidhur me aspekte të hetimit të çështjes), T 6913 (dëshmoi se kishte konfiskuar materiale në emër të Prokurorisë).

841 Blagoja Markovski, T 10611; *shih* Provën Materiale 2D100.

842 Prova Materiale P45. Në këtë dokument incidentet e përshkruara u atribuohen përgjithësisht "grupeve terroriste" pa hollësi të tjera.

843 Prova Materiale 1D342.

dhunë për prishjen e qetësisë gjatë kësaj periudhe. Duke mbajtur parasysh këto mangësi, Dhoma Gjyqësore do t'i shqyrtoje provat për ngjarjet e vitit 2001 në IRJM sipas rendit kronologjik.

212. Në janar 2001, ka dëshmi për dy sulme kundër stacioneve policore të kryera nga grupe të armatosura shqiptare përkatësisht në Haraçinë[844] dhe Tearcë[845], në rajonin e Tetovës. Në lidhje me sulmin kundër stacionit policor të Tearcës, u raportua përdorim bombash,[846] dhe automatikësh si dhe një granathedhësi apo bombave të dorës.[847] U sugjerua se përgjegjësia për këtë sulm ishte marrë përsipër nga UÇK-ja.[848] Në muajin shkurt pati një shtim të pranisë së forcave ushtarake të IRJM-së gjatë kufirit verior me Kosovën.[849] Në fshatin kufitar të Tanushës u raportuan të paktën tri incidente.[850] Ekzistojnë prova se një grup i armatosur i UÇK-së rrëmbeu një ekip gazetarësh, të cilët i liroi më pas, pa iu shkaktuar asnjë lëndim.[851] Po atë ditë një patrullë ushtarake kufitare[852] u sulmua nga persona të armatosur të veshur me rroba të zeza kamuflimi pasuar nga një shkëmbim zjarri si pasojë e të cilit u plagosën disa "anëtarë të UÇK-së.[853] U pretendua se luftimet në zonën e Tanushës ishin shkaktuar si rezultat i përpjekjes së UÇK-së për të kontrolluar hyrjen në zonën e Malit të Zi të Shkupit.[854] Ka dëshmi se rruga e Malit të Zi të Shkupit u përdor nga grupet "terroriste" për të transportuar armë, drogë, dhe njerëz.[855] Viktimat e shkaktuara si rezultat i përleshjeve të armatosura gjatë gjithë muajve janar dhe shkurt, ishin të paktën katër policë të vrarë.[856]

---

844 M056, T 2150; Zoran Jovanovski, T 4921. *Shih* edhe Provën Materiale P45, f. 109 (*shih* N005-7716); 1D342, f. 7 (Raporti i Drejtorisë së Sigurimit dhe Kundërzbulimit të Ministrisë së Brendshme thotë se sulmi ndodhi një vit më parë, më 11 janar 2000).

845 Prova Materiale 1D256, p 2; *shih* gjithashtu Risto Galevski, T 3732; Provat Materiale 1D227 (lajm shtypi); 1D342, f. 7; P45, f. 109, 326; P466, Pjesa 5, f. 1.

846 Prova Materiale 1D227.

847 Provat Materiale 1D342; P466, Pjesa 5, f. 1 (e cila citon një lajm të AFP-së për incidentin); Viktor Bezruchenko, T 6997-7002.

848 Prova Materiale 1D256, p 3.

849 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 2; para. 169.

850 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 2 dhe para. 169; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D256, f. 5.

851 Prova Materiale 1D256, f. 4; dy dëshmitarë, dokumenta të MB-së dhe qeverisë maqedonase dhe raporti i Viktor Bezruchenkos, duke cituar lajme shtypi, japin të gjithë dëshmi të njëjta lidhur me këtë incident; M084, T 1453; M037, T 818; Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 2; P45, f. 109; 1D342, f. 7.

852 M037, T 827; Forcat maqedonase të sigurisë kishin një apo dy Hermelina që patrullonin në zonën kufitare të Tanushës dhe Ramnos.

853 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 2.

854 Prova Materiale P466, para. 169 (citohet një artikull të *Jane's Intelligence Review*, Vol. 13, Nr. 6, f. 18-19).

855 M037, T 818.

856 M056, T 2150; Zoran Jovanovski, T 4921; Prova Materiale 1D256, f. 2.

213. Në muajin mars pati rritje të numrit të përleshjeve të armatosura midis forcave ushtarake dhe policore të IRJM-së dhe UÇK-së, përleshje të karakterizuara nga të shtëna sporadike, përdorim të minave tokësore nga UÇK-ja, shkëmbime zjarri në masë të vogël, granatim prej forcave maqedonase të pozicioneve të UÇK-së, sulme me armë automatike si dhe hapje zjarr nga UÇK-ja kundër autokolonave të policisë.[857] Ka dëshmi se ndërkohë vazhdonte konflikti në zonat përreth Tanushës.[858] U raportua se më 8 mars u sulmua një autokolonë në të cilin udhëtonte edhe i Akuzuari Lube Boshkoski, i sapoemëruar si "Këshilltar Shteti," në fshatin Brezë, në zonën kufitare pranë Tanushës.[859] Dëshmitë sugjerojnë se më pas konflikti u shtri në Tetovë dhe në rajonin e Malit të Zi të Shkupit.[860] Presidenti lëshoi disa vendime në lidhje me përdorimin e forcave të sigurisë së IRJM-së, ku urdhërohej që ushtria maqedonase t'u përgjigjej "sulmeve me armë" të "grupeve diversioniste-terroriste";[861] mobilizimin e Batalionit të Parë dhe të Katërt Gardist, përdorimin e Batalionit Artilerik të Brigadës së Parë të Këmbësorisë, kalimin e të gjitha njësive ushtarake në gatishmëri të plotë luftarake;[862] urdhërimin konkret të operacionit për "shkatërrimin e terroristëve" në zonën e Tetovës, për rimarrjen e kontrollit të territorit;[863] si dhe një operacion tjetër të posaçëm për "shkatërrimin e terroristëve " në zonën e Kumanovës.[864] U mobilizuan rezervistë të ushtrisë[865] dhe të policisë.[866] Në fillim të marsit u organizua operacioni Ramno për bashkërendimin dhe drejtimin e veprimtarive në përgjigje të krizës.[867] Më 12 mars Këshilli i Sigurimit i OKB-së lëshoi një Deklaratë të Kryetarit, e cila dënonte dhunën e "ekstremistëve të armatosur shqiptarë etnikë" dhe shprehte shqetësim për rrezikun që i kanosej stabilitetit dhe sigurisë në IRJM dhe më

857 Provat Materiale 1D342, f. 7-8; 1D230; 1D343; P45, f. 110-112, 327-329.
858 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 3-5; 1D342, f. 7.
859 Prova Materiale 1D340.
860 *Shih* në përgjithësi Provën Materiale P466, Pjesa 5, f. 3-10; para. 170-172. Tetova është afërsisht 35 kilometra në perëndim të Shkupit, është qyteti i dytë më i madh i Maqedonisë dhe është i banuar kryesisht nga shqiptarët etnikë; *shih* gjithashtu Provën Materiale P45, f. 110 (ku bëhet e ditur se më 8 mars, dega e punëve të brendshme e Tetovës u sulmua me një granathedhës, që shkaktoi dëme materiale); Provat Materiale 1D256, f. 6; P466, Pjesa 5, f. 6 (bëhet e ditur se nga 13 deri më 17 mars, UÇK-ja luftoi kundër forcave të ndryshme maqedonase në Tetovë dhe rreth saj).
861 Provat Materiale P473.
862 Prova Materiale P474.
863 Provat Materiale 1D51; P475; 1D79 (nën vulë).
864 1D80 (e mbyllur me vulë). *Shih* gjithashtu M051, T 4173
865 M051, T 4173; Prova Materiale P474.
866 Prova Materiale P393; M084, T1453. Në varësi të intensitetit të konfliktit, numri i rezervistëve të policisë ndryshonte nga 5,101 deri në 10,211 persona, Prova Materiale P393.
867 Prova Materiale 1D112; Petre Stojanovski, T 9116; Risto Galevski, T 3704 (të cilët dëshmuan se të gjitha organet shtetërore dhe të sigurisë së vendit ishin të detyruara t' dërgonin informacione lidhur me UÇK-në dhe/ose grupe të tjera "terroriste", shtabit qendror, i cili ua përcillte informacionin pjesëmarrësve të veprimeve operative).

gjerë prej dhunës.[868] Lidhur me përleshjet në zonën e Tetovës rreth mesit të marsit, ekzistojnë prova se UÇK-ja përdori armë të vogla, mortaja të lehta, granathedhësa,[869] si dhe armë të kalibrit të madh, predha, dhe bomba dore.[870] Si rezultat i luftimeve të ashpra në zonën e Tetovës,[871] më 20 mars qeveria e IRJM-së bëri thirrje për një armëpushim 24-orësh, si dhe i paraqiti një ultimatum UÇK-së që të dorëzohej ose të largohej nga Maqedonia;[872] ka dëshmi se ky armëpushim u refuzua.[873] Megjithëse raporti i Viktor Bezruchenko-ss, duke cituar njoftime të shtypit, pohon se UÇK-ja u përgjigj duke shpallur një armëpushim të njëanshëm,[874] Dhoma thekson se ekzistojnë edhe dëshmi të kundërta që tregojnë se luftimet vazhduan dhe se pati njoftime për një numër viktimash.[875]

214. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se deri rreth mesit të marsit konflikti ishte përhapur në zonën e Kumanovës,[876] duke përfshirë fshatrat Likovë dhe Allashec.[877] Më 25 mars ushtria filloi një ofensivë në zonën kufitare të Tetovës,[878] dhe nga data 26 deri më 31 mars, kundër forcave të UÇK-së pranë Likovës dhe zonës së Malit të Zi të Shkupit.[879] Ka dëshmi se gjatë ofensivës në zonën e Tetovës, ushtria përdori tanke T-55, topa 120-milimetërsh si dhe helikopterë luftarakë në mbështetje të trupave të armatosura.[880] Si rezultat i ofensivës, ushtria pretendoi se kishte rifituar kontrollin e zonës së Tetovës.[881] Më 21 mars, Këshilli i Sigurimit i OKB-s miratoi Rezolutën 1345, e cila dënonte dhunën dhe mirëpriste përfshirjen e strukturave të ndryshme ndërkombëtare në

868 Prova Materiale 1D343.
869 Prova Materiale P466, para. 171.
870 Prova Materiale P45, f. 110-111.
871 Provat Materiale P45, f. 111; P466, Pjesa 5, f. 7, e cila citon lajme shtypi; 18 mars, forcat maqedonase granatuan pozicionet e UÇK-së me artileri të rëndë nga zona e Malit të Zi të Shkupit; 20 mars, ushtarët e IRJM-së u sulmuan në një kullë vrojtimi në Goshince; më tej në veri, u sulmua një patrullë e IRJM-së; luftime të ashpra vazhduan në Tetovë më 20 mars.
872 Prova Materiale 1D225; *Shih* gjithashtu Provën Materiale P466, Pjesa 5, f. 7, e cila citon lajme shtypi.
873 Prova Materiale 1D225.
874 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 7.
875 Provat Materiale P45, f. 111-112; 1D342, f. 7-8.
876 Provat Materiale 1D342; P45, f. 111-112.
877 Provat Materiale P45, f. 111; P466, Pjesa 5, f. 6, e cila citon lajme shtypi.
878 Prova Materiale 1D256, f. 7-8.
879 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 9, e cila citon lajme shtypi.
880 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 9.
881 Prova Materiale 1D256, f. 8 (N0025180).

zgjidhjen e krizës.[882] Organizatat ndërkombëtare u angazhuan në monitorimin dhe parandalimin e dhunës së mëtejshme.[883]

215. Në prill u raportuan pesë incidente dhune,[884] duke përfshirë një sulm në pritë të UÇK-së pranë Vejcës në zonën e Tetovës më 28 prill, në të cilën u vranë katër policë nga Manastiri si dhe katër ushtarë.[885] Më 29 prill ky sulm u dënua nga Kryesia e Bashkimit Evropian nëpërmjet një deklarate.[886] Dhoma Gjyqësore ka marrë prova për protesta të mëdha në Manastir më 31 prill – 2 maj si reagim ndaj sulmit në pritë prej UÇK-së.[887] U dëmtuan, plaçkitën apo dogjën të paktën 16 njësi tregtuese si dhe një numër shtëpish, kryesisht të shqiptarëve etnikë. Sipas njoftimeve, u sulmua edhe një xhami.[888] Si rezultat i përleshjeve gjatë gjithë marsit dhe prillit 2001, u vranë të paktën 10 ushtarë,[889] si dhe u plagos një numër policësh,[890] luftëtarësh të UÇK-së dhe civilësh.[891]

216. Në maj dhe qershor ngjarjet në IRJM morën një kthesë veçanërisht serioze.[892] Ka dëshmi se më 3 maj ose rreth kësaj date, "militantët" hynë në fshatrat Vaksincë dhe Sllupçan në rajonin e Kumanovës.[893] U raportua për një sulm me mortaja kundër një postblloku të ushtrisë si dhe për një pritë kundër dy ushtarëve të IRJM-së në këto

882 Prova Materiale 1D230 f. 11-12 (N0009019-N0009020); Viktor Bezruchenko dëshmoi se Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan, Bashkimi Evropian, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbajtën të njëjtin qëndrim si ai që pasqyrohet në rezolutën e Këshillit të Sigurimit, ndërsa Blagoja Markovski dëshmoi se NATO-ja dhe OSBE-ja mbajtën qëndrim të njëjtë negativ ndaj dhunës në Maqedoni. *Shih* Viktor Bezruchenko, T 7062-7063 dhe Blagoja Markovski, T 10632. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 2D70 (ku Ambasadori britanik në IRJM dënon "terroristët").

883 *Shih* përgjithësisht Provat Materiale 1D343; P45, f. 327-328; veçanërisht,*shih* Provën Materiale 1D230.

884 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 10-11, e cila citon raporte të qeverisë maqedonase dhe lajme shtypi; në këto sulme përfshihej një sulm kundër një postblloku të forcave maqedonase të sigurisë pranë Tetovës, hedhja në erë e një automjeti nga një minë, hapja zjarr ndaj forcave të KFOR-it, rrëmbimi i një polici, dhe një pritë e realizuar nga UÇK-ja pranë Velcës.

885 Provat Materiale P45, f. 112-113; P466, Pjesa 5, p 11, e cila citon raporte të qeverisë maqedonase dhe lajme shtypi; *shih* gjithashtu Nazim Bushi, T 5792-5793; Gëzim Ostreni, T 7595-7611.

886 Prova Materiale 1D261.

887 Prova Materiale P45, f. 112-113; Kristo Zdravkovski, Prova Materiale 1D125; *Shih* gjithashtu 1D338, f. 3-4.

888 Prova Materiale P466, f. 12-13; Kristo Zdravkovski, Prova Materiale 1D125.

889 Provat Materiale 1D342, f. 7-8; P45, f. 110-112; P466, Pjesa 5, f. 3, 9-11 e cila citon raporte të qeverisë maqedonase dhe lajme shtypi.

890 Provat Materiale P45, f. 139-148; P466, Pjesa 5, f. 8-11, e cila citon raporte të qeverisë maqedonase dhe lajme shtypi.

891 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 3-10, FN 23; P45, f. 110-111; *shih* gjithashtu Provat Materiale 1D342; 1D230; 1D343.

892 Prova Materiale 2D69.

893 Prova Materiale P494, f. 3.

fshatra.[894] Forcat maqedonase ndërmorën ofensiva në fillim të majit dhe në javën e fundit të po atij muaji për "shkatërrimin e forcave terroriste" në rajonin e Kumanovës.[895] Gjatë ofensivave u përdorën armë të rënda, ndër të tjera autoblinda, helikopterë luftarakë dhe granatime.[896] Edhe UÇK-ja përdori lloje të ndryshme armësh.[897] Pas ofensivës së parë u tha se qeveria po shqyrtonte mundësinë e shpalljes së gjendjes së luftës;[898] ajo i caktoi UÇK-së 17 majin, si afat për t'u tërhequr apo për të dorëzuar armët dhe shpalli armëpushim deri në mbarim të afatit.[899] Banorët civilë u evakuuan prej zonave të luftimeve nga KNKK-ja.[900] Gjatë gjithë muajit UÇK-ja vazhdoi sulmet kundër pozicioneve të ushtrisë dhe policisë në veriperëndim të Tetovës.[901]

217. Më 22 maj, Ali Ahmeti, "përfaqësues politik" i UÇK-së, Arben Xhaferi, kryetar i PDSH-së dhe Imer Imeri, kryetar i PPD-së (Partia për Prosperitet Demokratik), të dy parti politike të shqiptarëve etnikë në IRJM, nënshkruan "Marrëveshjen e Prizrenit," në të cilën ata binin dakord për veprim të përbashkët për zgjidhjen e problemeve të popullsisë shqiptare etnike në IRJM.[902] Pas ofensivës së dytë në fund të majit u raportuan incidente të tjera dhune në fshatrat Mateç,[903] Opajë,[904] në afërsi të Nikushtakut,[905] dhe pranë kufirit me Kosovën,[906] si dhe një sulm me mortaja në periferi të qytetit të Kumanovës.[907] U raportua se UÇK-ja kishte përdorur mortaja dhe automatikë,[908] dhe se gjatë këtyre sulmeve kishte lëshuar edhe një raketë tokë-ajër për të rrëzuar një helikopter të forcave të

894 Provat Materiale P45, f. 113; 1D342, f. 9; P466, Pjesa 5, f. 13; një sulm me mortajë u krye kundër një postblloku të ushtrisë në zonën e Kumanovës; në Vaksincë, dy ushtarë u vranë në një pritë dhe një tjetër u kap rob.

895 Provat Materiale 1D50; P494 f. 3; P466, Pjesa 5, f. 18; *shih* gjithashtu Gëzim Ostrenin, T 7469-7471, 7835, i cili flet për zhvillimin e një ofensive kundër brigadës së 113-të të UÇK-së të vendosur në fshatrat e rajonit të Kumanovës.

896 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 13 dhe 18; *shih* gjithashtu Gëzim Ostrenin, T 7473 (i cili dëshmoi se deri në atë kohë kishte patur shkëmbime të rregullta zjarri midis anëtarëve të UÇK-së dhe forcave të ushtrisë dhe policisë, por tani forcat e ushtrisë dhe policisë filluan të përdornin armë artilerike dhe helikopterë); Prova Materiale P494, f. 3.

897 Prova Materiale P601; Blagoja Markovski, T 10718; *shih* gjithashtu Gëzim Ostrenin, T 7839 (i cili diskuton për armët e përdorura nga UÇK-ja gjatë opeacionit të forcave maqedonase të sigurisë në Vaksincë).

898 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 15 (e cila citon lajme shtypi).

899 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 16 (e cila citon një lajm shtypi si dhe "informacione të marra në shtabin qendror në Ramno").

900 Prova Materiale P392; *Shih* gjithashtu 1D156, f. 5; Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 16-17, KNKK-ja evakuoi gjithsej 187 civilë nga Lojana, Sllupçani, Vaksinca, Likova dhe Orizari.

901 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 14; 16; 17.

902 Prova Materiale P560.

903 Provat Materiale P45, f. 115; 1D342 f. 10; katër civilë u rrëmbyen dhe u mbajtën në xhaminë e Mateçit.

904 Provat Materiale P45, f. 114-115; 1D342, f. 9-10.

905 Provat Materiale P45, f. 115; 1D342, p 10; në afërsi të Nikushtakut u hap zjarr kundër pozicioneve të policisë.

906 Provat Materiale P45, f. 115; 1D342, f. 10; një autobot me ujë u hodh në erë nga një minë në rrugën nga fshati Banjan për në veriperëndim të Shkupit, pranë kufirit me Kosovën, dhe u vra një ushtar maqedonas.

907 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 19.

908 Provat Materiale P45, f. 114-115; 1D342, f. 9-10; Zoran Jovanovski, T4858, 4926.

sigurisë së IRJM-së[909]. Ka dëshmi se rreth kësaj kohe autoritetet maqedonase arrestuan 66 persona, 32 prej të cilëve u akuzuan për terrorizëm, 28 për armëmbajtje të paligjshme, një për organizimin e rebelimit të armatosur dhe një për sulm kundër rendit kushtetues.[910] Ofensivat dhe përleshjet e armatosura gjatë muajit maj, shkaktuan vdekjen e një numri anëtarësh të UÇK-së[911], pjesëtarëve të forcave të IRJM-së,[912] dhe civilëve.[913] Më 29 maj, Ministri i Brendshëm, i Akuzuari, Lube Boshkoski, krijoi një grup pune për mbledhjen e provave për krime lufte të kryera në territorin e IRJM-së.[914]

218. Incidentet e armatosura në zonën e Kumanovës vazhduan prej majit në fillim të qershorit si dhe gjatë gjithë pjesës tjetër të atij muaji.[915] Edhe në rajonin e Tetovës vazhduan përleshjet.[916] Në muajin qeshor, sulmet vazhduan dhe u shpeshtuan si nga forcat maqedonase po ashtu dhe nga UÇK-ja, si dhe u zgjerua zona gjeografike e luftimeve duke u shtrirë përtej Tetovës dhe Kumanovës për në Haraçinë dhe zonat përreth.[917] Si rezultat i shpeshtimit të sulmeve në fillim të qershorit, më 6 qershor kryeministri Georgievski kërcënoi se do t'i kërkonte parlamentit shpalljen e gjendjes së luftës.[918] Pavarësisht nga një komunikatë e UÇK-së që bënte thirrje për armëpushim të dyanshëm, luftimet në rajonin e Kumanovës vazhduan edhe javën e dytë të qershorit.[919]

---

909 Provat Materiale P45, f. 114-115; 1D342, f. 9-10.

910 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 19, e cila citon një "kërkesë të punonjësit të zyrës së prokurorisë së Shkupit për hetim dhe propozim për marrjen e masave izoluese," datë 28 nëntor 2001.

911 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 13, f. 18-19; P600.

912 Provat Materiale P45, f. 114-115; 1D342 f. 9-10; Zoran Jovanovski, T4858, 4926.

913 Provat Materiale P45, f. 149.

914 Prova Materiale 1D115.

915 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 20-23. Pavarësisht luftimeve nga 1 deri më 3 qershor, asnjë palë nuk arriti të vinte Mateçin nën kontrollin e vet. Luftime u zhvilluan edhe në Sllupçan dhe Otllë më 2 qershor. U raportua se më 4 qershor, në Ramno një automjet ndeshi në një minë. Pati njoftime për incidente në Sllupçan, Orizare, dhe Mateç, si dhe granatime në afërsi të Vishticës. Në Sllupçan, UÇK-ja pretendoi se kishte marrë Mateçin nën kontroll dhe se kishte ripushtuar Vaksincën. Më 9 qershor Sllupçani dhe Orizarja u sulmuan nga forcat maqedonase, të cilat përdorën tanke dhe artileri. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D342, f. 10.

916 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 21-23, 25 (luftime u zhvilluan në malet mbi Tetovën, në zonën e Selcës, Brodecit, Shipkovës dhe Popova Shapkës si dhe pati luftime në Gajre, pak më sipër Tetovës. UÇK-ja hapi zjarr kundër zonës Gradski Stadioni dhe stacionit policor si dhe kundër kazermave të Kuzman Josifovskit. Luftimet vazhduan në Tetovë, si dhe në Vejcë, Gurin e Kuq, Orllovc, dhe Porroj). *Shih* gjithashtu Provat Materiale 1D342, f. 10-11; P45, f. 115-117.

917 Prova Materiale P466, f. 20. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P488, një hartë e marrë nga arkiva e Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë, e përgatitur në fillim të qershorit 2001, me shënime në ngjyrë blu që tregojnë pozicionet e forcave qeveritare (Brigada e Parë Gardiste dhe Batalioni i Tretë Gardist në skajin e djathtë) dhe shënime me ngjyrë të kuqe që tregojnë pozicionet e UÇK-së. Shigjetat tregojnë kahun e avancimit të UÇK-së nga Kumanova drejt juglindjes, drejt kryeqytetit; dhe nga perëndimi drejt kryeqytetit. Viktor Bezruchenko, T 6543-6544.

918 Provat Materiale P494, f. 4; P466, Pjesa 5, f. 22.

919 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 22-23.

Më 8 qershor, afërsisht 250 anëtarë të UÇK-së[920] hynë në fshatin Haraçinë[921], që ishte rrezik i madh sigurie për qeverinë dhe e vendoste Shkupin brenda rrezes së qitjes së mortajave të UÇK-së.[922] Shumë civilë shqiptarë dhe maqedonas u larguan nga Haraçina dhe zonat përreth.[923] Ndërkohë vazhduan incidentet në Haraçinës dhe rrethinë.[924] U raportua gjithashtu se policia në afërsi të asaj zone filloi t'u shpërndante armë rezervistëve.[925] U dhanë dëshmi sipas të cilave rreth datës 11 qershor, policë nga pjesë të tjera të vendit u ridislokuan në zonën e Kumanovës.[926] Në këtë datë u bë një përpjekje tjetër për armëpushim; të dy palët e ndërprenë luftimin.[927] U raportua se gjatë këtij armëpushimi UÇK-ja u vuri zjarrin shtëpive të serbëve dhe maqedonasve etnikë si dhe një kishe në Mateç.[928] U raportua se forcat e KFOR-it arrestuan 19 individë të dyshuar si anëtarë të UÇK-së, si dhe konfiskuan 27 mina kundër këmbësorëve, 40 mitralozë, gjashtë granathedhës, 13 mortaja, tetë pistoleta si dhe municion, uniforma, para, ushqime, ujë dhe pajisje mjekësore.[929]

---

920 Dëshmitarët dhanë shifra të ndryshme të përafërta lidhur me numrin e anëtarëve të UÇK-së që kishin hyrë në Haraçinë, por burime më të besueshme thanë se ky numër ishte rreth 250. Blagoja Markovski, T 10906 (i cili dëshmoi se 250-260 ekstremistë të armatosur kishin hyrë në Haraçinë); Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 23 (Lube Boshkoski tha se në Haraçinë ishin rreth 800 guerilas të UÇK-së të armatosur mirë dhe e përshkroi gjendjen si "dramatike"); Prova Materiale 1D259, e cila duket se është një raport i qeverisë amerikane, thotë se më 8 qershor në Haraçinë ishin 30 anëtarë të UÇK-së. Viktor Bezruchenko dëshmoi se ky raport përgjithësisht përputhet me analizën e tij. Megjithatë, ai tha se, sipas mendimit të tij, në Haraçinë kishte anëtarë të UÇK-së që më parë se të ishte konstatuar prania e këtyre 30 burrave. Ai ishte gjithashtu i mendimit se "ashpërsia" e luftimeve midis UÇK-së dhe forcave maqedonase gjatë 10 ditëve të pushtimit tregonte se numri i forcave të UÇK-së të pranishme në atë zonë ishte shumë më i madh. Viktor Bezruchenko, T 7101-7106. Prova Materiale 1D162, f. 4, një raport i sektorit të analizës, hetimit, dhe informacionit të MB-së thotë se sipas disa vlerësimeve, në Haraçinë ishin 450-500 anëtarë të UÇK-së.

921 Provat Materiale 1D342, f. 11; P45, f. 116; 1D162, f. 4.

922 Prova Materiale 2D37 (BBC citohet Komandanti Hoxha që tha: "Do të filloj të sulmoj stacionet policore, dhe aeroportin, qeverinë dhe parlamentin. Çdo gjë që mund të bëj me mortajat tona 120 milimetërshe."); M051, T 4202-4203; Blagoja Markovski, T 10676; Prova Materiale 1D162, f. 4-5.

923 Provat Materiale 1D342, f. 11; P45, f. 116; P402, f. 33.

924 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 25 (U sulmuan postblloqet e forcave maqedonase në Straçincë dhe Bërnjarcë; një grup maqedonësh etnikë ishin orvatur të krijonin një grup të armatosur për mbrojtje dhe dy shqiptarë etnikë u vranë në Haraçinë, njëri u vra me armë zjarri dhe tjetri kishte vdekur nga rrahjet prej policisë; në fshatin Bërnjarc, pranë Haraçinës, sipas njoftimeve, policia shtiu dhe vrau shoferin e një Nissani Jeep, i cili kishte kaluar me makinë përmes një postblloku dhe kishte hapur zjarr kundër policëve. U njoftua se në makinë ishin gjetur një numër armësh; P45, f. 117; 1D342, f. 12.

925 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 25; f. 26, më 16 qershor, MB njoftoi se do t'i mblidhte armët që u ishin shpërndarë rezervistëve një javë më parë.

926 Prova Materiale P468.

927 UÇK-ja lëshoi një komunikatë me anë të së cilës urdhëronte një armpushim njëditor; Provat Materiale P511; P45, f. 117; 1D342, f. 11.

928 Provat Materiale P45, f. 11; 1D342, f. 11.

929 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 24.

219. U dhanë urdhra për veprim të përbashkët të MB-së dhe Mbrojtjes Civile për mbrojtjen e qytetit të Shkupit,[930] për komunikimin me postblloqet e MB-së, si dhe për sigurimin e pozicioneve kyçe.[931] U lëshua një vendim për krijimin e Komandës së Mbrojtjes për qytetin e Shkupit nën varësinë e së cilës do të ishin Brigada e 12 e Këmbësorisë, Brigada e 16-të e Këmbësorisë, Brigada e Parë Gardiste, si dhe Brigada e 8-të e Këmbësorisë.[932] Brigadat u mobilizuan me formacionin e tyre të plotë ushtarak, si dhe u la hapur mundësia për përdorimin e rekrutëve ushtarakë, që nuk ishin caktuar në njësi të veçanta.[933] Sipas Viktor Bezruchenko-s, numri i përgjithshëm i këtyre forcave ishte afërsisht 8,000 vetë.[934] Në gjysmën e parë të qershorit, Presidenti nxorri disa vendime për përgatitjen dhe mobilizimin e njësive të ndryshme ushtarake, përfshirë urdhrin e 8 qershorit për mobilizimin e plotë të Brigadës së Parë dhe të Dytë - të parë/të 25-të të Këmbësorisë së Lehtë si dhe urdhrin e 9 qershorit për mobilizimin e plotë të Batalionit Artilerik *Ogan* të Granathedhësve Shumëtytësh 128 milimetërsh, i cili i përkiste Regjimentit të Parë të Artilerisë së Përzierë të Korpusit të Parë.[935] Më 12 qershor, Kryeministri miratoi një vendim për krijimin e Njësisë së Posaçme, e përbërë nga njësi të ushtrisë dhe policisë, dhe e ngarkuar për të ndaluar dhe luftuar veprimet terroriste në Maqedoni.[936] Më 13 qershor, Presidenti lëshoi një urdhër tjetër për mobilizimin e disa brigadave dhe për mbrojtjen e Ohrit.[937] Më 15 qershor, Presidenti miratoi vendimin për krijimin e një njësie të përkohshme kundërterroriste të kategorisë

930 Prova Materiale 1D81, Urdhër i 11 qershorit, (mbrojtje kundërajrore, aviacion ushtarak, mbështetje me zjarr dhe artileri, sipas kërkësës). *Shih* gjithashtu Marijo Jurishiq, T 3343; M-051,T 4146.

931 Prova Materiale 1D82; *shih* gjithashtu Nikollçe Grozdanovski, T 10399; 10405; 10458 (dëshmitari dëshmoi se bateria e tij ishte dislokuar në zonën Lubancë-Luboten duke filluar nga 12 qershori 2001, me detyrë që të parandalonte depërtimin apo përparimin e "terroristëve" nga rajoni i Mateçit, Vaksincës dhe Sllupçanit, në drejtim të Shkupit). Shtabi i përgjithshëm do të angazhonte dhe dislokonte njësitë në drejtimin e fshatit Orman, si dhe do të krijonte një zonë mbrojtjeje në bazë të urdhrave të Ministrisë së Mbrojtjes (Mitre Despodov, T 2628).

932 Prova Materiale 1D99. Marijo Jurishiq informoi Dhomën Gjyqësore se meqë numri i rekrutëve ushtarakë që iu përgjigjën mobilizimit ishte i vogël, niveli i kërkesave u ul dhe, si pasojë, persona që normalisht nuk do të mobilizoheshin, u përfshinë në zbatimin e operacioneve. Gjithashtu, meqë përbërja e forcave rezerviste ndryshonte çdo 30 ditë, ishte e vështirë për komandantët të stërvisnin dhe të ruanin kontrollin efektiv të trupave. (T 3345-3346)

933 Prova Materiale 1D100.

934 Viktor Bezruchenko, T 6106.

935 Prova Materiale 1D58 (fshatrat Rugjincë, Sllupçan, Opajë, Mateç dhe Strimë); vendim i Presidentit për përgatitjen e njësive të ushtrisë dhe policisë për kryerjen e sulmeve kundër UÇK-së, në një rajon më të gjerë të Malit të Zi të Shkupit; *shih* gjithashtu Viktor Bezruchenko, T 6095-6097; Prova Materiale P476; Provat Materiale P477; P478 (këto urdhra lejonin përdorimi e rekrutëve ushtarakë, të cilët nuk ishin caktuar në njësi të veçanta). *Shih* gjithashtu Viktor Bezruchenko, T 6102-6103 (dëshmoi se mortaja shumëgrykëshe 128 milimetërshe *Ogan* përdoret për të shkatërruar forcat armike në një terren të hapur).

936 Prova Materiale 1D59.

937 Prova Materiale P479; Viktor Bezruchenko, T 6110 (dëshmoi se krijimi i mbrojtjes së qytetit të Ohrit në jug mund të jetë tregues i faktit se qyteti konsiderohej i kërcënuar nga UÇK-ja).

"A", e përbërë nga njësi të ushtrisë dhe policisë.[938] Ndërkohë UÇK-ja shpalli një armëpushim tjetër nga 14 deri më 27 qershor.[939]

220. Pavarësisht shpalljes së këtij armëpushimi, incidentet e dhunës së armatosur vazhduan gjatë gjithë gjysmës së dytë të muajit qershor.[940] Megjithëse u raportua për sulme të kufizuara në zonat e Tetovës, Haraçinës dhe Kumanovës më 19-20 qershor,[941] dëshmitë sugjerojnë se pati një shtim të numrit të përleshjeve në ditët e mëvonshme. Më 21 qershor, shtabi i përgjithshëm i ushtrisë maqedonase i dha urdhër njësisë së posaçme për kryerjen e operacioneve në një zonë të gjerë të Malit të Zi të Shkupit.[942] Njësive do t'u jepej mbështetje me transport, helikopterë luftarakë dhe artileri.[943] Më 22 qershor forcat maqedonase filluan një mësymje në Haraçinë dhe rrethinë.[944] U raportua se u përdorën helikopterë luftarakë si dhe artileria.[945] Operacioni vazhdoi edhe ditën e nesërme me granatime të dendura, të cilat i hapën rrugën forcave maqedonase për të hyrë në fshatin Haraçinë ku u luftua shtëpi më shtëpi.[946] Më 24 qershor UÇK-ja sulmoi postblloqe të policisë pranë Haraçinës.[947] Ekzistojnë prova se në bazë të një marrëveshjeje të arritur më 24 qershor, afërsisht 250 anëtarë të UÇK-së që ishin në Haraçinë, u evakuuan nën shoqërimin e 50 automjeteve amerikanë dhe francezë të KFOR-it për në fshatrat në zonën e Likovës,[948] proces që u monitorua nga NATO-ja dhe Bashkimi Evropian.[949] Gjatë gjithë këtij operacioni vazhduan të shtëna të atykëtushme, prej të cilave u plagos një zyrtar i ambasadës amerikane.[950] Incidente dhune vazhduan

938 Prova Materiale 1D60; Viktor Bezruchenko tha se vendimi për krijimin e grupit të ri u bazua në mendimin se nevojiteshin forcat shtesë të stërvitura dhe të pajisura për luftime asimetrike për të fituar epërsi në luftimet kundër e UÇK-së. (Viktor Bezruchenko, T 6532-6533)

939 Prova Materiale P512.

940 Provat Materiale 1D342, f. 12-13; P45, f. 118-119. Më 18 qershor u njoftua për sulme në zonën e pikës kufitare të Jazhincës; tre persona të armatosur të veshur me uniforma të zeza hapën zjarr me pushkë automatike kundër pozicioneve të policisë dhe në një incident tjetër që vazhdoi gjysëm ore, u hap gjithashtu zjarr nga një shtëpi në kufi me RFJ-në. Më 20 qershor, u njoftua se UÇK-ja sulmoi stacionin policor "Rasce" si dhe një patrullë nga ky stacion në Radushë. Më 21 qershor, UÇK-ja, e vendosur në Shipkovicë, sulmoi forcat maqedonase në Popova Shapka me mortaja dhe armë automatike. Më 23 qershor, një patrullë policore në Radushë ra në pritë dhe u sulmua me pushkë automatike dhe granathedhës.

941 Prova Materiale P45, f. 118; *shih* gjithashtu Provën Materiale P466, Pjesa 5, f. 26.

942 Prova Materiale 1D314.

943 Prova Materiale 1D314.

944 Provat Materiale P45, f. 118; 1D342, f. 12; 2D101, para. 149.

945 Provat Materiale P495; P466, Pjesa 5, f. 27.

946 Prova Materiale P495.

947 Provat Materiale P45, f. 119; 1D342, f. 13; P466, Pjesa 5, f. 28.

948 Prova Materiale P514 (marrëveshja e 24 qershorit); Gëzim Ostreni, T 7495-7497; pas një marrëveshjeje midis komandantit të UÇK-së, Ali Ahmetit dhe përfaqësuesve të NATO-s.

949 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 28.

950 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 28.

edhe në ditët e mëvonshme.[951] U ra dakord për disa armëpushime, por ato nuk u zbatuan.[952] Luftimet midis policisë dhe UÇK-së rifilluan më 26 qershor dhe në ditët e mëvonshme në zonat e Tetovës[953] dhe Kumanovës.[954] Më 27 qershor, ushtria granatoi Nikushtakun, ku ishin vendosur disa anëtarë të evakuuar të UÇK-së.[955]

221. Në fillim të korrikut, pati të paktën 10 incidente dhune në të gjithë rajonet e Kumanovës, Tetovës dhe Radushës, që konsistonin kryesisht në sulme kundër pozicioneve të ushtrisë apo policisë nga "grupe terroriste" siç u përshkruan nga burime zyrtare të IRJM-së, sulme kundër patrullave apo autokolonave të policisë, si dhe reagim ndaj këtyre sulmeve nga forcat maqedonase, ku përfshiheshin granatime si dhe përdorimi i helikopterëve luftarakë.[956] Grupet "terroriste" gjithashtu ngritën postblloqe, pika kontrolli, dhe pozicione mitralozi.[957] Gjatë kësaj periudhe u vranë dy ushtarë dhe një anëtar i UÇK-së, si dhe u plagosën të paktën tetë ushtarë të IRJM-së dhe 28 civilë.[958]

222. Më 5 korrik, qeveria krijoi një organ bashkërendues, Qendrën e Menaxhimit të Krizës, me përgjegjësi për marrjen e masave për zgjidhjen paqësore të krizës[959] dhe që bashkëpunonte ngushtë me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, si me NATO-n dhe OSBE-në.[960] Përfaqësuesi i NATO-s Peter Feith, ndërmjetësoi një armëpushim midis UÇK-së dhe qeverisë maqedonase.[961] Ky armëpushim hyri në fuqi më 6 korrik dhe u

---

951 Provat Materiale P45, f. 119-120; 1D342, f. 13-14 (sulm kundër postblloqeve policore në Haraçinë; 25 qershor, sulm kundër forcave maqedonase të vendosura në Popova Shapka, duke përdorur "predha të kalibrit 120 mm"; u njoftua për sulme të tjera në Tetovë kundër postblloqeve të policisë pranë stadiumit të Tetovës si dhe në afërsi të kazermave ushtarake.

952 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 28 (lajme shtypi që njoftojnë se përfaqësuesit e NATO-s negociuan një armëpushim të kufizuar, por luftimet rifilluan në Haraçinë pas disa orësh; pasdite u bënë përpjekje për një armëpushim tjetër).

953 Provat Materiale P45, f. 120-121; 1D342, f. 14 (U sulmua një postbllok policor i vendosur midis fshatrave Llavcë dhe Sellcë, pranë Tetovës, ku u plagosën dy oficerë rezervistë; njoftime për hyrjen e UÇK-së në fshatra pranë Tetovës më 30 qershor, dhe pikërisht në Jedoarcë, Otunjë, Varvara, dhe Setolë, të cilat janë të banuara kryesisht nga maqedonas etnikë; u raportua se fshatarët u plackitën dhe u keqtrajtuan nga UÇK-ja; *shih* gjithashtu Provën Materiale P466, Pjesa 5, f. 30 (civilë të kërcënuar nga UÇK-ja për t'i detyruar të largohen nga ajo zonë).

954 Prova Materiale P45, f. 120; 1D342, f. 14; P466, Pjesa 5, f. 29-30 (postblloku ushtarako-policor në lokalitetin Nikushtak – Umin Dol u sulmua nga UÇK-ja, e cila përdori predha që shkaktuan zjarr në arat me misër; u sulmuan edhe postblloqe të tjera në të gjithë zonën e Tetovës; nga pozicionet e UÇK-së në periferi të Kumanovës u hap zjarr me mortajë, duke shkaktuar disa dëme në fabrikat).

955 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 29.

956 Prova Materiale P45, f. 121-124. *Shih* gjithashtu Provat Materiale 1D342, f. 15; P466, Pjesa 5, f. 31-33.

957 Prova Materiale P45, f. 123-124.

958 Provat Materiale P45, f. 121-122; 1D342, f. 15.

959 Zoran Jovanovski, T 4961.

960 *Shihi* Provën Materiale P249; Henry Bolton, T 1604-1607.

961 Gëzim Ostreni, T 7497-7498; Henry Bolton, T 1606-1607. Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të armëpushimit, u dha urdhër njësive nën komandën e saj, t'i përgjigjeshin zjarrit vetëm në vetëmbrojtje, dhe saktësoii se çdo veprim tjetër përbënte shkelje të armëpushimit, Prova Materiale 1D272, f. 1.

respektua, me përjashtim në Radushë, ku të dy palët vazhduan të përdornin armë të rënda.[962] Periudha 6 - 16 korrik u karakterizua nga një numër relativisht i vogël shkeljesh të armëpushimit, por informacione të ndryshme tregojnë për rritje të vazhdueshme të numrit të incidenteve.[963]

223. Më 9 korrik ose rreth kësaj date,[964] Qendra e Menaxhimit të Krizës miratoi "planin dhe programin për kapërcimin e krizës në Republikën e Maqedonisë"[965] si dhe "planin për përdorimin e forcave të sigurisë së RM-së,"[966] të cilat theksonin nevojën për operacione ushtarake ofensive për të detyruar terroristët të respektonin armëpushimin, si dhe për krijimin e "kushteve normale të kohës së paqes." Plani parashikonte gjithashtu misione "kërkimi dhe shkatërrimi" duke e vënë theksin tek nevoja për informacione të mira zbulimi në mënyrë që operacionet të planifikoheshin në mënyrë të tillë që t'i detyronin terroristët të reagonin (dhe si rezultat të shkatërroheshin).[967]

224. Pavarësisht nga zhvillimi i një raundi të ri bisedimesh për paqe, që prej 16 korrikut pati një rritje të numrit të shkeljeve të armëpushimit.[968] Më 16-17 korrik, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi një Qëndrim të Përbashkët që ndalonte lëshimin e vizave për "ekstremistët që rrezikojnë paqen dhe sigurinë e IRJM-së dhe kërcënojnë sovranitetin dhe tërësinë tokësore të IRJM-së."[969] Që prej 23 korrikut, numri i sulmeve kundër pozicioneve të forcave të IRJM-së u rrit në mënyrë të konsiderueshme në të gjithë rajonin e Tetovës[970], dhe këto forca u përgjigjen duke granatuar pozicionet e UÇK-së.[971]

962 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 33.
963 Provat Materiale P45, f. 124-126; P249, f. 12-14.
964 Zoran Jovanovski dëshnoi se organi koordinativ për menaxhimin e krizës miratoi projekt-plane më 9 korrik 2001. (Zoran Jovanovski, T 4965)
965 Prova Materiale 1D171. Ky plan vinte në dukje se kërcënimi që vinte nga UÇK-ja, prekte IRJM-në si dhe të gjithë rajonin, dhe theksonte se kjo situatë nuk mund të zgjidhej vetëm me "mjete ushtarake/policore" dhe se kërkohej dialog politik, se duheshin përdorur "mjetet përkatëse" për mbrojtjen e IRJM-së, se ishte e nevojshme të arrihej një armëpushim për zgjidhjen e krizës, se kjo duhej të pasohej nga çarmatimi, dhe se duhej të zbatoheshin operacione ushtarake për të "izoluar" terroristët.
966 Provat Materiale 1D174; 1D177.
967 Objektivi i planit ishte të "kthimi i ushtrisë së RM-së në pozicionet e saj në kohë paqeje." Plani i referohej domosdoshmërisë së "ruajtjes së gatishmërinë luftarake e cila nevojitej për t'ju përgjigjur siç duhej veprimeve të mëvonshme terroriste," si dhe përgatitjes intensive të forcave të sigurisë për "luftime kundër grupeve të armatosura ekstremiste," "për operacione të sigurisë," përgatitjes për "operacione kundër grupeve të armatosura ekstremiste që nuk do të respektojnë armëpushimin," nevojës për të garantuar lirinë e lëvisjes së automjeteve joushtarake, dhe "përdorimit të forcës […] në nivelin e duhur për të parandaluar […] viktima mininale në popullsinë civile." Prova Materiale 1D177.
968 Provat Materiale 1D342, f. 15-16; P45, f. 127-129.
969 Prova Materiale 1D237, f. 6.
970 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 36.
971 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 36.

Më 25 korrik, NATO-ja ndërmjetësoi një armëpushim tjetër ku UÇK-së iu kërkua të tërhiqej në pozicionet e vijës së frontit të 6 korrikut.[972] Sipas vlerësimit të Qendrës së Menaxhimit të Krizës, ditën e armëpushimit të 5 korrikut, UÇK-ja "ushtronte kontroll"[973] në 21 fshatra[974], kurse pas atij armëpushimi UÇK-ja "ushtronte kontroll" në më tepër se 39 fshatra.[975] Sipas Qendrës, nga 5 deri më 24 korrik, UÇK-ja ndërmori 93 sulme kundër forcave maqedonase të sigurisë, duke vrarë një individ dhe duke plagosur 16 të tjerë.[976] Të shtëna me pushkë, të shtëna të veçuara dhe sulme ndaj forcave të sigurisë përbënin pjesën më të madhe të shkeljeve të armëpushimit,[977] 78 përqind e të cilave ndodhën në zonën e Tetovës, 16 përqind në zonën e Kumanovës dhe 5 përqind në zonën e Shkupit.[978]

225. Me gjithë armëpushimin e ri, veprimet sporadike të dhunës vazhduan në të gjitha zonat kryesore të luftimeve.[979] Më 29 korrik, një autokolonë ku ishte edhe i Akuzuari Lube Boshkoski, e cila po udhëtonte në autostradën Tetovë-Shkup, u bë objekt i një "sulmi të pretenduar të grupeve të armatosura të shqiptarëve etnikë" pranë Karpallakut.[980] MB-ja paraqiti një kërkesë për hetime si dhe një kërkesë gjykatësit hetues të Gjykatës 2 të Shkupit për paraburgimin e anëtarëve të UÇK-së për kërcënim të tërësisë tokësore, rebelim të armatosur, akte diversioniste, si dhe për gjenocid, krime lufte kundër robërve të luftës dhe krime lufte kundër popullsisë civile.[981]

226. Në korrik KFOR-i kapi një sasi të madhe armësh që po futej kontrabandë në IRJM.[982] Më tej, në kundërshtim me disa dëshmi,[983] Dhoma Gjyqësore konkludon se

---

[972] Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 37.

[973] Qendra e menaxhimit të krizës e përkufizon përdorimin prej saj të shprehjes "ushtrimi i kontrollit" në kuptimin e "krijimit prej terroristët të strukturave pushtetare alternative nëpërmjet kufizimit të lëvizjes dhe keqtrajtimit të qytetarëve duke vendosur postblloqe; duke krijuar "organe pushtetare" në të ashtuquajturat "territore të çliruara". Prova Materiale P249, f. 3 (N0015594).

[974] Prova Materiale P249, f. 1- 2 (N0015592 -N0015593).

[975] Prova Materiale P249, f. 1- 2 (N0015592 -N0015593).

[976] Prova Materiale P249, f. 4-11 (N0015595 - N0015598).

[977] Prova Materiale P249, f. 9 (N0015596).

[978] Prova Materiale P249, f. 11 (N0015598).

[979] *Shih* Provat Materiale P45, f. 131-133; P466, Pjesa 5, f. 37-38.

[980] Provat Materiale 1D370, f. 1; P45, f. 132.

[981] Prova Materiale P391, Shtojca H (N0009930).

[982] Në një rast në korrik, KFOR-i gjeti tri depo të fshehta armësh të rënda dhe materiali logjistik në kufirin maqedonas me Kosovën (Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 34). Në të paktën dy raste të tjera në korrik, KFOR-i arrestoi deri në 56 persona që dyshoheshin se ishin luftëtarë të UÇK-së si dhe një vargan prej 55 kafshësh që transportonin materiale luftarake, si armë antitank, mortaja, pushkë automatike, granatahedhës si dhe municion (Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 33 and f. 37.)

[983] Gëzim Ostreni, T 7533-7534; 7539; 7563.

rreth 62 civilë dhe 3 ushtarë të forcave maqedonase u rrëmbyen nga UÇK-ja,[984] se u kryen edhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut,[985] dhe se ndaj popullsisë civile në zonat rreth Tetovës u bënë kërcënime.[986]

227. Luftimet vazhduan në Tetovë dhe rreth saj.[987] Më 1 gusht, gjatë luftimeve në zonën e Gostivarit u vranë pesë persona dhe u plagosën dy të tjerë.[988] Deri më 2 gusht, sipas njoftimeve, UÇK-ja kontrollonte pjesën më të madhe të Tetovës si dhe rrugën Tetovë-Jazhincë.[989] Ndërkohë UÇK-ja ishte furnizuar me disa armë moderne me origjinë nga Evropa Perëndimore dhe Amerika.[990]

228. Gjatë periudhës 5 - 8 gusht, UÇK-ja sulmoi pozicione të ndryshme të ushtrisë dhe policisë, veçanërisht në zonën e Tetovës.[991] Pati disa incidente të keqtrajtimit të maqedonasve etnikë, ndër të cilat rrëmbime,[992] dhe dëbime të dhunshme.[993] Gjithashtu UÇK-ja filloi të pushtonte fshatra rreth Tetovës.[994] Si shpagim, forcat e IRJM-së vranë në Shkup "Komandant Telin" e "Brigadës 115" të UÇK-së si dhe katër anëtarë të tjerë të UÇK-së.[995]

---

984 Provat Materiale P45, f. 124; P466, Pjesa 5, f. 32; *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D16; Provat Materiale 1D342, f. 15; P466, Pjesa 5, f. 35 (e cila njofton se më 18 korrik një grup i UÇK-së i përbërë nga 11 anëtarë dhe i komanduar nga "komandant Leka" rrëmbeu tre civilë nga fshati Otushishtë). Një qytetar maqedonas etnik u rrëmbye nga fshati Leshok më 22 korrik. *Shih* gjithashtu Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 36-37; 1D18, f. 2; P568 (e cila njofton se të paktën 20 persona u rrëmbyen prej UÇK-së, nga rajoni i Tetovës më 23 korrik). *Shih* gjithashtu P45, f. 130-132 (u raportua për rrëmbime të mëtejshme dhe incidente keqtrajtimi në të gjithë rajonin më 24 korrik dhe në ditët e mëvonshme); Igno Stojkov, T 8986-8987.

985 Një mesazh eletronik dërguar nga misioni i OSBE-së në Shkup ambasadorit Stoudmann, i datës 10 korrik, flet për shtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga UÇK-ja, ndër të cilat mbajtje e paligjshme e civilëve, punë me detyrim, rekrutim me forcë, përdorim i të miturve në operacione ushtarake, frikësim në një postbllok të UÇK-së, spastrim etnik, shkatërrim pa cak, përdorim i minave, si dhe nisje e luftimeve në zona të banuar nga popullsia civile. Prova Materiale 1D16; Henry Bolton, T 1656-1658.

986 *Shih* p.sh. Provat Materiale P45, f. 121, 125, 128; 1D342, f. 14, 15; P466, Pjesa 5, f. 33, 36, 37, 38; 1D267; 1D18; Mitre Despodov, T 2634.

987 Provat Materiale P45, f. 133.

988 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 40.

989 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 40.

990 M051, T 4208; Prova Materiale 2D40, f. 7.

991 Provat Materiale 2D40; P45, f. 134; P466, Pjesa 5, f. 40; P166 (më 5 gusht, një kamp i Ushtrisë së RM-së ku ishin vendosur ushtarë belgë të KFOR-it, u sulmua nga UÇK-ja, dhe një sulm i ngjashëm u u krye kundër pozicioneve të ushtrisë në Popova Shapka); Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 41 (më 6 gusht, pozicionet e forcave të IRJM-së në të gjithë zonën e Likovës u sulmuan me mitralozë të rëndë dhe mortaja); Prova Materiale P45, f. 134 (stacioni policor në Ratajë u sulmua nga UÇK-ja) dhe P466, f. 42 (u zhvilluan luftime në Xhaminë e Larme në Tetovë, dhe rreth rajonit, duke iu referuar në mënyrë të veçantë Neproshtenit, Reçicës së Vogël, Kalasë, Çarshisë së Vjetër, Drenocit, Gajres, Popova Shapkës).

992 Provat Materiale 1D19; P466, Pjesa 5, f. 41-42.

993 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 42.

994 Viktor Bezruchenko, T 6118-6119; Provat Materiale 2D40; P466, Pjesa 5, f. 42.

995 Blagoja Markovski, T 10856; M051, T 4210-4211; Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 41. Sipas Peter Bouckaert, më 5 gusht 2001, policia maqedonase vrau pesë persona në një shtëpi në Shkup siç u pretendua, gjatë, një beteje të ashpër me armë zjarri me anëtarë të UÇK-së, T 2952.

229. Më 8 gusht, UÇK-ja organizoi pritë kundër një autokolone në autostradën Shkup-Tetovë pranë fshatit Grupçin (zona e Karpallëkut), duke përdorur granathedhësa dhe armë këmbësorie, si dhe duke i vënë më pas zjarrin.[996] Gjatë sulmit u vranë 10 ushtarë të IRJM-së si dhe u plagosën tre prej tyre.[997] U shkatërrua një autoblindë Hermelinë si dhe u dëmtuan disa automjete ushtarake.[998] Si shpagim, helikopterët luftarakë të IRJM-së granatuan pozicionet e UÇK-së në atë zonë.[999] Në Prilep prej të cilit ishin pjesa më e madhe e ushtarëve të vrarë,[1000] një grup personash kërkoi armë për të sulmuar një fshat fqinj të banuar nga shqiptarë etnikë.[1001] Kur kjo kërkesë u refuzua, turma i vuri zjarrin një xhamie si dhe sulmoi dyqane që ishin prona të myslimanëve.[1002] Turma hyri gjithashtu me forcë në kazermat e ushtrisë në Prilep.[1003] Në Shkup, gjatë trazirave u dëmtuan prona dhe ndërtesa të shqiptarëve etnikë.[1004]

230. Po në këtë periudhë, Presidenti nxori një dekret urgjent që e urdhëronte ushtrinë të hynte në Tetovë "me qëllim që të parandalonte rënien e qytetit në duart e grupit terrorist të vetëquajtur UÇK, dhe për mbrojtjen e jetës, sigurisë dhe pronës së qytetarëve të Tetovës,"[1005] si dhe një vendim në të cilin ushtria urdhërohej që "të përgjigjej në kohën dhe mënyrën e duhur duke hapur zjarr kundër pozicioneve të terroristëve – sa herë që ata sulmonin forcat e sigurisë së Republikës së Maqedonisë si dhe sa herë kërcënohej jeta e anëtarëve të forcave të sigurisë."[1006]

231. Më 9 gusht, sulme të ndryshme nga UÇK-ja në rajonin e Tetovës dhe Radushës[1007] shkaktuan vrasjen e dy anëtarëve të forcave maqedonase të sigurisë si dhe plagosjen e 10 anëtarëve të këtyre forcave dhe pesë civilëve. U raportua se gjatë një sulmi kundër një postblloku të policisë pranë fshatit Gallatë, afër Gostivarit, forcat maqedonase

996 Provat Materiale 2D40; P482; Henry Bolton, T 1620-1625; Viktor Bezruchenko, T 6113-6117; M053, T 1985.
997 Provat Materiale P45, f. 134; P466, Pjesa 5, f. 41.
998 Prova Materiale 2D40.
999 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 41.
1000 Blagoja Markovski, T 10880; Prova Materiale P610.
1001 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 41.
1002 Provat Materiale P610; P466, Pjesa 5, f. 41.
1003 Blagoja Markovski, T 10880-10881; Prova Materiale 2D40, f. 8.
1004 Provat Materiale 1D127; P466, Pjesa 5, p 41; Risto Galevski, T 3745-3746.
1005 Prova Materiale P481.
1006 Prova Materiale 1D52.
1007 Prova Materiale 1D229.1.

të sigurisë vranë 11 persona që dyshoheshin se ishin luftëtarë të UÇK-së.[1008] U njoftua se sipas pretendimeve të MB-së, forcat maqedonase rimorën në kontroll rrugën kryesore Tetovë-Jazhince, e cila kishte qenë nën kontrollin e UÇK-së gjatë muajit të mëparshëm.[1009]

232. Ngjarjet e 10-12 gushtit lidhur me incidentin në Luboten, duke përfshirë incidentin me minë tokësore pranë Staneve të Lubotenit më 10 gusht, diskutohen gjetiu në këtë Aktgjykim. Po në këtë periudhë ndodhën incidente të dhunshme në vende të tjera, veçanërisht në Radushë, Gostivar, si dhe në Tetovë dhe rrethinë.[1010] Në fshatrat pranë Shkupit, UÇK-ja hapi zjarr kundër një aeroplani gjuajtës të IRJM-së, dhe për pak e rrëzoi atë.[1011] Në Radushë vazhduan luftime të ashpra dhe në mbështetje të trupave të atjeshme, forcat e sigurisë së IRJM-së dërguan helikopterë luftarakë si dhe aeroplanë gjuajtës Sukhoi SU-25 për sulme kundër objektivave tokësorë.[1012] U sulmuan edhe pozicionet e ushtrisë në Radushë ku një tank u godit dhe mori zjarr.[1013] Më 11 gusht 2001, Presidenti Trajkovski i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Annan, si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Xhorxh Robertson/George Robertson/, ku shkruhej se forcat e sigurisë dhe popullsia civile në zonën e fshatit Radushë dhe fshatin Rogaçevë ishin ballafaquar me sulme të vazhdueshme të terroristëve me zjarr këmbësorie dhe artilerie.[1014] Luftimet në rajonin e Tetovës vazhdonin.[1015] U njoftua se kishte patur të shtëna si dhe prani të shumtë të anëtarëve të UÇK-së në Nikushtak, Mateç, Sllupçan, Haraçinë, dhe Bojanë.[1016] Pati njoftime për mbylljen e përkohshme të autostradës Shkup-Tetovë për shkak të pranisë së UÇK-së. Qeveria e IRJM-së njoftoi për një armëpushim të

1008 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 42-43 (ku citohet BBC-ja që transmeton një lajm të agjencisë së lajmeve BETA, Serbi).
1009 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 43 (ku citohet BBC-ja që transmeton një lajm të agjencisë së lajmeve BETA, Serbi).
1010 Provat Materiale P45, f. 135; 1D13; P466, Pjesa 5, f. 43.
1011 Prova Materiale 2D44, f. 2.
1012 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 44; P605. Blagoja Markovski, T 10782; Risto Galevski, T 3761; Petre Stojanovski, T 9154-9155.
1013 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 45.
1014 Prova Materiale 2D101, para. 267.
1015 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 44.
1016 Provat Materiale 2D39; P466, Pjesa 5, f. 44-45.

njëanshëm.[1017] Pavarësisht prej këtij njoftimi, është e qartë se më 12 gusht në Luboten u krye një operacion me pjesëmarrjen si të forcave të policisë, po ashtu dhe të ushtrisë.

233. Më 13 gusht, u nënshkrua Marrëveshja Kuadër e Ohrit nga partitë kryesore parlamentare të maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë,[1018] si dhe nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian si garantues.[1019] UÇK-ja nuk ishte pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja përcaktonte vendosjen e një "armëpushimi të përgjithshëm, pa kushte dhe të pakufizuar", mbi bazën e parimit të gjetjes së "zgjidhjeve paqësore politike."[1020] Gjithashtu ajo u caktonte palëve detyrime për lehtësimin e kthimit të refugjatëve, rehabilitimin, dhe rindërtimin, si dhe parashtronte ndryshime thelbësore në kushtetutën e Maqedonisë, duke përfshirë pjesën hyrëse të saj si dhe të disa dispozitave të rëndësishme lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe, të drejtat për arsimim në gjuhën amtare, përfaqësim proporcional në organet e pushtetit, si dhe ristrukturim të disa funksioneve dhe kompetencave administrative në nivel komunal.[1021] Presidenti i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s ku shkruhej se anëtarëve të UÇK-së do t'u ofrohej amnisti, me përjashtim të atyre që kishin kryer krime që mbuloheshin prej juridiksionit të TPNJ-së.[1022]

234. Më 14 gusht, UÇK-ja nxori një komunikatë për marrëveshjen e nënshkruar me NATO-n, për çarmatimin dhe shpërndarjen e saj, në përputhje me Marrëveshjen e Ohrit.[1023] 14 persona të arrestuar në lidhje me operacionin në Luboten u nxorën para Gjykatës së Shkallës së Parë II të Shkupit dhe u akuzuan për veprën penale të "terrorizmit"[1024] dhe u lëshuan vendime për zgjatjen e paraburgimit të të arrestuarve edhe për 30 ditë të tjera.[1025] Më 26 shtator ose rreth kësaj date, akuzat për terrorizëm u zëvendësuan me akuzën "shërbim në ushtrinë armike," akuzë që gjen zbatim vetëm "gjatë luftës apo gjatë një konflikti të armatosur"[1026] mbi bazën e pretendimit se personat

1017 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 45.
1018 Gëzim Ostreni, T 7781-7782.
1019 Prova Materiale P84; *Shih* gjithashtu Provat Materiale 1D15; 1D345.
1020 Prova Materiale P84
1021 Prova Materiale P84.
1022 Prova Materiale 1D193.
1023 Provat Materiale P458; Prova Materiale P466, f. 46. *Shih* gjithashtu Provat Materiale 1D339; Nazim Bushi, T 5783; 6040.
1024 Prova Materiale P81, f. 111. *Shih më lart*, para. 85-95.
1025 Provat Materiale P25; P27; P54.049.
1026 Prova Materiale P81, f. 114.

e akuzuar kishin "marrë pjesë në konfliktin e armatosur si luftëtarë kundër Republikës së Maqedonisë" gjatë së cilit kishin marrë pjesë në "operacione intensive ushtarake ku u përdorën këmbësoria, armë dhe municione."[1027]

235. Luftimet vazhduan për pak ditë edhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër të Ohrit, por ato ishin më pak të ashpra se sa në periudhën para nënshkrimit të saj.[1028] Disa anëtarë të UÇK-së krijuan një grup më vete, Armata Kombëtare Shqiptare – AKSH, e cila kundërshtoi kushtet e Marrëveshjes së Ohrit dhe shpalli se do të vazhdonte sulmet kundër forcave të IRJM-së.[1029]

236. Disa ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit mbërritën forcat e NATO-s për operacionin e grumbullimit të armëve.[1030] Gjatë këtij operacioni, të quajtur "Essential Harvest", ku do të përfshiheshin 3,500 trupa të NATO-s,[1031] NATO-ja parashikonte që UÇK-ja të dorëzonte më tepër se 3,333 armë.[1032] Në raportin e NATO-s shkruhet se u grumbulluan gjithsej 3,875 armë.[1033] Krahas tyre u dorëzuan 354 shpërthyes si dhe 1,045 bomba dhe mina.[1034] U grumbulluan edhe katër autoblinda/tanke,[1035] por nuk ka prova se ishin përdorur nga UÇK-ja.

237. Numri i përleshjeve midis forcave maqedonase dhe UÇK-së apo AKSH-së filloi të pakësohej nga fundi i gushtit dhe me hyrjen e shtatorit me gjithë incidentet e herëpashershme në Tetovë dhe rrethinë, në zonën e Kumanovës dhe në Shkup, duke shkaktuar vrasjen e dy rojeve të sigurisë, maqedonas etnikë, plagosjen e dy civilëve,[1036] si dhe shkatërrimin më 21 gusht të manastirit të Shën Thanasit në Leshok, ndërtuar në shekullin e 14-të.[1037] Incidente sporadike të dhunës dhe përleshjeve vazhduan thuajse gjithë shtatorin,[1038] deri më 26 shtator[1039] kur Ali Ahmeti njoftoi se UÇK-ja zyrtarisht

[1027] Prova Materiale P46, f. 5 (E.T. 0463-8778); 11(E.T. 0463-8783).
[1028] Provat Materiale 1D23; P466, Pjesa 5, f. 46-47. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D268, f. 5.
[1029] Provat Materiale P485, f. 19; P466, f. 46.
[1030] Prova Materiale P516.
[1031] Prova Materiale P516.
[1032] Viktor Bezruchenko, T 7507.
[1033] Prova Materiale P519; Gëzim Ostreni, T 7509; 7588-7589, 7825.
[1034] Prova Materiale P519.
[1035] Prova Materiale P519.
[1036] Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 48-49.
[1037] Provat Materiale 1D268, p 5; 2D105; Henry Bolton, T 1664-1665.
[1038] Anëtarë të UÇK-së ose AKSH-së morën pjesë në ndalimin e pesë autobusëve me maqedonas etnikë të shpërngulur që dëshironin të vizitonin familjet e tyre në verilindje të Tetovës, në të shtëna kundër pozicioneve të

ishte shpërndarë, ndonëse disa sulme të UÇK-së apo AKSH-së u njoftuan edhe pas kësaj date në zonën e Tetovës.[1040] Më 21 shtator, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën e dytë për gjendjen në IRJM, me anë së cilës mirëpriti nënshkrimin e Marrëveshjes Kuadër dhe bëri thirrje për zbatimin e plotë të Rezolutës 1345.[1041]

238. Më 8 tetor 2001, Presidenti deklaroi se qeveria do të shpallte amnistinë për të gjithë ata persona që kishin kryer apo që akuzoheshin se kishin kryer akte kriminale gjatë konfliktit të vitit 2001 deri më 26 shtator, me përjashtim të atyre akteve që ishin nën juridiksionin e TPNJ-së.[1042] Më 26 tetor, Presidenti Boris Trajkovski i shkroi një letër Prokurores së TPNJ-së ku i kërkonte hetim për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera "në ato pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë që nuk ishin nën kontrollin e forcave maqedonase të sigurisë."[1043] Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi se në nëntor 2001, tre anëtarë të MB-së u vranë në një pritë të UÇK-së apo AKSH-së në Treboshit,[1044] dhe se më 3 dhjetor pati një shkëmbim zjarri midis një "grupi terrorist" apo "disa personave të armatosura" dhe ushtrisë pranë Lubotenit.[1045] Në dhjetor Presidenti nxori disa vendime për faljen e anëtarëve të UÇK-së të privuar nga liria, duke përfshirë ata që kishin marrë pjesë në ngjarjet në Luboten.[1046] Për këtë qëllim, më 8 mars 2002 doli një ligj amnistie,[1047] i cili u miratua në "mbështetje të paqes dhe për kapërcimin e krizës."[1048] Dekreti u akordonte amnisti të plotë të gjithë atyre "personave që kishin marrë pjesë në konflikt," me përjashtim të personave, të cilët kishin kryer krime që mbuloheshin prej juridiksionit të TPNJ-së.[1049]

---

forcave të IRJM-së rreth Likovës dhe Tetovës, në shpërthimin e tri bombave në Shkup, në hapje zjarri nga fshatrat pranë Tetovës kundër postave të policisë dhe pozicioneve të forcave të IRJM-së dhe kundër një autokolone të maqedonasve të shpërngulur në një lagje të Drenocit. Pati një përleshje midis UÇK-së apo AKSH-së dhe forcave maqedonase në kullën e vrojtimit të Goshincës në Malin e Zi të Shkupit dhe në Mateç dy shtëpi të banorëve joshqiptarë u dogjën, Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 50-51.

1039 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 50-51.

1040 Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, f. 12; *Shih* gjithashtu Provën Materiale P466, Pjesa 5, f. 51.

1041 Prova Materiale 1D346.

1042 Prova Materiale P585, f. 3 (N001-15917).

1043 Prova Materiale P391, Shtojca A.

1044 Zoran Jovanovski, T 4913-4914.

1045 Zoran Jovanovski, T 4987-4988; Provat Materiale 1D180; 1D139.

1046 Prova Materiale P50.045.

1047 Prova Materiale P83.

1048 Prova Materiale P585.

1049 Prova Materiale P83.

239. Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi kontradiktore lidhur me numrin e viktimave si rezultat i ngjarjeve të vitit 2001. Burime, që ndryshojnë nga njëri-tjetri, bëjnë të ditur se u vranë 15[1050] deri në 24[1051] policë si dhe 35[1052] deri 43[1053] deri 60[1054] anëtarë të ushtrisë. Gëzim Ostreni dëshmoi se ishin vrarë rreth 68 anëtarë të UÇK-së.[1055] "Libri i Bardhë" dokumenton vrasjen e 10 civilëve,[1056] kurse "Raporti për veprimtarinë e Ministrisë së Brendshme gjatë vitit 2001" thotë se u vranë 16 civilë.[1057] U plagosën afërsisht 150[1058] deri 174[1059] policë, 119[1060] deri 211[1061] deri 270[1062] anëtarë të ushtrisë, dhe 61[1063] deri 75[1064], deri 100[1065] civilë si dhe 20[1066] deri 36[1067] civilë u raportuan të zhdukur. Megjithëse asnjë nga këto shifra nuk është tërësisht e saktë, Dhoma Gjyqësore mendon se ato japin një ide të përgjithshme për numrin e viktimave gjatë ngjarjeve të vitit 2001. Duket se shumica e viktimave u regjistruan në qershor dhe gusht.

240. Përsa i përket numrit të personave të shpërngulur për shkak të konfliktit, Agjencia e Refugjatëve e OKB-së përllogariti se, deri në fund të gushtit, në Kosovë apo Serbinë Jugore kishte rreth 64,000 refugjatë nga Maqedonia, dhe se numri i të shpërngulurve brenda Maqedonisë arrinte rreth 70,000 vetë, ndër të cilët 15,000 "të mikroshpërngulur" shumë afër vendbanimeve të tyre, apo që ditën rrinin në shtëpitë e tyre dhe natën e kalonin gjetkë.[1068] Dëshmitë sugjerojnë se pjesa më e madhe e shpërnguljeve ndodhi në fund të marsit, rreth datës 8 qershor,[1069] në fund të korrikut si dhe prej fillimit deri në mes

1050 Prova Materiale P45, f. 139.
1051 Prova Materiale P393, f. 2 (N005-0691-ET-02).
1052 Prova Materiale P393, f. 2.
1053 Prova Materiale P45, f. 140-141.
1054 Prova Materiale P45, f. 8 (kjo shifër mund të përfshijë vdekjet si të anëtarëve të ushtrisë po ashtu dhe atyre të policisë, pasi referenca është "anëtarë të forcave të sigurisë").
1055 Gëzim Ostreni, T 7749.
1056 Prova Materiale P45, f. 148.
1057 Prova Materiale P393, f. 2.
1058 Prova Materiale P45, f. 142-145.
1059 Prova Materiale P393, f. 2.
1060 Prova Materiale P45, f. 146-148.
1061 Prova Materiale P393, f. 2.
1062 Prova Materiale P45, f. 8.
1063 Prova Materiale P393, f. 2.
1064 Prova Materiale P45, f. 150-151.
1065 Prova Materiale P45, f. 8.
1066 Prova Materiale P45, f. 153.
1067 Prova Materiale P45, f. 8.
1068 Prova Materiale 1D268, f. 6.
1069 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 24 (citohen raporte që bëjnë fjalë për lëvizjen e një numri të përgjithshëm prej 40,000 vetësh që nga janari, 2,700 individë të regjistruar me agjencitë e ndihmave më 8 qershor, dhe 7,000 që ikën në Kosovë që nga rënia e Haraçinës).

të gushtit.[1070] Sipas burimeve të IRJM-së, numri i refugjatëve nga Maqedonia ishte 80,000[1071] dhe numri i personave të shpërngulur brenda Maqedonisë arriti në më tepër se 86,000.[1072]

241. Sipas vlerësimeve të kryera prej Grupitt Ndërkombëtar të Menaxhimit ("IMG"), që kreu vlerësime më 13 shtator 2001 dhe më 19 qershor 2002, në zonat e prekura nga konflikti u dëmtuan në masë të ndryshme 6,500 shtëpi, shumica prej të cilave u përkisnin qytetarëve shqiptarë etnikë.[1073] IMG-ja përllogariti se kostoja për restaurimin bazë të të gjitha shtëpive të dëmtuara, arrinte në rreth 33 milion euro.[1074] Sipas përllogaritjeve të MB-së, dëmi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i shkaktuar ekonomisë, arrinte në gjysëm miliard euro dhe kostoja e dëmeve shkaktuar nga djegja, shkatërrimet, si dhe dëmtimet e shtëpive dhe pronave të qytetarëve dhe infrastrukturës, arrinte në më tepër se 150 milion euro.[1075]

242. Dhoma Gjyqësore ka marrë analiza të ndryshme lidhur me kontrollin territorial të UÇK-së gjatë vitit 2001. Kjo u ndërlikua nga fakti se burime të ndryshme përdorën përkufizime të ndryshme të termit "kontroll."[1076] "Raporti për veprimtaritë e Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë" i prillit 2002 pohon se sipas mendimit të MB-së, UÇK kishte "pushtuar përkohësisht" deri 20 përqind të pjesës veriperëndimore të Maqedonisë.[1077] Ndonëse UÇK-ja nuk kontrollonte ndonjë qytet të vogël apo të madh, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se pjesa më e madhe e zonave malore me fshatra të banuara kryesisht nga shqiptarë etnikë, ishin nën "kontrollin" e UÇK-së. Sipas përllogaritjeve të OSBE-së, UÇK-ja kishte nën kontroll 135 deri 140 fshatra, çka do të thoshte se policia nuk mund të

1070 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 37; 40-41; 45; 47.
1071 Prova Materiale P393 (N005-0650-ET-01).
1072 Prova Materiale P393 (N005-0691-ET-03).
1073 Prova Materiale P390, f. 3, para. 11.
1074 Prova Materiale P390, f. 3, para. 9.
1075 Prova Materiale P393 (N005-0650-ET-01).
1076 Theksohet se nuk ka ndonjë përkufizim konkret të termit "kontroll" të territorit në dokumentet e të drejtës humanitare ndërkombëtare. Dhoma Gjyqësore e TPNR-së në *Akayesu* konkludoi se territori nën kontrollin e një grupi të armatosur zakonisht është territori, i cili nuk është më nën kontrollin e forcave qeveritare. Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Akayesu*, para. 626.
1077 Prova Materiale P393 (N005-0650_ET-01). *Shih* gjithashtu Provën Materiale P249 (Raport i Qendrës së Menaxhimit të Krizës), f. 3 (N0015594) (ku përkufizohet shprehja "ushtrimi i kontrollit" në kuptimin e "krijimit prej terroristët të strukturave pushtetare alternative nëpërmjet kufizimit të lëvizjes dhe keqtrajtimit të qytetarëve duke vendosur postblloqe; duke krijuar "organe pushtetare" në të ashtuquajturat "territore të çliruara"'.")

kryente detyrat e veta në këto fshatra.[1078] Niveli i kontrollit nuk arriti nivelin e kontrollit të ushtruar nga autoritetet shtetërore[1079], mirëpo forcat maqedonase nuk mundën të hynin në këto fshatra për periudha të zgjatura. Dhomës Gjyqësore nuk iu paraqitën prova konkrete bindëse në mbështetje të pretendimit se UÇK-ja faktikisht kontrollonte zonat e shënuara në dy hartat e paraqitura nga Gëzim Ostreni –"Udhëzimi Operativ" i qershorit[1080] dhe harta e 5 korrikut, që iu dhanë NATO-s për të treguar territoret nën kontrollin e UÇK-së në kohën e armëpushimit[1081] – në dallim me thjesht praninë e UÇK-së në këto zona.

243. Ndonëse gjatë muajve të parë të vitit 2001 pati veprime të armatosura të UÇK-së, veçanërisht në zonat më malore në veriperëndim të vendit, në kufi me Shqipërinë dhe Kosovën, dëshmitë e përshkruara më sipër tregojnë një përshkallëzim të konsiderueshëm të ashpërsisë së incidenteve në Maqedoni nga maji deri në mesin e gushtit 2001 kur u nënshkrua Marrëveshja Kuadër e Ohrit, pavarësisht se nuk është gjithmonë e qartë nëse "grupet terroriste" të përfshira në këto ngjarje i përkisnin në fakt UÇK-së. Pati shtim të numrit të përleshjeve të armatosura me incidente dhune thuajse të përditëshme, të shtëna dhe provokime nga UÇK-ja si dhe reagim të zakonshëm ushtarak nga ushtria, ose policia ose të dyja.[1082] Pati gjithashtu një zgjerim gjeografik të zonave të luftimeve nga Tetova në Kumanovë-Likovë, rreth Shkupit dhe në Gostivar.[1083] Faktorë të tjerë të rëndësishëm ishin shpërndarja dhe përdorimi i armëve të rënda nga forcat maqedonase, duke përfshirë helikopterë luftarakë dhe tanket;[1084] shtimi i llojshmërisë së armëve të përdorura nga UÇK-ja; mobilizimi i ushtrisë dhe njësive policore në gatishmëri luftarake; thirrja e forcave rezerviste; numri i urdhrave për ofensiva ushtarake për "shkatërrimin e terroristëve";[1085] rrethimi i qyteteve, si Tetova (veçanërisht në gusht) dhe fshatrave, si Haraçina (në qershor); armëpushimet;[1086] thirrjet dhe ndërhyrja e aktorëve ndërkombëtarë për zgjidhjen e krizës nga të dy palët; arritja e një marrëveshjeje paqe për dhënien fund të

[1078] Henry Bolton, T 1608-1609. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D31, f. 1 (raport i OSBE-së i cili thotë se "grupe të armatosur shqiptarc" kishin marrë nën kontroll "zona të konsiderueshme" të vendit).
[1079] Blagoja Markovski, T 10893.
[1080] Prova Materiale P487. Gëzim Ostreni, T 7451-7452; 7458; 7777.
[1081] Prova Materiale P515. Gëzim Ostreni, T 7497-7498.
[1082] *Shih* më lart, para. 216-234.
[1083] *Shih* më lart, para. 216-234.
[1084] *Shih* më lart, para. 214; 216; 219; 220; 222; 232.
[1085] Provat Materiale 1D79; P475; 1D80; 1D50; 1D58; 1D81.
[1086] *Shih* më lart, para. 213; 216; 219; 220; 222; 232.

luftimeve;[1087] dhe numri i madh i personave të shpërngulur dhe refugjatëve për shkak të konfliktit. Janë edhe disa faktorë të tjerë që tregojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur në këtë vend: këtu përfshihen vëmendja e treguar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së i cili miratoi një rezolutë në mars ku dënoheshin "veprimtaritë terroriste" si dhe një rezolutë tjetër në shtator ku përshëndetej nënshkrimi i Marrëveshjes së Ohrit;[1088] ndërhyrja e KNKK-së për lirimin e personave të kapur nga të dy palët si dhe për njoftimin e familjeve të këtyre personave;[1089] procedimi penal nga autoritetet e IRJM-së i personave që i kishin shërbyer një ushtrie armike apo që kishin kryer akte të tjera të dënueshme vetëm gjatë një konflikti të armatosur;[1090] si dhe miratimi i një amnistie të gjerë për të gjithë ata që kishin marrë pjesë në konflikt, me përjashtimin të individëve që ishin akuzuar shprehimisht për krime lufte që do të procedoheshin në bazë të juridiksionit të TPNJ-së.[1091]

244. Dhoma Gjyqësore merr parasysh se pavarësisht këtij përshkallëzimi të qartë, pati relativisht pak viktima për të dy palët si dhe për civilët (sipas përllogaritjeve më të larta, numri i përgjithshëm i të vrarëve në vitin 2001 prej përleshjeve të armatosura, ishte 168), dhe dëmtimi material shkaktuar pronave dhe shtëpive ishte relativisht në masë të vogël. Këto shifra të vogla mund të tregojnë se pavarësisht nga përdorimi i armëve të rënda prej forcave të IRJM-së, përgjithësisht u tregua vetëpërmbajtje në mënyrën e përdorimit të këtyre armëve, gjë që mund të sugjerojë se synimi i operacioneve policore dhe ushtarake ishte ruajtja e rendit publik. Megjithatë, një faktor tjetër që lidhet me numrin e vogël të viktimave ishte se përleshjet e armatosura zakonisht ndodhën midis grupeve të vogla dhe prireshin të ishin lokale. Megjithëse siç u tha më sipër, dëshmitë jo gjithmojnë vërtetojnë plotësisht nëse incidentet apo përleshjet u kryen nga "UÇK-ja" apo nga grupe individësh që vepronin në mënyrë të pavarur, duhet vënë në dukje se përgjithësisht taktika e zgjedhur e UÇK-së ishte e një karakteri guerilas për faktin se shpesh kishte sulme të shpejta, të kryera nga një forcë e vogël e cila shfrytëzonte plotërisht terrenin. Kundrejt një taktike të tillë, ushtria kishte pak mundësi të reagonte me një ofensivë ushtarake në shkallë të gjerë, e cila normalisht do të shkaktonte një numër më të madh viktimash.

1087 *Shih* më lart, para. 233-234.
1088 *Shih* më lart, para. 214; 237; *shih* gjithashtu *para.* 213.
1089 Prova Materiale P607.
1090 *Shih* më lart, para. 234; *shih* gjithashtu para. 217; 225.
1091 *Shih* më lart, para. 238.

245. Dëshmitë e marra tregojnë se ka mospërputhje në zbatimin e kuadrit ligjor nga forcat e sigurisë së IRJM-së gjatë vitit 2001. Këto mospërputhje mund të jenë tregues i ekzistencës së një farë paqartësie, madje edhe mosmarrëveshjeve midis organeve të ndryshme të qeverisë për mënyrën se si duhej reaguar ndaj situatës ekzistuese.[1092] Dhoma Gjyqësore merr parasysh Urdhrin e Presidentit për ushtrinë në fillim të gushtit – periudha me intensitet më të lartë gjatë vitit 2001 – për përdorimin e forcës vetëm në përgjigje të sulmeve ndaj "të vetëquajturës UÇK" apo në vetëmbrojtje,[1093] një tregues i mundshëm I zbatimit të kuadrit ligjor. Mirëpo në shumë aspekte kuadri ligjor dhe adminitrativ i zbatuar nga qeveria e IRJM-së në veprimtarinë e saj saj gjatë vitit 2001, tregon se ai ishte i zbatueshëm në rastin e një konflikti të armatosur. Çdo urdhër i atij viti prej Presidentit u lëshua në bazë të Nenit 79(2) të Kushtetutës, që do të thotë se Presidenti vepronte në cilësinë e Kryekomandantit të forcave të armatosura.[1094] Urdhrat bënë thirrje vazhdimisht për mobilizimin e njësive policore, duke përfshirë rezervistët, të cilët, sipas Rregullores Zyrtare për thirrjen dhe angazhimin e pjesëtarëve rezervistë të MB-së, mund të angazhohen "në gjendje lufte apo në gjendje të jashtëzakonshme", për mbrojtjen e sigurisë së IRJM-së apo për ruajtjen e qetësisë dhe rendit publik, kur "ato kërcënohen në masë të madhe."[1095] Ligji për Punët e Brendshme parashikon kushte të njëjta në bazë të të cilave MB-ja mund të krijojë njësi të posaçme policore,[1096] të cilat u krijuan në disa raste gjatë vitit 2001.

246. Ajo çka është edhe më e rëndësishme, në bazë të këtij ligji punonjësit e MB-së nuk mund të angazhohen në veprime luftarake, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë "kushtet e gjendjes së luftës."[1097] Mirëpo gjatë vitit 2001 pati raste të vazhdueshme kur njësitë e policisë u angazhuan në veprime të tilla. Për më tepër, po ky ligj kufizonte përdorimin e armëve nga punonjësit e MB-së vetëm për mbrojtjen e jetës së qytetarëve, për vetëmbrojtje, për zbrapsjen e një sulmi kundër një objekti apo një personi të vendosur

1092 *Shih* më lart, në para. 216; 218, dëshmi që tregon se Kryeministri Georgievski kërcënoi në të paktën dy raste në vitin 2001 se do t'i kërkonte parlamentit të shpallte gjendjen e luftës. Në bazë të Nenit 124 të Kushtetutës së Maqedonisë (Prova Materiale P91), gjendja e luftës ekziston kur "është i afërt rreziku i drejtpërdrejtë i një sulmi ushtarak kundër Republikës, kur sulmohet Republika, apo kur i shpallet luftë asaj." Kjo gjuhë duket se e kufizon nocionin e luftës vetëm në konflikte të karakterit ndërkombëtar, dhe jo në konflikte që lindin nga kërcënime të brendshme. *Shih* Blagoja Markovski, T 10628. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P464.

1093 Prova Materiale 1D52.

1094 Prova Materiale P91 (N0018982).

1095 Prova Materiale 1D154, Neni 2.

1096 Prova Materiale P86, Neni 11.

1097 Prova Materiale P86, Neni 22.

në masa sigurie, apo për parandalimin e ikjes së një personi që kryen një vepër të rëndë penale.[1098] Ligji, po ashtu si dhe Dekreti për përdorimin e mjeteve të dhunës dhe armëve të zjarrit,[1099] përcaktonte gjithashtu detyrimin e paralajmërimit përpara hapjes së zjarrit.[1100] Gjithsesi njësitë ushtarake dhe policore u udhëzuan disa herë gjatë vitit 2001 të "shkatërronin terroristët "[1101] dhe, sipas një urdhri luftarak, t'u shkaktonin atyre sa më shumë "humbje jete".[1102] Dekreti gjithashtu përcaktonte se arma e zjarrit nuk mund të përdorej në rast se do të rrezikohej jeta e qytetarëve të tjerë[1103], mirëpo në planet e hartuara theksohej nevoja që forcat e sigurisë të minimizonin "dëmin anësor" në civilë.[1104] Urdhrat dhe përdorimi faktik i forcës nga ushtria dhe policia gjatë vitit 2001 në mjaft raste i tejkaluan rregullat ligjore të zbatueshme gjatë operacioneve për ruajtjen e rendit publik në kohë paqeje.

247. Paqartësi mund të konstatohet edhe në zbatimin e kuadrit ligjor për trajtimin e anëtarëve të UÇK-së të kapur nga autoritetet e IRJM-së. Megjithëse Ministria e Mbrojtjes nxori një urdhër për trajtimin e "personave ushtarakë të kapur" në përputhje me "Konventën e Gjenevës,"[1105] Dhomës Gjyqësore nuk i janë paraqitur dëshmi që të tregonin se një gjë e tillë u zbatua, apo nëse ky urdhër duhej të zbatohej për anëtarët e UÇK-së. Dhoma Gjyqësore merr parasysh faktin se shumë meshkuj shqiptarë etnikë të dyshuar për terrorizëm, duke përfshirë edhe ata nga Luboteni, u arrestuan dhe u akuzuan për vepra penale, në një kohë që, sipas praktikës së zakonshme në një konflikt të armatosur, duhej thjesht të mbaheshin të izoluar dhe të mos akuzoheshin gjatë periudhës së konfliktit. Mirëpo shpesh këta persona u akuzuan për shkelje që zakonisht gjejnë zbatim në rastin e një konflikti të armatosur.[1106] Për më tepër, Ligji i Amnistisë i miratuar

[1098] Prova Materiale P86, Neni 35.
[1099] Prova Materiale P95, Nenet 3-6, 11-12, 22.
[1100] Prova Materiale P86, Neni 37.
[1101] Provat Materiale 1D79; P475; 1D80; 1D50; 1D58; 1D81.
[1102] Prova Materiale 1D314, f. 2.
[1103] Prova Materiale P95, Neni 26.
[1104] Prova Materiale 1D177, f. 3.
[1105] Prova Materiale 1D314, f. 7.
[1106] Për shembull, në maj 2001, autoritetet e IRJM-së arrestuan 66 vetë, 32 prej të cilëve u akuzuan për terrorizëm, 28 për armëmbajtje të paligjshme, një për organizim të rebelimit të armatosur dhe një pëe sulm kundër rendit kushtetues. (Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 19, ku citohet një "Kërkesë e Juristit për Ndjekje Penale të Zyrës së Prokurorisë së Shkupit për hetim dhe propozim për marrjen e masës së paraburgimit," datë 28 nëntor 2001) Në korrik, MB-ja i paraqiti gjykatësit hetues të Gjykatës II të Shkupit një kërkesë për hetimin dhe paraburgim paragjyqësor të anëtarëve të UÇK-së për rrezikim të tërësisë territoriale, rebelim të armatosur, veprime diversioniste, si dhe gjenocid, krime lufte kundër robërve të luftës, dhe krime lufte kundër popullsisë civile. Prova Materiale P391, Shtojca H (N000-9330). Në shtator, akuzat kundër 14 personave të arrestuar në Luboten më 12

më 8 mars 2002, i cili çliroi nga ndjekja penale të gjithë ata persona që kishin "marrë pjesë në konflikt," me përjashtim të të akuzuarve për krime nën juridiksionin e TPNJ-së, tregon se ekzistonin rrethana të një konflikti të armatosur.[1107]

248. Një argument i rëndësishëm në mbështetje të konkluzionit se situata në IRJM kishte arritur nivelin e një konflikti të armatosur, është trazira civile e pasqyruar në shpërnguljen masive të banorëve nga shtëpitë dhe fshatrat e tyre. Të paktën 64,000 prej tyre u bënë refugjatë, dhe 70,000 të tjerë u shpërngulën në vende të tjera brenda IRJM-së.[1108]

249. Dhoma Gjyqësore është bindur se gjatë kohës së mbuluar nga Aktakuza, konflikti në IRJM kishte arritur nivelin e kërkuar të ashpërsisë.

(b) Organizimi i grupit të armatosur

250. Aktakuza pretendon se dy palët kryesore ndërluftuese në konfliktin e pretenduar të armatosur ishin forcat e sigurisë së IRJM-së (njësitë e ushtrisë dhe policisë) si dhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare Shqiptare ("UÇK").[1109]

251. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi dhe është bindur se forcat e përdorura në Maqedoni në vitin 2001, përfshinin forca të konsiderueshme të ushtrisë maqedonase dhe Ministrisë maqedonase të Punëve të Brendshme, d.m.th. policisë, të cilat përfaqësojnë "autoritetet qeveritare" sipas kuptimit të kushtit *Tadiq*.

252. Prokuroria ka parashtruar se provat tregojnë se UÇK-ja ishte një grup i armatosur, i organizuar dhe i strukturuar nga pikëpamja hierarkike, me një linjë funksionale të komandimit dhe logjistikës, e aftë të angazhohej në një konflikt të brendshëm të armatosur.[1110] Të dy Mbrojtjet e kanë kundërshtuar këtë pretendim. Mbrojtja e Boshkoskit ka argumentuar se provat nuk kanë vërtetuar se UÇK-ja kishte aftësinë e

---

gusht u ndryshuan në "shërbim në një ushtri armike" apo "shërbim në forcat ushtarake armike," një akuzë që zbatohet vetëm "gjatë luftës apo gjatë një konflikti të armatosur" (Prova Materiale P81, f. 114 (N000-5518)) mbi bazën e pretendimit se të akuzuarit "kishin marrë pjesë si luftëtarë kundër Republikës së Maqedonisë" dhe se gjatë këtij procesi kishin marrë pjesë në "veprime intensive ushtarake duke përdorur këmbësorinë, armë dhe municione" (Prova Materiale P46, f. 5 (E.T. 0463-8778).

1107 Prova Materiale P585.

1108 *Shih* më lart, para. 240.

1109 Aktakuza, para. 52.

1110 Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 445.

nevojshme organizative, luftarake dhe logjistike për t'u konsideruar si palë në një konflikt të armatosur, veçanërisht për arsyen-vazhdon argumenti i Mbrojtjes- se UÇK-ja nuk kishte aftësinë e një grupi të organizuar për të planifikuar dhe kryer operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të koordinuara si dhe për të garantuar zbatimin e standardeve humanitare.[1111] Mbrojtja e Tarçulovskit ka argumentuar se nuk ekzistojnë prova dokumentare të besueshme në mbështetje të pretendimit se UÇK-ja ishte grup i armatosur i organizuar dhe se dëshmitë për ngjarjet në terren nuk tregojnë se UÇK-ja kreu veprime karakteristike të një force të organizuar ushtarake.[1112]

253. Për të përcaktuar nivelin e organizimit të UÇK-së, Prokuroria u mbështet veçanërisht në dëshmitë e katër dëshmitarëve kryesorë, dhe pikërisht, Gëzim Ostrenit, Nazim Bushit, Viktor Bezruchenko-s dhe Franz-Josef Hutsch-it.

254. Gëzim Ostreni[1113] kishte qenë anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe më pas, i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK), nga viti 1999 deri në 2001. Gjatë kësaj periudhe ai mori pjesë aktive në veprime ushtarake në Kosovë. Në vitin 2000 ai kishte postin e Shefit të Shtabit të TMK-së dhe mbante gradën "gjeneral brigade."[1114] Në fund të shkurtit 2001, Gëzim Ostreni u zhvendos në Maqedoni, dhe parashtrohet se në mars 2001 iu bashkua UÇK-së (Ushtria Çlirimtare Kombëtare) me detyrën e Shefit të Shtabit.[1115] Gëzim Ostreni dëshmoi se në atë kohë UÇK-ja përbëhej kryesisht nga disa grupe të vogla që vepronin pa bashkëpunim dhe që kishin nevojë për drejtim dhe kontroll.[1116] Kjo ishte një nga detyrat e tij si Shef i Shtabit.[1117] Duke u mbështetur në përvojën e tij ushtarake në Kosovë, ai përgatiti disa rregullore të brendshme për UÇK-në.[1118] Këto do të diskutohen më pas në këtë kapitull. Ai ishte gjithashtu autori i komunikatave të shtypit që lëshoheshin nga kjo organizatë.[1119]

1111 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 263.
1112 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes sëTarçulovskit, para. 58-59.
1113 Dëshmitari u informua paraprakisht se nuk ishte i detyruar t'u përgjigjej pyetjeve nëqoftëse mendonte, se mund të ishin vetëinkriminuese, T 7414-7415.
1114 Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 15; Gëzim Ostreni, T 7710.
1115 Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 3, 15; Gëzim Ostreni, T 7525; 7829. Ai u emërua në këtë post me vendim gojor të Ali Ahmetit, udhëheqësit të UÇK-së. (Gëzim Ostreni, T 7524-7525) Kur u bashkua me UÇK-në, atij iu dha grada e gjeneralit. (Gëzim Ostreni, T 7523)
1116 Gëzim Ostreni, T 7525; 7728-7731; Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 20.
1117 Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 20.
1118 *Shih* për shembull Gëzim Ostreni, T 7418; 7420-7423; 7430; 7436-7437.
1119 Provat Materiale P505; P508.

255. Vlerësimin e dëshmisë së Gëzim Ostrenit Dhoma Gjyqësore duhet ta bëjë duke patur parasysh detyrat konkrete me të cilat ishte ngarkuar si dhe faktin se në atë kohë ai ishte një nga drejtuesit më të lartë të UÇK-së. Ai u thirr për të dhënë dëshmi në mbështetje të pretendimit se UÇK-ja kishte karakteristikat e një grupi të organizuar të armatosur, ndërkohë që detyra e tij kryesore ishte të mundësonte funksionimin e organizuar të grupeve të ndryshme të armatosura. Në këto rrethana, Dhoma Gjyqësore nuk mund të përjashtojë mundësinë se në dëshminë e tij Z. Ostreni u ndikua nga dëshira për të treguar se i kishte arritur qëllimet e tij. Gjithashtu Z. Ostreni përpiloi apo, si anëtar i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, mori pjesë në hartimin e komunikatave të UÇK-së të lëshuara në vitin 2001. Disa nga këto komunikata bënin një përshkrim të ekzagjeruar të ngjarjeve që ndodhnin në atë kohë.[1120] Këto komunikata shkruheshin me qëllim që të ngrinin moralin e luftëtarëve të UÇK-së si dhe për të rritur reputacionin e kësaj organizate në sytë e publikut (rrjedhimisht informacioni i tyre mund të ketë qenë i ekzagjeruar). Sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, përfshirja e Z. Ostreni në përpilimin e komunikatave të shtypit dhe në paraqitjen e imazhit publik të UÇK-së, duket se ka ndikuar në dëshminë që ai dha para Dhomës Gjyqësore për UÇK-në.

256. Dëshmia e Z. Ostrenit i krijoi Dhomës Gjyqësore përshtypjen e qartë se deklaratat e tij në sallën gjyqësore ishin shpesh të ekzagjerura apo të pabazuara. Sipas përllogaritjes së bërë nga Z. Ostreni, në kulmin e konfliktit UÇK-ja kishte afërsisht 5,000 anëtarë[1121], vlerësim që sipas Dhomës nuk përputhet me realitetin. Ai dëshmoi gjithashtu se gjatë konfliktit UÇK-ja kishte humbur gjithsej 68 veta, 38-40 prej të cilëve të veshur me uniformë. Mirëpo ai nuk ishte në gjendje t'i vërtetonte këto shifra dhe, as të sqaronte nëse në këto shifra përfshiheshin personat që ishin vrarë në Luboten.[1122] Për më tepër, siç do të

[1120] Prova Materiale P505, komunikatë e lëshuar më 5 maj 2001 dhe e nënshkruar nga shtabi i përgjithshëm flet për rrëzimin e dy helikopterëve luftarakë nga UÇK-ja si dhe për luftime të ashpra, ndërsa dëshmi të tjera thonë se ashpërsia e luftimeve nuk ishte në nivelin e përshkruar në komunikatë dhe se informacioni për rrëzimin e dy helikopterëve nuk ishte i saktë. *Shih* gjithashtu Viktor Bezruchenko, T 7227-7232. Prova Materiale P508, komunikatë e lëshuar më 10 maj 2001 që mban nënshkrimin e Gëzim Ostrenit pretendon se "gjatë luftimeve aktuale shteti maqedonas po përdor të gjitha strukturat ushtarake dhe policore që ka në dispozicion." Më tej në komunikatë përmenden shembuj të forcave që, siç pretendohet, ishin përfshirë në luftime dhe shpjegohet pikëpamja e UÇK-së se "në Maqedoni ishte krijuar *de facto* gjendja e jashtëzakonshme" dhe se "angazhimi i të gjitha forcave të armatosura maqedonase […] do të thotë se lufta me UÇK-në ishte bërë tashmë zyrtare," si dhe shprehen argumentat e UÇK-së përse "luftimet ishin përhapur përgjatë vijës Karadak-Sharr." Dëshmi të tjera theksojnë se ndonëse ka patur luftime në disa nga zonat e përmendura në komunikatë, është e pamundur që të përcaktohet për çdo rast nëse janë zhvilluar luftime apo nëse janë dislokuar njësi të veçanta, siç pretendohet.

[1121] Gëzim Ostreni, T 7740; Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 21.

[1122] Gëzim Ostreni, T 7744-7745.

diskutohet më poshtë, lidhur me disa çështje që kanë të bëjnë me nivelin e organizimit të UÇK-së, dëshmia e Gëzim Ostrenit nuk u mbështet nga dëshmitë e tjera apo u mbështet vetëm nga dëshmia e Nazim Bushit, udhëheqës tjetër i UÇK-së.

257. Tërësia e rrethanave e bind Dhomën Gjyqësore se dëshmia e Z. Ostreni është e ekzagjeruar në përshkrimin e gjendjes organizative të UÇK-së. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtojë këtë dëshmi me shumë rezervë.

258. Edhe Nazim Bushi dha dëshmi për organizimin e UÇK-së. Ai dëshmoi se u bë anëtar i UÇK-së në korrik 2001 dhe se që nga ajo kohë shërbeu si "komandant i Brigadës së 114-të të UÇK-së."[1123] Ai dëshmoi se detyra e tij kryesore si komandant ishte të krijonte strukturën e Brigadës së 114-të, duke filluar me batalionet deri te kompanitë dhe togat.[1124] Ai dëshmoi më tej se Brigada e 114-të përbëhej afërsisht nga 1,000 anëtarë, se kishte dy batalione dhe dy njësi të posaçme, Arusha dhe Teli, të quajtura kështu sipas emrave të komandantëve të tyre.[1125] Ai dëshmoi se shtabi i brigadës u krijua brenda dy-tri ditësh, ndonëse procesi i formimit të brigadës ishte shumë më i gjatë dhe, në fakt, vazhdoi gjatë gjithë konfliktit.[1126] Ai mohoi që Brigada e 114-të të kishte kryer operacione të përbashkëta me Brigadën e 113-të të UÇK-së, por pranoi se të dy këto brigada koordinonin veprimet e tyre në vijën e frontit.[1127] Mirëpo sipas disa dëshmive të tjera, gjatë formimit të saj Brigada e 114-të mund të ketë qenë nën komandën e Brigadës së 113-të.[1128]

259. Dhoma Gjyqësore e ka të vështirë të pranojë të gjithë dëshminë e Z. Bushi për shumë arsye. Dëshmia e tij lidhur me numrin e anëtarëve të brigadës së tij, bie ndesh qartësisht me dëshmitë e tjera të paraqitura gjatë procesit gjyqësor,[1129] të cilat Dhoma Gjyqësore i pranon si më të besueshme. Pavarësisht rolit të tij si "komandant i Brigadës së 114-të", Z. Bushi tha se nuk e dinte për sa municion dhe armë kishte nevojë kjo

[1123] Nazim Bushi, T 5575-5576; 5611.
[1124] Nazim Bushi, T 5587.
[1125] Nazim Bushi, T 5587-5589.
[1126] Nazim Bushi, T 5867-5868.
[1127] Nazim Bushi, T 5931-5932.
[1128] Prova Materiale P493, f. 11.
[1129] Sipas Provës Materiale P493, f. 11 (dokument i NATO-s), mendohej se Brigada e 114-të përbëhej nga rreth 200 luftëtarë. Mendohej gjithashtu se Brigada e 114-të mund të ishte nën komandën e Brigadës 113-të dhe se ka të ngjarë që misioni i saj të përfshinte sulme kundër objektivave strategjike ushtarake dhe politike në kryeqytet në bashkëpunim me Brigadën e 113-të.

brigadë.[1130] Ai nuk dinte sa anëtarë kishte UÇK-ja në atë kohë dhe sipas hamendjes së tij, ky numër lëvizte në shifrat 5,000 deri në 6,000 deri në 4,000.[1131] Ai deklaroi në mënyrë të përsëritur se brigada e tij kishte zbatuar rregulloret e UÇK-së[1132] (të cilat do të diskutohen hollësisht më poshtë) ndërsa Gëzim Ostreni dëshmoi se këto rregullore u zbatuan në mënyrë graduale, sipas nevojave të secilës brigadë.[1133] Gjithashtu gjatë periudhës përkatëse, zona e përgjegjësisë së Brigadës së 114-të e cila sipas Nazim Bushiit, ishte nën komandën e tij, përfshinte Shkupin dhe rrethinat e tij,[1134] pra edhe fshatin Luboten.[1135] Mohimi këmbëngulës prej Nazim Bushit i pranisë dhe veprimtarisë së UÇK-së në Luboten dhe rreth tij gjatë kësaj periudhe, mohim i cili bie ndesh me dëshmitë e tjera të paraqitura gjatë procesit gjyqësor, i krijoi Dhomës Gjyqësore përshtypjen se Z. Bushi ishte përgatitur që të zvogëlonte çfarëdo roli që anëtarët e UÇK-së mund të kenë luajtur në këto ngjarje. Duke marrë parasysh të gjithë këta faktorë, Dhoma Gjyqësore e pranon dëshminë e Nazim Bushit me shumë rezerva.

260. Franz-Josef Hutsch dha gjithashtu dëshmi lidhur me strukturën dhe organizimin e UÇK-së. Siç u shpjegua më sipër në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore nuk e ka pranuar si të vërtetë dëshminë e Z. Hutsch se ai ka qenë në Luboten më 12 gusht 2001 dhe pretendimet e tij për vëzhgimet që ka bërë atë ditë dhe ditët e mëparshme dhe të mëvonshme.[1136] Përveç problemit të madh për besueshmërinë e kësaj dëshmie, dëshmia e Franz-Josef Hutsch-it lidhur me strukturën dhe organizimin e UÇK-së, bazohej në informacionin e marrë nga Gëzim Ostreni,[1137] si dhe në informacione të marra në konferencat e shtypit të Ali Ahmetit, nga burime konfidenciale të paidentifikuara, si dhe nga një apo disa takime me Ali Ahmetin dhe një figurë tjetër të UÇK-së të quajtur Dren

1130 Nazim Bushi, T 5884.
1131 Nazim Bushi, T 5930.
1132 Nazim Bushi dëshmoi se Kodi i Bashkëbisedimit të UÇK-së (Prova Materiale P456) përdorej për të komunikuar midis Brigadës së 114-të dhe Gëzim Ostrenit; T 5584-5585; 5934. Ai dëshmoi gjithashtu se UÇK-ja miratoi të gjitha standardet dhe procedurat me krijimin e brigadave, T 6013-6015 dhe se ai zbatoi masa disiplinore për shkeljet e standardeve.
1133 Gëzim Ostreni, T 7438.
1134 Nazim Bushi, T 5575-5576; 5605.
1135 Viktor Bezruchenko, T 7241.
1136 *Shih* më lart, para. 18.
1137 Franz-Josef Hutsch, T 2829.

Korabi.[1138] Duke marrë parasysh sa më sipër, Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në dëshminë e Z. Hutsch.

261. Për përcaktimin e nivelit të organizimit të UÇK-së Prokuroria është mbështetur edhe në dëshminë e Viktor Bezruchenko-s. Mbrojtja vë në dyshim besueshmërinë e këtij dëshmitari dhe pretendon, në veçanti, se ai ka marrë pjesë aktive në hetimin dhe procedimin penal të kësaj çështje gjyqësore, se u zgjodh si dëshmitar ekspert nga Prokuroria për shkak të pikëpamjeve të tija lidhur me ngjarjet, dhe se në shumë pjesë të dëshmisë së tij ai nuk bën gjë tjetër veçse mbron qëndrimin e Prokurorisë.[1139] Siç është theksuar, Viktor Bezruchenko, analist ushtarak që punon në zyrën e Prokurorisë, dëshmoi si dëshmitar ekspert për Prokurorinë. Ai dëshmoi se u ngarkua nga Prokuroria që në raportin e tij ndër të tjera, të trajtonte çështje lidhur me konfliktin në Maqedoni në vitin 2001. Mirëpo Dhoma Gjyqësore mendon se do të ishte më e saktë të thuhej se ai u ngarkua të provonte ekzistencën e një konflikti të armatosur në Maqedoni në vitin 2001 në lidhje me një çështje gjyqësore në Tribunal.[1140] Ndërkohë që ishte ngarkuar me këtë detyrë, ai ka qenë i pranishëm në intervistat e Prokurorisë me dëshmitarë dhe në disa raste ka bërë edhe pyetje gjatë këtyre intervistave për llogari të Prokurorisë.[1141] Sa herë që gjatë punës së tij për përgatitjen e analizës. Z. Bezruchenko kishte nevojë për ndonjë dokument, ai dhe kolegët e tij të Zyrës së Prokurorit përpilonin kërkesa konkrete për ndihmë dhe ua paraqisnin autoriteteve maqedonase.[1142] Ai u ndihmua nga ekipi i Prokurorisë.[1143] Megjithëse disa aspekte të raportit dhe dëshmisë së Z. Bezruchenko ishin të dobishme për Dhomën Gjyqësore, për shkak të arsyeve të përmendura më sipër, Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë plotësisht se gjykimi dhe konkluzionet e Z. Bezruchenko pasqyrojnë pavarësinë dhe paanshmërinë karakteristike të një dëshmitari ekspert. Rrjedhimisht, për arritjen e konkluzioneve të saj, Dhoma Gjyqësore do të shyqrtojë burimet e përdorura nga Z. Bezruchenko për përgatitjen e raportit të tij si dhe dëshmi të tjera.

1138 Franz-Josef Hutsch, T 2822-2826.
1139 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes e Boshkoskit, para. 760-764.
1140 *Prokurori kundër Boshkoskit dhe Tarçulovskit,* Çështja Nr: IT-04-82-T, "Decision on Prosecution's Urgent Application to Be Relieved from Disclosing Information pursuant to Rule 68(iv)", 30 October 2007, para 2./"Vendim në lidhje me Kërkesën e Ngutshme të Prokurorisë për t'u Liruar nga Detyrimi për Nxjerrjen e Informacionit në bazë të Rregullës 68(iv)", 30 tetor 2007, para. 2.
1141 Viktor Bezruchenko, T 6879-6998; 6645; 7146-7149; *shih* gjithashtu Provën Materiale P215.
1142 Viktor Bezruchenko, T 6747-6752.
1143 Viktor Bezruchenko, T 6750-6752.

262. Një nga dokumentat ku mbështetet raporti i Z. Bezruchenko është Prova Materiale P485.[1144] Dokumenti nuk ka as nënshkrim, as datë; nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se kush e ka përpiluar atë. Dokumenti përmban paraqitje grafike që tregojnë strukturën e brigadave të UÇK-së, lista të armëve që pretendohet se ishin në zotërim të UÇK-së, vlerësim i numrit të pjesëtarëve të brigadave të UÇK-së, lista të udhëheqësve të UÇK-së, lista të vendndodhjeve të kampeve të pretenduara stërvitore të UÇK-së, si dhe përshkruan objektivat, strategjitë, aftësitë dhe dobësitë e UÇK-së. Nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se në cilat burime janë mbështetur hartuesit e këtij dokumenti dhe, as se si është marrë ky informacion. Viktor Bezruchenko mendon se ky dokument u përgatit nga sektori i analizës në zbulimin ushtarak të IRJM-së në shtator 2001, mbi bazën e informacionit të grumbulluar nga ky shërbim.[1145] Mirëpo në dokument nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se dokumenti është hartuar pikërisht nga ky organ. Duke marrë parasysh mungesën e provave për autorin, datën dhe llojin e informacionit të përdorur, Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në këtë dokument.

263. Një dokument tjetër i përdorur është dokumenti me titull "Paketa Informative për Maqedoninë /Macedonia Briefing Pack/."[1146] Pjesa e këtij dokumenti, e cila jep të dhëna për strukturën e UÇK-së dhe udhëheqjen e saj politike dhe ushtarake, është përgatitur nga Franz-Josef Hutsch mbi bazën e informacionit që ai thotë se ka marrë nga Gëzim Ostreni, Ali Ahmeti, dhe burime të cilat Z. Hutsch refuzoi t'i bënte të njohura.[1147] Duke patur parasysh mendimin e shprehur nga Dhoma Gjyqësore për dëshminë e Franz-Josef Hutsch-it si dhe rezervat e saj lidhur me Gëzim Ostrenin dhe Ali Ahmetin, Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në këtë dokument pa patur konfirmim të pavarur të përmbajtjes përkatëse.

264. Raporti i ekspertit të Prokurorisë citon më pas disa dokumenta të MB-së të cilat kanë datë dhe titull, por nuk janë të nënshkruara.[1148] Këto raporte nuk janë pranuar si

---

1144 Prova Materiale P485 citohet 37 herë në pjesën e raportit (Prova Materiale P466) që trajton UÇK-në.
1145 Viktor Bezruchenko, T 6511-6512.
1146 Prova Materiale P321 citohet katër herë.
1147 Franz-Josef Hutsch, T 2817, 2818-2819; 2822-2826; 2827-2830.
1148 Dokumenti 1013 i Rregullës 65*ter* është një raport i panënshkruar i MB-së lidhur me "Veprimet e të ashtuquajturës UÇK në rajonin e krizës në Shkup" i gushtit 2001. Dokumenti citohet katër herë. Dokumenti 1012 i Rregullës 65*ter* është një raport i panënshkruar i titulluar "Përmbledhje e informacionit për kanalet e paligjshme të hyrje së anëtarëve të të ashtuquajturës UÇK nga Kosova dhe për transportimin e armëve (Hyrja e paligjshme e anëtarëve të UÇK-së nga Kosova)", datë 23 mars. Dokumenti 936 i Rregullës 65*ter* është një raport i

prova dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e përpilimit të tyre. Dhoma Gjyqësore do të mbështetet në deklaratat e paraqitura në raportin e ekspertit të Prokurorisë, duke u bazuar mbi këto dokumente për aq sa ato konfirmohen nga dëshmi të tjera. Gjithashtu është përdorur edhe një libër i titulluar "Lufta në Maqedoni në vitin 2001" i botuar në IRJM në vitin 2006 nga tre zyrtarë të lartë ushtarakë maqedonas.[1149] Autorët e këtij libri nuk dëshmuan në këtë proces gjyqësor. Nuk ka informacion për burimet dhe metodologjinë e përdorur prej tyre. Për më tepër, duke patur parasysh kontekstin politik në të cilin u shkrua libri dhe, veçanërisht faktin se autorët e tij ishin zyrtarë të lartë të një institucioni të përfshirë thellësisht në ngjarjet e vitit 2001 në IRJM, Dhoma Gjyqësore nuk mund ta pranojë këtë dokument si një rrëfim të saktë dhe të paanshëm, pa konfirmim të pavarur prej provave të tjera.

265. Raporti i ekspertit të Prokurorisë citon gjithashtu disa dokumenta pa nënshkrim dhe pa datë, të cilat nuk i atribuohen ndonjë agjencie apo institucioni konkret.[1150] Këto dokumenta nuk janë pranuar si prova. Dhoma Gjyqësore nuk mund t'u kushtojë rëndësi këtyre dokumentave apo deklaratave në raport që mbështeten në këto dokumenta.

266. Dhoma Gjyqësore i ka analizuar dëshmitë mbi bazën e këtyre konsideratave duke arritur në konkluzionet e mëposhtme.

---

panënshkruar i titulluar "Terroristët shqiptarë në rajonin e Tetovës", i gushtit 2001. Raporti citohet tri herë. Dokumenti 662 i Rregullës 65*ter* është një dokument i MB-së i titulluar "Informacion për armët që zotërohen nga e vetëquajtura UÇK në RM" datë 23 gusht 2001. Dokumenti citohet shtatë herë.

[1149] Prova Materiale P464. Autorët e librit janë ish-Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Dr Mitre Arsovski, dhe kolegët e tij Koloneli Kuzev dhe Gjenerali Damjanovski. Viktor Bezruchenko, T 6545.

[1150] Dokumenti 741 i Rregullës 65*ter*, i cili jep detaje lidhur me Brigadën e 114-të, citohet 10 herë. Dokumenti, i cili duket se është një pjesë e një dokumenti më të madh, nuk ka titull, nuk ka datë dhe nuk është i nënshkruar. Dokumenti 702 i Rregullës 65*ter* i titulluar "Ushtria Kombëtare Çlirimtare në IRJM," citohet nëntë herë. Dokumenti është i panënshkruar dhe pa datë. Dokumentat 663 dhe 927 të Rregullës 65*ter* janë pa datë, të panënshkruar. Secili prej këtyre dokumenteve citohet një herë. Dokumenti 664 i Rregullës 65*ter* (list pa datë dhe e panënshkruar e anëtarëve të Brigadës së 113-të) citohet pesë herë. Dokumenti 661 i Rregullës 65*ter* titullohet "Të dhënat e zbulimit për Brigadën e 113-të Ismet Jashari, Lidhjet me Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe përfshirja në të e muxhahedinëve nga Republika e Maqedonisë, Kosova, Bosnja, dhe shtetet islamike". Dokumenti nuk ka datë dhe nuk është i nënshkruar. Ai citohet tre herë. Dokumenti 669 i Rregullës 65*ter* është një tabelë e panënshkruar, pa autor, e titulluar "Një pjesë e armëve të përdorura nga UÇK-ja." Dokumenti citohet një herë. Dokumenti 935 i Rregullës 65*ter* është një dokument i panënshkruar, pa autor, i titulluar "Lidhjet midis së ashtuquajturës UKÇ (*sic*) në Maqedoni dhe UÇPMB-së në Serbinë jugore." Dokumenti citohet një herë. Dokumenti 934 i Rregullës 65*ter*, një artikull i panënshkruar, pa autor, i titulluar "Informacion rreth fondit të LPK-së "Vendlindja thërret" në financimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UKC-së (*sic*) dhe UÇPMB-së" citohet një herë.

267. Në qershor 2001, UÇK-ja kishte afërsisht 2,000 deri në 2,500 luftëtarë[1151] si dhe 1,000 persona të tjerë që siguronin mbështetjen joushtarake (ushqim, strehim, transport, etj.).[1152] Në gusht 2001, UÇK-ja kishte katër brigada funksionuese megjithëse me personel të paplotë – 112, 113, 114, dhe 115, si dhe dy brigada (111 dhe 116), të cilat ishin ende duke u bërë funksionuese.[1153] Brigada e 112-të vepronte në zonën e Tetovës, e 113-ta në zonën e Kumanovës, e 114-ta në zonën e Shkupit, dhe e 115-ta në zonën e Radushës.[1154]

268. Ali Ahmeti ishte udhëheqësi i UÇK-së. Megjithëse dëshmitë nuk hodhën dritë të plotë për mënyrën si e mori këtë pozitë,[1155] anëtarët e UÇK-s e konsideronin atë udhëheqësin e tyre,[1156] po ashtu si anëtarë të bashkësisë ndërkombëtar, që pasqyrohet prej faktit se mesazhet për UÇK-në i drejtoheshin atij[1157] dhe se negociatat për armëpushime, tërheqjen e trupave, dhe çarmatimin u kryen me Zotin Ahmeti.[1158] Gëzim Ostreni ishte Shefi i Shtabit të UÇK-së; ai konsiderohej si zëvëndësudhëheqësi i organizatës dhe drejtuesi i saj ushtarak.[1159]

269. UÇK-ja lëshoi një numër komunikatash gjatë vitit 2001, shumica e të cilave të nënshkruara nga Ali Ahmeti.[1160] Këto komunikata ishin mjeti kryesor i komunikimit të UÇK-së me publikun. Në një komunikatë të 9 marsit përcaktoheshin objektivat e grupit.[1161] Një tjetër e datës 9 maj informonte për strukturën dhe hierarkinë e UÇK-së.[1162] Të dhënat për armët dhe numrin e anëtarëve të UÇK-së jepeshin në një komunikatë të

1151 Prova Materiale P493, f. 3 (Doracaku i NATO-s për UÇK-në); Prova Materiale 1D260 (Jane's Defence Magazine); Prova Materiale 1D342, f. 5 (Dokument i MB-së). Dhoma Gjyqësore nuk pranon dëshmitë e Gëzim Ostrenit dhe Nazim Bushit se në periudhën kur konflikti ishte në kulmin e tij, UÇK-ja kishte 5,000 deri në 6,000 anëtarë. (Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497; para. 2; Nazim Bushi, T 5928). Dhoma Gjyqësore nuk pranon gjithashtu dëshminë e Viktor Bezruchenkos se në maj numri i anëtarëve të UÇK-së arrinte në rreth 2,000 vetë (Viktor Bezruchenko, T 7094-7095), si dhe as vlerësimet e bëra nga ekspertë të sigurisë së IRFM-së pas luftës për 8,000 anëtarë të UÇK-së, të cituara në raportin e tij. (Prova Materiale P466, f. 11)

1152 Prova Materiale P493, f. 3.

1153 Provat Materiale P493; 1D342, f. 5; *shih* gjithashtu Provën Materiale P466, para. 93; Viktor Bezruchenko, T 6067; Prova Materiale P321.

1154 Prova Materiale P493, f. 3, 11, 21.

1155 Gëzim Ostreni, T 7525; 7807; Prova Materiale 2D101, para. 279; Blagoja Markovski, T 10639-10640.

1156 Gëzim Ostreni, T 7525-7526; 7807; Nazim Bushi, T 5585.

1157 Prova Materiale P323.

1158 Provat Materiale P514; P458; Gëzim Ostreni, T 7495-7497.

1159 Provat Materiale P493, f. 34; 1D342, f. 5.

1160 Provat Materiale P520; P507; P508; P513; P457; P514; P509; P511; P512; P506; P510.

1161 Prova Materiale P520.

1162 Prova Materiale P507.

datës 10 maj të nënshkruar nga Ostreni.[1163] Një komunikatë njoftonte për emërimin e Mevlud Aliut si përfaqësuesi politik i UÇK-së në Turqi dhe Lindjen e Mesme.[1164] Nuk ka prova të tjera për praninë e këtij përfaqësuesi politik apo ndonjë veprimtari të tij në Turqi apo Lindjen e Mesme megjithëse Gëzim Ostreni dëshmoi se ishin emëruar përfaqësues politikë thuajse në të gjitha vendet evropiane si dhe në Shtetet e Bashkuara.[1165] Një komunikatë tjetër shpjegonte se tërheqja e UÇK-së nga Haraçina kishte qenë e vullnetshme dhe ishte bërë në bazë të negociatave me BE-në dhe NATO-n.[1166] Më 14 gusht, Ahmeti lëshoi një komunikatë ku informonte për marrëveshjen midis UÇK-së dhe NATO-s për çmilitarizimin dhe çarmatimin e UÇK-së.[1167]

270. Dëshmitë nuk përputhen përsa i përket vendndodhjes së shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Sipas disa burimeve, UÇK kishte një shtab të përgjithshëm në Prizren, Kosovë, i cili, siç njoftohej, "udhëhiqte dhe koordinonte" shtabet e tjera në Vitinë, Hanin e Elezit, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë dhe në fshatrat Staniq, Rushtë dhe Stanevce, të gjithë në Kosovë.[1168] Burime të tjera thonë se shtabi i Brigadës së 112-të që vepronte në zonën e Tetovës, ishte vendosur në Shipkovicë dhe se ky shtab mund të ketë shërbyer edhe si shtab rajonal, edhe si shtab i përgjithshëm.[1169]

271. Nazim Bushi dhe Gëzim Ostreni dëshmuan se brigadat ishin të përbëra nga batalione, kompani, toga dhe skuadra, dhe se ekzistonte linja e komandimit që shtrihej nga Ali Ahmeti dhe Gëzim Ostreni deri poshtë te çdo anëtar i veçantë i organizatës në terren.[1170] Rregulloret e UÇK-së hartuar nga Gëzim Ostreni, i referohen një strukture komplekse hierarkike, ku përfshiheshin njësitë nga niveli i batalionit deri në nivelin e skuadrës.[1171] Megjithëse Dhoma Gjyqësore nuk mund ti pranojë këto dëshmi në tërësi, ekzistenca e një strukture hierarkike komanduese konfirmohet prej Provës Materiale

[1163] Prova Materiale P508.
[1164] Prova Materiale P513.
[1165] Gëzim Ostreni, T 7493.
[1166] Prova Materiale P514.
[1167] Prova Materiale P458.
[1168] Provat Materialet 1D162, f. 3; 1D342, f. 5; P493, f. 11; *shih* gjithashtu Gëzim Ostreni, T 7713.
[1169] Prova Materiale P493, f. 3. Në përputhje me këtë është dëshmia e Nazim Bushit se shtabi qendror i UÇK-së ishte vendosur në Prizren për një kohë të shkurtër dhe më pas u zhvendos në Shipkovicë. (Nazim Bushi, T 5579)
[1170] Nazim Bushi, T 5587-5588; Gëzim Ostreni, T 7526. Nazim Bushi deklaroi gjithashtu se anëtarëve të UÇK-së iu caktuan grada si pjesë e strukturimit ushtarak, sipas rregullores së tyre, T 5863.
[1171] Provat Materiale P498; P461. Nazim Bushi dëshmoi se detyra kryesore e tij si komandant ishte të krijonte strukturën e Brigadës së 114-të, duke filluar nga batalionet deri poshtë te kompanitë dhe togat, gjë që do të bëhej në bazë të rregullores së UÇK-së. (Nazim Bushi, T 5588)

P493, dokument i NATO-së i cili përmban pjesë nga "Doracaku i UÇK-së",[1172] ku jepen hollësi për strukturat e brigadave, udhëheqjen politike të UÇK-së, komandën ushtarake të UÇK-së (shtabi i përgjithshëm), dhe komandën dhe kontrollin e UÇK-së.[1173] Rregulloret e UÇK-së përgatitur nga Gëzim Ostreni, përmendin funksionet e këshilltarëve ligjorë si dhe oficerëve të medias dhe informacionit.[1174] Nazim Bushi dëshmoi se këta oficerë kanë ekzistuar[1175] dhe kjo konfirmohet pjesërisht nga informacioni i dhënë në një kapitull të "Doracakut të UÇK-së" të NATO-s ku jepen emrat dhe hollësi, ndër të tjera për oficerët e UÇK-së për informacionin, shefin e shërbimit informativ, oficerët e logjistikës, dhe një ideolog politik dhe fondmbledhës.[1176]

272. Për të provuar ekzistencën e një sistemi organizativ funksionues, Prokuroria u mbështet te një numër rregullash dhe rregulloresh që thuhet se janë zbatuar nga UÇK-ja në vitin 2001.[1177] Këto rregullore dhe rregulla joformale ndër të tjera, synojnë të krijojnë një linjë komandimi duke përcaktuar detyrat e çdo niveli;[1178] të detyrojnë komandantët e njësive për garantimin e zbatimit të rregulloreve;[1179] parashikojnë marrjen e masave disiplinore si ndalim ose arrestim;[1180] informojnë komandantët e brigadave për detyrimin për respektimin e civilëve dhe pronën civile[1181] si dhe detyrimin për respektimin e ligjeve të luftës dhe konventave ndërkombëtare gjatë veprimeve ushtarake;[1182] si dhe të pranojnë juridiksionin e TPNJ-së për çdo krim të kryer nga anëtarët e UÇK-së.[1183] Gëzim Ostreni, i cili tha se i hartoi këto dokumente në mars, prill dhe maj 2001, dëshmoi se kishte

[1172] Ku dokument është pa datë, por disa referenca për shtatorin 2001, sugjerojnë se ky dokument u hartua gjatë operacionit të NATO-s "Essential Harvest." Viktor Bezruchenko, T 7335.
[1173] Prova Materiale P493, f. 19; 23-30.
[1174] Provat Materiale P498; P461.
[1175] Nazim Bushi dëshmoi se ka patur një këshilltar ligjor i cili bënte pjesë në një qendër të përbashkët informative që përdorej si nga Brigada e 114-të, po ashtu dhe ajo e 113-të (T 5868-5869). Ai dëshmoi gjithashtu se oficeri i ngarkuar me moralin dhe informacionin punonte në këtë qendër të përbashkët në Karadak dhe se detyra e tyre ishte grumbullonin të gjithë informacionin gjatë ditës, të shkonin në terren, të vizitonin njësitë e ushtrisë, të ndihmonin në ngritjen e moralit të ushtarëve dhe t'i informonin ata për çka po ndodhte (T 6004-6005). Ai dëshmoi gjithashtu se Rivdan Bajrami ishte shefi i spitalit ushtarak (T 5589).
[1176] Prova Materiale P493, f. 31-36.
[1177] Provat Materiale P498; P499; P461; P456; P500.
[1178] Prova Materiale P498.
[1179] Prova Materiale P498.
[1180] Gëzim Ostreni, T 7529; Prova Materiale P 498.
[1181] Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 51.
[1182] Gëim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 51; Prova Materiale P487, f. 4; *shih* gjithashtu Nazim Bushi, T 5582.
[1183] Prova Materiale P507.

përdorur si burime rregulloret e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Shqipërisë, dhe RSFJ-së.[1184]

273. Shqyrtimi i këtyre dokumentave i krijoi Dhomës Gjyqësore përshtypjen e qartë se disa nga këto rregulla dhe rregullore ishin thjesht kopje të dokumentave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Trupave Mbrojtëse të Kosovës, apo të forcave të tjera të ngjashme, dhe se nuk ishin hartuar apo përshtatur duke patur parasysh rrethanat në IRJM apo nevojat e UÇK-së. Edhe duke marrë parasysh faktin se Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare përdornin të njëjtën shkurtesë "UÇK" në shqip,[1185] Dhoma Gjyqësore vë në dukje se referencat e shpeshta ndaj "Kosovës" në këto dokumente që pretendohet se janë të UÇK-së /Ushtria Çlirimtare Kombëtare/[1186] konfirmojnë pikëpamjen se ato ishin thjesht dokumente të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës porse me emrin UÇK /Ushtria Çlirimtare Kombëtare/ të vendosur në titull apo në kapak. Për shembull, një dokument i titulluar "Udhëzues për Jetën e Brendshme të UÇK-së" përcakton rregullat në kazermat, fjetoret dhe objekte të ngjashme.[1187] Mirëpo dëshmitë sugjerojnë se UÇK-ja nuk zotëronte objekte të tilla në IRJM. Më tej, Prova Materiale P461, një dokument i titulluar "Udhëzues për Kompetencat dhe Punën e Komandës së Brigadës", që përshkruan funksionet dhe përgjegjësitë e oficerëve të brigadës, përmend ndër të tjera detyrimin e anëtarëve për të "kryer detyrat dhe detyrimet e tyre në përputhje me kushtetutën […]", në një kohë kur një nga objektivat e UÇK-së, siç theksohet në Marrëveshjen e Prizrenit, ishte ndryshimi i rendit kushtetues të IRJM-së.[1188] Një dokument tjetër i titulluar "Rregullore mbi Kriteret për Klasifikimin e Informacionit të Rëndësishëm për UÇK-në, i cili Duhet të Mbahet Sekret Ushtarak apo Shtetëror, dhe Metodat për Ruajtjen e tij" i referohet "përgatitjes së UÇK-së për mbrojtjen dhe sigurinë e vendit",[1189] kur ishte e qartë se në atë kohë UÇK luftonte kundër forcave të sigurisë së IRJM-së, të cilat, nga vetë emri i tyre, kishin për qëllim të

[1184] Gëzim Osteni, T 7418-7419.
[1185] *Ushtria Çlirimtare Kombëtare* (shkurtesa UÇK), dhe *Ushtria Çlirimtare e Kosovës* (shkurtesa UÇK).
[1186] Prova Materiale P461, f. 9, pika 6, para. 4 (përmendet "mbrojtja e Kosovës"), f. 22, pika 12.1, para. 7 (përmendet "Garda e Kosovës"), f. 28, pika 13.1, para. 11 (përmendet "Garda e Kosovës"), f. 29, pika 14, para. 3 (përmendet "Lufta për Çlirimin e Kosovës"), para. 6 (përmendet "Garda e Kosovës"); Prova Materiale P500, f. 4, pika 17, para. 1 (përmendet "mbrojtja e Kosovës").
[1187] Prova Materiale P499.
[1188] Prova Materiale P461, f. 3; *shih* gjithashtu Provat Materiale P560; P520; Gëzim Ostreni, T 7444.
[1189] Prova Materiale P500, Neni 15.

garantonin sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, dhe UÇK-ja nuk mund të ishte ruajtëse e "Sekreteve Shtetërore".

274. Për Dhomën Gjyqësore mbetet e rëndësishme të shqyrtojë se deri në çfarë mase këto rregulla dhe rregullore u zbatuan faktikisht nga brigadat e UÇK-së. Lidhur me këtë aspekt, Nazim Bushi, komandanti i Brigadës së 114-të, dëshmoi se ai ishte i informuar për rregulloret[1190] dhe Gëzim Ostreni dëshmoi se brigadat zbatonin udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm dhe rregulloret e UÇK-së.[1191] Megjithëse veç këtyre nuk ka prova të drejtpërdrejta për shpërndarjen dhe zbatimin e këtyre rregullave dhe rregulloreve në të gjitha njësitë dhe strukturat e UÇK-së, në një dokument të NATO-s të përgatitur në vitin 2001 dhe të pranuar si të besueshëm, UÇK-ja përshkruhet si "një organizatë e mirarmatosur, me disiplinë të mirë dhe shumë e motivuar" me "një nivel bazë organizativ dhe disiplinor shumë të zhvilluar", që mundëson funksionimin efektiv të grupit në nivelin taktik.[1192] Kjo sugjeron faktin se megjithëse përmbajtja e plotë e të ashtuquajturave "Rregulla" dhe "Rregullore" të UÇK-së nuk pasqyron në mënyrë të besueshme nivelin e organizimit të UÇK-së, UÇK-ja ka patur një sistem bazë disiplinor i cili i mundësonte funksionimin me një farë efikasiteti.

275. Një grup tjetër dokumentash, Prova Materiale P486 ("Ecuria e Mobilizimit dhe formimi i Shtabit të Përgjithshëm me Personel dhe Pajisje), Prova Materiale P459 ("Formimi i Brigadës me Personel dhe Pajisje") dhe Prova Materiale P460 ("Formimi i Batalionit të Këmbësorisë me Personel dhe Pajisje"), flasin për numrin e anëtarëve të shtabit në nivele të ndryshme (përkatësisht, shtabi i përgjithshëm, brigada, dhe batalioni) dhe u paraqitën nga Prokuroria për të treguar strukturën ekzistuese të UÇK-së. Veç dëshmive të Nazim Bushit dhe Gëzim Ostrenit, të cilët thanë se këto skema u ishin dërguar brigadave të UÇK-së,[1193] nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta që konfirmojnë pretendimin se këto dokumenta u zbatuan efektivisht në brigadat e UÇK-së. Megjithatë, për ekzistencën e strukturës bazë hierarkike flitet në një kapitull të "Doracakut të UÇK-

[1190] Nazim Bushi, T 5591-5598.
[1191] Gëzim Osteni, T 7820.
[1192] Prova Materiale P493, f. 3; 12.
[1193] Nazim Bushi, T 5591-5594; Gëzim Ostreni, T 7432-7434.

së" të NATO-s, ku përshkruhen madhësia, struktura bazë komanduese, si dhe armët e mundshme në dispozicion të çdo brigade.[1194]

276. Ndër dëshmitë e paraqitura janë edhe disa dokumenta organizative të hartuara në nivel brigade, batalioni apo kompanie,[1195] ku jepen të dhëna për armët dhe teshat që u janë shpërndarë anëtarëve të një skuadre. Dhoma Gjyqësore i pranon këto dokumenta si prova të ekzistencës së një niveli të caktuar organizimi në njësitë më të vogla, por jo si prova të zbatimit të një organizimi në të gjithë strukturën e UÇK-së.

277. Një tregues i nivelit të organizimit të një grupi të armatosur është aftësia për kryerjen e operacioneve ushtarake, duke përfshirë lëvizjet e trupave dhe logjistikën.[1196] Siç është diskutuar më sipër, Dhoma Gjyqësore është bindur se duke filluar nga maji 2001 pati një intensifikim të dukshëm të luftimeve, kryesisht të përqëndruara në pjesën veriperëndimore të vendit. Në pjesën më të madhe, këto incidente ishin sulme me grupe të vogla kundër patrullave apo stacioneve policore. Ashtu si grupet e tjera të armatosura të shqiptarëve etnikë në fazat e para të kryengritjes, siç ishte rasti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kosovë në vitin 1998,[1197] taktikat e UÇK-së konsistonin kryesisht në veprime të goditjes dhe ikjes, që pasqyrohet prej numrit të pritave të realizuara në vitin 2001. Pati edhe incidente më të rënda dhe më të zgjatura, siç ishte "pushtimi" i Haraçinës nga UÇK-ja për 10 ditë në qershor, dhe përleshjet e ashpra në Tetovë dhe Radushë në gusht.

278. Prokuroria e paraqet tërheqjen e Brigadës së 113-të të UÇK-së nga Haraçina më 24 qershor mbi bazën e marrëveshjes së Ali Ahmetit me përfaqësuesit e NATO-s dhe BE-së,[1198] si dëshmi e veprimit të një brigade në përputhje me urdhrat e shtabit të përgjithshëm. Në mbështetje të këtij argumenti Prokuroria citon një komunikatë të UÇK-së që njofton tërheqjen,[1199] e cila, siç diskutohet gjetkë, ndodhi më 24 qershor 2001.

1194 Prova Materiale P493.

1195 Prova Materiale P501 (një diagramë me titull "Karta e armëve personale dhe kolektive të ushtarit"); Prova Materiale P502 (një diagramë me titull "Karta personale e veshjeve dhe pajisjeve të tjera personale të ushtarit"). Gëzim Ostreni, T 7448-7451.

1196 *Shih* më lart, para. 200-201.

1197 *Shih* Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 169-170 (ku thuhet se e ballafaquar me forca serbe me epërsi në numër, stërvitje dhe pajisje, UÇK-ja përdori taktika të efektshme të tipit guerrilas, duke shmangur beteja të tejzgjatura fikse me forcat serbe); Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 87 (ku përmenden dëshmitë e dy dëshmitarëve, UÇK-ja, në prill të vitit 1998, ishte në fazat e hershme të një lëvizjeje standarde kryengritëse apo ushtrie guerrilase, duke përdorur kryesisht taktikat e goditjes dhe tërheqjes së menjëhershme).

1198 Gëzim Ostreni, T 7692; 7822-7824.

1199 Prova Materiale P514.

Pavarësisht nga disa prova për incidente të dhunshme gjatë dhe pas tërheqjes,[1200] Dhoma Gjyqësore pranon se përgjithësisht UÇK-ja zbatoi urdhrin e dhënë nga Z. Ahmeti për tërheqje në bazë të negociatave që ai kishte zhvilluar me përfaqësuesit e NATO-s dhe BE-së.

279. Dëshmitë që iu paraqitën Dhomës Gjyqësore flasin edhe për raste të tjera në të cilat UÇK-ja veproi në mënyrë të organizuar dhe koordinuar. Një raport konfidencial ditor i Sektorit të Sigurisë dhe Zbulimit të Ministrisë së Mbrojtjes, i datës 9 gusht 2001 përmban informacion të incizuar prej kontakteve me radio të grupeve terroriste në rajonin e Tetovës, ku, midis të tjerave, përmendet një urdhër nga "Komandant Iliri" të "gjitha pikave terroriste", që të mos krijojnë panik, por të presin marrjen e urdhrave, si dhe një urdhër "për të vepruar, por të mos harxhohet shumë municion".[1201] Dëshimtari ekspert i Mbrojtjes së Tarçulovskit e tërhoqi pjesërisht deklaratën e tij të mëparshme, sipas së cilës secila brigadë e UÇK-së vepronte në mënyrë të pavarur,[1202] sipas planeve të saj.[1203] Ai e bëri këtë pasi u ballafaqua me pjesë të raportit të tij[1204] ku përmendej fakti se Gëzim Ostreni urdhëroi Xhavid Hasanin, anëtar i Brigadës së 114-të të UÇK-së, që të kryente sulme në Rashtak dhe Lubancë, më 10 gusht apo rreth kësaj date,[1205] duke konfirmuar në këtë mënyrë faktin se Gëzim Ostreni u jepte urdhra vartësve të tij në terren. Ky urdhër përmendet edhe në një raport të Sektorit të Sigurisë dhe Zbulimit të Ministrisë së Mbrojtjes së datës 13 gusht 2001.[1206] Dhoma Gjyqësore vë në dukje gjithashtu se më 12 gusht 2001, ditën e operacionit policor në Luboten, UÇK-ja u informua menjëherë për operacionin dhe forcat e saj u nisën nga pozicionet në malet mbi fshat për t'iu ofruar ndihmë fshatarëve.[1207] Pas zjarrit me mortaja dhe artileri prej forcave ushtarake rreth Lubotenit gjatë të cilit UÇK-ja pësoi humbje, forcat e saj u detyruan të tërhiqeshin.[1208] Mirëpo ky reagim nga ana e UÇK-së, tregon se ajo kishte aftësi për të komunikuar si dhe për të reaguar ushtarakisht në mënyrë të organizuar dhe të efektshme. Për më tepër, UÇK-ja përgjithësisht e zbatoi armëpushimin e arritur pas nënshkrimit të marrëveshjes së

[1200] *Shih* më lart, para. 220-221.
[1201] Prova Materiale 2D40, f. 3.
[1202] Blagoja Markovski, T 10633; 10844.
[1203] Blagoja Markovski, T 10844.
[1204] Prova Materiale 2D101**,** para**.** 371 dhe 379, poshtëshënimi 255.
[1205] *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D85, f. 11.
[1206] Prova Materiale 2D39, f. 3.
[1207] Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 45. *Shih* gjithashtu më lart, para. 139.
[1208] Prova Materiale P466, Pjesa 5, p 45. *Shih* gjithashtu më lart, para. 139.

Ohrit më 13 gusht 2001, megjithëse jo tërësisht. NATO-ja grumbulloi 3,875 armë,[1209] rreth 500 më tepër se sa priste të grumbullonte.[1210]

280. Gjithashtu pati raste kur të paktën një pjesë e forcave të UÇK-së në terren nuk vepruan në përputhje me qëndrimin e shprehur prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Të paktën në tri raste në qershor 2001, UÇK-ja shpalli në mënyrë të njëanshme, apo ra dakord për armëpushim; megjithatë luftimet vazhduan.[1211] Peter Feith, përfaqësues i NATO-së në rolin e negociatorit, arriti të ndërmjetësonte një armëpushim midis UÇK-së dhe forcave maqedonase më 5 korrik[1212] që hyri në fuqi më 6 korrik.[1213] Megjithëse periudha 6 -16 korrik, fill pas armëpushimit, ishte e qetë, me një numër relativisht të pakët shkeljesh të armëpushimit,[1214] duke filluar prej 16 korrikut, pati një rritje të theksuar të numrit të shkeljeve.[1215] Sipas Qendrës së Menaxhimit të Krizës, strukturë e krijuar nga qeveria e IRJM-së,[1216] nga data 6 deri më 24 korrik u regjistruan gjithsej 788

1209 Prova Materiale P519.

1210 Viktor Bezruchenko, T 7507.

1211 Më 7 qershor UÇK njoftoi, nëpërmjet një komunikate, se do të ndërpriste operacionet duke filluar nga ora 2400 më 7 qershor, "për aq kohë sa nuk do të provokohej nga forcat ushtarake dhe policore të qeverisë së RM-së." (Prova Materiale P510) Sipas raportit të Viktor Bezruchenkos, luftimet vazhduan në rajonin e Kumanovës më 7 dhe 8 qershor (Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 22-23), ndërsa më 8 qershor, pati luftime në rajonin e Likovës dhe sulme në Tetovë, duke përfshirë sulme ndaj linjave të transmetimit të energjisë elektrike. (Provat Materiale 1D342, f. 11; P45, f. 116; P466, Pjesa 5, f. 23 (në Popova Shapka dhe në fshatrat fqinje të Gajres dhe Shipkovicës)) Sipas burimeve të MB-së, forcat e UÇK-së hynë në Haraçinë. (Provat Materiale 1D342, f. 11; P45, f. 116; 1D162) UÇK-ja njoftoi, nëpërmjet një komunikate më 11 qershor, se ishte dakord për një armëpushim 24-orësh duke filluar nga ora 14:00 e asaj dite. (Prova Materiale P511) U njoftua se gjatë armëpushimit UÇK-ja dogji shtëpi dhe një kishë në Mateç. (Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 24; P45, f. 117; 1D342, f. 11) Më 12 qershor, një automjet i policisë maqedonase u sulmua në rrugën Jazhincë-Tetovë. Si rezultat, u plagosën gjashtë policë. (Provat Materiale 1D342, f. 11; P45, f. 117) U sulmuan postblloqet e forcave maqedonase të sigurisë në Straçincë dhe Bërnjarcë, pranë Haraçinës, dhe u qëllua me mortaja kundër kazermave të forcave maqedonase të sigurisë në Tetovë. (Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 25) Më 14 qershor, një komunikatë e UÇK-së përshëndeti ndërhyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe të përfaqësuesve të BE-së për politikën e jashtme dhe të sigurimit dhe shpalli një armëpushim nga ora 2400 më 14 qershor deri më 27 qershor. (Prova Materiale P512; Gëzim Ostreni, T 7492-7493) Më 18 qershor, u njoftua për sulme në zonën e pikës së kalimit kufitar në Jazhincë. (Provat Materiale 1D342, f. 12; P45, f. 118; (tre persona të armatosur dhe të veshur me uniforma të zeza hapën zjarr me armë automatike kundër pozicioneve të policisë, dhe pati gjithashtu të shtëna kundër një shtëpie në kufi me RFJ-në në një incident, i cili vazhdoi gjysëm ore)) Më 19-20 qershor, u njoftua për sulme të kufizuara në zonat e Tetovës, Haraçinës dhe Kumanovës. (Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 26; P45, f. 118) Më 20 qershor, u njoftua se UÇK-ja kishte sulmuar stacionin policor "Rasce" si dhe një patrullë nga ky stacion në Radushë, Shkup. (Provat Materiale P45, f. 118; 1D342, f. 12) Më 21 qershor, u njoftua se UÇK-ja kishte sulmuar forcat maqedonase të sigurimit në Popova Shapka me mortaja dhe armë automatike. (Blagoja Markovski, T 10787; Prova Materiale P45, f. 118) Sulmet vazhduan në rajonet e Tetovës dhe Kumanovës, si dhe pati sulme edhe pranë Radushës. (Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 27) Më 22 qershor, forcat maqedonase të sigurisë filluan një ofensivë të madhe kundër Haraçinës dhe, pas kësaj, vazhduan sulmet si nga UÇK-ja po ashtu dhe nga Forcat Maqedonase të Sigurisë. (Provat Materiale P45, f. 118-119; 1D342, f. 12-13; 2D101, para. 149; P466, Pjesa 5, f. 27)

1212 Gëzim Ostreni, T 7497-7498; Prova Materiale 1D272; Henry Bolton T1606-1607.

1213 Gëzim Ostreni, T 7497-7498; Prova Materiale 1D272.

1214 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 33-34; P45, f. 124-126; P249, f. 12-14.

1215 Provat Materiale 1D342, f. 15-16; P466, f. 34-35; P45, f. 127-129.

1216 Henry Bolton, T 1604.

shkelje të armëpushimit nga UÇK-ja.[1217] Më 25 korrik, pas luftimeve të ashpra në zonën e Tetovës,[1218] NATO-ja ndërmjetësoi një armëpushim tjetër.[1219] Megjithatë pati shpërthime sporadike të dhunës në të gjitha zonat ku edhe më parë kishte patur dhunë.[1220] Luftimet e ashpra vazhduan edhe në fillim të gushtit.[1221] Më 9 gusht, Ali Ahmeti, i cili ishte në terren, i dha gojarisht urdhër UÇK-së të tërhiqej nga Tetova për qetësimin e situatës dhe vazhdimin e armëpushimit. U raportua se ky urdhër për tërheqje u zbatua.[1222] Megjithatë, në pjesë të tjera të IRMJ-së sulmet vazhduan.[1223] Efekti i përgjithshëm i këtyre dëshmive është se ato tregojnë se UÇK-ja kishte zhvilluar një farë kapaciteti për respektimin e armëpushimeve, megjithëse jo tërësisht apo jo gjithmonë me sukses. Mosrespektimi i armëpushimeve mund të tregojë gjithashtu se në disa prej incidenteve dhe përleshjeve gjatë shkeljeve të armëpushimeve nuk ishin të përfshira forcat e UÇK-së, por grupe dhe individë të tjerë, të cilët, për arsye të ndryshme, ishin të prirur për akte dhune dhe trazira. Duhet theksuar se shkelje të konsiderueshme të armëpushimeve apo veprime të tjera të ndaluara u kryen edhe nga forcat maqedonase gjatë të njëjtës periudhë edhe pse ishin forca ushtarake dhe policore të organizuara dhe të disiplinuara sipas standardit.[1224]

281. Gëzim Ostreni dëshmoi se, ndonëse me disa vështirësi, UÇK-ja ishte e aftë të furnizonte njësitë e saj me armë dhe pajisje.[1225] Disa burime vunë në dukje se UÇK-ja merrte mbështetje financiare nga diaspora shqiptare e cila financoi armatimin e shumicës së brigadave.[1226] Gjatë vitit 2001, KFOR-i kapi vazhdimisht sasi të mëdha armësh dhe furnizimesh që hynin ilegalisht në IRMJ përmes kufirit nga Kosova, si dhe arrestoi qindra

---

1217 Prova Materiale P249, f. 4-11; *shih* gjithashtu Risto Galevski, T 3743-3744.

1218 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 36-37; P45, f. 130. Këto prova materiale tregojnë se UÇK-ja sulmoi një stacion policor në Tetovë, repartin e zjarrfikësve, kazermat e ushtrisë, si dhe disa postblloqe. Luftimet vazhduan në Porroj, Tearcë, Jegunoc dhe Nerashtë. Pika kryesore e kalimit kufitar me Kosovën, Bllaca, u mbyll për të huajt. Pesë civilë u plagosën gjatë sulmeve të UÇK-së në Neproshten dhe Leshok. U shkatërruan kazermat në Granit si dhe dy automjete të forcave të sigurisë së IRJM-së.

1219 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 37.

1220 *Shih* Provat Materiale P45, f. 131-133; P466, Pjesa 5, f. 37-38.

1221 *Shih* Provat Materiale P45, f. 133-134; P466, Pjesa 5, f. 40-42.

1222 Gëzim Ostreni, T 7849-7851.

1223 Provat Materiale P466, Pjesa 5, f. 43-44; P45, f. 135; 1D13.

1224 Provat Materiale P249, f. 7 (N0015594) (raport i Qendrës së Menaxhimit të Krizës ku thuhet se në korrik pati njoftime për një numër të vogël shkeljesh të armëpushimeve nga forcat e sigurisë së IRJM-së); 1D19, f. 2, para. 2 (Raporti për Incidentet në lidhje me Të Drejtat e Njeriut përmend mungesën e disiplinës së konstatuar në të dyja palët e përfshira në konflikt gjatë periudhës 1-15 gusht 2001).

1225 Gëzim Ostreni, T 7820.

1226 Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 47; Provat Materiale 1D342, f. 6; 1D255, f. 2, P485, f. 13-14; 1D162, f. 11.

persona që dyshoheshin se ishin anëtarë të UÇK-së.[1227] Sipas Ostrenit, UÇK-ja kishte armë të ndryshme, ku përfshiheshin raketa të bartshme AA "Strela-2M" (që përdoreshin kundër aviacionit), mortaja 60, 82, dhe 120 milimetërshe, mitraloza AA 12.7 milimetërsh, pushkë snajper, granathedhësa antitank, granathedhësa, si dhe haubica 120 milimetërshe.[1228] Nazim Bushi dëshmoi se në fillim të korrikut dhe fund të gushtit Brigada e 114-të kishte pistoleta, pushkë automatike, pushkë snajper, bomba dore, pushkë automatike "Gulinov", granatahedhës 12.7 milimetërsh, topa, OSA (granathedhësa dore) dhe mortaja 62 dhe 82 milimetërshe.[1229] Dëshmi të tjera sugjerojnë se brigadat e UÇK-së ishin të armatosura me pushkë snajper me tejqyra teleskopike, një numër pushkësh tytëshkurtra të tipit shotgun dhe mitralozë të lehtë me furnizim të pandërprerë municioni, sisteme të bartshme të mbrojtjes kundërajrore, mortaja 120 milimetërshe, dhe se shumica e anëtarëve të brigadës mbanin, të paktën një bombë dhe një armë në brez apo një thikë.[1230] Provat nuk ofrojnë shifra për numrin e këtyre armëve. Siç është theksuar, gjatë operacionit Essential Harvest, NATO-ja grumbulloi 3,875 armë nga anëtarët e UÇK-së,[1231] por ka të ngjarë që kjo shifër të jetë shumë më e vogël se numri i armëve që zotëronte UÇK-ja në kulmin e konfliktit.[1232] Një mesazh eletronik i misionit të OSBE-së për parandalimin e përhapjes së konfliktit, bën të ditur se UÇK-ja përdorte vazhdimisht mina kundërtanke si dhe, ndoshta mina kundër këmbësorëve.[1233]

282. UÇK-ja nuk kishte mjete të mëdha tranportuese dhe përdorte kryesisht traktorë apo i transportonte armët dhe furnizimet në këmbë apo me gomerë dhe mushka nëpërmjet terreneve malore.[1234]

1227 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 6; 9; 22-23; 33; 34; 37; 41; 49.

1228 Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 44; *shih* gjithashtu P485, f. 4.

1229 Nazim Bushi, T 5589.

1230 Prova Materiale P493, f. 3; 12; *shih* gjithashtu Provën Materiale P464, f. 3-4.

1231 Prova Materiale P519. Këtu përfshihen 4 tanke/autoblinda, 17 armë të mbrojtjes kundërajrore, 161 armë mbështetëse, 483 mitralozë, dhe 3210 pushkë sulmi. NATO-ja grumbulloi gjithashtu 397,625 pjesë municioni, ku përfshiheshin 1045 mina dhe bomba, 354 lëndë shpërthyese, municion për 606 armë mbështetëse, dhe 395,620 municione për armë të vogla.

1232 Prova Materiale 1D260 (*Jane's Defence Magazine*) ku vlerësohet se në gusht 2001, UÇK-ja kishte 5,000-8,000 pushkë, 15,000-39,000 pushkë të vjetra, 40,000-55,000 arrmë dore, 150-250 mitralozë, 100-200 pushkë snajper, 20-50 raketahedhës të bartshëm tokë-ajër, 200-359 granathedhësa të bartshëm kundër tankeve, 100-200 mortaja, më tepër se 5,000 mina tokësore, dhe mijëra granata.

1233 Prova Materiale 1D16, p 1.

1234 Viktor Bezruchenko, T 7014-7018; 7334-7335; 1D162, f. 11; 2D101, para. 336-337. Prova Materiale P604, një raport i MB-së, drejtorisë së sigurisë dhe kundërzbulimit, i titulluar "Informacion operativ i cili sugjeron keqësimin e mundshëm të gjendjes së sigurisë në Republikën e Maqedonisë", datë 11 mars 2001, përmend komandantë të UÇK-së që mblidhnin para dhe transportonin armë dhe ilaçe për UÇK-në si dhe depozitonin apo

283. Dëshmitë sugjerojnë se rekrutetë e rinj merrnin pjesë në një ceremoni inaugurimi si dhe pajiseshin me një letërnjoftim ushtarak.[1235] Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë prova konkrete që konfirmojnë sa më sipër, megjithëse në një lajm të Radio-Televizionit maqedonas më 27 maj 2001, thuhet se komandantët e "terroristëve" po mblidhnin "identifikimet" e anëtarëve të tjerë të grupit për të parandaluar ndonjë procedim ligjor pas operacionit në Vaksincë,[1236] që me gjasë sugjeron se anëtarëve të UÇK-së u ishin shpërndarë letërnjoftime. Në gusht, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm lëshoi një urdhër, sipas të cilit prova për anëtarësisë në UÇK do të përcaktohej nga një komision qendror.[1237] Nuk ka dëshmi se një gjë e tillë ndodhi para shpërndarjes së UÇK-së.

284. Rekrutët e UÇK-së kryenin një stërvitje të shkurtër ushtarake.[1238] Sipas provave, ekzistonte një kamp stërvitor në Brodec.[1239] Ka dëshmi për ekzistencën e një numri më të madh qendrash stërvitore në IRJM[1240], që konfirmohet nga një raport i sektorit të analizës, hetimit, dhe zbulimit në MB,[1241] si dhe për ekzistencën e një qendre stërvitore jashtë vendit,[1242] që nuk konfirmohet në mënyrë të pavarur.

285. Gjithashtu ka dëshmi që tregojnë se anëtarët e UÇK-së ishin të detyruar të mbanin uniforma gjatë operacioneve,[1243] ndonëse jo të gjithë anëtarët e UÇK-së kishin uniformë. Disa ishin veshur me rroba të zeza apo rroba të tjera civile.[1244] Ka gjithashtu dëshmi që

---

krijonin rezerva me ushqime apo uniforma të UÇK-së. Sipas Blagoja Markovskit, kontrabandimi i armëve të paligjshme nga Kosova në Maqedoni u bë nga një grusht njerëzish, që përdornin kafshët për transport dhe që e kryenin këtë veprimtari në errësirë apo në kohë mjegulle për t'u fshehur (T 10860-10862).

1235 "Rregullorja e Jetës së Brendshme të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare" përcakton se rekrutët e rinj marrin pjesë në një ceremoni inaugurimi gjatë së cilës ata bëjnë betimin ushtarak. (Prova Materiale P498, f. 15) Sipas Gëzim Ostreni, anëtarët e rinj regjistroheshin dhe u shpërndaheshin karta ushtarake identiteti ku ishin shënuar të dhënat e tyre personale. (Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 40, 41)

1236 Prova Materiale P600, f. 2; Blagoja Markovski, T 10716-10717.

1237 Prova Materiale P517.

1238 Prova Materiale 1D342, f. 6; *shih* gjithashtu Gëzim Ostreni, T 7827; 7613-7614; Nazim Bushi, T 5582; 5933; Prova Materiale P493, f. 12.

1239 Prova Materiale 2D57 është një fotografi, e cila, sipas dëshmisë së Gëzim Ostrenit (T 7827), tregon rreth 20 rekrutë në një qendër stërvitore në Brodec gjatë një vizite të Ali Ahmetit. Ata ende nuk janë të veshur me uniforma, ndonëse shumica prej tyre kanë bluza me mëngë të shkurtra kamuflimi, dhe nuk kanë armë. Një grup prej 12 burrash duken në qendër të fotografisë të veshur me uniforma kamuflimi. Ostreni dëshmoi se sapo gjendeshin uniformat, çdo rekruti të ri i jepej një uniformë dhe një armë. *Shih* gjithashtu Gëzim Ostreni, Prova Materiale P497, para. 38, 40.

1240 Viktor Bezruchenko, T 7292-7295.

1241 Prova Materiale 1D162, f. 5 (ku thuhet se në gjysmën e dytë të korrikut u zhvilluan seanca stërvitore 3-4 ditore , në Likovë (për ata që do të dislokoheshin në zonën e Kumanovës) ose në Porroj (për ata që do të dislokoheshin në zonën e Tetovës)).

1242 Prova Materiale P464, f. 7 of N006-3017-ET.

1243 Nazim Bushi, T 5582; Gëzim Ostreni, T 7826-7827.

1244 Provat Materiale 2D64; 2D65; 2D66; 2D67. Dhoma Gjyqësore mori prova se njësia e UÇK-së e udhëhequr nga Komandant Teli, e cila ishte në një mision vëzhgimi dhe zbulimi, nuk ishte veshur me uniforma, por kishte me

disa anëtarë të UÇK-së duhej të mbanin së paku emblemën e brigadës së UÇK-së,[1245] por kjo ndoshta nuk ishte praktike, sidomos kur visheshin civilë.

286. Pavarësisht nga disa mangësi të veçanta në disa dëshmi të cilat janë diskutuar më sipër, rezultati tërësor i një sërë dëshmish tregon se megjithëse fillimisht në janar dhe shkurt 2001, UÇK-ja përbëhej kryesisht nga grupe të vogla lokale të krijuara individualisht apo në mënyrë të organizuar, të cilat kishin vështirësi në gjetjen e armëve dhe armatimeve të nevojshme, dhe që vepronin kryesisht mbi bazën e iniciativës lokale, UÇK-ja ishte gjithnjë e më shumë në rrugën e zhvillimit dhe të rritjes.[1246] Anëtarësia e saj u shtua në mënyrë të konsiderueshme si me banorë vendas po ashtu dhe vullnetarë që vinin nga jashtë vendit.[1247] Furnizimi dhe shpërndarja e armëve dhe armatimeve u bë gjithnjë e më e planifikuar dhe e koordinuar. Po ashtu, u rrit sasia dhe shumëllojshmëria e armëve.[1248] Gradualisht dhe hap pas hapi, po siguroheshin uniforma dhe pajisje të tjera.[1249] Filloi zbatimi i një sistemi të kufizuar të stërvitjes themelore.[1250]

287. Dëshmitë sugjerojnë se ekzistonin dhe funksiononin edhe grupe të tjera lokale të tipit "terrorist", ndoshta në mënyrë të pavarur nga UÇK-ja. Në fakt, gjatë procesit të formimit dhe zhvillimit të saj, UÇK-ja duket se është mbështetur shumë në këto grupe. Është e qartë se pas marrëveshjes së Ohrit një formacion rebel vazhdoi të ndiqte rrugën e agresionit të armatosur. Mirëpo fuqizimi dhe rritja e nivelit të organizimit të UÇK-së çoi në kufizimin e numrit dhe të efikasitetit të nëngrupeve, veçanërisht nga mesi i vitit 2001. Dhoma Gjyqësore konkludon se UÇK-ja bëri përparim të dukshëm drejt krijimit dhe zbatimit të plotë dhe të efektshëm të një strukture komanduese si dhe organizimit të grupeve të saj të lokalizuara me vullnetarë në brigada dhe njësi të tjera më të vogla

---

vete uniforma kur u vranë nga forcat maqedonase të sigurisë në Shkup më 5 gusht 2001. Nazim Bushi dëshmoi se gjatë kohës së lirë, kur bënin pushim, ushtarët e UÇK-së lejoheshin të vishnin rroba civile. (Nazim Bushi, T 5943-5945; 5975-5976)

1245 Prova Materiale P493.

1246 *Shih* më lart, para. 267-285.

1247 Provat Materiale P493, f. 3 (raporti i NATO-s thotë se forcat luftarake mund të arrinin në 2,000 deri në 2,500 vetë, si dhe ndoshta 1,000 persona të tjerë në mbështetje); 1D162, f. 3 (raport i sektorit të analizës, hetimit, dhe informacionit të MB-së i cili përshkruan ecurinë e rekrutimit të UÇK-së në vitin 2001).

1248 Prova Materiale P466, Pjesa 5, f. 6, 9, 22, 22-24, 33, 34, 37, 41, 49 (ku njoftohet për shumë incidente në të cilat KFOR-i kapi armë dhe furnizime të tjera të UÇK-së si dhe qindra persona që dyshoheshin se ishin anëtarë të UÇK-së teksa përpiqeshin të kalonin kufirin me Kosovën për të hyrë në IRJM.

1249 Disa fotografi të pranuara si prova materiale tregojnë anëtarë të UÇK-së të veshur me bluza me mëngë të shkurtra ose të gjelbra/kamuflimi, shpesh me simbolin e UÇK-së, çizme dhe kapele, disa duke mbajtur armë (Provat Materiale 2D54; 2D55; 2D56; 2D57; 2D58; 2D59; 2D60; 2D61; 2D62; 2D63; 2D64; 2D65; 2D66).

1250 Prova Materiale 2D57 (ku tregohet një kamp stërvitor në Brodec).

vartëse. Megjithatë, deri në gusht të vitit 2001 kjo përpjekje e gjerë nuk ishte materializuar plotësisht.

288. Drejtuesit kryesorë si Ali Ahmeti dhe Gëzim Ostreni, anëtarët kryesorë të Shtabit të Përgjithshëm, si dhe komandantët e brigadave kishin filluar veprimtarinë e tyre si pjesë e këtij procesi, të paktën që prej majit të vitit 2001. Karakteri i veprimeve të UÇK-së në terren tregon se masat e sapopërmendura po jepnin efekt. Zgjerimi gjeografik i veprimeve luftarake të ndërmarra nga UÇK-ja gjatë majit, qershorit, korrikut dhe fillimit të gushtit, tregon se UÇK-ja po rritej jo vetëm në numër dhe armatime, por dhe se po bëhej gjithnjë e më e aftë për të planifikuar dhe koordinuar operacione. Situata e përgjithshme pasqyronte një rritje të efikasitetit të UÇK-së dhe dobësimin e kontrollit të qeverisë dhe forcave të IRJM-së ndaj disa rajoneve pak a shumë të përcaktuara gjeografikisht, kryesisht në veriperëndim të vendit.

289. Nuk është fjala se në çdo moment UÇK-ja ishte një forcë efikase luftarake, moderne, e organizuar dhe furnizuar mirë, e stërvitur dhe e disiplinuar. Një tërësi e gjerë provash prej burimeve qeveritare, ushtarake dhe policore të IRJM-së vërteton se UÇK-ja arriti të detyronte qeverinë të angazhonte të gjitha forcat e saj ushtarake, duke përfshirë edhe rezervistët, si dhe një pjesë të madhe të forcave policore, duke përfshirë edhe rezervistët, për të luftuar kundër UÇK-së. UÇK-ja shihej nga qeveria maqedonase si kërcënim shumë i madh ndaj vetë ekzistencës së vendit. Ashtu siç theksohet në shumë vlerësime të asaj kohe, vendi ishte në prag të një lufte civile.[1251] Qeveria kërkoi ndihmën e organizatave ndërkombëtare, ndër të cilat edhe NATO, dhe veprimtaria diplomatike u intensifikua dhe u arrit të kontaktohej me udhëheqjen e UÇK-së dhe të bindej që të përfshihej në negociata për një zgjidhje politike paqësore të krizës. UÇK-ja kishte nivelin e mjaftueshëm organizativ që mundësoi realizmin e armëpushimeve me ndërmjetësinë e strukturave ndërkombëtare, duke arritur të negociojë dhe nënshkruajë një marrëveshje politike ku përcakoheshin objektivat e saj të përbashkëta me grupet politike shqiptare në IRJM, si dhe duke nënshkruar dhe respektuar një marrëveshje me NATO-n për çarmatimin dhe shpërbërjen e saj graduale.

[1251] Prova Materiale P611 (Ministri i Brendshëm i IRJM-së, Vllado Buçkovski, më 9 gusht, duke iu referuar ngjarjeve në Karpallëk, deklaroi "Kjo tragjedi e madhe le të jetë fillimi i fundit të luftës, jo fillimi i një lufte të përgjakshme civile.")

290. Dhoma Gjyqësore është bindur se efekti i shkaktuar nga UÇK-ja deri në gusht 2001, niveli i suksesit ushtarak që kishte arritur ndaj forcave ushtarake dhe policore maqedonase të cilat ishin më të mëdha në numër dhe të pajisura më mirë, si dhe aftësia për të folur me një zë të vetëm dhe për të rekrutuar dhe armatosur anëtarët e saj, në kontekstin e rrethanave konkreteve në shqyrtim janë të mjaftueshme për të treguar se UÇK-ja kishte arritur një nivel organizimi dhe koordinimi shumë më të lartë dhe më të fokusuar se sa në muajt e para të vitit 2001. Kjo i mundësoi UÇK-së kryerjen e veprimeve ushtarake dhe arritjen e sukseseve të tilla ushtarake të cilat ishin të pamendueshme në fillim të vitit 2001. Gjithashtu është për t'u theksuar se ekzistenca e konfliktit të armatosur gjatë periudhës së mbuluar nga Aktakuza është pranuar dhe zbatuar nga vetë sistemi ligjor i IRJM-së Gjatë kësaj periudhe dhe më herët janë kryer hetime gjyqësore, janë formuluar akuza, dhe janë shqiptuar verdikte fajësie për vepra penale që lidhen me ekzistencën e një konflikti të armatosur.

291. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se provat tregojnë, se në gusht të vitit 2001, UÇK-ja kishte karakteristika të mjaftueshme të një grupi apo force të organizuar të armatosur, e cila plotësonte kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e Tribunalit dhe të përmendura më sipër në këtë Aktgjykim.

3. Konkluzion

292. Duke patur parasysh ligjin ekzistues dhe analizën e mësipërme të provave, Dhoma Gjyqësore është bindur se në gusht 2001, gjatë periudhës së mbuluar nga Aktakuza, në IRJM ka ekzistuar një konflikt i brendshëm i armatosur ku morën pjesë forcat e sigurisë së IRJM-së, ushtrake dhe policore, si dhe UÇK-ja.

B. Lidhja midis veprimeve që pretendohet se janë kryer nga të akuzuarit dhe konfliktit të armatosur

293. Për plotësimin e kushteve të përgjithshme të Nenit 3 të Statutit, Prokuroria duhet të provojë ekzistencën e një lidhjeje të mjaftueshme midis veprimeve që pretendohet se

janë kryer nga të Akuzuarit dhe konfliktit të armatosur.[1252] Vërtetimi i kësaj lidhjeje lipset për të bërë dallimin midis krimeve të luftës dhe krimeve të karakterit thjesht ordiner si dhe për të parandaluar trajtimin e veprave penale të rastësishme apo të veçuara si krime lufte. Nuk kërkohet domosdoshmërisht që konflikti i armatosur të ketë qenë shkaku i kryerjes së krimit të akuzuar, mirëpo duhet të ketë luajtur rol thelbësor në aftësinë e keqbërësit për kryerjen e krimit.[1253] Nuk është e nevojshme që krimet e pretenduara të kenë ndodhur në vendin dhe kohën ku kishte luftime.[1254] Në rastin e konflikteve të brendshme të armatosura, Dhoma e Apelit ka konkluduar se kohëzgjatja e zbatueshmërisë së ligjeve dhe zakoneve të luftës vazhdon deri sa të jetë arritur një zgjidhje paqësore.[1255] Ky konkluzion nuk duhet kuptuar sikur juridiksioni i Tribunalit mbulon vetëm krime të kryera deri në nënshkrimin e një marrëveshje paqeje midis palëve; përkundrazi, nëqoftëse dhuna e armatosur vazhdon edhe pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, konflikti i armatosur mund të vazhdojë të ekzistojë dhe ligjet dhe zakonet e luftës mbeten ende të zbatueshme. Për të përcaktuar ekzistencën e një lidhjeje midis veprimeve të të akuzuarit dhe konfliktit të armatosur, ndër të tjera, duhet të përcaktohet nëse shkelësi ka marrë pjesë në luftime, nëse viktima nuk ka marrë pjesë në luftime, nëse viktima ishte anëtar i palës kundërshtare, nëse veprimi u krye në funksion të arritjes së objektivit themelor të fushatës ushtarake, dhe nëse krimi u krye si pjesë apo në kuadrin e detyrave zyrtare të autorit të krimit.[1256]

294. Duke marrë parasysh konkluzionet e nxjerra gjetiu në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore është bindur se është vërtetuar lidhja midis veprimeve të pretenduara në Aktakuzë dhe konfliktit të armatosur. Veçanërisht Dhoma Gjyqësore u referohet përfundimeve të veta se autorët e krimeve të kryera në Luboten më 12 gusht 2001 ishin

---

1252 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 572-573.

1253 Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 58; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342.

1254 Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 57. *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 64, ku Dhoma e Apelit tha se "nuk është e nevojshme që Prokurori të provojë se ka patur konflikt të armatosur në çdo pëllëmbë të sipërfaqes së përgjithshme. Gjëndja e konfliktit të armatosur nuk është e kufizuar në zonat ku ka faktikisht luftime ushtarake, por ekziston në të gjithë territorin që është nën kontrollin e palëve ndërluftuese." Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* tha se e drejta humanitare ndërkombëtare zbatohet "në të gjithë territorin e shteteve ndërluftuese, apo, në rastin e konflikteve të brendshme, në të gjithë territorin që është nën kontrollin e një pale, *pavarësisht nga fakti nëse në këtë territor po zhvillohen apo jo luftime*". Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*, para. 70 (theksim i shtuar), i konfirmuar në Aktgjykimin e Apelit *Kordiq*, para. 319.

1255 Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*, para. 70; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 57.

1256 Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 59.

policë maqedonas,[1257] se operacioni u udhëhoq prej një anëtari të forcave policore,[1258] se ushtria e mbështeti operacionin me artileri dhe mjete të tjera,[1259] dhe se disa nga viktimat mund të kenë marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në luftime.[1260] Fshati Luboten gjendet në një zonë kur gjatë periudhës në fjalë janë kryer akte dhune si incidenti me minë në Stanet e Lubotenit më 10 gusht.[1261] Gjithashtu kohëzgjatja e konfliktit të armatosur shtrihet përtej 12 gushtit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër të Ohrit të 13 gushtit, së paku deri në fund të atij muaji.

295. Mbrojtja e Boshkoskit pretendon se i Akuzuari Lube Boshkoski nuk kishte dijeni për ekzistencën e një konflikti të armatosur në periudhën në fjalë, dhe, se për këtë arsye nuk është plotësuar kriteri i *mens rea* /gjendja mendore kriminale/ për akuzat e ngritura në bazë të Nenit 3 të Statutit.[1262] Prokuroria e pranon se është detyra e saj të provojë që të dy të Akuzuarit dinin ose kishin arsye të dinin për rrethanat faktuale të konfliktit,[1263]duke iu referuar për këtë pikë diskutimit në Aktgjykimin e Apelit *Naletiliq*, dhe parashtron se ky kusht është plotësuar.[1264] Në vendimin e lartpërmendur problemi doli në kontekstin e Nenit 2 të Statutit. U konkludua se ishte detyra e Prokurorisë të provonte se i akuzuari kishte dijeni për fakte lidhur me karakterin ndërkombëtar të një konflikti të armatosur.[1265] Më hollësisht, u deklarua se kërkohet që "të paktën [i akuzuari] të kishte dijeni për rrethanat faktuale" mbi bazën e së cilave gjykatësit më pas konkluduan se konflikti i armatosur ishte ndërkombëtar.[1266] Në këtë kontekst kërkohet që i akuzuari të ishte në "dijeni të mjaftueshme" të atyre rrethanave faktuale.[1267] Ky diskutim u bë në kontekstin e Nenit 2 të Statutit dhe nuk ekziston jurisprudencë konkrete lidhur me kushtin *mens rea* të

1257 *Shih* më poshtë, para. 552-554. *Shih* gjithashtu më lart, para. 42; 60-61.
1258 *Shih* më poshtë, para. 560. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 552-554.
1259 *Shih* më lart, para. 40; 99.
1260 *Shih* më poshtë, para. 348. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 336; 344-345.
1261 *Shih* më lart, para. 102.
1262 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 458-470; Argumentet Përmbyllëse, T 11178-11180.
1263 Argumentet Përmbyllëse, T 11047-11048.
1264 Konkretisht argumentohet se në rastin e Boshkoskit ky kusht është plotësuar me arsyetimin se ai "ka lëshuar urdhra, ka lëshuar deklarata për shtyp lidhur me veprimet ushtarake, ka qenë rregullisht në terren" (Argumentat Përmbyllëse, T 11047-11048) dhe në rastin e Tarçulovskit, për faktin se, si polic në shërbim të Presidentit, "ai kishte dijeni, ose kishte arsye të dinte për rrethanat faktike në Maqedoni", veçanërisht për faktin se kishte parë "si ishin vrarë shokët, kolegët e tij në Stanet e Lubotenit" dhe se ai "madje kishte udhëhequr një operacion në Luboten ku kishte thënë, "Kjo është gjendje lufte'." (Argumentat Përmbyllëse, T 11047)
1265 Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 116.
1266 Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 118; 119. Në parashtrimet e Mbrojtjes së Boshkoskit ky element nuk shqyrtohet.
1267 Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 119.

Nenit 3.[1268] Mirëpo duke u bazuar në një përfundim të Dhomës së Apelit në *Naletiliq,*[1269] Dhoma Gjyqësore bën të ditur përfumdimin e saj se për shkak të funksioneve të tyre zyrtare dhe përfshirjes së tyre në ngjarjet, të dy të Akuzuarit kishin dijeni apo kishin arsye të kishin dijeni për rrethanat faktuale që tregojnë se në periudhën në fjalë gjatë vitit 2001 në IRJM ka patur një konflikt të armatosur.

C. Kushtet *Tadiq*

296. Në jurisprudencën e Tribunalit është përcaktuar pandryshueshmërisht se një shkelje mund të përfshihet brenda juridiksionit të Nenit 3 të Statutit vetëm nëqoftëse plotësohen katër kushte. Së pari, shkelja duhet të përbëjë thyerje të një rregulle të të drejtës humanitare ndërkombëtare. Së dyti, rregulla duhet të jetë zakonore në përmbajtje, ose, nëqoftëse i përket së drejtës së traktateve, duhet të plotësohen kushtet e kërkuara. Së treti, shkelja duhet të jetë e rëndë, domethenë, ajo duhet të jetë shkelje e një prej rregullave që mbrojnë vlera të rëndësishme dhe duhet të shkaktojë pasoja të rënda për viktimën. Së fundi, në bazë të së drejtës zakonore apo konvencionale, shkelja e rregullës duhet të çojë në përgjegjësi penale individuale të shkelësit.[1270]

297. Krimi i "shkatërrimit pa shkak të qyteteve ose fshatrave" renditet shprehimisht në listën e Nenit 3(b) të Statutit, dhe është konkluduar se Tribunali ka juridiksion ndaj këtij krimi.[1271]

298. Vrasja dhe trajtimi çnjerëzor bazohen në ndalimet e shprehura në Nenin e Përbashkët 3 (1) (a) të Konventave të Gjenevës së vitit 1949, të cilat janë pjesë të ligjeve apo zakoneve të luftës. Është përcaktuar qartë se Neni 3 i Statutit është "klauzolë

[1268] Dhoma Gjyqësore kujton gjithashtu vendimin e Dhomës Paragjyqësore të 8 shtatorit 2006 në të cilën Dhoma Paragjyqësore konkludoi se jurisprudenca e Tribunalit nuk ofron arsye në mbështetje të pretendimit se *mens rea* lidhur me ekzistencën e një konflikti të armatosur është parakusht juridiksional i Nenit 3 të Statutit. (*Prokurori kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Çështja Nr. IT-04-82-PT, "Decision on Assigned *Pro Bono* Counsel Motion Challenging Jurisdiction", 8 September 2006, para 19)/"Vendimi në lidhje me Mocionin e Avokatit të Caktuar *Pro Bono* që Kundërshton Juridiksionin", 8 shtator 2006, para. 19)

[1269] *Shih* Aktgjykimin e Apelit *Naletiliq*, para. 120: "në zbatimin e Neneve 2 dhe 3 të Statutit […], ekzistenca e një konflikti të armatosur apo lloji i tij duhet të shqyrtohet sipas parimit *in dubio pro reo*, si elementë të zakonshëm të një krimi në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare […]".

[1270] Vendimi i Juridisionit *Tadiq*, para. 94. *Shih* gjithashtu Vendimin e Apelit *Aleksovski*, para. 20; Aktgjykimin e Apelit *Kunarac*, para. 66; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 425-426.

[1271] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq*, para. 38, ku citohet Vendimi i Apelit *Haxhihasanoviq* i Rregullës 98*bis*, para. 30.

mbetëse", që përcakton juridiksionin ndaj çdo shkeljeje të rëndë të të drejtës humanitare ndërkombëtare që nuk mbulohet nga Nenet 2, 4, apo 5 të Statutit.[1272]

299. Jurisprudenca ka vërtetuar se shkeljet e Nenit të Përbashkët 3 trajtohen prej Nenit 3 të Statutit. Në veçanti, është përcaktuar se Neni i Përbashkët 3 është pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe se shkelja e kësaj dispozite mbart përgjegjësi penale.[1273] Dhoma e Apelit ka pranuar se shkelje të rënda të Nenit të Përbashkët 3 përmbushin automatikisht të katër kushtet *Tadiq*.[1274]

300. Krimet e vrasjes dhe trajtimit çnjerëzor pa dyshim, përbëjnë shkelje të një rregulle që mbron vlera të rëndësishme, dhe sjellin pasoja të rënda për viktimat.[1275] Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludon se lidhur me këta krime janë plotësuar katër kushtet *Tadiq*.

D. A merrnin pjesë aktive në luftime viktimat

301. Meqë Neni i Përbashkët 3 mbron personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime,[1276] duhet vërtetuar se viktimat e krimit të pretenduar nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së krimit.[1277]

302. Dhoma Gjyqësore u referohet përfundimeve të saj të bëra gjetkë, sipas të cilave lidhur me Pikën 1 (vrasje), të katër viktimat nuk merrnin pjesë aktive në luftime, ndërkohë që Prokuroria nuk ka vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, se tre të tjerët nuk po merrnin pjesë aktive në luftime në kohën kur u vranë.[1278] Rrjedhimisht Neni 3 i Statutit është i zbatueshëm vetëm për katër viktimat që nuk merrnin pjesë aktive në luftime.

[1272] Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*, para. 89-93; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 125, 131, 133.

[1273] Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*, para. 129. Megjithëse konkludoi se Neni i Përbashkët 3 nuk përmend shprehimisht përgjegjësinë penale për shkeljen e dispozitave të saj, Dhoma e Apelit u mbështet në konkluzionet e Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak në Nyrenberg, në praktikën e shteteve, në legjislacionin e vendeve, ndër të cilët legjislacionin e ish-Jugosllavisë, në rezolutat e Këshillit të Sigurimit, dhe në marrëveshjen e arritur me ndërmjetësinë e KNKK-së më 22 maj 1992. Konkluzioni i saj u konfirmua në Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, para. 174.

[1274] Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*, para. 134; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 125; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 68.

[1275] Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 219.

[1276] Neni i Përbashkët 3(1).

[1277] *Jelisić* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Jelisiq*, para. 34; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 420; *Kvočka* Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kvoçka*, para. 124; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bllagojeviq*, para. 540.

[1278] *Shih* më poshtë, para. 348.

303. Lidhur me Pikën 3 (trajtim çnjerëzor), Dhoma Gjyqësore është e bindur se asnjë prej viktimave nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së krimeve. Në veçanti, ajo e vë theksin te përfundimet se krimet e trajtimit çnjerëzor ndaj viktimave u kryen kur ata ishin të paarmatosur si dhe në një lloj paraburgimi.[1279] Edhe sikur disa prej viktimave të kishin marrë pjesë aktive në luftime para arrestimit të tyre, që do ishte në kundërshtim me përfundimin e Dhomës Gjyqësore, kjo pjesëmarrje do të ishte ndërprerë që prej momentit kur u arrestuan prej policisë maqedonase dhe gjithashtu për faktin se ishin të paarmatosur, ato do të kishin ndërprerë pjesëmarrjen aktive në luftime dhe rrjedhimisht do të ishin në mbrojtjen e Nenit të Përbashkët 3.[1280]

[1279] *Shih* më poshtë, para. 383-391.

[1280] Neni i Përbashkët 3(1) mbron: "[p]ersonat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët pjestarët e forcave të armatosura që janë dorëzuar dhe ata që janë nxjerrë *jashtë luftimit/ hors de combat* me anë të […] paraburgimit […]".

VI. AKUZAT

A. Vrasje (Pika 1)

304. Aktakuza pretendon përgjegjësinë penale të Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit për vrasjen e shtatë shqiptarëve etnikë banorë të Lubotenit: Rami Jusufi, Sulejman Bajrami, Muharem Ramadani, Atulla Qaili, Xhelal Bajrami, Bajram Jashari dhe Kadri Jashari. Këto pretendime mbështesin një pikë për vrasje si shkelje të ligjeve apo zakoneve të luftës të njohura nga Neni 3(1)(a) i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe të ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit.

1. Ligji

305. Akti i vrasjes si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit kërkon që të provohen tre elementët e mëposhtëm: (1) vdekja e viktimës, ndonëse nuk është e nevojshme të vërtetohet gjetja e kufomës së personit të vdekur;[1281] (2) se vdekja ishte rezultat i veprimit apo mosveprimit të shkelësit; dhe (3) se në momentin e veprimit apo mosveprimit, autori i krimit kishte për qëllim të vriste viktimën apo, në mungesë të një qëllimi konkret, ishte i vetëdijshëm se vdekja ishte pasojë e mundshme e veprimit apo mosveprimit të tij.[1282]

2. Përfundime

(a) Rami Jusufi

306. Siç është theksuar gjetkë në këtë Aktgjykim, Rami Jusufi u qëllua në hyrje të shtëpisë së prindërve të tij në Luboten, mëngjesin e 12 gushtit.[1283] Ai vdiq pas pak në shtëpi dhe u varros të nesërmen në oborrin e shtëpisë së një të afërmi.[1284] Afërsisht pas

---

[1281] *Shih* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërnojelac*, para. 326. Në *Kvoçka* Dhoma e Apelit tha më tej se "fakt [i] për vdekjen e një viktime mund të jetë një konkluzion rrethanor mbi bazën e të gjitha dëshmive të paraqitura Dhomës Gjyqësore. Ajo që duhet të përcaktohet nga dëshmitë është se i vetmi konkluzion i arsyeshëm që mund të nxirret mbi bazën e dëshmive është se viktima vdiq për shkak të veprimive apo mosveprimeve të të akuzuarit ose të një apo më shumë personave, për të cilët i akuzuari mban përgjegjësi penale." (Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka* para. 260). *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 240.

[1282] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 236; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 241; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 486.

[1283] *Shih* më lart, para. 43.

[1284] Elmaz Jusufi, Prova Materiale P8.1, para. 42; Muzafer Jusufi, Prova Materiale P389, para. 8.

një muaj familja e rivarrosi.[1285] Kufoma e tij u zhvarros më 8 prill 2002.[1286] Analiza e ADN-së konfirmoi se kufoma ishte e Rami Jusufit.[1287] Autopsia e kryer më 9 prill 2002 nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Kriminologjisë në Shkup[1288] konstatoi një "çarje" në shtresën e brendshme të peritoneumit (zgavra abdominale) majtas, që korrespondonte me nivelin e zorrës së trashë. Gjithashtu u konstatua një vrimë në eshtrën e kofshës së majtë si dhe çarje e lëkurës në zonën e baqthit. Sipas mendimit të shprehur në raport, "ndryshimet" e konstatuara ishin shkaktuar nga plumbi i një arme zjarri, i cili, "me gjasë" hyri në trupin e Rami Jusufit nga zona e pjesës së poshtme të majtë të stomakut dhe lëvizi nga para-prapa, nga e djathta në të majtë dhe nga poshtë-sipër.[1289] Në kufomë nuk u gjetën plumba ose copëza plumbi. Në raport nuk konkludohet për shkakun e vdekjes. Mirëpo M171 dëshmoi se mbi bazën e përvojës së saj mjekësore të specializuar për plagë në bark të shkaktuara nga armë zjarri, këto lloj plagësh nuk janë vdekjeprurëse, por të rënda, dhe nëqoftëse nuk jepet ndihmë mjekësore, ato mund të shkaktojnë vdekjen për shkak të hemorragjisë.[1290] Në këtë rast u dëshmua se ishte e pamundur t'i jepej ndihmë mjekësore Rami Jusufit gjatë kohës që ishte gjallë pas të shtënave, për shkak të veprimeve të policisë së armatosur në atë kohë në fshat.[1291] Dhoma Gjyqësore konkludon se Rami Jusufi vdiq si pasojë e një plagë të shkaktuar me armë zjarri.

307. Mbrojtja kundërshton rrethanat e sugjeruara për vdekjen e Rami Jusufit. Ajo argumenton se është e pamundur që ai të jetë qëlluar ndërkohë që po mbyllte derën e shtëpisë,[1292]duke patur parasysh lartësinë e verandës dhe derës së jashtme, pasi plumbi e përshkoi trupin e Rami Jusufit nga poshtë-lart. Dr Jaqovski sugjeroi se *nëqoftëse* personi që qëlloi në drejtim të Rami Jusufit ka qenë i përkulur apo i shtrirë barkas, ai do ta kishte shkaktuar atë plagë plumbi vetëm nëqoftëse do të kishte qenë jo më larg se një apo dy metra nga Rami Jusufi. Si hipotezë alternative, largësia mund të ishte më e madhe nëqoftëse Rami Jusufi do të ishte në një pozicion më të lartë dhe qitësi në një pozicion

[1285] Elmaz Jusufi, Prova Materiale P8.1, para. 42.
[1286] Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 4.
[1287] Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 6.
[1288] Autopsitë e viktimave të tjera u kryen gjithashtu nga ky institut.
[1289] Provat Materiale 1D78, f. 3; 1D208; *shih* gjithashtu Zlatko Jaćovski/Zllatko Jaqovski, T 2397-2400; Provat Materiale 1D4; P9.
[1290] M171, T 3434.
[1291] Zenepe Jusufi, T 448.
[1292] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 253 dhe 254; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 292; *shih* gjithashtu Zllatko Jaqovski, T 2400-2401; 2426-2427.

më të ulët.[1293] Mirëpo të dy hipotezat e paraqitura nga Dr. Jaqovski marrin si të mirëqenë faktin se Rami Jusufi ishte në pozicion vertikal, në këmbë, kur u godit. Largësia midis plagës së hyrjes dhe asaj të daljes së plumbit nuk është e madhe – katër centimetra – që konfirmohet nga raporti i autopsisë dhe fotografia e kufomës bërë në shtëpi. Sipas dëshmive, ai po përpiqej të mbyllte derën kur u godit. Për pasojë, jo domosdoshmërisht ka qenë në pozicion vertikal në këmbë. Vetëm për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk konsideron bindëse asnjë prej hipotezave.

308. Më tej Dhoma Gjyqësore argumenton se bazuar në vendndodhjen e gëzhojave që shikohen në fotografinë e verandës dhe hyrjes së shtëpisë, është e pamundur që një person të jetë goditur në pragun e derës së shtëpisë.[1294] Marijo Jurishiq shpjegoi se një Kallashnikov (pushkë automatike që përdoret zakonisht nga policia), kur shkrepet, i shpërndan gëzhojat në formë harku në të djathtë si dhe pak përpara dy apo tri metra nga pozicioni i qitësit.[1295] Dëshmitari sugjeroi se një qitës i vendosur dy-tri metra në të majtë të gëzhojave të paraqitura në fotografi, do t'a kishte të pamundur të qëllonte një person në derën e shtëpisë apo pranë saj, pasi e shtëna do të pengohej nga një mur.[1296] Në këtë sugjerim del më shumë se një problem. Dhoma Gjyqësore vë në dukje dëshminë e Fatmir Kamberit se më 13 gusht, ai pa shenja plumbash në derën e hyrjes së shtëpisë së Rami Jusufit.[1297] Gjithashtu ka prova për gëzhoja të tjera pak më larg, pranë një çezme dhe një gardhi.[1298] Një mundësi është që pas ngjarjes dikush të ketë zhvendosur gëzhojat. Është gjithashtu për t'u theksuar se trajektorja e një gëzhoje ndryshon sipas mënyrës së mbajtjes së armës në momentin e shkrepjes së saj. Për këtë arsye, pozicioni i gëzhojave në fotografi nuk mund të jetë përcaktues në këtë çështje. Dëshmitë nuk përjashtojnë mundësinë që Rami Jusufi të jetë qëlluar nga çfarëdolloj pozicioni pranë hyrjes së shtëpisë, pavarësisht nëse personi që ka qëlluar, mund të ketë qënë i kërrusur apo i shtirë barkas. Megjithëse mbi bazën e dëshmive Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të

[1293] Zllatko Jaqovski, T 2427.
[1294] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 292.
[1295] Marijo Jurishiq, T 3359-3362, Prova Materiale 1D101. Mirëpo trajektorja e gëzhojave varet nga mënyra e mbajtjes së armës, domethënë, horizontalisht dhe vertikalisht, dhe duhet të merret shenjë mirë.
[1296] Marijo Jurishiq, T 3362; Prova Materiale 1D101.
[1297] Fatmir Kamberi, T 4619; Prova Materiale P429.
[1298] Fatmir Kamberi, T 4617-4618; Prova Materiale P429, që tregon me "2" drejtimin e çezmës dhe gardhin dy metra prapa gëzhojave të fotografuara në 1D101.

përcaktojë pozicionin e saktë nga i cili u qëllua Rami Jusufi, ajo është bindur dhe konkludon se ai u qëllua nga jashtë shtëpisë, në momentin kur ishte në hyrje të shtëpisë.

309. Mbrojtja ka sugjeruar gjithashtu se dikush ka ndryshuar pamjen e jashtme të Rami Jusufit pas vdekjes së tij, dhe përpara se të bëheshin fotografi të kufomës së tij, duke argumentuar se nuk kishte njolla gjaku në bluzën me mëngë të shkurtra që pretendohet se kishte veshur Rami Jusufi në momentin kur u vra.[1299] Në mbështetje të këtij argumenti, Mbrojtja i referohet komentit të Dr Zdravko Çakarit, i cili mori pjesë në autopsinë e Rami Jusufit dhe tha se në bluzën me mëngë të shkurtra të Rami Jusufit kishte dy vrima, por asnjë njollë gjaku.[1300] Në aktautopsinë e Rami Jusufit, në prill të vitit 2002, shkruhet se kur u zhvarros, ai ishte i veshur me një bluzë me mëngë të shkurtra dhe pantallona xhins në ngjyrë të kaltër.[1301] Kjo përputhet me përshkrimin e teshave që ai kishte veshur kur u qëllua, siç tregohet në disa fotografi të bëra nga një hoxhë më 13 gusht 2001.[1302] Gjithashtu në këto fotografi shikohen *në fakt* njolla gjaku në bluzën me mëngë të shkurtra të Rami Jusufit.[1303] Elmaz Jusufi dëshmoi se pas vdekjes së Rami Jusufit atij nuk iu ndryshuan teshat dhe se plaga ishte lidhur me një copë çarçafi për të parandaluar hemoragjinë pas plagosjes së tij.[1304] Kjo mund të shpjegojë mungesën e njollave të tjera të gjakut në rrobat e tij. Provat nuk konfirmojnë pretendimin se dikush ka ndërhyrë për të ndryshuar pamjen e jashtme të Rami Jusufit pas vdekjes së tij.

310. Lidhur me çështjen nëse Rami Jusufi ka marrë pjesë aktive në luftime, Dhoma Gjyqësore vë në dukje se sipas mendimit të Mbrojtjes, Rami Jusufi ishte anëtar i UÇK-së,[1305] dhe se gjatë ngjarjeve në Luboten, Fatmir Kamberi së bashku, ndër të tjerë, me Rami Jusufin, kanë marrë pjesë në "qëndresë aktive kundrejt forcave të sigurisë".[1306] Gjithashtu pretendohet se shtëpia e Rami Jusufit së bashku me shtëpitë pranë saj, u

---

1299 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 293, ku citohet ndër të tjera, Prova Materiale 1D104.

1300 Howard Tucker, vërejtjet nga Dr Çakar të bëra nga dëshmitari gjatë autopsisë, T 5449-5450; Prova Materiale 1D208, f. 6; *shih* gjithashtu raportin e autopsisë, Prova Materiale 1D78; Fillimisht Rami Jusufi u varros një ditë pas vdekjes së tij, dhe më pas u rivarros pas një muaji; *shih* më lart, para. 44.

1301 Provat Materiale 1D77; 1D78.

1302 Zenepe Jusufi, T 473; Elmaz Jusufi, T 483; 486; 535; Provat Materiale P4; P9; 1D104.

1303 *Shih,* për shembull, Provat Materiale P4; P9; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D104, e cituar nga Mbrojtja në mbështetje të pretendimit se në bluzën me mëngë të shkurtra *nuk* kishte gjak. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se ndonëse në Aktakuzë pretendohet se Rami Jusufi ishte me pizhama kur u vra, dëshmitë e paraqitura nga Prokuroria e hedhin kategorisht poshtë këtë.

1304 Elmaz Jusufi, T 541-542.

1305 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 294; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 257.

1306 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 292.

përdor si pozicion i UÇK-së, nga i cili u hap zjarr kundër forcave maqedonase më 12 gusht 2001.[1307] Mbrojtja mbështetet në një dokument të UBK-së, të datës 8 prill 2002, me informacione nga "oficerët operativë" të MB-së, për të vërtetuar pretendimin e saj se Rami Jusufi ishte anëtar i UÇK-së.[1308] Ky dokument nuk ka ekzistuar në atë kohë. Ai u hartua disa muaj pas ngjarjeve. Thuhet se u përgatit nga "oficerët operativë" dhe burimet e tyre nuk dihen. Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet vetëm në këtë dokument, pasi përmbajtja e tij nuk konfirmohet nga burime të tjera më të drejtpërdrejta dhe më të besueshme. Për më tepër, gjatë pyetjeve nga Mbrotja, Fatmir Kamberi u pyet nëse ka patur një postbllok të UÇK-së para shtëpisë së Rami Jusufit,[1309] dhe nëse ai së bashku me Rami Jusufin dhe persona të tjerë kanë qenë në këtë postbllok natën e 11-12 gushtit 2001.[1310] Fatmir Kamberi e mohoi këtë.[1311] Pavarësisht prej këtyre pyetjeve, nuk është paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimit të mësipërm. Pretendimi për praninë e një postblloku përpara shtëpisë së Rami Jusufit nuk bazohet në prova dhe bie ndesh me dëshminë e Fatmir Kamberit, të cilën Dhoma Gjyqësore e pranon. Për arsye të dhëna gjetkë në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore nuk ka pranuar dëshminë e dy dëshmitarëve të ushtrisë, Kapitenit Grozdanovski dhe M2D-008, të cilët pretenduan se atë mëngjes kishin vënë re të shtëna që vinin nga një radhë shtëpish, të cilat u përkisnin anëtarëve të familjes Jusufi. Në lidhje me këtë pretendim nuk ka dëshmi të tjera.

311. Gjithashtu argumentohet se një rrip i gjetur në krahërorin e Rami Jusufit, sugjeron se ai nuk kishte status civil.[1312] Por një gjë e tillë nuk sugjerohet nga dëshmitë apo nga parashtrimet. Howard Tucker dëshmoi se, siç u theksua nga Dr. Çakar, ka të ngjarë që ky rrip të jetë vendosur rreth trupit në momentin e varrimit.[1313] Nuk ka asnjë përshkrim të këtij rripi. Në fotografitë e kufomës së Rami Jusufit të bëra përpara varrimit dhe të paraqitura si dëshmi, nuk shikohet asnjë rrip në trupin e tij.[1314] Rrjedhimisht, Dhoma

---

1307 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 257.

1308 Të dy ekipet e Mbrojtjes mbësheten në Provën Materiale 1D168. Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit citon "P168" por është e qartë se është gabim dhe, në fakt, është referencë ndaj Provës Materiale 1D168.

1309 Fatmir Kamberi, T 4578.

1310 Fatmir Kamberi, T 4584.

1311 Fatmir Kamberi, T 4578.

1312 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 293, përmend një rrip rreth "mesit" së tij; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 255, përmend një rrip të gjetur "poshtë rrobave të tij në zonën e krahërorit".

1313 Howard Tucker, T 5446-5448, Prova Materiale 1D208, f. 4.

1314 *Shih* Provat Materiale P4; P9; 1D104.

Gjyqësore nuk mund të konkludojë se ky rrip është përdorur pikërisht për qëllime ushtarake, apo se prania e tij mund të tregojë se Rami Jusufi merrte pjesë aktive në luftime në momentin kur u qëllua. Provat tregojnë se Rami Jusufi ka qenë civil i paarmatosur, që gjithsesi nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur u qëllua me pasoja fatale. Ky është përfundimi i Dhomës Gjyqësore.

312. Gjetkë në këtë Aktgjykim, është vërtetuar se personat që hynë në oborrin e shtëpisë ku banonte Rami Jusufi mëngjesin e 12 gushtit, në kohën kur u qëllua dhe hapën zjarr kundër shtëpisë, ishin anëtarë të forcave policore.[1315] Duke patur parasysh, në veçanti faktin se dëshmitë tregojnë se nuk pati qëndresë prej tij, se Rami Jusufi u godit nga një largësi e afërt nga jashtë shtëpisë kur ai ishte tek dera e hapur, se në atë moment ishte i paarmatosur dhe i veshur me rroba civile, si dhe numrin e plumbave të shkrehur nga oborri dhe zona e verandës drejt shtëpisë në afërsi të pragut të derës ku po qëndronte Rami Jusufi,[1316] Dhoma Gjyqësore konkludon se ata që hapën zjarr kundër shtëpisë, d.m.th, anëtarët e policisë të cilët kryen këtë akt, vepruan në këtë mënyrë me qëllim që të vrisnin Rami Jusufin, apo, përndryshe, të vetëdijshëm se veprimet e tyre mund të shkaktonin vdekjen e tij. Identiteti i këtyre policëve nuk është përcaktuar dhe prej dëshmive nuk u identifikua asnjë prej tyre si personi që hapi zjarr duke shkaktuar vdekjen e Rami Jusufit.

(b) <u>Sulejman Bajrami</u>

313. Gjetkë në këtë Aktgjykim është vërtetuar se Sulejman Bajrami ishte në grupin e burrave të arrestuar nga policia e armatosur dhe të keqtrajtuar përpara shtëpisë së Adem Ametovskit. Ai u qëllua dhe u vra pranë kësaj shtëpie, pasi ishte keqtrajtuar rëndë.[1317] Kufoma e Sulejman Bajramit u varros në varrezën e Lubotenit pak ditë pas vrasjes së tij.[1318] Kufoma e tij u zhvarros më 15 prill 2002.[1319] Analiza e ADN-së përcaktoi se ishte kufoma e Sulejman Bajramit.[1320] Autopsia e kryer më 16 prill 2002 zbuloi lëndime që konsistonin në kanale të hapura nga disa plagë armësh zjarri – në kokë, në të djathtë dhe

[1315] *Shih* më lart, para. 46-47.
[1316] *Shih* më lart, para. 43.
[1317] *Shih* më lart, para. 55.
[1318] *Shih,* për shembull, Provën Materiale 1D71.
[1319] Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 9.
[1320] Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 12.

të majtë të brinjëve, eshtrën e shpatullës, si dhe në eshtrën e pjesës së sipërme të krahut dhe të këmbës.[1321] Prapa eshtrës së shpatullëss u gjet një plumb. Për shkak të fazës së avancuar të kalbëzimit të kufomës, nuk mund të përcaktohej me saktësi shkaku i vdekjes.[1322] Në momentin kur u qëllua, Sulejman Bajrami ishte veshur me bluzë të zezë me mëngë të shkurtra dhe pantallona xhins blu.[1323] Ky përshkrim përputhet me teshat në kufomën e tij kur u fotografua nga Henry Bolton më 14 August.[1324]

314. Lidhur me statusin e Sulejman Bajramit, Mbrojtja sugjeron se ai ishte anëtar i UÇK-së, [1325] dhe se vrasja e tij ishte e përligjur, sepse ai u orvat të ikte kur ishte në duart e forcave policore.[1326] Në pretendimet e saj, Mbrojtja mbështetet në një dokument të UBK-së të datës 8 prill 2002.[1327] Ky dokument sugjeron se Sulejman Bajrami ishte përfshirë në transportin e armëve dhe materialeve të tjera për UÇK-në, dhe se disa nga këto armë ishin lënë në Luboten për nevojat e UÇK-së.[1328] Ky informacion u dha nga "oficerë operativë" të paidentifikuar më se gjashtë muaj pas ngjarjeve në Luboten. Burimet e tyre nuk dihen. Dhoma Gjyqësore tashmë ka theksuar se nuk mund të mbështetet vetëm në këtë dokument, duke marrë parasysh mungesën e burimeve më të drejtpërdrejta dhe më të besueshme. I njëjti dokument sugjeron gjithashtu se dy nga vëllezërit e viktimës ishin anëtarë të UÇK-së.[1329] Nuk ka asnjë lloj konfirmimi për këtë sugjerim. Edhe po të ishte i vërtetë, ai nuk të çon në konkluzionin se edhe viktima ishte gjithashtu anëtar i UÇK-së.

315. Sulejman Bajrami ishte një nga tre burrat që ishin strehuar së bashku me gratë.[1330] Nuk ka asnjë dëshmi për këtë ngjarje nga asnjë pjesëtar i njësisë policore, e cila ishte e pranishme në vendin e ngjarjes. Të vetmit persona të tjerë të pranishëm ishin 12 burra të

1321 Prova Materiale P449.

1322 Prova Materiale P449, f. 4; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D222, konstatime për kufomën 1D/6, në N000-1628, ku thuhet se kishte të paktën (pjesë të mbetura) të të dy plumbave, të kalibrit 7.62 milimetra.

1323 Provat Materiale P450; P19.

1324 Henry Bolton, T 1630-1632; Provat Materiale P239; P240; P241; P185.

1325 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, paras 165, 211.

1326 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 300; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 264.

1327 Prova Materiale 1D168.

1328 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, paras 165, 211.

1329 M088, Prova Materiale P206, para. 12; M092, Prova Materiale P215, para. 28, 29; M039, Prova Materiale P200.2, para. 32, përmendet "Shefqet Bajrami" si pjesëtar i UÇK-së; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D167.

1330 Sulejman Bajrami ishte një nga tre burrat që u nxorën nga bodrumi ku ishin strehuar gratë. (M017, T 615-616; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 26; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 12; Ismail Ramadani, T 1022)

tjerë shqiptarë etnikë, banorë të Lubotenit, të cilët, së bashku me Sulejman Bajramin, i kishin detyruar të qëndronin përmbys, me sytë dhe kokë të mbuluar, përpara shtëpisë së Adem Ametovskit. Dëshmitë nga këta mbijetues ndryshojnë dhe disa prej tyre duket se nuk janë të besueshme. Në pjesën më të madhe të kohës ata nuk kishin mundësi të shihnin se çfarë po ndodhte. Është e qartë se për shumë aspekte ata kanë bërë përshkrimin e ngjarjeve thjesht duke u nisur nga zhurmat që kanë dëgjuar.

316. Babai i Sulejman Bajramit u godit me plumb në krahë apo dorë nga një polic ndërkohë që ishte i shtrirë barkas në tokë.[1331] Duket se ai ishte duke folur me të birin, Sulejmanin, të cilin e shkelmuan rëndë në kokë. Duket se të paktën për një çast ai humbi vetëdijen.[1332] Pastaj Osman Ramadani dëgjoi Sulejman Bajramin të thoshte se nuk mund të duronte më dhe Sulejman Bajrami u çua në këmbë.[1333] Pastaj Osman Ramadani dëgjoi një polic të thoshte "[l]e të ikë", fjalë të cilat u pasuan nga zhurma e një breshërie plumbash.[1334] Më pas ai pa trupin e Sulejmanit që dergjej rreth 10 metra më tej në rrugë.[1335] Ismail Ramadani i dëgjoi dhe interpretoi këto ngjarje pak më ndryshe. Ai konfirmoi gjithashtu se Sulejman Bajramin e kishin shkelmuar në kokë dhe se Sulejmani ishte çuar në këmbë dhe ishte larguar. Ai sugjeroi se Sulejmani u orvat të ikte për shkak të dhimbjes.[1336] Ajo çka Ismail Ramadani dëgjoi ishin fjalët e një polici që tha "[l]e të largohet pak dhe pastaj e qëllojmë", dhe më pas Sulejman Bajrami u qëllua dhe u vra pasi kishte vrapuar disa metra.[1337] Rrëfimet nuk përputhen nëse fjala që u dëgjua ishte "ecje" apo "vrap". Dëshmitarë të tjerë thjesht dëgjuan të shtëna. Më vonë pasi 10 burrat u nisën të shoqëruar nga policët e armatosur për në shtëpinë e Bracës, ata panë trupin e Sulejman Bajramit që dergjej i vdekur në mes të rrugës. Disa dëshmitarë më parë kishin thënë se kishin parë Sulejman Bajramin teksa largohej me vrap, por në gjykatë ata pohuan se kishin parë vetëm kufomën e tij.[1338] Sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, kjo ka të bëjë

[1331] M012, T 893, 949; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 22.
[1332] Ismail Ramadani, T 1022.
[1333] Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 33.
[1334] Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 33.
[1335] Osman Ramadani, Prova Materiale P198, para. 22.
[1336] Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 24.
[1337] Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 25. Një version tjetër i këtyre fjalëve ishte "le të largohet pak. Do t'ja tregojmë qejfin." (Ismail Ramadani, T 1022)
[1338] Vehbi Bajrami, T 1841-1843. *Shih* gjithashtu M017, T 702-704; 626-628.

me faktin se duhet bërë dallim midis ngjarjeve aktuale që panë dhe interpretimit të ngjarjeve në mendjet e tyre.

317. Një vëzhgues i OSBE-së, Henry Bolton, bëri një inspektim në fshat më 14 gusht. Gjatë vizitës së tij ai pa dhe fotografoi kufomën e Sulejman Bajramit, i cili ishte lënë *in situ* në rrugë. Z. Bolton shprehu shqetësim të veçantë për kufomën e Sulejman Bajramit. Z. Bolton pa shumë gëzhoja rreth kësaj kufome si dhe "shenja vrimash" në njollën e gjakut në asfalt, gjë që tregonte se Sulejman Bajrami ishte qëlluar ndërkohë që ishte shtrirë barkas në rrugë.[1339]

318. Konkluzioni i Dhomës Gjyqësore është se pasi Sulejman Bajrami ishte shkelmuar rëndë në kokë dhe pasi babai i tij ishte qëlluar në dorë apo në krahë, ai u çua në këmbë dhe eci ose vrapoi përgjatë rrugës. Megjithëse mund të ketë menduar arratisjen, është e qartë se ky ishte një opsion i pashpresë. Ai gjendej në mes të një grupi të madh policësh të armatosur mirë, ishte i paarmatosur dhe vetëm ai u përpoq të largohej. Nuk kishte ku të shkonte veçse të largohej përgjatë rrugës, në terren të hapët. Ka shumë të ngjarë që veprimet e tij të ishin pasojë e goditjes së fortë që mori në kokë.

319. Dhoma Gjyqësore konkludon se dëshmitë konfirmojnë që polica e kishte të qartë pozicionin e tij të pashpresë. Sjellja e tij nuk paraqiste rrezik të vërtetë arratisjeje. Në vend që t'a ndalonte menjëherë, siç mund të kishte vepruar, policia e lejoi Sulejman Bajramin të largohej me hap apo me vrap për disa çaste dhe pastaj hapi zjarr kundër tij qëllimisht dhe në mënyrë të vazhdueshme. Gëzhojat e gjetura konfirmojnë se ai u qëllua nga një largësi shumë e afërt. Vrasja e tij me armë zjarri bëri të qartë jo vetëm në lidhje me të, por edhe për personat e tjerë të arrestuar, si dhe më vonë fshatarët në përgjithësi, se në duart e kujt ishte pushteti.

320. I vetmi konkluzion që mund të arrihet mbi bazën e dëshmive ishte se në momentin kur u vra, Sulejman Bajrami ishte civil i pararmatosur që nuk merrte pjesë aktive në luftime. Ndonëse veprimet e tij mund të jenë interpretuar si përpjekje për t'u arratisur, policia nuk gjykoi se këto veprime përbënin rrezik real për arratisje. Në fakt, policia e lejoi të largohej për disa çaste dhe pastaj hapi zjarr me qëllim disa herë, duke e

[1339] Henry Bolton, T 1808-1809; Prova Materiale 1D24, f. 2.

goditur dhe vrarë atë. Ai u vra në mënyrë që vdekja e tij të bëhej mësim për të tjerët. Vrasja e Sulejman Bajramit është vërtetuar.

(c) Muharem Ramadani

321. Mëngjesin e 12 gushtit, Muharem Ramadani ishte strehuar në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit. Ai ishte gjithashtu në grupin e burrave që ishin në bodrum dhe që u arrestuan dhe keqtrajtuan nga policia në oborrin e përparmë të shtëpisë., Muharem Ramadani dhe Aziz Bajrami u urdhëruan të qëndronin në këtë shtëpi, kurse burrat e tjerë të arrestuar, të shoqëruar nga policë të armatosur, u çuan në shtëpinë e Bracës.[1340] Më pas, Aziz Bajrami përcolli informacionin se Muharem Ramadani ishte vrarë tek porta e shtëpisë së Adem Ametovskit.[1341]

322. Muharem Ramadani u varros në varrezën e Lubotenit disa ditë pas vdekjes së tij.[1342] Kufoma e tij u zhvarros më 18 prill 2002.[1343] Prova e ADN-së konfirmoi identitetin e kufomës së Muharem Ramadanit.[1344] Pavarësisht gjendjes së kalbëzimit të kufomës, autopsia e kryer më 19 prill zbuloi kanalin e plagëve të shkaktuara me armë zjarri në zonën e qafës dhe të kafazit të krahërorit. Aktautopsia bën të ditur se ky kanal shtrihej nga para-prapa si dhe paksa sipër. Në pjesën e poshtme të kafazit të krahërorit u konstatua një "defekt" i shkaktuar nga një "mjet shpërthyes". Një kanal tjetër i një plage të shkaktuar me armë zjarri u konstatua në pjesën e sipërme të krahut, nga e djathta në të majte, nëse pjesa e sipërme e krahut do të ishte në pozicion të përkulur.[1345] Në raport nuk përcaktohet shkaku i vdekjes. Kur u zhvarros, u pa se Muharem Ramadani ishte veshur me një xhaketë të zezë prej lëkurë, një këmishë ngjyrë kafe, bluzë me mëngë të shkurtra, pantallona me një rrip lëkure ngjyrë kafe, benevrekë ngjyrë kafe, dhe çorape blu të errët.[1346] Fotografia e kufomës së viktimës, e bërë nga Henry Bolton më 14 gusht,

[1340] *Shih* më lart, para. 57.
[1341] *Shih* më lart, para. 57.
[1342] *Shih,* për shembull, Provën Materiale 1D71.
[1343] Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 12.
[1344] Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 14.
[1345] Prova Materiale P451, f. 3-4.
[1346] Prova Materiale P451, f. 1.

përputhet me këtë përshkrim,[1347] me përjashtim të faktit se në fotografi nuk dallohet bluza me mëngë të shkurtra.

323. Henry Bolton e pa kufomën e Muharem Ramadanit më 14 gusht *in situ* në një degëzim të rrugës që çonte në oborrin e një shtëpie,[1348] e cila, sipas konkluzionit të Dhomës Gjyqësore, ishte shtëpia e Adem Ametovskit. Vëzhgimet e Z. Bolton janë të shënuara në një raport të OSBE-së, të datës 16 gusht. Ai pa gëzhoja të shumta rreth kufomës, fakt që e bëri të konkludonte se Muharem Ramadani ishte vrarë nga afër.[1349] Henri Bolton vuri re një plagë të rëndë në krahëror, e cila, sipas mendimit të dëshmitarit, ishte plagë daljeje e shkaktuar nga një plumb me shpejtësi të madhe që kishte goditur viktimën në shpinë; ai mendonte se në shpinë të viktimës ishin dy plagë hyrjeje.[1350] Defekti i shkaktuar nga një lëndë shpërthyese dhe i konstatuar gjatë autopsisë, mund të përputhet me këtë, mirëpo duket se ka një mospërputhje lidhur me drejtimin e plumbave. Dhoma Gjyqësore pranon rezultatet e autopsisë. Mospërputhja nuk ndikon në konkluzionet e përgjithshme të Dhomës Gjyqësore.

324. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se nuk ka prova konkrete lidhur me rrethanat e vrasjes së Muharem Ramadanit. Mirëpo provat nuk konfirmojnë sugjerimin e raportit të OSBE-së, se vrasja e Muharem Ramadani mund të ketë ndodhur gjatë operacionit të forcave maqedonase "për spastrimin" e zonës nga forcat armike gjatë përparimit të tyre drejt shtëpive në "skajin verior të fshatit".[1351] I njëjti sugjerim është bërë në raport edhe lidhur me kufomën e Sulejman Bajramit. Burimi i këtij sugjerimi nuk bëhet i ditur. Mund të jetë thjesht një sugjerim hamendësues apo paralajmërues, pasi autori nuk ka patur asnjë mundësi për të ditur se çfarë shkaktoi të shtënat dhe bie ndesh me dëshmitë që konfirmojnë se Muharem Ramadani ishte strehuar me të tjerët në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit, se nxori një shami të bardhë në dritaren e bodrumit dhe e tundi nga

[1347] Prova Materiale P186; Henry Bolton konfirmon se këtë fotografi e kishte bërë ai, T 1633.
[1348] Henry Bolton, P236.1, para. 16.
[1349] Henry Bolton, T 1691-1692; Prova Materiale 1D24, f. 2.
[1350] Henry Bolton, T 1633-1634; 1697; Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 16; Henry Bolton, Prova Materiale P236.2, para. 8; Prova Materiale P186.
[1351] Prova Materiale 1D24, f. 3.

frika se mos vritej nga policët maqedonas që po afroheshin,[1352] dhe se më pas u arrestua nga policia në oborrin e shtëpisë.[1353]

325. Duke patur parasysh se Muharem Ramadani ishte në duart e policëve të armatosur përpara shtëpisë së Adem Ametovskit kur u pa për herë të fundit nga persona të tjerë përveç policisë, se kufoma e tij u gjet në rrugën në hyrje të shtëpisë, se, sipas shenjave ai ishte qëlluar disa herë nga një distancë e afërt, dhe se, sipas autopsisë, plagët ishin të tilla që i kishin shkaktuar vdekjen, Dhoma Gjyqësore konkludon se Muharem Ramadani vdiq nga plagë me armë zjarri më 12 gusht, para shtëpisë së Adem Ametovskit, dhe se plumbat vdekjeprurës u shkrehën nga një apo më shumë policë të paidentifikuar, të cilët e kishin mbajtur në shtëpi.

326. Në lidhje me statusin e Muharem Ramadanit, Mbrojtja pretendon se ai ishte angazhuar me UÇK-në. Pretendohet se veshja që kishte kur u vra përputhej me uniformën e zezë të UÇK-së.[1354] Ai nuk ishte veshur me uniformë të zezë të UÇK-së, apo pjesë të një uniforme të tillë. Ngjyra e zezë e xhaketës prej lëkure dhe e pantallonave të tij nuk është veshje e pazakontë për burrat shqiptarë etnikë. Pjesët e tjera të veshjes kishin ngjyra të tjera. Ai kishte në trup më tepër se një palë veshje, gjë e zakonshme për shqiptarët kur temperaturat janë të larta.[1355] Gjithashtu, si edhe në rastin e të vdekurit Rami Jusufi, Mbrojtja duket se pretendon pa u bazuar në prova, se rripi që duket në fotografinë e kufomës së Muharem Ramadanit, tregon se ai nuk kishte statusin e civilit. Dhoma Gjyqësore pajtohet me mendimin e Howard Tucker-it, i cili nuk e identifikoi si rrip objektin që duket në fotografi mbi krahërorin e të vdekurit.[1356] Dhoma Gjyqësore vë në dukje se gjatë hetimeve apo gjatë zhvarrimit, Z. Tucker nuk hulumtoi për identifikimin e këtij objekti. Po kështu nuk ka dëshmi që të tregojnë se çfarë ishte ky objekt apo se për çfarë arësye ishte atje.[1357] I vetmi rrip që përmendet në aktautopsinë apo në aktekspertizën kriminaliste të veshjes, është një rrip lëkure ngjyrë kafe në pantallona.[1358]

[1352] Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 2; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 30; *shih* më lart, para. 51.
[1353] *Shih* më lart, para. 54; 60.
[1354] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 303; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 269.
[1355] Henry Bolton, T 1697-1698.
[1356] Howard Tucker, T 5448-5449.
[1357] Howard Tucker, T 5449.
[1358] Provat Materiale P451; P452.

Dhoma Gjyqësore konkludon se provat nuk konfirmojnë pikëpamjen se rripi në trupin e të vdekurit është rrip ushtarak, apo se ky rrip tregon përkatësinë e viktimës në UÇK-së apo *arguendo*, se rripi konfirmon pikëpamjen se viktima u qëllua gjatë pjesëmarrjes së tij aktive në luftime.

327. Më tej Mbrojtja sugjeron se Muharem Ramadani mori pjesë në veprime ushtarake kundër forcave maqedonase dhe se ai kishte qëlluar kundër forcave të sigurisë.[1359] Mendimi i Prokurorisë është se Muharem Ramadani ishte civil i paarmatosur dhe se, po të kishte marrë pjesë aktive në luftime, ai do të kishte qenë *hors de combat* (jashtë luftimit) në kohën kur u vra.[1360] Mbrojtja pretendoi se burrat në bodrumin e Adem Ametovskit hapën zjarr kundër policisë me një "karabinë" dhe një automatik, të cilat më vonë i fshehën nën një "frigorifer", dhe se kjo është arsyeja që policia nuk i gjeti armët kur bëri kontroll në shtëpi më 12 gusht.[1361] Ky pretendim mbështetet vetëm nga një raport i UBK-së mbi një intervistë me një "burim operativ" anonim më shumë se gjysëm viti pas ngjarjeve në Luboten.[1362] Raporti nuk ekzistonte në gusht të vitit 2001. Autori i raportit dhe "burimi operativ" nuk njihen. Për arsyet e dhëna më sipër, Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në një dokument të tillë, sepse përmbajtja e tij nuk konfirmohet nga burime më të drejtpërdrejta dhe më të besueshme. Gjithashtu është për t'u theksuar se ky dokument nuk i referohet Muharem Ramadanit, por një "personi të panjohur, i biri i Muarem (*sic*) Ramadanit".[1363] E vetmja armë që u gjet në shtëpinë e Adem Ametovskit nuk ishte pushkë, por një çifte që mund të përdoret për gjuetinë e shpendëve. Z. Bolton, i cili e gjeti dhe përshkroi armën, vuri në dukje se "përdorimi praktik i një arme të tillë është shumë i ndryshëm nga përdorimi i një pushke, e cila përdor fishekë me shpejtësi shumë të madhe".[1364] Kjo çifte u gjet nën një minder në bodrum më 14 gusht. Nuk kishte asnjë shenjë se arma ishte lëvizur apo përdorur. Nuk kishte gëzhoja të plumbave të kësaj

[1359] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 303.
[1360] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 103.
[1361] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, para. 265, poshtëshënim 615.
[1362] Prova Materiale 1D273.
[1363] Prova Materiale 1D273.
[1364] Henry Bolton, T 1701-1702; Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 17.

arme apo të ndonjë arme tjetër, dhe asnjë shenjë tjetër që të tregonte se nga ai vend ishte qëlluar.[1365]

328. I vetmi konkluzion mbi bazën e dëshmive është se në momentin kur u qëllua dhe u vra, Muharem Ramadani ishte civil i paarmatosur i cili nuk merrte pjesë aktive në luftime, konkluzion i nxjerrë prej Dhomës Gjyqësore. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore është e bindur dhe konkludon se një apo më shumë policë që qëlluan Muharem Ramadanin duke shkaktuar vdekjen e tij, vepruan me qëllimin për t'a vrarë apo të vetëdijshëm se të shtënat e tyre mund të shkaktonin vdekjen e tij.

(d) Atulla Qaili

329. Siç është vërtetuar, Atulla Qaili ishte ndër burrat që ishin strehuar në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit më 12 gusht; përfundimisht ai së bashku me të arrestuarit e tjerë, dhe të shoqëruar nga roje të armatosura, u transferuan në stacionin policor të Mirkocit. Siç është diskutuar gjetkë në këtë Aktgjykim, Atulla Qaili u keqtrajtua rëndë nga policët gjatë kohës kur ishte në duart e tyre para shtëpisë, në shtëpinë e Bracës në Luboten, dhe më pas në stacionin policor të Mirkocit.[1366] Ai u transferua nga stacioni policor në spitalin e Shkupit më 13 gusht.[1367] Në vërtetimin e vdekjes[1368] shkruhet se ai vdiq më 13 gusht, në orën 13:39.[1369] Atulla Qaili u varros nga anëtarët e familjes së tij në varrezën e Lubotenit, disa ditë pas vdekjes së tij. Përfaqësues të OSBE-së, HRW-së, si dhe disa gazetarë vendorë ishin në shtëpinë e familjes Qaili para varrimit.[1370] Kufoma e tij u zhvarros më 7 prill 2002.[1371] Në kufomën e Atulla Qailit u kryen dy autopsi, e para

[1365] Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 17. Dhoma Gjyqësore pranon nga dëshmitë se gjatë kontrollit të shtëpisë policia nuk gjeti asnjë armë, çifte apo gëzhojë, *shih* Ismail Ramadani, Prova Materiale P189, para. 10.

[1366] *Shih* më lart, para. 54; 74; 78.

[1367] Zllatko Jaqovski, T 2304-2305; Prova Materiale P259, një notë zyrtare e datës 13 gusht e paraqitur nga Dragan Surlov i stacionit policor të Mirkocit, ku bëhet e ditur se Atulla Qaili kishte kërkuar ndihmë mjekësore në orën 14:30 më 13 gusht, pas kësaj Surlov kishte thirrur një ambulancë dhe Atulla Qaili ishte dërguar në spital; *shih* gjithashtu Blagoja Toskovski, T 4315-4316, Prova Materiale P261, një notë zyrtare Nr. 537 datë 14 gusht 2001 e paraqitur nga dëshmitari tregon se Atulla Qaili vdiq në spital më 13 gusht 2001, pasi ishte mbajtur në stacionin policor të Mirkocit nga ora 0200 më 13 gusht 2001; dokumenti njofton se pas keqësimit të gjendjes së tij shëndetësore, polici roje në stacionin policor kishte thirrur ambulancën dhe ai ishte dërguar në Spitalin e Qytetit të Shkupit, ku vdiq më vonë po atë ditë.

[1368] Zllatko Jaqovski, duke iu referuar Provës Materiale P284, një dokument me titull "Historia e sëmundjes" dëshmitari dëshmoi se ndonëse emri ishte dhënë si "Abdulla Cajani" u pranua më vonë se personi ishte Atulla Qaili, T 2289.

[1369] Prova Materiale P287; Zllatko Jaqovski konfirmoi një vërtetim tjetër vdekjeje lëshuar nga dëshmitari e cila thotë se vdekja e Atulla Qailit ishte shkaktuar prej dhunës, T 2298; Prova Materiale P288.

[1370] Betullah Qaili, Prova Materiale P383, para. 31, 35.

[1371] Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 4, 6.

pas vdekjes së tij më 14 gusht 2001, dhe e dyta pas zhvarrimit të tij më 9 prill 2002.[1372] Aktautopsia e 14 gushtit 2001 përmend një sërë plagësh praktikisht në tërë kufomën e Atulla Qailit. U konkludua se shkaku i vdekjes ishte dhuna dhe si rezultat i traumës u shkaktua ndërprerja e funksionimit të organeve jetike, për shkak të "forcës dinamike kompakte jodepërtuese" dhe të vazhdueshme në kokë, trup dhe gjymtyre.[1373] Aktautopsia e dytë konfirmoi konkluzionet e autopsisë së vitit 2001 për thyerje të shumta në brinjë, në anën e majtë të kafazit të krahërorit, si dhe thyerje në rrëzë të kafkës.[1374] Dr Zllatko Jaqovski dëshmoi se këto plagë ishin shkaktuar në të njëjtën kohë, por nuk ishte në gjendje të përcaktonte kohën.[1375]

330. Mbrojtja e Boshkoskit sugjeron se policia veproi menjëherë për t'i siguruar Atulla Qailit ndihmë mjekësore për shkak të gjendjes së tij shëndetësore; Pretendohet se një veprim i tillë pasqyron "një gjendje psikologjike krejt ndryshe" nga ajo e një vrasësi.[1376] Dhoma Gjyqësore nuk mund të pajtohet me këtë pretendim. Madhësia e së paku disa prej plagëve të tij dhe gjendja e tij e rëndë duhet të kenë qenë të dukshme për ata që po e rrihnin në stacionin policor të Mirkocit. Ai u çua në spital, por dëshmitë sugjerojnë se tranportimi i tij për në spital u bë nga një polic tjetër.[1377] Mirëpo problemi është qëllimi ose gjendja mendore e rrahësve të Atulla Qailit gjatë rrahjes. Edhe sikur personi apo personat që rrahën Atulla Qailin të jenë kujdesur më pas që ai të mjekohej, nuk përjashtohet fakti që ky person apo këta persona të kenë patur *mens rea* të nevojshme për vrasje gjatë rrahjes.

331. Provat për plagët e shumta dhe të ndryshme në trupin e Atulla Qailit e bindin Dhomën Gjyqësore që të konkludojë se Atulla Qaili u rrah në mënyrë të vazhdueshme, në të gjithë trupin, dhe egërsisht. Ndaj tij u ushtrua forcë shumë e madhe fizike, pasojë e së cilës ishte vdekja e shkaktuar me mjetet e përshkruara në aktautopsinë e 14 gushtit. Mbi

---

1372 Provat Materiale P49, f. 14; përkatësisht 1D74, f. 1.

1373 Prova Materiale P49, f. 31; *shih* gjithashtu Zllatko Jaqovski, T 2263-2286; 2275-2277; Provat Materiale P14; P187, e marrë pas autopsisë; *shih* gjithashtu Provat Materiale P280; P281; P282.

1374 Prova Materiale 1D74, f. 3.

1375 Zllatko Jaqovski, T 2333; T 2267; Prova Materiale 1D279.

1376 Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 315.

1377 *Shih* Provën Materiale P259. Dhoma Gjyqësore vë në dukje gjithashtu se ekzistojnë dy dokumenta të spitalit si prova materiale të cilat thonë se "Abdulla Cajani" u shtrua në klinikë për shkak të dëmtimeve nga një rrëzim, Provat Materiale P283; P286. Ky ishte informacioni që mori doktori kur Abdulla Cajani (Atulla Qaili) u soll në spital më 13 gusht; *shih* gjithashtu Zllatko Jaqovski, T 2295-2297; 2287-2288.

bazën e provave, Dhoma Gjyqësore pranon se Atulla Qaili u keqtrajtua përpara se t'a çonin në stacionin policor të Mirkocit. Megjithatë, në këtë stacion policor ai u rrah përsëri egërsisht. Dhoma Gjyqësore nuk përjashton opsionin se disa nga plagët e përmendura në aktautopsi mund t'i jenë shkaktuan përpara se t'a çonin në stacionin policor të Mirkocit. Dhoma Gjyqësore nuk kupton pse Dr Jaqovski përjashton mundësinë që plagët të jenë shkaktuar gjatë një periudhe disaorëshe, në deklaratën e tij bazuar në përfundimet e tij të vitit 2002, se plagët u shkaktuan "në të njëjtën kohë". Sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, fjala "kohë" ka një kontekst kohor relativ. Dhoma Gjyqësore konkludon se në fazat e fundit të rrahjes së Atulla Qailit në stacionin policor të Mirkocit, gjendja e tij e rëndë dhe efektet e keqtrajtimit të tij të mëparshëm duhet të kenë qenë domosdoshmërisht të qarta për personin apo personat që vazhdonin t'a rrihnin. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore konkludon se ky person apo këta persona vazhduan t'a rrihnin Atulla Qailin duke qenë të vetëdijshëm se duke vepruar kështu ata mund t'i shkaktonin vdekjen.

332. Mirëpo në lidhje me vërtetimin e krimit të vrasjes, Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të konkludojë nëse personi apo personat që e keqtrajtuan Atulla Qailin përpara se ai të transferohej në stacionin policor të Mirkocit, e bënë këtë gjë me *mens rea*-n e kërkuar. Në mungesë të provave më të drejtpërdrejta, *mens rea* duhet përcaktuar nëpërmjet deduksionit. Duke u nisur nga kjo hipotezë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të përjashtojë deduksionin se keqtrajtimi i qëllimshëm përpara se Atulla Qaili të transferohej në stacionin policor, mund të jetë bërë pa synimin për t'a vrarë si dhe pa qenë të vetëdijshëm se keqtrajtimi mund të çonte në vdekjen e tij.

333. Më tej, provat e bindin Dhomën Gjyqësore se keqtrajtimi i Atulla Qailit në Luboten më 12 gusht u bë nga një apo më shumë pjesëtarë të paidentifikuar të njësisë policore e cila hyri në fshat atë mëngjes nën drejtimin e të Akuzuarit Johan Tarçulovski. Mirëpo Dhoma Gjyqësore konkludon se rrahja e Atulla Qailit në stacionin policor të Mirkocit nuk u krye nga pjesëtarë të kësaj njësie policore, por nga një apo më shumë policë maqedonas të paidentifikuar, që ishin në detyrë në stacionin policor të Mirkocit më 12 apo 13 gusht 2001.

(e) Xhelal Bajrami, Bajram Jashari dhe Kadri Jashari

334. Në këtë Aktgjykim është vërtetuar dhe më poshtë parashtrohet në hollësi, se Xhelal Bajrami, Bajram Jashari dhe Kadri Jashari u qëlluan ndërkohë që po vraponin nga shtëpia e Qani Jasharit në Luboten rreth kohës kur një autoblindë Hermelinë dhe policët iu afruan kësaj shtëpie më 12 gusht.[1378] Kufomat e tyre u varrosën disa ditë pas vdekjes së tyre në varrezën e Lubotenit.[1379] Në prill 2002, kufomat e tyre u zhvarrosën nga varreza dhe u kryen autopsi.[1380]

335. Autopsia e kufomës së Xhelal Bajramit u krye më 15 prill 2002. Në kufomën e tij u gjetën 10 plumba që ndodheshin prapa qafës, në anë të majtë të shpatullës së majtë, në pjesën e djathtë të kafazit të krahërorit, në diafragmë, në zonën e legenit, në anën e djathtë të trupit, dhe në pjesën e brendshme të kofshës së majtë. Kahu i kanaleve të hapura nga plumbat nuk mund të përcaktohej për shkak të gjendjes së kalbëzuar të kufomës.[1381] Aktautopsia nuk arriti të përcaktonte se cila nga këto plagë me armë zjarri kishte qenë shkaku konkret i vdekjes. Këqyrja e plumbave të gjetura në kufomë, ndër të tjera, të Xhelal Bajramit, kryer nga Instituti Kriminalistik i Hollandës ("IKH") konkludoi se fishekët ishin të kalibrit 7.62 milimetërsh. Por instituti nuk arriti të përcaktojë kalibrin e bërthamës së brendshme prej plumbi të veshjes metalike si dhe kalibrin e një copëze të metalit të petëzuar.[1382] Dhoma Gjyqësore vë në dukje se aktekspertiza e IKH-së nuk përjashton mundësinë që kjo copëz të jetë shkëputur nga një lëndë shpërthyese.[1383] Në kohën kur u bë autopsia, Xhelal Bajrami ishte veshur me xhins, një këmishë të zezë si dhe sandale të sheshta prej gome.[1384] Kjo përputhet me veshjen e kufomës në fotografitë e marra *in situ* më 14 gusht.[1385]

1378 *Shih* më lart, para. 68.
1379 *Shih,* për shembull, Provën Materiale 1D71.
1380 Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 6-12; kufomat e vëllezërve ID/3 dhe ID/4, për të cilat u vërtetua se ishin përkatësisht të Bajram Jasharit dhe Kadri Jasharit, u zhvarrosën më 11 prill 2002, ndërsa kufoma ID/5, e cila u vërtetua se ishin të Xhelal Bajramit, u zhvarros më 15 prill 2002.
1381 Provat Materiale P447, f. 7; P448.
1382 Raporti, Prova Materiale 1D222, ERN N000-1628, përmban një shënim se provat materiale marrë nga kufoma ID/5, përmbanin copëzat e mbetura të *së paku* nëntë plumbave.
1383 Prova Materiale 1D222, f. 6 dhe N000-1628, përshkrimi i Provave Materiale nga kufoma ID/5, copëza BA-21, për të cilin raporti thotë se nuk dihet kalibri i tij.
1384 Prova Materiale 1D5, f. 5-6; *shih* gjithashtu Provën Materiale P448.
1385 Henry Bolton, T 1694-1696; Prova Materiale 1D27; *shih* gjithashtu Provën Materiale P203, ERN N000-7828.

336. Kur u krye autopsia, në xhepat e veshjes së tij u gjetën 26 krehëra municioni të papërdorura.[1386] Ishin të kalibrit 7.62 milimetërsh, të prodhimit kinez apo shqiptar, dhe veç tyre, u gjet edhe një krehër municioni i një prodhimi të panjohur.[1387] Ky është kalibri i armës Kallashnikov AK47, armë e përdorur gjerësisht nga ushtria dhe policia maqedonase si dhe nga UÇK-ja.[1388] Plumbat e identifikuar të kalibrit 7.62 millimetërsh të gjetura në kufomat e dy prej tre të vdekurve të tjerë, ishin të një prodhimi të ndryshëm nga ai i gëzhojave të gjetura në xhepin e Xhelal Bajramit.[1389]

337. Autopsia e kufomës së Bajram Jasharit më 11 prill zbuloi dy copëza plumbi si dhe një plumb të plotë në pjesën e prapme të qafës;[1390] po ashtu kishte plagë të shumta me armë zjarri në zonën e kafazit të krahërorit dhe stomak, të shkaktuara nga të paktën gjashtë plumba.[1391] Aktautopsia përshkruan thyerje të shumta në kufomën e viktimës dhe pohon se ato ishin shkaktuar nga disa kanale të plumbave me armë zjarri, disa me kahun "para-prapa," disa "majtas-djathtas," dhe disa nga "lart-poshtë."[1392] Kahu i kanaleve "lart-poshtë" sugjeron se Bajram Jasharit iu shkaktuan këto plagë me armë zjarri në kohën kur ishte i shtrirë përtokë. Aktautopsia nuk përcaktoi se cila nga këto plagë me armë zjarri ishte konkretisht shkaku i vdekjes. Tre nga plumbat e gjetur në kufomën e tij, u identifikuan si të kalibrit 7.62 milimetërsh, ndërsa kalibri i plumbave dhe copëzave të tjera mbeti i panjohur.[1393] Aktekspertiza balistike e IKH-së-së për plumbat dhe copëzat e gjetura në kufomat nuk përjashtoi mundësinë që dy prej copëzave të gjetura në kufomën e Bajram Jasharit të jenë shkëputur nga "lëndë shpërthyese".[1394] Një fotografi e shënuar nga Henry Bolton në të cilën ai tregon se ku i pa kufomat e tre burrave përtokë më 14 gusht, tregon se kufoma e Bajram Jasharit ishte më afër shtëpisë së Qani Jasharit se sa

---

1386 Prova Materiale 1D5, "Raport për zhvarrosjet e kryera në Luboten dhe autopsitë e mëvonshme", datë 9 maj 2002, f. 6; Howard Tucker, T 5451; Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 9-11; Zllatko Jaqovski, T 2401-2406; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D222, ERN N000-1630.

1387 Prova Materiale 1D222, Kufoma ID/5, ERN N000-1630; Howard Tucker, T 5451.

1388 *Shih* gjithashtu Zoran Jovanovski, T 5107; Nazim Bushi, që konfirmon se "shumë shpesh" UÇK-ja përdorte Kallashnikov të prodhimit kinez apo rus, T 5930.

1389 Prova Materiale 1D222, f. 5, Kufoma ID/5.

1390 Prova Materiale P444, ERN N000-4291 dhe N000-4294, i referohet "anës së brendshme të pjesës së prapme të këmishës". Megjithëse e paqartë, Dhoma Gjyqësore konkludon se këtu është fjala për një plagë në trup, dhe jo për dëmtim të këmishës.

1391 Prova Materiale P444, f. 5; *shih* gjithashtu Provën Materiale 1D222, Kufoma ID/3, ERN N000-1627, e cila thotë se Provat Materiale nga kufoma e tij përmbajnë (copëzat e mbetura të) të paktën pesë plumbave; *shih* gjithashtu dëmtimin në rrobat e tij, Prova Materiale P445.

1392 Prova Materiale P444, f. 5.

1393 Prova Materiale 1D222, Kufoma ID/3, ERN N000-1627.

1394 Prova Materiale 1D222, ERN N000-1626 dhe N000-1627, përshkrimi i Provave Materiale nga kufoma ID/3; copëza BA-7 dhe BA-8.

kufomat e tjerat.[1395] Bajram Jashari ishte i veshur me xhaketë të zezë xhins, këmishë të kuqe në të gjelbër, si dhe pantallona xhins[1396] kur u zhvarros.[1397] Ky përshkrim përputhet me veshjen e treguar në fotografitë e bëra më 14 gusht.[1398]

338. Autopsia e kufomës së Kadri Jasharit e kryer më 13 prill 2002, zbuloi plagë në zonën e kokës, fytyrë, vertebrat e qafës dhe pjesën e sipërme të krahut të djathtë të shkaktuara nga "lëndë shpërthyese", si dhe plagë të shkaktuar nga plumbat në zonën e pjesës së sipërme të krahut të majtë, në brinjë, dhe në kularth (klavikula).[1399] Provat materiale të marra nga kufoma e tij dhe të analizuara prej IKH-së, përfshijnë copëzat e mbetura të së paku një plumbi; kalibri i copëzave të mbledhura mbeti i panjohur.[1400] Aktekspertiza e IKH-së nuk përjashtoi mundësinë që dy copëza të gjetura në kufomën e Kadri Jasharit të jenë shkëputur nga lëndë shpërthyese.[1401] Aktautopsia e tij nuk përcaktoi se cila nga plagët me armë zjarri apo dëmtimet e tjera kishin shkaktuar vdekjen e tij. Kur u zhvarros kufoma, u pa se Kadri Jashari ishte veshur me pantallona të zeza, një bluzë të bardhë me mëngë të shkurtra, si dhe një xhaketë poliestër blu e errët.[1402] Kjo përputhet me veshjen e fotografisë së kufomës më 14 gusht.[1403]

339. Siç është diskutuar gjetkë në Aktgjykim, dëshmitë sugjerojnë se Xhelal Bajrami, Bajram Jashari dhe Kadri Jashari, së bashku me M088 dhe M092, u larguan nga shtëpia e Qani Jasharit duke vrapuar në një të përpjetë përmes një fushe. Ndërkohë që po vraponin, kundër tyre u hap zjarr nga ushtria dhe policia.[1404] M092, një nga burrat që u larguan me vrap nga shtëpia e Qani Jasharit, dëshmoi se kundër tyre u hap zjarr nga pozicionet e ushtrisë në Malistenë[1405], të cilat, sipas mendimit të dëshmitarit, ishin rreth një kilometër

---

1395 Henry Bolton, T 1633-1638; Prova Materiale P242, shenja BJ = Bajram Jashari, shenja BY = Xhelal Bajrami dhe KJ = Kadri Jashari.
1396 Nga fotografitë e kufomës duket se xhinsat ishin të zeza.
1397 Prova Materiale P445.
1398 Henry Bolton, T 1636; Prova Materiale P244; *shih* gjithashtu Provën Materiale P203, ERN N000-7826.
1399 Prova Materiale P446, f. 4.
1400 Prova Materiale 1D222, Kufoma ID/4, ERN N000-1627.
1401 Prova Materiale 1D222, Kufoma ID/4, f. 6 dhe ERN N000-1627, përshrim i Provave Materiale nga Kufoma ID/4, fragmente BA-11 dhe BA-13.
1402 Prova Materiale P446 f. 1.
1403 Henry Bolton, T 1638; Prova Materiale P245; *shih* gjithashtu Provën Materiale P203, ERN N000-7827.
1404 *Shih* më lart, para. 68.
1405 Nga një krahasim i hartave, vendi i përshkruar nga M092 si "Malistena" i përgjigjet pozicioneve të ushtrisë në Smok dhe Bomba; M092, T 1254-1256; Prova Materiale P216; Nikollçe Grozdanovski, T 10463-10465; Prova Materiale P596.

larg,[1406] si dhe nga forcat maqedonase në lagjen Elezaj,[1407] nga një largësi rreth 300 metra.[1408] Kjo përputhet me dëshmitë e tjera të diskutuara gjetkë në këtë Aktgjykim për hapje zjarri nga pozicionet e ushtrisë në Smok dhe Bomba, si dhe nga policët, të cilët në atë kohë po i afroheshin shtëpisë së Qani Jasharit.[1409] Mirëpo vlerësimi i largësisë prej dëshmitarit nuk është i saktë. Dëshmitë e tjera dhe hartat tregojnë se largësia deri në Smok dhe Bomba ishte afro 800 metra,[1410] kurse largësia nga rruga në hyrje të shtëpisë së Qani Jasharit deri në kufomën më të largët ndër tre viktimat ishte më pak se 300 metra.[1411] Kjo gjë kuptohet edhe nga fotografitë e pozicioneve të tri kufomave.[1412]

340. Ndonëse policët ishin shumë më afër burrave ndërkohë që ata vraponin dhe ndonëse ndaj tyre hapën zjarr shumë policë, rezultatet e autopsisë tregojnë se plumbat që goditën viktimat erdhën nga më tepër se një drejtim. Megjithëse Henry Bolton kishte pa dyshim të drejtë kur mbi bazën e vëzhgimit të tri kufomave në fushë tha se plagët e hyrjes dhe daljes së plumbave tregojnë se të tre burrat u goditën nga pas ndërkohë që po vraponin,[1413] domethënë nga pozicioni i policëve, disa plagë të tjera që u identifikuan gjatë autopsisë tregojnë se ato nuk ishin shkaktuar nga plumba që erdhën nga prapa. Disa nga plagët mund të jenë shkaktuar nga plumbat e ushtrisë. Kalibri i këtyre plumbave dhe copëzave të identifikuara në kufomat, tregon se u përkasin pushkëve Kallashnikov që përdoreshin nga policia dhe ushtria[1414], por nuk përputhet me kalibrin më të madh të plumbit të shkrepur nga një pushkë snajpër prej ushtrisë në Smok.[1415]

1406 M092, T 1297-1298; M092, Prova Materiale P215, para. 19.

1407 Lagjjaa Elezaj përfshin shtëpitë e familjeve Rexhepi dhe Lutfiu. Duket se kjo zonë shtrihet në zonën e shtëpisë së Qani Jasharit.

1408 M092, Prova Materiale P215, para. 19.

1409 *Shih* më lart, para. 64.

1410 *Shih* Provën Materiale P298.

1411 M088 dha dëshmi se largësia midis shtëpisë së Qani Jasharit dhe rreshtit të parë të shkurreve ishte rreth 500 metra, Prova Materiale P206, para. 25. Nga një fotografi e shënuar nga Henry Bolton për të treguar pozicionin e kufomave të Xhelal Bajramit, Kadri Jasharit dhe Bajram Jasharit në fushë pranë shtëpisë së Qani Jasharit, duket se Kadri Jashari, kufoma e të cilit ishte më larg se dy kufomat e tjera nga shtëpia, ishte rreth më pak se 300 metra nga shtëpia e Qani Jasharit.

1412 Henry Bolton, T 1633-1635; Prova Materiale P242.

1413 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 18.

1414 Raporti i NFI-së për analizën e plumbave dhe fragmenteve të marra gjatë autopsive nga kufomat e viktimave që pretendohet se janë vrarë, sugjeron se plumbat që mund të identifikoheshin janë të armëve të kalibrit 7.62 milimetra, të përdorura kryesisht për pushkë gjysëmautomatike, pushkë automatike, dhe mitralozë, Prova Materiale 1D222, f. 5.

1415 M2D-008, T 10563. Kjo pushkë snajper ishte e kalibrit 7.92 milimetra; Simon Eichner dëshmoi se plumbi 7.92 milimetërsh nuk mund të jetë shkrepur prej pushkës Kallashnikov, pasi kjo pushkë është e një kalibri tjetër, T 4471; Prova Materiale P425. Në asnjë nga këto kufoma nuk u identifikua asnjë plumb I tillë, *shih* Prova Materiale 1D222, N000-1627-N000-1628; Një fragment 7.92 milimetërsh u gjet gjatë zhvarrosjes më 7 prill

341. Të dyja aktautopsitë lënë të hapur mundësinë që disa nga plagët nuk u shkaktuan nga plumbat, por nga shpërthime apo lëndë shpërthyese. Në një rast të tillë një plagë shpërthimi mund të jetë shkaktuar nga një granathedhës Zolja apo bomba që përdoren nga policia,[1416] apo nga predha mortaje apo topi të gjuajtura nga ushtria. Mirëpo asnjë dëshmitar nuk ka folur për ndonjë shenjë shpërthimi pranë ndonjërës prej tri kufomave. Dëshmitë sugjerojnë se ushtria dhe policia hapën zjarr me një mitraloz kundër burrave që vraponin, por po të ketë ndodhur kështu, nuk ka prova për kalibrin e këtyre armëve.

342. Aktautopsitë nuk identifikojnë plagë konkrete si shkak vdekjeje të cilitdo prej këtyre tre burrave. Duke marrë parasysh çështjet e sapodiskutuara, Dhoma Gjyqësore pranon se së paku disa nga plagët të cilat mund të kenë shkaktuar vdekjen e Xhelal Bajramit, Kadri Jasharit dhe Bajram Jasharit, u shkaktuan nga policët që hapën zjarr drejt burrave që vraponin nga pozicioni i tyre në afërsi të shtëpisë së Qani Jasharit. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk përjashton mundësinë që të paktën disa nga plagët apo dëmtimet e pësuara nga secili prej tre burrave, të jenë shkaktuar nga zjarri i hapur kundër tyre prej pozicioneve të ushtrisë në Smok dhe Bomba.

343. Në rrethanat e sapopërmendura nuk mund të përcaktohet nëse ndonjë prej tre burrat u vra nga policia, dhe jo nga ushtria. Në Aktakuzë pretendohet se të tre burrat u vranë nga policia. Rrjedhimisht Prokuroria nuk ka vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se plagët që çuan në vdekjen e Xhelal Bajramit, Kadri Jasharit dhe Bajram Jasharit, u shkaktuan nga të shtënat e policisë. Duke u nisur vetëm nga kjo bazë, të Akuzuarit nuk mund të shpallen fajtorë për vrasjen e ndonjërit prej këtyre tre burrave, sipas pretendimit të Aktakuzës.

344. Dhoma Gjyqësore ka theksuar më hollësisht gjetkë në këtë Aktgjykim se përfaqësuesi i OSBE-së që vizitoi Lubotenin më 14 gusht nuk pa prova për ndonjë pozicion mbrojtës apo shkëmbim zjarri në zonën e ndërtesave thuajse të djegura të shtëpive të Qani Jasharit dhe anëtarëve të tjerë të familjes Jashari.[1417] Mirëpo forca e kësaj dëshmie dobësohet sepse ai e vizitoi këtë vend dy ditë pas vrasjeve dhe ndërkohë

2002. U gjet pranë sipërfaqes së tokës pranë varrit të Rami Jusufit, por nuk u arrit të përcaktohej lidhje midis këtij fragmenti dhe kufomës së tij; *shih* gjithashtu Howard Tucker, Prova Materiale P443, f. 4.

[1416] *Shih* më lart, para. 48; 165.

[1417] Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 19.

gjurmët e provave për këto çështje mund të jenë eliminuar. Gjithashtu Z. Bolton pranoi se një apo më shumë prej tre burrave mund të kenë patur armë zjarri me vete në kohën kur u vranë.[1418] Faktikisht ai theksoi se pranë kufomave të tre burrave në fushë nuk u gjetën gëzhoja.[1419] Mirëpo kur vizitoi fshatin, ai nuk i pa tri armët funksionale,[1420] për të cilat thuhej se ishin gjetur pranë kufomave së bashku me municionet për këto armë. Dhoma Gjyqësore i ka shprehur tashmë shqetësimet e saj për aspektet e kësaj dëshmie, mirëpo ato nuk e përjashtojnë këtë dëshmi. Për më tepër dhe çka është më e rëndësishme, në kohën kur bëri këtë vizitë Z. Bolton nuk e dinte se më pas në xhepat e rrobave që kishte veshur Xhelal Bajrami do të gjendeshin 26 krehëra fishekësh të papërdorur të kalibrit 7.62 milimetërsh, të përshtatshme për dy nga tri armët. Gjithsesi raporti i OSBE-së bazuar në përfundimet e tij pranon, bazuar mbi çfarë pa dhe dëgjoi Z. Bolton, se vdekjet e këtyre tre burrave ishin "më pak të dyshimta dhe me gjasë kishin lidhje me veprim legjitim ushtarak."[1421]

345. Natyrisht Dhoma Gjyqësore ka patur mundësi t'i shqyrtojë dëshmitë e shumta gojore dhe me shkrim për këto çështje, të cilat mundësojnë të bëhet një vlerësim më i plotë i rrethanave të vdekjes së Xhelal Bajramit, Kadri Jasharit dhe Bajram Jasharit. Duke patur parasysh gjithçka që dihet tani, siç është përshkruar me hollësi në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore konkludon se ekziston një dyshim i arsyeshëm nëse këta tre burra merrnin pjesë aktive në luftime me armë në momentin kur u qëlluan. Ky përfundim është i mundshëm mbi bazën e dëshmive se kundër policisë apo ushtrisë u hap zjarr nga shtëpia e Qani Jasharit dhe më herët nga shtëpitë e tjera të Jasharëve dhe se, kur policët e armatosur iu afruan shtëpisë së Qani Jasharit, pesë burrat u larguan nëpërmjet pjesës së prapme të shtëpisë duke vrapuar përmes fushës në drejtim të zonës së pyllëzuar, duke mbartur me vete tri armë dhe municione. Rrjedhimisht Prokuroria nuk mundi të

[1418] Henry Bolton, T 1706-1707, Prova Materiale 1D24, f. 1.
[1419] Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 19.
[1420] Prova Materiale P424, f. 6. Theksohet se lidhur me municionin e papërdorur të gjetur në fushën pranë shtëpisë së Qani Jasharit së bashku me armët, Simon Eichner dëshmoi se, prej Kallashnikovëve mund të ishin shkrepur 40 plumba, megjithëse kishte edhe municione të papërdorura që përdoreshin për automatikun Thompson, T 4544-4545; Prova Materiale P242. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se dëshmitari konkludoi se asnjë nga fragmentet që i dhanë për analizë, të marra gjithashtu nga vendi i ngjarjes, nuk mund të ishte pjesë e një plumbi të shkrepur prej automatikut Tompson, T 4470. Nuk mund të përjashtohej se disa nga fragmentet e gjetura 7.62 milimetërshe të kishin dalë nga njëri apo të dy Kallashnikovët, ndërsa disa nga fragmentet e kalibrit 7.62 milimetërsh kishin disa "karakteristika përfaqësuese" të cilat përjashtonin mundësinë se dy Kallashnikovët ishin armët prej të cilave ishin shkrepurr këta plumba, T 4471.
[1421] Prova Materiale 1D24, f. 2.

vërtetonte jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se këta tre burra nuk merrnin pjesë aktive në luftime me armë, në kohën kur u vranë.

3. Konkluzion

346. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë individuale të të dy të Akuzuarve, Dhoma Gjyqësore konkludon se janë vërtetuar elementët e Pikës 1, Vrasjes, lidhur me viktimat Rami Jusufi, Sulejman Bajrami, dhe Muharem Ramadani.

347. Elementët e Vrasjes janë vërtetuar edhe lidhur me viktimën Atulla Qaili, mirëpo duke marrë parasysh çështjet që do të trajtohen më poshtë, Dhoma Gjyqësore thekson se përfundimi i saj nuk vlen në lidhje me veprimet e policisë në fshatin Luboten, por në lidhje me veprimet e mëvonshme të policëve të ndryshëm në stacionin policor të Mirkocit.

348. Gjithsesi, në lidhje me Xhelal Bajramin, Kadri Jasharin dhe Bajram Jasharin, Dhoma Gjyqësore konkludon se provat nuk vërtetuan jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se këta tre burra u vranë nga të shtënat e policisë, dhe jo nga të shtënat e ushtrisë për të cilën nuk ka pretendim në Aktakuzë. Gjithashtu Prokuroria nuk vërtetoi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se në kohën kur u vranë, këta burra nuk merrnin pjesë aktive në luftime me armë. Për këto arsye, nuk mund të shpallet fajësi për Vrasje lidhur me vdekjen e secilit prej këtyre tre burrave.

B. Shkatërrim pa shkak (Pika 2)

1. Ligji

349. Pika 2 e Aktakuzës i akuzon të Akuzuarit për shkatërrim pa shkak të qyteteve, qytezave ose fshatrave, i dënueshëm si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës, në bazë të Nenit 3(b) të Statutit.

350. Neni 3(b) i Statutit kodifikon dy krime: “shkatërrim pa shkak i qyteteve, qytezave ose fshatrave i papërligjur nga domosdoshmëria ushtarake” dhe “shkretim i papërligjur nga domosdoshmëria ushtarake”. Të dy krimet janë trajtuar së bashku nga një sërë

instrumentash të së drejtës humanitare ndërkombëtare,[1422] dhe Dhoma Gjyqësore nuk konstaton dallim thelbësor midis elementëve të këtyre dy krimeve.[1423] Në këtë çështje është bërë akuzë vetëm për krimin e parë.

351. Elementët e krimit "shkatërrim pa shkak i papërligjuar nga domosdoshmëria ushtarake" janë identifikuar nga jurisprudenca e këtij Tribunali si më poshtë:[1424]

(i) shkatërrimi i pronës ndodh në një masë të madhe;

(ii) shkatërrimi nuk përligjet prej domosdoshmërisë ushtarake; dhe

(iii) keqbërësi veproi me synimin për të shkatërruar pronën në fjalë apo duke shpërfilluar papërgjeshmërisht gjasën e shkatërrimit.

352. Elementi i parë – që shkatërrimi ndodhi në "një masë të madhe" – kërkon që të jenë dëmtuar apo shkatërruar një numër i konsiderueshëm objektesh. Gjithsesi nuk kërkohet që shkatërrimi të ketë ndodhur në të gjithë qytetin ose fshatin.[1425] Dhoma Gjyqësore në çështjen *Haxhihasanoviq* konkludoi se ky kusht plotësohet kur është shkatërruar një sasi e madhe e pronës ose kur vlera e një objekti të vetëm është mjaftueshmërisht e madhe.[1426] Shkatërrimi i pjesshëm i pronës mund të konsiderohet i mjaftueshëm për aq kohë sa veprimet e shkatërrimit të pjesshëm janë kryer në një masë të madhe.[1427]

353. Kushti i dytë është se veprimi "nuk përligjet prej domosdoshmërisë ushtarake". Domosdoshmëria ushtarake mund të përkufizohet në mënyrë të volitshme duke iu

---

1422 *Shih* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 291, poshtëshënimi 934 ku përmendet "Lista e Krimeve të Luftës" e përgatitur nga Komisioni për Përgjegjësinë e Autorëve të Luftës dhe për Zbatimin e Dënimeve /Commission on the Responsibility of the Authors of the War and on the Enforcement of Penalties/, e cila iu paraqit Konferencës Paraprake të Paqes në Paris më 29 mars 1919/; Article 6(B) of the Nuremberg Charter, Article II, para 1(b) of the Control Council Law No. 10, and Articles 8(2)(b)(xiii) and 8(2)(e)(xii) of the Rome Statute of the International Criminal Court, U.N. Doc. A/CONF.183/9, 17 July 1998 /Neni 6(B) i Kartës së Nyrenbergut, Neni II, para. 1(b) i Ligjit për Këshillin e Kontrollit Nr. 10, dhe Nenet 8(2)(b)(xiii) dhe 8(2)(e)(xii) të Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, OKB. Dok. A/CONF.183/9, 17 korrik 1998/.

1423 *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 290-297; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 591-593; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, para. 91.

1424 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 346; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 74; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Naletiliq*, para. 579; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 292; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq*, para. 43; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, para. 90.

1425 *Shih* p.sh. Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Naletiliq*, para. 584, 596. *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 294; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Oriq*, para. 585; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, para. 92.

1426 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq*, para. 43.

1427 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq*, para. 44.

referuar përkufizimit të objektivave ushtarake në Nenin 52 të Protokollit Shtesë I.[1428] Para shqyrtimit të hollësishëm të përkufizimit të objektivave ushtarake, është e rëndësishme të theksohet se vetëm goditja e objekteve që cilësohen si objektiva ushtarake, mund të përligjet prej domosdoshmërisë ushtarake. Parimet e dallimit dhe mbrojtjes i detyrojnë palët ndërluftuese të bëjnë gjithnjë dallimin midis objektivave ushtarake dhe civile, si dhe të sulmojnë vetëm objektiva ushtarake.[1429] Siç konkludoi Dhoma e Apelit, këto parime imponojnë "ndalim absolut të sulmeve kundër civilëve"[1430] dhe "ndalimi i sulmeve kundër civilëve apo objekteve civile nuk mund të anulohet duke iu referuar domosdoshmërisë ushtarake."[1431] Dëmtimi i pronës civile apo shkaktimi i viktimave civile mund të konsiderohet i ligjshëm vetëm po të jenë rastësore gjatë kryerjes së operacioneve ushtarake kundër objektivave ushtarake.[1432]

354. Neni 52 i Protokollit Shtesë I i përkufizon objektivat ushtarake si më poshtë:

> Përsa u përket objekteve, objektivat ushtarakë konsistojnë në ato objekte të cilat, në sajë të natyrës, vendndodhjes, qëllimit apo përdorimit të tyre, japin kontribut të efektshëm në operacionin ushtarak dhe shkatërrimi, kapja, apo asgjësimi i tyre i plotë apo i pjesshëm, në rrethanat ekzistuese të asaj kohe, ofrojnë epërsi të dukshme ushtarake.

355. Dhoma Gjyqësore merr gjithashtu parasysh Nenin 52(3) të Protokollit Shtesë I, i cili thekson se nëqoftëse ekziston dyshimi se një objekt, si për shembull, një shtëpi apo banesë e cila normalisht është për qëllime civile, përdoret për dhënien e kontributit të efektshëm në operacionin ushtarak, presupozohet se ky objekt nuk po përdoret për një gjë të tillë. Dhoma e Apelit e ka bërë të qartë se ndonëse Neni 52(3) u drejtohet ushtarakëve që synojnë të kryejnë një sulm, në një çështje penale kjo dispozitë nuk ndikon në detyrimin e Prokurorisë për të provuar se një objekt ishte me të vërtetë i caktuar për qëllime civile.[1433]

356. Objekti mund të ofrojë "epërsi të dukshme ushtarake" në kuptimin e Nenit 52 të Protokollit Shtesë I, nëqoftëse ky objekt kontribuon efektivisht në një operacion ushtarak.

[1428] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 295; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Galiq*, para. 51; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Oriq*, para. 587-588.
[1429] Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 190.
[1430] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 109; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 190.
[1431] Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 54; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 130.
[1432] Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 190.
[1433] Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 53; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 145.

Nëse nëpërmjet shkatërrimit të një objekti mund të arrihet epërsi ushtarake, kjo duhet të përcaktohet në bazë të "rrethanave të asaj kohe". Një objekt nuk sulmohet kur nuk është e arsyeshme të besohet në rrethanat e "personit që mendon të bëjë sulmin, duke marrë parasysh informacionin që ai ka në dispozicion, se objekti po përdoret për dhënien e kontributit të efektshëm në operacionin ushtarak."[1434]

357. Në vlerësimin nëse shkatërrimi i pronës "përligjej prej domosdoshmërisë ushtarake", duhet patur parasysh parimi i proporcionalitetit, i sanksionuar në Nenin 51 të Protokollit Shtesë I.[1435] Parimi i proporcionalitetit është thelbësisht i lidhur me domosdoshmërinë ushtarake[1436] dhe është pasqyruar që në përkufizimet e hershme të domosdoshmërisë ushtarake.[1437] Dëmtimi i pronës nuk duhet të jetë në disproporcion me epërsinë konkrete dhe të drejtpërdrejtë të planifikuar përpara sulmit.[1438] Me fjalë të tjera, përdorimi i panevojshëm apo pa shkak i forcës kundër personave dhe pronës, është i ndaluar.[1439] Në përcaktimin nëse një sulm kundër objektivave ushtarake ishte proporcional, është e nevojshme të përdoret këndvështrimi i zbatuesit faktik që planifikon sulmin si dhe shfrytëzon në mënyrë të arsyeshme informacionin në dispozicion.[1440]

358. Përsa i përket *mens rea*-s së krimit të shkatërrimit pa shkak, në bazë të Nenit 3(b) të Statutit, kërkohet që shkelësi të ketë vepruar "me synimin për të shkatërruar pronën në fjalë apo duke shpërfillur papërgjeshmërisht gjasën e shkatërrimit të saj",[1441] pra, duhet të

1434 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Galiq*, para. 51; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 295.

1435 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kupreshkiq*, para. 524; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 190; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Galiq*, para. 58. Parimi i proporcionalitetit pasqyrohet tashmë në përkufizimet e hershme të domosdoshmërisë ushtarake.

1436 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Galiq*, para. 58, poshtëshënim 104.

1437 Sipas Nenit 14 të Kodit Lieber 1863, domosdoshmëria ushtarake konsiston "në domosdoshmërinë e atyre masave që janë *jetike* për të arritur synimet e luftës." (Theksim i shtuar, *shih* gjithashtu Nenet 15, 16 dhe 22 të Kodit Lieber). Për më tepër, Neni 23(g) i Rregullores për Respektimin e Ligjeve dhe Zakoneve të Luftës Tokësore bashkangjitur si shtojcë Konventës së Hagës IV 1907 /Article 23(g) of the Regulations Respecting the Laws and Customs of War on Land annexed to the Hague Convention IV 1907/ thekson se shkatërrimi i pronës duhet "*të diktohet rreptësisht* prej domosdoshmërive të luftës." (Theksim i shtuar, *shih* gjithashtu në lidhje me Kodin Lieber dhe Nenin 23 (g) të Rregullores për Respektimin e Ligjeve dhe Zakoneve të Luftës Tokësore bashkangjitur si shtojcë Konventës së Hagës IV 1907, *Jaworski*, Military Necessity and Civilian Immunity, in: Chinese JIL 2003, pp 179-180)/.Domosdoshmëria Ushtarake dhe Imuniteti i Civilëve, në: Revista Kineze e së Drejtës NdërkombëtareĆ, 2003, f. 179-180).

1438 Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 190.

1439 Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 686 i cili citon Chistopher Greenwood [në] Dieter Fleck (ed.): The Handbook of Humanitarian Law in Armed Conflicts Doracak i Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në Konfliktet e Armatosura, 1995, f. 30, para. 130.

1440 Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 58.

1441 *Shih* më lart, poshtëshënimi 1424.

provohet synimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.[1442] Dhoma Gjyqësore do të procedojë mbi bazën se kushti *mens rea* plotësohet kur shkelësi ka vepruar me synim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë; synimi i tërthortë mund të shprehet nëpërmjet dijenisë së shkelësit se veprimet e tij mund të shkaktonin shkatërrim.

2. Përfundime

359. Pretendohet se 14 shtëpitë në fshatin Luboten, të cilat renditen në Listën A të Aktakuzës, u dëmtuan prej zjarrit të vënë nga njësia policore e komanduar nga Johan Tarçulovski, e cila marshoi përmes fshatit më 12 gusht 2001. Pretendohet gjithashtu se disa nga dëmtimet mund të jenë shkaktuar nga përdorimi i bombave të dorës dhe armëve të vogla.[1443]

360. Në paragrafët e mëposhtëm do të përmenden vlerësimet e Grupit Ndërkombëtar të Menaxhimit ("IMG"). Më 13 shtator 2001, përfaqësues të IMG-së vizituan Lubotenin dhe vlerësuan dëmin e shkaktuar 78 shtëpive. Ata u takuan me parinë e fshatit dhe banorë të fshatit, të cilët identifikuan shtëpitë e dëmtuara. Shtëpitë u fotografuan. Dëmi u vlerësua në përputhje me "Metodologjinë e Vlerësimit për Strehimin" të IMG-së dhe u shpreh si përqindje e shkatërrimit të përgjithshëm. Ekspertët e IMG-së bënë vetëm vlerësimin e masës së dëmit dhe nuk shqyrtuan mënyrën dhe kohën e shkaktimit të dëmit.[1444] Dhoma Gjyqësore i pranon vlerësimet e dëmtimeve, të bëra nga IMG-ja, si të bazuara dhe të besueshme.

361. Ka dëshmi se në disa shtëpi në fshatin Luboten kishte stoqe të materialeve bujqësore, të ndezshme.[1445] Për shembull, në shtëpinë e Xhevdet Jusufit kishte shumë thasë me grurë të cilët shkaktuan daljen e tymit nga shtëpia për një javë të tërë pas 12 gushtit 2001.[1446] Gjithsesi, nuk ka prova që tregojnë se ndonjë nga shtëpitë e përmendura në Aktakuzë si të dëmtuara pa shkak, të ketë marrë zjarr rastësisht.

1442 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 296; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar Martiq*, para. 94.
1443 Aktakuza, para. 24. Lista A jep pseudonimet e pronarëve të 14 shtëpive, që, siç pretendohet, janë dëmtuar. Emrat e tyre jepen në Shtojcën Konfidenciale B të Dosjes Paragjyqësore të Prokurorisë.
1444 Jorgen Engel, Prova Materiale P390.
1445 Marijo Jurishiq T 3363; Sherafedin Ajrullai T 4022-4023; Nikollçe Grozdanovski T 10453-10454.
1446 Prova Materiale P426, para. 20.

362. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi se disa nga shtëpitë në Luboten pësuan dëmtime më 16 apo 17 gusht 2001. Disa raste të tilla përshkruhen në raporte të autoriteteve të policisë lokale. Përmendet shtëpia e Dimo Acevskit dhe tri shtëpi të paidentifikuara të cilave iu vu zjarri më 17 gusht 2001.[1447] Edhe një raport i OSBE-së flet për djegjen e shtëpive më 16 dhe 17 gusht 2001. Raporti bën të ditur se natën e 16-17 gushtit 2001, në zonën e kishës u dogj shtëpia e një maqedonasi etnik dhe më 17 gusht 2001 u dogjën më së shumti tri shtëpi të shqiptarëve.[1448] Rrjedhimisht, një apo më shumë prej shtëpive në këtë zonë dhe të përmendura në Aktakuzë, mund të jenë djegur më 16 apo 17 gusht, dhe jo më 12 gusht 2001, siç pretendohet në Aktakuzë. Dhoma Gjyqësore do t'a ketë parasysh këtë fakt, kur të diskutojë dëshmitë lidhur me shtëpitë në këtë zonë të Lubotenit.

363. Siç është diskutuar gjetkë, më 12 gusht 2001 shtëpisë së Alim Durakit iu vu zjarri nga njësia policore që hyri në fshat.[1449] IMG-ja vlerësoi se dëmi i përgjithshëm shkaktuar shtëpisë së Alim Durakit, ishte në nivelin 25%.[1450] U vlerësua se dëmi i çatisë ishte i barasvlershëm me kategorinë e nivelit më të lartë individual të dëmit të shkaktuar për atë pjesë të shtëpisë.[1451]

364. Nga dëshmitë nuk mund të konkludohet se në atë kohë apo në ndonjë kohë tjetër, shtëpia po përdorej për qëllime ushtarake apo se shkatërrimi i saj do t'i ofronte epërsi ushtarake policisë, e cila i vuri zjarrin. Dhoma Gjyqësore konkludon se djegja e shtëpisë nga policia më 12 gusht 2001 shkaktoi dëme të cilat nuk përligjeshin prej domosdoshmërisë ushtarake.

365. Siç është diskutuar gjetkë, më 12 gusht 2001, shtëpisë së Agim Jusufit iu vu zjarri nga njësia policore që hyri në fshat.[1452] IMG-ja vlerësoi se shtëpia e Agim Jusufit pësoi një dëm në nivelin 64%.[1453] U vlerësua se dëmi i shkaktuar çatisë, dritareve dhe dyerve, ishte i barasvlershëm me kategorinë e nivelit më të lartë individual të dëmit për këto pjesë

1447 Provat Materiale P134; P135.
1448 Prova Materiale 1D32, faqja 1; Prova Materiale P334; Peter Bouckaert T 3021; 3037; Prova Materiale P426, para. 21-22.
1449 *Shih* më lart, para. 45.
1450 Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P412.08.
1451 Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P409.
1452 *Shih* më lart, para. 45.
1453 Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P412.03.

të shtëpisë, ndërsa dëmi i shkaktuar në ambientet e brendshme u vlerësua se ishte në kategorinë e dytë më të rëndë.[1454]

366. Atë mëngjes policia i vuri zjarrin edhe shtëpisë së Qenan Jusufit, që ishte aty pranë.[1455] IMG-ja vlerësoi se dëmi i pësuar nga shtëpia e Qenan Jusufit ishte në nivelin 57%.[1456] U vlerësua se dëmi i shkaktuar çatisë ishte i barasvlershëm me nivelin më të lartë individual për ato pjesë të shtëpisë, ndërsa dëmi shkaktuar ambienteve të brendshme të brendshëm ishte në kategorinë e dytë individuale të dëmit më të rëndë.[1457]

367. Një shtëpie tjetër aty pranë, asaj të Sabit Jusufit, iu vu gjithashtu zjarri nga policia atë mëngjes.[1458] IMG-ja vlerësoi se dëmi i shkaktuar shtëpisë së Sabit Jusufit ishte në nivelin 64%.[1459] Dëmi i shkaktuar çatisë, dritareve dhe dyerve, u vlerësua se ishte në kategorinë e barasvlershme me nivelin më të lartë individual të dëmit për këto pjesë të shtëpisë, ndërsa dëmi i shkaktuar në ambientet e brendshme u vlerësua se ishte në kategorinë individuale të dëmit të dytë më të rëndë.[1460]

368. Një shtëpie tjetër aty pranë, pronë e Xhevdet Jusufovskit, iu vu gjithashtu zjarri nga policia atë mëngjes.[1461] IMG-ja vlerësoi se dëmi shkaktuar shtëpisë së Xhevdet Jusufovskit ishte në nivelin 44%.[1462] Dëmi shkaktuar çatisë u vlerësua se ishte në kategorinë e barasvlershme me nivelin më të lartë individual të dëmit për atë pjesë të shtëpisë.[1463]

369. Siç është diskutuar hollësisht gjetkë në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore e ka shqyrtuar me kujdes, por nuk ka mundur të pranojë si të vërtetë dëshminë sipas së cilës pjesëtarë të ushtrisë të vendosur në malin mbi Luboten, mëngjesin e 12 gushtit 2001, vunë re të shtëna që vinin në drejtimin e pozicioneve të ushtrisë nga një vend afër shtëpive të familjes Jusufi. Nuk ka dëshmi për të shtëna nga këto shtëpi kundër

[1454] Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P409.
[1455] *Shih* më lart, para. 45.
[1456] Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P412.07.
[1457] Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P409.
[1458] *Shih* më lart, para. 45.
[1459] Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P412.04.
[1460] Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P409.
[1461] *Shih* më lart, para. 45.
[1462] Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P412.06.
[1463] Prova Materiale P410, faqe 3; Prova Materiale P409.

pjesëtarëve të njësisë policore që hyri në fshat atë mëngjes. Sipas konstatimit të Dhomës Gjyqësore, dëshmitë nuk janë të tilla që të mund të arrihet në konkluzionin se ndonjë prej shtëpive të Agim Jusufit, Qenan Jusufit, Sabit Jusufit dhe Xhevdet Jusufovskit përdoreshin për qëllime ushtarake në atë kohë, apo se shkatërrimi i ndonjërës prej tyre do t'i ofronte epërsi ushtarake policisë që u vuri zjarrin apo forcave ushtarake në atë zonë. Lidhur me ushtrinë, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se atë mëngjes, rreth orës 08:00, nga pozicionet e ushtrisë u hap zjarr drejt zonës ku ndodheshin shtëpi të shqiptarëve etnikë, jo larg kishës ortodokse. Dëshmitë, veçanërisht për dëmin shkaktuar këtyre shtëpive dhe në mbështetje të konkluzionit se atyre iu vu zjarri nga policia, nuk ofrojnë bazë për mundësinë se shkaku i dëmeve të lartpërmendura në këto shtëpi ishin pikërisht të shtënat nga ushtria. Dhoma Gjyqësore konkludon se dëmet e shkaktuara këtyre katër shtëpive kur iu vu zjarri nga policia më 12 gusht 2001, nuk përligjej prej domosdoshmërisë ushtarake.

370. IMG-ja vlerësoi se shtëpitë e Muhamer Rashitit dhe Isni Fazlievit pësuan dëme në nivelin 64%.[1464] Asnjë nga dëshmitë e paraqitura nuk saktësuan rrethanat e dëmtimit të këtyre shtëpive. Megjithatë, siç u theksua më herët, përfaqësuesit e IMG-së vizituan fshatin Luboten një muaj pas ngjarjeve që kanë lidhje me këtë Aktakuzë. Në mungesë të dëshmive më konkrete, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundimin se këto shtëpi u dëmtuan më 12 gusht 2001 si rezultat i veprimeve të pretenduara në Aktakuzë. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në konkluzionin se lidhur me shtëpitë e Muhamet Rashitit dhe Isni Fazlievit u krye krimi i shkatërrimit pa shkak, siç pretendohet në Aktakuzë.

371. Shtëpia e Nazim Murtezanit pësoi dëmtime në nivelin 24%.[1465] Peter Bouckaert dëshmoi se gjatë vizitës së tij në Luboten më 23 gusht 2001, ai pa vendbanimin e Nazim Murtezanit, duke përfshirë edhe shtëpinë, të djegur. Në muret e jashtme të oborrit, ai pa gjurmë të shkakuara nga armë zjarri.[1466] Ai nuk pa ndonjë dëmtim tjetër të shkaktuar nga granatime dhe arriti në përfundimin se shtëpia ishte djegur.[1467] Ka dëshmi të tjera se më

[1464] Prova Materiale P410; Provat Materiale P412.05; P412.18.
[1465] Provat Materiale P410; P412.23.
[1466] Peter Buckart, T 2984; Prova Materiale P347.
[1467] *Shih* më lart, poshtëshënim 156.

10 gusht 2001, në rrugicën me zhavorr midis shtëpive të Nazim Murtezanit dhe Nevzat Murtezanit, ra një predhë mortaje.[1468] Kjo mund të shpjegojë gjurmët e shkaktuara nga armë zjarri në muret e oborrit. Dhoma Gjyqësore konkludon se më 12 gusht 2001, shtëpia e Nazim Murtezanit u dëmtua kur iu vu zjarri nga policia.

372. Në raporti për ngjarjet në Luboten përgatitur nga Human Rights Watch, lexohet se më 12 gusht 2001, shtëpia e Abdullah Lutfiut u dogj nga policia.[1469] IMG-ja thekson në raportin e saj se dëmi shkaktuar kësaj shtëpie ishte në nivelin 57%.[1470] Dëmi në çati, dritare dhe dyer u vlerësua se ishte në kategorinë e barasvlershme me nivelin më të lartë individual të dëmit për këto pjesë shtëpie, ndërsa dëmi shkaktuar në ambientet e brendshme u vlerësua në kategorinë individuale të dëmit të dytë më të rëndë.[1471] Raportet e Human Rights Watch dhe IMG-së bëjnë vlerësime të njëjta të dëmit të shkaktuar shtëpisë së Abdullah Lutfiut. Dhoma Gjyqësore konkludon se ky dëm u shkaktua kur shtëpisë iu vu zjarri nga policia, e cila përparoi përmes fshatit Luboten më 12 gusht 2001.

373. Shtëpia e Harun Rexhepit (Redžepi) u dogj nga policia më 12 gusht 2001.[1472] IMG-ja vlerësoi se dëmi shkaktuar shtëpisë ishte në nivelin 58%. Dëmi shkaktuar çatisë, dritareve, dhe dyerve u vlerësua se ishte në kategorinë e barasvlershme me nivelin më të lartë individual të dëmit për këto pjesë të shtëpisë, ndërsa dëmi në ambientet e brendshme u vlerësua se ishte në kategorinë individuale të dëmit të dytë më të rëndë.[1473]

374. Shtëpia e Ismet Rexhepovskit (Rexhepi, Redžepi) u dogj nga policia më 12 gusht 2001.[1474] IMG-ja vlerësoi se dëmi shkaktuar shtëpisë së Ismet Rexhepovskit (Rexhepi, Redžepi) ishte në nivelin 57%. Dëmtimi shkaktuar çatisë, dritareve, dhe dyerve u vlerësua se ishte në kategorinë e barasvlershme me nivelin më të lartë individual të dëmit për këto pjesë shtëpie, ndërsa dëmi shkaktuar në ambientet e brendshme u vlerësua se ishte në kategorinë individuale të dëmit të dytë më të rëndë.[1475]

[1468] Prova Materiale P197, para. 14.
[1469] Prova Materiale P352, ERN U000-0105.
[1470] Prova Materiale P410.
[1471] Provat Materiale P410; P409; P412.19.
[1472] *Shih* më lart, para. 49.
[1473] Provat Materiale P410; P409; P412.20.
[1474] *Shih* më lart, para. 49.
[1475] Provat Materiale P410; P409; P412.21.

375. Në konkluzionet e paraqitura më sipër për shtëpitë e Abdullah Lutfiut, Harun Rexhepit (Redžepi), Ismet Rexhepovskit (Rexhepi, Redžepi) dhe Nazim Murtezanit, Dhoma Gjyqësore ka shqyrtuar gjithashtu dëshmitë e trajtuara më hollësisht gjetkë në këtë Aktgjykim, sipas së cilave pjesëtarë të ushtrisë së vendosur në pozicione mbi fshat vunë re të shtëna në drejtimin e tyre që vinin nga zona pranë xhamisë, një zonë e cila e përshkruar në mënyrë të përgjithshme, mund të përfshijë edhe vendin ku gjenden këto katër shtëpi. Mirëpo nuk ka dëshmi për të shtëna nga asnjë prej këtyre katër shtëpive kundër policëve ndërkohë që ata kalonin përmes fshatit mëngjesin e 12 gushtit 2001. Dëshmitë, veçanërisht përsa i përket dëmtimeve dhe në mbështetje të përfundimit të Dhomës Gjyqësore se atyre iu vu zjarri nga policia, gjë që u krye veças dhe nga policët që ishin afër shëpive, nuk ofrojnë bazë mbi të cilën mund të konkludohet se ndonjë nga shtëpitë po përdorej në atë kohë për qëllime ushtarake, apo se shkatërrimi i ndonjërës prej tyre do t'i ofronte epërsi ushtarake policisë që u vuri zjarrin. Po kështu, dëshmitë nuk lenë të hapur mundësinë që dëmtimi i ndonjërës prej këtyre shtëpive të jetë shkaktuar nga ushtria. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se zjarrvënia në secilën prej këtyre katër shtëpive nga policia më 12 gusht 2001, shkaktoi dëmtim të tyre, të papërligjur prej domosdoshmërisë ushtarake.

376. IMG-ja vlerësoi se shtëpia e Qani Jasharit pësoi dëme në nivelin 60%. Dëmi i çatisë, dritareve, dhe dyerve u vlerësua se ishte në kategorinë e barasvlershme me nivelin më të lartë individual të dëmit për këto pjesë të shtëpisë, ndërsa dëmi në ambientet e brendshme u vlerësua se ishte në kategorinë individuale të dëmit të dytë më të rëndë.[1476]

377. Siç u konkludua më herët, policia hapi zjarr kundër shtëpisë së Qani Jasharit me automatikë dhe një mitraloz. Menjëherë pas kësaj, policia i vuri zjarrin shtëpisë.[1477] Ka gjithashtu dëshmi që tregojnë se njësia ushtarake e kapitenit Grozdanovski hapi zjarr kundër shtëpisë së Qani Jasharit dhe rreth saj, me predha mortaje, një pushkë snajper, dhe një mitraloz.[1478] Dhoma Gjyqësore pranon se ushtria hapi zjarr kundër personave që po vraponin nga shtëpia përmes fushës në drejtimin e pemëve, fakt që po të merret parasysh veçazi, lë të hapur mundësinë që të paktën disa dëme në shtëpi, siç tregojnë shenjat e

[1476] Provat Materiale P410; P409; P412.46.
[1477] *Shih* më lart, para. 68.
[1478] *Shih* më lart, para. 155.

plumbave, mund të jenë shkaktuar nga ushtria. Në shtëpi nuk rezulton asnjë dëmtim i shkaktuar nga granatimet.[1479] Siç është diskutuar gjetkë, mbi bazën e dëshmive, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se shtëpisë iu vu zjarri nga policia atë mëngjes pasi burrat ishin larguar me vrap prej shtëpisë për në fushë. Dëshmitë tregojnë gjithashtu se policia hapi zjarr të dendur drejt shtëpisë.[1480]

378. Mbi bazën e dëshmive mbetet të paktën e hapur mundësia që shtëpia e Qani Jasharit të jetë përdorur për një farë kohe gjatë mëngjesit të 12 gushtit nga tre apo pesë persona për të hapur zjarr drejt pozicioneve të ushtrisë në Smok dhe Bomba si dhe për të qëlluar kundër policëve që po kalonin përmes fshatit. Një mundësi e tillë ekziston, ndonëse nga këto të shtëna nuk u plagos asnjë pjesëtar i policisë apo i ushtrisë. Po të ketë patur të shtëna të tilla, atëhere do të përligjej ushtarakisht hapja zjarr prej policisë dhe ushtrisë drejt shtëpisë. Shtëpia mund të konsiderohet si objekt që ka dhënë "kontribut të efektshëm në veprimin ushtarak"[1481] dhe sulmi kundër shtëpisë mund të ofrojë "epërsi të qartë ushtarake".[1482] Mirëpo siç konkludoi Dhoma Gjyqësore, policia qëllimisht u vuri zjarrin shtëpive të zbrazëta më vonë, vetëm pasi të pesë burrat ishin larguar me vrap nga pjesa e pasme e shtëpisë, duke e lënë të zbrazët. Nuk ka dëshmi që tregojnë se policia besonte se luftëtarët e armatosur ishin ende në shtëpi, apo mund të kishin qenë në shtëpi kur asaj iu vu zjarri. Edhe sikur të ketë ndodhur kështu, duke marrë parasysh largimin e vëzhguar të personave nga shtëpia, mungesën e të shtënave nga shtëpia, numrin e madh të policëve të armatosur mirë, si dhe aftësinë e demonstruar të policisë për t'iu afruar shtëpisë për t'i vënë zjarrin, nuk rezulton se policia veproi mbi bazën e ndonjë domosdoshmërie apo arsyeje ushtarake kur i vuri zjarrin shtëpisë. Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore konkludon se, duke i vënë zjarrin shtëpisë, policia donte t'a shkatërronte atë, duke menduar, pa dyshim, se kjo shtëpi ishte shfrytëzuar nga persona, që besohej se ishin anëtarë të UÇK-së, gjatë aksionit kundër policisë. Në këto rrethana zjarrvënia në shtëpi prej policisë, nuk përligjej prej domosdoshmërisë ushtarake.

[1479] *Shih* më lart, para. 155-156.
[1480] *Shih* më lart, para. 67-68.
[1481] *Shih* më lart, para. 354.
[1482] *Shih* më lart, para. 354.

379. IMG-ja vlerëroi se shtëpitë e dy anëtarëve të tjerë të familjes Jashari, Afet Jashari dhe Ramush Jashari, të cilat ishin në rreshtin e katër shtëpive të familjes Jashari, të vendosura pranë shtëpisë së Qani Jasharit, por në anën tjetër të rrugës, kishin pësuar një dëm në nivelin 30%.[1483] Ka prova se njësia ushtarake e kapitenit Grozdanovski hapi zjarr me një mitraloz dhe një pushkë snajper[1484] drejt shtëpive në këtë rresht, pak kohë përpara se ajo të qëllonte kundër personave që po largoheshin me vrap nga shtëpia e Qani Jasharit. Ka gjithashtu dëshmi se drejt këtyre shtëpive u qëllua me top edhe nga një pozicion tjetër i ushtrisë, ndonëse Dhoma Gjyqësore nuk e pranon këtë. Sipas dëshmive, ky ishte zjarr i hapur si përgjigje ndaj të shtënave që ishin parë nga shtëpitë në këtë rresht apo rreth tyre.[1485] Megjithëse nuk është në gjendje të arrijë një konkluzion të tillë për arsyet e dhëna gjetkë, Dhoma Gjyqësore pranon se një gjë e tillë mund të ketë ndodhur. Nëse është pikërisht kështu, atëhere të shtënat e ushtrisë mund të kenë shkaktuar disa nga dëmet në shtëpitë në këtë rresht, duke përfshirë shtëpitë e Afet Jasharit dhe Ramush Jasharit. Mirëpo sipas dëshmive, të shtënat që u panë nga ky rresht shtëpish u ndërprenë dhe personat që ishin në këtë shtëpi, kapërcyen rrugën duke shkuar në shtëpinë e Qani Jasharit, prej së cilës më pas rifilluan të shtënat. Mandej ndodhën ngjarjet e përshkruara më sipër lidhur me shtëpinë e Qani Jasharit dhe personat që u larguan prej saj duke vrapuar përmes fushës. Më pas nuk u panë më të shtëna nga rreshti i shtëpive. Nuk ka dëshmi për të shtëna nga shtëpia e Afet Jasharit, apo Ramush Jasharit, apo nga ndonjë prej shtëpive në rresht, në kohën kur në këtë vend mbërriti policia apo më vonë. Pas ardhjes së policisë në këtë vend, Dhoma Gjyqësore konkludon mbi bazën e dëshmive se policët u vunë zjarrin shtëpive të Afet Jashari dhe Ramush Jasharit, si dhe hapën zjarr drejt tyre me predha Zolja.[1486] Nuk ka prova që në atë kohë në të dy shtëpitë të ketë qenë njerí. Ndonëse dëshmitë e ushtrisë, po të jenë të sakta, sugjerojnë se nga të dy shtëpitë mund të ketë patur më herët të shtëna, nuk ka dëshmi se policia kishte arsye të mendonte se në ndonjë prej shtëpive ishin apo mund të ishin ende luftëtarë të armatosur në momentin kur atyre iu vu zjarri qëllimisht. Nuk rezulton se policia veproi mbi bazën e domosdoshmërisë apo arsyes ushtarake kur u vuri zjarrin të dy shtëpive. Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore konkludon se po ashtu si në rastin e shtëpisë së Qani Jasharit, policia u

[1483] Provat Materiale P410; P412.48; P412.47.
[1484] Nikollçe Grozdanovski, T 10429; 2D90.
[1485] *Shih* më lart, para. 155.
[1486] Prova Materiale P238, f. 2.

vuri zjarrin të dy shtëpive me qëllim që t'i shkatërronte. Në këto rrethana, zjarrvënia në secilën prej dy shtëpive prej policisë, nuk përligjej prej domosdoshmërisë ushtarake.

3. Konkluzion

380. Dhoma Gjyqësore konkludon se më 12 gusht 2001, shtëpitë e Alim Durakit, Agim Jusufit, Qenan Jusufit, Sabit Jusufit, Xhevdet Jusufovskit, Abdullah Lutfiut, Harun Redžepit (Rexhepi), Ismet Rexhepit (Rexhepovski), Nazim Murtezanit, Qani Jasharit, Afet Jasharit dhe Ramush Jasharit, u dëmtuan nga zjarri i vënë prej policisë gjatë kalimit të saj përmes fshatit Luboten. Dhoma Gjyqësore konkludon më tej se të paktën shtëpive të Sabit Jusufit, Qenan Jusufit, Agim Jusufit, Ismet Rexhepovskit (Redžepi, Rexhepi), Harun Rexhepit (Redžepi), Qani Jasharit, Afet Jasharit, dhe Ramush Jasharit iu vu zjarri me benzinë apo lëndë tjetër djegëse. Disa nga këto shtëpi pësuan dëme edhe nga të shtënat e policisë me armë zjarri. Përsa u përket shtëpive të Qani Jasharit, Afet Jasharit dhe Ramush Jasharit, disa nga dëmtimet mund të jenë shkaktuar edhe nga të shtënat e ushtrisë me armë zjarri, por jo prej predhave të mortajave apo topave. Sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, duke patur parasysh madhësinë e fshatit Luboten, numri i shtëpive të dëmtuara me të drejtë mund të gjykohet i konsiderueshëm, i mjaftueshëm për t'u cilësuar dëmtim në "masë të madhe" në kuptimin përkatës. Në asnjë nga këto raste dëmi nuk përligjej prej domosdoshmërisë ushtarake, me përjashtim, ndoshta të disa dëmtimeve shkaktuar shtëpive të familjes Jashari me armë zjarri. Dhoma Gjyqësore konkludon se rrethanat e treguara nga dëshmitë vërtetojnë se në secilin rast policia veproi me synimin për shkatërrimin e objekteve të cilave policia u vuri zjarrin. Së këtejmi rrjedh se është vërtetuar krimi i shkatërrimit pa shkak, akuzuar në Pikën 2.

C. Trajtim mizor (Pika 3)

381. Në Aktakuzë pretendohet se nga 12 deri më 15 gusht 2001, gjatë hyrjes në Luboten të një njësie policore dhe më pas, më shumë se 100 shqiptarë etnikë, banorë të fshatit, u arrestuan dhe atyre iu shkaktuan qëllimisht dhimbje apo vuajtje të mëdha nëpërmjet rrahjeve, poshtërimit, keqtrajtimit dhe keqtrajtimit psikologjik në Luboten, në dy postblloqe policore në afërsi të fshatit dhe në pesë stacione policore në komunën e Çairit dhe në Shkup, si dhe në gjykatën dhe spitalin e Shkupit. Lista B, bashkëngjitur

Aktakuzës, jep hollësi për viktimat, datat, vendndodhjet, si dhe përshkrimin e akteve të trajtimit mizor, që pretendohet se u kryen ndaj tyre. Këto akuza shërbejnë si bazë për një pikë të trajtimit mizor për të cilën akuzohet i Akuzuari Lube Boshkoski. Akuzat për trajtim mizor kundër të Akuzuarit Johan Tarçulovski përqëndrohen në akte të keqtrajtimit që pretendohet se ndodhën në shtëpinë e Adem Ametovskit dhe në shtëpinë e Bracës.[1487]

1. Ligji

382. Trajtimi mizor, në bazë të Nenit 3 të Statutit, përkufizohet si veprim apo mosveprim i qëllimshëm që i shkakton vuajtje apo lëndim të rëndë mendor apo fizik, apo që përbën sulm të rëndë kundër dinjitetit të një personi që nuk merr pjesë aktive në luftime. Autori duhet të ketë vepruar me synim të drejtpërdrejtë për të kryer trajtim mizor, apo me synim jo të drejtpërdrejtë, d.m.th. i vetëdijshëm se trajtimi mizor do të ishte pasojë e mundshme e veprimit apo mosveprimit të tij.[1488]

2. Përfundime

383. Dhoma Gjyqësore ka konkluduar tashmë se më 12 gusht 2001. rezervistë të policisë hynë në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit në Luboten ku ishin strehuar 10 burra shqiptarë etnikë, banorë të Lubotenit, pasi që nga 10 gushti kishte patur granatime. Këta burra u rrahën përpara shtëpisë së Adem Ametovskit. Dhoma Gjyqësore ka konkluduar gjithashtu se edhe tre burra të tjerë shqiptarë etnikë, banorë të Lubotenit, të cilit ishin strehuar në shtëpinë fqinje të Zija Ametit, u detyruan të bashkohen me këtë grup burrash dhe u rrahën. Grupi i burrave përpara shtëpisë së Adem Ametovskit u rrahën, lënduan, apo kërcënuan me thika dhe armë, si dhe u shkelmuan nga policët.[1489] Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto akte ishin mjaftueshmërisht të rënda për t'u konsideruar trajtim mizor. Në kohën kur ndodhën këto incidente, policët ishin të armatosur dhe shumë më tepër në numër se grupi i banorëve shqiptarë, të cilët ishin të paarmatosur. Banorët u rrahën vazhdimisht ndërkohë që u detyruan të shtriheshin barkas me sytë dhe fytyrat të mbuluara. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore është e bindur se

[1487] Aktakuza, para. 42.
[1488] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 424; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 595; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 261; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 231; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 516.
[1489] *Shih* më lart, para. 50; 52-54.

autorët e këtyre akteve kishin *mens rea*-n e nevojshme. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se në atë kohë viktimat ishin në duart e policisë, ishin të paarmatosur, dhe rrjedhimisht nuk merrnin pjesë në luftime.

384. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë individuale penale të të dy të Akuzuarve, Dhoma Gjyqësore është e bindur se pretendimet për trajtimin mizor përpara shtëpisë së Adem Ametovskit janë vërtetuar lidhur me viktimat e mëposhtme, emrat e të cilëve janë në Listën B të Aktakuzës: M012,[1490] Hamdi Ametovski,[1491] Adem Ametovski,[1492] Aziz Bajrami,[1493] M017,[1494] Nevaip Bajrami,[1495] Vehbi Bajrami,[1496] Atulla Qaili,[1497] Beqir Ramadani,[1498] Ismail Ramadani,[1499] Muharem Ramadani,[1500] Osman Ramadani,[1501] dhe Sulejman Bajrami.[1502]

385. Dhoma Gjyqësore ka bërë gjithashtu të ditura përfundimet e veta të mëtejshme në këtë Aktgjykim sipas së cilave shumica e burrave nga ky grup u morën, këmbëzbathur,

---

[1490] M012, T 888-889; M017, T 622-625; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 26, 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 12, 17; Prova Materiale P108; Ismail Ramadani, T 1038; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P 247.1, f. 3.

[1491] M012, T 946-947; M017, T 622-625; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 26, 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Ismail Ramadani, T 1038; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1492] M012, T 888-889, 946-947; Prova Materiale P17; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 12, 17; Ismail Ramadani, T 1038; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1493] M012, T 889-889; 949; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17, 22, 23; Ismail Ramadani, T 1038; 1022-1023; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 32.

[1494] M012, T 889-889; 946-947; Prova Materiale P17; M017, 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Ismail Ramadani, T 1038; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 26, 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1495] M012, T 888-889; 946-947; Prova Materiale P17; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Ismail Ramadani, T 1038; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 26, 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1496] M012, T 888-889; 946-947; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Ismail Ramadani, T 1038; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 26, 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1497] M012, T 888-889; 947; Prova Materiale P17; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Ismail Ramadani, T 1038; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 26, 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1498] M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 32.

[1499] M012, T 888-889; 894; Prova Materiale P17; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17, 19; Ismail Ramadani, T 1038; Provat Materiale P194; P195; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1500] M012, T 888-889; Prova Materiale P17; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Ismail Ramadani, T 1038; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1501] M012, T 888-889; 946-947; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17; Ismail Ramadani, T 1038; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 31-32; Osman Ramadani, T 1870; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3.

[1502] M012, T 888-889; M017, T 622-625; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 17, 22; Ismail Ramadani, T 1022; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 32, 33.

dhe nën shoqërimin e policëve të armatosur, me sy dhe fytyra ende të mbuluara, dhe u çuan në një vend anës rrugës jashtë shtëpisë së Bracës në hyrje të fshatit, ku u rrahën sërish prej policëve që i kishin shoqëruar nga shtëpia e Adem Ametovskit. Rrahjet ishin kaq të egra sa disa nga burrat humbën vetëdijen. Kur një prej tyre erdhi në vete, ai pa se ishte pa pantallona apo mbathje.[1503] Dhoma Gjyqësore konkludon se këto akte janë kaq të rënda sa përbëjnë trajtim mizor, dhe është e qartë se u kryen me *mens rea*-n e nevojshme dhe në rrethana në të cilat viktimat nuk po merrnin pjesë aktive në luftime.

386. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale individuale të të dy të Akuzuarve, është përcaktuar se M012,[1504] Hamdi Ametovski,[1505] Adem Ametovski,[1506] M017,[1507] Nevaip Bajrami,[1508] Vehbi Bajrami,[1509] Atulla Qaili,[1510] Beqir Ramadani,[1511] Ismail Ramadani,[1512] dhe Osman Ramadani[1513] pësuan trajtim të mëtejshëm mizor në shtëpinë e Bracës.

387. Dhoma Gjyqësore konkludon se dëshmitë përcaktojnë gjithashtu se, nga shtëpia e Bracës këta banorë u çuan në stationin policor të Mirkocit ku u mbajtën edhe dy ditë të tjera dhe pësuan akte të tjera të trajtimit mizor, duke përshirë rrahje nga policë të stacionit policor të Mirkocit me kondakë pushke dhe shkopinj. Ata u kërcënuan me thika dhe armë dhe u goditën nga policët me grushte dhe armë.[1514] Dhoma Gjyqësore është bindur se autorët e akteve të trajtimit mizor në stacionin policor të Mirkocit vepruan me *mens rea* të nevojshme. Është e qartë se viktimat nuk po merrnin pjesë aktive në luftime. Duke lënë

1503 *Shih* më lart, para. 74.

1504 M012, T 897-898; M017, T 630; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1872.

1505 M012, T 897; M017, T 630; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36, 38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1872; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34.

1506 M012, T 897; M017, T 630; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36-38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, p 3; Vehbi Bajrami, T 1872.

1507 M012, T 897; M017, T 630; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36-38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1872.

1508 M012, T 897; M017, T 630; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36 -38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1872.

1509 M012, T 897; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36 -38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1872; M017, T 630.

1510 M012, T 897; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36 -38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1872; M017, T 630.

1511 M012,T 897; M017, T 630; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36-38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, p 3; Vehbi Bajrami, T 1872.

1512 M012, T 897; M017, T 630; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 36-38; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3; Vehbi Bajrami, T 1872.

1513 M012, T 897; M017, T 630; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32-34; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 37-39; Vehbi Bajrami, T 1872.

1514 *Shih* më lart, paras 77-78.

mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale individuale të të Akuzuarve, Dhoma Gjyqësore konkludon se pretendimi për trajtim mizor në stacionin policor të Mirkocit është vërtetuar për individët e mëposhtëm: M012,[1515] Hamdi Ametovski,[1516] Adem Ametovski,[1517] M017,[1518] Atulla Qaili,[1519] Nevaip Bajrami,[1520] Vehbi Bajrami,[1521] Beqir Ramadani,[1522] Ismail Ramadani,[1523] dhe Osman Ramadani.[1524]

388. Siç u diskutuar dhe më sipër, disa banorë të Lubotenit që u përpoqën të largoheshin nga fshati më 12 gusht 2001, u ndaluan në postbllokun e Buzalakut ku burrat, të cilët ishin veçuar nga gratë dhe fëmijët, u rrahën nga policët që shërbenin në atë postbllok. Prej këtij vendi këta burra u transportuan për në stacionin policor të Butelit, stacionin policor të Karposhit, stacionin policor të Bit Pazarit, apo në stacionin policor të Proleqes dhe u mbajtën atje. Në secilin prej këtyre stacioneve policore, banorët u keqtrajtuan vazhdimisht nga policia. Në çdo stacion policët ishin të armatosur, banorët ishin të paarmatosur, dhe u mbajtën e u rrahën vazhdimisht nga policët në këto stacione. Duke marrë parasysh këta faktorë, Dhoma Gjyqësore është bindur se këto akte u kryen me *mens rea* të nevojshme, dhe se viktimat nuk po merrnin pjesë aktive në luftime. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale individuale të të dy të Akuzuarve, Dhoma Gjyqësore është bindur se akuza për trajtim mizor është vërtetuar të paktën për individët e mëposhtëm, emrat e të cilëve janë të përfshirë në Listën B të Aktakuzës: në postbllokun e Buzalakut, Hazbi Ajrullai,[1525] Sherafedin Ajrullai,[1526]

[1515] M012, T 900-901; M017, T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1516] M012, T 901-902; M017, T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1517] M012, T 901-902; M017, T 636-638.
[1518] M012, T 900; M017, T 636-638; 714-715; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1519] M012, T 905-906; 954; M017, T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 35, 43; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1520] M012, T 900; M017, T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1521] M012, T 900; M017; T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1522] M012, T 900; M017, T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1523] M012, T 900; M017, T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1524] M012, T 900; M017, T 636-638; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 37-38; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 45-46; Vehbi Bajrami, Prova Materiale P247.1, f. 3-4.
[1525] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 8; Sherafedin Ajrullai,T 4028-4029.
[1526] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 8.

Murtezan Murtezani,[1527] Ramiz Xhavidi,[1528] Bejtulla Zendeli,[1529] Suat Zendeli,[1530] dhe Sulejman Zendeli;[1531] në stacionin policor të Butelit, Sherafedin Ajrullai;[1532] në stacionin policor të Proleqes, Isni Aliu,[1533] Vehap Aliu,[1534] Burhan Murtezani,[1535] Murtezan Murtezani, [1536] Aziz Rexhepi,[1537] Rametulla Zendeli,[1538] dhe Sulejman Zendeli;[1539] në stacionin policor të Bit Pazarit, Isni Aliu,[1540] Aziz Rexhepi,[1541] Latif Saliu,[1542] Rametulla Zendeli,[1543] dhe Sulejman Zendeli;[1544] dhe në stacionin policor të Karposhit Sherafedin Ajrullai[1545] dhe Arben Murseli.[1546]

389. Siç është theksuar gjetkë në këtë Aktgjykim, dëshmitë vërtetojnë gjithashtu se që nga stacionet policore të lartpërmendura shumë banorë të Lubotenit u çuan në Gjykatën II të Shkupit, e cila ishtë nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, jo të Lube Boshkoskit. Policët e gjykatës janë pjesë e personelit të Ministrisë së Drejtësisë.[1547] Ekzistojnë dëshmi që mund të vërtetojnë se të paktën banorët e mëposhtëm, emrat e të cilëve renditen në Listën B të Aktakuzës, mund të kenë pësuar akte të mëtejshme të dhunës: Isni Aliu,[1548] M012,[1549] Hamdi Ahmetovski,[1550] Vehbi Bajrami,[1551] Beqir Ramadani[1552] dhe Osman Ramadani.[1553] Akuzat për trajtim mizor në Gjykatën II të Shkupit janë paraqitur vetën kundër të Akuzuarit Lube Boshoskit, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit. Nuk është vërtetuar

[1527] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 8; Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 8-9; Sherafedin Ajrullai, T 4029; Aziz Rexhepi, T 4674.
[1528] Aziz Rexhepi, Prova Materiale P432, para. 17; Aziz Rexhepi,T 4674.
[1529] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 8.
[1530] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 8.
[1531] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 8.
[1532] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 11, 13, 15.
[1533] Aziz Rexhepi, Prova Materiale P432, para. 19-22; 24-27; *shih* gjithashtu Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 9-11.
[1534] Aziz Rexhepi, Prova Materiale P432, para. 29; *shih* gjithashtu Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 9-11.
[1535] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 9-11.
[1536] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 9-10; Isni Ali, T 2007-2010; 3463-3464.
[1537] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 10.
[1538] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 10.
[1539] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 10.
[1540] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 11-13.
[1541] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 11-13.
[1542] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 11-13.
[1543] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 11-13.
[1544] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 11-13.
[1545] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403 para. 15; Sherafedin Ajrullai, T 4034-4036.
[1546] Sherafedin Ajrullai, Prova Materiale P403, para. 15-18.
[1547] Risto Galevski, T 3786; Prova Materiale P92, Neni 17. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 517.
[1548] Isni Ali, Prova Materiale P263, para. 13; Isni Ali, T 2012-2013, 3476, 3496-3497.
[1549] M012, T 917, T 909.
[1550] M012, T 908-909.
[1551] M012, T 908-909.
[1552] M012, T 908-909.
[1553] M012, T 908-909.

që Lube Boshkoski ushtronte kontroll efektiv ndaj personave që kryen këto akte apo që vartësit e Lube Boshkoskit të kenë ndihmuar dhe inkurajuar apo lehtësuar, në ndonjë mënyrë, kryerjen e këtyre akteve. Rrjedhimisht hidhen poshtë pretendimet për trajtimin mizor në Gjykatën II të Shkupit.

390. Siç është diskutuar më hollësisht gjetkë, katër banorë u transportuan nga stacioni policor i Mirkocit për në Spitalin e Qytetit të Shkupit,[1554] i cili është nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, jo të të Akuzuarit Lube Boshkoski. Siguria në spitale nuk ishte kompetencë e Ministrisë së Brendshme.[1555] Ndonëse ka dëshmi që vërtetojnë se M017,[1556] Nevaip Bajrami,[1557] dhe Ismail Ramadani[1558] mund të jenë keqtrajtuar, këto dëshmi janë shumë të kufizuara dhe nuk identifikojnë personat që kryen këto akte.[1559] Nuk është vërtetuar se Lube Boshkoski ushtronte kontroll efektiv ndaj personave që kryen këto akte apo që vartësit e Lube Boshkoskit të kenë ndihmuar dhe inkurajuar apo lehtësuar, në ndonjë mënyrë, kryerjen e këtyre akteve. Rrjedhmisht hidhen poshtë akuzat për trajtim mizor në Spitalin e Qytetit të Shkupit.

3. Konkluzion

391. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë individuale penale të të Akuzuarve, Dhoma Gjyqësore është bindur se akuzat për trajtim mizor në shtëpinë e Adem Ametovskit, shtëpinë e Bracës, stacionin policor të Mirkocit, postbllokun e Buzalakut, stacionin policor të Butelit, stacionin policor të Proleqes, stacionin policor të Bit Pazarit, dhe stacionin policor të Karposhit, janë vërtetuar lidhur me individët e lartpërmendur.

1554 *Shih* më lart, para. 79.
1555 Risto Galevski, T 3786. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 517.
1556 M017, T 637-640; Ismail Ramadani, T 1026; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 48-49.
1557 M017, T 638-640, Ismail Ramadani, T 1026-1027; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 48-49.
1558 M017, T 638-640, Ismail Ramadani, T 1026-1027; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 48-49.
1559 *Shih* më lart, para. 79. Dy dëshimtarë dhanë dëshmi lidhur me këtë. M017 dëshmoi se ai u keqtrajtua nga një mjek dhe policë, T 639, ndërsa një dëshmitar tjetër tha se personat që e keqtrajtuan atë ishin rezervistë që nuk i njihte, Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 49. Baza për këto identifikime është e paqartë.

VII. PËRGJEGJËSIA

A. Ligji

1. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(1)

392. Neni 7(1) i Statutit parashikon:

> Një person që ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer apo, në ndonjë mënyrë tjetër, ndihmoi dhe inkuraoi planifikimin, përgatitjen, ose kryerjen e një krimi të përmendur në Nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti, është individualisht përgjegjës për krimin.

Çështja kundër të Akuzuarit Johan Tarçulovski në Aktakuzë, është e kufizuar në Nenin 7(1).

393. Dhoma e Apelit ka theksuar se Neni 7(1) "ka të bëjë para së gjithash, me kryerjen fizike të një krimi nga vetë autori i krimit, ose moskryerjen e fajshme të një veprimi të detyrueshëm në bazë të dispozitave të së drejtës penale."[1560] Mirëpo përgjegjësia penale nuk bie vetëm mbi personin fizik që ka kryer një krim konkret, por në rrethana të caktuara, ajo shtrihet edhe tek ata që kanë ndihmuar apo kanë kontribuar në mënyra të ndryshme në kryerjen e krimit.[1561]

(a) Kryerja e krimit përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale

394. Aktakuza pretendon se i Akuzuari Johan Tarçulovski ka përgjegjësi individuale penale për krimet e akuzuara, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale ("NPK").

395. Jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar tri kategori të NPK-së. *Actus reus/Veprimi i fajshëm* i një pjesëmarrësi në një NPK është i përbashkët për të tri kategoritë. Së pari, kërkohet ekzistenca e një bashkësie personash.[1562] Nuk kërkohet që ata të jenë të organizuar në një strukturë ushtarake, politike ose administrative.[1563] Së dyti, duhet të vërtetohet ekzistenca e një plani, projekti apo synimi të përbashkët, i cili

[1560] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 188.
[1561] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 373; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 192.
[1562] Aktgjykimi i Apelit *Vasiljeviq*, para. 100.
[1563] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 64.

përbën apo përfshin kryerje krimi të parashikuar në Statut.[1564] Nuk është e nevojshme që plani, projekti, apo synimi të jenë përgatitur apo formuluar që më parë. Gjithashtu përgjegjësia për NPK-në nuk kërkon që të ketë ndonjë mirëkuptim apo marrëveshje për kryerjen e krimit konkret, midis të akuzuarit dhe autorit kryesor të krimit. Plani apo qëllimi i përbashkët mund të materializohet spontanisht dhe konkluzioni për ekzistencën e tij mund të nxirret nga bashkëveprimi i një grupi personash për të vënë në zbatim NPK-në.[1565] Së treti, i akuzuari duhet të ketë marrë pjesë në planin e përbashkët,[1566] duke marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e vet krimit, ose duke ndihmuar apo kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët.[1567] Kontributi i të akuzuarit nuk është i domosdoshëm, në kuptimin e *sine qua non*, për arritjen e synimit të përbashkët kriminal;[1568] në fakt, nga pikëpamja ligjore, nuk është as e nevojshme që kontributi i të akuzuarit në qëllimin e përbashkët të jetë thelbësor.[1569] Gjithsesi, duhet që i akuzuari të ketë dhënë, të paktën, një kontribut të konsiderueshëm në planin e përbashkët.[1570] Nga ana tjetër, duhet theksuar se jo çdo lloj veprimi që përbën kontribut të rëndësishëm në qëllimin e përbashkët, shkakton përgjegjësi penale të të akuzuarit për krimet e kryera.[1571] Nuk kërkohet prania e pjesëmarrësit në NPK-së në kohën e kryerjes së krimit.[1572]

396. Përsa i përket *mens rea/gjendjes mendore kriminale,* kërkesat e tri kategorive të NPK-së ndryshojnë. Në kategorinë e pare themelore të NPK-së i akuzuari synon të kryejë një krim dhe këtë synim kanë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në këtë krim.[1573] Në formën e dytë, për të cilën nuk ka akuzë në këtë çështje dhe e cila ka të bëjë me të ashtuquajtura çështje "të kampeve të përqëndrimit", apo NPK sistemore, i akuzuari ka dijeni për sistemin e shtypjes ku ai merr pjesë, si dhe ka synimin për t'a çuar më tej planin e përbashkët dhe të koordinuar për keqtrajtimin e të burgosurve në një kamp përqëndrimi.[1574] Kategoria e tretë shfaqet në çështje në të cilat një nga pjesëmarrësit

[1564] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; Aktgjykimi i Apelit *Vasiljeviq* para. 100.
[1565] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227*;* Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 97, Aktgjykimi i Apelit *Vasiljeviq*, para. 100, 109; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 415, 418.
[1566] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 196; 202-203; 227-228.
[1567] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227.
[1568] Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 98.
[1569] Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 97.
[1570] Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.
[1571] Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.
[1572] Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81.
[1573] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220, 228.
[1574] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 202-203; 227-228.

kryen një krim jashtë planit të përbashkët. *Mens rea* në raste të tilla është e dyfishtë. Së pari, i akuzuari duhet të ketë patur synimin për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në qëllimin e përbashkët kriminal. Së dyti, për të patur përgjegjësi për krimet që nuk ishin pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal, por që ishin gjithsesi pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e këtij qëllimi, i akuzuari duhet të ketë gjithashtu dijeni për kryerjen e mundshme të këtij krimi nga një anëtar i grupit dhe si dhe të bashkohet vullnetarisht me ndërmarrjen apo të vazhdojë të marrë pjesë në të.[1575] Vlerësimi nëse krimet e kryera jashtë qëllimit të përbashkët të NPK-së ishin "pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e këtij qëllimi" duhet të bëhet në lidhje me dijeninë e të akuzuarit, d.m.th. Prokuroria duhet të provojë se i akuzuari ka patur dijeni të mjaftueshme se krimet shtesë ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme.[1576]

397. Nuk është e nevojshme që autorët që kryen *actus reus* të krimeve të parashtruara në Aktakuzë, të jenë anëtarë të NPK-së. E rëndësishme në raste të tilla, është nëse krimi në fjalë është ose nuk është pjesë e qëllimit të përbashkët[1577] dhe nëse të paktën një anëtar i NPK-së ka përdorur autorin e krimit në përputhje me planin e përbashkët.[1578] Në këtë kontekst, kur një anëtar i NPK-së përdor një person jashtë NPK-së për kryerjen e *veprimit të fajshëm* të një krimi, fakti se ky person ka dijeni për ekzistencën e NPK-së, d.m.th. për qëllimin e përbashkët, është një faktor që mund të merret parasysh në përcaktimin nëse krimi është pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal.[1579] Kur një autor i drejtpërdrejtë kryen një krim jashtë qëllimit të përbashkët të NPK-së, i cili është pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e NPK-së,[1580] i akuzuari mund të konsiderohet përgjegjës nëqoftëse mori pjesë në qëllimin e përbashkët kriminal me synimin e kërkuar dhe, nëqoftëse, në rrethanat e rastit, (i) parashikohej që një krim i tillë mund të kryhej nga një apo më shumë persona të përdorur prej tij (apo nga cilido anëtar tjetër i NPK-së) për të kryer *actus reus* të krimeve që janë pjesë e qëllimit të përbashkët; dhe (ii) i akuzuari e merr përsipër këtë

[1575] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 204; 227-228; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 83.
[1576] Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 86.
[1577] Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410, 418.
[1578] Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, 430.
[1579] Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410.
[1580] Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, 431.

rrezik me dëshirën e tij – d.m.th i akuzuari, i vetëdijshëm se një krim i tillë ishte pasojë e mundshme e zbatimit të asaj ndërmarrjeje, vendosi të merrte pjesë në atë ndërmarrje.[1581]

(b) Planifikimi

398. *Actus reus* i "planifikimit" kërkon që një apo më shumë persona të planifikojnë apo hartojnë, si në fazën përgatitore ashtu dhe në atë zbatuese, sjelljen kriminale që konsiston në një apo më shumë krime, të parashikuara nga Statuti, të cilat më pas kryhen.[1582] Planifikimi është vetëm një element, i cili kontribuon thelbësisht në sjelljen kriminale.[1583] Për sa i përket *mens rea*, i akuzuari duhet të ketë vepruar me synimin për kryerjen e krimit apo i vetëdijshëm se gjatë zbatimit të planit gjasa e kryerjes së një krimi është shumë e lartë.[1584]

(c) Nxitja

399. Termi "nxitje" është përkufizuar si "të shtysh dikë për kryerjen e një vepre penale."[1585] Nxitje mund të konsiderohen si veprimi po ashtu dhe mosveprimi, të cilat konsistojnë në veprime të dukshme apo të fshehta.[1586] Duhet të provohet lidhja midis nxitjes dhe kryerjes së krimit, gjë që realizohet kur një sjellje konkrete kontribuon në kryerjen e krimit. Nuk është e nevojshme të provohet që krimi nuk do të kishte ndodhur pa nxitjen.[1587] Për sa i përket *mens rea*, duhet të tregohet se i akuzuari synonte të provokonte apo të nxiste kryerjen e krimit, apo se ishte i vetëdijshëm për gjasën e madhe se nxitja mund të shkaktonte krim.[1588]

1581 Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 411.
1582 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 268; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërstiq*, para. 601; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Stakiq*, para. 443; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 26, ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 386.
1583 Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 26; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 513.
1584 Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 31.
1585 Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 601; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Akayesu*, para. 482; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*, para. 280; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 27; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 387; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 514.
1586 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 269; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*, para. 280.
1587 Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 27.
1588 Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 32.

(d) Urdhërimi

400. *Actus reus* i "urdhërimit kërkon që një person në pozitë eprore të udhëzojë dikë të kryejë një vepër penale.[1589] E lidhur ngushtë me "nxitjen", kjo formë përgjegjësie kërkon gjithashtu që i akuzuari të ketë pushtet, *de jure* ose *de facto*, për të urdhëruar kryerjen e një vepre penale.[1590] Ky pushtet mund të nënkuptohet logjikisht prej rrethanave.[1591] Gjithashtu nuk është e nevojshme që urdhri të jetë dhënë me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër, dhe ekzistenca e urdhrit mund të provohet në bazë të provave rrethanore.[1592] Lidhur me *mens rea*, i akuzuari duhet të ketë synuar kryerjen e krimit, ose duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për gjasën e madhe të kryerjes së krimit si rezultat i zbatimit apo vënies në jetë të urdhrit.[1593]

(e) Ndihma dhe inkurajimi

401. "Ndihma dhe inkurajimi" është një formë e përgjegjësisë si bashkëfajtor,[1594] e cila është përkufizuar si akt i dhënies së ndihmës praktike, inkurajimit apo mbështetjes morale, që ka efekt të madh në kryerjen e një krimi konkret.[1595]

402. Lidhur me *actus reus*, nuk është e nevojshme të vërtetohet lidhja shkak-pasojë midis sjelljes së një ndihmësi apo inkurajuesi dhe kryerjes së krimit, apo të provohet se një sjellje e tillë i parapriu kryerjes së krimit.[1596] Gjithsesi duhet të tregohet se ndihma e dhënë nga i akuzuari pati një efekt të madh në kryerjen e krimit,[1597]gjë që kërkon një hetim mbi bazë faktesh.[1598] Një ndihmë e tillë mund të jepet para, gjatë, apo pas kryerjes

---

1589 Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 28 ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 388; Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 361.

1590 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 270; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 550.

1591 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 270; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 515.

1592 Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, para. 76, ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 388; *shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*, para. 281; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 515; lidhur me verifikimin e një urdhri me anë të dëshmive rrethanore, *shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Galiq*, para. 170-171.

1593 Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 42; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 30; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 270.

1594 Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 229.

1595 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërstiq*, para. 601; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 162, ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Furunxhija*, para. 249; Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq dhe Jokiq*, para. 127; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 551.

1596 Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 48, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 517.

1597 Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 48, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Furunxhija*, para. 249, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kunarac*, para. 391, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 517.

1598 Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq*, para. 134.

së krimit kryesor.[1599] Gjithashtu në rrethanat e veçanta të një çështjeje, mosveprimi mund të përbëjë *actus reus* të ndihmës dhe inkurajimit.[1600] Ndonëse është konkluduar se thjesht prania në vendin e një krimi zakonisht nuk do të konsiderohet si ndihmë dhe inkurajim, prania e një eprori, për shembull, mund të shërbejë si nxitje për autorin konkret dhe mund t'i japë legjitimitet krimit.[1601] Një inkurajim i tillë mund të jetë edhe miratimi në heshtje prej një personi me pozitë eprore, i pranishëm fizikisht në vendin e krimit, madje edhe ku ai nuk e kishte detyrim për të vepruar.[1602]

403. *Mens rea* e nevojshme është dijenia se me sjelljen e tij, ndihmësi dhe inkurajuesi po ndihmon apo lehtëson në kryerjen e veprës penale,[1603] dijeni e cila nuk është e nevojshme të jetë bërë e njohur shprehimisht, por që mund të deduktohet prej të gjitha rrethanave përkatëse.[1604] Nuk është e nevojshme që ndihmësi dhe inkurajuesi të ketë *mens rea* të keqbërësit kryesor; gjithsesi ai duhet të jetë i vetëdijshëm për elementët thelbësore të krimit të kryer nga keqbërësi kryesor, ndër të cilat edhe gjendjen e tij psikologjike.[1605] Megjithëse është konkluduar se nuk është e nevojshme të provohet që ndihmësi dhe inkurajuesi ka qenë i vetëdijshëm për krimin konkret, të synuar apo të kryer, me kusht që të ketë qenë i vetëdijshëm për gjasën e kryerjes së një krimi prej një numri krimesh si dhe për kryerjen faktuale të një prej këtyre krimeve[1606], Dhoma e Apelit së fundi konfirmoi se ky konkluzion nuk e zgjeron përkufizimin e *mens rea* të ndihmës dhe inkurajimit.[1607]

[1599] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 48; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërnojelac*, para. 88; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 271; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 517.

[1600] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 47. *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërnojelac*, para. 88; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kunarac*, para. 391; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq* para. 553.

[1601] Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 273, 277. Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 517.

[1602] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haradinaj*, para. 145. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin*, para. 273, 277.

[1603] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Furunxhija*, para. 249; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 229; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 49; Aktgjykimi i Apelit *Vasiljeviq*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 484; Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq*, para. 127.

[1604] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 328; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, para. 676; Aktgjykimi *Limaj*, para. 518.

[1605] Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 162; Aktgjykimi i Apelit *Vasiljeviq*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 229.

[1606] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 50, ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*, para. 287; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Furunxhija*, para. 246; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 272.

[1607] Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq*, para. 222.

2. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(3) të Statutit

404. Neni 7(3) i Statutit përcakton:

> Fakti që cilido prej veprimeve të përmendura në Nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti u krye prej një vartësi, nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale nëqoftëse ai dinte, ose kishte arsye të dinte se vartësi do të kryente veprime të tilla ose i kishte kryer dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose për ndëshkimin e kryesve të tyre.

Parimi i përgjegjësisë penale individuale të eprorëve për mosveprim për parandalimin apo ndëshkimin e krimeve të kryera nga vartësit, është një parim i sanksionuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare,[1608] i cili zbatohet si për konfliktet ndërkombëtare po ashtu dhe ato të brendshme, të armatosura.[1609] Kjo kategori e përgjegjësisë penale zakonisht cilësohet përgjegjësi eprori apo komande. Ajo përfshin të gjitha format e sjelljes kriminale të vartësve, jo vetëm "kryerjen" e krimeve në kuptimin e ngushtë të këtij termi, por edhe mënyra të tjera të pjesëmarrjes në krimet e parashtruara në Nenin 7(1) të Statutit.[1610]

405. Çështja kundër të Akuzuarit Lube Boshkoski, në Aktakuzë, kufizohet në aspektet e Nenit 7(3). Ai akuzohet mbi bazën e pretendimit të mosmarrjes së masave për ndëshkimin e vartësve të tij, të cilët kanë kryer krimet e akuzuara në Aktakuzë apo kanë ndihmuar dhe inkurajuar të tjerët për kryerjen e këtyre krimeve.

406. Për përgjegjësinë e eprorit në bazë të Nenit 7(3) të Statutit, jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar tre elementë që duhen përmbushur:

> 1. ekzistenca e marrëdhënies epror-vartës;
> 2. eprori dinte apo kishte arsye të dinte se do të kryhej apo ishte kryer një akt kriminal; dhe
> 3. eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e aktit kriminal apo ndëshkimin e autorit të tij.[1611]

[1608] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 195; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 557. Për mosmarrjen e masave ndëshkuese, *shih* Aktgjykimin e Apelit *Blashkiq*, para. 85; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haliloviq*, para. 94.

[1609] Për zbatimin e parimit të përgjegjësisë komanduese në konflikte të armatosura të brendshme, *shih Prokurori kundër Haxhihasanoviq*, Çështja Nr. IT-01-47-AR72, Appeals Chamber Decision on Interlocutory Appeal Challenging Jurisdiction in Relation to Command Responsibility, 16 July 2003, para 31Vendim i Dhomës së Apelit në lidhje me Apelin e Ndërkohshëm për Kundërshtimin e Juridiksionit lidhur me Përgjegjësinë Komanduese, 16 korrik 2003, para. 31.

[1610] Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq*, para. 280-282; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 21.

[1611] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 346, Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 484; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 72. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Kordiq*, para. 827; Aktgjykimi i Dhomës

(a) Marrëdhënia epror-vartës

407. Doktrina e përgjegjësisë së komandës bazohet, në fund të fundit, në pozitën komanduese ndaj veprimeve të vartësve si dhe kompetencën e kontrollit të këtyre akteve. Kjo pozitë përbën bazën ligjore të detyrës së eprorit për të vepruar si dhe të përgjegjësisë së tij rezultuese në rast se nuk vepron.[1612]

408. Ekzistenca e pozitës komandueses mund të rrjedhë prej statusit formal apo *de jure* të një eprori, apo prej ekzistencës së kompetencave *de facto* të kontrollit. Ajo përcaktohet kryesisht prej "zotërimit apo moszotërimit faktual të kompetencave të kontrollit të vartësve."[1613] Në përcaktimin e nivelit të kontrollit të ushtruar prej eprorit ndaj vartësit, Dhoma e Apelit mbështeti standardin e kontrollit efektiv, të cilin e përkufizoi si aftësi thelbësore për parandalimin ose ndëshkimin e sjelljes kriminale.[1614] Ekzistenca e marrëdhënies epror-vartës "nuk […] përcakton kushtin për vartësi *të drejtpërdrejtë apo formale*".[1615] Po kështu, nuk është e nevojshme përhershmëria e lidhjes komandë-vartësi.[1616] Gjithashtu, Dhoma kujton se "kushti i kontrollit efektiv […] nënkupton se për të njëjtin krim të kryer nga një vartës, përgjegjësia mund të jetë e më shumë se një personi."[1617]

Gjyqësore *Blashkiq*, para. 294; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kvoçka*, para. 314; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilloviq*, para. 56; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 558.

1612 Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 76; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 559.

1613 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 370; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 560.

1614 Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 256. Dhoma e Apelit ka kundërshtuar argumentin se eprori mund të mbajë përgjegjësi penale mbi bazën e pushtetit të tij ndikues, pasi kjo Dhomë konkludoi se "ndikimi thelbësor si mjet kontrolli në çfarëdo kuptimi, që nuk arrin në nivelin e kontrollit efektiv ndaj vartësve" (dmth. zotërimi i aftësisë materiale për të parandaluar apo ndëshkuar) nuk ka statusin e një rregulle në të drejtën zakonore, veçanërisht status të tillë që të çojë në përgjegjësi penale. *Shih* Aktgjykimin e Apelit *Çelebiçi*, para. 266. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Halilloviq*, para. 59: "koncepti i kontrollit të efektshëm ndaj një vartësi [...] është kufiri që duhet të arrihet për përcaktimin e marrëdhënies epror-vartës".

1615 Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 303. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Halilloviq*, para. 59.

1616 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 362; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kunarac*, para. 399; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 560.

1617 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*, para. 303, i cili i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore *Aleksovski*, para. 106; *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 365; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 560.

409. Neni 7(3) i Statutit zbatohet jo vetëm për komandantët ushtarakë, por edhe për eprorët civilë.[1618] Eprorët civilë mbajnë përgjegjësi penale në përputhje me Nenin 7(3) të Statutit në të njëjtat rrethana si komandantët ushtarakë.[1619]

410. Në disa rrethana, dhe veçanërisht në një konflikt të armatosur, eprorët civilë mund të ushtrojnë kompetenca *de facto* krahas kompetencave të tyre *de jure* ndaj vartësve të tyre. Rrjedhimisht është e nevojshme të shqyrtohen me kujdes si kompetencat *de facto* po ashtu dhe ato *de jure* si dhe kontrolli efektiv i ushtruar nga eprori civil në rrethanat e veçanta e çështjes.[1620]

411. Ndonëse kjo pikë do të analizohet gjithnjë në bazë të fakteve konkrete të çështjes,[1621] janë identifikuar, ndonëse jo plotësisht, një sërë faktorësh mbi bazën e të cilëve mund të arrihet në konkluzione për kontrollin efektiv. Ndër këta faktorë përfshihen pozita zyrtare e të akuzuarit, aftësia e tij për lëshimin e urdhrave *de jure* apo *de facto,* procedura për emërimin, pozicioni i të akuzuarit në strukturën ushtarake apo politike, dhe detyrat faktike që ka kryer.[1622] Zotërimi i kompetencave *de jure* në vetvete mund të mos mjaftojë për identifikimin e kontrollit efektiv.[1623] Ndonëse zotërimi i kompetencave *de jure* mund të sugjerojë aftësinë e kërkuar për parandalimin apo ndëshkimin e veprimeve kriminale të vartësve, Prokuroria ende ka detyrimin për të provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se i akuzuari kishte kontroll efektiv ndaj vartësve të tij.[1624]

[1618] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 195; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 356, 378; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Aleksovski*, para. 75; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 76; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 416; *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Bagilishema*, para. 51; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, para. 85; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 605.

[1619] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 223-226; Aktgjykimi i Apelit *Bagilishema*, para. 50 ku theksohet se: "kushti i kontrollit të [e]fektshëm zbatohet për të gjithë eprorët, pavarësisht nëse *de jure* apo *de facto*, janë ushtarakë apo civilë." *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërnojelac*, para. 94; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 281-282.

[1620] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 421-422; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 281.

[1621] Zotërimi i kontrollit efektiv prej eprorit është çështje provash, dhe jo e së drejtës së mirëfilltë, Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 20. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin i Apelit *Blashkiq*, para. 69.

[1622] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 418-424. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Halilloviq*, para. 204: "urdhrat *në vetvete* nuk vërtetojnë kontroll efektiv; urdhrat në fjalë duhet të vlerësohen me kujdes mbi bazën e dëshmive për të përcaktuar nivelin e kontrollit ndaj autorëve të veprave penale."

[1623] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 197; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Galiq*, para. 173.

[1624] Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 91-92. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 21.

(b) Elementi mendor: Eprori dinte apo kishte arsye të dinte

412. Përgjegjësia e ngushtë ligjore nuk zbatohet në lidhje me parimin e përgjegjësisë së komandës; Për këtë arsye duhet të provohet se eprori dinte apo kishte arsye të dinte se vartësit e tij po kryenin apo do të kryenin krime. Vlerësimi i elementit mendor, i kërkuar nga Neni 7(3) i Statutit, bëhet mbi bazën e rrethanave konkrete të çdo rasti dhe situatës konkrete të të akuzuarit në periudhën në fjalë.[1625]

413. Fakti që një epror kishte dijeni se vartësit e tij po kryenin apo do të kryenin një krim, nuk mund të supozohet; gjithsesi ai mund të vërtetohet duke u nisur nga provat rrethanore,[1626] ndër të cilat numri, lloji dhe objektivi i veprimeve të paligjshme, koha gjatë së cilës ndodhën aktet e paligjshme, numri dhe lloji i trupave dhe baza logjistike e përdorur, vendndodhja geografike, përhapja e këtyre veprimeve, ritmi taktik i operacioneve, *modus operandi* i veprimeve të ngjashme të paligjshme, oficerët dhe personeli i përfshirë, si dhe vendndodhja e komandantit në atë kohë.[1627]

414. Për të konkluduar se një epror "kishte arsye të dinte" se vartësit e tij po kryenin apo do të kryenin një krim, është e nevojshme të vërtetohet se eprori ka patur në dispozicion informacion konkret për krimet e kryera apo që do të kryheshin nga vartësit e tij.[1628] Nuk është e nevojshme që ai të jetë njohur me këtë informacion, duhet vetëm që ky informacion të ishte i disponueshëm për të.[1629] Para së gjithash eprori nuk mund të konsiderohet përgjegjës thjesht për faktin se nuk bëri asgjë për ta siguruar këtë informacion.[1630] Mirëpo nuk është e nevojshme që informacioni faktual i disponueshëm të jetë në vetvete i mjaftueshëm për nxjerrjen e konkluzioneve për ekzistencën e këtyre krimeve.[1631] Mjafton që eprori të jetë në zotërim të informacionit të mjaftueshëm, qoftë edhe të përgjithshëm, që sjell në vëmendje gjasën për akte të paligjshme prej vartësve të tij, me fjalë të tjera që përligj hetime të mëtejshme për të vërtetuar nëse faktikisht akte të

1625 Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi* para. 239, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilovia*, para. 70.
1626 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 386; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 368; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 563.
1627 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 386. *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 427; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*, para. 307; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 368; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 563.
1628 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 393; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 564.
1629 Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 239.
1630 Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 62-63, Aktgjykimi i Apelit *Çelebiçi*, para. 226, 241.
1631 Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 393; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 564.

tilla janë kryer ose do të kryhen.[1632] Nëqoftëse eprori *qëllimisht* nuk siguron informacione të mëtejshme, madje edhe kur ka mundësinë për një gjë të tillë, mund të konsiderohet se ai "kishte arsye të ishte në dijeni " të krimeve.[1633]

(c) Masat e nevojshme dhe të arsyeshme

415. Detyra e një eprori për marrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e kryerjes së një krimi ose për ndëshkimin e autorëve të tij, lidhet drejtpërsëdrejti me zotërimin e kontrollit efektiv prej tij, d.m.th. me aftësinë e tij materiale për marrjen e masave të tilla. Një epror mund të ngarkohet me përgjegjësi nëqoftëse nuk merr masa të tilla, madje edhe kur nuk zotëron kompetencën e shprehur ligjore për t'a bërë një gjë të tillë, në rast se provohet se marrja e këtyre masave përfshihej në aftësinë e tij materiale.[1634] Dhoma e Apelit ka konkluduar se masa "të nevojshme', janë masat e përshtatshme për përmbushjen e detyrimit prej eprorit (që tregojnë se ai u përpoq me të vërtetë për parandalimin apo ndëshkimin) dhe masa 'të arsyeshme" janë masat që logjikisht përfshihen brenda kompetencave materiale të eprorit."[1635] Së këtejmi del se "masat e nevojshme dhe të arsyeshme" nuk janë subjekt i të drejtës së mirëfilltë, por kanë lidhje me provat[1636] dhe, si të tilla, ato duhet të trajtohen mbi bazën e rrethanave konkrete të çështjes.[1637]

416. Neni 7(3) i Statutit përmban dy detyrime të qarta ligjore: parandalimin e kryerjes së një vepre penale dhe ndëshkimin e autorëve të një vepre penale.[1638] Këto nuk janë detyrime alternative.[1639] Detyrimi për parandalim lind prej momentit kur eprori vihet në dijeni, apo ka arsye të dijë se po kryhet ose do të kryhet krim, ndërsa detyrimi për

[1632] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 393; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 437; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 564; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 27.

[1633] *Shih* Aktgjykimin e Apelit *Çelebiçi* para. 226; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 406; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haliloviq*, para. 69.

[1634] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiçi*, para. 395, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 443, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 565; *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blagojeviq*, para. 793; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 279; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Stakiq*, para. 461.

[1635] Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 177; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 63.

[1636] Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 177; Aktgjykimi i Apelit *Haxhiihasanoviq*, para. 33.

[1637] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 72, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haliloviq*, para. 74; Aktgjykimi i Apelit *Haxhiihasanoviq*, para. 33. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Haliloviq*, para. 63: "masat të nevojshme' janë masat e përshtatshme për eprorin për të përmbushur detyrimin e tij (që tregojnë se ai u përpoq me të vërtetë që të parandalonte dhe ndëshkonte) dhe "të arsyeshme' janë masat që logjikisht përfshihen brenda kompetencave materiale të eprorit."

[1638] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 259.

[1639] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 83; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 566.

ndëshkim lind pasi eprori vihet në dijeni për kryerjen e krimit.[1640] Eprori është i detyruar të veprojë që prej momentit kur merr informacion të tillë.[1641]

417. Lidhur me gjerësinë e detyrimit të eprorit për ndëshkim, Dhoma e Apelit ka konkluduar së fundi se thjesht marrja e masave të një natyre disiplinore, penale, apo disiplinore-penale nga një epror, nuk është përcaktuese në përmbushjen e detyrimit prej eprorit.[1642] Përcaktuese është nëse masat e marra nga eprori për ndëshkim ishin "të nevojshme dhe të arsyeshme" në rrethanat e rastit, jo nëse këto masa ishin të një natyre disiplinore apo penale.[1643] Nuk është e nevojshme që eprori ta zbatojë ndëshkimin personalisht. Ai mund ta përmbushë detyrimin e tij për ndëshkim, duke ia raportuar çështjen autoriteteve kompetente.[1644]

418. Detyrimi i një eprori për ndëshkimin e autorëve të një krimi mund të përfshijë detyrimin për kryerjen e një hetimi të efektshëm për vërtetimin e fakteve.[1645] Detyrimi për hetim shndërrohet në detyrim të eprorit për marrjen e masave aktive për ndëshkimin e autorëve. Për këtë qëllim, eprori mund të ushtrojë kompetencat e tij ndëshkimore, ose në rast se nuk i ka këto kompetenca, ai mund t'i raportojë autorët e krimit tek autoritetet kompetente.[1646] Jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar se eprorët civilë, të cilët nuk i kanë kompetencat disiplinore dhe ndëshkimore të komandantëve ushtarakë, mund t'a përmbushin detyrimin e tyre duke u raportuar autoriteteve kompetente sa herë kryhet një krim, në qoftë se ka të ngjarë që raportime të tilla të çojnë në një hetim, ose të iniciojnë procedim disiplinor apo penal.[1647]

[1640] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 445-446; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Oriq*, para. 326; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq*, para. 125, 126. *Shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Blashkiq*, para. 83.

[1641] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 373; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 527; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 566.

[1642] Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 33.

[1643] Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 142.

[1644] Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 154.

[1645] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 376; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 529; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 568.

[1646] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq*, para. 446; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*, para. 335; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Strugar*, para. 376; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj*, para. 529; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haliloviq*, para. 97, 100; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 182; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq*, para. 568.

[1647] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Aleksovski*, para. 78; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Bërgjanin*, para. 281.

B. Përfundime në lidhje me përgjegjësinë e Lube Boshkoskit

1. Roli i Lube Boshkoskit në ngjarjet e 12 gushtit

419. Ka dëshmi se tri deri në pesë javë para ngjarjeve në Luboten, shefi i OVR-së së Çairit pati një thirrje telefonike prej të Akuzuarit Lube Boshkoski, i cili i tha se i Akuzuari tjetër Johan Tarçulovski do të vinte në zyrën e shefit të OVR-së së Çairit dhe se nëqoftëse Johan Tarçulovski do të kishte nevojë për ndihmë, shefi i OVR-së së Çairit duhej ta ndihmonte.[1648] Të nesërmen, Johan Tarçulovski erdhi në zyrën e shefit të OVR-së së Çairit dhe i tha se ishte dërguar nga Ministri (d.m.th. Lube Boshkoski) dhe ata shkëmbyen numrat e telefonave.[1649] Dhoma Gjyqësore e ka shqyrtuar këtë dëshmi me shumë kujdes. Ajo nuk është konfirmuar nga ndonjë dëshmi tjetër. Duke u nisur, në përgjithësi, nga sjellja e M052 në trajtimin e kësaj çështjeje, si dhe nga mundësia e zbardhjes së rolit të rëndësishëm të M052 prej provave lidhur me operacionin e Lubotenit më 12 gusht, Dhoma Gjyqësore nuk mund t'a pranojë si të ndershme dhe të besueshme këtë dëshmi, e cila, sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, mund të jetë ndikuar nga interesi i M052 për të distancuar veten nga çdo përgjegjësi për këto ngjarje.

420. Më 11 gusht 2001 Lube Boshkoski ishte në Radushë.[1650]

421. Me të marrë informacionin se "diçka po ndodhte rreth Lubotenit", më 12 gusht 2001, rreth orës 10:00, gjenerali i policisë Risto Galevski i telefonoi Lube Boshkoskit nëpërmjet qendrës operative në detyrë dhe e pyeti nëse Boshkoski kishte dijeni për çfarë po ndodhte në Luboten.[1651] Ka gjithashtu dëshmi se Presidenti i telefonoi Lube Boshkoskit në mëngjes lidhur me ngjarjet në Luboten,[1652] dhe e urdhëroi të shkonte në Luboten.[1653]

[1648] M052, T 8245-8247.
[1649] M052, T 8250-8251.
[1650] Blagoja Jakovoski, T 3976-3977; Risto Galevski, T 3858-3859.
[1651] Risto Galevski, T 3765-3766.
[1652] Blagoja Jakovoski, T 3978-3979; Zllatko Keskovski, T 10022-10026; Zoran Trajkovski, T 5558-5559.
[1653] Zoran Trajkovski, T 5558-5559.

422. Disa dëshmitarë dëshmuan se më 12 gusht 2001 Lube Boshkoski vizitoi postbllokun e Murit Kinez pranë shtëpisë së Bracës si dhe oborrin jashtë shtëpisë së Bracës.[1654]

423. M052 dëshmoi se para ardhjes së Lube Boshkoskit në shtëpinë e Bracës, Johan Tarçulovski i kishte thënë se Ministri kishte miratuar përdorimin e një autoblinde Hermelinë për tranportimin e të plagosurve apo të vrarëve.[1655] Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë mesazhin dhe nëntekstin e kësaj dëshmie se Boshkoski miratoi përdorimin e Hermelinës pasi, sipas mendimit të kësaj Dhome, dëshmia e M052 duket se është ndikuar nga interesi i tij i fortë personal për të distancuar vetveten nga çdo përgjegjësi për ngjarjet atë ditë. Gjithashtu, nuk ka të ngjarë që Ministri Boshkoski të ketë dhënë miratimin e tij për një çështje operative relativisht të parëndësishme.

424. Lube Boshkoski mbërriti në postbllokun e Murit Kinez i shoqëruar nga roja e tij personale Blagoja Jakovoski,[1656] dhe një ekip televiziv i përbërë nga gazetarja Eli Çakar dhe një kameraman,[1657] të cilët e shoqëruan gjatë gjithë vizitës[1658] dhe filmuan pjesën më të madhe të saj.[1659]

425. Ndërsa Eli Çakar thotë se ata mbërritën në këtë postbllok shumë më vonë,[1660] pjesa më e madhe e dëshmive e bind Dhomën Gjyqësore se Lube Boshkoski mbërriti në postbllok rreth orës 12:00 dhe u largua para mbarimit të operacionit, i cili përfundoi rreth orës 13:45. E gjithë vizita, si në postbllok po ashtu dhe në oborrin e shtëpisë së Bracës, zgjati afërsisht një orë e gjysëm.[1661]

[1654] Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 16-19, 21-22; Eli Çakar, T 5157-5159; 5161; 5177-5178; 5190; M017, T 630-635; M052, T 8278-8284; M053, T 1912-1914; 1932; 1977-1978; M037, T 752; 796-798; Blagoja Jakovoski, T 3937-3941; 3998; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 37-38,43; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32; Prova Materiale 189, f. 5.

[1655] M052, T 8288-8289.

[1656] Blagoja Jakovoski, T 3937-3941.

[1657] Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 10 dhe 16. *Shih* gjithashtu M052, T 8279-8280; M053, T 1913.

[1658] Eli Çakar, T 5178; 5190; 5202-5204.

[1659] Prova Materiale P442; Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 6; Eli Çakar, T 5158-5159.

[1660] Eli Çakar tha se dëshmitari dhe Boshkoski nuk u larguan nga Shkupi para orës 14:00, mbërritën në shtëpinë e Bracës në orën 15:00, dhe nuk u kthyen para orës 1700, Prova Materiale P441, para. 14; T 5172; 5176; 5179.

[1661] M052, T 8277-8278; Blagoja Jakovoski, T 3939-3941; 3998; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 43. *Shih* gjithashtu M052, T 8280; 8281; Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 12; Eli Çakar, T 5178; 5190; M053, T 1977-1978.

426. Në postbllok, Lube Boshkoski u prit nga shefi i OVR-së së Çairit.[1662] Në dëshmi u sugjerua paksa në mënyrë të habitshme, se ai kishte informuar Ministrin për numrin e forcave në postblloqe.[1663] Më pas Lube Boshkoski dhe shpura e tij hynë në oborrin e shtëpisë së Bracës pranë postbllokut.[1664] Në oborr vëmendja e tyre u përqëndrua veçanërisht në drejtim të Lubotenit.[1665] Ndonëse nga shtëpia e Bracës nuk mund të dallohen shtëpitë e Lubotenit,[1666] shihej se nga fshati ngrihej ende tym. Herë pas here kishte të shtëna.[1667] Është sugjeruar se nga fshati pati disa të shtëna në drejtim të shtëpisë,[1668] por Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur për besueshmërinë e kësaj dëshmie. Edhe pamjet televizive të pranuara si provë nuk ndihmojnë shumë, sepse, siç pranon Dhoma Gjyqësore, filmimet e bëra në shtëpinë e Bracës më pas u përpunuan, të paktën përsa i përket zërit, për të krijuar përshtypjen e një operacioni më të madh ushtarak.[1669]

427. Sipas gazetares Eli Çakar, kur hynë në oborr, Boshkoskin e informuan[1670] se kishin hyrë terroristë nga Kosova dhe se po zhvillohej një operacion për arrestimin e tyre.[1671] Ndërkohë që ishin në oborr, shefi i OVR-së së Çairit[1672] e informoi Boshkoskin për "situatën"[1673] apo "operacionin" që po ndodhte.[1674] U tha se forcat e sigurisë kishin arritur të shpartallonin grupet terroriste që kishin kryer sulme nga Luboteni[1675] (pretendim në lidhje me të cilin Dhomës Gjyqësore nuk i janë paraqitur prova bindëse), dhe se kishte patur vetëm një viktimë në radhët e pjesëtarëve të forcave të sigurisë.[1676]

1662 M052, T 8278-8279; M053, T 1977-1978; Blagoja Jakovoski, T 3937-3941; 3990; 3991.
1663 M052, T 8278.
1664 Eli Čakar, Prova Materiale P441, para. 17; Eli Çakar, T 5161; *Shih* gjithashtu M037, T 797; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32; Prova Materiale P189, para. 17; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 37.
1665 Eli Çakar, T 5196-5197. *Shih* gjithashtu M037, T 797; Prova Materiale P442.
1666 *Shih* Blagoja Jakovoski, T 3937; Eli Çakar, T 5181; 5196-5197.
1667 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 17; Eli Çakar, T 5181; 5196.
1668 Blagoja Jakovoski, T 3993; 3996; M052, T 8545-8546. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P442, në të cilën mund të shihett se njerëzit janë të përkulur në gjunjë prapa murit rrethues të oborrit të shtëpisë së Bracës.
1669 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 29-33; Prova Materiale P442.
1670 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 18.
1671 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 18. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P442.
1672 M037, T 798; 840; 843; 875. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P378, faqe 3; Blagoja Jakovoski, T 3991; 3993.
1673 M053, T 1978.
1674 Prova Materiale P441, para. 18.
1675 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 35; Prova Materiale P442.
1676 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 35; Prova Materiale P442. Kjo ka të bëjë me një rezervist i cili plagosi veten aksidentalisht, *Shih* më lart, para. 69.

Boshkoskit i raportuan edhe të tjerë në shtëpinë e Bracës.[1677] Nuk ekzistojnë prova se në atë kohë Boshkoski gjithashtu u informua se gjatë operacionit ishin vrarë "terroristë".

428. Ka dëshmi se gjatë kohës që Lube Boshkoski ishte në oborrin e shtëpisë së Bracës, një grup prej katër deri në gjashtë rezervistësh të policisë të cilët kishin marrë pjesë në operacionin në fshat atë ditë dhe ishin nga agjencia "Kometa", sollën një grup prej 10 personash përpara portës së shtëpisë së Bracës.[1678] Boshkoskin e informuan se grupi i "terroristëve" që kishin hyrë nga Kosova, ishte kapur dhe arrestuar gjatë operacionit, se atyre u ishin marrë letërnjoftimet dhe se do të dërgoheshin në stacionin policor.[1679] Gjithashtu Boshkoskit i treguan tri armë që u ishin marrë "terroristëve" të arrestuar[1680] Mirëpo sipas policisë, armët kishin ardhur nga një burim krejt i ndryshëm.[1681] Dhoma Gjyqësore konkludon se këta të arrestuar ishin banorët që i kishin sjellë nga oborri i Adem Ametovskit. Gjendja e tyre e keqe fizike përshkruhet gjetkë në këtë Aktgjykim.[1682] Dhoma Gjyqësore shënon këtu përfundimin e saj se një nga banorët ishte veçanërisht në gjendje shumë të keqe dhe se tek të tjerët dalloheshin blana të kuqe prej rrahjeve.[1683] Këta persona u detyruan të shtriheshin barkas jashtë portës me fytyrë përtokë,[1684] dhe kokën të mbuluar me bluzat me mëngë të shkurtra.[1685] Eli Çakar e pa këtë grup kur ajo u largua nga shtëpia e Bracës me Boshkoskin,[1686] në një largësi 10-15 metra.[1687] Mbi këtë bazë, Dhoma Gjyqësore pranon dhe konkludon se Lube Boshkoski e pa këtë grup të këtyre personave të arrestuar te porta. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë se të arrestuarit u rrahën para syve të Lube Boshkoskit,[1688] sugjerim që nuk është konfirmuar nga asnjë prej dëshmitarëve të pranishëm. Gjithashtu, megjithëse

---

1677 M052 tha se Boshkoski foli me policët, T 8316-8317, dhe rezervistët, T 8281. Eli Çakar dha dëshmi se Boshkoski foli me një grup njerëzish të veshur me uniforma kamuflimi dhe me maska në fytyrë, Prova Materiale P441, para. 21. *Shih* gjithashtu M053, T 1977-1978.

1678 M052, T 8282-8284. *Shih* gjithashtu M017, T 630-631; Prova Materiale P20.

1679 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 18-19. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P442.

1680 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 25. *Shih* gjithashtu M037, T 798; 840; 845. Këto armë ishin në Hermelinë ose në tokë pranë Hermelinës, M037, T 798; Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 22. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P442. Pasi pa armët, Boshkoski tundi kokën në shenjë pohimi, M037, T 798-799; 840-841.

1681 *Shih* më lart, para. 76.

1682 *Shih* më lart, para. 74.

1683 M052, T 8283; 8285; 8286.

1684 M017, T 630; M012, T 976. *Shih* gjithashtu M052, T 8284; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 37; Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32.

1685 M017, T 633; M012, T 898; Osman Ramadani, Prova Materiale P197, para. 40.

1686 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 22. *Shih* gjithashtu Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 23; Prova Materiale P442; Eli Çakar, T 5162; 5163.

1687 M052, T 8284; Prova Materiale P20; M037, T 799.

1688 Ismail Ramadani, Prova Materiale P188, para. 32.

Boshkoski mund të ketë konstatuar aspekte të gjendjes së tyre, jo domosdoshmërisht ai do të kishte konkluduar se disa nga këta persona ishin rrahur apo keqtrajtuar bazuar në çfarë pa, ndërkohë që të arrestuarit ishin të shtrirë përmbys me fytyra të mbuluar me bluza me mëngë të shkurtra. Nuk ka dëshmi që sugjerojnë se Lube Boshkoskin e informuan për gjendjen e këtyre personave.

429. Gjenerali i policisë, Risto Galevski, dëshmoi se pasdite ai urdhëroi njësinë e posaçme policore Posebna të shkonte në Luboten për të krijuar një barrierë midis banorëve maqedonas të fshatrave fqinj, veçanërisht Lubancës, dhe fshatarëve të Lubotenit që kërkonin të largoheshin nga Luboteni për shkuar në këmbë në Shkup. Parashikoheshin përleshje të dhunshme. Ai thotë se u konsultua paraprakisht me Lube Boshkoskin, Goran Mitevskin, Lupço Bliznakovskin dhe zyrtarë të tjerë të lartë të MB-së.[1689] Nuk ka prova konkrete që Lube Boshkoski të ketë dhënë ndonjë urdhër lidhur me këtë.

430. Në mbrëmjen[1690] e 12 gushtit 2001, TV maqedonas transmetoi një reportazh për vizitën e Lube Boshkoskit në shtëpinë e Bracës.[1691] Komentet e bëra në këtë reportazh bazoheshin në informacione të dhëna nga Lube Boshkoski.[1692] Gjatë reportazhit u tha se forcat e sigurisë kishin arritur të shpartallonin grupet terroriste që kishin kryer sulme nga Luboteni.[1693] Ky reportazh tërhoqi vëmendjen e organizatave ndërkombëtare, si Human Rights Watch.[1694]

2. Njoftimi për gjykatësin hetues

431. Sipas një note zyrtare të gjykatësit hetues Ognen Stavrev,[1695] më 12 gusht 2001, në 17:30, gjykatësi hetues kujdestar u informua nga qendra operative kujdestare e MB-së se kishte "disa të anëtarë të vrarë të forcave paraushtarake të terroristëve shqiptarë" në zonën e fshatrave Lubancë dhe Luboten dhe se nuk mund të garantohej siguria e autoriteteve hetimore për shkak të përleshjeve ushtarake që ende vazhdonin midis forcave

1689 Risto Galevski, T 3629; 3766-3767.
1690 Prova Materiale P352, f. 2.
1691 Eli Çakar, T 5192; Prova Materiale P442.
1692 Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 35; Eli Çakar, T 5179-5180.
1693 Prova Materiale P442.
1694 Prova Materiale P352, f. 2-3.
1695 Prova Materiale 1D6.

paraushtarake dhe atyre të sigurisë. Gjykatësi hetues informoi prokurorin publik.[1696] Më 14 gusht 2001, rreth orës 13:30, gjykatësi hetues kujdestar u informua nga MB-ja se kishte disa kufoma në zonën e fshatit Luboten dhe se ato ishin ndoshta të "anëtarëve të organizatës terroriste të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare / Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të vrarë gjatë luftimeve me forcat e sigurisë së RM-së më 12 gusht 2001."[1697] Pak kohë më pas në stacionin policor të Çairit erdhën gjykatësi hetues Stavrev së bashku me zëvendësprokurorin publik dhe Zllatko Jaqovskin nga Instituti Mjekoligjor, por në vendngjarjen në Luboten nuk u krye asnjë hetim pasi shefi i OVR-së së Çairit tha se forcat e sigurisë nuk mund të garantonin sigurinë e tyre. U tha se forcat e sigurisë nuk kishin hyrë në Luboten dhe se nga fshati dëgjoheshin ende të shtëna me armë zjarri.[1698] Gjykatësi hetues Stavrev erdhi edhe një herë tjetër me një ekip hetimor më 14 gusht 2001, por shefi i OVR-së së Çairit deklaroi përsëri se kishte të shtëna dhe se kufomat tashmë ishin varrosur.[1699] Duhet vënë në dukje se nuk pati ndonjë njoftim konkret për shkatërrimin e shtëpive në Luboten apo për ndonjë keqtrajtim të fshatarëve të arrestuar apo të personave të dyshuar në Luboten, në shtëpinë e Bracës, në postbllokun e Buzalakut, në stacione të ndryshme policore, në gjykatën e Shkupit apo në spitalin e Shkupit. Për më tepër gjykatësit hetues nuk i dhanë asnjë emër të ndonjë dëshmitari të mundshëm nga radhët e banorëve apo policisë.

432. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se nuk ka dëshmi për përleshje të armatosura të vazhdueshme në Luboten, apo për të shtëna që ende dëgjoheshin më 13 ose më 14 gusht. Përkundrazi, përfaqësuesi i OSBE-së, Henry Bolton, e vizitoi Lubotenin më 14 gusht pa vështirësi, për të inspektuar vendngjarjen e 12 gushtit dhe kufomat, të cilat ishin ende *in situ*, dhe as nuk dëgjoi, as nuk pa përleshje të armatosura apo të shtëna armësh.[1700] Ai u tha njerëzve në fshat se duhej t'i varrosnin kufomat.[1701]

1696 Prova Materiale 1D6; Zllatko Jaqovski, T 2353. *Shih* gjithashtu Petre Stojanovski, T 9167-9168.

1697 Prova Materiale 1D6.

1698 Prova Materiale 1D6. *Shih* gjithashtu Vilma Ruskovska, Prova Materiale P235, para. 10. Mungesa e sigurisë u shpjegua më pas në një notë zyrtare përgatitur nga zëvendësprokurori publik më 15 gusht: "Këtu nuk është dislokuar asnjë përfaqësues i forcave të sigurisë, për të garantuar sigurinë e grupit hetimor; ka vetëm dy postblloqe policore rreth fshatit, por ka gjithashtu grupe terroristësh me pushkë snajper dhe armë këmbësorie. Për shkak të kësaj situate në terren ne ramë dakord me gjykatësin hetues kompetent që të anullonim hetimin në terren," Prova Materiale 1D72.

1699 Prova Materiale 1D6.

1700 Henry Bolton, T 1740-1742.

1701 Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 22.

433. Më 14 gusht 2001, OVR-ja e Çairit informoi gjithashtu prokurorin publik për vdekjen e një prej banorëve të arrestuar të fshatit, Atulla Qailit, në spitalin e qytetit të Shkupit më 13 gusht 2001, se ai ishte mbajtur në stacionin policor të Mirkocit para se të dërgohej në spital dhe se ambulanca ishte thirrur nga polici roje në stacionin policor.[1702] Autopsia e Atulla Qailit u krye nga instituti mjekoligjor më 14 gusht 2001.[1703] Autopsia përcaktoi plotësisht masën e dëmtimeve të rënda në trupin e tij, duke theksuar se ato ishin shkaktuar nga "goditje dinamike të vazhdueshme dhe të forta me objekte jo të mprehtë" në zonën e kokës, trupit, dhe gjymtyrëve.[1704] Mirëpo duhet theksuar se më pas aktautopsia nuk iu dërgua prokurorit publik apo autoriteteve gjyqësore, pasi, siç duket, "gjykata kompetente nuk pagoi për autopsinë e kryer." Gjithashtu nuk u bë asnjë përpjekje për të marrë raportin.[1705] Më 16 gusht 2001, gjykatësi hetues mori masa për verifikimin e identitetit të Atulla Qailit,[1706] i cili fillimisht ishte shënuar gabim.[1707] Të nesërmen, policia për krime e MB-së u përpoq të identifikonte Atulla Qailin duke krahasuar shenjat e gishtave,[1708] dhe rezultati më pas iu komunikua gjykatësit hetues.[1709]

3. Përpjekjet hetimore prej Ministrisë së Brendshme

(a) Komisioni i krijuar më 13 gusht 2001

434. Deri më 13 gusht 2001, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare dhe media kishin marrë informacione të ndryshme se në Luboten, më 12 gusht, kishte patur përleshje me qytetarët, granatime nga policia, dhe se ishin vrarë pesë deri në 15 persona.[1710] U tha se shqetësimi i ngritur nga ky informacion ishte arsye e mjaftueshme për vendimin e marrë po atë ditë nga Lube Boshkoski për krijimin formal të një komisioni, që:[1711]

1702 Provat Materiale P46.16; P261. *Shih* gjithashtu Petre Stojanovski, T 9180.
1703 Prova Materiale P54.059.
1704 *Shih* më lart, para. 329.
1705 *Shih* më poshtë, para. 443.
1706 Prova Materiale 1D67.
1707 Prova Materiale P49, f. 19, ERN N001-0095.
1708 Prova Materiale 1D69. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P54.059.
1709 Prova Materiale 1D70.
1710 Risto Galevski, T 3869-3870. Risto Galevski dëshmoi gjithashtu se pasditen e 12 gushtit kishte informacion për fshatarë të plagosur, disa prej të cilëve u mjekuan në spital, T 3766-3767. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P362.
1711 Prova Materiale P73; Risto Galevski, T 3869-3870.

> I. […] të shqyrtojë rrethanat dhe analizojë veprimet e kryera nga forcat e sigurisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme për zmbrapsjen e sulmeve të armatosura nga grupet terroriste më 12.08.2001 në fshatin Luboten-Shkup, i përbërë nga:
>
> 1. Goran Mitevski – Drejtor i Zyrës së Sigurisë Publike, kryetar;
>
> 2. Risto Galevski – Drejtor i Drejtorisë së Policisë, anëtar, dhe
>
> 3. Zhivko Petrovski – Drejtor i Drejtorisë së Policisë për Krime, anëtar.
>
> II. Mbështetur në të dhënat, raportet dhe materiale të tjera ekzistuese nga seksionet përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe mbështetur në informacionin e marrë nga bisedat me punonjësit e Ministrisë, komisioni i krijuar sipas pikës I të këtij vendimi ngarkohet të shqyrtojë rrethanat dhe të analizojë veprimet e ndërmarra nga forcat e sigurisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme për zmbrapsjen e sulmeve terroriste të grupeve terroriste më 12.08.2001 në fshatin Luboten-Shkup.
>
> III. Komissioni ngarkohet të fillojë menjëherë punën për zbatimin e detyrave të përcaktuara në pikën II të këtij Vendimi si dhe për përgatitjen e një raporti mbi faktet e përcaktuara, me një shpjegim lidhur me arsyet, justifikimin, dhe legjitimitetin e veprimeve të ndërmarra nga forcat e sigurisë së Ministrisë.
>
> IV. Raporti i hartuar mbi bazën e pikës III të këtij vendimi t'i paraqitet Ministrit të Punëve të Brendshme.

435. Komisioni ia paraqiti raportin e vet pesëfaqësh Lube Boshkoskit, më 4 shtator 2001.[1712] Lidhur me ngjarjet më 12 gusht 2001, komisioni vuri në dukje se "nëpërmjet veprimeve ushtarake forcat e përbashkëta të sigurisë shpartalluan grupet terroriste", dhe se ato ishin "provokuar" duke u detyruar të ndërmerrnin veprime "për zmbrapsjen e sulmeve dhe shpartallimin e grupeve terroriste."[1713] Ishin arrestuar afërsisht 73 persona.[1714] Sipas mendimit të komisionit:

> Veprimet e ndërmarra nga forcat e sigurisë së Ministrisë së Brendshme për zmbrapsjen e sulmeve të grupeve terroriste më 12 gusht 2001, në fshatin Luboten, Shkup, ishin të arsyetuara, të justifikuara dhe të zbatuara siç duhet, megjithëse u konstatua një numër i pakët i tolerueshëm i rasteve të tejkalimit individual të kompetencave të përcaktuara, nga një numër i vogël i anëtarëve të Ministrisë së Brendshme, që morën pjesë aktive në incidentin në fjalë.
>
> Duke patur parasysh mungesën objektivisht të justifikueshme të dokumentacionit me shkrim nga hetimi në terren dhe autopsinë e kufomave të gjetura në fshatin Luboten, Shkup, dhe për të arritur plotësueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen, është e nevojshme që organet e Republikës së Maqedonisë të ndërmarrin hapa ligjore, zhvarrimin e

[1712] Prova Materiale P378. *Shih* gjithashtu Risto Galevski, T 3589-3590.
[1713] Prova Materiale P378, f. 2, 3.
[1714] Prova Materiale P378, f. 3.

> kufomave, në prani të ekspertëve dhe të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare të interesuara, gjë e cila do të çojë në marrjen e të gjitha masave të nevojshme ligjore për konfirmimin e të gjitha fakteve përkatëse dhe marrjen e përgjigjeve për pyetjet thelbësore të hapura për këtë ngjarje.[1715]

436. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se, sipas një anëtari të komisionit, komisioni nuk ishte strukturë e ngarkuar për të kryer hetime, por "një grup i posaçëm pune i nevojshëm për të vënë në lëvizje mekanizmat në dispozicion të Ministrisë së Brendshme."[1716] Ndonëse dëshmitari nuk dha më shumë hollësi për këtë, nga përmbajtja e raportit është mjaft e qartë se përqasja e komisionit ishte shumë e kufizuar. Vlen të theksohet se raporti nuk trajtoi në mënyrë të drejtpërdrejtë disa ngjarje konkrete, si rrethanat e vrasjeve, shkatërrimin i pronave në Luboten më 12 gusht 2001, keqtrajtimi i të arrestuarve në Luboten dhe në stacionet policore dhe gjetkë, apo nëse forcat e sigurisë së MB-së të dislokuara në Luboten atë ditë apo në stacionet policore morën pjesë në ndonjë prej këtyre incidenteve.[1717] Gjithashtu raporti duket se krijon përshtypjen se forcat e sigurisë zmbrapsën sulmet "terroriste", ndërsa dëshmitë tregojnë se ishin forcat e sigurisë ato që sulmuan.[1718] Kjo, natyrisht, pasqyron keqkuptimin që është i dukshëm në programin themelues të komisionit. Mirëpo nëpërmjet raportit të vet komisioni në fakt identifikoi nevojën për zhvarrimet si hap drejt konfirmimit të fakteve përkatëse dhe pranoi se "pyetja thelbësore e hapur për këtë ngjarje" kishte mbetur pa përgjigje.

437. Puna e komisionit u krye në mënyrë shumë sipërfaqësore. Komisioni nuk bëri asnjë vizitë në Luboten. Mbrojtja argumentoi se në vendngjarjen e një krimi mund të shkojë për mbledhjen e informacionit vetëm një ekip hetimor i kryesuar nga një gjykatës hetues.[1719] Dhoma Gjyqësore mendon se ndonëse ishte kompetencë e prokurorit publik dhe gjykatësit hetues për të urdhëruar apo kryer një hetim në vendngjarje në kontekstin e një hetimi penal, komisioni mund të kishte bërë vizitë në Luboten për qëllimet e veta. Komisioni nuk po kryente hetim penal, dhe rrjedhimisht nuk do të kishte ndërhyrë në punën e gjykatësit hetues apo të tjerëve të angazhuar në hetimin e veprave të mundshme penale.

[1715] Prova Materiale P378, f. 4-5.
[1716] Risto Galevski, T 3581.
[1717] Megjithëse këto ishin detyra të Komisionit, *Shih* Provën Materiale P73; Risto Galevski, T 3868-3869.
[1718] *Shih* më lart, para. 42.
[1719] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 135-141.

438. Në raport komisioni shprehet se veç mbledhjes së dokumentacionit me shkrim në Ministrinë e Brendshme për qëllimet e veta, zyrtarë të Ministrisë që e ndihmonin komisionin "biseduan me punonjës të tjerë të Ministrisë, të cilët kishin marrë pjesë aktive në ngjarjet lidhur me këtë çështje."[1720] Drejtori i policisë i cili ishte anëtar i komisionit, gjenerali Risto Galevski, deklaroi se "ishin intervistuar shumë persona në stacionet policore."[1721] Mirëpo, as në raport dhe as në ndonjë dokument të bashkëngjitur nuk përmendet ndonjë intervistë konkrete. Risto Galevski nuk intervistoi askënd gjatë kohës që komisioni zhvilloi punën e tij,[1722] dhe ai pohoi se komisioni nuk intervistoi asnjë banor shqiptar të Lubotenit.[1723] Ai nuk dinte të ishte intervistuar ndonjë nga të arrestuarit.[1724] Për më tepër banorë të Lubotenit,[1725] duke përfshirë ata që ishin arrestuar nga policia,[1726] dhe, me një përjashtim të mundshëm,[1727] policë të përfshirë në ngjarjet në Luboten,[1728] të cilët dëshmuan para Dhomës Gjyqësore, thanë se nuk ishin kontaktuar nga komisioni për ndonjë intervistë.

439. Mbi këtë bazë, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se komisioni nuk këqyri vendin e ngjarjeve në Luboten, dhe as nuk u përpoq të intervistonte banorë në Luboten, personat e arrestuar në Luboten më 12 gusht dhe asnjë nga policët që kishin marrë pjesë në operacionin në Luboten. Dhoma Gjyqësore konkludon se, në sajë të mandatit dhe funksioneve të anëtarëve të tij bazuar në postet që kishin në MB, komisioni i kishte kompetencat dhe kapacitetin për t'i bërë këto gjëra. Komisioni nuk bëri identifikimin e anëtarëve të policisë që hynë në fshat apo që mbikëqyrën banorët në postblloqet apo stacionet policore.[1729] Pretendohet se banorët nuk kontaktuan komisionin apo policinë.

1720 Prova Materiale P378, f. 1.

1721 Risto Galevski, T 3787-3790. *Shih* gjithashtu Petre Stojanovski, T 9195-9197; 9375-9376. Petre Stojanovski dëshmoi se ai intervistoi shefat e stacioneve policore ku ishin mbajtur të arrestuarit, por asnjë prej tyre nuk konfirmoi se kishte patur ndonjë keqtrajtim. Ai nuk dha hollësi të tjera për këto intervista.

1722 Risto Galevski, T 3583-3584.

1723 Risto Galevski, T 3587-3588.

1724 Risto Galevski, T 3845.

1725 Aziz Rexhepi, T 4691.

1726 M017, T 739; Sherafedin Ajrullai, T 4055; Ejup Hamiti, T 4433; Sedat Murati, T 4064; M012, T 919-920; Osman Ramadani, T 1103; Osman Ramadani, Prova Materiale P198, para. 40.

1727 M083, T 1438-1439.

1728 M084, T 1482; M037, T 871; M052, T 8369.

1729 Risto Galevski pohoi se ekzistonin lista për të gjithë personat e dislokuar (të cilat mund të gjendeshin në OVR-në e Çairit për këto forca policore, dhe në një sektor të njësive të posaçme në ministri për njësinë Posebna), T 3842-3844. Risto Galevski sugjeroi se komisioni mund të ketë folur me anëtarë të MB-së të cilët kishin qenë të pranishëm në Luboten më 12 gusht 2001, për të marrë informacion për numrin e personave që ishin vrarë, T 3871-3873, por ishte vetëm hamendje dhe nuk ka asnjë provë që tregojn se në fakt ndodhi kështu dhe raporti i komisionit nuk pasqyron çka sugjeron ai.

Mirëpo komisioni apo ata që e ndihmuan, nuk bënë asnjë përpjekje për të kontaktuar banorët për intervistim.

440. Në një raport shumë të gjatë që trajtonte shumë çështje në IRJM, i cili iu paraqit qeverisë së IRJM-së në fund të marsit 2002, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtërues (CPT), organ i Këshillit të Evropës, komentoi çështje që janë drejtpërsëdrejti të lidhura me këtë proces gjyqësor.[1730] Lidhur me rastin e Lubotenit, në raport thuhet:

> [D]uket se zyrtarët e Ministrisë së Brendshme nuk ndërmorën hapa për mbrojtjen dhe ruajtjen e provave si dhe për kryerjen e një hetimi penal megjithëse në bazë të kodit të procedurës penale janë të detyruar ligjërisht, për t'a bërë një gjë të tillë.[1731]

Lidhur me konkluzionin e komisionit, raporti thekson:

> Pavarësisht nga vlerësimi i bërë nga komisioni ad hoc i Ministrisë së Brendshme, provat mjekësore të grumbulluara nga delegacioni përputheshin me pretendimet për keqtrajtim të personave të privuar prej lirisë së tyre gjatë apo pas operacionit të forcave qeveritare të sigurisë në Luboten.[1732]

441. Nuk dihet saktësisht se kur iu paraqit ky raport Lube Boshkoskit, por Dhoma Gjyqësore, duke u nisur nga natyra e raportit, supozon se Lube Boshkoski duhet të jetë vënë në dijeni të tij. CPT-ja shprehu pikëpamje të cilat janë shumë të ngjashme me ato të konkluduara nga Dhoma Gjyqësore në këtë Aktgjykim, veçanërisht lidhur me mosveprimin e policisë për të hetuar siç duhet ngjarjet në Luboten dhe pasojat e tyre, më 12 gusht 2001 dhe në ditët e mëvonshme.

442. Raporti i CPT-jë trajtonte shumë çështje. Qeveria e IRJM-së paraqiti një dokument të hollësishëm prej 12 faqesh si përgjigje ndaj raportit.[1733] Kopja e kësaj përgjigjeje, që u pranua si provë, është pa datë, por meqë përmenden ngjarje në tetor 2002, duket se hartimi i saj nuk u bë brenda një kohe të shkurtër. Në këtë përgjigje qeveria përfshiu komente për çështje të shumta nga Ministria e Brendshme, si dhe komente nga Ministria e Shëndetësisë, Këshilli Shtetëror Gjyqësor, dhe Prokurori Publik.

1730 Prova Materiale P380.1

1731 Prova Materiale P380.1 Raport i Qeverisë së IRJM-së për vizitën e CPT-së(Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës) në IRJM, nga 12 deri më 26 tetor 2001 2001, para. 64.

1732 Prova Materiale P380.1, para. 30.

1733 Prova Materiale 1D372; Përgjigjja e qeverisë së IRJM-së ndaj raportit të CPT-së për vizitën nga 21 deri më 26 tetor 2001.

Prej këtij reagimi del qartë se ministria e Lube Boshkoskit i kishte kushtuar vëmendje raportit të CPT-së.

443. Ndër çështjet e shumta të trajtuara nga Ministria e Drejtësisë, janë çështjet lidhur me Lubotenin (pika 28), duke përfshirë çështjen e "AQ", d.m.th. Atulla Qailit (pika 34).[1734] Nën titullin e përgjithshëm, Informacion i kërkuar në Raport, është një koment i shkurtër i Këshillit Shtetëror Gjyqësor, i cili thotë se nuk ka marrë asnjë kërkesë dhe peticion lidhur me trajtimin e personave të arrestuar që përmend torturën dhe ndonjë trajtim tjetër të paligjshëm.[1735] Nuk bëhet asnjë koment për veprimet e gjyqësorit lidhur me vrasjet në Luboten dhe vrasjen e Atulla Qailit. Gykata II e Shkupit e Shkallës së Parë ofroi informacion për persona nga Luboteni kundër të cilëve ishin hapur procese penale për "Shërbim në Ushtrinë Armike" si dhe për lirimin e këtyre personave pas shpalljes së amnistisë në dhjetor 2001.[1736] Zyra e Shkallës së Parë të Prokurorisë Publike të Shkupit njoftoi gjithashtu se kishte marrë informacion për çështjen e Atulla Qailit më 13 gusht 2001. Ai ishte ndër të dyshuarit për veprën penale të Përfshirjes në veprimtari armiqësore. Ai nuk u soll përpara gjykatësit hetues, sepse ishte në spital ku edhe vdiq më vonë. Me urdhër të gjykatësit hetues kufomës iu bë një autopsi. Mirëpo "Protokolli i procedurës së kësaj autopsie nuk u sigurua, sepse gjykata kompetente nuk pagoi për autopsinë e kryer." Pasi vihet në dukje kryerja e zhvarrimit në prill 2002 thuhet se "arsyet për vdekjen do të njoftohen pasi të merren rezultatet e këtij zhvarrimi …"[1737]

444. Mirëpo në përgjigjen e qeverisë nuk përmenden përpjekje hetimore prej policisë ose shpjegime për mungesën e përpjekjeve të tilla dhe as për mosveprimin e prokurorit publik apo gjykatësit hetues për të reaguar në lidhje me njoftimet për vdekjet në Luboten dhe për vdekjen e Atulla Qailit. E vetmja gjë që përmendet është fakti se gjykata nuk kishte paguar për aktautopsinë e Atulla Qailit. Në përgjigje thuhet më tej se juridiksioni për pesë çështje, duke përfshirë atë të Lubotenit, ishte marrë përsipër nga TPNJ-ja.

445. Nëqoftëse Lube Boshkoski do t'i kishte marrë parasysh raportin e CPT-së dhe përgjigjen e IRJM-së gjatë periudhës së Aktakuzës, atëhere ai duhej të kishte ndërmarrë

[1734] Prova Materiale 1D372 (N001-4809-N001-4811).
[1735] Prova Materiale 1D372 (N001-4808).
[1736] Prova Materiale 1D372 (N001-4809).
[1737] Prova Materiale 1D372 (N001-4811).

veprime, veçanërisht për faktin se nuk kishte patur asnjë reagim ndaj pretendimit për mosveprim nga ana e policisë nën pushtetin e tij. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi, sepse IRJM-ja e dha përgjigjen disa muaj pas periudhës së Aktakuzës, e cila përfundoi në maj 2002, kur Prokurorja e TPNJ-së mori përgjegjësinë për hetimin dhe procedimin penal lidhur me Lubotenin, dhe nuk është vërtetuar se Lube Boshkoski ishte informuar për raportin e CPT-së para kësaj date.

(b) Informacione të tjera të marra nga Lube Boshkoski në gusht/shtator 2001

446. Më 14 gusht 2001,[1738] Lube Boshkoski u takua me shefin e misionit të OSBE-së, ambasadorin Carlo Ungaro, sepse siç është sugjeruar, tashmë publiku ishte informuar për vrasjen e disa personave në Luboten, dhe ky informacion kishte ardhur nga OSBE-ja.[1739] Përpara këtij takimi, Lube Boshkoski e kishte kritikuar ashpër OSBE-në në media.[1740] Pas takimit, në një deklaratë për televizionin maqedonas, Lube Boshkoski tha se ata kishin biseduar për çështjen e pesë[1741] kufomave në Luboten, situatën e sigurisë, dhe se, sipas informacionit paraprak të policisë:

> viktimat ishin anëtarë të një grupi terrorist që kishte hapur zjarr kundër forcave të sigurisë së Republikës së Maqedonisë, gjë që provon përsëri se në Luboten nuk kishte patur ndonjë masakër dhe se nuk ishin vrarë civilë, por anëtarë të një grupi terrorist-ekstremist.[1742]

Gjithashtu Lube Boshkoski deklaroi se të pesë kufomat ishin varrosur nga banorët e fshatit po atë pasdite dhe se:

> Forcat maqedonase të sigurisë nuk u lejuan t'u afroheshin të vdekurve për të bërë një hetim.[1743]
>
> […] çka mbetet për t'u vërtetuar është, nëse ata ishin nga Luboteni apo terroristë të ardhur, siç thashë më parë, nga Kosova, apo nga pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë apo Evropës, dhe ka shumë të ngjarë të jetë bërë për të fshehur gjurmët e krimit që kishin kryer. Për hir të zbulimit të së vërtetës, prokurori publik duhet të autorizohet të bëjë

[1738] *Shih* Provën Materiale P362. Megjithatë shih Risto Galevski, i cili thotë se ky takim u zhvillua më 13 gusht 2001, T 3770; 3859-3860.
[1739] Risto Galevski, T 3770; 3859-3860; Prova Materiale P362. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D203.
[1740] Prova Materiale P352, f. 18. *Shih* gjithashtu Peter Bouckaert, T 2993; 3003-3005.
[1741] Duket se kjo nuk përputhet me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ishin vrarë shtatë persona, Dhoma Gjyqësore nuk e gjykon kështu, pasi ka shumë të ngjarë që informacioni të mos ketë qenë i plotë pak pas ngjarjes.
[1742] Prova Materiale P362. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D203.
[1743] Prova Materiale 1D203. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D202.

> zhvarrimin në përputhje me procedurën ligjore, nëqoftëse duam konfirminin e së vërtetës.[1744]

447. Në periudhën pas ngjarjeve në Luboten, Lube Boshkoskit iu paraqitën katër raporte lidhur me ato ngjarje.[1745] Këto raporte iu paraqitën nga 14 deri më 17 gusht 2001, duke e informuar, ndër të tjera, se më 14 gusht 2001, OSBE-ja gjeti pesë kufoma në Luboten, se ato më pas ishin varrosur, dhe se ishin bërë përpjekje të pasuksesshme për këqyrjen e vendit të ngjarjes.

448. Më 5 shtator 2001, Human Rights Watch (HRW) nxori një raport lidhur me ngjarjet në Luboten për periudhën 10 - 12 gusht 2001.[1746] Pjesa më e madhe e raportit përmban një version të supozuar të ngjarjeve në Luboten më 12 gusht 2001 që kanë lidhje me akuzat në këtë çështje.[1747] Burimet në këtë raport janë intervista të kryera prej një përfaqësuesi të HRW-së, Peter Bouckaert, me banorë të Lubotenit nga 18 deri më 29 gusht 2001, njoftime të shtypit, dhe një vizitë e bërë nga Bouckaert në fshatin Luboten më 23 gusht 2001.[1748] Këto rrëfime përmendin vrasjen e disa personave dhe granatimet, të shtëna me armë, dhe djegjen e disa shtëpive në Luboten më 12 gusht 2001. Aty flitet edhe për keqtrajtimin e të arrestuarve në Luboten dhe në postbllokun e Buzallakut më 12 gusht 2001, në spital dhe në stacionet policore të Butelit, Karposhit dhe Proleqes më 12 gusht 2001, si dhe ditët e mëvonshme. Raportohet gjithashtu se një i arrestuar, Atulla Qaili, vdiq në spital pasi ishte rrahur më parë për vdekje. Konkretisht saktësohet se në këto operacione morën pjesë policë të MB-së në varësinë e Lube Boshkoskit dhe se Lube Boshkoski kishte qenë i pranishëm "gjatë gjithë operacionit".[1749]

1744 Prova Materiale P362.

1745 Provat Materiale 1D361; 1D364; 1D373; 1D374.

1746 Prova Materiale P352, "Krimet kundër civilëve. Keqtrajtime nga forcat maqedonase në Luboten, 10-12 gusht 2001"; Prova Materiale P353; Peter Bouckaert, T 2991-2992.

1747 Prova Materiale P352, f. 5-17.

1748 Prova Materiale P352. *Shih* gjithashtu Peter Bouckaert: Informacioni i përfshirë në këtë raport erdhi, veçanërisht, nga intervistat e tij me dëshmitarë okularë, viktima, gazetarë, vëzhgues, figura politike, si dhe deklarata publike të bëra nga zyrtarë maqedonas dhe vëzhgimet e tij personale gjatë vizitës së tij në Luboten më 23 gusht 2001, T 2992. *Shih* gjithashtu Peter Bouckaert, T 3098-3099. U shfrytëzuan gjithashtu pamjet filmike të transmetuara nga MTV-ja më 12 gusht 2001, dhe këto pamje ishin në fakt dëshmia e vetme që sugjeronte se Lube Boshkoski kishte "marrë pjesë plotësisht" në operacion dhe se personat e përfshirë në të ishin nën urdhrat e tij, Peter Bouckaert, T 3074; 3078.

1749 Prova Materiale P352, f. 15. *Shih* më lart, poshtëshënimin 1748. Në raportin HRW Peter Bouckaert citoi gazetarin që foli në televizionin shtetëror maqedonas kur thotë se Lube Boshkoski kishte qenë i pranishëm "gjatë gjithë operacionit", Peter Bouckaert, T 3075.

449. Raporti iu paraqit instancave të ndryshme në Maqedoni, por nuk konfirmohet se ky raport iu dërgua MB-së në mënyrë të drejtpërdrejtë.[1750] Peter Bouckaert nuk u përpoq ta kontaktonte Lube Boshkoskin para publikimit të raportit.[1751]

450. Megjithatë, Lube Boshkoski iu përgjigj me dy deklarata shtypi pretendimeve të raportit të HRW-së. Përpara botimit të raportit, gazeta angleze The Sunday Telegraph mori informacion për përmbajtjen e tij të pritshme,[1752] dhe në një artikull të botuar në gazetë më 16 gusht 2001, përmendeshin paraprakisht akuzat e HRW-së, sipas të cilave, ndër të tjera, fshatarët e përshkruanin operacionin në Luboten si "një operacion policor triditor gjatë të cilit u torturuan dhe u vranë gjakftohtësisht banorë civilë," dhe se, duke iu referuar një reportazhi televiziv, "Lube Boshkoski ishte i pranishëm gjatë gjithë operacionit të forcave maqedonase të sigurisë."[1753] Një artikull i BBC-së i datës 27 gusht 2001 iu referua komenteve të Lube Boshkoskit në Radion Maqedonase për këto pretendime:[1754]

> I hedh poshtë kategorikisht akuzat kundër Ministrisë së Brendshme dhe forcave të rregullta dhe rezerviste të policisë, të cilat gjatë gjashtë mujve të fundit kanë demonstruar kurajë të paparë në mbrojtjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Maqedonisë.

Pas botimit të raportit të HRW-së, për të pati artikuj në gazeta të ndryshme dhe, sipas njoftimeve, organe të ndryshme maqedonase e konsideronin HRW të njëanshme.[1755] Një artikull i BBC-së i datës 6 shtator 2001 citonte Lube Boshkoskin, i cili duke reaguar ndaj raportit, thotë se:[1756]

> Do të paraqes akuza në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, sepse pretendimet e organizatës Human Rights Watch cënojnë jo vetëm dinjitetin e Ministrisë së Brendshme maqedonase, por edhe dinjitetin tim personal.

451. Dhoma Gjyqësore konkludon se edhe sikur të mos kishte patur dijeni më parë, në sajë të raportit të HRW-së Lube Boshkoski u informua për pretendimet shqetësuese lidhur me veprimet e policisë më 12 gusht dhe më pas. Ndonëse raporti, në disa aspekte,

---

1750 Peter Bouckaert, T 2994.
1751 Peter Bouckaert, T 3069; 3076.
1752 Peter Bouckaert, T 3007-3008.
1753 Prova Materiale P354.
1754 Prova Materiale P355.
1755 Prova Materiale P356 (The New York Times, 5 shtator 2001); Prova Materiale P357 (Associated Press, 5 shtator 2001); Prova Materiale P358 (The Times, 6 shtator 2001).
1756 Prova Materiale P359.

bie ndesh me dëshmitë e hollësishme të paraqitura në këtë proces gjyqësor, gjë që është diskutuar në këtë Aktgjykim,[1757] lloji dhe rëndësia e pretendimeve si dhe ekzistenca e bazës së dukshme faktuale për to, ishin të mjaftueshme për të tërhequr vëmendjen e Lube Boshkoskit mbi gjasën e veprimeve të paligjshme të vartësve të tij.

(c) Çështje të tjera

452. Në nëntor 2001, në komentet e tij paraqitur qeverisë për një projekt-rezolutë propozuar nga një grup deputetësh të Partisë së Prosperitetit Demokratik për dënimin e ngjarjeve dhe përdorimin e forcës nga anëtarët e MB-së, Lube Boshkoski theksonte se abuzimet e policëve ishin hetuar nga drejtoria e kontrollit të brendshëm të MB-së në lidhje me të cilin Dhoma Gjyqësore vë në dukje se për këtë kontroll nuk ekziston asnjë dokument dhe asnjë dëshmi konfirmuese. Ai shtonte se numri i rasteve të abuzimeve ishte "qartësisht i pakrahasueshëm dhe jo shqetësues në numër" në raport me numrin e sulmeve kundër policëve.[1758]

453. Më 3 shtator 2001, me kërkesë të gjykatësit hetues, shefi i OVR-së së Çairit paraqiti një përmbledhje të ngjarjeve nga 10 deri më 13 gusht 2001 në Luboten. Në këtë përmbledhje, ndër të tjera përfshihej informacioni se më 12 gusht 2001, "forcat e armatosura vepruan për të shpartalluar dhe kapur grupin terrorist që vepronte në fshatin Luboten," dhe se ishin arrestuar afërsisht 70 persona.[1759]

454. Më pas, më 7 shtator 2001, drejtori i drejtorisë së sigurisë publike (PSB) në MB propozoi që të bëhej zhvarrimi.[1760] Mbi bazën e këtij propozimi, Zëvëndësprokurori Publik paraqiti kërkesë për zhvarrim më 11 shtator 2001.[1761] Në një takim më 14 shtator 2001, gjykatësi hetues Dragan Nikolovski dhe Zëvendësprokurori publik, i kërkuan MB-së informacion për vendndodhjen e varreve dhe identitetin e personave të varrosur në

[1757] *Shih* më lart, para. 140.
[1758] Prova Materiale P531.
[1759] Provat Materiale P50.009; P50.010.
[1760] Provat Materiale 1D47; P102; 1D33. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D73.
[1761] Prova Materiale 1D47; Dragolub Çakiq dëshmoi se në detyrën e tij si zëvëndësprokuror, ai ia paraqiti këtë propozim gjykatësit hetues rreth datës 15 gusht, Prova Materiale P388, para. 7. Mirëpo Dhoma Gjyqësore vë në dukje se gjykatësi hetues i referohet vetëm një propozimi nga MB-ja i datës 7 shtator 2001 dhe një propozimi nga zëvendësprokurori publik, i datës 11 shtator 2001, Prova Materiale 1D47.

mënyrë që të përgatitej zhvarrimi.[1762] Mirëpo zhvarrimi i personave të vrarë në Luboten më 12 gusht 2001 dhe i Atulla Qailit, që vdiq në spital më 13 gusht 2001, u bë vetëm në prill 2002, nën mbikqyrjen e Gjykatësit Hetues dhe Zëvendësprokurorit publik. Të pranishëm ishin përfaqësues të Prokurores së TPNJ-së.[1763]

455. Gjatë muajve ndërmjetës nga shtatori 2001 deri në prill 2002 pati disa takime me pjesëmarrjen e gjykatësit hetues, prokurorit publik apo zëvendësit të tij, Prokurores së TPNJ-së apo zëvendësit të saj, dhe të tjerëve. Në takimet e zhvilluara në nëntor 2001, Zëvendësprokurori Publik foli për vështirësitë e hasura prej hetuesve për vdekjet në Luboten, për sigurinë dhe pamundësinë për të shkuar në vendin e krimit,[1764] si dhe për problemin e marrjes së informacionit nga dëshmitarët shqiptarë.[1765] Më 30 janar 2002, Gjykatësi Hetues tha se kishin informacion për vrasjen e disa personave, por asnjë informacion për identitetin e tyre.[1766] Mirëpo në mars 2002, Zëvendësprokurori Publik i dha Gjykatësit Hetues emrat e të vdekurve dhe propozoi paraqitjen e kërkesës për zhvarrim dhe këqyrjen e vendit të ngjarjes.[1767]

456. Në takimin e 28 nëntorit 2001, sipas procesverbalit të asaj kohe Zëvendësprokurori Publik bëri të ditur :

> […] hetimi për Lubotenin kishte filluar pavarësisht nga mungesa e informacionit të nevojshëm për një gjë të tillë. Ata kishin pritur një kohë të gjatë të merrnin informacion nga Ministria e Brendshme. Megjithatë, ai theksoi se kishte qenë në kontakt me profesorin Duma të Institutit Kriminalistik (Shkup).
>
> Ata nuk kishin qenë në gjendje të vizitonin vendin e vrasjeve për të kryer këqyrjen e "vendit të ngjarjes", apo të vizitonin vendndodhjen e varreve të viktimave. Nuk ishte bërë asnjë intervistë me të afërmit e viktimave dhe asnjë hetim i dëshmitarëve të tjerë të mundshëm (probleme sigurie). Ai theksoi se ai dhe kolegët e tij ishin të gatshëm të fillonin hetimet sapo të krijoheshin kushtet. Por ai nuk mund të shkonte në atë zonë për aq kohë sa nuk ishin zgjidhur problemet e sigurisë. Z. Sokiq shpjegoi se kishte përjetuar personalisht momentin kur për pak "ishte hedhur në erë" gjatë një misioni të ngjashëm dhe e konsideronte veten me fat që kishte shpëtuar.[1768]

[1762] Prova Materiale 1D73.
[1763] Prova Materiale P55.20.
[1764] Prova Materiale 1D197.
[1765] Prova Materiale 1D196.
[1766] Prova Materiale 1D37.
[1767] Provat Materiale P55.10; P55.11. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se tashmë më 14 gusht 2001 një banor i Shkupit i kishte dhënë OVR-së së Çairit emrat e personave të vdekur në Luboten, Prova Materiale P148. Mirëpo nuk ekzistojnë prova që të sugjerojnë se Lube Boshkoski kishte dijeni që MB-ja e kishte këtë informacion dhe se ky informacion nuk i ishte kaluar organeve gjyqësore.
[1768] Prova Materiale 1D197.

Lidhur me hetimin e çështjes së Lubotenit, i njëjti zëvendësprokuror publik dëshmoi se:[1769]

> Qëllimi ynë nuk ishte të sqaronim se çfarë kishte ndodhur në Luboten. Qëllimi ynë ishte vetëm të kryenim zhvarrimin dhe të identifikonim personat e varrosur në varrezën e fshatit Luboten.

Një zëvendësprokurore tjetër publike, Vilma Ruskovska, dëshmoi se:[1770]

> Nuk u bë asnjë përpjekje për të biseduar apo intervistuar ndonjë nga policët që ishin dislokuar në Luboten. Në rrethana normale unë mund t'i thërrisja policët që të dëshmonin. Por gjatë luftës në vitin 2001, policët gjithnjë refuzonin të dëshmonin për çështje të tilla. Sa herë që kërkonim paraqitjen e një polici për të dëshmuar, na thuhej: "Zyrtarisht nuk është më në këtë detyrë dhe nuk mund të përgjigjet." Kishte një problem institucional. Në atë kohë nuk patëm asnjë mbështetje nga Ministria e Brendshme për paraqitjen e policëve për të dëshmuar.

Prokurorja e TPNJ-së vazhdoi përçapjet për ngjarjet në Luboten gjatë muajve të fundit të vitit 2001 dhe gjatë vitit 2002. U zhvilluan takime me Presidentin,[1771] Prokurorin Publik,[1772] Ministrin e Drejtësisë,[1773] Gjykatësin Hetues dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë. Gjatë një vizitë në IRJM më 8 maj 2002, Prokurorja e TPNJ-së informoi autoritetet maqedonase se kishte vendosur të ushtronte përparësinë e juridiksionit të Tribunalit për pesë çështje të IRJM-së, ndër të cilat edhe çështja e Lubotenit.[1774] Mirëpo Prokurori Publik i IRJM-së shprehu mendimin se ata nuk do të ndërprisnin hetimet për aq kohë sa nuk kishte ende kërkesë nga një prej Dhomave Gjyqësore të këtij Tribunali për transferimin e këtyre çështjeve.[1775] Natyrisht, nuk i takon Prokurorit të TPNJ-së të deklarojë ushtrimin e përparësisë së juridiksionit; për këtë ekziston një procedurë gjyqësore. Për këtë arsye, më 4 tetor 2002, një Dhoma Gjyqësore e këtij Tribunali nxori një vendim duke kërkuar transferimin, ndër të tjera, e çështjes së Lubotenit në TPNJ.[1776]

1769 Dragolub Çakiq, Prova Materiale P388, para. 8.
1770 Vilma Ruskovska, Prova Materiale P235, para. 13.
1771 *Shih* Provën Materiale 1D206; Howard Tucker, T 5429-5431.
1772 Prova Materiale 1D206; Howard Tucker, T 5421-5424. TPNJ-ja ndoshta e kishte çështjen e Lubotenit në vëmendjen e vet që në gusht 2001, *Shih* Provën Materiale 1D204. Duket se Prokurorja e TPNJ-së nisi hetimet më 20 nëntor 2001, Prova Materiale 1D366, ose edhe më 9 nëntor 2001, Prova Materiale P391, ERN N000-9885.
1773 Prova Materiale 1D195.
1774 Prova Materiale P391. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D201.
1775 Prova Materiale P391, Shtojca F. (letër nga Z. Dzikov adresuar Prokurores së TPNJ-së, datë 14 gusht 2002); Prova Materiale P391, Shtojca H (letër nga Z. Dzikov prokurores së TPNJ-së datë 2 shtator 2002).
1776 Prova Materiale 1D218.

457. Mirëpo Dhoma Gjyqësore thekson se Aktakuza e akuzon Lube Boshkoskin vetëm se deri në fillim të majit 2002 ai nuk ndërmori asnjë veprim për ndëshkim.[1777] Kjo duket se shpjegon pretendimin për ushtrimin e përparësisë së juridiksionit paraqitur nga Prokurorja e atëhershme e TPNJ-së më 8 maj 2002, siç përmendet më sipër.

458. Duke u paraprirë çështjeve vijuese, Dhoma Gjyqësore konkludon se përfshirja e Prokurores së TPNJ-së në këtë çështje nuk pati asnjë ndikim ndaj detyrimit të Lube Boshkoskit për ndëshkimin e vartësve të tij, sipas kuptimit të pranuar në jurisprudencën e këtij Tribunali, për krimet e akuzuara në këtë Aktakuzë deri në maj të vitit 2002.

(d) "Hetime" të tjera

(i) Grupi i punës për krimet e luftës

459. Mbrojtja e Boshkoskit iu referua veprimit të Lube Boshkoskit, i cili, më 29 maj 2001,[1778] krijoi një grup pune për grumbullimin e provave për krime lufte të kryera në territorin e IRJM-së.[1779] Mirëpo grupi i punës filloi të punojë për çështjen e Lubotenit vetëm në vitin 2002.[1780] Lube Boshkoski u informua rregullisht për punën e grupit të punës.[1781]

460. Dëshmitari Igno Stojkov, anëtar i grupit,[1782] dëshmoi se lidhur me këtë çështje, detyra ishte të merrnin dhe të dorëzonin të gjitha dokumentat dhe të dhënat lidhur me ngjarjet në Luboten; çfarë kishte ndodhur atë ditë, nëse kishte patur arrestime dhe ku ishin çuar personat e arrestuar, kush ishin ata, dhe si ishte vepruar me ta.[1783] U konstatua se në stacionet policore nuk kishte asnjë denoncim nga palët e dëmtuara.[1784] Ekipi hetimor foli me policët të cilët thanë se ngjarjet ishin dokumentuar në nota zyrtare, të cilat i ishin dërguar seksionit të analizës në stacionin policor të Çairit. Ekipi kërkoi të

1777 Aktakuza, para. 15. Në Dosjen Përfundimtare të Prokurorisë kjo sqarohet për 14 maj 2002, para. 388 (duke iu referuar Provës Materiale P391, f. 18, ERN N000-9900).
1778 *Shih* Provën Materiale 1D116.
1779 Prova Materiale 1D115.
1780 Igno Stojkov, T 9043.
1781 Igno Stojkov, T 8957.
1782 Igno Stojkov, T 8874-8876; 8878; 8953; Prova Materiale 1D116.
1783 Igno Stojkov, T 9031.
1784 Igno Stojkov, T 8900-8901; 9031.

bënte intervista zyrtare me policët, por këta të fundit nuk pranuan.[1785] U vendosën disa kontakte me persona nga Luboteni, por kur u kërkua informacion më i detajuar, këta persona nuk dëshironin të kishin kontakt me organet policore.[1786] Grupi i punës nuk shkoi në spital për të marrë dokumenta mjekësore, pasi u mendua se kjo nuk ishte detyrë e tij.[1787] Sipas Igno Stojkovit, dosja përfundimtare e çështjes së Lubotenit përfshinte vetëm vizitën në stacionet policore të Mirkocit dhe Çairit, si dhe notën zyrtare të veprimtarisë së grupit të punës.[1788] Kjo dosje e Lubotenit u transferua së bashku me të gjitha dosjet e tjera në drejtorinë e analizës së MB-së.[1789]

461. Grupi i punës nuk u ngarkua të trajtonte të gjitha çështjet përkatëse dhe kishte kompetenca të kufizuara, të pamjaftueshme për mbledhjen e provave për procedim të mundshëm penal. Grupi i punës nuk mund ta përdorte informacionin nëqoftëse ky informacion nuk ishte dokumentuar në ministri,[1790] rrjedhimisht grupi i punës nuk ishte i autorizuar të kontaktonte politikanët shqiptarë, OSBE-në ose organizata të tjera,[1791] apo të verifikonte informacionin e grumbulluar, ndër të tjera, nga organizatat ndërkombëtare[1792] Ai madje nuk ishte autorizuar të kontaktonte as edhe drejtorinë e analizës në MB, e cila kishte grumbulluar prova nga shërbime të ndryshme në ministri.[1793] Mirëpo Dhoma Gjyqësore vë në dukje se këto kufizime në pushtetin dhe kompetencat e grupit të punës ekzistonin për shkak të programit statutor mbi bazën e së cilave grupi u krijua nga Lube Boshkoski. Po të dëshironte, ai mund t'i kishte zgjeruar pushtetin dhe kompetencat e grupit të punës. Ai nuk e bëri një gjë të tillë, pavarësisht se dëshmitë nuk sugjerojnë se një gjë e tillë iu kërkua.

462. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se policët e përfshirë në ngjarjet në Luboten, të cilët dëshmuan para Dhomës Gjyqësore, thanë se ishin kontaktuar nga autoritetet maqedonase lidhur me ngjarjet në Luboten.[1794] Për më tepër, ndonëse tha se kishte

[1785] Igno Stojkov, T 8897; 9023. *Shih* gjithashtu T 8900; 8905; 8931.
[1786] Igno Stojkov, T 8937.
[1787] Igno Stojkov, T 8929.
[1788] Igno Stojkov, T 8939; 9044-9045. Bisedat jozyrtare me policët nuk u incizuan, Igno Stojkov, T 9045-9046.
[1789] Igno Stojkov, T 9046-9047. Igno Stojkov dëshmoi se dosja e çështjes së Lubotenit nuk u përfundua asnjëherë, T 8943;9019; 9049.
[1790] Igno Stojkov, T 9037.
[1791] Igno Stojkov, T 9053-9054.
[1792] Igno Stojkov, T 9050; 9051-9053.
[1793] Igno Stojkov, T 9017.
[1794] M084, T 1482; M037, T 871; M052, T 8369.

kontaktuar persona në Luboten, Igno Stojkov nuk pranoi të jepte emrat e tyre.[1795] Rrjedhimisht këto kontakte nuk mund të verifikohen. Provat tregojnë se grupi i punës nuk kreu hetim të efektshëm të ngjarjeve të Lubotenit. Shumë-shumë, ai grumbulloi disa dokumenta ekzistuese nga stacionet policore.[1796]

(ii) Puna e Zj. Sofija Galeva-Petrovska

463. Sofija Galeva-Petrovska, juriste, por në atë kohë stazhiere mjaft e re në MB,[1797] duket se ra në sy për mirë te Lube Boshkoski, i cili në një takim në fund të prillit 2002,[1798] i tha drejtorit Mitevski se dëshmitarja duhej angazhuar në çështjen e Lubotenit.[1799] Ajo dëshmoi se detyra e saj ishte të grumbullonte materiale të MB-së lidhur me çështjen e Lubotenit, të përgatiste një kronologji të ngjarjeve, dhe t'ia dorëzonte këto materiale drejtorëve dhe Ministrit.[1800] Lube Boshkoski sugjeroi që të caktohej një nga shefat e sektorëve të MB-së për t'ju përgjigjur pyetjeve që ajo mund të kishte për çështje konkrete në mënyrë që ajo "të mos sorollatet shumë në këtë çështje."[1801] Më 1 qershor 2002, Galeva-Petrovska u ngrit në pozitë duke u emëruar këshilltare në kabinetin e Lube Boshkoskit.[1802]

464. Sofija Galeva-Petrovska tha se kishte grumbulluar materiale nëpërmjet kontakteve me shumë zyrtarë të lartë të MB-së,[1803] si dhe me drejtorin e Institutit Kriminalistik, profesorin Aleksej Duma,[1804] dhe Gjykatësin Hetues Dragan Nikolovski.[1805] Sipas Zj. Galeva-Petrovska, të gjithë ata i dhanë informacion, si me shkrim po ashtu dhe gojor.[1806]

465. Dhomës Gjyqësore nuk iu paraqit ndonjë material me shkrim për punën e Zj. Galeva-Petrovska, çka do të kishte vërtetuar dëshminë e saj. Nuk ka procesverbale për

[1795] Igno Stojkov, T 9033-9034.
[1796] Igno Stojkov, T 9065-9066.
[1797] Sofija Galeva-Petrovska, T 8687-8689. Sofija Galeva-Petrovska ishte e punësuar në Ministrinë e Brendshme prej 1 prillit 2002, T 8714; 8767.
[1798] Sofija Galeva-Petrovska, T 8697.
[1799] Sofija Galeva-Petrovska, T 8698; 8774.
[1800] Sofija Galeva-Petrovska, T 8702; 8778; 8784.
[1801] Sofija Galeva-Petrovska, T 8703-8704; 8803.
[1802] Sofija Galeva-Petrovska, T 8690; 8693; 8770.
[1803] Sofija Galeva-Petrovska, T 8696; 8699; 8702; 8709-8710; 8738; 8739; 8748-8750; 8751; 8752; 8792-8793; 8820; 8846-8847.
[1804] Sofija Galeva-Petrovska, T 8732; 8812; 8825.
[1805] Sofija Galeva-Petrovska, T 8734-8735; 8736; 8825; 8841.
[1806] Sofija Galeva-Petrovska, T 8696; 8700; 8702; 8709-8710; 8720; 8728-8729; 8733; 8740-8741; 8745; 8748-8750; 8825; 8846-8847.

ndonjë nga takimet e shumta që sipas saj, ajo pati me zyrtarë të lartë në MB dhe me personat e tjerë që i dhanë informacione.[1807] Për më tepër, ndonëse dëshmitarja deklaroi se ia kishte dorëzuar të gjitha materialet prokurorit publik në gusht/shtator 2002,[1808] ajo tha gjithashtu se deri në atë moment këto materiale ishin në një regjistër në një dosje sipas rendit kronologjik.[1809] Mirëpo nuk u paraqit asnjë provë për dokumentat që, sipas dëshmitares, ajo grumbulloi gjatë punës së saj. Rrëfimi i saj nuk konfirmohet nga dëshmi të tjera të pranuara nga Dhoma Gjyqësore.

466. Zj. Galeva-Petrovska është aktualisht nëpunëse në Ministrinë e Brendshme.[1810] Ajo ka qenë anëtare e së njëjtës parti politike të cilës i përkiste Lube Boshkoski[1811], dhe gjatë dhënies së dëshmisë së saj, ajo krijoi përshtypjen e qartë se e ndjente si detyrë se duhej të mbronte interesat e tij. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se edhe gjashtë vjet pas ngjarjeve, dëshmitarja çuditërisht, ende pretendon se i kujtohet një numër i caktuar dokumentash që mori gjatë punës së saj si dhe prej kujt i mori ato.[1812] Po kaq çuditërisht, dëshmitarja pretendon se asaj i kujtohen disa diskutime konkrete me hollësi, megjithëse që nga ajo kohë kanë kaluar gjashtë vjet.[1813] Ajo dëshmoi gjithashtu se megjithëse Z. Duma, drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore i kishte thënë se informacioni që kishte kërkuar nuk mund t'i jepej me shkrim MB-së, por vetëm gjykatës,[1814] gjithsesi ajo e mori këtë informacion gojarisht nga Z. Duma.[1815] Më tej, informacioni gojor që ajo pretendon se mori nga Z. Uslinkovski, Shef i Sektorit Kriminalistik në MB, bie ndesh me aktautopsitë e Institutit të Mjekësisë Ligjore.[1816] Më e pakta, pretendimet për marrje informacioni gojor janë të habitshme, veçanërisht kur thuhet se këto informacione u

[1807] Sofija Galeva-Petrovska, T 8814.
[1808] Sofija Galeva-Petrovska, T 8756-8757; 8814.
[1809] Sofija Galeva-Petrovska, T 8754-8755.
[1810] Sofija Galeva-Petrovska, T 8695.
[1811] Sofija Galeva-Petrovska, T 8774.
[1812] Sofija Galeva-Petrovska, T 8704-8706 (Prova Materiale 1D136 nga Znj. Jovanovska); 8716 (Prova Materiale P46.16 nga Z. Mitevski); 8716-8718 (Prova Materiale P23 nga Z. Stojanovski); 8717-8718 (Prova Materiale P46.15); 8723 (Prova Materiale P102, një propozim për zhvarrim nga Z. Mitevski); 8724 (Prova Materiale 1D46 nga Z. Mitevski); 8724-8725 (Prova Materiale 1D47 nga Z. Mitevski); 8726 (Prova Materiale 1D73 nga Z. Uslinkovski); 8730 (Prova Materiale P55.20 nga sektori i policisë kriminaliste); 8743 (Prova Materiale P50.010 nga Z. Stojanovski); 8743-8744 (Prova Materiale P261 nga Z. Stojanovski).
[1813] Sofija Galeva-Petrovska, T 8721-8722.
[1814] Sofija Galeva-Petrovska, T 8732.
[1815] Sofija Galeva-Petrovska, T 8732-8733; 8735-8736.
[1816] Sofija Galeva-Petrovska dëshmoi se Z. Uslinkovski tha se disa nga kufomat ishin të veshura me bluza kamuflimi me mëngë të shkurtra, T 8730-8732. Ajo dëshmoi gjithashtu se Z. Duma dhe Z. Nikolovski e konfirmuan këtë, T 8825. Në raportet e autopsies nuk figuron një informacion i tillë (Provat Materiale P49, P444-P452, 1D5, 1D74, 1D77 dhe 1D78).

dhanë nga një person në pozitën e Z. Duma dhe siç u sugjerua, kur thuhet se këto informacione iu dhanë një stazhiereje shumë të re në ministri. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se ngjarja e Lubotenit ishte shumë e rëndësishme dhe Lube Boshkoski ishte nën presion ndërkombëtar për implikimin e tij në të si dhe për mosmarrjen e masave për hetimin e saj. Gjithsesi dëshmitarja sugjeron se asaj iu dhanë kompetenca të plota për mbledhjen e të tëra provave lidhur me këtë çështje. Për këto arsye, si dhe duke patur parasysh vlerësimin e besueshmërisë së saj si dhe mungesën e konfirmimit të pavarur prej provave dokumentare apo gojore, Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë si të besueshme dëshminë e Zj. Galeva-Petrovska lidhur me punën e saj dhe informacionin që mori. Ajo mund të ketë grumbulluar dokumenta ekzistuese në MB për çështjet në Luboten dhe ngjarjet lidhur me to, mirëpo në këtë moment këto dokumenta nuk janë të disponueshme për ta ndihmuar Tribunalin në këtë proces gjyqësor, dhe Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të konkludojë se Zj. Galeva-Petrovska ia dha këto informacione prokurorit publik, siç pretendoi dëshmitarja. Sidoqoftë ajo e filloi punën e saj vetëm pak ditë para përfundimit të periudhës së Aktakuzës, dhe, siç e përshkroi ajo, roli i saj ishte të grumbullonte materiale në mënyrë që prokurori publik t'ia përcillte Prokurores së TPNJ-së.[1817] Në këto rrethana, çfarëdo që bëri ajo ka pak lidhje të drejtpërdrejtë me veprimet e Lube Boshkoskit nga 12 gusht 2001 deri në maj 2002.

(iii) Komisioni Zoran Jovanovski

467. Më 18 qershor 2001, Lube Boshkoski nxori një urdhër për krijimin e një komisioni për të:

> hetuar vlefshmërinë e informacioneve nga shqiptarët etnikë në Republikën e Maqedonisë, sipas të cilave anëtarët e Ministrisë së Brendshme tejkaluan kompetencat e tyre.[1818]

Sipas Zoran Jovanovskit,[1819] Komisioni punoi për masat parandaluese, por nuk iu paraqit asnjë ankesë për ngjarje apo persona konkretë.[1820]

[1817] Sofija Galeva-Petrovska, T 8814.

[1818] Prova Materiale 1D113. Zoran Jovanovski mori pjesë gjithashtu në një komision tjetër të ngritur më 7 mars 2003, nga pasuesi i Lube Boshkoskit, Hari Kostov, i kryesuar nga Zoran Jovanovski, për të hetuar ngjarjet në Luboten, *Shih* Provën Materiale P379.05. Ky komision nuk arriti të konkludojë se çfarë ndodhi në Luboten, dhe as se kush ishte përgjegjës, Zoran Jovanovski, T 5026-5028; 5050; 5060. *Shih* gjithashtu *më poshtë*, para. 556-557.

[1819] Nuk ka lidhje me Zoran Jovanovskin, me nofkën Buçuk.

4. Përgjegjësia e Lube Boshkoskit

(a) Struktura organizative e Ministrisë së Brendshme

468. Ministria e Brendshme ("MB") merrej, ndër të tjera, me çështje lidhur me zbatimin e sistemit të sigurisë shtetërore dhe publike,[1821] duke përfshirë ruajtjen e qetësisë dhe rendit si dhe parandalimin dhe zbulimin e krimeve.[1822]

469. Ministri i Brendshëm ishte kreu i organizimit të brendshëm të MB-së.[1823] Menjëherë nën Ministrin, në majën hierarkike të MB-së vinin Zëvendësministri dhe Sekretari i Shtetit.[1824]

470. Rregullorja e Organizimit dhe Punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme ("Rregullorja për Organizimin") përcakton organizimin e brendshëm të MB-së, pa drejtorinë e sigurimit dhe kundërzbulimit, "format organizative dhe fushën e punës së tyre, menaxhimin e formave organizative, përgjegjësinë në realizimin e punës dhe detyrave, si dhe çështje të tjera lidhur me organizimin dhe punën e ministrisë".[1825] Struktura formale e MB-së paraqitej në një organigramë, e cila ishte pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.[1826]

471. Zyra e sigurisë publike (PSB) dhe drejtoria e sigurimit dhe kundërzbulimit (ose sigurimi i shtetit) (UBK), ishin organe brenda strukturës së MB-së.[1827] Disa dëshmitarë sugjeruan se PSB-ja dhe UBK-ja ishin tërësisht të shkëputura nga ministria;[1828] Dhoma Gjyqësore nuk mund t'a pranojë këtë sugjerim. UBK-ja dhe PSB-ja drejtohen nga një drejtor,[1829] i cili emërohet dhe shkarkohet nga qeveria[1830] me propozim të Ministrit të

1820 Zoran Jovanovski, T 4886-4887.
1821 Prova Materiale P92, Neni 16 (1).
1822 Prova Materiale P86, Neni 1. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P86, Neni 2.
1823 Provat Materiale 1D107, Neni 2; *Shih* më poshtë, para. 510; 514.
1824 Provat Materiale 1D107, Neni 28; 1D65; M056, T 2132.
1825 Prova Materiale 1D107, Neni 1. *Shih* gjithashtu Risto Galevski, T 3647-3648; 3653; Zoran Jovanovski, T 4864.
1826 Provat Materiale 1D107, Neni 28; 1D65. *Shih* gjithashtu Petre Stojanovski, T 9111.
1827 Prova Materiale P92, Neni 16(2); Vesna Dorevska, T 9409-9410. Për PSB në veçanti, *Shih* Provën Materiale 1D107, Neni 28; Prova Materiale 1D65. Për UBK në veçanti, *Shih* Provën Materiale P86, Neni 2.
1828 Petre Stojanovski, T 9077; Risto Galevski, T 3650-3653; Prova Materiale 1D310, para. 29 dhe 71; Slagjana Taseva, T 9701-9704; 9742-9743; 9750-9751;Vesna Dorevska, T 9642-9643.
1829 Provat Materiale 1D107, Neni 2(2); P86, Neni 13(3).

Brendshëm.[1831] Drejtorët e UBK-së dhe PSB-së janë anëtarë të kolegjiumit, organ këshillimor për Ministrin, ku përfshihen edhe zëvendësministri, drejtorët e drejtorive të policisë dhe policisë për krime si dhe sekretari i shtetit,.[1832] Natyra e përgjegjësive të UBK-së për sigurinë dhe kundërzbulimin shpjegon arsyen e hartimit të dispozitave të veçanta për funksionimin e këtij organi.[1833] Duket se në disa dëshmi sugjerohet se kolegjiumi ishte organi vendimmarrës i Ministrisë dhe madje edhe vetë Ministri nuk mund të merrte vendim pa mbështetjen e kolegjiumit.[1834] Mirëpo nga dispozitat statutore është e qartë se kolegjiumi ishte thjesht një organ këshillimor për Ministrin.[1835]

472. Për zbatimin e detyrave brenda kompetencës së PSB-së, punonin drejtoria e policisë, drejtoria e policisë për krime si dhe disa struktura organizative të pavarura.[1836] Detyrat e policisë ishin:

> ruajtja e drejtpërdrejtë e qetësisë dhe rendin publik, rregullimi dhe kontrolli i qarkullimit rrugor, kontrolli i kalimit të kufirit shtetëror, sigurimi i personave dhe objekteve të veçanta, siguria e liqeneve, si dhe detyra të tjera të përcaktuara në Nenin 1 të Ligjit për Punët e Brendshme, natyra dhe kushtet e të cilave kërkojnë që të kryhen nga policia me uniformë e Ministrisë.[1837]

473. Detyrat e policisë për krime ishin:

> veprime për parandalimin e veprave penale, zbulimi dhe kapja e autorëve të veprave penale, veprime teknike në lidhje me krimet, kontrolli i qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, inspektimi dhe mbikqyrja e mbrojtjes kundër zjarrit dhe lëndëve shpërthyese, si dhe veprime të tjera të përcaktuara në Nenin 1 të këtij Ligji.[1838]

1830 Vesna Dorevska, T 9411; 9517; 9520. *Shih* gjithashtu Zoran Jovanovski, T 4866; M083, T 1413-1414; Tatjana Grosheva, T 4749-4750; Petre Stojanovski, T 9110; Slagjana Taseva, T 9709-9710; 9740-9741; Prova Materiale 1D105. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P552, Neni 96(7).

1831 Risto Galevski, T 3648-3650; Vesna Dorevska, T 9411; 9517; 9520.

1832 Prova Materiale 1D107, Neni 26(1) dhe (2).

1833 *Shih* Provën Materiale 1D297.

1834 Vesna Dorevska, T 9566; Zoran Jovanovski, T 4855-4856; 4869; 5104. *Shih* gjithashtu Sofija Galeva-Petrovska, T 8862.

1835 Prova Materiale 1D107, Neni 26(1).

1836 Prova Materiale 1D107, Nenet 3 dhe 28; Prova Materiale 1D65, f. 3. *Shih* gjithashtu Petre Stojanovski, T 9081; Zoran Jovanovski, T 4865; Vesna Dorevska, T 9421.

1837 Provat Materiale 1D107, Neni 4(1); P86, Neni 8. *Shih* gjithashtu Zoran Jovanovski, T 4865; Risto Galevski, T 3645-3647.

1838 Prova Materiale P86, Neni 12. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D107, Neni 5; Zoran Jovanovski, T 4865.

474. Policia me uniformë[1839] dhe policia për krime përbëjnë policinë e rregullt.[1840] Ata ishin të punësuar rregullisht, merrnin pagë për punën e tyre,[1841] dhe sipas ligjit, krahas Ministrit, ishin "zyrtarë të autorizuar" në MB.[1842] Të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve të autorizuar si dhe mënyra si duhej të kryenin punën e tyre, ishin të përcaktuara në rregulloren e nxjerrë nga Ministri i Brendshëm.[1843] Disa dëshmitarë dëshmuan se jo çdo zyrtar i autorizuar i kishte të gjitha kompetencat që u akordoheshin zyrtarëve të autorizuar në bazë të ligjit.[1844] Veçanërisht u pretendua se Ministri nuk ishte i autorizuar të kryente detyra operative, siç ishin detyrat e policisë për krime.[1845] Mirëpo nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që kufizon në ndonjë mënyrë kompetencat e Ministrit si zyrtar i autorizuar.[1846] Ndonëse këto detyra, normalisht, duhej të kryheshin prej vartësve të tij, Dhoma Gjyqësore mendon se Ministri ishte formalisht i autorizuar t'i kryente detyrat e caktuara një "zyrtari të autorizuar" në Ministri.

475. Drejtuesit e drejtorisë së policisë dhe drejtorisë së policisë për krime ishin nën varësinë e drejtorit të PSB-së dhe jepnin llogari para tij.[1847]

476. Gjatë periudhës në fjalë, drejtor i PSB-së ishte gjeneral Goran Mitevski.[1848] Drejtori i drejtorisë së policisë ishte gjeneral Risto Galevski,[1849] dhe zëvendës i tij ishte kolonel Zoran Jovanovski.[1850] Drejtori i drejtorisë së policisë për krime ishte Zhivko Petrovski.[1851]

1839 Prova Materiale P86, Neni 8; M037, T 751. *Shih,* megjithatë, Provën Materiale P86, Neni 10(1): "Policët mund të kryenin veprimet e përmendura në Nenin 8 të këtij ligji të veshur civilë si dhe nëqoftëse kjo urdhërohej nga eprori i drejtpërdrejtë apo punonjësi i autorizuar prej tij". *Shih* gjithashtu M037 i cili dëshmoi se një polic pa unformë mund të ricaktohej në një nga drejtoritë apo sektorët e punëve të brendshme nga Ministri apo një person i autorizuar prej tij, T 750-751.

1840 Zoran Jovanovski, T 4865. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P86, Nenet 8-10 dhe 12; M083, T 1415-1417.

1841 M083, T 1415-1417. Për pozitën e policëve rezervistë, *Shih* më poshtë, para. 492-494.

1842 Prova Materiale P86, Neni 24. *Shih* gjithashtu M037, T 810; Risto Galevski, T 3647-3648; Petre Stojanovski, T 9086. *Shih* më poshtë, para. 513.

1843 Prova Materiale P86, Neni 25 *et seq.*; Prova Materiale P96.

1844 Tatjana Grosheva, T 4745; Vesna Dorevska, T 9433-9434; Slagjana Taseva, T 9723-9726.

1845 Risto Galevski, T 3647-3648; Vesna Dorevska, T 9434: Slagjana Taseva, T 9723-9729; Petre Stojanovski, T 9106.

1846 Vesna Dorevska tha se kompetencat e zyrtarëve të autorizuar ishin të rregulluar me akte nënligjore, si Rregullorja për Organizimin dhe Kategorizimin e Vendeve të Punës, T 9432. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se kjo rregullore nuk përfshihet në prova.

1847 Provat Materiale 1D107, Neni 28; 1D65, f. 3; Vesna Dorevska, T 9531; 9532-9534. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D107, Nenet 21(2) dhe 22; Zoran Jovanovski, T 5077; Petre Stojanovski, T 9213-9215.

1848 Zoran Jovanovski, T 4866; M056, T 2132; Vesna Dorevska, T 9418; Prova Materiale 1D105.

1849 Risto Galevski, T 3642-3643; 3576; Zoran Jovanovski, T 4832-4833; 4866.

1850 Zoran Jovanovski, T 4832-4833; 4863; 4866.

1851 Risto Galevski, T 3846-3848.

477. Në Ministri ishte gjithashtu sektori për sigurinë[1852] nga i cili varej stacioni policor PSOLO. Ky sektor garantonte sigurinë e personave të tillë, si Presidenti, ministrat, dhe diplomatët, si dhe të ndërtesave të tilla, si parlamenti, ndërtesat qeveritare, dhe ambasadat.[1853] Gjatë periudhës në fjalë drejtor i sektorit për sigurinë ishte Zllatko Keskovski.[1854] I Akuzuari Johan Tarçulovski ishte i punësuar si polic në MB,[1855] më saktësisht detyrat e tij të zakonshme ishin në sektorin për sigurinë, në ekipin për sigurimin e bashkëshortes së Presidentit Boris Trajkovski.[1856] Zoran Trajkovski (jo Presidenti) ishte shefi i sigurimit personal të Lube Boshkoskit.[1857] Ministri i jepte urdhra personalisht Trajkovskit lidhur me sigurinë e tij.[1858]

478. Në MB ishte gjithashtu drejtoria për përgatitjet e mbrojtjes,[1859]dhe sektori për analiza dhe hulumtime.[1860] Ky sektor përpunonte informacionin e marrë nga sektorët rajonalë (SVR-të), dhe përgatiste raporte ditore apo javore të cilat ua dërgonte zyrtarëve të lartë të sigurisë dhe Ministrit, varësisht prej temës së raportit dhe situatës.[1861]

(i) <u>Njësitë organizative rajonale dhe vendore të Ministrisë së Brendshme</u>

479. Për zbatimin e detyrave në punët e brendshme (d.m.th. brenda IRJM-së) ishin krijuar 11 sektorë rajonalë, duke përfshirë sektorin për punët e brendshme për qytetin e Shkupit (SVR e Shkupit).[1862]

480. Drejtuesit e policisë me uniformë dhe policisë për krime kishin funksione koordinuese dhe mbështetëse në lidhje me këta sektorë rajonalë.[1863] Në kunndërshtim me disa dëshmi,[1864] Dhoma Gjyqësore mendon se ligji parashtronte varësinë e ketyre

---

1852 Prova Materiale 1D107, Nenet 6, 6.5 dhe 28; Prova Materiale 1D65. *Shih* gjithashtu Zllatko Keskovski, T 9958; 10071. Sektori ishte i përbërë, ndër të tjera, nga seksioni për sigurinë e Presidentit të IRJM-së, Prova Materiale 1D107, Neni 6.5.1.

1853 Zllatko Keskovski, T 10037-10038; M083, T 1412-1413. *Shih* gjithashtu Zoran Jovanovski, T 4847; Prova Materiale 1D118.

1854 Zllatko Keskovski, T 9948.

1855 Prova Materiale P533. *Shih* gjithashtu Zllatko Keskovski, T 10033-10034; Blagoja Jakovoski, T 3962.

1856 Zoran Trajkovski, T 5549. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D315.

1857 Zoran Trajkovski, T 5502; 5527-5528.

1858 Zoran Trajkovski, T 5503-5504.

1859 Prova Materiale 1D107, Neni 6.8.

1860 Prova Materiale 1D107, Neni 6.1.

1861 Tatjana Grosheva, T 4803-4805.

1862 Prova Materiale 1D107, Neni 8. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D107, Neni 28; M053, T 1957; Vesna Dorevska, T 9423; Petre Stojanovski, T 9082.

1863 Kristo Zdravkovski, T 10233; Vesna Dorevska, T 9532-9534.

1864 Vesna Dorevska, T 9533-9534.

sektorëve prej Ministrisë,[1865] gjë që është e logjikshme, pasi sektorët rajonale ishin të ngarkuar të zbatonin detyrat e Ministrisë, ato detyra për të cilat Ministria nën drejtimin e Ministrit ishte përgjegjëse.[1866]

481. Drejtoria e analizës së SVR-së në Shkup merrte informacione nga OVR-të, dhe çdo ditë ia përcillte këto informacione, të përmbledhura për ngjarjet më të rëndësishme, sektorit të analizës në Ministri.[1867]

482. SVR-ja e Shkupit kishte disa seksione, ndër të cilat qendrën operative në detyrë, seksionin për përgatitjet e mbrojtjes, drejtorinë e luftës kundër krimit të organizuar dhe krimet e përgjithshme, drejtorinë për teknikën e krimeve, dhe drejtorinë për qetësinë dhe rendin publik (OJRM[1868]).[1869] SVR-ja e Shkupit ishte gjithashtu e nënndarë në drejtori sipas shtrirjes gjeografike të disa komunave të qytetit të Shkupit, ndër të cilat, OVR-ja e Qendrës, OVR-ja e Karposhit, OVR-ja në Kisela Voda, dhe OVR-ja e Çairit.[1870]

483. Shefi i SVR-së në Shkup në atë kohë ishte Zoran Efremov.[1871] Efremov ishte epror i të gjithë shefave të OVR-ve të ndryshme,[1872] dhe stacioneve policore në OVR-të.[1873] Në SVR-në e Shkupit, shefi i policisë me uniformë në atë kohë ishte Lupço Bliznakovski, i cili ishte gjithashtu zëvendësi i Efremovit,[1874] dhe jepte llogari para shefit të rendit publik në drejtorinë e policisë.[1875] Zëvendësi i Efremovit për çështjet operative dhe policinë e krimeve, ishte Petre Stojanovski.[1876]

484. Ndonëse ka prova se shefi i OVR-së së Çairit varej drejtpërsëdrejti nga Lupço Bliznakovski dhe Petre Stojanovski,[1877] Petre Stojanovski e mohoi këtë dhe tha se shefi i

---

1865 Prova Materiale 1D107, Nenet 22 dhe 28.
1866 *Shih* më poshtë, para. 513. *Shih* gjithashtu M053, T 1957; Vesna Dorevska, T 9423; Petre Stojanovski, T 9082; M084, T 1487.
1867 Tatjana Grosheva, T 4803-4805. *Shih* gjithashtu M052, T 8242-8244; Prova Materiale 1D107, Neni 9.9. *Shih* raporte të ndryshme nga SVR-ja në periudhën nga 26 qershor 2001 - 15 gusht 2001: Provat Materiale P103; 1D126; 1D127; 1D128; 1D129; 1D131; 1D133; 1D374.
1868 *Shih* M052, T 8602-8607.
1869 Prova Materiale 1D107, Neni 9.1-9.12.
1870 Provat Materiale 1D107, Neni 9.13-9.17; 1D107, f. 22; M037, T 809; M083, T 1411-1412; M084, T 1487. *Shih* gjithashtu M053, T 1976-1977; Petre Stojanovski, T 9242.
1871 M053, T 1976-1977; Petre Stojanovski, T 9088.
1872 Vesna Dorevska, T 9531; M052, T 8417-8420. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D107, f. 22.
1873 M084, T 1486.
1874 Risto Galevski, T 3687; 3776; Petre Stojanovski, T 9148. *Shih* gjithashtu M084, T 1487; M052, T 8240.
1875 Zoran Jovanovski, T 5077. *Shih* gjithashtu Risto Galevski, T 3629; 3763-3766.
1876 M052, T 8415-8416; 8460; Petre Stojanovski, T 9074. *Shih* gjithashtu M084, T 1487.
1877 M052, T 8417-8420.

SVR-së në Shkup ishte eprori i drejtpërdrejtë i shefit të OVR-së në Çair dhe i jepte udhëzime atij, dhe se Stojanovski vetëm ndiqte situatën në OVR-të nga pikëpamja e policisë së krimeve dhe jepte mbështetje, p.sh. për veprime të kriminalistikës, pajisje për hetime në vendngjarje, si dhe i sugjeronte zgjidhje shefit të SVR-së.[1878] Dhoma Gjyqësore konkludon se shefi i SVR-së ishte eprori i drejtpërdrejtë i shefit të OVR-së, por edhe se Petre Stojanovski ushtronte gjithashtu pozitë eprore ndaj shefit të OVR-së në Çair në kuptimin që në momente të caktuara, ai, si zëvendësi i Efremovit, lëshonte urdhra për shefin e OVR-së në Çair.[1879] Faktikisht ka të ngjarë që një zëvendës të ketë patur kompetencë për nxjerrjen e urdhrave. Në rastin konkret të SVR-së në Shkup, duke patur parasysh se Shkupi është kryeqyteti i IRJM-së, është e qartë se Efremovi nuk do të mund të nxirrte të gjitha urdhrat për të gjitha OVR-të në qytetin e Shkupit.

485. Petre Stojanovski dëshmoi gjithashtu se Lupço Bliznakovski nuk mund të lëshonte urdhra për OVR-të,[1880] por Dhoma Gjyqësore nuk mund ta pranojë këtë dëshmi. Petre Stojanovski kishte interes të qartë personal për të dëshmuar në këtë mënyrë, duke synuar të dobësonte lidhjen hierarkike midis SVR-së dhe OVR-së, veçanërisht gjatë ngjarjeve të çështjes. Më tej, ashtu si edhe në rastin e Petre Stojanovskit, nuk do të ishte praktike që një zëvendës i Efremovit të mos mund t'u lëshonte urdhra njësive për të cilat Efremov ishte përgjegjës. Dëshmi të dëshmitarëve të tjerë e mbështesin këtë mendim.[1881]

486. Duke përgjithësuar, Dhoma Gjyqësore vë në dukje se në shumicën e rasteve këto mospërputhje në dëshmi lidhur me pushtetin komandues në strukturat e Ministrisë, duket se pasqyrojnë interesin personal të disa dëshmitarëve për të shmangur përgjegjësinë për veprimet e zyrtarëve të rangjeve më të ulta, të cilat janë të rëndësishme në këtë çështje.

487. OVR-të kishin detyrë të informonin SVR-në për ngjarjet në territorin e OVR-së.[1882] OVR-ja në Çair duhej t'i raportonte rregullisht SVR-së në Shkup,[1883] d.m.th. çdo 12 orë.[1884]

[1878] Petre Stojanovski, T 9083-9085; 9088; 9230-9234.
[1879] Petre Stojanovski, T 9232-9234.
[1880] Petre Stojanovski, T 9148-9149.
[1881] M052, T 8239; 8602-8607.
[1882] Petre Stojanovski, T 9087-9088.

488. Përsa i përket raportimit, me përfundimin e detyrës së tyre, policët duhej të shkruanin Notat Zyrtare ose raportet dhe t'ia paraqisnin ato eprorëve të tyre në stacionin policor.[1885] Stacionet policore i raportonin OVR-së çdo ditë.[1886] Në dallim me disa dëshmi,[1887] Dhoma Gjyqësore konkludon se stacionet policore dhe seksioni operativ në OVR, kishin përgjegjësinë kryesore lidhur me veprat penale dhe autorët e tyre.[1888]

(ii) Njësitë e posaçme policore

489. Neni 11 i Ligjit për Punët e Brendshme parashtron:[1889]

> Për të parandaluar cënimin e sigurisë së Republikës së Maqedonisë, në luftë, në një situatë të jashtëzakonshme, ose kur paqja dhe rendi publik cënohen në masë të madhe, Ministri mund të krijojë njësi policore për kryerjen e detyrave të caktuara, të përbëra nga policë dhe kandidatë-policë, kadetë me moshë më të madhe se 18 vjeç, studentë, studentë të kurseve policore, punonjës të institucioneve stërvitore të Ministrisë së Brendshme, si dhe personel rezervist i caktuar të shërbejë në polici.

490. Duket se në vitin 2001 ekzistonin tri njësi të posaçme policore; njësia "Tigër", njësia (e posaçme) "*Posebna*" dhe Njësia e Batalionit të Ndërhyrjes së Shpejtë e njohur me emrin "Luanët".

491. Njësia "Tigër" e përbërë nga afërsisht 120 vetë[1890] ekzistonte në gusht 2001.[1891] Faktikisht ishte komanduar nga Toni Mandarovski nga 30 prill 1999 deri më 25 maj 2001 kur Lube Boshkoski e zëvendësoi atë me Goran Zdravkovskin.[1892] Në kohën e ngjarjeve në Luboten kjo njësi ishte nën komandën e drejtpërdrejtë të Lube Boshkoskit si Ministër.[1893] Në kohën e ngjarjeve në Luboten njësia Posebna ekzistonte prej shumë

1883 *Shih* raporte të ndryshme në periudhën 10-14 gusht 2001, ndër të tjera, Provat Materiale P98; P106; P107; P108; P109; P110; P113; P114; P115; P116; P117; P124; P126; P127; P144; P146; P147; P148; P152; P153; P154; P155; P157; P182; P254; P397; P440; 1D289. *Shih* gjithashtu Tatjana Grosheva, T 4803-4804.

1884 M053, T 1948.

1885 M053, T 1415. *Shih* gjithashtu Petre Stojanovski T 9310-9311; 9317; Provat Materiale P95, Neni 27; P111; P112; P125; P136; P396; 1D84; 1D145.

1886 M052, T 8239; 8602-8607. *Shih* gjithashtu raporte të ndryshme në periudhën 10-14 gusht 2001, *ndër të tjera,* Provat Materiale P36; P37; P105; P145; P150; P151; P158; P159; P160; P161; P162; P163; P164; P257; P258; P259; P395; P398; P399; P400; 1D288.

1887 M052, T 8602-8607.

1888 Vilma Ruskovska, T 1539; Petre Stojanovski, T 9100. *Shih* gjithashtu M053, T 1958.

1889 Prova Materiale P86, Neni 11.

1890 M056, T 2094.

1891 M051, T 4191. *Shih* gjithashtu Zoran Jovanovski, T 4891.

1892 *Shih* Zoran Trajkovski, T 5518; Prova Materiale 1D44.

1893 Prova Materiale 1D107, Neni 7.1; Prova Materiale 1D65; Risto Galevski, T 3666.

vjetësh.[1894] Ajo ishte e përbërë nga policë të rregullt,[1895] të cilët, në bazë të një urdhri të Ministrit për aktivizimin e njësisë Posebna, u shkëputën nga detyrat e tyre të zakonshme duke u ridislokuar në këtë njësi.[1896] Ajo funksiononte në sektorin e njësive të posaçme të Ministrisë. Një "Batalion Policor i Ndërhyrjes së Shpejtë" u krijua formalisht në Ministri nga Lube Boshkoski më 6 gusht 2001.[1897] Batalioni u vendos nën komandën e shefit të sektorit të njësive të posaçme,[1898] dhe u riemërtua formalisht si "Batalioni i Ndërhyrjes së Shpejtë-Luanët" më 5 shtator 2001.[1899] Ka mospërputhje në dëshmi lidhur me faktin nëse krijimi formal më 6 gusht 2001, ishte thjesht konfirmim i asaj që tashmë ishte bërë realitet,[1900] apo nëse "Luanët" filluan të funksionon plotësisht vetëm pas ngjarjeve në Luboten.[1901]

(iii) Pozita e policëve rezervistë në Ministrinë e Brendshme

492. Në rrethana normale, të gjitha detyrat policore kryheshin nga policia e rregullt.[1902] Forcat rezervistë thirreshin: [1903]

> në kushte të luftës apo gjendjes së jashtëzakonshme, për të parandaluar cënimin e sigurisë së Republikës së Maqedonisë apo për të ruajtur qetësinë dhe rendin publik kur ato cënoheshin në masë të madhe.

493. Të gjithë të rriturve që kishin kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, u ishte caktuar pozicioni i shërbimit të tyre ushtarak si rezervistë. Pozicioni i shërbimit të tyre mund të ishte në ushtrinë e IRJM-së, në polici apo në mbrojtjen civile.[1904] Ndonëse

---

1894 Zoran Jovanovski, T 4896; 4900; Risto Galevski, T 3684-3685; Prova Materiale 1D57. Prova Materiale P75 është një vendim i datës 26 qershor 2001 "për krijimin e një njësie të posaçme /posebna/ policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme." Në paragrafin 15 të vendimit thuhej se vendimi për krijimin e njësisë Posebna i vitit 1993 (Prova Materiale 1D57) pushoi së ekzistuari. Mirëpo asnjë dëshmitar nuk sugjeroi se kjo nënkuptonte se njësia Posebna nuk ekzistonte në gusht 2001, përkundrazi, dëshmitarët sugjeruan se ky vendim tregonte për rritjen e numrit të anëtarëve të njësisë Posebna, Risto Galevski, T 3683-3684; 3686; Vesna Dorevska, T 9402-9404.

1895 Zoran Jovanovski, T 4896; Risto Galevski, T 3683-3684. *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D57, para. 3.

1896 Zoran Jovanovski, T 4896; Prova Materiale 1D57, para. 10.

1897 Prova Materiale P74, para. 8. Po atë ditë, Lube Boshkoski nxori një vendim duke caktuar Batalionin e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe Njësinë e Detyrave të Posaçme në njësinë e përkohshme të përbashkët kundër terrorizmit e përbërë nga anëtarët e Ministrisë së Brendshme dhe ushtrisë, Prova Materiale P275.

1898 Prova Materiale P74, para. 1.

1899 Prova Materiale 1D61.

1900 Nasim Bushi, T 5896; Viktor Bezruchenko, T 6713; Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 32.

1901 Viktor Bezruchenko, T 6712; Prova Materiale P82; Prova Materiale 1D359. Mbi bazën e Provës Materiale 1D153 Dhoma Gjyqësore pranon se personat u caktuan formalisht në njësinë "Luanët" vetëm në nëntor 2001.

1902 M083, T 1415-1417.

1903 Prova Materiale P86, Neni 45(2). *Shih* gjithashtu Provat Materiale 1D154, Nenet 1 and 2; 1D356, Neni 2; Risto Galevski, T 3714-3715; Vesna Dorevska, T 9456; Miodrag Stojanovski, T 6822-6825.

1904 Risto Galevski, T 3714-3715. *Shih* gjithashtu M083, T 1415-1417; M053, T 1959-1960; Vesna Dorevska, T 9457; 9458; Blagoja Markovski, T 10670; Prova Materiale 1D98, Neni 81.

rezervistët e ushtrisë dhe ata të policisë ishin të regjistruar në një listë të vetme të Ministrisë së Mbrojtjes,[1905] rezervistët që ishin caktuar për Ministrinë e Brendshme ishin të regjistruar edhe në një listë të drejtorisë së përgatitjeve të mbrojtjes në Ministrinë e Brendshme. Kjo drejtori mbante dosjet e këtyre rezervistëve si dhe ishte e ngarkuar me stërvitjen e tyre.[1906] Me kërkesë të drejtorisë së përgatitjeve të mbrojtjes në MB, një anëtar i policisë rezerviste mund të hiqej nga lista e kësaj drejtorie.[1907] Megjithatë, ai mbetej anëtar i forcave ushtarake rezerviste të Ministrisë së Mbrojtjes dhe i nënshtrohej kontrollit të kësaj ministrie.[1908]

494. Sipas ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, policët rezervistë mund të angazhoheshin dhe mobilizoheshin sipas kërkesës së MB-së,[1909] vepronin nën autoritetin e MB-së,[1910] dhe vishnin uniforma të policisë.[1911] Gjatë kryerjes së detyrave dhe misionieve të MB-së, rezervistët ishin "zyrtarë të autorizuar".[1912] Mobilizimi i policëve rezervistë bëhej nga Ministri i Brendshëm mbi bazën e urdhrit të lëshuar nga Presidenti dhe Këshilli i Sigurimit.[1913]

495. Disa dëshmi sugjeruan në mënyra të ndryshme, se përveç regjistrimit nga MB-ja, për t'u bërë rezervistë ishte gjithashtu e nevojshme që personi në fjalë të kishte letërnjoftim,[1914] t'u përgjigjej thirrjeve për paraqitje apo të paraqitej vullnetarisht nëse këto thirrje bëheshin publikisht, të kryente një stërvitje të shkurtër,[1915] të verifikohej për ndonjë precedent penal,[1916] të pajisej me një armë dhe uniformë,[1917] si dhe t'i jepej shpërblim.[1918] Këto kërkesa nuk bazoheshin në ndonjë nga rregulloret ekzistuese. Në

1905 Vesna Dorevska, T 9492; Blagoja Markovski, T 10670; 10672; Prova Materiale 1D351.
1906 Prova Materiale 1D107, Neni 6.8.
1907 Blagoja Markovski, T 10673. *Shih* gjithashtu Vesna Dorevska, T 9489-9491; 9641-9642; Provat Materiale 1D350; 1D351.
1908 Vesna Dorevska, T 9642; 9644.
1909 Prova Materiale P86, Neni 45(2).
1910 Prova Materiale 1D154, Neni 2(2). *Shih* gjithashtu Slagjana Taseva, T 9719-9720.
1911 Prova Materiale P86, Neni 45(3).
1912 Prova Materiale P86, Neni 46(2). *Shih* gjithashtu Slagjana Taseva, T 9724.
1913 Risto Galevski, T 3716. *Shih* gjithashtu Vesna Dorevska, T 9489; M053, T 1959-1960; Slagjana Taseva, T 9718-9719; M083, T 1417; M084, T 1453; Provat Materiale P86, Neni 46(1); P393, ERN N005-0625 (urdhri për mobilizimin u lëshua më 4 mars 2001)
1914 Risto Galevski, T 3717-3718. *Shih* gjithashtu M053, T 1964; Zoran Jovanovski, T 4917-4918.
1915 Zoran Jovanovski, T 4917-4918. *Shih* gjithashtu M053, T 1983; Miodrag Stojanovski, T 6822-6825.
1916 M084, T 1455-1456; M083, T 1418-1419.
1917 Risto Galevski, T 3717-3718; Petre Stojanovski, T 9115-9116. *Shih* gjithashtu M053, T 1964; 1968-1969; Zoran Jovanovski, T 4917-4918; Vesna Dorevska, T 9614.
1918 Prova Materiale 1D310, para. 46. *Shih,* megjithatë, Zoran Jovanovskin i cili dëshmoi se një rezervist mund të mobilizohej për më pak se një muaj pa pagesë nga Ministria, T 4918.

shumë aspekte, ato thjesht pasqyronin praktikën administrative. Nga ky këndvështrim, anëtarët e forcave policore rezerviste që hynë në fshatin Luboten më 12 gusht 2001, dhe ata që ishin ngarkuar me detyra në stacionet policore në atë kohë, ishin pajisur paraprakisht me armë, uniforma dhe pajisje në stacionet policore. Ndonëse u sugjerua se disa prej tyre kishin precedentë penal, kjo nuk u vërtetua nga dëshmitë. Po kështu, ishte e pamundur të verifikohej nëse dënimet që u ishin dhënë këtyre personave ishin ende "të pashlyera" në kohë në bazë të ligjit të IRJM-së, apo ishin të një kategorie të tillë që nuk i lejonte këta persona të shërbenin në policinë rezerviste. Gjatë periudhës së Aktakuzës, këta persona kryenin detyra si anëtarë të policisë rezervistë. Në rastin e stacionit policor të Çairit më 10 dhe 11 gusht, përpara se të shpërndaheshin armët, u bë verifikimi i të kaluarës penale të të gjithë vullnetarëve.[1919]

496. Ministri i Brendshëm kishte kompetencë të vendoste se në cilën njësi do të caktohej një polic rezervist pas mobilizimit të tij.[1920] Kur një rezervist caktohej në një stacion policor, përgjegjësia për atë person duke përfshirë dhënien e detyrave dhe përgjegjësive, merrej nga komandanti i atij stacioni policor.[1921] Në vitin 2001, në OVR-në e Çairit u mobilizuan 300-350 policë rezervistë.[1922]

(iv) <u>"Kometa"</u>

497. "Kometa" ishte agjenci private sigurimi, e cila i përkiste Zoran Jovanovskit, me nofkën Buçuk.[1923] "Kometa" nuk ishte pjesë e ushtrisë apo policisë maqedonase. Në një kontratë të nënshkruar midis MB-së dhe "Kometës", përcaktohej që "Kometa" t'i ofronte Ministrisë shërbime në fushën e sigurisë, dhe lidhur me këtë agjencisë iu dhanë pesë autorizime.[1924] Më 25 dhe 26 korrik 2001, punonjësve të "Kometës" të cilët erdhën në PSOLO, iu shpërndanë pushkë automatike, municione dhe uniforma të policisë.[1925] Dëshmitë tregojnë gjithashtu se personat që u dërguan nga "Kometa", u pajisën në OVR-në e Çairit më 10 dhe 11 gusht 2001. Dhoma Gjyqësore konkludon se këto ngjarje

[1919] M084, T 1461-1462; Prova Materiale P231.
[1920] Prova Materiale P74.
[1921] M053, T 1968-1969; 1990. *Shih* gjithashtu M084, T 1460; M083, T 1445; Vesna Dorevska, T 9489.
[1922] M053, T 1972.
[1923] M056, T 2146-2147.
[1924] Prova Materiale P534.
[1925] Miodrag Stojanovski, T 6791-6792; Prova Materiale P436.

tregojnë se personat e dërguar nga "Kometa", ishin në listën e policëve rezervistë të MB-së, të cilët, pas paraqitjes së tyre në ministri vullnetarisht apo të thirrur personalisht në shërbim, ishin pranuar për shërbim aktiv si anëtarë të policisë rezerviste.[1926]

(b) Kompetencat *de jure* dhe *de facto* të Lube Boshkoskit

498. Lube Boshkoski ishte Ministër i Brendshëm i IRJM-së nga maji 2001 deri në nëntor 2002.[1927]

499. Në Aktakuzë pretendohet se në periudhën në fjalë, Lube Boshkoski, në postin e tij si Ministër i Brendshëm, ushtronte komandë dhe kontroll *de jure* dhe *de facto* ndaj policisë së rregullt dhe rezerviste, duke përfshirë të gjitha njësitë e posaçme policore në IRJM.[1928]

500. U paraqitën shumë dëshmi gojore dhe dokumentare si dhe u trajtua gjatë çka mund të përmblidhet si roli dhe kompetencat *de jure* dhe *de facto* të Lube Boshkoskit në postin e tij si Ministër i Brendshëm, gjatë kohës së mbuluar nga Aktakuza. Vëmendje e madhe iu kushtua strukturës formale të MB-së dhe funksionimit të saj. Dhoma Gjyqësore nuk e gjykon të nevojshme paraqitjen e hollësishme të këtyre dëshmive dhe parashtrimeve lidhur me to, pasi, sipas mendimit të saj, shumë pak prej tyre kishin lidhje me çështjen.

501. Siç është theksuar, e vetmja arsye e pretenduar në Aktakuzë mbi të cilën Lube Boshkoski mund të shpallet fajtor për krimet për të cilat akuzohet është përgjegjësia e dispozitave të Nenit 7(3) të Statutit, d.m.th. përgjegjësia komanduese. Ishte kryesisht brenda këtij konteksi ku rolit dhe kompetencave të tij si ministër iu kushtua vëmendje kaq e madhe.

502. Një nga pretendimet kryesore të mbrojtjes së Boshkoskit ishte se sipas kuptimit të Nenit 7(3) të Statutit, Lube Boshkoski nuk ishte as *de jure* dhe as *de facto* epror i

[1926] Anëtarët e policisë rezerviste ishin mobilizuar nga paraardhësi i Lube Boshkoskit, M084, T 1453; Prova Materiale P393, ERN N005-0625, dhe ishin rimobilizuar nga Lube Boshkoski, Prova Materiale 1D91. *Shih* gjithashtu Zoran Jovanovski, T 4920; Risto Galevski, T 3719-3720; Blagoja Markovski, T 10663-10664; Petre Stojanovski, T 9117-9120.

[1927] Prova Materiale P43, fact 3.

[1928] Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë, para. 11-12.

policëve që hynë në Luboten mëngjesin e 12 gushtit 2001, as i Johan Tarçulovskit, dhe as i policisë në postblloqet policore, stacionet policore, gjykatë apo në spital, të cilat përmenden në Aktakuzë.[1929] Më tej argumentohet se Lube Boshkoski nuk kishte kompetencë të ndëshkonte ndonjë nga këta persona sipas kuptimit të Nenit 7(3).[1930]

503. Dëshmitë dhe parashtrimet e hollësishme që u paraqitën në mbështetje të këtyre pretendimeve bazoheshin pak a shumë në argumentin se në bazë të kushtetutës dhe ligjeve të IRJM-së Ministri i Brendshëm ishte figurë simbolike politike me përgjegjësi dhe funksione kryesisht të përqëndruara në punën e tij në qeveri, dhe se ai kishte realisht pak kompetenca apo funksione në MB, me përjashtim të atyre rasteve të pakta ku ligji i akordonte shprehimisht Ministrit një funksion apo kompetencë të veçantë.[1931] Kjo pikëpamje mjaft e habitshme u argumentua shumë seriozisht dhe mjeshtërisht. Vëmendje e madhe iu kushtua drejtorive dhe strukturave organizative në MB, secila me hierarkinë e saj drejtuese, strukturave raportuese dhe llogaridhënëse, si dhe shumë dispozitave të hollësishme ligjore të cilat u akordonin përgjegjësi për kryerjen e detyrave ose kompetencave konkrete zyrtarëve apo organeve dhe strukturave konkrete në MB.[1932] Theks i veçantë iu kushtua argumentit se kompetenca për lëshimin e urdhrave dhe kryerjen e detyrave të tjera në MB, madje edhe në nivelet e saj më të larta, nuk mund të ushtrohej gjithanshmërisht ndaj drejtorive dhe struktura, por vetëm nga lart-poshtë brenda drejtorisë apo strukturës.[1933] Vëmëndje iu kushtua edhe atyre dispozitave ligjore që shprehimisht përcaktojnë kryerjen e një detyre apo kompetence konkrete prej Ministrit.

504. Këto aspekte të strukturës ligjore dhe administrative u paraqitën në mbështetje të pretendimit se Ministri ishte zhveshur efektivisht nga të gjitha kompetencat dhe funksionet të cilat u kishin kaluar zyrtarëve të ndryshëm në Ministrinë e tij.[1934] Ministri mund të vepronte me nismën e vet vetëm në ato pak raste kur ai ishte mveshur shprehimisht me kompetencë apo funksion.

[1929] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 82, 108, 381-417, 433-455. Argumentet Përmbyllëse, T 11063-11065, 11070-11071, 11075-11076.
[1930] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 73-74, 436.
[1931] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 9, 13,16-18, 44-53, 83-94,124. Argumentet Përmbyllëse, T 11076, 11081.
[1932] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 6-17, 47, 99-100.
[1933] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 12, 99, 103, 108, 123.
[1934] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 20-21.

505. Efekti që duket se synonin të krijonin këto argumenta ishte se Ministri kryesisht merrte raporte nga drejtuesit e secilës drejtori apo strukturë apo nëpërmjet tyre, që e ndihmonin të informohej për ngjarjet kryesore apo të ndiqte punën e këtyre drejtorive dhe strukturave në mënyrë që të mund t'u ofronte këshilla vartësve të tij në MB, të cilët kishin përgjegjësinë për të vepruar për çdo rast konkret, dhe se, nga ana tjetër mund të informonte siç duhej qeverinë, Presidentin dhe Parlamentin dhe mund të kërkonte vëmendjen apo vendimmarrjen e tyre për çështje të ndryshme sa herë që të ishte e nevojshme.[1935]

506. Theks i veçantë iu kushtua një dispozite statutore, sipas së cilës ministrat vetëm *administrojnë* punën e ministrive të tyre, duke nënkuptuar sipas këtij termi faktin se ministri kishte vetëm rol administrativ, realisht i zhveshur nga çdo kompetencë për vendime, kontroll apo drejtimin e punës së ministrisë.[1936]

507. Sipas pikëpamjes së Dhomës Gjyqësore, argumentet e Mbrojtjes në këtë pikë dhe dëshmitë e paraqitur prej saj në mbështetje të këtyre argumenteve, nuk mund të pranohen. Ato mbështeten në një keqinterpretim thelbësor të qëllimit dhe efektit të legjislacionit përkatës të IRJM-së. Po të pranoheshin si të mirëqena, këto pikëpamje do të kishim të bënim me një kufizim të theksuar të efektivitetit dhe efikasitetit të demokracisë parlamentare mbi bazën e cilës qeveriset IRJM-ja. Dhoma Gjyqësore dëshiron të tërheqë vëmendjen vetëm në lidhje me disa dispozita ligjore.

508. Neni 11 (1) l i Ligjit për Qeverinë e IRJM-së, përcakton:

> Kryetari i qeverisë administron punën e qeverisë; ai/ajo është përgjegjës për funksionimin e qeverisë si dhe për zbatimin e bashkëpunimit me organe të tjera, ndërmarrjet dhe institucionet publike.[1937]

Këtu për Kryetarin "e Qeverisë"*(sic)* është përdorur nocioni *administron*. Pikëpamja se nocioni *administron* duhet interpretuar në kuptim të ngushtë dhe pak a shumë pa pushtet administrativ, është joreale dhe me mangësi ligjore. Ironikisht, kjo bie deri diku, ndesh edhe me qëndrimin e Mbrojtjes, e cila dukej se pranoi faktin që kryetari i qeverisë kishte

[1935] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 16, 56.
[1936] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 16, 56.
[1937] Prova Materiale P551, Neni 11(1).

kompetenca të gjera për të drejtuar ministrat dhe ministritë në sajë të pozitës së tij si pushtetmbajtësi më i lartë në qeverinë e IRJM-së.[1938]

509. Në të njëjtin Ligj për Qeverinë, Neni 13 përcakton:

> Ministri administron në mënyrë të pavarur ministrinë ku është emëruar, mbikëqyr dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera.[1939]

Është e qartë se në këtë ligj, *administron* përdoret si për kryetarin e qeverisë ashtu dhe për ministrin. Në secilën dispozitë konteksti ka të bëjë me kontrollin në nivelin më të lartë të qeverisë apo një prej ministrive. Në secilin rast *administron* përdoret për të përshkruar rolin e kryetarit të qeverisë apo ministrit, të cilët japin llogari para parlamentit dhe popullit për funksionimin e duhur të krejt qeverisë, në rastin e kryetarit të qeverisë, dhe ministrisë, në rastin e ministrit. Ky kontekst tregon qartësisht se nocioni *administron* nuk mund të kufizohet thjesht në mbikëqyrje administrative pa kompetenca reale për marrje vendimesh dhe udhëheqjen e detyrave të administruara. Kjo bëhet edhe më e qartë nga ajo çka thuhet më poshtë në Nenin 13 ku ministri që administron ministrinë *në mënyrë të pavarur*, është *përgjegjës* për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera. Theksimi i shprehjes "në mënyrë të pavarur" bie ndesh me pretendimin sipas të cilit Ministri në thelb është thjesht kanali i komunikimit për punonjësit në ministri, të cilët (ndryshe nga Ministri) kanë përgjegjësinë për ushtrimin e pjesës më të madhe të kompetencave dhe funksioneve. Kjo mospërputhje është edhe më e dukshme për faktin se Ministri ngarkohet shprehimisht me përgjegjësinë e zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera. Mirëpo Mbrojtja argumenton se pikërisht me këtë detyrë janë ngarkuar drejtpërsëdrejti (jo Ministri) zyrtarë të ndryshëm të ministrisë, në përputhje me të gjitha kompetencat apo funksionet statutore që kanë në bazë të postit që mbajnë.

510. Qëllimi i vërtetë i skemës legjislative për qeverinë mund të kuptohet edhe më qartë në Ligjin për Organizimin dhe Punën e Organeve Qeveritare, ku përcaktohet:

Neni 47(1):

> Puna e ministrisë administrohet nga ministri.[1940]

[1938] Argumentet Përmbyllëse, T 11093-11094.
[1939] Prova Materiale P551, Neni 13.

Neni 49(1):

> Ministri përfaqëson ministrinë, organizon dhe siguron kryerjen e ligjshme dhe efikase të punës dhe detyrave; paraqet rregulla dhe akte të tjera për të cilat është i autorizuar dhe merr masa të tjera në bazë të kompetencave të ministrisë, në përputhje me ligjin; vendos për të drejtat, detyrat, dhe përgjegjësitë e punonjësve të shtetit dhe personave të tjerë të punësuar nga ministria që nuk kanë statusin e punonjësit shtetëror, kur nuk përcaktohet ndryshe me ligj.[1941]

Prej këtyre dy dispozitave që kanë lidhje të drejtpërdrejtë midis tyre, del qartë se administrimi i ministrisë prej ministrit përfshin marrjen e masave për të siguruar kryerjen e ligjshme dhe efikase të punës së ministrisë. Ministri ka për detyrë të garantojë që puna e bërë në ministrinë e tij të kryhet në mënyrë të ligjshme dhe efikase. Kjo kërkon domosdoshmërisht që në përputhje me çdo kërkesë të shprehur statutore, Ministri të jetë në gjendje të urdhërojë dhe përcaktojë punën që duhet të kryhet në ministrinë e tij, të drejtojë punonjësit në kryerjen e detyrave në ministri, (duke përfshirë ato kompetenca dhe funksione që u janë caktuar punonjësve në bazë të dispozitave statutore), si dhe të kërkojë zbatimin e udhëzimeve të tij.

511. Shpjegimet e hollësishme të mësipërme përputhen gjithashtu me kuptimin fillestar, të zakonshëm, dhe të drejtpërdrejtë të fjalës *administroj*, d.m.th. të kontrollosh dhe drejtosh punën.

512. Duke iu referuar në veçanti një argumenti të Mbrojtjes së Boshkoskit, akordimi i shprehur i një kompetence apo funksioni një zyrtari të MB-së nëpërmjet ligjit, ndodh dhe duhet kuptuar në kontekstin e dispozitave statutore të shqyrtuara më sipër. Pavarërisht akordimit të shprehur të një kompetence apo funksioni, Ministri i Brendshëm nuk privohet nga mundësia për të kërkuar kryerjen e ligjshme dhe të efektshme të asaj kompetence apo atij funksioni.

513. Për këto arsye Dhoma Gjyqësore është e bindur se Lube Boshkoski, si ministër, kishte kompetencën *de jure* për të kontrolluar dhe drejtuar policinë si dhe të gjithë punonjësit e tjerë operativë të MB-së, duke përfshirë anëtarët e njësive rezerviste dhe të posaçme të policisë, lidhur me operacionin e kryer në Luboten më 12 gusht 2001 si dhe

---

[1940] Prova Materiale P92, Neni 47(1). *Shih* gjithashtu Provën Materiale 1D107, Neni 2.
[1941] Prova Materiale P92, Neni 49(1).

me ngjarjet e mëvonshme në postblloqet policore dhe stacionet policore. Kjo kompetencë *de jure* përfshinte edhe garantimin e kryerjes efikase dhe në përputhje me ligjin të hetimit të ngjarjeve prej policëve përgjegjës, ndër të cilët edhe ata që duhej të zbatonin udhëzimet e gjyqësorit apo për të ndihmuar prokurorin publik, d.m.th. policia për e MB-së për krimet.[1942] Kompetenca e kontrollit dhe drejtimit konkretisht ishte e zbatueshme edhe ndaj të Akuzuarit Johan Tarçulovski, i cili në atë kohë ishte punonjës i MB-së që kryente normalisht detyrat e tij lidhur me sigurinë e bashkëshortes së Presidentit.[1943]

514. Lube Boshkoski ishte ministër i një ministrie të strukturuar, të disiplinuar dhe të tejrregulluar ligjërisht në një qeveri që funksiononte efektivisht dhe që kishte në dispozicion të saj struktura qeveritare mbështetëse të plota dhe normale, ndër të cilat gjyqësori, policia dhe institucionet ushtarake. Nuk ka dyshim se ai ishte në gjendje t'i ushtronte efektivisht kompetencat e tij ministrore në atë masë që dëshironte.[1944] Dëshmitë tregojnë se sa aktiv ishte ai në këtë rol.[1945]

515. Në kontekstin e Nenit 7(3) të Statutit, Dhoma Gjyqësore konkludon se Lube Boshkoski ishte eprori i personelit të lartpërmendur të MB-së.[1946] Ai kishte kompetencën e nevojshme komanduese dhe mund t'a ushtronte efektivisht.

516. Veç konkluzionit të saposhqiptuar, Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludon se provat tregojnë se në lidhje me çështjet e sapodiskutuara, edhe nëqoftëse nuk do të kishte qenë i mveshur me kompetencën e nevojshme *de jure*, Lube Boshkoski *de facto* kishte kompetencë të barasvlerëshme dhe mund t'a ushtronte me efektivitet. Dëshmitë e bindin Dhomës Gjyqësore për forcën e personalitetit dhe energjinë e tij, për ndikimin dhe drejtimin e suksesshëm të personelit të ministrisë prej tij, si dhe sigurimin e mbështetjes

Prova Materiale P86, Neni 12; Zoran Jovanovski, T 5008; 5114; Petre Stojanovski, T 9099.

1943 *Shih* më sipër, para. 477.

1944 *Shih* për shembull Provën Materiale P92, Nenet 49 dhe 55; Vesna Dorevska, T 9407; 9435-9436; 9555: Petre Stojanovski, T 9246-9248.

1945 *Shih* për shembull Provat Materiale P64; P65; P71; P72; P74; P77; P80; P82; P85; P271; P278; P468; P469; P470; P471; 1D61; 1D62; 1D65; 1D66; 1D358; 1D359; Vesna Dorevska, T 9548; Slagjana Taseva, T 9720.

1946 *Shih* më sipër, para. 513.

së tyre për propozimet e tij, dhe ndjenjën e besnikërisë që ai fitoi dhe arritjen e bashkëpunimit në të gjitha nivelet e ministrisë.[1947]

517. Mirëpo Dhoma Gjyqësore konkludon se duke qenë Ministër i Brendshëm, Lube Boshkoski nuk kishte funksione apo kompetenca lidhur me ushtrinë apo personelin e saj, të cilët ishin nën përgjegjësinë e Ministrit të Mbrojtjes.[1948] Gjithashtu Lube Boshkoski nuk kishte funksione apo kompetenca ministrore lidhur me gjyqësorin, prokurorin publik, apo policinë gjyqësore, e cila ishte përgjegjëse për sigurinë në gjykata. Po kështu, Lube Boshkoski nuk kishte funksione apo kompetenca lidhur me personelin e sigurimit apo rojet, në spitale apo burgje, të cilët ishin nën përgjegjësinë e Ministrit të Drejtësisë.[1949]

518. U diskutua gjatë dhe u paraqitën shumë dëshmi lidhur me faktin nëse Lube Boshkoski kishte kompetencat e nevojshme për të marrë masa ndëshkuese sipas Nenit 7(3) të Statutit. U argumentua se ai nuk kishte kompetenca për të ndëshkuar rastet e sjelljes kriminale të policisë.[1950] Sipas ligjeve ekzistuese të IRJM-së, ishte detyrë e gjyqësorit të hetonte dhe ndëshkonte, dhe prokurori publik ishte ngarkuar me përgjegjësi në mbështetje të funksionit gjyqësor.[1951] Më tej, lidhur me procedurat disiplinore në MB, u argumentua se Ministri nuk kishte kompetencë të niste procedim disiplinor apo të ndëshkonte thyerjet disiplinore pasi përgjegjësinë dhe kompetencat për këtë e kishin të tjerët.[1952] Gjithashtu lidhur me policinë rezerviste, u argumentua se në atë kohë nuk ekzistonin procedura apo kompetenca për marrjen e masave ndëshkuese ndaj thyerjeve disiplinore. Faktikisht anëtarët e forcave rezerviste nuk ishin të punësuar dhe, siç u pretendua, sistemi disiplinor zbatohej vetëm për të punësuarit.[1953]

519. Lidhur me sjelljen kriminale të policisë dhe ligjin e jurisprudencën, të cilat Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi më herët në këtë Aktgjykim, është e qartë se në kontekstin e Nenit 7(3) dhe, në veçanti, në rastin e një eprori që nuk ka kompetencë personale për

[1947] Provat Materiale P277; P278; P401; Zoran Trajkovski, T 5505-5506; Blagoja Jakovoski, T 3917-3918; Zoran Jovanovski, T 4854.
[1948] Prova Materiale P92, Neni 15.
[1949] Prova Materiale P92, Neni 17; Prova Materiale P90, Neni 103 *et seq.* ; Vilma Ruskovska, T 1557; Risto Galevski, T 3785-3786.
[1950] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 31-32, 73, 190-194.
[1951] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 22-25, 28, 34-35, 131-147. Argumentet Përmbyllëse, T 11081, 11099.
[1952] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 231-237, 240-242.
[1953] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 3, 209-212, 250-253.

ndëshkimin e vartësve, siç është rasti i drejtuesve politikë, ajo që kërkohet është që t'u paraqitet një raport autoriteteve kompetente, i cili ka të ngjarë të çojë në një hetim, apo në nisjen e procedimit përkatës.[1954] Përgjegjësia e eprorit është që ai të ndërmarrë masa aktive me qëllim që autorët e krimeve të dënohen.[1955] Këto çështje do të trajtohen më hollësisht.

520. Lidhur me mundësinë e procedimit disiplinor në MB, Dhoma Gjyqësore konstaton se për arsyet e sapopërmendura, nuk është e nevojshme që Ministri të ketë kompetencë personale për të dënuar apo ndëshkuar. Nëqoftëse ekzistojnë organe apo procedura të përcaktuara për masa disiplinore, përgjegjësia e Ministrit si epror, është t'i raportojë autoriteteve kompetente, siç u theksua më sipër. Në këtë aspekt, në kundërshtim me një argument të Mbrojtes,[1956] Dhoma Gjyqësore konkludon se Ministri jo vetëm që kishte kompetencë për të marrë vendime mbi bazën e propozimeve të paraqitura nga komisioni disiplinor sipas Marrëveshjes Kolektive.[1957] por ai mund edhe të niste procedime përpara këtij komisioni.[1958] Gjithashtu Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë dëshmitë dhe parashtrimet sipas të cilave policët rezervistë nuk i nënshtrohen procedurave të përcaktuara disiplinore. Këto dëshmi dhe parashtrime bazohen mbi një këndvështrim shumë të ngushtë të skemës statutore në bazë të së cilës rezervistët mobilizohen dhe angazhohen si policët e tjerë, ndonëse shpërblimi i tyre bëhet në bazë të skemës së veçantë statutore për rezervistët, si dhe mbi një këndvështrim shumë të ngushtë të efektit të vërtetë të dispozitave, si Neni 46(2) i Ligjit për Punët e Brendshme, i cili përcakton:

> Gjatë kohës së kryerjes së detyrave të tyre anëtarët e forcave rezerviste kanë përgjegjësitë dhe kompetencat e zyrtarëve të autorizuar, siç theksohet në Nenin 24 të këtij ligji.[1959]

Neni 24 përcakton:

[1954] *Shih* më sipër, para. 418.
[1955] *Shih* më sipër, para. 417.
[1956] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit, para. 231-237.
[1957] Prova Materiale P382, Nenet 148 dhe 149.
[1958] Megjithëse kompetenca për iniciimin e procedurave të tilla ishte deleguar tek vartësit e tij, kjo bëhej me autorizimin e Ministrit, Prova Materiale P382, Neni 143(5) dhe (6). Për këtë arsye, Ministri ruante kompetencën për t'i bërë propozime komisionit disiplinor.
[1959] Prova Materiale P86, Neni 46(2).

> Punonjësit e ministrisë, të cilët kanë përgjegjësi dhe kompetenca të posaçme të përcaktuara me ligj, janë zyrtarë të autorizuar.

Ky nen përcakton gjithashtu që të gjithë policët dhe punonjësit operativë të ministrisë janë zyrtarë të autorizuar.[1960]

521. Mirëpo sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, nuk është e nevojshme të arrihet në ndonjë vendim përfundimtar lidhur me procedimet disiplinore në MB apo nëse policët rezervistë mund të ndëshkohen për thyerje disiplinore. Në këtë çështje, sjellja e pretenduar në këtë Aktakuzë është vrasja e banorëve të Lubotenit, ushtrimi i dhunës së rëndë ndaj banorëve, dhe shkatërrimi i shtëpive dhe pronës së banorëve. Secili prej këtyre akteve është sjellje kriminale, dhe si e tillë e ndëshkueshme në bazë të ligjeve të IRJM-së. Trajtimi i një sjelljeje kriminale të kësaj natyre thjesht si thyerje disiplinore e brendshme do të ishte një masë tërësisht e pamjaftueshme për ndëshkimin e atyre policëve që mund të kenë kryer shkeljet e pretenduara.

522. Sipas pikëpamjes së Dhomës Gjyqësore, pyetja konkrete që paraqitet mbi bazën e rrethanave të kësaj çështjeje, është nëse Lube Boshkoski mori masat e duhura për informimin e autoriteteve përkatëse për sjelljen e pretenduar kriminale të policisë në mënyrë që kjo sjellje të hetohej me synimin e ngritjes së akuzave penale dhe dhënies së ndëshkimit të duhur. Si rrjedhojë, nuk është e nevojshme të trajtohen më tej çështjet lidhur me procedurat e brendshme disiplinore.

(c) Dijenia dhe veprimet e Lube Boshkoskit

523. Rrethanat e ndriçuara prej dëshmive, janë përshkruar hollësisht më sipër në këtë Aktgjykim. Nuk është provuar se Lube Boshkoski vuri re sjellje kriminale të policisë gjatë vizitës së tij në Luboten më 12 gusht 2001. Dëshmitë tregojnë se ai qëndroi në shtëpinë e Bracës për më tepër se një orë. Gjatë kësaj kohe ai dëgjoi të shtëna dhe pa shtëpi që po digjeshin.[1961] Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se për një kohë të shkurtër ai pa një grup prej 10 personash të ruajtur nga policia jashtë shtëpisë së Bracës. Këta persona ishin të shtrirë përmbys me kokën e mbuluar. Atij i thanë se ishin terroristë

[1960] Prova Materiale P86, Neni 24(2).
[1961] *Shih* më sipër, para. 426.

të kapur. Ndonëse është vërtetuar se këta njerëz ishin keqtrajtuar keqazi më parë nga policia dhe, në disa raste, edhe gjatë kohës që mbaheshin të shtrirë jashtë oborrit të shtëpisë së Bracës, nga dëshmitë nuk mund të konkludohet se Lube Boshkoski e pa keqtrajtimin, apo se nga pamja e 10 personave ai duhej të kishte arritur në përfundimin se ata kishin pësuar keqtrajtim kriminal.[1962]

524. Tymi që dilte mbi fshat tregonte se po digjeshin shtëpi, por thjesht kjo pamje si dhe informacioni për përleshje të armatosura midis forcave të sigurisë dhe "terroristëve" nuk ishin arsye e mjaftueshme për ta bërë atë të mendonte se kishte patur zjarrvënie të qëllimshme apo shkatërrime të tjera pa shkak të pronës nga policia.

525. Lube Boshkoski nuk pa vrasjen e asnjë personi. Dëshmitë nuk sugjerojnë se ai u informua për vrasjen e ndonjë personi. Atij iu tha se gjatë operacionit në mëngjes ishin kapur një numër "terroristësh". Në mbështetje të informacionit që iu dha atë mëngjez, atij i treguan tri armë zjarri dhe municione të cilat, siç i thanë, u ishin gjetur terroristëve të arrestuar.[1963] Kjo e përforcoi edhe më tej vërtetësinë e informacionit që ai kishte marrë për operacionin e suksesshëm kundër terroristëve në fshat atë mëngjes dhe kapjen e një numri terroristësh gjatë këtij operacioni. Komentet e tij dhënë gazetarit të televizionit në shtëpinë e Bracës sugjerojnë se kjo ishte ideja e përgjithshme që ai kishte për çka kishte ngjarë atë mëngjes.[1964]

526. Nuk ka dëshmi që sugjerojnë se Lube Boshkoski pa, apo se më 12 gusht i thanë se kishte patur keqtrajtim të banorëve nga policia në postblloqe apo se kishte patur keqtrajtim të banorëve të Lubotenit në stacionet policore, ngjarje që duket se ndodhën në orët e mëvonshme të asaj dite. Dëshmitë gjithashtu tregojnë se Lube Boshkoski nuk ka qenë në Luboten "gjatë gjithë" operacionit atë ditë, gjë që bie ndesh me sugjerimet e bëra më pas nga disa media dhe njoftime.[1965] Dëshmitë tregojnë se momenti më i hershëm i mbërritjes së Lube Boshkoskit në Luboten ka qenë momenti kur operacioni i mëngjesit ishte në fazën e tij përmbyllëse,[1966] dhe se ai qëndroi vetëm në shtëpinë e Bracës, në

[1962] *Shih* më sipër, para. 428.
[1963] *Shih* më sipër, para. 428.
[1964] Prova Materiale P442; Eli Çakar, Prova Materiale P441, para. 35.
[1965] *Shih* më sipër, para. 425.
[1966] *Shih* më sipër, para. 70.

periferi të fshatit nga ku nuk mund të shikohej mirë fshati.[1967] Nuk ka bazë për të konkluduar se ai ndoqi zhvillimin e ngjarjeve gjatë gjithë ditës.

527. Mirëpo dëshmitë sidoqoftë tregojnë se media dhe trupi diplomatik dëgjuan menjëherë versione të ndryshme të ngjarjeve të asaj dite dhe, të nesërmen, në media dhe qarqe të ndryshme, qarkullonin thashetheme se kishte patur përleshje me banorët, granatime nga policia, dhe se ishin vrarë disa persona. Dhoma Gjyqësore është plotësisht e bindur se Lube Boshkoski mësoi shpejt për këto akuza shumë të rënda. Dhoma Gjyqësore pranon se pikërisht për këtë arsye, po atë ditë, më 13 gusht 2001, Lube Boshkoski veproi duke krijuar një komision për hetimin e ngjarjeve të 12 gushtit në Luboten.[1968] Për shkak të këtyre thashethemeve, Henry Bolton i OSBE-së vizitoi fshatin më 14 gusht.[1969] Mirëpo në të njëjtën ditë, Lube Boshkoski u takua me ambasadorin e OSBE-së, Carlo Ungaro, të cilit i shprehu shqetësimin e tij për reagimin e OSBE-së ndaj thashethemeve që qarkullonin.[1970] Siç duket, këto thashetheme u shtuan deri në atë pikë sa më 23 gusht 2001, Peter Bouckaert i HRW-së shkoi në fshat për të bërë hetime.[1971] Raporti i tij, për të cilin Lube Boshkoski u vu në dijeni, si dhe artikujt e gazetave që i referoheshin raportit, identifikuan qartësisht pretendimet për vrasje, brutalitetin e policisë dhe shkatërrimin e pronës.[1972] Në atë moment akuzat për kryerjen e krimeve të rënda nga policia në Luboten më 12 gusht ishin aq të forta sa përligjnin plotësisht nevojën për kryerjen e hetimeve të duhura për çfarë kishte ndodhur. Ashtu siç ka konkluduar më sipër në këtë Aktgjykim, në kuadrin e Nenit 7(3) të Statutit, Dhoma Gjyqësore mendon se Lube Boshkoski, si epror i policisë, kishte në dorë të dhëna të mjaftueshme të cilat, të paktën, duheshin hetuar. Komisioni, që u krijua më 13 gusht i cili paraqiti raportin më 4 shtator 2001, nuk ishte i mjaftueshëm për të plotësuar nevojën për hetime të tilla. Programi i punës dhe i kompetencave të komisionit ishte faktikisht i gabuar, duke sugjeruar se forcat e sigurisë kishin vepruar në përgjigje të një sulmi terrorist, dhe ishte hartuar brenda një kuadri të ngushtë.[1973] Komisioni nuk kishte detyrë ligjore për hetime kompetente. Raporti përfundimtar i paraqitur nga zyrtarë shumë të lartë të MB-së tregon

[1967] *Shih* Blagoja Jakovoski, T 3937-3941; Eli Çakar, T 5181; 5196.
[1968] *Shih* më sipër, para. 434.
[1969] Prova Materiale 1D24; Henry Bolton, Prova Materiale P236.1, para. 11, 13.
[1970] *Shih* më sipër, para. 446.
[1971] P eter Bouckaert, T 2926; 2960; 3024-3026; Peter Bouckaert, Prova Materiale P322, para. 29-33.
[1972] *Shih* më sipër, para. 448; 450-451.
[1973] Prova Materiale P73.

për errësim të qëllimshëm të fakteve dhe mospërfshirje të pandershme të tyre, tregues mjaft i qartë i qëndrimit që mbizotëronte në radhët e policisë.

528. Krijimi i komisionit hetimor nga Lube Boshkoski më 13 gusht tregon për një veprim, i cili mund të paraqitet si provë se ai kishte përmbushur detyrimin e tij në bazë të Nenit 7(3), ndonëse dëshmitë sugjerojnë se Lube Boshkoski ishte kryesisht i motivuar nga konsiderata politike[1974] me qëllim që të shmangte kritikat e brendshme dhe ndërkombëtare të asaj kohe.

529. Por ngjarjet rrodhën ndryshe. Si pasojë nuk shtrohet problemi nëse nëpërmjet një hetimi të mëtejshëm dhe më intensiv, Lube Boshkoski duhej të kishte mësuar për sjelljen e policisë, gjë që do t'a detyronte t'ia raportonte këtë autoriteteve përgjegjëse për hetimin e çështjeve penale. Çfarë ndodhi faktikisht, ishte hartimi i një raporti dhe paraqitja e tij autoriteteve kompetente, autoriteteve gjyqësore hetimore dhe prokurorit publik. Dëshmitë nuk tregojnë se ky raport u hartua sipas udhëzimeve të Lube Boshkoskit. Mirëpo ai u përpilua nga zyrtarë të policisë së ministrisë së tij, vonë më 12 gusht 2001, gjatë kryerjes së detyrave të tyre të zakonshme.[1975] Çka është edhe më e rëndësishme, i Akuzuari u informua për këtë. Ai u informua gjithashtu se ishte formuar një ekip hetimor me gjykatësin hetues dhe se ishin bërë përpjekje për të kryer një këqyrje të vendit të ngjarjes në Luboten.[1976] Dëshmitë nuk sugjerojnë se Lube Boshkovski u informua për përmbajtjen konkrete të raportit që policia i paraqiti gjykatësit hetues dhe prokurorit publik, dhe nuk ka arsye të mendohet se ai duhej të kërkonte të njihej me këtë përmbajtje. Mirëpo raporti bënte të ditur se në Luboten ishin gjetur kufomat e disa njerëzve dhe se kishte të ngjarë që ata të ishin vrarë nga forcat e sigurisë gjatë veprimeve të tyre luftarake.[1977] Në raport nuk përmendeshin konkretisht pretendimet për rrahje. Aty flitej për veprime luftarake, por nuk përmendeshin raste konkrete të shkatërrimit të pronës. Gjithsesi raporti informonte drejtëpërsëdrejti për vdekjet organet përgjegjëse për hetimin e veprave penale dhe ndonëse sugjeronte një shkak, e linte të hapur shkakun e vdekjes. Të njëjtave organeve gjyqësore iu paraqit edhe një raport tjetër më 14 gusht 2001, pas vdekjes në

[1974] *Shih* Prova Materiale P402, ERN N000-9661.
[1975] Prova Materiale 1D6.
[1976] Provat Materiale 1D373; 1D374. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P402, ERN N000-9659.
[1977] Prova Materiale 1D6.

spital më 13 gusht të një personi të arrestuar nga policia në Luboten më 12 gusht 2001, Atulla Qaili.[1978] Këto dy raporte policore për vdekjet në Luboten më 12 gusht 2001 dhe vdekjen e Atulla Qailit më 13 gusht 2001, normalisht duhej t'a kishin bindur gjykatësin hetues dhe prokurorin publik të bënin një hetim siç parashikohet nga ligji në rrethana të tilla.[1979] Normalisht një hetim i tillë duhej t'i kishte bërë zyrtarisht gjykatësin hetues dhe prokurorin publik të vetëdijshëm për akuzat të lidhura ngushta me këto vdekje, për sjelljen kriminale të policisë në Luboten, dhe më pas, në postblloqet dhe stacionet policore, dhe kjo duhej të kishte çuar në një hetim të këtyre akuzave. Mirëpo siç theksohet më sipër në Aktgjykim, një hetim i tillë që normalisht duhej të ishte zhvilluar, në fakt nuk u zhvillua.[1980]

530. Konkluzioni i Dhomës Gjyqësore është se një faktor i rëndësishëm në këtë mosveprim ishte pretendimi i përsëritur, por i pabazë i shefit të OVR-së së Çairit para gjykatësit hetues dhe prokurorit publik, sipas së cilit problemet e vazhdueshme të sigurisë në Luboten e bënin shumë të rrezikshme vajtjen e gjykatësit hetues dhe të tjerëve që të shkonin në Luboten për kryerjen e hetimeve të zakonshme.[1981] Një faktor tjetër është mungesa e plotë e deklaratave të policisë për ngjarjet në fshat atë mëngjes, për vdekjet, dhe për plagët e Atulla Qailit. Provat e disponuara prej Dhomës Gjyqësore tregojnë se prokurorit publik apo gjykatësit hetues nuk iu dhanë asnjëherë emrat e policëve që hynë në fshat mëngjesin e 12 gushtit 2001. Deri më sot këta policë janë ende të paidentifikuar. Përpara se të njoftoheshin gjykatësi hetues dhe prokurori publik, policia nuk bëri asnjë hetim të zakonshëm atë ditë apo më pas në vendet ku kishin ndodhur vdekjet në fshat[1982].

[1978] Prova Materiale P46.16.

[1979] Prova Materiale P88, Kapitujt XV dhe XVI.

[1980] *Shih* më sipër, para. 431; 433; 454-456.

[1981] Provat Materiale 1D6; 1D190.

[1982] Ligji për Punët e Brendshme përcakton në Nenin 12 se policia për krimet duhet të kryejë veprime, ndër të tjera, "për gjetjen dhe kapjen e autorëve të veprave penale", dhe duke iu referuar Nenit 1 "për parandalimin e veprave penale, zbulimin dhe kapjen e autorëve dhe dorëzimin e tyre te organet kompetente", Prova Materiale P86. Ka dëshmi që sugjerojnë se, pavarësisht nga këto dispozita, policia nuk mund të niste hetime pa autorizimin e Jjykatësit Hetues apo Prokurorit Publik: Zoran Jovanovski, T 5041-5043; Petre Stojanovski, T 9092; 9094; 9179. *Shih* gjithashtu Vilma Ruskovska, T 1538. Mirëpo për ilustrim, Neni 144(3) i Kodit të Procedurës Penale, Prova Materiale P88, nuk e mbështet këtë. Kjo dispozitë kërkon që prokurorit publik t'i jepet informacion i mjaftueshëm për t'a lejuar të bëjë vlerësimet përkatëse. Kjo dispozitë e lejon prokurorin publik të kërkojë ndihmën e Ministrisë nëqoftëse do të ketë nevojë për më tepër ndihmë. Kjo nuk bie ndesh me kompetencën e prokurorit publik për të marrë përsipër dhe drejtuar procedurën penale në bazë të Neneve 42 dhe 45 të Kodit të Procedurës Penale. *Shih* gjithashtu Prova Materiale P88, Neni 142 (1) dhe (2), në bazë të të cilit Ministria e Brendshme ka për detyrë të mbledhë të gjitha të dhënat që mund të jenë të dobishme për ecurinë e suksesshme të procedurave penale dhe duhet të ndërmarrë masat dhe veprimet e nevojshme për këtë qëllim. Më tej, Prova Materiale P88, Neni 142(6) parashikon: "Mbi bazën e informacionit të mbledhur, Ministria e Brendshme harton një kallëzim penal ku paraqet

Nuk u bënë këqyrjet kriminalistike të këtyre vendeve, të cilat ishin të nevojshme për t'iu mundësuar prokurorit publik dhe autoriteteve gjyqësore të kryenin hetimet e tyre. Kjo e vështirësoi shume edhe punën e Tribunalit. Kufomat e të vrarëve u lanë aty ku kishin rënë. Gjykatësit hetues dhe prokurorit publik nuk iu dha asnjë informacion lidhur mënyrën dhe kohën kur Atulla Qaili pësoi plagët vdekjeprurëse, dhe për arrestimin e Atulla Qailit nuk u identifikua asnjë dëshmitar dhe asnjë polic. Nuk u dha emri i asnjë dëshmitari për plagët e tij. Ndonëse gjykatësi hetues urdhëroi kryerjen e një autopsie, rezultatet e saj nuk iu përcollën gjykatësit hetues apo prokurorit publik, dhe autoritetet nuk ndërmorën asnjë hap për t'a ndjekur këtë problem.[1983] Ndër çështjet e shumta, ky raport dha hollësi për plagët e shumta dhe të rënda fizike nga dhuna e vazhdueshme që çuan në vdekjen e tij.[1984]

531. Me përjashtim të një numri shumë të vogël personash që i dhanë disa informacione policisë,[1985] duket se asnjë nga banorët nuk u paraqit në polici për të denoncuar vrasjet, keqtrajtimin, apo shkatërrimin e pronës. Gjithashtu nuk u mor asnjë deklaratë nga banorët e fshatit që kishin dijeni për ngjarjet, subjekt i kësaj aktakuze, dhe policia nuk i dha gjykatësit hetues apo prokurorit publik asnjë deklaratë të banorëve apo emra të dëshmitarëve të mundshëm. Gjatë dëshmive u tha se arsyeja për këto mosveprime ishte fakti se banorët nuk dëshironin të bashkëpunonin me policinë.[1986] Në rast se ishte kështu, është e kuptueshme duke patur parasysh sjelljen e disa policëve, sjellje që është vërtetuar gjatë këtij procesi gjyqësor. Mirëpo është për t'u theksuar se policia nuk u përpoq të siguronte bashkëpunimin e banorëve, madje as nuk u përpoq të merrte deklarata prej tyre.

532. Dhoma Gjyqësore vë në dukje suksesin e përpjekjeve të Henry Bolton-it të OSBE-së më 14 gusht, dhe të Peter Bouckaert-it të HRW-së përpara dhe më 23 gusht për

---

të gjitha provat e siguruara. [… Nëqoftëse organet e punëve të brendshme mësojnë për fakte apo dëshmi të reja pas paraqitjes së kallëzimit penal, ato janë të detyruara të hartojnë raportet përkatëse dhe t'ua dërgojnë ato prokurorit publik si shtojcë e kallëzimit penal." *Shih* gjithashtu Provën Materiale P96, Neni 167. Gjithsesi mund të ishin kryer shumë hetime me rëndësi thelbësore për të ruajtur vendin e krimit, dhe provat materiale, si dhe për të identifikuar dëshmitarët e mundshëm në Luboten më 12 gusht 2001, përpara se të përgatitej raporti për gjykatësin hetues dhe prokurorin publik, dhe në një kohë kur prania e një numri të madh policësh të armatosur mund të ndihmonte për ndërmarrjen e këtyre hapave, dhe megjithatë nuk u bë asgjë.

1983 *Shih* më sipër, para. 443.

1984 Prova Materiale P49, f. 14, 31.

1985 *Shih* Provën Materiale P148; 1D189; 1D190.

1986 Petre Stojanovski, T 9191.

të siguruar ndihmën e banorëve ndërkohë që ata përpiqeshin të hetonin se çfarë kishte ndodhur. Fakti se ata përfaqësonin agjenci të pavarura mund të ketë qenë faktor i rëndësishëm në rezultatet e arritura prej tyre dhe informacioni që ata morën mund të ketë qenë i pakonfirmuar dhe i pasaktë në disa aspekte, mirëpo përvoja e tyre të paktën tregon se gjendja e sigurisë nuk ishte aq e keqe sa të mos bëhej asnjë përpjekje për kryerjen e hetimeve.

533. Natyrisht që do të kishte qenë brenda kompetencave ligjore të autoriteteve gjyqësore hetimore dhe prokurorit publik që të kishin qenë më këmbëngulës se këto pista normale hetimore të ndjekura nga policia. Ndonëse raportet policore për mungesën e vazhdueshme të sigurisë mund të japin arsyen përse nuk u bë një gjë e tillë, dëshmitë tregojnë gjithashtu se mendimi mbizotërues që mund të ketë ekzistuar në atë kohë ishte se nuk duhej të bëheshin përpjekje për hetime të zakonshme për shkak të gjendjes së sigurisë në vend në atë kohë. Meqë autoritetet gjyqësore hetimore dhe prokurori publik nuk ishin nën pushtetin ministror të Lube Boshkoskit, Dhoma Gjyqësore nuk ka arsye për nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare në këto çështje. Këtu është e mjaftueshme të vihet në dukje se pati një mungesë serioze veprimi për hetimin e duhur të raporteve që policia u paraqiti autoriteteve gjyqësore hetimore dhe prokurorit publik.

534. Siç është theksuar, policia nën juridiksionin e OVR-së së Çairit tregoi shkujdesje të theksuar në kryerjen e detyrave të saj të zakonshme lidhur me këto hetime. Nuk ka prova që tregojnë se kjo ndodhi sipas udhëzimeve të Lube Boshkoskit apo se ai kishte dijeni për këtë. Është e qartë se ashtu si në rastin e gjykatësit hetues dhe prokurorit publik, raportet që iu paraqitën Lube Boshkoskit theksonin se në Luboten nuk mund të bëheshin hetime për shkak të gjendjes së sigurisë.[1987] Nuk ka bazë për të konkluduar se ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë, apo se gjatë periudhës së Aktakuzës ai kishte dijeni për moskryerjen prej policies të detyrave të saj të zakonshme.[1988]

535. Lube Bushkoski kishte mundësi që të informohej më plotësisht apo të garantonte kryerjen e detyrave nga dega përkatëse e policisë në mënyrë që gjykatësi hetues dhe prokurori publik të ishin në një pozitë më të favorshme për të përcaktuar se çfarë kishte

[1987] Provat Materiale 1D373; 1D374.
[1988] *Shih* më sipër, para. 440-445.

ndodhur në të vërtetë dhe nëse përligjeshin akuza penale kundër ndonjë polici. Dëshmitë nuk tregojnë se Lube Boshkoski ishte shumë i motivuar për këtë aspekt, edhe sikur të kishte patur dijeni për mangësitë e policisë. Ndonëse këto çështje mund të kenë lidhje me përgjegjësinë politike të Lube Boshkoski në lidhje me veprimet e policisë gjatë dhe pas ngjarjeve në Luboten, ato nuk janë përcaktuese për përgjegjësinë e tij penale në bazë të Nenit 7(3) të statutit, lidhur me veprimet e disa policëve.

(d) Përfundime

536. Siç është theksuar, të dhënat që kishte Lube Boshkoski për akuzat lidhur me sjelljen e policisë në Luboten më 12 gusht 2001 dhe më pas, ishin të mjaftueshme së paku për t'a bërë të vetëdijshëm për mundësinë e kryerjes së krimeve prej policisë.. Ai kishte informacion të mjaftueshëm për mundësine e kryerjes së krimeve nga policët. Si epror i tyre, Lube Boshkoski ishte i detyruar t'ia raportonte këtë informacion autoriteteve kompetente përgjegjëse për hetimin e akteve të mundshme penale në mënyrë që çështja të hetohej plotësisht dhe autorët e këtyre akteve të ndëshkoheshin, në rast se një gjë e tillë ishte e justifikueshme. Në kontekstin e Nenit 7(3), ai do t'a kishte përmbushur detyrimin e tij për ndëshkimin e vartësve keqbërës në rast se raportimi i kësaj çështjeje prej tij do të kishte të ngjarë të shkaktonte hetimin e akteve të pretenduara penale. Në kuadrin e detyrave të saj të zakonshme policia e Ministrisë së Brendshme i paraqiti dy raporte autoriteteve gjyqësore hetimore dhe prokurorit publik. Lube Boshkoski u informua se autoritetet gjyqësore ishin vënë në dijeni dhe se po bëheshin përpjekje për kryerjen e një hetimi.[1989] Dhoma Gjyqësore mendon se duke patur parasysh natyrën e ngjarjeve dhe funksionet ligjore të këtyre autoriteteve, këto raporte, ndonëse jo të plota apo të sakta dhe jo të hollësishme për çdo vepër të mundshme penale, ishin të tilla që me gjasë do të kishin çuar në kryerjen e një hetimi. Në fakt, sipas ligjit këto raporte duhej të kishin çuar në një hetim gjyqësor mbështetur nga prokurori publik, për çdo vrasje. Gjatë këtij hetimi gjykatësi hetues dhe prokurori publik duhej të viheshin zyrtarisht në dijeni për akuzat mbi shkelje të policisë që konsistonin në trajtim mizor dhe shkatërrim pa shkak, dhe në këtë mënyrë do të ishin në gjendje të konkludonin nëse përligjej ngritja e akuzave penale. Faktikisht nuk u krye asnjë hetim i përshtatshëm nga autoritetet përgjegjëse. Nuk pati

[1989] *Shih* më sipër, para. 447.

asnjë procedim penal kundër ndonjë polici. Ka disa arsye për këtë, por moskryerja e detyrave nga policia në OVR-në e Çairit dhe mungesa e vendosmërisë nga autoritetet përgjegjëse janë faktorët kryesorë. Lube Boshkoski nuk kishte as pushtet, as kompetencë ndaj autoriteteve përgjegjëse jashtë MB-së. Nuk është vërtetuar se policia nuk i kreu detyrat për shkak të urdhrave të marra nga Lube Boshkoski dhe as se ai kishte dijeni për këtë në periudhën në fjalë, apo se duhej t'a kishte parashikuar një gjë të tillë. Rrjedhimisht nuk u vërtetua se Lube Boshkoski duhej të kishte bërë raportim të mëtejshëm apo duhej të kishte ndërmarrë veprime të tjera për të përmbushur detyrimin e tij sipas Nenit 7(3) të Statutit. Nuk u vërtetua se ai nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme. Ndonëse rrethanat e zbuluara nga dëshmitë tregojnë për mangësi serioze në funksionimin e organeve gjyqësore dhe policore të IRJM-së në atë kohë, Prokuroria nuk ka vërtetuar se Lube Boshkoski mban përgjegjësi penale për çfarë ndodhi.

C. Përfundime mbi përgjegjësinë e Johan Tarçulovskit

1. Roli i Johan Tarçulovskit

537. Në vitin 2001, Johan Tarçulovski shërbente në një njësi sigurimi të Ministrisë së Brendshme. Normalisht, detyra e tij ishte garantimi i sigurisë së bashkëshortes së Presidentit të atëhershëm të IRJM-së, Boris Trajkovski.[1990] Zllatko Keskovski ishte Shefi i Njësisë së Sigurimit të Presidentit dhe epror i Johan Tarçulovskit.[1991] Presidenti zgjodhi Jahan Tarçulovskin personalist sepse ishte i mendimit se një post i tillë mund t'i jepej vetëm një personi të cilin ai e njihte mirë.[1992] Zllatko Keskovski dëshmoi se Johan Tarçulovski gëzonte besimin e madh të Presidentit. Tarçulovski ishte shpesh i pranishëm në shtëpinë e Presidentit.[1993]

538. Siç u tha më lart, më 25 dhe 26 korrik 2001, në stacionin policor PSOLO iu shpërndanë armë dhe uniforma, ndër të tjerëve, edhe punonjësve të agjencisë së sigurimit "Kometa."[1994] Johan Tarçulovski u pa në oborrin e stacionit policor në kohën kur njerëzit

[1990] Zllatko Keskovski, T. 9969-9970; Prova Materiale 1D317.
[1991] Zllatko Keskovski, T. 9948; 9968-9970; Prova Materiale 1D317.
[1992] Zllatko Keskovski, T. 9977-9980.
[1993] Zllatko Keskovski, T. 9980.
[1994] *Shih* më sipër, para. 497.

e "Kometës" erdhën në PSOLO.[1995] Miodrag Stojanovski i kishte pohuar komisionit hetimor për ngjarjet e Lubotenit, se ky grup i "Kometës" udhëhiqej nga Johan Tarçulovski. Mirëpo, në dëshminë e tij, ai nuk i qëndroi besnik këtij rrëfimi për ngjarjet, duke sugjeruar se nuk mund të dinte nëse grupi udhëhiqej nga Johan Tarçulovski pasi në momentin e ardhjes së grupit ai, Stojanovski, ndodhej në zyrën e tij.[1996] Në vazhdim të përpjekjeve të tij për të justifikuar ndryshimin e rrëfimit të tij të mëparshëm, Miodrag Stojanovski tha se prania e Johan Tarçulovskit në PSOLO nuk ishte gjë e jashtëzakonshme në atë kohë pasi Tarçulovski e kishte vendin e tij të punës në vendbanimin e Presidentit që ndodhej afër PSOLO-s, dhe ai vinte shpesh në PSOLO.[1997] Një dëshmitar i Mbrojtjes, Zllatko Keskovski, u përpoq t'a mbështeste këtë qëndrim duke thënë se PSOLO ruante hyrjen në kompleksin e banimit të Presidentit dhe të Kryeministrit dhe se ishte normale që një oficer sigurimi të vinte çdo ditë në PSOLO në lidhje me punën e tij të sigurimit të vendbanimit të Presidentit.[1998] Mirëpo pas kësaj ngjarjeje në PSOLO në korrik 2001, siç u tha gjetkë, Johan Tarçulovski u pa edhe në disa rate të tjera së bashku me punonjës të agjencisë "Kometa,"[1999] gjë që mbështet deri diku mendimin se prania e tij në PSOLO në momentin e mbërritjes së grupit të "Kometës" për të marrë armë dhe uniforma nuk ishte e rastësishme, siç u pohua edhe nga Miodrag Stojanovskit në rrëfimin e tij fillestar. Për më tepër, siç i konfirmoi Johan Tarçulovski Komisionit Hetimor në vitin 2003, ai i kishte zgjedhur personalisht këta persona, të cilët ishin armatosur dhe pajisur në PSOLO.[2000] Dhoma Gjyqësore nuk u bind në besueshmërinë e dëshmive të Stojanovskit dhe të Keskovskit; dëshmitë e tyre dukej se ishin të sajuara në dobi të Johan Tarçulovskit. Ky vlerësim konfirmohet dukshëm nga dëshmitë e tjera mbi rolin e Johan Tarçulovskit në raste të tjera lidhur me punonjësit e agjencisë "Kometa," përfshirë armatimin dhe pajisjen e tyre në OVR-në e Çairit.[2001]

539. Zllatko Keskovski dëshmoi gjithashtu se më 10 gusht 2001, Johan Tarçulovski i telefonoi dhe i kërkoi leje për t'u larguar, duke thënë se një person i afërt i tij ishte vrarë

[1995] Miodrag Stojanovski; T 6784-6803-6804; 6833.
[1996] Miodrag Stojanovski; T 6840-6841.
[1997] Miodrag Stojanovski; T 6833.
[1998] Zllatko Keskovski, T 10037-10038.
[1999] *Shih* më lart, para. 106.
[2000] Provat Materiale P379.01; 379.02.
[2001] *Shih* më lart, para. 106.

në incidentin me minë tokësore në Stanet e Lubotenit.[2002] Zllatko Keskovski informoi Presidentin për këtë. Presidenti dhe Keskovski urdhëruan Johan Tarçulovskin që të vinte në Shkup.[2003] Zllatko Keskovski dëshmoi se Johan Tarçulovski mbërriti në zyrën e Presidentit në pasditen e asaj dite. Presidenti i shprehu ngushëllimet. Zllatko Keskovski tha se Presidenti urdhëroi Johan Tarçulovskin të shkonte dhe të qëndronte në zonën e Lubancës dhe ta informonte mbi zhvillimet në atë zonë. Mirëpo ai tha gjithashtu se Tarçulovski kishte marrë disa ditë leje.[2004] Johan Tarçulovski e ka prejardhjen nga fshati Lubancë.[2005]

540. Në përpjekje të dukshme për të konfirmuar dëshminë e tij se Presidenti i kërkoi Tarçulovskit ta informonte për zhvillimet në zonën e Lubancës, Zllatko Keskovski deklaroi se më pas Presidenti dukej se kishte dijeni për gjendjen në atë zonë. Zllatko Keskovski sugjeroi se mbi këtë bazë ai arriti në përfundimin se Presidenti ishte informuar nga Johan Tarçulovski.[2006] Zllatko Keskovski përshkroi gjithashtu një rast kur u dërgua diku me mision nga Presidenti, siç duket për të treguar se nuk ishte diçka e pazakontë që Presidenti të dërgonte oficerët e sigurisë së tij me qëllim që t'i raportonin atij.[2007]

541. Përveç vlerësimit të saj lidhur me besueshmërinë e një aspekti të dëshmisë së Zllatko Keskovskit, Dhoma Gjyqësore vëren gjithashtu një mospërputhje në dëshminë e tij për rolin e Johan Tarçulovskit në Lubancë më 10-12 gusht. Nga njëra anë, ai dëshmoi se Tarçulovski u urdhërua të shkonte dhe të qëndronte në zonën e Lubancës dhe t'i raportonte Presidentit për zhvillimet e atjeshme. Mirëpo nga ana tjetër, ai thotë se Presidenti i dha disa ditë leje Tarçulovskit. Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranojë si të vërtetë dëshminë e Zllatko Keskovskit se Johan Tarçulovski shkoi në Lubancë me kërkesën e tij për shkak të vdekjes së një personi. Dhoma Gjyqësore konkludon se Johan Tarçulovski u dërgua në Lubancë, por nuk mund të arrijë në përfundimin nëse u urdhërua nga Presidenti apo nga një prej eprorëve të tij në ministri, si Zllatko Keskovski. Faktet që do të trajtohen tani prej Dhomës Gjyqësore, së bashku me çka është trajtuar deri tani, e

[2002] Zllatko Keskovski, T 10001.
[2003] Zllatko Keskovski, T 10002.
[2004] Zllatko Keskovski, T 10003-10004.
[2005] M052, T 8256.
[2006] Zllatko Keskovski, T 10005-10007.
[2007] Zllatko Keskovski, T 10142-10143.

bindin Dhomën Gjyqësore për të konkluduar se Johan Tarçulovski u urdhërua të drejtonte policinë në një operacion të planifikuar në Luboten, i cili faktikisht u krye nën drejtimin e Tarçulovskit mëngjesin e 12 gushtit 2001.

542. Siç u diskutua më sipër, më 10 gusht 2001, Johan Tarçulovski ishte në stacionin policor të Çairit. Ai ishte me Zoran Kërstevskin dhe Goçe Ralevskin. Ai u takua me shefin e OVR-së në Çair, Lube Kërstevskin, dhe siguroi transportimin e një grupi personash të veshur me uniforma të policisë rezerviste, të cilët kishin ardhur në oborrin e stacionit policor. Në këtë grup ishin njerëz nga agjencia "Kometa".[2008] Më pas, Johan Tarçulovski shkoi nga Çairi në Lubancë, së bashku me grupin e sapopërmendur, për të cilët ishte siguruar transporti nga OVR-ja e Çairit. Të paktën disa nga pjesëtarët e grupit u transportuan më pas në një shtëpi pushimi për fëmijë pranë Lubancës, ku kaluan natën dhe, pa dyshim, edhe një natë më pas.[2009] Shtëpia e pushimit për fëmijë përdorej në atë kohë nga ushtria. Johan Tarçulovski u pa atë mbrëmje në shtëpinë e pushimit për fëmijë.[2010]

543. Mbrëmjen e 10 gushtit 2001, Johan Tarçulovski mori pjesë në një mbledhje në postkomandën e Batalionit të Tretë Gardist në Lubancë. Siç është theksuar më sipër, në këtë mbledhje ndër të tjerë ishin të pranishëm, Lube Kërstevski, shefi i OVR-së në Çair, dhe majori Despodov nga ushtria. Johan Tarçulovski diskutoi me pjesëmarrësit e tjerë lidhur me një operacion për të hyrë në fshatin Luboten. U tha se Johan Tarçulovski e kishte planifikuar operacionin.[2011] Një raport ushtarak i referohet operacionit si "aksion i Johan Tarçulovskit".[2012] Ai u zotua të ndërhynte tek Presidenti në mënyrë që ky të lëshonte një urdhër në bazë të të cilit trupat e majorit Despodov do të siguronin mbështetje me zjarr për operacionin.[2013] Operacioni duhej të kryhej mëngjesin e 11 gushtit, por ai e shtyu një ditë.

2008 *Shih* më sipër, para. 107.
2009 *Shih* më sipër, para. 110.
2010 M084, T 1478-1479.
2011 M052, T 8270.
2012 Prova Materiale P303.
2013 *Shih* më sipër, para. 111-112.

544. Në orët e pasdites së 11 gushtit 2001, një grup policësh rezervistë të udhëhequr nga Johan Tarçulovski kryen një mision zbulimi në fshatin Luboten.[2014] Rreth orës 17:00 ose 18:00, Johan Tarçulovski u kthye në postkomandën e Batalionit të Tretë Gardist dhe e pyeti majorin Despodov nëse kishte marrë ndonjë urdhër lidhur me operacionin e planifikuar. U dëshmua se pas kësaj Johan Tarçulovski e vendosi majorin Despodov në kontakt telefonik me një person, të cilin majori Despodov e identifikoi si Presidenti. U dëshmua gjithashtu se gjatë bisedës Presidenti i dha udhëzime të përgjithshme majorit lidhur me operacionin e planifikuar dhe tha se do të fliste me gjeneralin Mitrovski dhe se do t'i telefonte përsëri Despodovit.[2015] Gjatë kontakteve të tija atë ditë me majorin Despodov, Johan Tarçulovski i tha Despodovit se operacioni do të kryhej me apo pa ndihmën e trupave të Despodovit, çka tregon pushtetin që ushtronte Johan Tarçulovski.[2016] Në një raport ushtarak të asaj kohe ai citohet të ketë thënë se "… nesër në orën 04:30 unë do të filloj operacionin", çka tregon qartë marrjen përsipër të kompetencave të plota.[2017]

545. Ka dëshmi, të cilat ndonëse nuk të çojnë në konkluzione përfundimtare, përputhen në faktin se Johan Tarçulovski fjeti në shtëpinë e pushimit për fëmijë në Lubancë. Përpara dhënies së dëshmisë prej tij në këtë proces gjyqësor, togerit Jurishiq iu tregua një tabelë me fotografi ku ai njohu personin për të cilin mendonte se kishte qenë i pranishëm në shtëpinë e pushimit për fëmijë, ndonëse nuk ishte i sigurtë për këtë.[2018] Fotografia të cilën dëshmitari e shënoi në atë rast, është e Johan Tarçulovskit. M052 dëgjoi gjithashtu se një grup që do të merrte pjesë me Johan Tarçulovskin në operacionin më 12 gusht 2001, e kaloi natën në shtëpinë e pushimit për fëmijë.[2019]

546. Vlen të theksohet se në këtë çështje gjyqësore dëshmitë nga policia apo në lidhje me identitetin e policëve që hynë në Luboten mëngjesin e 12 gushtit 2001, janë të pakta. Në fakt, pavarësisht prej hetimeve të autorizuara nga Lube Boshkoski dhe përgjegjësisë së policisë së krimeve të OVR-së në Çair, autoriteteve gjyqësore dhe prokurorit publik

2014 *Shih* më sipër, para. 124.
2015 *Shih* më sipër, para. 126-130.
2016 *Shih* më lart, para. 125.
2017 Prova Materiale P303.
2018 Marijo Jurishiq, T 3305-3307; Prova Materiale P368; Thomas Kuehnel, T 7954-7957.
2019 M052, T 8275.

për hetimin e vrasjeve dhe ngjarjeve të tjera, dëshmitë tregojnë se, me fare pak përjashtime, ende nuk dihet identiteti i personave që hynë në fshat. Dokumentet e policisë që janë paraqitur si dëshmi, nuk bëjnë identifikimin e tyre**.** Banorët që u keqtrajtuan nga policët dhe dëshmuan për këtë, nuk ishin në gjendje të shikonin fytyrat e këtyre policëve pasi në pjesën më të madhe të kohës këta banorë ishin urdhëruar t'a mbanin kokën të mbuluar. Ajo çka përgjithësisht përshkruan banorët u referohej policëve me uniforma, të cilët mbanin maska në fytyrë. Disa banorë mendonin se kishin arritur të identifikonin disa nga policët si banorë vendas të kombësisë maqedonase bazuar vetëm në zërat e këtyre personave, e pamjaftueshme për një identifikim të saktë. Pak dokumente policore për shpërndarjen e armëve dhe pajisjeve të tjera janë një mjet për identifikimin e disa prej këtyre policëve. Por me përjashtim të këtyre rasteve, dëshmitë nuk janë të mjaftueshme për përcaktimin e identitetit të policëve.

547. Dhoma Gjyqësore pranon se ka patur shumë raste kur policët mbanin maska në fytyrë, çka tregon për një përpjekje të qëllimshme për të penguar identifikimin e tyre. Mosidentifikimi prej policëve të tjerë i policëve që hynë në Luboten më 12 gusht, zbulon orvatjen e tyre të vendosur dhe skandaloze për të mbrojtur këta persona si dhe përbën dështim të rëndë në zbatimin e detyrave të tyre në kuadrin e OVR-së në Çair, dështim i cili duket se ka gjetur mbështetjen e zyrtarëve më të lartë të policisë pasi nuk është korigjuar për një kohë të gjatë. Ky është konteksti në të cilin Dhoma Gjyqësore duhet të trajtojë dëshmitë e kufizuara për Johan Tarçulovskin më 12 gusht 2001.

548. Veç vërtetimit të rëndësisë së pranisë dhe rolit të Johan Tarçulovskit në mbledhjen e planifikuar në postkomandën e Batalionit të Tretë Gardist më 10 gusht 2001, Dhoma Gjyqësore konkludon se dëshmitë tregojnë se Johan Tarçulovski ishte në kontakt telefonik me përfaqësuesit e ushtrisë, të cilët patën një rol kyç aktiv në mbështetje të operacionit policor në 12 gusht 2001. Ky konkluzion u arrit pavarësisht mohimeve prej këtyre oficerëve të ushtrisë në dëshmitë e tyre për kontakte të tjera me Johan Tarçulovskin. Togeri Jurishiq fillimisht deklaroi se nuk kishte shkëmbyer numra telefonikë me ndonjë nga policët që kishte parë në shtëpinë e pushimit për fëmijë atë fundjavë.[2020] Më pas ai korrigjoi veten duke thënë se kishte shkëmbyer numra me

[2020] Marijo Jurishiq, T 3307-3308.

drejtuesin e policëve pas ardhjes së këtij.[2021] Numri i telefonit që përdorte togeri Jurishiq në atë kohë ishte në listën e thirrjeve telefonike të bëra nga telefoni që përdorte Johan Tarçulovski në atë kohë.[2022] Këto thirrje janë regjistruar më 11 gusht 2001, në orën 10 :30 dhe më 12 gusht 2001, në orën 03 :47.[2023] Ndonëse togeri Jurishiq sugjeroi se nuk i kujtohet asnjë nga këto biseda telefonike,[2024] Dhoma Gjyqësore konkludon se ai ka bërë dy bisedat telefonike me Johan Tarçulovskin, biseda e dytë u bë kur priteshin të fillonin përgatitjet për veprimet në 12 gusht. Dhoma Gjyqësore i kushton gjithashtu rëndësi përkufizimit prej togerit Jurishiq, të rolit të Johan Tarçulovskit si "drejtues të grupit të policëve", me të cilin, Dhomës Gjyqësore konkludon, se ai shkëmbeu numrat e telefonit.[2025]

549. Po kështu, edhe Kapiten Grozdanovski mohoi të kishte shkëmbyer numrat e telefonit me Johan Tarçulovskin.[2026] Atij nuk i kujtohej të kishte patur ndonjë thirrje telefonike nga Johan Tarçulovski më 11 gusht 2001.[2027] Megjithatë, numri i telefonit të tij është në listën e thirrjeve telefonike të bëra nga telefoni i Johan Tarçulovskit. Kapiten Grozdanovski mohoi të kishte marrë ndonjë thirrje telefonike të tillë.[2028] Por lista e thirrjeve telefonike të marra në telefonin e Johan Tarçulovskit tregon se në fakt Kapiten Grozdanovski i bëri një telefonatë Johan Tarçulovskit më 12 gusht 2001, në orën 03 :56. Kapiten Grozdanovski e mohoi këtë telefonatë duke argumentuar se ndoshta telefoni i tij ishte përdorur nga dikush tjetër.[2029] Dhoma Gjyqësore është e bindur për pavërtetësinë e mohimit nga kapiteni Grozdanovski të këtyre kontakteve telefonike me Johan Tarçulovskin. Ashtu siç u konstatua lidhur me thirrjen telefonike bërë togerit Jurishiq në më 12 gusht, në orën 03 :47, thirrja në orën 03 :56 u bë në një kohë kur priteshin të fillonin përgatitjet për veprimet e 12 gushtit 2001. Këto mohime të rreme duket se janë një përpjekje tjetër e Kapiten Grozdanovskit për të distancuar veten nga Johan Tarçulovski dhe veprimet e policisë në Luboten më 12 gusht. Këto gënjeshtra janë një

[2021] Marijo Jurishiq, T 3308.
[2022] Siç duket telefoni ishte regjistruar në emrin e një farë Z. Todorovski; Thomas Kuehnel, T 7978-7979. Megjithatë, ka dëshmi të cilat Dhoma Gjyqësore i pranon, se në atë kohë telefoni përdorej nga Johan Tarçulovski; M052, T 8322; Prova Materiale P231, f. 4.
[2023] Marijo Jurishiq, T 3311-3313; Prova Materiale P369.
[2024] Marijo Jurishiq, T 3312-3313.
[2025] Marijo Jurishiq, T 3308.
[2026] Nikollçe Grozdanovski, T 10482.
[2027] Nikollçe Grozdanovski, T 10486-10487.
[2028] Nikollçe Grozdanovski, T 10489-10490; 10514; Prova Materiale P369.
[2029] Nikollçe Grozdanovski, T 10490-10492; Prova Materiale P369.

nga aspektet e peshuara nga Dhoma Gjyqësore në refuzimin e dëshmive të tjera të Kapiten Grozdanovskit lidhur me ngjarjet në 12 gusht.

550. Dhoma Gjyqësore është e bindur se si Togeri Jurishiq po ashtu dhe Kapiten Grozdanovski e njihnin Johan Tarçulovskin në kohën e ngjarjeve në Luboten dhe se shkëmbyen numrat e telefonit me të. Meqë të gjithë ata ishin në zonën e Lubotenit në atë kohë dhe të përfshirë në ato ngjarje, Dhoma Gjyqësore konkludon se nga rrethanat është e qartë se bisedat telefonike midis këtyre personave u bënë lidhur me përgatitjet për operacionin në fshat. Këto biseda janë tregues, ndër të tjera, i rolit planifikues dhe koordinues të Johan Tarçulovskit. Dhoma Gjyqësore nuk ka prova të drejtpërdrejta për mjete të tjera të mundshme të komunikimit, përveç telefonit, në dispozicion të Johan Tarçulovskit dhe këtyre dy oficerëve të ushtrisë, të cilët ishin vendosur në pozicione dominuese nga ku mund të vëzhgonin Lubotenin gjatë operacionit policor. Një nga këto mjete mund të ketë qenë radioja. Johan Tarçulovski ishte pajisur me radio në OVR-në e Çairit.[2030] Por pavarësisht nga mjetet e përdorura, duket se ka patur komunikim midis tyre. Meqë, ashtu siç ka konkluduar Dhoma Gjyqësore gjetkë në këtë Aktgjykim, operacioni filloi me granatime të kufizuara të një zonë shqiptare etnike të fshatit nga ushtria, në afërsi të pikës së hyrjes së policisë në fshat,[2031] është e qartë se nevojitej komunikim, të paktën për të siguruar ndërprerjen e këtyre granatimeve përpara se policia të hynte në Luboten. Lidhur me këtë aspekt, Dhoma Gjyqësore vë në dukje gjithashtu se nuk e pranon si të ndershme dëshminë sipas së cilës ushtria e ndërpreu zjarrin për arsye se nga pozicionet e tyre ushtarakët vunë re praninë (e papritur) të një grupi policësh që po lëviznin në fshat.

551. Dhoma Gjyqësore pranon gjithashtu se para hyrjes së policisë në fshat dhe granatimit me mortaja prej ushtrisë (duke hedhur poshtë si të pandershme atë pjesë të dëshmisë së M037 ku ai, për arsye të qarta personale, sugjeron se kjo ndodhi shumë më vonë në mëngjes dhe pas një pritjeje të gjatë), Johan Tarçulovski kërkoi që një autoblindë Hermelinë e policisë nga Mirkoci të priste në postbllokun e Stranishtës derisa të sigurohej mbështetje me zjarr mortajash.[2032] Kjo duket se konfirmon faktin që në atë moment Johan

[2030] *Shih* më sipër, para. 113.
[2031] *Shih* më sipër, para. 39; 42.
[2032] *Shih* më lart, para. 41.

Tarçulovski u informua për fillimin së shpejti të granatimit nga ushtria me mortaja. Vetë prania e Hermelinës është një provë tjetër e përfshirjes së Johan Tarçulovskit në planifikimin e operacionit, duke qenë se Hermelina u vu në dispozicion nga shefi i OVR-së së Çairit me kërkesë të Tarçulovskit. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në dëshminë sipas së cilës edhe Lube Boshkoski miratoi personalisht përdorimin e Hermelinës,[2033] pasi dëshmitari që dha këtë dëshmi dukej se u orvat të tregonte se ai nuk kishte asnjë përgjegjësi për përdorimin e Hermelinës në operacion. Dhoma Gjyqësore konkludon se përdorimi i Hermelinës në operacionin e 12 gushtit u bë me kërkesën specifike të Johan Tarçulovskit dhe kjo kërkesë u miratua, së paku prej shefit të OVR-së në Çair.

552. Dëshmitë nuk janë konkrete përsa u përket lëvizjeve të policisë përmes Lubotenit më 12 gusht, megjithëse përputhen në faktin se policët lëvizën në një grup përgjatë rrugës kryesore përmes fshatit dhe u përfshinë si grup në ngjarje konkrete, duke filluar me të shtënat kundër shtëpisë së Jusufëve dhe duke përfunduar me luftimin përtej skajit më të largët të fshatit, në shtëpitë e familjes Jashari.

553. Në këtë kontekst ndodhën ngjarjet në shtëpinë e Adem Ametovskit. Ka dëshmi konkrete të pranuara prej Dhomës Gjyqësore,[2034] se Johan Tarçulovski ishte së bashku me grupin e personave të veshur me uniforma kamuflimi, me fjalë të tjera policë sipas përfundimit të Dhomës Gjyqësore, të cilët kapën dhjetë banorë të fshehur në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit dhe pastaj i keqtrajtuan rëndë në oborrin e përparmë të asaj shtëpie. Në atë vend u keqtrajtua rëndë Atulla Qaili dhe, Dhoma Gjyqësore konkludon se një apo më shumë policë të këtij grupi hapën zjarr dhe vranë dy banorë, Sulejman Bajramin dhe Muharem Ramadanin, në rrugën pranë asaj shtëpie.[2035] Një banor i tretë u qëllua në dorë.

554. Dhoma Gjyqësore konkludon gjithashtu se Johan Tarçulovski ishte i pranishëm edhe tek shtëpitë e familjes Jashari pranë të cilave grupi i policëve dhe ushtria hapën zjarr duke vrarë tri vetë, dhe se ai dha udhëzime duke thënë se nuk ishte e nevojshme që

[2033] M052, T 8288-8289.
[2034] M037, T 786; *Shih* më sipër, shënim 200.
[2035] *Shih* më sipër, para. 55; 57.

policia të verifikonte vrasjet e këtyre tre personave pasi ishte gjendje lufte.[2036] Dëshmitë tregojnë gjithashtu se armët dhe municioni që policia gjeti pranë kufomave të tre personave të vrarë iu treguan Johan Tarçulovskit, i cili urdhëroi që ato të transportoheshin me Hermelinë. Më pas armët dhe municionet u transportuan me Hermelinën në shtëpinë e Bracës, ku iu treguan Lube Boshkoskit.[2037]

555. Dëshmitë e diskutuara deri këtu janë të mjaftueshme për t'a bindur Dhomën Gjyqësore se Johan Tarçulovski ishte drejtuesi i operacionit të policisë, e cila hyri në fshatin Luboten më 12 gusht, dhe se në këtë rol ai ishte përgjegjës për përgatitjen e operacionit. Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur nga dëshmitë se ai ishte në krye të policëve që lëvizën përmes fshatit më 12 gusht.

556. Ekzistojnë edhe prova të tjera të rëndësishme në rrëfimet e Johan Tarçulovskit në vitin 2003 para një komisioni hetimor për opeacionin në Luboten. Këto rrëfime janë pranuar si dëshmi lidhur me Johan Tarçulovskin, por jo si dëshmi kundër Lube Boshkoskit. Në një Notë Zyrtare të datës 3 mars 2003[2038] Johan Tarçulovski përshkruan shkurtimisht se së bashku me policët rezervistë, që kishin ardhur vullnetarisht:

> … ne hymë në fshat me vetëm 20 veta, me qëllim që të hynim në shtëpitë në të cilat mund të ishte strehuar ai [Xhavit Hasani], por na u desh të prisnim deri sa të zbardhte sepse kundër nesh u hap zjarr nga ana tjetër. Pastaj sulmuam pozicionet nga të cilat ishte hapur zjarr kundër nesh. Operacioni vazhdoi deri në orën 15 :00, sepse ne hymë vetëm në ato shtëpi, të cilat, sipas informacioneve që kishim, ishin në duart e Xhavitit dhe terroristëve, si dhe në dy apo tri shtëpi, nga të cilat kishte patur të shtëna kundër nesh. Njerëzit që gjetëm në fshat, gratë, fëmijët dhe të moshuarit, u kontrolluan dhe u lanë të lirë. 15 veta që u gjetën të fshehur në bodrumin e një prej tri shtëpive u arrestuan.[2039]

557. Në një takim me Komisionin Hetimor më 12 nëntor 2003 Johan Tarçulovski dha informacione të mëtejshme për operacionin në Luboten. Në atë rast ai ishte i shoqëruar prej avokatit të tij. Komisioni nuk kishte kompetenca detyruese. Në takim u mbajt procesverbal[2040] që nuk pasqyron fjalë për fjalë çfarë u tha, por gjithsesi procesverbali ofron një rrëfim të besueshëm të thënieve të tij për çështjet më të rëndësishme. Procesverbali është i nënshkruar nga Johan Tarçulovski. Më konkretisht, në të thuhet:

2036 *Shih* më sipër, para. 69.
2037 *Shih* më sipër, para. 69; 428.
2038 Prova Materiale P379.01.
2039 Prova Materiale P379.01.
2040 Prova Materiale P379.02.

> …Tarçulovski u përgjigj se kishte qenë në Luboten me një grup të madh njerëzish, më tepër se 100 veta, dhe se i njihte. Përsa u përket veprimeve të tyre, ai refuzoi të përgjigjej. Lidhur me armët, Tarçulovski u përgjigj se gjatë veprimeve të tyre në fshatin Luboten, ata ishin të armatosur vetëm me automatikë. …
>
> Tarçulovski shpjegoi se aksioni në fshatin Luboten filloi midis orës 03:00 dhe 04:00 dhe vazhdoi deri rreth mesditës. Gjatë aksionit ata nuk patën kontakt me askënd, në fshat nuk kishte anëtarë të forcave të rregullta apo zyrtarë të lartë të policisë. Në atë kohë Ministri i Brendshëm erdhi në hyrje të fshatit, por Tarçulovski nuk e pa atë personalisht. Gjatë aksionit në Luboten, ata hynë në dy shtëpi, nga të cilat ishte hapur zjarr dhe arrestuan 10 persona të cilët më pas u morën në dorëzim nga policia e rregullt e vendosur në hyrje të fshatit. Tarçulovski tha se ishin ndërmarrë masa vetëm kundër ndërtesë, ku, sipas informacioneve, ishin strehuar persona në kërkim, dhe i pyetur se kush e kishte dhënë këtë informacion, ai u përgjigj se këtë informacion e kishte marrë vetë nëpërmjet kontakteve të tij personale.[2041]

Në këtë rast ai tha gjithashtu se "kishte shkuar në Luboten me dëshirën dhe vullnetin e vet, domethënë askush nuk e kishte urdhëruar të shkonte në Luboten."[2042] Megjithëse u pyet shprehimisht se kush ishte me të në Luboten, Johan Tarçulovski u përgjegj se "kishte vendosur të mos i tregonte emrat e tyre".[2043] Në të dy rastet ai theksoi se personat që ishin me të, ishin rezervistë vullnetarë, të cilët ishin pajisur me armë në stacionin policor PSOLO. Në rastin e dytë ai tha se Ministri i Brendshëm e kishte urdhëruar t'i zgjidhte këta persona për të ruajtur ndërtesa shtetërore të rëndësisë së veçantë.[2044]

558. Ka mospërputhje midis këtyre dy rrëfimeve, si dhe mospërputhje të mëdha midis dëshmisë së bërë publike dhe rrëfimeve të Johan Tarçulovskit para komisionit. Nuk përmendet fare fakti se pati të vrarë dhe të keqtrajtuar mizorisht, dhe se shumë shtëpive iu vu zjarri qëllimisht. Këto incidente hedhin poshtë deklaratat e Johan Tarçulovskit për operacionin se qëllimi ishte kontrollimi i shtëpive ku mendohej se kishte terroristë. Dëshmitë tregojnë gjithashtu se policët që hynë në fshat ishin të armatosur më shumë se sa thjesht me Kallashnikovë dhe se veprimet e tyre mbështeteshin nga një Hermelinë, e cila transportonte edhe lëndë djegëse për t'u vënë zjarrin shtëpive. Për më tepër, megjithëse pranon se i përzgjodhi personalisht vullnetarët e policisë rezerviste dhe se ishte me ta gjatë gjithë operacionit në fshat,[2045] Johan Tarçulovski nuk pranon haptasi se personi që udhëhoqi operacionin, ishte ai vetë. Për arsyet e përmendura më sipër, Dhoma

[2041] Prova Materiale P379.02.
[2042] Prova Materiale P379.02.
[2043] Prova Materiale P379.02.
[2044] Prova Materiale P379.02.
[2045] Referenca e përsëritur "ne" në Provën Materiale P379.01.

Gjyqësore është bindur se Johan Tarçulovski ishte personi që udhëhoqi operacionin, gjatë të cilit u bë shoqërimi i personave të arrestuar për në shtëpinë e Bracës.

559. Johan Tarçulovski sugjeron gjithashtu se rezervistët u armatosën dhe u pajisën në stacionin policor PSOLO. Por dëshmitë tregojnë se kjo është e saktë vetëm për disa prej tyre të cilët u pajisën në korrik 2001. Ai nuk thotë se shumë prej këtyre personave u armatosën dhe u pajisën në OVR-në e Çairit më 10 dhe 11 gusht. Duke patur parasysh shumë pika të trajtuara në dëshmitë e sapodiskutuara, Dhoma Gjyqësore konstaton se sugjerimi i Johan Tarçulovskit se ai shkoi në Luboten "me dëshirën e vet" dhe jo në bazë të urdhrave të dikujt, është tërësisht i pabesueshëm. Faktet hedhin plotësisht poshtë pretendimin se çfarë ndodhi ishte një ngjarje spontante në të cilën Johan Tarçulovski dhe më tepër se 100 policë rezervistë u mblodhën së bashku, gjetën armë, municione, pajisje, transport dhe strehim, mblodhën të dhëna nëpërmjet kontakteve personale, siguruan bashkëpunimin e policisë dhe ushtrisë, dhe patën kaq sukses sa që edhe vetë Ministri erdhi për të parë çfarë po ndodhte. Duhet theksuar se Mbrojtja paraqiti prova dhe parashtroi se Presidenti ishte i përfshirë personalisht në mbështetjen e operacionit.

560. Dhoma Gjyqësore është plotësisht e bindur dhe konkludon se Johan Tarçulovski ishte personi në komandë të një operacioni policor për të hyrë në fshatin Luboten më 12 gusht 2001 dhe se ai ishte përgjegjës për përgatitjen e operacionit. Dhoma Gjyqësore konkludon gjithashtu se ai i udhëhoqi personalisht policët gjatë lëvizjes së tyre përmes fshatit më 12 gusht.

2. Përgjegjësia e Johan Tarçulovskit

561. Në Aktakuzë, i Akuzuari Johan Tarçulovski ngarkohet me përgjegjësi penale individuale në bazë të Nenit 7(1) të Statutit për urdhërimin, planifikimin, nxitjen apo ndihmën dhe inkurajimin e krimeve të përmendura në Nenin 3 të Statutit dhe të përshkruara në Aktakuzë, si dhe për kryerjen e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.[2046]

[2046] Aktakuza, para. 3.

(a) Urdhërimi, planifikimi, nxitja dhe ndihma dhe inkurajimi

562. Duket se përgatitjet për operacionin policor filluan mbrëmjen e po asaj dite, kur terroristët për të cilët besohej se i përkisnin UÇK-së, vranë dhe plagosën shumë ushtarë duke përdorur një minë tokësore në një vend pranë Lubotenit. Fillimisht u planifikua që operacioni të zhvillohej të nesërmen në mëngjes, por ai u shty për një ditë.[2047] Disa nga ushtarët e vrarë ishin nga Lubanca, fshat me popullsi maqedonase etnike ngjitur me Lubotenin. Persona për të cilët mendohej se ishin anëtarë të UÇK-së dhe që kishin marrë pjesë në sulmin me minë tokësore, pas sulmit u panë duke u tërhequr drejt Lubotenit, dhe, sipas raporteve të tjera, duke hyrë në të. Incidenti me minë tokësore në Stanet e Lubotenit ndodhi vetëm dy ditë pas një sulmi tjetër të UÇK-së në rrugën Shkup-Tetovë pranë fshatit Grupçin (zona e Karpallëkut), gjatë të cilit u vranë 10 ushtarë.[2048] Siç është theksuar gjetkë në këtë Aktgjykim, një valë zemërimi dhe trazirash përfshiu popullsinë maqedonase etnike në zonat ku përkatësisht u kryen këto sulme.[2049] Nga dëshmitë mësohet për veprime të qytetarëve të zemëruar pas çdo sulmi, që tregon dëshirën e tyre për të vepruar me dhunë kundër shqiptarë etnikë që jetonin në zonat e lartpërmendura. Në zonën e Lubotenit, pas sulmit me minë tokësore, një numër i madh maqedonasish etnikë të armatosur me çfarë të mundnin, u nisën për t'u përleshur me banorët shqiptarë që po përpiqeshin të largoheshin nga Luboteni, dhe një njësi e posaçme policore u dislokua për t'i mbajtur të dy grupet larg njëri-tjetrit.[2050]

563. Grumbullimi i policëve rezervistë në mbrëmjen e 10 gushtit dhe më 11 gusht duke përfshirë edhe angazhimin e punonjësve të agjencisë së sigurisë Kometa, masat e marra për armatimin, pajisjen dhe strehimin e disa prej tyre, dhe zhvillimi i mbledhjes së përfaqësuesve të lartë të ushtrisë dhe policisë së zonës me Johan Tarçulovskin mbrëmjen e 10 gushtit, të gjitha sugjerojnë ngut në organizimin e operacionit. Johan Tarçulovski, i cili udhëhoqi operacionin policor, ishte nga Lubanca. Nga shpërthimi i minës tokësore më 10 gusht ishte vrarë një person i afërt i tij.[2051] Dhoma Gjyqësore konkludon se pavarësisht prej implikimit ose mosimplikimit të drejtpërdrejtë të Presidentit, të gjitha

[2047] *Shih* më sipër, para. 109; 113.
[2048] *Shih* më sipër, para. 229.
[2049] *Shih* më sipër, para. 105; 123; 229.
[2050] *Shih* më sipër, para. 82.
[2051] *Shih* më sipër, para. 539.

këto aspekte tregojnë se operacioni i Lubotenit ishte reagim i drejtpërdrejtë si përgjigje ndaj sulmit me minë tokësore më 10 gusht.

564. Dhoma Gjyqësore konkludon se dëshmitë e diskutuara hollësisht më sipër në këtë Aktgjykim, vërtetojnë se Johan Tarçulovski e udhëhoqi personalisht operacionin policor më 12 gusht, dhe se ishte së bashku me grupin e policëve gjatë lëvizjes së tyre përmes fshatit nga ana e Lubancës, përgjithësisht përgjatë rrugës kryesore për në lagjet e jashtme të fshatit, nga ku rruga vazhdon për në Rashtak. Pastaj policët u kthyen duke u larguar nga fshati dhe shkuan drejt Lubancës. Policët nuk shkelën në të gjitha rrugët e fshatit dhe nuk hynë në të gjitha shtëpitë apo në të gjitha shtëpitë e banuara nga shqiptarët etnikë. Nuk pati ndonjë rregullsi në bastisjet e shtëpive. Policët lëvizën kryesisht përgjatë rrugës kryesore dhe vepruan ndaj shtëpive në anë të kësaj rruge, duke përfshirë një devijim të shkurtër ku rruga degëzohet, si dhe ndaj shtëpive afër asaj rruge.

565. Dhoma Gjyqësore konkludon se në këto rrethana veprimet e kryera prej grupit të policëve në fshat, në praninë e drejtuesit të grupit, Johan Tarçulovskit, janë tregues të rëndësishëm dhe të besueshëm të objektivit të operacionit, synuar prej Johan Tarçulovskit.

566. Dhoma Gjyqësore konkludon se grupi i policëve ishte i madh në numër, siç është shënuar gjetkë, së paku 60-70 dhe ndoshta më shumë se 100 vetë, të gjithë të armatosur mirë, të pajisur me llojshmëri armësh, duke përfshirë bomba dhe lëndë shpërthyese. Pasojat e veprimeve të policëve në fshat tregojnë se ata kishin marrë me vete sasira të konsiderueshme benzine apo lëndësh djegëse, të cilat, siç tregojnë rrethanat, u transportuan me Hermelinën që shoqëroi grupin, si për shkak të peshës po ashtu dhe për arsye sigurie në rast të ndonjë qëndrese të armatosur.

567. Veprimi i parë i grupit në fshat ishte hapja me shpërthim e portës së një shtëpie të një familjeje shqiptare etnike (Jusufët), të shtëna të shumta të disa policëve drejt shtëpisë si dhe përmes derës së përparme të hapur, duke qëlluar për vdekje një burrë të paarmatosur me rroba të zakonshme civile, teksa përpiqej të mbyllte derën. Provat nuk vërtetojnë ndonjë lidhje të viktimës me UÇK-në, i cili qartësisht nuk paraqiste asnjë kërcënim ndaj policisë kur u qëllua, dhe nuk merrte pjesë aktive në luftime. Nuk ka

dëshmi se atë ditë shtëpia u përdor për luftime kundër policisë apo ushtrisë. Policia nuk u përpoq të hynte në shtëpi për të kontrolluar apo pyetur personat e tjerë që ishin brenda. Përkundrazi, policët i vunë zjarrin qëllimisht një automjeti dhe materialeve të ndërtimit në oborrin e përparmë duke përdorur lëndët djegëse që kishin me vete, konkludon Dhoma Gjyqësore. Pastaj policia vazhdoi më tej.

568. Veprimi i mëtejshëm i policëve ishte zjarrvënia e qëllimshme në shtëpinë e një shqiptari tjetër etnik, përsëri duke përdorur lëndët djegëse që policët kishin me vete. Policët nuk hynë në shtëpi për të bërë kontroll. Përsëri nuk ka prova që tregojnë se kjo shtëpi ishte përdorur për luftime kundër policisë apo ushtrisë atë ditë, apo se i zoti ishte i lidhur me UÇK-në.

569. Praktika e zjarrvënies së shtëpive në rrethana të ngjashme me të sapopërshkruarat, u përsërit shumë herë nga policët gjatë lëvizjes së tyre përmes fshatit. Shpesh pati edhe të shtëna të shumta me armë drejt shtëpive.

570. Siç është përshkruar gjetkë në këtë Aktgjykim, një grup prej 10 burrash ishin të strehuar në bodrumin e shtëpisë së Adem Ametovskit. Ata nuk ishin të armatosur, ishin të veshur me rroba civile, dhe nuk bënë asnjë rezistencë kur u arrestuan. Nga bodrumi i një shtëpie ngjitur, ku ishin strehuar së bashku me gra dhe fëmijë, u sollën edhe tre burra të tjerë të cilët iu bashkuan grupit të 10 burrave. Burrave iu morën sendet e çmuara si dhe dokumentat e identifikimit, ndërsa grave iu morën sendet e çmuara. Duket se dokumentat e identifikimit u morën për të përcaktuar nëse burrat ishin banorë të Maqedonisë dhe shqiptarë etnikë. Më pas burrat pësuan dhunë të egër. Për më tepër, dy prej tyre u qëlluan dhe u vranë, ndërsa një i tretë u qëllua dhe u plagos nga policia në rrethana të përshkruara gjetkë. Të arrestuarit e tjerë u çuan nën shoqërimin e disa policëve të armatosur në postbllokun policor tek shtëpia e Bracës, ku pësuan keqtrajtim të mëtejshëm të dhunshëm nga policët. Dëshmitë nuk tregojnë për lidhje të ndonjërit prej këtyre burrave me UÇK-në. Në disa raste një anëtar tjetër i së njëjtës familje ishte ose mund të ketë qenë anëtar i UÇK-së. Për më tepër dhe gjithsesi, këta burra ishin në duart e policisë, ishin të paarmatosur dhe ishte e qartë se nuk përbënin asnjë kërcënim ndaj policëve të armatosur që ishin dukshëm më të shumtë se ta në numër. Ata nuk po merrnin pjesë aktive në

luftime. Po të kishin patur lidhje me UÇK-në, gjë që nuk është e vërtetë sipas konkluzionit të Dhomës Gjyqësore, ata sigurisht do të kishin qenë *hors de combat/jashtë luftimit* në kohën kur u keqtrajtuan dhe, në tri raste, kur ndaj tyre shtinë me armë.

571. Siç është përmendur më sipër, ka disa dëshmi që sugjerojnë se qëllimi i operacionit ishte zbatimi i ligjit për gjetjen dhe arrestimin, ose trajtimin në një mënyrë apo në një tjetër, e anëtarëve të UÇK-së, të përshkruar gjithashtu si "terroristë", në fshat. Në disa aspekte, por vetëm në disa aspekte, sjellja e policëve ndaj të arrestuarve, kundër të cilëve nuk u hap zjarr, mund të konsiderohet në përputhje me këtë qëllim. Mirëpo në shumicën e aspekteve të tjera, veprimet e policëve në fshat, të cilat u përshkruan më sipër, përmbledhtasi, zbulojnë diçka krejt të ndryshme. Ndër faktorë të tjerë që tregojnë se operacioni nuk ishte vetëm apo kryesisht për zbatimin e ligjit apo i fokusuar kundër UÇK-së ose terroristëve, janë përbërja e njësisë policore që kreu operacionin; anëtarët e kësaj njësie nuk ishin policë të rregullt me përvojë në luftën kundër kriminelëve apo terroristëve, por rezervistë nga një agjenci sigurimi si dhe, siç duket, vullnetarë të tjerë; operacioni udhëhiqej nga Johan Tarçulovski, i cili nuk kishte përvojë në luftën kundër kriminelëve apo terroristëve dhe nisur prej pozitës dhe detyrave që kryente nuk kishte pse të caktohej drejtues i një grupi të tillë; aktet e hapjes zjarr kundër burrave të cilët nuk përbënin kërcënim serioz ndaj policisë; zjarrvënia e qëllimshme e shtëpive dhe pronave pa ndonjë arsye apo justifikim të dukshëm; të shtënat e qëllimshme me armë zjarri kundër shtëpive; dhuna e rëndë dhe e vazhdueshme ndaj të arrestuarve; konfiskimi i sendeve të çmuara të burrave të arrestuar dhe grave, ndaj të cilave nuk u ndërmor ndonjë veprim tjetër; fakti që policia nuk shkeli në të gjitha rrugët e fshatit dhe nuk hyri për të kontrolluar të gjitha shtëpitë e banorëve shqiptarë etnikë. Në fakt, operacioni u përqëndrua kryesisht tek shtëpitë të cilave mund t'u afroheshin lehtësisht nga rruga kryesore.

572. Dhoma Gjyqësore konkludon se qëllimi i zbuluar, me gjasë qëllimi kryesor ishte të sulmoheshin pa dallim shqiptarët etnikë dhe pronat e shqiptarëve etnikë. Provat nuk vërtetojnë përfundimin se personat e sulmuar dhe personat, pronat e të cilëve u shkatërrua, u shënjuan për sulm për shkak të lidhjeve të tyre me UÇK-në. Përkundrazi, tërësia e rrethanave mbi të cilat hedhin dritë dëshmitë, e bindin Dhomën Gjyqësore në

konkluzionin se objektivi parësor i këtij operacioni policor ishte hakmarrje ndaj personave të kombësisë shqiptare në fshat për veprimet e UÇK-së, për të cilën mendohej se kishte gjetur strehë apo mbështetje për vrasjen e ushtarëve maqedonas dhe, më konkretisht, lidhur me sulmin me minë tokësore në Stanet e Lubotenit më 10 gusht 2001. Duke vepruar në këtë mënyrë, operacioni nuk ishte vetëm akt hakmarrjeje, por edhe paralajmërim ndaj banorëve shqiptarëve etnikë për pasojat e mbështetjes së UÇK-së prej fshatit. Këtu nuk përjashtohet mundësia se në disa raste Johan Tarçulovski mund të jetë informuar për lidhje të mundshme me UÇK-në të një anëtari të ndonjë familjeje, gjë që nxiti veprimet kundër këtij personi apo shtëpisë së atij personi apo familjes së tij. Por kjo nuk del nga dëshmitë, pasi Johan Tarçulovski nuk tregoi se për çfarë ishte informuar dhe prej kujt i kishte marrë këto informacione. Dhoma Gjyqësore konkludon se provat vërtetojnë se kjo nuk ishte arsyeja e vetme apo parësore e ngjarjeve, dhe më tej, edhe sikur të ishte një faktor që ndikoi në disa nga veprimet e policisë, ai nuk ofron justifikim ligjor për veprimet e policisë, me përjashtim të tre rasteve të identifikuara konkretisht në shqyrtimin e akuzave për vrasje nga Dhoma Gjyqësore.

573. Dhoma Gjyqësore konkludon se mënyra e sjelljes së policisë në fshat tregon për një sulm të qëllimshëm por pa dallim kundër banorëve shqiptarë etnikë të Lubotenit, që rezultoi në vrasje dhe keqtrajtim mizor, si dhe në shkatërrim pa cak dhe pa shkak të shtëpive dhe pronave të tjera të banorëve shqiptarë etnikë të Lubotenit. Konkluzioni i Dhomës Gjyqësore është se kryerja e përsëritur e akteve të vrasjes, keqtrajtimit mizor, dhe shkatërrimit pa cak, përjashton çdo mundësi që këto akte të kenë ndodhur gabimisht, për shkak të ndonjë ngatërrese, apo rastësisht.

574. Dëshmitë nuk flasin për ndonjë emërim formal apo burim autoriteti që i dha të drejtë Johan Tarçulovskit *de jure* të udhëheqë apo drejtojë policët që hynë në Luboten bashkë me të më 12 gusht. Mirëpo nisur prej provave, Dhoma Gjyqësore konkludon se ai udhëhoqi dhe drejtoi operacionin në të gjitha fazat më 10, 11, dhe 12 gusht. Ai ushtroi efektivisht udhëheqje dhe kontroll ndaj policëve në fshat atë ditë. Veprimet e policisë në fshat u kryen sipas udhëzimeve të tij. Megjithatë dëshmitë tregojnë se roli udhëheqës i Johan Tarçulovskit dhe pushteti i tij *de facto* nuk vazhduan pas përfundimit të operacionit policor në Luboten, ku përfshihet keqtrajtimi mizor i të arrestuarve në shtëpinë e Bracës,

por përfshinë vetëm operacionin dhe policët që hynë në fshat. Si pasojë, policët në postbllokun e Buzallakut dhe në stacionet policore të Mirkocit, Çairit/Butelit, Kisela Vodës, Bit Pazarit dhe Karposhit, si dhe njësitë e posaçme të policisë dhe personeli i sigurisë në Gjykatën II të Shkupit dhe Spitalin e Qytetit të Shkupit nuk ishin nën pushtetin apo drejtimin e tij. Ky fakt pranohet në Aktakuzë ku në paragrafin 42 ai nuk akuzohet se mban përgjegjësi penale për ndonjë nga veprat penale që pretendohet se ndodhën në këto vende.

575. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se ndonëse Atulla Qaili pësoi keqtrajtim mizor në fshat më 12 gusht nga ana e policisë së udhëhequr nga Johan Tarçulovski, për arsyet e parashtruara më sipër nuk është vërtetuar se policët përgjegjës për keqtrajtimin mizor në atë kohë, donin të shkaktonin vdekjen e tij, as se ata vepruan duke ditur se veprimet e tyre me gjasë do t'i shkaktonin vdekjen. Siç është theksuar më sipër në këtë Aktgjykim, policët që e keqtrajtuan përsëri Attulla Qailin më vonë në stacionin policor të Mirkocit duke shkaktuar vdekjen e tij, ishin policë të tjerë të cilët nuk ishin nën pushtetin dhe drejtimin e Johan Tarçulovskit. Nuk është vërtetuar se Johan Tarçulovski mban përgjegësi penale për veprimet e tyre që shkaktuan vrasjen e Atulla Qailit.

576. Dhoma Gjyqësore konkludon se rrethanat e diskutuara më sipër dhe, në veçanti, prania e Johan Tarçulovskit si drejtues i policisë kur u kryen aktet e vrasjes, keqtrajtimit mizor dhe shkatërrimit pa cak gjatë operacionit, tregojnë se aktet e vrasjes, keqtrajtimit mizor, dhe shkatërrimit pa cak ishin synime të Johan Tarçulovskit në kohën përkatëse të urdhërimit, planifikimit, dhe nxitjes, apo ndryshe, në kohën kur kryerja e krimeve të tilla kishte shumë të ngjarë të ishte pasojë e parashikueshme e zbatimit të operacionit.

577. Elementët e nevojshëm që përbëjnë urdhërim planifikim dhe nxitje në kontekstin e Nenit 7(1) të Statutit, janë përcaktuar më sipër në këtë Aktgjykim.[2052] Duke patur parasysh çështjet e diskutuara më sipër, Dhoma Gjyqësore konkludon se është vërtetuar se i Akuzuari Johan Tarçulovski mban përgjegjësi penale për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e disa veprave për të cilat ai akuzohet në këtë Aktakuzë si më poshtë:

[2052] Përveç këtyre elementëve të cilat u diskutuan në këtë pjesë, Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se veprimet e ndërmarra nga Johan Tarçulovski si në fazën përgatitore po ashtu dhe atë zbatuese të operacionit për të hyrë në fshatin Luboten, kontribuan në mënyrë thelbësore në kryerjen e krimeve për të cilat akuzohet dhe të cilat janë provuar.

- vrasja e Rami Jusufit, Sulejman Bajramit dhe Muharem Ramadanit;

- shkatërrimi pa shkak i shtëpive apo pronave të Halim Durakit, Agim Jusufit, Qenan Jusufit, Sabit Jusufit, Xhevdet Jusufovskit, Abdullah Lutfiut, Harun Rexhepit, Ismet Rexhepit (Rexhepovskit), Nazim Murtezanit, Qani Jasharit, Afet Jasharit dhe Ramush Jasharit;

- keqtrajtimi mizor në shtëpinë e Adem Ametovskit i M012, Hamdi Ahmedovskit, Adem Ametovskit, Aziz Bajramit, M017, Nevaip Bajramit, Vehbi Bajramit, Atulla Qailit, Beqir Ramadanit, Ismail Ramadanit, Muharem Ramadanit, Osman Ramadanit, dhe Sulejman Bajramit dhe në shtëpinë e Bracës i M012, Hamdi Ahmedovskit, Adem Ametovskit, M017, Nevaip Bajramit, Vehbi Bajramit, Atulla Qailit, Beqir Ramadanit, Ismail Ramadanit, dhe Osman Ramadanit.

I Akuzuari do të shpallet fajtor për këto shkelje në bazë të Nenit 7(1) të Statutit.

578. Duke marrë parasysh rolin e tij të drejtpërdrejtë në urdhërimin e kryerjes së këtyre shkeljeve, ai nuk ishte thjesht ndihmës dhe inkurajues në kryerjen e këtyre akteve. Pretendimi në lidhje me përgjegjësinë e tij penale për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e akteve për të cilat akuzohet në Aktakuzë, nuk ka më rëndësi.

579. Më sipër në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore ka theksuar arsyet që e çuan në përfundimin se Prokuroria nuk vërtetoi që Xhelal Bajrami, Bajram Jashari dhe Kadri Jashari u vranë ashtu siç pretendohet.[2053]

(b) Ndërmarrja e përbashkët kriminale

580. Aktakuza pretendon se nga 10 deri më 12 gusht 2001 ka ekzistuar një ndërmarrje e përbashkët kriminale (NPK), ku merrte pjesë Johan Tarçulovski, dhe se synimi i saj ishte "kryerja e një sulmi të paligjshëm kundër civilëve dhe objekteve civile në fshatin Luboten, sulm i cili nuk përligjej prej domosdoshmërisë ushtarake, gjë që përbën krim në bazë të Nenit 3 të Statutit". Pretendohet se krimet e kryera në Luboten dhe të akuzuara në Pikat 1 deri 3 të Aktakuzës, ishin brenda synimit të NPK-së, ose ndryshe, ishin pasoja të

[2053] *Shih* më sipër, para. 345.

natyrshme dhe të parashikueshme të realizimit të synimit të NPK-së.[2054] Më tej në Aktakuzë pretendohet se anëtarë të tjerë të NPK-së të cilët vepruan në bashkëpunim me Johan Tarçulovskin, ishin policë të rregullt dhe rezervistë të IRJM-së nën komandën e tij nga strukturat e Ministrisë së Brendshme.[2055] Në mbështetje të pretendimit të saj për ekzistencën e një plani të përbashkët për kryerjen e këtyre krimeve, Prokuroria mbështetet në dëshmitë lidhur me takimin më 10 gusht ku morën pjesë Johan Tarçulovski dhe të tjerët, si dhe në mënyrën e kryerjes së krimeve në Luboten, çka tregon, sipas saj, për ekzistencën e një plani, projekti, apo qëllimi të tillë të përbashkët.[2056]

581. Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se në orët e mëngjesit të 12 gushtit 2001, një njësi policore e përbërë nga të paktën 60 - 70 vetë, ku përfshiheshin forca policore rezerviste dhe ndër ta, punonjës të agjencisë së sigurisë "Kometa", e udhëhequr nga Johan Tarçulovski, hyri në Luboten dhe kreu krimet e përshkruara më sipër. Prokuroria parashtron se Johan Tarçulovski, Petre Stojanovski, Lupço Bliznakovski, Zoran Jovanovski me nofkën Buçuk, drejtor i agjencisë Kometa, vëllezërit Janevski dhe punonjës të tjerë të kompanisë Kometa që hynë në fshatin Luboten me grupin e udhëhequr nga Johan Tarçulovski, ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.[2057] Një dëshmitar sugjeroi se Zoran Jovanovski me nofkën Buçuk, mund të ketë qenë një ndër pjesëmarrësit në takimin e zhvilluar në Lubancë më 10 gusht 2001,[2058] por duke patur parasysh mungesën e qartësisë së dëshmitarit si dhe mungesën e dëshmive të tjera konfirmuese, Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të arrijë në përfundimin se ai ishte i pranishëm. Nuk ka prova që në këtë takim të kenë qenë të pranishëm anëtarë të tjerë të agjencisë "Kometa". Nuk ka prova që vendimet për operacionin e hyrjes në fshat të jenë marrë në konsultim me punonjësit e "Kometës". Dëshmitë e pakta lidhur me pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet më 10-12 gusht, duke përfshirë edhe Buçukun, tregojnë se kjo pjesëmarrje u bë në bazë të urdhrave të marra nga të tjerët, në bazë të urdhrave konkrete dhe jo me nismën e tyre apo sipas një synimi të përbashkët me të tjerët. Siç është diskutuar pak më lart, Johan Tarçulovski ishte udhëheqësi i operacionit. Punonjësit

[2054] Aktakuza, para. 4, 8.
[2055] Aktakuza, para. 5.
[2056] *Shih* Dosjen Përfundimtare të Prokurorisë, para. 221-228.
[2057] Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, para. 61.
[2058] M052, T 8264-8265.

e “Kometës” vepruan sipas urdhrave të tij. Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se veprimet e tyre përgatitore për operacionin, lëvizja e tyre përmes Lubotenit dhe aktet që kryen në fshat, u bënë nën drejtimin e Johan Tarçulovskit.

582. Dëshmitë në mbështetje të akuzave se Petre Stojanovski dhe Lupço Bliznakovski ishin anëtarë të NPK-së, janë në të vërtetë të pakta dhe jo të besueshme.[2059] Funksioni i Stojanovskit dhe Bliznakovskit në MB si zëvendësa të shefit të SVR-së në Shkup, i bënte eprorë të shefit të OVR-së në Çair. Secili prej tyre mund t'i jepte urdhra shefit të OVR-së së Çairit. Mirëpo funksionet e tyre konkrete, me përgjegjësi për çështje operative dhe policinë e krimeve sa i përket Stojanovskit, dhe për ligjin dhe rendin publik në rastin e Bliznakovskit, nuk nxjerrin qartësisht arsyen e interesit apo implikimit të këtyre dy oficerëve në operacionin në Luboten. Nuk ka prova të drejtpërdrejta për lidhje të ndonjërit prej tyre me Johan Tarçulovskin, apo me ndonjë anëtar tjetër të identifikuar të NPK-së së pretenduar, apo që ata të ishin lidhur bashkë apo me ndonjë anëtar tjetër të identifikuar për formulimin e një synimi apo plani të përbashkët. Nuk ka dëshmi për urdhra të marra nga ndonjë epror i tyre apo për urdhra të lëshuara prej tyre për persona në rang më të ulët, çka do të ishte tregues i pjesëmarrjes së tyre në NPK-në e pretenduar. Është vërtetuar se shefi i OVR-së në Çair, Lube Kërstevski, diskutoi me Petre Stojanovskin nëse duhej të merrte pjesë në mbledhjen e zhvilluar në qendrën e ushtrisë në shkollën në Lubancë mbrëmjen e 10 gushtit, dhe Stojanovski urdhëroi apo miratoi pjesëmarrjen e Kërstevskit.[2060] Mirëpo dëshmitë tregojnë se edhe ai pak informacion që zotërohej lidhur me arsyet e thirrjes së mbledhjes, sugjeron se kjo mbledhje ishte organizuar nga ushtria dhe se Kërstevski ishte i justifikuar të mendonte se meqë OVR-ja e Çairit kishte përgjegjësi për atë zonë, ai duhej të merrte pjesë në këtë mbledhje, gjë që nuk tregon se ai kishte dijeni apo ishte përfshirë në synimin e paligjshëm të ndjekur eventualisht më pas.[2061] Dhoma Gjyqësore krijoi mendimin se sjellja e Stojanovskit gjatë dhënies së dëshmisë ishte jobindëse, por kjo përsëri është e pamjaftueshme për kapërcimin e mangësive në dëshmitë. Dëshmitë lidhur me Lupço Bliznakovskin ishin edhe më pak bindëse. Shumë nga këto aspekte, të cilat mund të mbështesnin, deri diku,

[2059] *Shih* më sipër, para. 108.
[2060] *Shih* më sipër, para. 108.
[2061] M052, T 8262-8263; 8459; Petre Stojanovski, T 9152.

pretendimin për pjesëmarrjen e tij në NPK, ishin qartësisht jo të besueshme.[2062] Thuhet se informacionin për mbledhjen e zhvilluar mbrëmjen e 10 gushtit, Kërstevski e mori nga Bliznakovski. Edhe sikur kjo dëshmi të ishte e besueshme, përsëri natyra e përgjithshme e kësaj dëshmie mund të sugjerojë se në atë kohë mendohej se mbledhja ishte organizuar nga ushtria. Dhoma Gjyqësore konkludon se dëshmitë e paraqitura nuk arrijnë të vërtetojnë se Petre Stojanovski apo Lupço Bliznakovski ishin anëtarë të NPK-së.

583. Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se mbrëmjen e 10 gushtit 2001, Johan Tarçulovski mori pjesë në një mbledhje të zhvilluar në postkomandën e Batalionit të Tretë Gardist në Lubancë. Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit kryesorë të ushtrisë dhe policisë në atë zonë, ndër të cilët komandanti i Batalionit të Tretë të Brigadës së Parë Gardiste, majori Despodov, dhe zyrtari i lartë policor, Shefi i OVR-së së Çairit, Lube Kërstevski. Ndër zyrtarë të tjerë të policisë të rangut më të ulët të pranishëm, ishin komandanti i stacionit policor të Mirkocit, Slavko Ivanovski, dhe shefi i sektorit të analizës në OVR-në e Çairit, Borce Pesevski.[2063] Në mbledhje, Johan Tarçulovski diskutoi me pjesëmarrësit e tjerë lidhur me një operacion për të hyrë në fshatin Luboten.[2064]

584. Nuk ka asnjë akuzë konkrete për pjesëmmarrje në NPK-në e pretenduar në Aktakuzë, të ndonjërit prej personave për të cilët dëshmitë provuan se kishin qenë të pranishëm në mbledhjen me Johan Tarçulovskin, më 10 gusht në Lubancë. Ndonëse këtu nuk përfshihen vetëm personat e identifikuar konkretisht, Prokuroria e bëri shpreimisht të qartë se anëtarët e ushtrisë maqedonase nuk ishin përfshirë në NPK-në e pretenduar në Aktakuzë.[2065] Prokuroria nuk pretendoi se shefi i OVR-së së Çairit ishte pjesëmarrës në NPK. Përkundrazi, Prokuroria parashtroi se ai nuk dëshironte të merrte pjesë në mbledhje. Dëshmitë nuk përcaktuan ndonjë rol të përcaktuar të zyrtarëve të tjerë të policisë që morën pjesë në mbledhje.

[2062] *Shih* më sipër, para. 121-122.
[2063] *Shih* më sipër, para. 108.
[2064] *Shih* më sipër, para. 111.
[2065] *Prokurori kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Çështja Nr. IT-04-82-PT, "Decision on Prosecution's Motion to Amend the Indictment and Submission of Proposed Second Amended Indictment and Submission of Amended Pre-Trial Brief," 26 May 2006, para 64./"Vendimi për Mocionin e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës dhe Paraqitja e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë të Propozuar dhe Paraqitja e Dosjes Paragjyqësore të Ndryshuar" 26 maj 2006, para. 64/.

585. Dhoma Gjyqësore konkludon se nuk është vërtetuar që Johan Tarçulovski veproi në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të NPK-së së pretenduar në Aktakuzë për kryerjen e krimeve të akuzuara. Faktikisht Dhoma Gjyqësore konkludon se dëshmitë vërtetojnë që ai planifikoi, nxiti dhe urdhëroi krimet e kryera në Luboten, më 12 gusht 2001, dhe përgjegjësia e tij duhet të përcaktohet mbi këtë bazë. Ndonëse rrethanat tregojnë se Johan Tarçulovski, nga ana e tij, veproi sipas urdhrave, dëshmitë nuk ndihmojnë të zbulohet se prej kujt erdhën këto urdhra, apo cila ishte përmbajtja e tyre. Rrjedhimisht akuzat për pjesëmarrjen e Johan Tarçulovskit në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, hidhen poshtë.

VIII. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

586. Prokuroria pohon se një dënim i vetëm me 15 vjet burgim është dënimi i duhur për të Akuzuarin Johan Tarçulovski, nëse shpallet fajtor.[2066]

587. Dhënia e dënimeve përcaktohet prej Nenit 24 të Statutit dhe Rregullës 101 të Rregullores.[2067] Në përputhje me Rregullën 101(A), personi i shpallur fajtor mund të dënohet me burgim për një periudhë deri në burgim të përjetshëm. Në përputhje me Nenin 24(2) të Statutit dhe Rregullën 101(B) të Rregullores, Dhoma merr parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor, si dhe çfarëdo rrethane rënduese dhe lehtësuese. Dhoma merr parasysh edhe praktikën e përgjithshme të dënimit me burgim në ish-Jugosllavi,[2068] megjithëse kjo praktikë nuk është e detyrueshme për të.[2069] Vendimi për kohëzgjatjen e dënimit lihet në gjykimin e Dhomës, në varësi të rrethanave të çështjes.[2070] Në zbatimin e kompetencës së saj gjykuese, Dhoma bazohet në dispozitat përkatëse të Statutit dhe të Rregullores. Dhoma merr parasysh gjithashtu synimet parësore të dënimit përcaktuar prej Dhomës së Apelit,

---

[2066] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 505; Argumente Përmbyllëse, T. 11058-11059.

[2067] Neni 24 i Statutit përcakton: "1. Të vetmin dënim që jep Dhoma Gjyqësore është burgimi. Në përcaktimin e kushteve të burgimit, Dhomat Gjyqësore i referohen praktikës të përgjithshme të dënimeve me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë. 2. Gjatë përcaktimit të dënimit, Dhomat Gjyqësore mbajnë parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat individuale të fajtorit. 3. Përveç burgimit, Dhomat Gjyqësore mund të urdhërojnë që pronarëve të ligjshëm t'u kthehet çdo pronë ose fitim siguruar nëpërmjet veprimeve kriminale, ndër të tjera nëpërmjet shtrëngimit."
Rregulla 101 e Rregullores përcakton: "(A) Personi i shpallur fajtor mund të dënohet me burg për një periudhë deri në burgim të përjetshëm. (B) Në përcaktimin e dënimit, Dhoma Gjyqësore merr parasysh faktorët e përmendur në paragrafin 2 të Nenit 24 të Statutit, dhe faktorë të tillë si: (i) çfarëdo rrethane rënduese; (ii) çfarëdo rrethane lehtësuese duke përfshirë bashkëpunimin thelbësor të personit të shpallur fajtorit me Prokurorin para ose pas shpalljes së fajësisë; (iii) praktikën e përgjithshme të dënimeve me burg në gjykatat e ish-Jugosllavisë; (iv) pjesën tashmë të kryer të dënimit që i është dhënë personit të shpallur fajtor nga një gjykatë e cilitdo shtet për të njëjtën vepër, siç përmendet në paragrafin 3 të Nenit 10 të Statutit. (C) Për personin e shpallur fajtor, merret në konsideratë koha e kaluar në paraburgim, qoftë para dorëzimit në Tribunal ose në pritje të gjykimit ose apelit"

[2068] Neni 24(1) i Statutit; Rregulla 101(B)(iii) e Rregullores.

[2069] Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 260; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 377; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafët 681-682, që i referohen Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore *Kunarac*, para. 829: "Megjithëse Dhoma Gjyqësore nuk është e detyruar të zbatojë praktikën e dënimeve të ish-Jugosllavisë, ajo që kërkohet sigurisht tejkalon citimin e thjeshtë të dispozitave përkatëse të kodit penal të ish-Jugosllavisë. Nëse ka ndryshime, dënimi i përcaktuar duhet shpjeguar në lidhje me praktikën e dënimeve në ish-Jugosllavi, sidomos kur e drejta ndërkombëtare nuk ofron udhëzime lidhur me një praktikë konkrete dënimi. Dhoma Gjyqësore thekson se duke qenë se shpesh ekzistojnë ndryshime rrënjësore midis procedimeve penale brenda shteteve dhe procedimit penal në këtë jurisdiksion, lloji, fushëverpimi dhe masa e shkeljeve të gjykuara prej Tribunalit Ndërkombëtar nuk lejojnë zbatimin automatik të praktikave të dënimit të ish-Jugosllavisë."

[2070] Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 248; Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 394; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 500.

gjegjësisht. parandalim dhe shpagim.[2071] Për më tepër dënimi nuk duhet të jetë spontan apo i tepruar, d.m.th. duhet të jetë në përputhje logjike me dënimet e dhëna në rrethana të ngjashme për të njëjtën vepër penale.[2072]

A. Pesha e krimit

588. Pesha e krimit është një faktor me rëndësi parësore në dhënien e dënimit.[2073] Në përcaktimin e peshës së krimit, Dhoma mund të marrë në shqyrtim llojin, masën dhe mizorinë e krimit, rolin e të akuzuarit dhe pasojat e përgjithshme të krimeve për viktimat dhe familjet e tyre.[2074] Faktorët e marrë parasysh nga një Dhomë Gjyqësore si aspekte të peshës së krimit, nuk duhet të merren parasysh veças si rrethana rënduese apo lehtësuese, dhe anasjellas.[2075] Dënimi duhet të pasqyrojë peshën e brendaqenësishme ose tërësinë e sjelljes kriminale të të akuzuarit, duke u kushtuar rëndësinë e duhur rrethanave konkrete të çështjes dhe formës e masës së pjesëmarrjes së të akuzuarit.[2076] Është parim i pranuar në jurisprudencën e Tribunalit se krimet e luftës në vetvete nuk janë më pak të rënda se krimet kundër njerëzimit.[2077]

589. Dhoma përfundoi se Johan Tarçulovski është fajtor për Vrasje (Pika 1), Shkatërrim Pa Shkak (Pika 2), dhe Trajtim Mizor (Pika 3). Veprat penale u kryen me 12 gusht 2001, në fshatin Luboten, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Të gjitha viktimat ishin banorë të fshatit dhe të kombësisë shqiptare.

[2071] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq* për Dënimin, para. 48; Aktgjykimi i Apelit *Deronjiq*, paragrafët 136-137, i cili i referohet Aktgjykimit të Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 800-801; 806; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, paragrafët 1073-1075; 1075-1076; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 678; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 185; Aktgjykimi i Apelit *Dragan Nikoliq*, para. 46; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 402.

[2072] Aktgjykimi i Apelit *Momir Nikoliq*, para. 39, i cili i referohet Aktgjykimit të Apelit *Jelisiq*, para. 96; *shih* gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Babiq*, para. 33.

[2073] Aktgjykimi i Apelit *Momir Nikoliq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Alekovski*, para. 182; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 731; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq*, para. 442; Aktgjykimi i Apelit *Jelisiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 683.

[2074] *Shih* Aktgjykimin e Dënimit *Rajiq*, paragrafët 83-95.

[2075] Aktgjykimi i Apelit *Deronjiq* në lidhje me Dënimin, para. 106; Aktgjykimi i Apelit *Momir Nikoliq*, para. 58; Aktgjykimi i Apelit *Limaj,* para. 143.

[2076] Aktgjykimi i Apelit *Furunxhia*, para. 249; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 683.

[2077] Aktgjykimi i Apelit *Tadiq* në lidhje me Dënimin, para. 69; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhia*, para. 247; Aktgjykimi i Dënimit *Rajiq*, para. 83.

590. Një forcë prej të paktën 60-70 policësh rezervistë të armatosur, e udhëhequr nga Johan Tarçulovski, hyri atë mëngjes në fshat, e mbështetur me zjarr mortajash nga ushtria prej pozicioneve të saj. Kur ndodheshin në fshat, policët shtinë dhe vranë tre burra (Pika 1), shkatërruan qëllimisht ose dëmtuan duke u vënë zjarrin shtëpive të 12 banorëve, në disa raste duke shkaktuar dëm edhe me të shtëna dhe bomba (Pika 2), dhe në mënyrë shumë mizore, rrahën, plagosën ose kërcënuan me thika dhe armë, dhe duke i shkelmuar për një kohë të gjatë dhe në disa raste në dy vende të ndryshme, 13 burra të cilët ishin strehuar në bodrumet e dy shtëpive (Pika 3).

591. Më vonë, dy burra të cilët pësuan trajtim mizor, u qëlluan dhe u vranë dhe këto vrasje përfshihen gjithashtu në Pikën 1. Edhe një burrë tjetër, nga grupi i trembëdhjetëve, u qëllua por nuk u vra, dhe një tjetri i kishin gdhendur me thikë një kryq në shpinë. Në disa raste rrahjet dhe plagët ishin kaq të rënda se viktimat humbën ndjenjat.

592. Burrat e cilët u vranë dhe u trajtuan mizorisht në fshat atë ditë, ishin të gjithë të paarmatosur dhe nuk përbënin kërcënim fizik, ose nuk i bënë qëndresë policisë. Në shumicën e rasteve policët ishin të maskuar.

593. Për viktimat që vdiqën, pasojat e veprimeve të policisë ishin të pandreqshme. Familjarët e tyre të ngushtë duhet të mbartin barrën e humbjes së të dashurve të tyre. Për viktimat që mbetën gjallë, del qartë se vuajtjet fizike dhe mendore shpesh kanë qenë të konsiderueshme dhe të zgjatura. Kuptohet se 12 familje pësuan humbje financiare dhe personale të shtëpive dhe pasurisë së tyre.

594. Megjithëse Johan Tarçulovski ishte drejtuesi i policisë në Luboten më 12 gusht 2001 dhe i operacionit policor të asaj dite, Dhoma përsërit edhe një herë përfundimin e saj se në këto ngjarje Johan Tarçulovski zbatonte urdhra të një personi apo të personave të panjohur, me rang më të lartë se ai në Ministrinë e Brendshme apo ndoshta, siç pretendon Mbrojtja e tij, urdhra të Presidentit të IRJM-së i cili ndërkohë ka vdekur. Rrjedhimisht Johan Tarçulovski nuk do të dënohet si nismëtar i operacionit policor në Luboten. Ai ishte person me rang relativisht të ulët në Ministrinë e Brendshme, i cili

zbatonte urdhra. Gjithashtu duhet theksuar se ai nuk ishte autori fizik i ndonjë vepre penale. Roli i Johan Tarçulovskit konsiston në planifikimin e veprave penale, nxitjen dhe urdhërimin e policisë rezerviste të grumbulluar prej tij për kryerjen e veprave penale. Roli i tij si urdhërues i kryerjes së veprave penale, pasqyron plotësisht dhe në mënyrë të duhur rëndësinë reale të sjelljes së tij. Në rrethanat e kësaj çështjeje, nuk përligjet asnjë ndështkim i mëtejshëm për planifikim dhe nxitje nga ana e tij. I rëndësishëm për dënimin është edhe fakti se nuk u vërtetua se ai mori pjesë në Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale për kryerjen e veprave penale, siç pretendohet në Aktakuzë.

B. Rrethanat individuale të të Akuzuarit: rrethana rënduese dhe lehtësuese

595. Statuti dhe Rregullorja nuk synojnë të përkufizojnë të gjithë faktorët të cilët mund të përbëjnë rrethanat e duhura rënduese dhe lehtësuese në përcaktimin e dënimit. Rregulla 101(B) përmend vetëm bashkëpunimin thelbësor me Prokurorin si rrethanë lehtësuese. Jurisprudenca e Tribunalit ka identifikuar faktorë të tjerë të cilët Dhoma mund t'i marrë parasysh.[2078] Këtu nuk përfshihen të gjithë faktorët. Detyrimisht rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe rëndësia që u akordohet, duhet të përcaktohen në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes.[2079]

596. Rrethanat rënduese duhet të lidhen drejtpërsëdrejti me kryerjen e veprës penale,[2080] dhe duhet të vërtetohen jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.[2081] Ushtrimi prej të akuzuarit, i të drejtës për të heshtur, nuk mund të konsiderohet rrethanë rënduese.[2082]

597. Rrethana lehtësuese mund të merren parasysh pavarësisht nëse kanë ose nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me veprën penale të pretenduar,[2083] dhe duhet të vërtetohen në bazë të tërësisë së gjasave.[2084] Faktorë, si gjendja familjare e të akuzuarit, përpjekjet e tij

[2078] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafët 686 dhe 696.
[2079] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 777, 780; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 685; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 405.
[2080] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kunarac*, para. 850; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Stakiq*, para. 911.
[2081] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 763; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 686.
[2082] Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 783; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 687.
[2083] Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Stakiq*, para. 920.
[2084] Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 697.

për t'u riintegruar në shoqëri dhe mungesa e precedentëve penalë, janë marrë parasysh si rrethana lehtësuese.[2085]

598. Në këtë çështje, Prokuroria argumenton se faktorë përkatës rëndues përfshijnë "pozitën udhëheqëse të Tarçulovskit si drejtuesi i njësisë policore e cila kreu krimet në Luboten më 12 gusht";[2086] pjesëmarrja e tij e drejtpërdrejtë dhe prania e tij; motivimi sadist apo mizor për kryerjen e krimeve dhe pambrojtshmëria e viktimave,[2087] si dhe mungesa e ndërgjegjes apo pendimit.[2088]

599. Mbrojtja e Tarçulovskit përmendi si faktorë lehtësues karakterin e mirë të të Akuzuarit, rrethanat e tij personale, sjelljen e tij gjatë procesit dhe në Njësinë e Paraburgimit të Tribunalit dhe bashkëpunimin e avokatit të tij.[2089]

600. Johan Tarçulovski ka lindur në Shkup në vitin 1974. Është i martuar me familje. Në vitin 2001 punonte polic në Ministrinë e Brendshme. U zgjodh për shërbim në njësinë e sigurimit të Presidentit dhe të familjes së tij. Konsiderohej polic i aftë dhe i suksesshëm. Nuk dihet asgjë e keqe për të kaluaren e tij apo rrethanat e tij personale. Disa persona kanë dëshmuar për karakterin e tij të mirë. Është përshkruar si njeri i ndershëm, efikas, punëtor dhe i besueshëm.[2090] Iu dorëzua me vullnet të lirë Tribunalit dhe u soll mirë në paraburgimin e këtushëm dhe gjatë procesit. Këto aspekte vlejnë si faktorë lehtësues në dënimin e tij.

601. Në një deklaratë në fund të procesit, Johan Tarçulovski bëri të ditur se ai gjykonte se kishte vepruar në mbrojtje të atdheut kundër terroristëve dhe në mbrojtjen e rendit kushtetues. Do të dalë qartë se Dhoma ka mendim tjetër për ngjarjet e asaj dite dhe ajo konstaton se nuk u shfaq ndonjë pendim i vërtetë për çfarë ndodhi. Mirëpo Dhoma pranon se, si shumë njerëz të tjerë, i Akuzuari ndodhej në mëdyshje se çfarë ishte e drejtë apo e padrejtë në vorbullën e një konflikti të armatosur midis interesave të kundërta

[2085] Aktgjykimi i Dënimit *Rajiq*, para. 160.
[2086] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 505.
[2087] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 505: Parashtrimi Përmbyllës i Prokurorisë, T 11058-11059.
[2088] Parashtrimi Përmbyllës i Prokurorisë, T 11059.
[2089] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Tarçulovskit, paragrafët 375-379.
[2090] Vilma Trajkovska, Prova Materiale 1D114; Jarçev Tadeush/ Jarčev Tadeuš, Prova Materiale 1D116.

brenda vendit dhe vëren se fill para kryerjes së krimeve në Luboten, Johan Tarçulovski kishte humbur një njeri shumë të afërt në incidentin e shpërthimit të minës tokësore në Stanet e Lubotenit.

C. Praktika e përgjithshme në gjykatat e IRJM-së dhe në këtë Tribunal

602. Në përcaktimin e dënimit të duhur, Dhoma do të marrë parasysh edhe praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e IRJM-së.[2091] Faktorët që duhet të merren parasysh për dhënien e dënimit në IRJM, përcaktohen në Nenin 39(1) dhe 39(2) të Kodit Penal të IRJM-së i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara në Aktakuzë.[2092]

603. Neni 404 i Kodit Penal të IRJM-së të vitit 1996 që mbulon shkeljet e të drejtës ndërkombëtare, "gjatë një lufte, konflikti të armatosur ose pushtimi," ndalon urdhërimin ose kryerjen e "vrasjeve," "veprimeve çnerëzore," dhe "shkaktimin e vuajtjeve apo lëndimeve të rënda trupore ose shëndetësore," dhe "shkatërrimin e paligjshëm dhe pa shkak ose uzurpimin e tepruar të pronave, të papërligjur prej domosdoshmërisë ushtarake" dhe parashikon një dënim prej së paku dhjetë vjet burgim, apo burgim të përjetshëm.[2093] Neni 35(1) i Kodit në versionin në fuqi në vitin 2001, përcaktoi se veç

[2091] Neni 24(1) i Statutit dhe Rregulla 101(B)(iii) e Rregullores. Neni 24 dhe Rregulla 101(B) përmendin praktikën ekzistuese të gjykatave të ish-Jugosllavisë. Mirëpo në jurisprudencën e Tribunalit është përcaktuar se në burimet për t'u konsultuar sipas këtyre dispozitave nuk përfshihet vetëm jurisprudenca nga ish-Jugosllavia, por edhe dispozita statutore, Aktgjykimi i Dënimit *Dragan Nikoliq*, para. 148; *Shih* edhe Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, para. 715; Aktgjykimi i Apelit *Jokiq*, paragrafët 36-38; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Stakiq*, paragrafët 888-890.

[2092] Prova materiale P81. Kodi Penal i IRJM-së u miratua më 23 korrik 1996 (Gazeta Zyrtare Nr. 37/1996) dhe hyri në fuqi më 1 nëntor 1996. Ligji pasues, "Ligji për ndryshimin e Kodit Penal" (Gazeta Zyrtare, Nr. 19/2004), u miratua duke ndryshuar disa dispozita të Kodit Penal.
Neni 39(1) i Kodit Penal të IRJM-së përcakton: "Gjykata i jep shkelësit një dënim brenda kufijve të përcaktuar me ligj për atë krim, duke marrë parasysh përgjegjësinë penale të shkelësit, peshën e krimit dhe synimet e dënimit."
Neni 39(2) i Kodit Penal të IRJM-së përcakton: "Këtu, gjykata merr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në uljen apo shtimin e dënimit (rrethana lehtësuese apo rënduese), dhe në veçanti: nivelin e përgjegjësisë penale, motivet e krimit të kryer, masën e rrezikimit apo të dëmtimit të pasurisë së mbrojtur, rrethanat e kryerjes së krimit, kontributin e viktimës në kryerjen e krimit, biografinë e shkelësit, rrethanat e tij personale dhe sjelljen e tij pas krimit të kryer, si dhe rrethana të tjera që lidhen me personalitetin e shkelësit."

[2093] Prova materiale P81. Neni 404 i Kodit Penal të IRJM-së pohon: "Një person i cili, në shkelje të rregullave të të drejtës ndërkombëtare, gjatë një lufte, konflikti të armatosur ose pushtimi, urdhëron një sulm kundër popullatën civile: […], për të kryer kundër popullatës civile vrasje, […], veprime çnjerëzore, […], duke shkaktuar lëndime ose vuajtje të rënda trupore ose shëndetësore, […], shkatërrimin e paligjshëm dhe të vullnetshëm ose uzurpimin e pronave në mësë të madhe, e papërligjur prej domosdoshmërisë ushtarake, […], ose një person i cili kryen disa prej krimeve të lartpërmendura – dënohet me të paktën 10 vjet burg, ose me burgim të përjetshëm."

burgimit të përjetshëm,[2094] burgimi nuk mund të zgjasë më shumë se 15 vjet.[2095] Theksohet se kjo dispozitë u ndryshua në vitin 2004 për të lejuar një dënim deri 20 vjet burgim për krime për të cilat parashikohet burgimi i përjetshëm. Edhe Neni 44 i këtij Kodi ka dispozita të veçanta për dënimin e krimeve të njëkohshme.[2096] Mirëpo, duket se, bazuar në parimin *lex mitior*-it mishëruar në të drejtën maqedonase në Nenin 3(2) të Kodit Penal të IRJM-së,[2097] dënimi maksimal që mund të jepet nga gjykatat maqedonase për krime të kryera në vitin 2001 të ngjashme me ato të akuzuara në këtë Aktakuzë është 15 vjet burgim, ose burgim i përjetshëm.

D. Llogaritja e kohës së paraburgimit

604. Sipas Rregullës 101(C) të Rregullores, i Akuzuari ka të drejtë që në kohëzgjatjen e dënimit t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, para dhe gjatë procesit gjyqësor. Lidhur me këtë Aktakuzë, i Akuzuari Johan Tarçulovski ka qenë në paraburgim që prej 16 marsit 2005.

[2094] Prova materiale P81. Neni 35(2) i Kodit Penal të IRJM-së pohon: "Nëse dënimi prej 15 vjetësh burgim parashikohet për një krim të kryer me paramendim, dënimi me burgim të përjetshëm mund të parashikohet për forma të rënda të këtij krimi."
[2095] Prova materiale P81. Neni 35(1) i Kodit Penal të IRJM-së, në variantin e vitit 2004, përcakton: "Burgimi nuk mund të jetë […] më i gjatë se 15 vjet. Për krimet, për të cilat ligji parashikon një dënim me burgim të përjetshëm, mund të zbatohet një dënim me burgim deri 20 vjet."
[2096] Prova materiale P81. Neni 44(1) i Kodit Penal të IRJM-së pohon: "Nëse keqbërësi kryen disa krime me një veprim apo me disa veprime, për të cilat ai gjykohet njëkohësisht, gjykata përcakton paraprakisht dënimet për secilin krim, dhe më pasjshpall një dënim të vetëm për të gjitha krimet." Neni 44(2)(i) i Kodit Penal të IRJM-së parashtron: "nëqoftëse gjykata jep dënim me burgim të përjetshëm për një prej krimeve bashkëkohëse, atëherë shpallet vetëm ky dënim," kurse Neni 44(2)(ii) parashtron: "nëse është dhënë dënim me burgim për krime bashkëkohëse, dënimi i vetëm duhet të jetë më i madh se çdo dënim veç e veç, por nuk mund të jetë sa shuma e dënimeve të përcaktuar, dhe as nuk mund të tejkalojë 15 vjet burgim."
[2097] Prova materiale P81. Neni 3(2) parashtron: "Nëse ligji ka ndryshuar një herë apo disa herë pas kryerjes së krimit, zbatohet ligji më i butë ndaj shkelësit."

IX. VENDIM

605. Për arsyet e lartpërmendura, pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha provat dhe parashtrimet e palëve, Dhoma vendos si më poshtë:

606. Dhoma e shpall të Akuzuarin Lube Boshkoski **TË PAFAJSHËM** për të gjitha pikat e Aktakuzës. Në bazë të Rregullës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirimin e Lube Boshkoskit nga Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara menjëhere pas kryerjes së formaliteteve të nevojshme.

607. Në bazë të Nenit 7(1) të Statutit, Dhoma e shpall të Akuzuarin Johan Tarçulovski **FAJTOR** për pika e mëposhtme:

Pika 1: Vrasje, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e vrasjeve të Rami Jusufit, Sulejman Bajramit dhe Muharem Ramadanit;

Pika 2: Shkatërrim pa shkak, shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e shkatërrimit pa shkak të shtëpive ose pronave të tjera të Alim Durakit, Agim Jusufit, Qenan Jusufit, Sabit Jusufit, Xhevdet Jusufovskit, Abdullah Luftiut, Harun Rexhepit, Ismet Rexhepovskit, Nazim Murtezanit, Qani Jasharit, Afet Jasharit dhe Ramush Jasharit;

Pika 3: Trajtim mizor, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e trajtimit mizor në shtëpinë e Adem Ametovskit të M012, Hamdi Ametovskit, Adem Ametovskit, Aziz Bajramit, M017, Nevaip Bajramit, Vehbi Bajramit, Atulla Qailit, Beqir Ramadanit, Ismail Ramadanit, Muharem Ramadanit, Osman Ramadanit, dhe Sulejman Bajramit; si dhe trajtim mizor në shtëpinë e Bracës të M012, Hamdi

Ametovskit, Adem Ametovskit, M017, Nevaip Bajramit, Vehbi Bajramit, Atulla Qailit, Beqir Ramadanit, Ismail Ramadanit, dhe Osman Ramadanit;

608. Rrjedhimisht Dhoma i jep Johan Tarçulovskit një dënim të vetëm me dymbëdhjetë vjet burgim. Johan Tarçulovski ndodhet në paraburgim që prej 16 marsit 2005. Në bazë të Rregullës 101(C) të Rregullores, koha që ka kaluar në paraburgim llogaritet plotësisht si kohë burgimi. Në bazë të Rregullës 103(C) të Rregullores, Johan Tarçulovski do të mbahet në paraburgim të Tribunalit deri në përfundimin e formaliteteve për transferimin e tij në shtetin ku do te vuajë dënimin.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

Sot, me datën 10 korrik 2008.
Në Hagë
Holandë

/nënshkruar në origjinal/
Kevin Parker
Kryegjykatës

/nënshkruar në origjinal/
Christine Van Den Wyngaert
Gjykatëse

/nënshkruar në origjinal/
Krister Thelin
Gjykatës

[Vula e Tribunalit]

X. SHTOJCA I: FJALORI

Akayesu/Aktgjykim	*Prosecutor v. Jean-Paul Akayesu,* Case No. ICTR-96-4-T. Judgement, 2 September 1998 /*Prokurori k. Jean-Paul Akayesu-s*, Lënda Nr. ICTR-96-4-T. Aktgjykim, 2 shtator 1998/
Aktakuza	*Prosecutor v. Ljube Boškoski and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-PT, Second Amended Indictment, 4 April 2006 /*Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë, 4 gusht 2006/
*Aleksovski/A*ktgjykim	*Prosecutor v. Zlatko Aleksovski*, Case No. IT-95-14/1-T. Judgement, 25 June 1999 /*Prokurori k. Zllatko Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-T. Aktgjykim, 25 qershor 1999/
Aleksovski/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Zlatko Aleksovski*, Case No. IT-95-14/1-A. Judgement, 24 March 2000 /*Prokurori k. Zllatko Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-A. Aktgjykim, 24 mars 2000/
APC	Autoblindë
Babiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Milan Babić*, Case No. IT-03-72-A. Judgement on Sentencing Appeal, 18 July 2005 /*Prokurori k. Milan Babiqit*, Lënda Nr. IT-03-72-A. Aktgjykimi i Apelimit të Dënimit, 18 korrik 2005/
Bagilishema Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Ignace Bagilishema*, Case No. ICTR-95-1A-A. Judgement, 3 July 2002 /*Prokurori k. Ignace Bagilishema-s*, Lënda Nr. ICTR-95-1A-A. Aktgjykim, 3 korrik 2002/
BBC	British Broadcasting Corporation/Korporata Britanike e Transmetimeve
BCS	Gjuha bosnjake kroate serbe
BE	Bashkimi Evropian
Bërgjanin/Aktgjykim	*Prosecutor v. Radoslav Brđanin*, Case No. IT-99-36-T. Judgement, 1 September 2004 /*Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit*, Lënda Nr. IT-99-36-T. Aktgjykim, 1 shtator 2004/
Bërgjanin/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Radoslav Brđanin*, Case No. IT-99-36-A. Judgement, 3 April 2007 /*Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit*, Lënda Nr. IT-99-36-A. Aktgjykimi, 3 prill 2007/
Blagojeviq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Vidoje Blagojević and Dragan Jokić*, Case No. IT-02-60-T. Judgement, 17 January 2005 /*Prokurori k. Vidoje Bllagojeviqit dhe Dragan Jokiqit*, Lënda Nr. IT-02-60-T. Aktgjykim, 17 janar 2005/
Bllagojeviq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Vidoje Blagojević and Dragan Jokić*, Case No. IT-02-60-A. Judgement, 9 May 2007 /*Prokurori k. Vidoje Bllagojeviqit dhe Dragan Jokiqit*, Lënda Nr. IT-02-60-A. Aktgjykim, 9 maj 2007/

Blashkiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Tihomir Blaškić*, Case No. IT-95-14-T. Judgement, 3 March 2000 / *Prokurori k. Tihomir Blashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-T Aktgjykim, 3 mars 2000/
Blashkiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Tihomir Blaškić*, Case No. IT-95-14-A. Judgement, 29 July 2004 / *Prokurori k. Tihomir Blashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-A Aktgjykim, 29 korrik 2004/
Bralo/Aktgjykimi i Apelimit të Dënimit	*Prosecutor v. Miroslav Bralo*, Case No. IT-95-17-A. Judgement on Sentencing Appeal, 2 April 2007 /*Prokuroria k. Mirosllav Bralos*, Lënda Nr. IT-95-17-A. Aktgjykimi i Apelimit të Dënimit: 2 prill 2007/
CPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimin Çnjerëzor ose Poshtërues /European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment/
Çelebiqi/Aktgjykim	*Prosecutor v. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, Hazim Delić, and Esad Landžo*, Case No. IT-96-21-T. Judgement, 16 November 1998 /*Prokurori k. Zejnil Dellalliqit, Zdravko Muçiqit, Hazim Deliqit, dhe Esad Lanxhos*, Lënda Nr. IT-96-21-T. Aktgjykim, 16 nëntor 1998/
Çelebiqi/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, Hazim Delić, and Esad Landžo*, Case No. IT-96-21-A. Judgement, 20 February 2001, /*Prokurori k Zejnil Dellalliqit, Zdravko Muçiqit, Hazim Deliqit, dhe Esad Lanxhos/*, Lënda Nr. IT-96-21-A. Aktgjykimi, 20 shkurt 2001/
DA	Alternativa Demokratike
Deronjiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Miroslav Deronjić*, Case No. IT-02-61-A Judgement on Sentencing Appeal, 20 July 2005 /*Prokurori k. Mirosllav Deronjiqit*, Lënda Nr. IT-02-61-A Aktgjykimi i Apelit për Dënimin, 20 korrik 2005/
Dosja Paragjyqësore e Mbrojtjes së Boshkoskit	*Prosecutor v. Ljube Boškoski and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-PT, Boškoski Defence Pre-Trial Brief, 2 October 2006 /*Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, Dosja Paragjyqësore e Mbrojtjes së Boshkoskit, 2 tetor 2006/
Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë	*Prosecutor v. Ljube Boškoski and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-PT, Confidential, Prosecution's Submission of Amended Pre-Trial Brief, 4 April 2006 /*Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, Dorëzimi Konfidencial prej Prokurorisë i Dosjes Paragjyqësore të Ndryshuar, 4 prill 2006/
Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit	*Prosecutor v. Ljube Boškoski and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-PT, Boškoski Defence Final Trial Brief with Confidential Annex A, 24 April 2008 /*Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes së Boshkoskit me Shtojcën Konfidenciale A, 24 gusht 2008/

Dosja Përfundimtare e Prokurorisë	*Prosecutor v. Ljube Boškoski and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-PT, Confidential, Prosecution's Final Brief, 24 April 2008 /*Prokuroria k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, Dosja Përfundimtare Konfidenciale e Prokurorisë, 24 gusht 2008/
Dhoma Gjyqësore	Seksioni II i Dhomës Gjyqësore II të Tribunalit
EAAG	Grupe të armatosura të shqiptarëve etnikë /Ethnic Albanian Armed Groups/
ECHR	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut /European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms/
ECtHR	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut /European Court of Human Rights/
ESZ	Njësi e Posaçme e Ministrisë së Brendshme e njohur me emrin "Tigrat"
EUMM	Misioni Monitorues i Bashkimit Evropian
Furunxhija/Aktgjykim	*Prosecutor v. Anto Furundžija*, Case No. IT-95-17/1-T. Judgement, 10 December 1998 /*Prokurori k. Anto Furunxhisë*, Lënda Nr. IT-95-17/1-T. Aktgjykim, 10 dhjetor 1998/
Furunxhija/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Anto Furundžija*, Case No. IT-95-17/1-A. Judgement, 21 July 2000 /*Prokurori k. Anto Furunxhisë*, Lënda Nr. IT-95-17/1-T. Aktgjykimi, 21 korrik 2000/
Galiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Stanislav Galić*, Case No. IT-98-29-T. Judgement and Opinion, 5 December 2003 /*Prokurori k. Stanisllav Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-T. Aktgjykimi dhe Mendim, 5 dhjetor 2003/
Galiq Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Stanislav Galić*, Case No. IT-98-29-A. Judgement, 30 November 2006 / *Prokurori k. Stanisllav Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-A. Aktgjykim, 30 nëntor 2006/
GDT	Grupe Diversante Terroriste
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë /International Court of Justice – ICJ/
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare /International Criminal Court – ICC/
Haliloviq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Sefer Halilović*, Case No. IT-01-48-T, Judgement, 16 November 2005 /*Prokurori k. Sefer Haliloviqit*, Lënda Nr. IT-01-48-T, Aktgjykim, 16 nëntor 2005/
Haliloviq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Sefer Halilović*, Case No. IT-01-48-A, Judgement, 16 October 2007 /*Prokurori k. Sefer Haliloviqit*, Lënda Nr. IT-01-48-A, Aktgjykim, 16 tetor 2007/
Haradinaj/Aktgjykim	*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, Lahi Brahimajt*. Lënda Nr. IT-04-84. Aktgjykim. 3 prill 2008.

Haxhihasanoviq Aktgjykim	*Prosecutor v. Enver Hadžihasanović and Amir Kubura*, Case No. IT-01-47-T. Judgement, 15 March 2006 /*Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-T. Aktgjykim, 15 mars 2006/
Haxhihasanoviq Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Enver Hadžihasanović and Amir Kubura*, Case No. IT-01-47-A. Judgement, 22 April 2008 /*Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A. Aktgjykim, 22 prill 2008/
Haxhihasanoviq Vendimi i Apelit të Rregullës 98*bis*	*Prosecutor v. Enver Hadžihasanović and Amir Kubura*, Case No. IT-01-47-AR73.3. "Decision on Joint Defence Interlocutory Appeal of Trial Chamber Decision on Rule 98*bis* Motions for Acquittal", 11 March 2005 /*Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-AR73.3. "Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Përbashkët të Mbrojtjes të Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Mocionet për Dhënie Pafajësie sipas Rregullës 98*bis*, 11 mars 2005/
HRW	Human Rights Watch
ICG	Grupi Ndërkombëtar i Krizë /International Crisis Group/
IMG	Grupi Ndërkombëtar i Menaxhimit /International Management Group/
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
Jelisiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Goran Jelisić*, Case No. IT-95-10-T Judgement, 14 December 1999 /*Prokurori k. Goran Jelisiqit*, Lënda Nr. IT-95-10-T Aktgjykim, 14 dhjetor 1999/
Jelisiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Goran Jelisić*, Case No. IT-95-10-A. Judgement, 5 July 2001 /*Prokurori k. Goran Jelisiqit*, Lënda Nr. IT-95-10-A. Aktgjykim, 5 korrik 2001/
Jokiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Miodrag Jokić*, Case No. IT-01-41/1-A. Judgement on Sentencing Appeals, 30 August 2005 /*Prokurori k. Miodrag Jokiqit*, Aktgjykim për Apelimet e Dënimit, Lënda Nr. IT-01-41/1-A. 30 gusht 2005/
Kamuhanda Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Jean de Dieu Kamuhanda*, Case No. ICTR-99-54A-A. Judgement, 19 September 2005 /*Prokurori k. Jean de Dieu Kamuhanda-s*, Lënda Nr. ICTR-99-54A-A. Aktgjykim, 19 shtator 2005/
Kayishema/Aktgjykim	*Prosecutor v. Clément Kayishema and Obed Ruzindana*, Case No. ICTR-95-1-T. Judgement, 21 May 1999 /*Prokurori k. Klement Kayishema-s dhe Obed Ruzindana-s*, Lënda Nr. ICTR-95-1-T. Aktgjykim, 21 mai 1999/
Kërnojelac/Aktgjykim	*Prosecutor v. Milorad Krnojelac*, Case No. IT-97-25-T. Judgement, 15 March 2002 /*Prokurori k. Millorad Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-T. Aktgjykim, 15 mars 2002/

Kërnojelac/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Milorad Krnojelac*, Case No. IT-97-25-A. Judgement 17 September 2003 /*Prokurori k. Millorad Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-A. Aktgjykim, 17 shtator 2003/
Kërstiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Radislav Krstić*, Case No. IT-98-33-T. Judgement, 2 August 2001 /*Prokurori k. Radisllav Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-T. Aktgjykim, 2 gusht 2001/
Kërstiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Radislav Krstić*, Case No. IT-98-33-A. Judgement, 19 April 2004 /*Prokurori k. Radisllav Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-A. Aktgjykim, 19 prill 2004/
KFOR	Forca e Kosovës. Forca shumëkombëshe e udhëhequr nga NATO-ja në Kosovë, e cila që prej vitit 1999 ndodhej nën mbikqyrjen e administratës së Kombeve të Bashkuara.
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq – International Committee of the Red Cross/ICRC
KNKK/Shpjegues	*Commentary on the Additional Protocols of Protocols 8 June 1977 to the Geneva Conventions of 12 August 1949* (International Committee of the Red Cross, Geneva 1987) /*Shpjegues në lidhje me Protokollet Shtesë të Protokolleve të 8 qershorit 1997 Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949* (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Gjenevë, 1987)/
KNKK /Shpjegues i Konventës së Gjenevës IV	J. Pictet, ed., *The Geneva Conventions of 12 August 1949: Commentary, Part IV: Geneva Convention Relative to the Protection of Civilian Persons in Time of War* (Geneva International Committee of the Red Cross 1958) /J. Pictet, bot., *Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949: Komentar, Pjesa IV: Konventa e Gjenevës për Mbrojtjen e Civilëve në Kohë Lufte* (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Gjenevë, 1958)/
Konventa e Gjenevës I	Geneva Convention I for the Amelioration of the Condition of Wounded and Sick in Armed Forces in the Field of 12 August 1949 /Konventa e Gjenevës I për Përmirësimin e Kushteve të të Plagosurve dhe të Sëmurëve në Forcat e Armatosura në Terren, e datës 12 gusht 1949/
Konventa e Gjenevës II	Geneva Convention II for the Amelioration of the Condition of Wounded, Sick and Shipwrecked Members of Armed Forces at Sea of 12 August 1949 /Konventa e Gjenevës I për Përmirësimin e Kushteve të të Plagosurve, të Sëmurëve dhe të Humburve në Det në Forcat e Armatosura në Det, e datës 12 gusht 1949/
Konventa e Gjenevës III	Geneva Convention III Relative to the Treatment of Prisoners of War of 12 August 1949 /Konventa e Gjenevës I lidhur me Trajtimin e Robërve të Luftës, e datës 12 gusht 1949/
Konventa e Gjenevës IV	Geneva Convention IV Relative to the Protection of Civilian Persons in Time of War of 12 August 1949 /Konventa e Gjenevës IV Për Mbrojtjen e Civilëve në Kohë Lufte, e datës 12 gusht 1949/
Konventat e Gjenevës	Konventat e Gjenevës I-IV të datës 12 gusht 1949

Kordiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Dario Kordić and Mario Čerkez*, Case No. IT-95-14/2-T. Judgement, 26 February 2001 /*Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit*, Lënda Nr. IT-95-14/2-T. Aktgjykim, 26 shkurt 2001/
Kordiq Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Dario Kordić and Mario Čerkez*, Case No. IT-95-14/2-A. Judgement, 17 December 2004 /*Prokuroria k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit*, Lënda Nr. IT-95-14/2-A. Aktgjykim, 17 dhjetor 2004/
Kunarac/Aktgjykim	*Prosecutor v. Dragoljub Kunarac, Radomir Kovač, Zoran Vuković*, Case No. IT-96-23/1-T, Judgement, 22 February 2001 /*Prokurori k. Dragolub Kunaracit, Radomir Kovaçit, Zoran Vukoviqit*, Lënda Nr. IT-96-23/1-T. Aktgjykim, 22 shkurt 2001/
Kunarac/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Dragoljub Kunarac, Radomir Kovač, Zoran Vuković*, Case No. IT-96-23&23/1-A Judgement, 12 June 2002 /*Prokurori k. Dragolub Kunaracit, Radomir Kovaçit, Zoran Vukoviqit*, Lënda Nr. IT-96-23&23/1-A Aktgjykim, 12 qershor 2002/
Kupreshkiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Zoran Kupreškić, Mirjan Kupreškić, Vlatko Kupreškić, Drago Josipović, and Vladimir Šantić*, Case No. IT-95-16-T. Judgement, 14 January 2000 /*Prokurori k. Zoran Kupreshkiqit, Mirjan Kupreshkiqit, Vllatko Kupreshkiqit, Drago Josipoviqit, dhe Vladimir Shantiqit*, Lënda Nr. IT-95-16-T. Aktgjykim, 14 janar 2000/
Kupreshkiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Zoran Kupreškić, Mirjan Kupreškić, Vlatko Kupreškić, Drago Josipović, and Vladimir Šantić*, Case No. IT-95-16-A. Judgement, 23 October 2001 / *Prokurori k. Zoran Kupreshkiqit, Mirjan Kupreshkiqit, Vllatko Kupreshkiqit, Drago Josipoviqit, dhe Vladimir Shantiqit*, Lënda Nr. IT-95-16-A. Aktgjykim, 23 tetor 2001/
Kvoçka/Aktgjykim	*Prosecutor v. Miroslav Kvočka, Milojica Kos, Mlađo Radić, Zoran Žigić, and Dragoljub Prcać*, Case No. IT-98-30-T, Judgement, 2 November 2001 /*Prokuroria k. Mirosllav Kvoçkës, Millojica Kosit, Mllagjo Radiqit, Zoran Zhigiqit, dhe Dragolub Përcaqit*, Lënda Nr. IT-98-30-T, Aktgjykim, 2 nëntor 2001/
Kvoçka/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Miroslav Kvočka, Mlađo Radić, Zoran Žigić, and Dragoljub Prcać*, Case No. IT-98-30-A, Judgement, 28 February 2005 / *Prokuroria k. Mirosllav Kvoçkës, Millojica Kosit, Mllagjo Radiqit, Zoran Zhigiqit, dhe Dragolub Përcaqit*, Lënda Nr. IT-98-30-A, Aktgjykimi, 28 shkurt 2005/
Limaj/Aktgjykim	*Prokurori k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut*, Lënda Nr. IT-03-66-T. Aktgjykim, 30 nëntor 2005
Limaj/Aktgjykimi i Apelit	*Prokurori k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut*, Lënda Nr. IT-03-66-T Aktgjykim, 27 shtator 2007
LP	Partia Liberale
LDP	Partia Liberal-Demokrate
Luanët	Batalioni policor i ndërhyrjes së shpejtë i Ministrisë së Brendshme të IRJM-së

Martiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Milan Martić*, Case No. IT-95-11-T. Judgement, 12 June 2007 /*Prokurori k. Milan Martiqit*, Lënda nr. IT-95-11-T. Aktgjykim, 12 qershor 2007/
MB	Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë
Mbrojtja	Avokatët e të Akuzuarve Lube Boshkoski dhe Johan Tarçulovski
Mbrojtja e Boshkoskit	Avokatët e të Akuzuarit Lube Boshkoski
Mbrojtja e Tarçulovskit	Avokatët e të Akuzuarit Johan Tarçulovski
Mërkshiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Mile Mrkšić, Miroslav Radić, and Veselin Šljivančanin*, Case No. IT-95-13/1, Judgement, 27 September 2007 /Aktgjykim: *Prokurori k. Mile Mërkshiqit, Mirosllav Radiqit, dhe Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13/1, Aktgjykim, 27 shtator 2007/
Dragomir Millosheviq Aktgjykim	*Prosecutor v. Dragomir Milošević*. Case No. IT-98-29/1, 12 December 2007 */Prokurori k. Dragmir Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-98-29/1, 12 dhjetor 2007/
Sllobodan Millosheviq Vendimi i Rregullës 98*bis*	*Prosecutor v. Slobodan Milošević*, Case No. IT-02-54-T, Decision on Motion for Judgement of Acquittal, 16 June 2004 /*Prokurori k. Sllobodan Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendimi mbi Mocionin për Verdiktin e Dhënies së Pafajësisë, 16 qershor 2004/
Muçiq/Aktgjykim për Apelimin e Dënimit	*Prosecutor v. Zdravko Mucić, Hazim Delić and Esad Landžo*, Case No. IT-96-21-Abis, Judgement on Sentence Appeal, 8 April 2003 /*Prokurori k. Zdravko Muçiqit, Hazim Deliqit dhe Esad Lanxhos*, Lënda Nr. IT-96-21-Abis, Aktgjykim për Apelimin e Dënimit, 8 prill 2003.
MRTV	Radio-Televizioni Maqedonas
Naletiliq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Mladen Naletilić and Vinko Martinović*, Case No. IT-98-34-T. Judgement, 31 March 2003 /*Prokurori k. Mlladen Naletiliqit dhe Vinko Martinoviqit*, Lënda Nr. IT-98-34-T, Aktgjykim, 31 mars 2003.
Naletiliq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Mladen Naletilić and Vinko Martinović*, Case No. IT-98-34-A. Judgement, 3 May 2006 /*Prokurori k. Mlladen Naletiliqit dhe Vinko Martinoviqit*, Lënda Nr. IT-98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006.
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior /North Atlantic Treaty Organisation/
ND	Demokracia e Re
NFI	Instituti Kriminalistik i Holandës /Netherlands Forensic Institute/
Dragan Nikoliq Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Dragan Nikolić*, Case No. IT-94-2-S, Judgement on Sentencing Appeal, 4 February 2005 /*Prokurori k. Dragan Nikoliqit*, Lënda Nr. IT-94-2-S, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit, 4 shkurt 2005/.
Dragan Nikoliq Aktgjykimi i Dënimit	*Prosecutor v. Dragan Nikolić*, Case No. IT-94-2-S, Sentencing Judgement, 18 December 2003 /*Prokurori k. Dragan Nikoliqit*, Lënda Nr. IT-94-2-S, Aktgjykimi i Dënimit, 18 dhjetor 2003/

Momir Nikoliq Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Momir Nikolić*, Case No. IT-02-60/1-A, Judgement on Sentencing Appeal, 8 March 2006 /*Prokurori k. Momir Nikoliqit*, Lënda Nr. IT-02-60/1-A, Aktgjykimi i Apelimit të Dënimit, 8 mars 2006/.
Neni i Përbashkët 3	Neni 3 I Konventave të Gjenevës I - IV
NPK	Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale /Joint Criminal Enterprise – JCE/
NPKB	Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara /United Nations Detention Unit – UNDU/
OJRM	Drejtoria për qetësinë dhe rendin publik (MB)
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara-United Nations Organisation/UNO
Oriq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Naser Orić*, Case No. IT-03-68-T, Judgement, 30 June 2006 /*Prokurori k. Naser Oriq*, Lënda Nr. IT-03-68-T, Aktgjykim, 30 qershor 2006/
Oriq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Naser Orić*, Case No. IT-03-68-A, Judgement, 3 July 2008 /*Prokurori k. Naser Oriq*, Lënda Nr. IT-03-68-A, Aktgjykim, 3 korrik 2008/
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë-organisation for Security and Cooperation in Europe/OSCE
OVR	Dega për Punë të Brendshme /Oddelenie za Vnatrešni Raboti/
PDSH	Partia Demokratike Shqiptare
PKK	Partia Punëtore e Kurdistanit /Partiya Karkerên Kurdistan/
PPD	Partia e Prosperitetit Demokratik
PPDSH	Partia për Prosperitet Demokratik e Shqiptarëve
Prokuroria	Zyra e Prokurores/it të TPNJ-së
Protokolli Shtesë I	Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 Për Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve Ndërkombëtare të Armatosura (Protokolli I), Gjenevë, 8 qershor 1977
Protokolli Shtesë II	Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949. Për Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve Jondërkombëtare të Armatosura (Protokolli II), Gjenevë, 8 qershor 1977
PSB	Zyra e Sigurisë Publike e Ministrisë së Brendshme /Public Security Bureau/
PSOLO	Stacion policor në Shkup
Rajiq/Aktgjykimi i Dënimit	*Prosecutor v. Ivica Rajić, a.k.a. Viktor Andrić*, Case No. IT-95-12-S, Sentencing Judgement, 8 May 2006 /*Prokuroria k. Ivica Rajiqit, i njohur gjithashtu si Viktor Andriq*, Lënda Nr. IT-95-12-S, Aktgjykimi i Dënimit, 8 maj 2006/
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë

RM	Republika e Maqedonisë
Rutaganda/Aktgjykim	*Prosecutor v. Georges Anderson Nderubumwe Rutaganda*, Case No. ICTR-96-3-T, Judgement, 6 December 1999 */Prokurori k. Georges Anderson Nderubumwe Rutaganda*, Lënda Nr. ICTR-96-3-T, Aktgjykim, 6 dhjetor 1999
Rregullorja	Rregullorja e Procedurës dhe e Provave
Rregullorja e Organizimit	Rregullorja e Organizimit dhe Punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme
SDSM	Aleanca Social-Demokrate e Maqedonisë
Semanza/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Laurent Semanza*, Case No. ICTR-97-20-A. Judgerment, 20 May 2005 /*Prokurori k. Laurent Semanza-s*, Lënda Nr. ICTR-97-20-A, Aktgjykim, 20 maj 2005.
Stakiq /Aktgjykim	*Prosecutor v. Milomir Stakić*, Case No. IT-97-24-T, Judgement, 31 July 2003 /*Prokurori k. Millomir Stakiqit*, Lënda Nr. IT-97-24-T, Aktgjykim, 31 korrik 2003/
Stakiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Milomir Stakić*, Case No. IT-97-24-A, Judgement, 22 March 2006 /*Prokurori k. Millomir Stakiqit*, Lënda Nr. IT-97-24-A, Aktgjykimi, 22 mars 2006/
Statuti	Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, themeluar nëpërmjet Rezolutës 827 të Këshillit të Sigurimit
Strugar/Aktgjykim	*Prosecutor v. Pavle Strugar*, Case No. IT-01-42-T, Judgement, 31 January 2005 /*Prokuroria k. Pavle Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-T, Aktgjykim, 31 janar 2005/
SVR	Sektori për Punë të Brendshme /Sektor za Vnatrešni Raboti/
T	Transkripti i seancave në këtë çështje. Të gjitha faqet e transkriptit të përmendura në këtë Aktgjykim janë marrë nga versioni i pakorrugjuar i Transkriptit. Si pasojë mund të ketë ndryshime të vogla në faqosjen e këtushme ne krahasim me Transkriptin përfundimtar publik
Tadiq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule,"* Case No. IT-94-1-T, Opinion and Judgement, 7 May 1997 / *Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur si "Dule,"* Lënda Nr. IT-94-1-T, Mendim dhe Aktgjykim, 7 maj 1997/
Tadiq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule,"* Case No. IT-94-1-A Judgement, 15 July 1999 /*Prokuroria k. Dushko Tadiqit i njohur si "Dule,"* Lënda Nr. IT-94-1-A, Aktgjykimi, 15 korrik 1999/
Tadiq/Aktgjykimi i Apelimit të Dënimit	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule,"* Case No. IT-94-1-A and IT-94-1-A*bis*, Judgement on Sentencing Appeals, 26 January 2000 /*Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur si "Dule,"* Lënda Nr. IT-94-1-A dhe IT-94-1-A*bis*, Aktgjykimi i Apelimit të Dënimit, 26 janar 2000/

Tadiq/Vendimi për Jurisdiksion	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule,"* Case No. IT-94-1-AR72, Decision on Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction, 2 October 1995 /*Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur si "Dule,"* Lënda Nr. IT-94-1-AR72, Vendimi në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes për Apelimin e Ndërkohshëm për Jurisdiksionin, 2 tetor 1995/
Tarçulovski Dosja Paragjyqësore e Mbrojtjes	*Prosecutor v. Ljube Boškoski and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-PT, Johan Tarčulovski Pre-Trial Brief, 2 October 2006 /*Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçuloskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, Dosja Paragjyqësore e Mbrojtjes, 2 tetor 2006.
Tarçulovski/Dosja Përfundimare e Mbrojtjes	*Prosecutor v. Ljube Boškoski and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-T, Johan Tarčulovski Pre-Trial Brief, 24 April 2008 /*Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, Dosja paragjyqësore e Mbrojtjes, 24 prill 2008.
TMK	Trupa e Mbrotjes së Kosovës
TPNJ	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991
TPNR	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës, dhe të Qytetarëve të Ruandës Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinje nga 1 Janari 1994 deri më 31 Dhjetor 1994
Tribunali	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991
UBK	Drejtoria e Sigurimit dhe Kundërzbulimit e Ministrisë së Brendshme
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare ose në anglisht NLA
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare ose në anglisht KLA
UÇPMB	Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit
URM	Ushtria e Republikës së Maqedonisë
Vasileviq/Aktgjykim	*Prosecutor v. Mitar Vasiljević*, Case No. IT-98-32-T, Judgement, 29 November 2002 /*Prokurori k. Mitar Vasileviqit*, Lënda Nr. IT-98-32-T, Aktgjykimi, 29 nëntor 2002/
Vasileviq/Aktgjykimi i Apelit	*Prosecutor v. Mitar Vasiljević*, Case No. IT-98-32-A, Judgement, 25 February 2004 / *Prokurori k. Mitar Vasileviqit*, Lënda Nr. IT-98-32-A, Aktgjykim, 25 shkurt 2004/
VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim në Maqedoni
VMRO-VMRO	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Opsioni i Vërtetë i Reformave në Maqedoni

Zolja Granathedhës dore i këmbësorisë

XI. SHTOJCA II: HISTORIA PROCEDURALE

A. Faza paragjyqësore

1. Konfirmimi i aktakuzës fillestare, arrestimi dhe paraqitja e parë

609. Aktakuza origjinale[2098] kundër të Akuzuarve Lube Boshkoski dhe Johan Tarçulovski, u konfirmua më 9 mars 2005;[2099] po atë ditë u lëshuan fletëarrestime konfidenciale për të dy të Akuzuarit.[2100] Në kohën e transferimit të tij për në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara ("NJPKB") në Hagë më 24 mars 2005, Lube Boshkoski ndodhej në paraburgim në Kroaci ku priste të gjykohej për akuza të palidhura me këtë çështje.[2101] Johan Tarçulovski u arrestua më 14 mars 2005 dhe u transferua në NJPKB më 16 mars 2005.[2102] Gjatë paraqitjes së parë më 1 prill 2005, Lube Boshkoski u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat kundër tij. Gjatë paraqitjes së parë më 21 mars 2005, Johan Tarçulovski vendosi të shtynte vendimin e vetëdeklarimit sipas Rregullores, dhe më vonë, më 18 prill 2005, u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat kundër tij.

2. Mospranim i jurisdiksionit të Tribunalit

610. Më 23 maj 2005, Lube Boshkoski parashtroi mospranimin e jurisdiksionit hapësinor, kohor dhe lëndor të Tribunalit dhe Johan Tarçulovski bëri të njëjtën gjë më 31

[2098] Aktakuza e mirëfilltë mban datën 22 dhjetor 2004.
[2099] Para Gjykatësit Shqyrtues Patrick Robinson, "Vendimi për Shqyrtimin e Aktakuzës," 9 mars 2005.
[2100] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit, ex parte* dhe e mbyllur me vulë, Lënda Nr. IT-04-82-1, "Fletarrestim/Urdhër për Dorëzim" 9 mars 2005, adresuar Republikës së Maqedonisë, Republikës së Kroacisë dhe shteteve anëtarë të Kombeve të Bashkuara; *Prokurorja k. Lube Boshkoskit, ex parte* dhe e mbyllur me vulë, Lënda Nr. IT-04-82-1, "Fletarrestim/Urdhër për Dorëzim" 9 mars 2005, adresuar Republikës së Maqedonisë, dhe shteteve anëtarë të Kombeve të Bashkuara" 9 mars 2005.
[2101] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR65.2,"Vendim në lidhje me Apelin e Ndërkohshëm të Lube Boshkoskit për Lirim të Përkohshëm," 28 shtator 2005, para. 3.
[2102] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim në lidhje me Mocionin e Johan Tarçulovskit për Lirim të Përkohshëm," 18 korrik 2005, para. 4.

mars 2005, 24 maj 2005 dhe 27 maj 2007.[2103] Të dy ekipet mbrojtëse argumentuan përmbledhtazi se: (i) jurisdiksioni kohor i Tribunalit mbaroi në vitin 1999 si rezultat i marrëveshjeve të paqes të cilat përfunduan luftën në Bosnje-Hercegovinë dhe Kroaci në vitin 1995 dhe në Kosovë në vitin 1999;[2104] (ii) Tribunali nuk ka jurisdiksion hapësinor sepse në vitin 1993 kur u themelua Tribunali, IRJM-ja nuk ishte pjesë e Jugosllavisë;[2105] dhe (iii) Tribunali nuk ka jurisdiksion lëndor me arsyetimin se nuk kishte konflikt të armatosur, dhe krimat e akuzuara nuk përmbushin kushtet e domosdoshme për zbatueshmërinë e Nenit 3 të Statutit.[2106]

611. Më 1 qershor 2005, Dhoma Paragjyqësore lëshoi vendime në lidhje me dy mocionet e para të Johan Tarçulovskit,[2107] ku u konnkludua se Tribunali kishte jurisdiksionin hapësinor mbi krimet e akuzuara në Aktakuzë, sepse në jurisprudencën e vet gjithmonë ishte pranuar se territori i ish-RSFJ-ja përfshinte IRJM-në,[2108] se Tribunali ka jurisdiksion kohor mbi krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 dhe Statuti nuk përcakton datën e mbarimit të këtij jurisdiksioni,[2109] dhe se argumenti i ekzistencës ose mosekzistencës së konfliktit të armatosur nuk kishte lidhje me argumentet e jurisdiksionit, por kërkon një konkluzion në lidhje me faktet, i cili mund të jepet vetëm prej një Dhome Gjyqësore pasi ajo ka shqyrtuar tërë provat e dorëzuara gjatë procesit.[2110] Në vendimin e datës 14 qershor 2005, Dhoma konkludoi se këto përfundime vlenin edhe në lidhje me argumentet e mocionit të Lube Boshkoskit të datës

[2103] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i Mbrojtjes së Lube Boshkoskit që Kundërshton Juridiksionin e Tribunalit," 23 maj 2005 ("Mocion i Boshkoskit për Juridiksionin maj 2005"); *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocion Paraprak kundër Aktakuzës së Prokurorisë së Tribunalit Nr. IT-04-82-I i datës 22 dhjetor 2004," dorëzuar nga Mbrojtja e të Akuzuarit Johan Tarçulovski më 31 mars 2005 ("Mocioni Paraprak i Tarçulovskit mars 2005"); "Shtojcë e Mocionit Paraprak," dorëzuar nga Mbrojtja e të Akuzuarit Johan Tarçulovski më 24 maj 2005 ("Shtojcë e Mocionit Paraprak maj 2005"); "Mocioni i dorëzuar nga Mbrojtja e Johan Tarçulovskit që Kundërshton Juridiksionin Hapësinor, Kohor dhe Lëndor të Tribunalit," 27 maj 2005 ("Mocion i Tarçulovskit për Juridiksionin maj 2005").
[2104] Mocion Juridiksioni i Boshkovskit maj 2005, para. 24; Mocioni Paraprak i Tarçulovskit, f. 7 para. 3; Shtojcë e Mocionit Paraprak maj 2005, f. 1; Mocion Juridiksioni i Tarçulovskit maj 2005, para. 5.
[2105] Mocion Juridiksioni i Boshkovskit maj 2005, paragrafët 22-23; Mocion Paraprak i Tarçulovskit mars 2005, f. 7, paragrafët 3-4, f. 8, para. 1; Shtojcë e Mocionit Paraprak maj 2005, f. 1-2; Mocion Juridiksioni i Tarçulovskit maj 2005, para. 5.
[2106] Mocioni Juridiksioni i Boshkovskit maj 2005, paragrafët 25-35; Mocion Juridiksioni i Tarçulovskit maj 2005, paragrafët 6-19.
[2107] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim në lidhje me Mocionin e Johan Tarçulovskit që Kundërshton Jurisdiksionin," 1 qershor 2005 ("Vendim Juridiksioni i Tarçulovskit qershor 2005"), dhe "Vendim në lidhje me Mocionin e Dytë të Tarçulovskit që Kundërshton Jurisdiksionin," 1 qershor 2005 ("Vendimi i dytë juridiksioni i Tarçulovskit qershor 2005").
[2108] Vendim juridiksioni i Tarçulovskit qershor 2005, para. 9.
[2109] *Ibid*, para. 10.
[2110] *Ibid*, para. 11.

23 maj 2005 për mospranimin e jurisdiksionit.[2111] Më 15 qershor 2005, Johan Tarçulovski dorëzoi një apel të ndërkohshëm kundër vendimit të Dhomës Paragjyqësore të datës 1 qershor 2005,[2112] i cili u hodh poshtë nga Dhoma e Apelit, më 22 korrik 2005 me arsyetimin se, së pari jurisdiksioni kohor i Tribunalit ishte i pakufizuar në afat dhe përfshinte akuza për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare që ndodhën edhe pas vitit 2001,[2113] dhe, së dyti, pajtohej me përfundimin e Dhomës Paragjyqësore se kategorizimi i konfliktit në IRJM-në ishte konkluzion mbi bazë faktesh që do të trajtohej gjatë gjykimit dhe jo gjatë fazës paragjyqësore.[2114]

612. Më 21 qershor 2006, avokati i atëhershëm i Lube Boshoskit, i caktuar *pro bono,* dorëzoi një mocion kundër jurisdiksionit të Tribunalit si dhe një parashtrim kundër Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë.[2115] Mocioni përmbante tri argumente: (i) se nuk ka bazë ligjore për përgjegjësinë sipas Nenit 7(3) të Statutit për veprime të kryera nga të tretë, veprime të cilat pretendohet se janë ndihmuar dhe inkurajuar nga vartësit e tyre;[2116] (ii) se nuk është argumentuar *mens rea* e domosdoshme lidhur me konfliktin e armatosur dhe rrjedhimisht aktakuza nuk përmbush kushtin juridiksional të Nenit 3;[2117] dhe (iii) se përgjegjësia sipas Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë konsiston në shpërdorim procesi, sepse ky ndryshim u kërkua si rezultat së dijenisë së Prokurorisë se akuzës i mungonte baza ligjore.[2118] Në vendimin e 8 shtatorit 2006, Dhoma Paragjyqësore i hodhi poshtë këta argumente[2119] me arsyetimin se argumenti i parë ishte hedhur poshtë tashmë në vendimin e mëparshëm të Dhomës,[2120] se në jurisprudencën e

[2111] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim për Mocionin e Lube Boshkoskit i cili kundërshtoi jurisdiksion," 14 qershor 2005, f. 3 ("Vendim juridiksioni i Boshkoskit qershor 2005").
[2112] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR 72.1, "Apeli i ndërkohshëm kundër vendimit mbi mocionin e Johan Tarçulovskit i cili kundërshtoi jurisdiksionin," 15 qershor 2005.
[2113] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR 72.1, "Vendim mbi apelin e ndërkohshëm mbi jurisdiksionin," 22 korrik 2005, para. 10.
[2114] *Ibid*, para. 13.
[2115] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i avokatit të caktuar *pro bono* i cili kundërshton jurisdiksionin," 21 qershor 2006, paragrafët 3-4 ("Mocion jurisdiksioni i avokatit të caktuar *pro bono* qershor 2006").
[2116] *Ibid,* paragrafët 5-23.
[2117] *Ibid,* paragrafët 24-27, shih në mënyrë të veçantë para. 26.
[2118] *Ibid,* paragrafët 28-33, shih në mënyrë të veçantë para. 30.
[2119] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim mbi mocionin e avokatit të caktuar *pro bono* i cili kundërshton jurisdiksionin," 8 shtator 2006 ("Vendim jurisdiksioni i avokatit të caktuar *pro bono* shtator 2006").
[2120] *Ibid*, para. 13, *shih* gjithashtu paragrafët 15-16; *shih* gjithashtu "Vendimin për mocionin e Prokurorisë për të ndryshuar Aktakuzën dhe për dorëzimin e Aktakuzës së Dytë të Ndryshuar të propozuar dhe për dorëzimin e Dosjës Paragjyqësore të Ndryshuar," 26 maj 2006.

Tribunalit nuk ekziston bazë ligjore në mbështetje të argumentit se *mens rea* në lidhje me ekzistencën dhe karakterin ndërkombëtar të një konflikti të armatosur, është kusht paraprak jurisdiksional,[2121] dhe se akuza e rëndë e keqpërdorimit të procesit nuk mund të vërtetohet.[2122] Lube Boshkoski dorëzoi një apel kundër këtij vendimi më 22 shtator 2006,[2123] i cili u hodh poshtë më 9 janar 2007 me arsyetimin, ndër të tjera, se argumentet në fjalë lidhur me Nenin 7(3) të Statutit ishin trajtuar ligjërisht më parë, meqenëse Dhoma Paragjyqësore hodhi poshtë të njëjtat argumente në vendimin e saj të datës 26 maj 2006 ku konfirmoi Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë dhe se pretendimet e Boshkoskit në lidhje me Nenin 3 dhe shpërdorimin e procesit nuk paraqiten në mënyrë të duhur si çështje jurisdiksioni në kuptimin e ngushtë të Rregullës 72(D) të Rregullores.[2124]

3. Historia e Aktakuzës

613. Historia e aktakuzës në këtë çështje ndërthuret me kundërshtimet e jurisdiksionit të paraqitura nga palët, veçanërisht Lube Boshkoski, lidhur me përgjegjësinë e tij në bazë të Nenit 7(3) të Statutit. Më 25 maj 2005, Lube Boshkoski dorëzoi një mocion kundër formës së aktakuzës fillestare, ku, ndër të tjera, argumentohej se kishte një sërë të metash në lidhje me argumentimin e Nenit 7(3) të Statutit.[2125] Në vendimin e 22 gushtit 2005, Dhoma Paragjyqësore hodhi poshtë të gjitha argumentet e ngritura në mocion,[2126] urdhëroi Prokurorinë që të ndryshonte aktakuzën fillestare duke qartësuar nëse Lube Boshkoski ngarkohet me përgjegjësinë eprore vetëm për veprimet e policëve të regullt dhe të policëve rezervistë, apo nëse ai akuzohet gjithashtu për veprimet e personave të tjerë, ndër të cilët, të disa civilëve, policisë së posaçme, rojave të burgut dhe personelit të spitalit, të përmendur në aktakuzën fillestare.[2127] Prokuroria dorëzoi një aktakuzë të rishikuar më 5 shtator 2005, në përputhje me urdhëresën e Dhomës Paragjyqësore dhe

[2121] Vendim jurisdiksioni i avokatit të caktuar *pro bono* shtator 2006, para. 19.
[2122] *Ibid*, para. 21.
[2123] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Apeli i Mbrojtjes së Boshkoskit mbi jurisdiksion," 22 shtator 2006.
[2124] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR72.2, "Vendim mbi apelin e Lube Boshkoskit mbi jurisdiksion," 9 janar 2007, paragrafët 4-5.
[2125] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i Mbrojtjes së Lube Boshkoskit i cili kundërshton formën e Aktakuzës," 25 maj 2005, *shih* paragrafët 27-47.
[2126] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim mbi mocionin e Lube Boshkoshkit i cili kundërshton formën e Aktakuzës," 22 gusht 2005.
[2127] *Ibid*, para. 19 dhe f. 12, Dispozitë.

kërkoi gjithashtu të shtonte ndryshime të tjera për t'a bërë aktakuzën "më të saktë dhe konkrete nga pikëpamja ligjore dhe faktike."[2128] Në mocionin e 29 shtatorit 2005, Mbrojtja e Boshkoskit argumentoi, ndër të tjera, se burimi dhe arsyet e pretendimeve për pushtetin dhe kontrollin efektiv të të Akuzuarit mbi policinë e posaçme, rojat e burgut, personelin e spitalit dhe civilë, nuk ishin paraqitur me hollësi të mjaftueshme në aktakuzën e ndryshuar të propozuar dhe se përcaktimi i afatit kohor të konfliktit të armatosur, e detyroi Prokurorinë që të paraqiste prova apo arsye të mjaftueshme për të besuar në ekzistencën e një konflikti të tillë.[2129] Gjithashtu, Mbrojtja e Tarçulovskit dorëzoi një mocion ku pretendoheshin një sërë mangësish në lidhje me argumentimin e Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, ku argumentohej se Prokuroria nuk përcaktoi identitetin e pjesëmarrësve të NPK-së, se ajo nuk arriti të sqaronte nëse Johan Tarçulovski akuzohet si bashkëkryes apo për ndihmë dhe inkurajim të NPK-së, dhe se afati kohor i pjesëmarrjes së Johan Tarçulovskit në NPK nuk u argumentua qartë.[2130]

614. Më 1 nëntor 2005, Dhoma Paragjyqësore nxorri një vendim në lidhje me kundërshtimet e ngritura nga të dy Mbrojtjet në mocionet e tyre përkatëse.[2131] Ndër të tjera, Dhoma Paragjyqësore përfundoi se parashtrimi i ri i propozuar në lidhje me pushtetin e Lube Boshkoskit mbi "policinë e posaçme" dhe policinë e zakonshme përfshiu fakte të mjaftueshme materiale, por se parashtrimi lidhur me "veprime të kryera nga rojat e burgut, personeli i spitalit dhe civilët" mbeti i përgjithshëm dhe i paqartë, dhe urdhëroi Prokurorinë që për të korigjuar këtë mangësi, të paraqiste sqarime në Dosjen e saj Paragjyqësore që do ta dorëzonte më 7 nëntor 2005.[2132] Gjithashtu Dhoma miratoi ndryshimin e propozuar lidhur me afatin kohor të konfliktit të armatosur.[2133] Dhoma Paragjyqësore hodhi poshtë kundërshtimet e ngritura nga Johan Tarçulovski ndaj ndryshimeve të propozuara nga Prokuroria, duke qenë se të gjitha kundërshtimet kishin të

[2128] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i Prokurorisë për leje për të ndryshuar Aktakuzën e mirëfilltë me shtesat Shtojca A dhe B," 5 shtator 2005, para. 2.
[2129] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Përgjigjja e Mbrojtjes mocionit të Prokurorisë për leje për të ndryshuar Aktakuzën e mirëfilltë me shtesat Shtojca A dhe B," 29 shtator 2005, paragrafët 10-13, 14-17, 25-26.
[2130] *Ibid*, paragrafët 6-11.
[2131] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim mbi mocionin e Prokurorisë për leje për të ndryshuar Aktakuzën e mirëfilltë dhe mbi mocionet e Mbrojtjes të cilat kundërshtojnë formën e Aktakuzës së propozuar," 1 nëntor 2005.
[2132] *Ibid,* paragrafët 37-42.
[2133] *Ibid,* paragrafët 10-13.

bënin me pretendimet të cilat kishin ekzistuar në aktakuzën fillestare, ndaj të cilave Tarçulovski nuk kishte ngritur kundërshtime. Mirëpo Dhoma Paragjyqësore urdhëroi *proprio motu* që në Dosjen e saj Paragjyqësore, Prokuroria të shtonte një përshkrim të hollësishëm, mundësisht me emër, të bashkëpjesëmarrësve të pretenduar të Johan Tarçulovskit në NPK, dhe shtoi se priste një përshkrim të zgjeruar të formave të tjera të përgjegjësisë për të cilat u akuzua i Akuzuari.[2134] Prokuroria dorëzoi aktakuzën e ndryshuar më 2 nëntor 2005,[2135] dhe Dosjen Paragjyqësore më 7 nëntor 2005.[2136]

615. Duke u bazuar në një tërësi udhëzimesh të lëshuara nga Gjykatësi Paragjyqësor gjatë një konference të Rregullës 65*ter*[2137]më 23 mars 2006, ndër të tjera, për çështje të cilat mbetën të paqarta në lidhje me akuzën kundër Lube Boshkoskit bazuar në Nenin 7(3),[2138] si dhe me disa çështje në lidhje me NPK-në e pretenduar dhe pjesëmarrjen e Johan Tarçulovskit në të,[2139] Prokuroria dorëzoi më 4 prill 2006 një mocion për ndryshimin e aktakuzës[2140] si dhe Dosjen Paragjyqësore të Ndryshuar.[2141] Në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë, Prokuroria synonte qartësimin dhe kufizimin e akuzave kundër të Akuzuarve.[2142] Më 11 prill 2006, Mbrojtja e Boshkoskit dorëzoi një Përgjigje,[2143] ku ndër të tjera argumentohej se ndryshimi i propozuar lidhur me përgjegjësinë eprore të Lube Boshkoskit tejkalonte juridiksionin e Nenit 7(3) të Statutit.[2144] Në një vendim të datës 26 maj 2006, Dhoma Paragjyqësore diskutoi

[2134] *Ibid,* paragrafët 45-47.
[2135] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Njoftimi i Prokurorisë se u bind žVendimit të Dhomës Gjyqësore mbi mocionin e Prokurorisë për leje për të ndryshuar Aktakuzën e mirëfilltë dhe mbi mocionet e Mbrojtjes të cilat kundërshtojnë formën e Aktakuzës së propozuar,' me Shtojcën A", 2 nëntor 2005, dhe "Aktakuza e Ndryshuar," 2 nëntor 2005.
[2136] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë," 7 nëntor 2005.
[2137] Konferenca e Rregullës 65*ter*, 23 mars 2006.
[2138] Konferenca e Rregullës 65*ter*, 23 mars 2006.
[2139] Konferenca e Rregullës 65*ter*, 23 mars 2006.
[2140] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i Prokurorisë për të ndryshuar Aktakuzën dhe dorëzimi i Aktakuzës së Dytë të Ndryshuar të propozuar," 4 prill 2006 ("Mocioni për të ndryshuar Aktakuzën dhe Aktakuza e Dytë e Ndryshuar e propozuar prill 2006")
[2141] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Dorëzimi i Prokurorisë i Dosjes Paragjyqësore të Ndryshuar," 4 prill 2006.
[2142] Mocion për të ndryshuar Aktakuzën dhe Aktakuza e Dytë e Ndryshuar e propozuar, prill 2006, para. 1.
[2143] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Përgjigjja e Mbrojtjes mocionit të Prokurorisë për të ndryshuar Aktakuzën dhe dorëzimi i Aktakuzës së Dytë të Ndryshuar të propozuar," 11 prill 2006.
[2144] *Ibid*, paragrafët 5-15.

hollësisht llojin dhe masën e përgjegjësisë së pretenduar penale të Lube Boshkoskit,[2145] dhe masën e përgjegjësisë së pretenduar penale të Johan Tarçulovskit,[2146] dhe miratoi kërkesën e Prokurorisë për ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar dhe Dosjes Paragjyqësore.[2147] Prokuroria dorëzoi Aktakuzën e Ndryshuar më 4 prill 2006/si në origjinal/; dhe të Akuzuarve iu dhanë 14 ditë prej datës së dorëzimit të përkthimit të vendimit të datës 26 maj 2006, për të dorëzuar kundërshtimet e tyre ndaj Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë.[2148]

616. Më 21 qershor 2006, avokati i caktuar *pro bono* për Lube Boshkoskin, dorëzoi një mocion ku argumentohej se paragrafi 11 i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë, lidhur me përgjegjësinë eprore të të Akuzuarit sipas Nenit 7(3) per veprimet e vartësve të tij, nuk përmbante fakte të nevojshme materiale.[2149] Mocionit iu bashkëngjit një shtojcë me një sërë pyetjesh të të Akuzuarit Lube Boshkoski lidhur me Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë.[2150] Prokuroria u përgjigj se as në pyetjet e të Akuzuarit, as në parashtrimet e avokatit të caktuar *pro bono*, nuk përmendej ndonjë mangësi materiale në formën e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë.[2151] Në vendimin e datës 27 shtator 2006, Dhoma Paragjyqësore hodhi poshtë të gjitha argumentet e ngritura në lidhje me paragrafin 11 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë, për Nenin 7(3) dhe rrëzoi mocionin e Mbrojtjes.[2152] Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë, e datës 4 prill 2006, u bë aktakuza në fuqi.

617. Së fundi, më 28 shtator 2007, Prokuroria dorëzoi një mocion ku kërkoi leje për të ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë duke zëvendësuar referencat për një postbllok të policisë maqedonase në Buzallak ose "Buzallak / Kodra e Zaimit" me

[2145] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim mbi mocionin e Prokurorisë për të ndryshuar Aktakuzën dhe dorëzimi i Aktakuzës së Dytë të Ndryshuar të propozuar dhe dorëzimi i Dosjes Paragjyqësore të ndryshuar," 26 maj 2006, paragrafët 15-48.
[2146] *Ibid*, paragrafët 49-51.
[2147] *Ibid*, para. 71.
[2148] *Ibid*, f. 21, Dispozitë. Përkthimi anglisht i Vendimit të datës 26 maj 2006 u dorëzua më 7 qershor 2006.
[2149] Mocion jurisdiksioni i avokatit të caktuar *pro bono* qershor 2006, paragrafët 15-18.
[2150] *Ibid*, Shtojca.
[2151] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Përgjigjja e Prokurorisë žMocionit të avokatit të caktuar *pro bono* i cili kundërshton formën e Aktakuzës së Dytë të Ndryshuar' me Shtojcën A," 4 korrik 2006, para. 15.
[2152] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim mbi mocionin i cili kundërshtoi formën e Aktakuzës së Dytë të Ndryshuar dhe mbi mocionin për leje për t'u përgjigjur," 27 shtator 2006, para. 28 dhe 29, dhe f. 10, Dispozitë.

referencat për një "postbllok të policisë të ngritur në një zonë midis dy vendeve të njohura si Buzallak dhe Kodra e Zaimit."[2153] Mbrojtja dorëzoi një përgjigje të përbashkët ku argumentohej se ndryshimet në aktakuzë, të propozuara nga Prokuroria, përbënin një akuzë të re sepse bëhej fjalë për një vendndodhje të re ku pretendohet se janë kryer krime.[2154] Në një vendim të datës 14 nëntor 2007, Dhoma Paragjyqësore konkludoi se nuk ishte e bindur për nevojën e ndryshimit të Aktakuzës, sepse emri konkret i postbllokut të policisë nuk ishte element ligjor i shkeljeve që pretendohet se kanë ndodhur aty dhe nuk kishte lidhje faktuale me to.[2155] Rrjedhimisht Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë, mbeti në fuqi gjatë gjithë pjesës tjetër të procesit.

4. Kërkesa për lirim të përkohshëm

618. Më 25 maj 2005, Lube Boshkoski dorëzoi një mocion ku kërkoi lirim të përkohshëm në IRJM, ose ndryshe, në Republikën e Kroacisë.[2156] Prokuroria paraqiti përgjigje kundër mocionit.[2157] Më 4 korrik 2005 u mbajt një seancë dëgjimore para Dhomës Paragjyqësore, për të dëgjuar të dy palët dhe Ministrin e Drejtësisë së IRJM-së në lidhje me çështjen.[2158] Në vendimin e datës 18 korrik 2005, Dhoma Paragjyqësore hodhi poshtë kërkesën e të Akuzuarit për lirim të përkohshëm, duke arsyetuar ndër të tjera, se mundësia e një dënimi me burgim të gjatë, qoftë nga procesi i Tribunalit, qoftë nga implikimi i pretenduar i të Akuzuarit në vrasjen e shtatë individëve nga IRJM-ja, mund të përbënte shtysë për të Akuzuarin për t'u arratisur.[2159] Për më tepër Dhoma Paragjyqësore nuk u bind se lirimi i të Akuzuarit nuk mund të përbënte rrezik për viktima, dëshmitarë apo persona të tjerë.[2160] Dhoma Paragjyqësore hodhi poshtë

[2153] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Mocioni i Prokurorisë për leje për të ndryshuar Aktakuzën e Dytë të Ndryshuar me Shtojcat A dhe B," 28 shtator 2007, para. 1.
[2154] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Përgjigjja e përbashkët e Mbrojtjes mocionit të Prokurorisë për leje për të ndryshuar Aktakuzën e Dytë të Ndryshuar," 17 tetor 2007, paragrafët 4(iii), 8-10.
[2155] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Vendim mbi mocionin për të ndryshuar Aktakuzën," 14 nëntor 2007, *shih* ndër të tjera, para. 7.
[2156] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i Mbrojtjes së Lube Boshkoskit për lirim të përkohshëm," 25 maj 2005.
[2157] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Pergjigjja e Prokurorisë kërkesës së Lube Boshkoskit për lirim të përkohshëm," 7 qershor 2005, paragrafët 16-23.
[2158] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim mbi mocionin e Mbrojtjes së Lube Boshkoskit për lirim të përkohshëm," 18 korrik 2005, para. 1.
[2159] *Ibid,* para. 32.
[2160] *Ibid,* para. 43.

gjithashtu kërkesën e të Akuzuarit për lirim të përkohshëm në Kroaci, për arsye se qeveria kroate nuk mori pjesë në seancën gojore të datës 4 korrik dhe nuk u shpreh për këtë çështje, si dhe nuk lëshoi garanci shtetërore për të Akuzuarin.[2161] Më 28 shtator 2008, Dhoma e Apelit hodhi poshtë apelin e Lube Boshkoskit kundër këtij vendimi.[2162]

619. Johan Tarçulovski dorëzoi një kërkesë për lirim të përkohshëm më 20 maj 2005.[2163] Prokuroria e kundërshtoi mocionin.[2164] Më 18 korrik 2005 Dhoma Paragjyqësore e hodhi poshtë kërkesën e Johan Tarçulovskit për lirim të përkohshëm sepse kishte dyshime rrënjësore nëse do të paraqitej në gjyq dhe nëse mund të përbënte rrezik për viktima, dëshmitarë apo persona të tjerë.[2165] Më 4 tetor 2005, u hodh poshtë apeli i Johan Tarçulovskit kundër këtij vendimi.[2166] Më 1 dhjetor 2006 i Akuzuari dorëzoi konfidencialisht një mocion të dytë për lirim të përkohshëm, duke argumentuar se kishte pasur një ndryshim material në rrethanat lidhur me kërkesën e tij.[2167] Dhoma Paragjyqësore e rrëzoi këtë mocion më 17 janar 2007, duke konkluduar se i Akuzuari nuk kishte provuar ndryshim faktik material të rrethanave që prej Vendimit të Dhomës Paragjyqësore i cili hodhi poshtë kërkesën e tij të parë për lirim të përkohshëm.[2168] Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë të dy mocionet e mëvonshme për lirim të përkohshëm, përkatësisht më 19 korrik 2007 dhe më 10 dhjetor 2007.[2169]

[2161] *Ibid,* paragrafët 47, 49.
[2162] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR65.2, "Vendimi mbi apelin e ndërkohshëm të Lule Boshkoskit për lirim të përkohshëm," 28 shtator 2005, para. 24.
[2163] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i dorëzuar nga Mbrojtja e Johan Tarçulovskit i cili kërkon lirim të përkohshëm për të Akuzuarin Tarçulovski," 20 maj 2005.
[2164] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Përgjigjja e Prokurorisë kërkesës së Johan Tarçulovskit për lirim të përkohshëm," 2 qershor 2005, paragrafët 5-12.
[2165] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim mbi mocionin e Johan Tarçulovskit për lirim të përkohshëm," 18 korrik 2005, paragrafët 20, 30 dhe 33.
[2166] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR-65.1, "Vendim mbi apelin e ndërkohshëm të Johan Tarçulovskit për lirim të përkohshëm," 4 tetor 2005.
[2167] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Mocioni i dytë i Johan Tarçulovskit për lirim të përkohshëm," dorëzuar me mirëbesim më 1 dhjetor 2006.
[2168] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Vendim lidhur me mocionin e rishikuar për lirim të përkohshëm të Johan Tarçulovskit," 17 janar 2007, paragrafët 17, 22 dhe f. 12, Dispozitë.
[2169] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Vendim mbi mocionin e Johan Tarçulovskit për lirim të përkohshëm për arsye humanitare," me mirëbesim, 19 korrik 2007; *shih* gjithashtu *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR65.4, "Vendim mbi apelin e ndërkohshëm të Johan Tarçulovskit për lirim të përkohshëm," 27 korrik 2007; Vendim mbi mocionin e katërtë të Tarçulovskit për lirim të përkohshëm me Shtojcat A deri B," 10 dhjetor 2007.

5. Fillimi i procesit

620. Prokuroria e dorëzoi Dosjen Paragjyqësore për herë të parë më 7 nëntor 2005, bashkë me një listë dëshmitarësh dhe provash materiale sipas Rregullës 65*ter*(E) të Rregullores. Më 4 prill 2006 u dorëzua një Dosje Paragjyqësore e rishikuar.[2170] Mbrojtjet e të Akuzuarve dorëzuan Dosjet e tyre Paragjyqësore më 2 tetor 2006.[2171]

621. Më 2 prill 2007, me Urdhër të Gjykatësit Carmel Agius, Kryegjykatësi i atëhershëm i Dhomës Gjyqësore II, çështja iu caktua një trupi gjykues të Dhomës Gjyqësore II, të përbërë prej Kryegjykatësit Kevin Parker, Gjykatëses Christine Van Den Wyngaert dhe Gjykatësit Krister Thelin.[2172] Konferenca paragjyqësore u zhvillua më 12 prill 2007 dhe procesi gjyqësor filloi më 16 prill 2007.

B. Procesi Gjyqësor

1. Vështrim i përgjithshëm

622. Prokuroria e nisi argumentimin e çështjes më 16 prill 2007 dhe e përfundoi më 6 dhjetor 2007. Mbrojtja e Boshkoskit nisi argumentimin e çështjes më 30 janar 2008 dhe e përfundoi më 4 mars 2008. Mbrojtja e Tarçulovskit nisi më 4 mars dhe e përfundoi më 18 mars 2008. Argumentet përfundimtare u dëgjuan nga 6 deri më 8 maj 2008. Dhoma mori dëshmitë e 56 dëshmitarëve të Prokurorisë; dëshmitë e gjashtë prej këtyre dëshmitarëve u paraqitën të gjitha në formën e deklaratave të Rregullës 92*bis*. 17 dëshmitarë të tjerë të Prokurorisë dëshmuan sipas Rregullës 92*bis*, por iu kërkua të paraqiteshin para Dhomës për t'iu përgjigjur pyetjeve. Dëshmitë e shtatë dëshmitarëve të Prokurorisë u paraqitën sipas Rregullës 92*ter*. Mbrojtja e Boshkoskit thirri gjithsej 13 dëshmitarë; dëshmitë e shtatë prej të cilëve u pranuan në formën e deklaratave me shkrim sipas Rregullës 92*bis*.

[2170] Parashtrimi i dosjes paragjyqësore të ndryshuar në prill 2006.
[2171] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Dosja paragjyqësore e Mbrojtjes së Boshkoskit," 2 tetor 2006 dhe "Dosja paragjyqësore e Mbrojtjes së Johan Tarçulovskit," 2 tetor 2006.
[2172] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-PT, "Urdhër për përbërjen e Dhomës Gjyqësore," 2 prill 2007.

Tre prej këtyre dëshmitarëve të Rregullës 92*bis* iu kërkua të paraqiten për t'iu përgjigjur pyetjeve. Mbrojtja e Tarçulovskit thirri shtatë dëshmitarë, katër prej të cilëve sipas Rregullës 92*bis*. Njërit prej dëshmitarëve të Rregullës 92*bis* iu kërkua të paraqitej për t'iu përgjigjur pyetjeve.

2. Çështje lidhur me dëshmitarët

623. Për procesin, Dhoma miratoi masa mbrojtëse për 13 dëshmitarë të Prokurorisë dhe një dëshmitar të Mbrojtjes. Dhoma lëshoi urdhërparaqitje për gjashtë dëshmitarë.

3. Vendimi në lidhje me pranueshmërinë e provave

624. Më 18 shtator 2007, Prokuroria paraqiti gojarisht kërkesë për pranimin si prova të disa dokumenteve, ndër të cilat deklarata të Johan Tarçulovskit dhe të disa personave të tjerë para një komisioni të krijuar në mars 2003 nga ish-Ministri i Brendshëm, Hari Kostov, për hetimin e ngjarjeve të Lubotenit.[2173] Më 7 dhjetor 2007, Dhoma lëshoi vendimin e saj për mocionin dhe pranoi si provë, ndër të tjera, një intervistë të Johan Tarçulovskit,[2174] një dokument me dëshminë e kësaj interviste,[2175] dhe një "Notë Zyrtare" nga Johan Tarçulovski dhënë komisionit.[2176] Intervista e Johan Tarçulovskit dhe informacioni me përmbajtjen e kësaj interviste nuk u pranuan si provë kundër Lube Boshkoskit.[2177]

[2173] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Seancë Gjyqësore, 18 shtator 2007, T 5135; 5147-5151.
[2174] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Vendim mbi mocionin e Prokurorisë për pranimin si provë materiale të dokumentave MFI P251, P379 dhe P435," 7 dhjetor 2007, "Procesverbali i datës 12 nëntor," intervista e Johan Tarçulovskit me Komisionin më 12 nëntor 2003, para. 3 dhe f. 24-25.
[2175] *Ibid*, para. 3 dhe f. 24-25, "Informacioni i datës 25 nëntor 2003," duke përmbledhur intervistën e Johan Tarçulovskit me Komisionin më 5 maj 2003.
[2176] *Ibid*, para. 3 dhe f. 24-25, një "Shënim Zyrtar," shkruar nga Johan Tarçulovski në lidhje me takimin e Komisionit në të cilin ai mori pjesë më 5 maj 2003.
[2177] *Ibid*, f. 25.

625 Gjatë procesit, Dhoma miratoi, plotësisht apo pjesërisht, disa mocione për pranimin e dokumenteve drejtpërsëdrejti në Sallën Gjyqësore,[2178] duke lejuar pranimin e provave materiale, ndër të tjera, rregulla, vendime gjyqësore dhe dokumenta të tjera zyrtare.

[2178] *Prokurorja k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, "Vendim mbi mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma, me shtojcat me mirëbesim A-E," 14 maj 2007; "Vendim mbi parashtrimin e Prokurorisë mbi përkthimin anglisht të provave materiale të caktuara të cilat janë temë të žMocionit të Prokurorisë për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma, me shtojcat me mirëbesim A dhe B," 19 korrik 2007; "Vendim mbi mocionin e Mbrojtjes së Boshkoskit për pranimin e dokumentave drejtpërdrejt nga Dhoma, me shtojcat me mirëbesim A deri B," 21 nëntor 2007; "Vendim mbi mocionin e dytë të Prokurorisë për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma," 5 dhjetor 2007; "Vendim mbi mocionin e tretë të Prokurorisë për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma," 5 dhjetor 2007; "Vendim mbi mocionin e Mbrojtjes së Boshkoskit për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma – për žKonfliktin e Armatosur' dhe kërkesa të tjera të lidhura me Nenin 3 të Statutit," 27 shkurt 2008; "Vendim mbi mocionin e dytë të Mbrojtjes së Boshkoskit për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma – për žKonfliktin e Armatosur' dhe elemente të tjera," 28 shkurt 2008; "Vendim mbi mocionin e dytë të Mbrojtjes së Boshkoskit për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma," 12 mars 2008; "Vendim mbi mocionin e Mbrojtjes së Tarçulovskit për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma," 12 mars 2008; "Vendim mbi mocionin e Mbrojtjes së Boshkoskit për të ndryshuar listën e saj të Rregullës 65*ter* dhe për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma," 20 mars 2008; "Vendim mbi mocionin e dytë të Mbrojtjes së Tarçulovskit për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma me shtojcën A," 7 prill 2008; žKorrigjim vendimit mbi mocionin e dytë të Tarçulovskit për pranimin e provave materiale drejtpërdrejt nga Dhoma me shtojcën A," 15 prill 2008.